



ALEANCA PËR FËMIJËT NË SHQIPËRI
Albanian Children's Alliance

Raport Alternativ i Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve (2005 – 2009)

Të drejtat e fëmijëve janë të drejta njerëzore

Drejtuar:

Komitetit të të Drejtave të Fëmijëve të OKB-së,
Gjenevë, ZVICËR

Prill 2009

Perberja e grupit te punes te Delegibus Consulting Law Firm:

Eksperti kryesor per metodologjine dhe legjislacionin:
Holta Zacaj, LL.M.

Eksperte ligjore:
Rezarta Abdiu, LL.M.
Entila Zyba

Ekspert psikolog,
Klodian Gega, Psikolog Klinikist

Redaktoi materialin: Mimoza Gjika

SHTËPIA BOTUESE & SHTYPSHKRONJA



Rruga e Elbasanit, Pallatet Filipeu Nr.2
Tel: 048 810 177/ 178 Cel: 069 20 26 773
Email: pegi@icc-al.org
www.botimepegi.com
Tiranë, SHQIPËRI

Përmbajtja

1. Hyrje	5
2. Masat e përgjithshme	11
3. Përkufizimi i termit <i>fëmijë</i>	19
4. Parimet e përgjithshme	21
5. Të drejtat civile dhe politike	41
6. Ambienti familjar dhe përkujdesja alternative	59
7. Shëndeti parësor dhe mbrojtja sociale	93
8. Edukimi, argëtimi dhe aktivitetet kulturore	111
9. Masat e posaçme të mbrojtjes	123
Aneks I – Zbatimi i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve analizuar nga këndvështrimi i fëmijëve, dhjetor 2008- janar 2009	159
Aneks II – Informacion nga strukturat kryesore publike dhe jo-publike të përfshira në garantimin e të drejtave të fëmijëve, janar–shkurt 2009 (Përmbledhje instrumentesh metodologjike)	205
Aneks III – Raport monitorues mbi zbatimin e të drejtave të fëmijëve në ambientet e paraburgimit dhe burgut, kryer nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, janar–mars 2009	277
Aneks IV - Lista e organizatave të angazhuara në mënyrë aktive për hartimin e Raportit Alternativ	293



I. HYRJE

Ky është Raporti i Parë Alternativ për Zbatimin e Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve, i përgatitur nga Aleanca e Fëmijëve, e cila është koalicioni më i madh i fëmijëve në Shqipëri, i përbërë nga 150 organizata. Aleanca ka synuar që, nëpërmjet këtij raporti, të hedhë dritë mbi situatën e të drejtave të fëmijëve, shkeljeve dhe mosrespektimit të tyre. Në këtë këndvështrim, ky raport është komplementar me raportin e përgatitur nga shteti shqiptar. Për më tepër, ky raport është munduar të prodhojë një analizë sistematike të përputhshmërisë së legjislacionit të brendshëm, të zbatimit të tij në praktikë, me standardet e vendosura në Konventë. Struktura e raportit, është bazuar në standardin e sugjeruar nga Komiteti i të Drejtave të Fëmijëve për raportin e shtetit, në mënyrë që të lehtësojë krahasimin e gjetjeve dhe përmbajtjes së dy raporteve.

Në këtë kuadër, Aleanca do të donte të sillte në vëmendje të Komitetit se Shqipëria është një vend, i cili vazhdon të përballet me sfidat për të superuar reminishencat e të kaluarës së sistemit komunist dhe të varfërisë me të cilat u përball vendi në vitet pas ardhjes së demokracisë. Vlen të theksohet se pas viteve '90 Shqipëria ka hartuar nga e para, pothuaj, gjithë kuadrin ligjor, ka ratifikuar një sërë aktesh ndërkombëtare, ndër të cilat ato për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe është anëtare e Këshillit të Europës. Në 12 dhjetor 2006, hyri në fuqi Marrëveshja e Stabilizim Asocimit e shtetit shqiptar me Bashkimin Europian në kuadër të së cilës shteti shqiptar, është i detyruar të ndërmarrë një sërë reformash për të bërë të mundur përqasjen e këtij legjislacionit me *aquis communautaire*. Shqipëria, gjithashtu, është miratuar si vend kandidat për anëtarësim në Organizatën e Aleancës së Atlantikut të Veriut (NATO). Duke përmendur dhe përshëndetur këto arritje në rrafshin e zhvillimit të marrëdhënieve dhe të reputacionit të shtetit shqiptar në arenën ndërkombëtare, do të donim të sillnim në vëmendje të Komitetit se arritjet e mësipërme duhet të konsiderohen nga shteti shqiptar si një burim i shtuar i detyrimit për të përmbushur standardet e kërkuara nga Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve dhe për t'i konsideruar ato si prioritare, jo vetëm në planin deklarativ e politik, por edhe atë praktik, duke prodhuar në realitet rezultatet e pritshme për t'u siguruar fëmijëve shqiptarë një nivel të përshtatshëm mirëqenieje, kushte mirërritjeje, akses të pakushtëzuar për edukim dhe arsimim, mbrojtje të posaçme për grupet e fëmijëve vulnerabël, mbështetje më të madhe për familjet që fëmijët të kenë mundësi të rriten në gjirin e saj, garanci më të madhe angazhimi, përpjekjeje dhe monitorim nga strukturat përgjegjëse për trajtimin e fëmijëve, ofrimin e ndërhyrjeve të koordinuara në aspektin nacional dhe transnacional dhe ofrimin e shërbimeve të nevojshme për fëmijët viktime të trafikimit, shfrytëzimit ekonomik, apo abuzimit seksual. Në

Shqipërinë, që ka ndryshuar dhe po ndryshon, vazhdojnë ende të mbarten, jo vetëm në formë rudimentare, fenomene si ai i “gjakmarrjes” dhe ai i “krimit në familje”. Në të dyja këto raste, fëmijët janë dhe mbeten viktimat të pafajshme, ku jeta dhe çdo e drejtë e tyre është e kërcënuar deri në mosguximin për të shpresuar se shteti dhe shoqëria do të mund t’i zgjidhë dot ndonjëherë.

Duke qenë se shteti shqiptar ka ratifikuar Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve, e cila bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, është pjesë e legjislacionit të brendshëm dhe ka prioritet mbi të gjitha aktet e tjera normative të legjislacionit të brendshëm, Aleanca e Fëmijëve dëshiron që nëpërmjet këtij raporti të tregojë problematikat e legjislacionit shqiptar, nëpërmjet një analize ligjore të çështjeve kryesore si dhe të pasqyrojë sensibilitet dhe situatën e fëmijëve në praktikë, nëpërmjet fakteve, shifrave, dhe çka është më e rëndësishme, vetë zërit të fëmijëve.

Në mënyrë të përmbledhur, Aleanca do të theksojë:

- Mungesën e financimeve të nevojshme për garantimin e të drejtave të fëmijëve në nivel qendror dhe atë lokal, në mënyrë që asnjë fëmijë të mos vuajë për shkak të mungesës së një niveli minimal të pranueshëm jetese;
- Mungesën e koordinimit dhe të koherencës sistemike të strukturave të ndryshme për ngritjen e një sistemi të mirëfilltë për mbrojtjen e fëmijës;
- Mungesën e përcaktimeve të qarta të përgjegjësi të strukturave shtetërore;
- Forcimin dhe mbështetjen e rolit të familjes për fëmijët;
- Garantimin e aksesit në edukim për të gjithë fëmijët në rang vendi;
- Garantimin e aksesit në shërbime të përshtatshme shëndetësore për të gjithë fëmijët në rang vendi;
- Mungesën e mbështetjes së përshtatshme për fëmijët pa kujdes prindëror;
- Mungesën e politikave të duhura për mbështetjen dhe trajtimin e duhur të fëmijëve me aftësi të kufizuara;
- Mungesën e një sistemi të përshtatshëm dhe të plotë statistikor;
- Mosrealizimin e decentralizimit, i cili megjithëse i parashikuar në legjislacion, në lidhje me transferimin e kompetencave nuk është mbështetur me burimet e duhura financiare.

I.1 Metodologjia

Aleanca e fëmijëve, për të realizuar hartimin e këtij raporti, bashkëpunoi me shoqërinë konsulente *Delegibus Consulting Law Firm*, e cila përzgjedhi, për këtë aksion shumë të rëndësishëm një grup konsulentësh ligjorë dhe psikologë me një eksperiencë dhe ekspertizë të spikatur në fushën e të drejtave të fëmijëve, të legjislacionit dhe të praktikës së tij në fushën kushtetuese, civile, penale, familjare, administrative, atë të të drejtave të njeriut.

Aleanca pati si fokus, gjithashtu, të garantonte një proces sa më pjesëmarrës dhe transparent duke garantuar që të gjitha organizatat anëtare të bënin prezent problematikat e identifikuara në lidhje me respektimin e të drejtave të fëmijëve për shkak të praktikës së tyre në fushat dhe aktivitetet përkatëse. Në këtë kuadër, Aleanca kërkoi nga kompania konsulente dizenjimin e një metodologjie që do të lejonte një proces gjithëpërfshirës dhe do të respektonte standardet e një pune kualitative bazuar në standardet të larta profesionale për shkrimin e raportit.

Në mënyrë më të detajuar procesi i hartimit të raportit alternativ ndoqi këto metoda dhe instrumente për të garantuar pjesëmarrjen dhe transparencën:

- Ekspertët ligjorë hartuan protokolle standarde për intervista gjysmë të strukturuar për mbledhjen e informacionit në terren nga strukturat shtetërore më të përfshira në garantimin e një sërë të drejtash të fëmijëve si: drejtoritë arsimore të rretheve, drejtoritë e shëndetit parësor në rrethe, komisaritet e policisë në rrethe, administratorët socialë pranë bashkive, institucionet rezidenciale për përkujdesjen e fëmijëve dhe OJF-të, të cilat ofrojnë shërbime. Përmbajtja e këtyre instrumenteve iu bë e ditur anëtarëve të Aleancës dhe ata ranë dakord për të. Këto instrumente u realizuan në 10 rrethe të Shqipërisë përkatësisht në Tiranë, Elbasan, Shkodër, Dibër, Kukës, Durrës, Vlorë, Lushnjë, Korçë dhe Gjirokastrë, nga koordinatoret e Aleancës për Fëmijët, të cilët janë përfaqësues të organizatave të ndryshme anëtare të saj. Kompania konsulente së bashku me bordin e Aleancës organizoi një trajnim 1 ditor me intervistuesit për t'i njohur me procedurën e realizimit të intervistave dhe shpjegimin e pyetjeve për marrjen e informacionit të kërkuar.
- Aleanca e Fëmijëve konsideroi si një element shumë të rëndësishëm marrjen e mendimit të fëmijëve si subjekte të së drejtës të cilët kanë të drejtë të shprehen në lidhje me atë se si i perceptojnë dhe si i përjetojnë ata të drejtat e tyre. Pa këtë komponent raporti alternativ nuk do të ishte real dhe nuk do të zbatonte një nga të drejtat më të rëndësishme të fëmijëve, atë të marrjes në konsideratë të mendimit të tyre. Në këtë kuadër ekspertët ligjorë dhe eksperti psikolog hartuan në konsultim të përbashkët dy pyetësorë për marrjen e mendimit të fëmijëve, pyetësori për fëmijët 10-14 vjeç dhe pyetësori për fëmijët 14-18 vjeç. Përmbajtja e pyetësorëve u aprovua nga anëtarët e Aleancës pas përgatitjes së tyre nga ekspertët. Pyetësorët u shpërndanë në 10 rrethet e përmendura të Shqipërisë përkatësisht Tiranë, Elbasan, Shkodër, Dibër, Kukës, Durrës, Vlorë, Lushnjë, Korçë dhe Gjirokastrë dhe u administruan nga koordinatoret e Aleancës si dhe përfaqësues të tjerë të organizatave anëtare. Pyetësori u shpërnda në dy shkolla, një 9 vjeçare dhe një të mesme, në zonat rurale të secilit rreth. Kjo u bë për arsye se Aleanca ishte e shqetësuar për situatën e të drejtave të fëmijëve në zonat rurale,

ndërkohë që të dhëna të zgjeruara për situatën e fëmijëve në zonat urbane ekzistojnë për shkak të studimeve të mëparshme. Gjithsej u shpërndanë 1350 pyetësorë gjatë periudhës dhjetor 2008 - janar 2009. Informacioni i marrë u përpunua në programin elektronik SPSS dhe gjetjet janë përmbledhur në aneksin shoqërues të këtij raporti me titull: “Zbatimi i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve analizuar nga këndvështrimi i fëmijëve, dhjetor 2008 - janar 2009”.

- Aleanca e fëmijëve duke qenë e ndërgjegjshme për kapacitetet, ekspertizën dhe eksperiencën e vyer të punonjësve të OJF-ve anëtare, ngriti disa grupe pune për lehtësimin e mbledhjes, përpunimit, analizimit të informacionit dhe formulimin e qasjeve të duhura për adresimin e çështjeve që preokupojnë sot shoqërinë civile shqiptare dhe komprometojnë respektimin dhe garantimin e të drejtave të fëmijëve. Në këtë kuadër u ngritën këto grupe pune:
 1. Grupi i punës mbi të drejtat e fëmijëve të privuar nga kujdesi prindëror dhe të vendosur në përkujdesje institucionale;
 2. Grupi i Punës mbi të drejtat e minoriteteve;
 3. Grupi i punës për fëmijët e shfrytëzuar për punë, viktime të shfrytëzimit dhe abuzimit seksual dhe trafikimit;
 4. Grupi i punës mbi të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Përfaqësuesit e organizatave dhanë ndihmesën e tyre në grupet e punës përkatëse duke sjellë opinionet e tyre në lidhje me prioritet që duhet të kishin parasysh konsulentët gjatë procesit të hartimit të raportit në lidhje me të drejtat e fëmijëve, sipas ndarjes së detyrave në grupet e punës. Më tej, ata ndihmuan duke sjellë informacion konkret për situatën e fëmijëve në terren, duke sjellë raste të fëmijëve që ata vetë kishin trajtuar, informacion nga studimet që ishin kryer nga organizatat e tyre, informacion nga partneriteti mes OJF-ve dhe strukturave shtetërore, projekteve pilot, praktikave më të mira dhe iniciativave ligjore përkatëse. Për shkak të vetë punës së tyre në terren, kontributi i anëtarëve të grupeve të punës ishte shumë i rëndësishëm sa i takon ekzaminimit dhe evidentimit konkret të problematikave në lidhje me mungesën apo nevojën e krijimit të infrastrukturës së duhur për zbatimin korrekt të legjislacionit dhe është, gjithashtu, për t'u theksuar kontributi për hartimin e rekomandimeve konkrete sipas të drejtave. Një informacion më i hollësishëm mbi organizatat sipas pjesëmarrjes së tyre në grupe pune gjendet në listën e organizatave në Aneksin IV.

- Është për të theksuar se Aleanca e Fëmijëve, përveç angazhimit të organizatave anëtare ka bashkëpunuar ngushtë për hartimin e këtij raporti alternativ edhe me Koalicionin e BKTF-së “Bashkë

Kundër Trafikimit të Fëmijëve”, i përbërë nga 19 organizata, të cilat punojnë direkt me fëmijë viktime të trafikimit apo me fëmijë në rrezik për t’u trafikuar, të shfrytëzuar apo të abuzuar. Aleanca ka bashkëpunuar, gjithashtu, edhe me Komitetin e Helsinkit, i cili në kuadër të kësaj iniciative ndërmori një seri vizitash monitoruese në ambientet e paraburgimit dhe burgut për fëmijë.

- Aleanca është ndihmuar, gjithashtu, nga strukturat shtetërore, të cilat kanë qenë të gatshme të bashkëpunojnë për dhënien e informacionit, garantimin e aksesit të grupit të ekspertëve në dokumente informative si dhe në vetë ambientet të cilat janë vëzhguar apo janë përdorur për të kryer intervistimet apo administrimin e pyetësorëve me fëmijët.

Në mënyrë më të detajuar Aleanca falënderon:

- Komitetin Ndërmintor nën kujdesin e Zv/Kryeministrit;
- Shërbimin Social Shtetëror dhe punonjës të institucioneve të përkujdesjes së fëmijëve;
- Drejtoritë arsimore në rrethe;
- Qendrat e shëndetit parësor në rrethe;
- Komisariatet e policisë;
- Administratorët socialë në Bashki;
- Punonjës të Sekretariatit Kombëtar të Fëmijëve pranë MPÇSSHB;
- Avokatin e Popullit;
- INSTAT;
- Drejtorinë e Buxhetit në Ministrinë e Financave;
- KKRRT;
- Sekretariatin Teknik të Fëmijëve pranë MPÇSSHB;
- Drejtorinë e Refugjatëve pranë MB;
- Së fundi, por jo për nga rëndësia, Aleanca e Fëmijëve do të falënderojë UNICEF dhe Save the Children, Shqipëri, për mbështetjen e dhënë në realizimin e gjithë procesit të hartimit të raportit alternativ.

Duke konkluduar këtë hyrje të Raportit të saj të Parë Alternativ, Aleanca e Fëmijëve kërkon edhe njëherë të sjellë në vëmendjen e Komitetit të të Drejtave të Fëmijëve, se ky raport synon të ndihmojë të gjithë organizmat shtetërore dhe jo-shtetërore, kombëtare dhe ndërkombëtare për të kuptuar realitetin e fëmijëve shqiptarë duke e parë situatën e tyre jo vetëm në optikën e ligjit dhe të projekteve në dokumentet politiko-strategjike, por të vetë të drejtave, se si dhe se sa ato ekzistojnë në realitet tek fëmijët shqiptarë.







II. Masat e Përgjithshme të zbatimit të Konventës (nenet 4, 42, 44)

Neni 4 - Zbatimi i të drejtave

Kuadri ligjor: Shqipëria u bë palë në Konventën e të Drejtave të Fëmijës (KDF) në 28 mars 1992 dhe në Protokollin e saj Opsional “Për përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura” dhe “Për shitjen e fëmijëve, prostitucionin e pornografinë me fëmijë”¹, akte të cilat në përputhje me dispozitat kushtetuese janë bërë tashmë pjesë e sistemit ligjor shqiptar.² Kushtetuta njeh fuqinë ligjore të marrëveshjeve/traktateve ndërkombëtare të ratifikuara vetëm pas publikimit në Fletoren Zyrtare³, si dhe parimin e vetëzbatueshmërisë së tyre, përjashtuar ato raste kur dispozitat nuk kanë efekt të drejtpërdrejtë dhe zbatimi i tyre kërkon nxjerrjen e ligjit. Kushtetuta garanton përparësinë e KDF ndaj të drejtës së brendshme, për sa kohë që kjo e fundit bie në kundërshtim me dispozitat e saj.⁴ Në këtë aspekt, ia vlen të nënvizojmë se prej vitit 1992 ende mbetet i papublikuar në Fletore Zyrtare teksti i KDF. Ndërkohë që tekstin e KDF në gjuhën shqipe e gjejmë të publikuar on-line në faqen zyrtare të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.⁵

Fëmijët gëzojnë, sipas dispozitave kushtetuese, mbrojtje të veçantë nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi, përdorimi për punë, mbrojtjen e shëndetit, moralit apo zhvillimin e tyre normal.⁶ Por në këtë aspekt, Kushtetuta ende garanton të drejtat duke iu referuar individëve në përgjithësi, pa u ndalur specifikisht tek kategoria e të miturve, mangësi dhe problematika ligjore që janë bërë prezente gjatë ekzaminimit nën për nen të këtij raporti.

Shteti shqiptar ende nuk ka realizuar një studim gjithëpërfshirës dhe krahasimor për të vlerësuar masat dhe kuadrin ligjor në funksion të zbatimit të KDF. Ndërkohë që shoqëria civile, “Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara” në bashkëpunim me Avokatin e Popullit dhe mbështetur nga Save

¹ Ligji Nr. 9893, datë 22.11.2007 dhe Ligji Nr. 9894, datë 22.11.2007 për aderimin në Protokollin Opsional të KDF.

² Neni 116, Kushtetuta e R.Sh.

³ Neni 122, Kushtetuta e R.Sh.

⁴ Neni 122/1. Kushtetuta e R.Sh.

⁵ www.mpcs.gov.al

⁶ Neni 54, Kushtetuta e R.Sh. “1. Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti. 2. Fëmijët e lindur jashtë martese kanë të drejta të barabarta me të lindurit nga martesa. 3. çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin e tij normal”.

the Children ka realizuar një studim krahasimor të KDF me Legjislacionin Shqiptar deri në vitin 2007.⁷ Gjithashtu, Ministria e Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta ka ndërmarrë iniciativën dhe ka ngritur grupin e punës për hartimin e një ligji të përgjithshëm mbi të drejtat e fëmijëve, hartimi i të cilit është ende në proces.⁸ Në këtë Projektligj parashikohen edhe një herë, në kuadrin e subjektit të fëmijëve, të drejtat themelore të njeriut të cilat garantohen në aspektin kushtetues për të gjithë shtetasit, si dhe parimet kryesore të KDF-së. Risi e këtij projektligji është ngritja e mekanizmave institucionale në nivel qendror dhe vendor për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Më tej, në këtë projektligj, parashikohet ngritja dhe funksionimi i një autoriteti përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të fëmijëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe nga palët e treta që veprojnë për llogari të saj. Me gjithë arritjet në lidhje me hartimin e një ligji të posaçëm të fëmijëve, problematik mbetet ende zbatimi i gjerë i parimeve kryesore të të drejtave të fëmijëve të parashikuara në këtë projekt-akt pasi ato janë të pazbatueshme për sa kohë në procedurat ligjore dhe gjyqësore implikohet zbatimi i kodeve ligjore. Sipas nenit 116 të Kushtetutës së R. Sh, përcaktohet hierarkia e akteve dhe mënyra e interpretimit të tyre sipas kësaj hierarkie. Duke qenë se ligji është më poshtë kodeve në hierarkinë e akteve ligjore,⁹ parashikimet e tij nuk mund t'i mbivendosen parashikimeve të Kodeve. Në këtë kuadër do të kishte qenë më e drejtë që ligji i mësipërm të ishte menduar si një Kod për Fëmijët se sa si një ligj. Pjesë të tij, siç është ai i mekanizmave mbrojtës apo ngritja e autoritetit përgjegjës, mund të mbeteshin në ligj, i cili do të detajonte Kodin e Fëmijëve.

Koordinimi: Qeveria Shqiptare ka miratuar “Strategjinë Kombëtare për Fëmijët” dhe Planin e saj të Veprimit (2005-2010)¹⁰ përmbajtja e të cilës është publikuar rishtazi në Fletoren Zyrtare.¹¹ Strategjia udhëhiqet nga

⁷ Studimi përfaqëson një analizë gjithëpërfshirëse dhe kapilare nëpërmjet së cilës është synuar në radhë të parë të krijohet një instrument për të evidentuar arritjet dhe mangësitë e legjislacionit Shqiptar në lidhje me reflektimin e standardeve që vendos Konventa për të Drejtat e Fëmijës. Nëpërmjet analizës dhe rekomandimeve konkrete, studimi shërben si bazë për të punuar për përmirësimin e legjislacionit shqiptar nga institucionet përgjegjëse shtetërore si dhe për të përforcuar punën lobuese të organizmave të Avokatit të Popullit dhe organizatave kombëtare e ndërkombëtare që punojnë në Shqipëri për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.

⁸ Në datë 30.03.2009 është bërë promovimi i parë i procesit të punës mbi hartimin e draft-ligjit.

⁹ Neni 116, Kushtetuta e R.Sh, dhe Vendimet e Gjykatës Kushtetuese Nr. 3, datë 20.02.2006 “... Rendi juridik nuk është një radhitje e barasvlershme normash, por një sistem hierarkik, i cili përbëhet nga nivele të ndryshme vlefshmërie, dhe në secilin prej këtyre niveleve, qëndron një normë ose grup normash duke përfshirë kështu edhe fuqinë e caktuar juridike”, dhe Vendim Nr. 19, datë 03.05.2007 “..... Referimi i drejtpërdrejtë nga Kushtetuta i mënyrës së miratimit të ligjeve organike të institucioneve të sipërpërmendura u jep atyre fuqi të veçantë juridike në krahasim me aktet e zakonshme të ligjvënësit. Për këtë arsye, në hierarkinë e akteve, ata renditen pas Kushtetutës dhe para ligjeve të zakonshme të Kuvendit. Mbështetur në këto konsiderime, Gjykata Kushtetuese rithekson se ligjet e zakonshme duhet të nxirren jo vetëm në bazë dhe për zbatim të Kushtetutës, por duhet treguar kujdes i veçantë që ata të mos prekin rregullimet që përfshihen natyrshëm në sferën ekskluzive të ligjeve organike, përndryshe ato do të binin në kundërshtim me nenet 6 dhe 81, pika 2, shkronja “a” të Kushtetutës.

¹⁰ Miratuar me VKM Nr. 368, datë 31.05.2005.

¹¹ Fletore Zyrtare ekstra, datë 11.09. 2008.

parimet kryesore të KDF,¹² por nga ana tjetër paraqet mangësi dhe nevojën për rishikim në një sërë fushash të saj, të cilat janë bërë evidente në rekomandimet konkrete nen për nen.

Monitorimi i kësaj strategjie realizohet nga “Komiteti Ndërmintor për të Drejtat e Fëmijëve”¹³ dhe Sekretariati Teknik i Fëmijëve.¹⁴ Ndërkohë që në nivel vendor mungojnë ende mekanizmat shtetërorë për vënien në zbatim të detyrimeve të strategjisë, të cilat aktualisht po mbulohen nga njësitë e mbrojtjes së fëmijëve-CPU- të ngritura në nivel projekti vetëm në 7 qytete të Shqipërisë.¹⁵

Nga ana tjetër, shteti shqiptar vazhdon ta trajtojë mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në nivel dokumentesh politike,¹⁶ si dhe nuk i kushton një vëmendje të veçantë uljes së pabarazisë, apo diskriminimit të të drejtave të

¹² Bazuar në katër objektiva kryesore; Mbijetesa e fëmijës; Mbrojtja e fëmijës; Zhvillimi i fëmijës; Pjesëmarrja e fëmijës, gjithashtu, përshkruan tërësinë e masave që duhet të ndërmerren nga ministritë e ndryshme për realizimin e të drejtave të fëmijëve.

¹³ Kjo strukturë është ngritur me urdhër të Kryeministrit Nr. 118, datë, 30.06. 2004, si një organ këshillimor i Këshillit të Ministrave, që në përputhje me programin e Qeverisë, bashkërendon dhe përcakton politikat në nivel qendror si dhe ndjek zbatimin e Strategjisë në bazë të raportimeve të Sekretariatit teknik të fëmijëve.

¹⁴ Strukturë e ngritur me urdhër të Kryeministrit Nr. 162, datë 24.07.2006, si strukturë në Drejtorinë e Politikave dhe Shanseve të Barabarta, në MPÇSSHB, ndjek zbatimin e Strategjisë si në nivel qendror dhe vendor.

¹⁵ Njësitë e mbrojtjes së fëmijëve aktualisht po pilotohet në 7 bashki të vendit në kuadër të projektit TACT financiar nga UNICEF në bazë të të cilit synohet promovimi i të drejtave të fëmijëve në nivel vendor, identifikimin dhe referimin e fëmijëve vulnerabël e në nevojë për mbështetje, parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha llojet e abuzimit, shfrytëzimit, dhunës, neglizhimit e trafikimit. Si dhe koordinimin e veprimeve me aktorë vendorë për menaxhimin me efikasitet të rasteve të identifikuar.

¹⁶ Shteti shqiptar ka miratuar këto dokumente politike të cilat prekin në mënyrë direkte dhe indirekte të drejtat e fëmijët;

* “Strategjinë Kombëtare për integrim dhe zhvillim 2008-2013” dokument i cili zëvendëson Strategjinë e mëparshme Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik dhe Social (SKZHES). Kjo strategji përfshin prioritetet dhe objektivat e integritit të Shqipërisë në BE dhe NATO dhe jep vizionin për zhvillimin e vendit dhe integrimin e tij në këto struktura. SKZHI referon te strategjitë sektoriale si dokumente më të hollësishëm për ndërhyrje strategjike në fusha, ose sektorë, të caktuar. Ndër këto strategji sektoriale është edhe Strategjia për Fëmijët apo Strategjia kundër trafikimit të fëmijëve.

* Strategjia Kombëtare për Fëmijët dhe Plani i Saj i Veprimit (2005-2010), kjo strategji përbën një dokument të rëndësishëm, ku përcaktohen objektivat strategjike të politikës së qeverisë dhe Shtetit Shqiptar në këtë drejtim. Ky dokument përshkruan tërësinë e masave që duhet të ndërmerren nga ministritë e ndryshme për realizimin e të drejtave të fëmijëve.

* “Strategjia e mbrojtjes sociale dhe planit të saj të veprimit” (2008-2013) (VKM nr 80, datë 28.01.2008) përcakton një politikë të qartë për reformimin e sistemit të pagesave dhe shërbimeve shoqërore, jo vetëm për grupet në nevojë, por për të gjithë shoqërinë. Fëmijët jashtë kujdesit prindëror dhe ata me aftësi të kufizuara janë të përfshirë shprehimisht në këtë strategji. Ndërkohë, objektivat e vendosura në të kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në respektimin e të drejtave të fëmijës sipas KDF.

* Strategjia për përfshirjen sociale (2007-2013) (VKM Nr. 218, datë 3.2.2008 dhe ndryshimet me VKM Nr. 1104, datë 30.07.2008). Kjo strategji është ndërsektoriale dhe fokusohet në varfërinë dhe përjashtimin social, rreziqe që mbeten edhe pas rritjes ekonomike dhe më specifikisht i referohet fëmijëve të rrezikuar nga dhuna, abuzimi e neglizhimi, fëmijëve romë e atyre me aftësi të kufizuara. Kjo strategji në lidhje me fëmijët e rrezikuar zhvillon një politike të integruar dhe i një strukturë institucionale për të siguruar ndërhyrje të hershme për fëmijët e rrezikuar, për zhvillimin dhe mbrojtjen e tyre nga të gjitha llojet e abuzimit, dhunës dhe shfrytëzimit.

* “Strategjia Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Komunitetit Rom” (VKM Nr. 633, datë 18.09.2003) është bazuar në analizën kritike dhe vlerësimin e problemeve të komunitetit rom. Hartimi i saj bëhet në kuadrin e përpjekjeve për përmirësimin e kushteve të jetesës së pakicës rome përmes politikave e programeve konkrete për zbutjen e varfërisë, përfshirjen e tyre në jetën publike, ruajtjen dhe

fëmijëve në pjesë të ndryshme të vendit, fakt i cili konstatohet në mënyrë të veçantë në ndarjen dhe ofrimin shërbimeve apo mekanizmave parandaluese të fenomeneve të shkeljes të të drejtave të fëmijëve, problematika të cilat janë bërë evidente në ekzaminimin e neneve të këtij raporti.

Pranë Avokatit të Popullit, si një institucion i pavarur dhe një nga institucionet përgjegjës për respektimin e të drejtave të fëmijës, është ngritur Nënseksioni i të Drejtave të Fëmijës, si pjesë e seksionit të përgjithshëm të ankesave. Misioni i këtij nënseksioni, është të shërbejë si avokat dhe monitorues i të drejtave të fëmijës, në përputhje me Konventën e të Drejtave të Fëmijëve. Ndërkohë që gjatë vitit 2008 zyrat vendore të Korçës dhe të Shkodrës u mbyllën për shkak të mungesës së mjeteve financiare.

Burimet financiare: Buxheti hartohet duke ndjekur rrugën e propozimeve nga departamentet e ministrive të caktuara,¹⁷ por hartimi i tij nuk mban parasysh në mënyrë të veçantë interesin më të lartë të fëmijës dhe grupet e fëmijëve në nevojë. Mënyra e hartimit të buxhetit të shtetit nuk lë vend për identifikimin e masës së zhvillimit e identitetit të tyre etnik. Për sa i përket fëmijëve rom, strategjia i referohet kësaj kategorie në mënyrë specifike sidomos në kreun e parë për arsimin dhe edukimin.

* “Strategjia Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara dhe Plani i saj i Veprimit” (VKM Nr. 8, datë 7.01.2005) përcakton një platformë masash për të përmirësuar jetesën e personave me aftësi të kufizuara në përgjithësi. Objektivat dhe masat e kësaj strategjie parashikojnë specifikisht të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, si ajo e dëgjimit të mendimit të fëmijës, të arsimit, shërbimit shëndetësor, argëtimit, të së drejtës për informim, të së drejtës për t’u rritur si fëmijë. Megjithatë, kësaj strategjie i mungon një fokus i veçantë për fëmijët PAK dhe për mbrojtjen e tyre nga fenomene si abuzimi, dhuna, neglizhimi apo shfrytëzimi të cilat përbëjnë edhe parimet bazë të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në kuadrin e KDF-së.

* “Strategjia Kombëtare kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore” (2008-2010) si dhe Dokumentit plotësues “Strategjia Kombëtare kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjes së Fëmijëve Viktima të Trafikimit” (VKM Nr. 1083, datë 23.07.2008). Strategjia Kombëtare kundër trafikimit të qenieve njerëzore ka për qëllim rritjen e aksesit të fëmijëve në arsim dhe përfshirjen e tyre në shkollë, regjistrimin e fëmijëve duke përmirësuar sistemin e regjistrimit të gjendjes civile, eliminimin e punës së fëmijëve dhe ndërtimin e sistemeve të integrimit dhe mbrojtjes, si dhe rrjetet e sigurisë për fëmijët dhe familjet e tyre në nivel rajonal dhe lokal që i përgjigjen një gamë më të madhe abuzimesh kundër shfrytëzimit të fëmijëve, përfshirë trafikimin e qenieve njerëzore.

Ndërkohë që “Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjen e Viktimave Fëmijë të Trafikimit” 2008-2010 nuk mbivendos Strategjinë e mësipërme, por e trajton çështjen e trafikimit të fëmijëve në mënyrë më të plotë, gjithëpërfshirëse, brenda kontekstit të Strategjisë Kombëtare, duke i mëshuar qasjes dhe masave specifike që nevojiten në rastin e të miturve. Strategjia përshpejton nismat aktuale për të zvogëluar dhe për të zhdukur trafikimin e fëmijëve në Shqipëri duke forcuar dhe koordinuar veprimtaritë e të gjitha institucioneve të përfshira qeveritare, partnerëve ndërkombëtare dhe OJF-ve vendase dhe atyre ndërkombëtare. Ajo i jep prioritet identifikimit të viktimave të mundshme të trafikimit, si edhe viktimave aktuale, përmes një funksionimi më të mirë të gjithë sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri.

* “Strategjia Kombëtare e Arsimit” (2014-2015) identifikon fushat prioritare në zhvillimin e arsimit parauniversitar në Shqipëri në funksion të qeverisjes dhe menaxhimit të arsimit, përmirësimi i cilësisë së mësimnxënies, financimi i arsimit dhe zhvillimi i kapaciteteve për zbatimin e strategjisë kombëtare të arsimit.

* “Strategjia e Shërbimeve Shoqërore” (2005-2010) (VKM Nr. 265, datë 28.04.2005) përcakton sigurimin e një politike të qartë afatmesme për reformimin e sistemit të shërbimeve shoqërore dhe specifikon në mënyrë të veçantë për fëmijët jetimë apo me probleme sociale që jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore; fëmijët jetimë pa prindër ose me një prind që nuk jetojnë në institucione; fëmijët e braktisur dhe të rrugës; fëmijët e trafikuar dhe fëmijët që punojnë.

¹⁷ Ligji Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”

fondeve e cila shkon për të përmbushur nevojat direkte të grupeve vulnerabël, apo fëmijëve në nevojë, apo për familjet me të ardhura të pamjaftueshme, masën e fondeve që shkon për shërbimet direkte që merr ky grup i popullsisë dhe masën e fondeve e cila shërben për të administruar procesin. Ndërkohë, që të tria këto kategori gjenden në të njëjtin zë buxhetor, shpesh herë të përziera me shpenzime të tjera, gjë që e bën të pamundur verifikimin e përputhjes së buxhetimit të prioriteteve strategjike në mënyrën e duhur.

Drejtorja e Buxhetimit pranë Ministrisë së Financave, e intervistuar, shpjegon se puna për hartimin e projekt-buxhetit fillon çdo muaj maj dhe synohet të përfundohet çdo muaj shtator, për tu vënë në dispozicion të institucionit ligjvënës për diskutim dhe miratim. Procedura fillon me komunikimin zyrtar me ministritë e linjës, duke i vënë në dijeni për nivelin tavan të parashikimeve buxhetore, i cili përcaktohet duke iu referuar në radhë të parë nivelit të buxhetimit të vitit paraardhës, apo historikut në vite të shpenzimeve të ministrisë, apo institucionit përkatës, por duke marrë në konsideratë edhe një sërë faktorësh të brendshëm dhe të jashtëm që pretendohet se mund të ndikojnë në shpenzimet e vitit pasardhës. Ministria e Financave mund të themi se është hallka e fundit e hartimit të tij; ky institucion thjesht luan rolin e rishikuesit të buxhetit të propozuar, sa është në përputhje me objektivat e qeverisë dhe kuadrin ligjor shqiptar, si dhe rillogaritjen e tij në përputhje me mundësitë financiare të shtetit për vitin që propozohet buxheti. Ministrinë e linjës e propozojnë buxhetin të detajuar në Ministrinë e Financave, në të cilat ato përcaktojnë prioritetet e tyre në bazë dhe në përputhje me detyrat dhe kompetencat e tyre. Në lidhje me përfshirjen e detyrimeve që burojnë nga strategjitë në projekt buxhetet, me ndryshimet e reja ligjore (ligji i 2008) gjatë fazave të diskutimit të projekt buxhetit është e detyrueshme për të diskutuar mbi këtë pikë Ministria e Integritit, Ministria e Financave dhe Kryeministria që përfaqësohet në këtë proces nga “Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj” dhe ministria e linjës që koordinon procesin e vënies në zbatim të strategjisë që është në diskutim. Në këtë fazë të diskutimit si Ministria e Linjës, edhe Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive, nxjerrin në pah detyrimet e shtetit shqiptar në bazë të strategjive të miratuara me qëllim përfshirjen e tyre në projekt buxhet. Ajo që ky departament konstaton si shumë problematike deri tani ka qenë miratimi i Strategjive dhe masave të tyre për veprim, pa i shoqëruar ato me kostot financiare, çka e ka bërë, në pjesën më të madhe, të pamundur përfshirjen e tyre në buxhet. Pas kësaj faze të diskutimit në nivel ministrial, ministria e linjës detajon në buxhet shpenzimet për fitin pasardhës dhe më pas Ministria e Financave rishikon dhe koordinon efektet financiare për të gjithë buxhetin.¹

Buxheti në ministrinë e linjës hartohet në bazë të propozimeve të departamenteve përkatëse, në bazë të nevojave që ato paraqesin pa parashikuar në zëra të veçantë kategoritë e fëmijëve të rrezikuar dhe shpërndarjen gjeografike të tyre. Decentralizimi i buxhetit dhe shërbimeve sociale ka sjell konfuzion dhe disproporcion në shpërndarjen e shërbimeve në komunitet. Decentralizimi i shërbimeve shoqërore nga pushteti qendror në vendor nuk është mirëmbështetur edhe me transferimet e duhura financiare. Në këtë aspekt njësi të pushtetit vendor (bashkiak apo komunal) me nivel të ulët të ardhurash të gjeneruara nga taksat vendore e kanë të pamundur të përballojnë nevojat vendore nga buxheti vendor. I vetmi fond me destinacion që vjen nga pushteti qendror në favor të pushtetit vendor është fondi i ndihmës ekonomike¹⁸ në bazë të të cilit ofronte vetëm një pagesë mujore, për familjet pa të ardhura pa marrë parasysh nevojat reale të fëmijëve. Kjo pamjaftueshmëri dhe mungesë fondesh e bën gjithë sistemin e shërbimeve sociale inekzistente në nivel lokal.



Drejtorja e Planifikimit të Buxhetit pranë Drejtorisë të Shanseve të Barabarta në MPÇSSHB shpjegon se buxheti propozohet i detajuar në Ministrinë e Financave, me zëra të veçantë, ku detyrimisht dhe në asnjë moment nuk mund të hiqen zërat e buxhetit si pagat, sigurimet shoqërore-shëndetësore, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e ministrisë dhe çështjet e punës së përditshme (kancelari). Secili nga programet ka ekipin e punës në bazë të të cilave diskutohet dhe nxirren prioritetet apo detyrimet në bazë ligjesh apo strategjish, duke u mbështetur në çdo rast nga Drejtori i buxhetit. Ndryshimet e reja ligjore kërkojnë në hartimin e buxhetit një proces gjithëpërfshirës duke nxjerr në plan të parë prioritetet e çdo programi, larg nga forma e vjetër e buxhetimit e cila ishte thjesht detyrë e drejtorisë së buxhetimit të çdo ministrie. Në këtë aspekt, Sekretariati i Fëmijëve paraqet nevojat dhe kërkesat e tij. Për vitin 2008 buxhetimi i propozuar nga Sekretariati i Fëmijëve ka përfshirë kryesisht trajnime, tryeza të rumbullakëta dhe apo shpenzimet financiare për hartimin e ligjit të përgjithshëm, draft i cili është në proces.

Mbledhja e të dhënave: Në lidhje me kategorinë e fëmijëve, INSTAT¹⁹ mbështet me mbledhjen e të dhënave brenda treguesve social në fushën e arsimimit dhe pjesërisht disa indikatorë në fushën e shëndetësisë.²⁰

¹⁸ Në përmblidhje të detyrimeve të Ligjit Nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” (intervistë e realizuar me përfaqësues në Drejtorinë e Buxhetimit pranë Ministrisë së Financave).

¹⁹ Ligji Nr. 9180, datë 5.2.2004 “Për statistikat zyrtare” dhe “Programin 5 vjeçar statistikor 2007-2011”.

²⁰ <http://www.instat.gov.al/>

Problematike në indikatorët matës paraqitet lënia e pambuluar e pjesës më të madhe të fushave të trajtuara nga nenet e KDF, problematika të cilat janë bërë prezente gjatë analizimit të neneve të këtij raporti. Gjithashtu, INSTAT në indikatorët matës duhet të përfshijë në mënyrë të veçantë kategoritë e fëmijëve të rrezikuar, si fëmijët e trafikuar, shfrytëzuar, abuzuar, neglizhuar, fëmijët e minoriteteve, fëmijët me aftësi të kufizuar apo kategori të tjera fëmijësh në rrezik, për të bërë të mundur analizimin e ndarë të të dhënave të tyre, si një tregues i rëndësishëm në ndërmarrjen e iniciativave politike-bërëse për përmirësimin e cilësisë së jetës së kësaj kategorie.

Neni 42- Shpërndarja e informacionit

Kushtetuta kërkon publikimin e KDF në Fletoren Zyrtare me qëllim hyrjen e saj në fuqi. Në këtë mënyrë, shteti shqiptar duhet të marrë të gjitha masat për publikimin e saj. Ndërkohë që KDF duhet të vihet në dispozicion të të gjithë fëmijëve dhe adultëve në të gjitha rajonet e Shqipërisë dhe, në mënyrë të veçantë, duhet të ofrohet në formate të përshtatshme për fëmijët me aftësi të kufizuar (në formate brail dhe në formate të zmadhuara për fëmijët me aftësi të kufizuar intelektuale).

Shteti shqiptar, duhet t'i kushtojë një vëmendje të veçantë edhe përhapjes së informacionit me anë të medias vizive dhe të shkruar në kuadër të promovimit të të drejtave të fëmijëve. Gjithashtu, të ofrojë trajnime të vazhdueshme në funksion të zbatimit të KDF për strukturat të cilat, në mënyrë direkte dhe indirekte, punojnë me fëmijët si për punonjësit në nivel vendor dhe ata në nivel qendror që ofrojnë shërbime sociale, shërbime shëndetësore, në fushën e arsimit, të punësimit dhe formimit profesional dhe të drejtësisë.²¹

²¹ Për më tepër informacion shih Aneks I – Zbatimi i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve analizuar nga këndvështrimi i fëmijëve, dhjetor 2008 - janar 2009 dhe Aneks II – Informacion nga strukturat kryesore publike dhe jo publike të përfshira në garantimin e të drejtave të fëmijëve, janar-shkurt 2009. (Përmbledhje instrumentesh metodologjike).



III. PËRKUFIZIMI I “FËMIJËS” (neni 10)

Neni 1 - Përkufizimi i termit “fëmijë”

Kushtetuta sanksionon se jeta e personit mbrohet me ligj,²² por nuk përcakton se kur fillon jeta për efekte ligjore: në momentin e konceptimit të një fëmije, apo në momentin e lindjes gjallë të tij. Liritë, të drejtat kushtetuese, legjislacioni civil²³ dhe ai familjar i referohen “lindjes gjallë” dhe “qenies njerëzore” që gëzon personalitet juridik.

Kodi Civil parashikon se mosha për lindjen e zotësisë së plotë për të vepruar është 18 vjeç. Megjithatë, në po këtë dispozitë Kodi Civil parashikon arritjen e moshës madhore për shkak të martesës edhe nën moshën 18 vjeç.²⁴ Ndërsa Kodin e Familjes parashikohet e drejta e fëmijës për t’u dëgjuar në çdo proces vendimmarrje gjyqësore. Ligji shqiptar, përcakton moshën 10 vjeç për dhënie mendimi të të miturit dhe 12 vjeç për dhënie pëlqimi në disa procedura si ajo e birësimit apo vendosjes në kujdestari.²⁵ Kodi i Familjes përcakton të drejtën e të miturit për t’u njohur me historinë e tij dhe me të dhënat për prindërit biologjik në përputhje me moshën dhe nivelin e pjekurisë.²⁶ Megjithatë, nuk ekziston asnjë akt nënligjor i cili interpreton këtë parim dhe e bën të zbatueshëm atë. Po kështu, legjislacioni shqiptar njeh moshën 14 vjeç²⁷ për mbajtjen e përgjegjësisë penale, 16 vjeç për kundravajtje penale dhe për tu angazhuar në marrëdhëniet e punës.²⁸ Duke penalizuar marrëdhëniet seksuale me të mitur nën 14 vjeç, legjislacioni penal përcakton në mënyrë indirekte se mosha për dhënien e konsensusit nga fëmija është ajo mbi 14 vjeç.²⁹ Gjithashtu, fëmijët kanë të drejtë të dëshmojnë pa kufizim moshor.³⁰

Legjislacioni shqiptar parashikon mbrojtjen e fetusit duke i siguruar nënës kujdesin që i nevojitet gjatë

²² Neni 21, Kushtetuta e R.Sh.

²³ Neni 2, Kodi Civil.

²⁴ Neni 6, Kodi Civil.

²⁵ Neni 6, Kodi i Familjes.

²⁶ Neni 262, Kodi i Familjes.

²⁷ Neni 12, Kodi i Penal.

²⁸ Neni 98/1, Kodi i Punës.

²⁹ Neni 100, Kodi Penal.

³⁰ Neni 155, Kodi i Procedurës Penale.

shtatzënisë³¹ ndërkohë që grave shtatzëna u garantohet edhe e drejta për të vendosur ndërprerjen e shtatzënisë deri në javën e 12, duke e trajtuar këtë çështje si pjesë të së drejtës të jetës private³² dhe potencialin e jetës, fetusin, si të barabartë me personin e lindur gjallë. Së fundmi, është ndërmarrë një nismë ligjore pozitive në këtë drejtim, duke hartuar një ligj specifik për të drejtat e fëmijëve, i cili është ende në fazën e projektligjit dhe pritet të miratohet së shpejti. Ky projekt ligj rikonfirmon, edhe një herë, përkufizimin e KDF për termin fëmijë³³.

Aleanca për Fëmijë vëren se ende mungon një përkufizim i përcaktuar me ligj i termit “fëmijë”.

Rekomandime:

- Të merren masa për të përkufizuar me ligj se kush konsiderohet fëmijë.
- Të merren masa me qëllim që, fëmijëve nën moshën 18 vjeç, t’u sigurohet mbrojtja për të cilën kanë nevojë.



³¹ Ligji Nr. 8876, datë 4.4.2002 “Për shëndetin riprodhues”.

³² Ligji Nr. 8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatzënisë”.

³³ Neni 3, Projektligji “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës”.



IV. PARIMET E PËRGJITHSHME (nenet 2, 3, 6 dhe 12)

Neni 2 - Mosdiskriminimi

Shteti shqiptar nuk ka përgatitur, ende, një ligj kuadër kundër diskriminimit³⁴ apo mbrojtje ligjore për fëmijët³⁵ kundër diskriminimit të tyre në sferën publike. Parimi i mosdiskriminimit me referencë të veçantë për fëmijët, nuk gjendet i pasqyruar në legjislacionin kryesor, por vjen në trajtën e parimit të barazisë në parimet e përgjithshme të legjislacionit: në Kushtetutë, Kodin e Punës³⁶, në Kodin Civil³⁷, në Kodin e Procedurave Administrative³⁸ dhe Kodin Penal.³⁹ Strategjia Kombëtare për Fëmijët⁴⁰ përcakton në mënyrë deklarative sigurimin e mundësive të barabarta për të gjithë fëmijët, pavarësisht moshës, gjinisë, etnisë, aftësisë së kufizuar, statusit të lindjes, dhe tenton të bëjë një përkufizim të fëmijëve vulnerabël ndaj diskriminimit si p.sh. fëmijë të ngujuar, fëmijë të braktisur, fëmijë të trafikuar, fëmijë të varfër, romë, etj.⁴¹

Dispozitat për mosdiskriminimin e fëmijëve në gëzimin e të drejtave të tyre parashikohen në legjislacionin⁴²

³⁴ Komiteti Shqiptar Për të Drejtat e Njeriut është duke përgatitur një projekt-ligj kundër diskriminimit.

³⁵ MPÇSSHBB po drejton procesin e përgatitjes së projekt-ligjit për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, i nisur nga fundi i vitit 2008.

³⁶ Neni 9, Kodi i Punës sanksionon barazinë dhe mosdiskriminimin në marrëdhëniet e punës për të gjithë shtetasit dhe si e tillë edhe për fëmijët mbi moshën 16 vjeç, të cilët punësohen sipas kriterëve të përcaktuara nga ky Kod.

³⁷ Neni 1, Kodi Civil. Nuk gjen pasqyrim eksplicit parimi i mosdiskriminimit, por parashikohet e drejta e çdo individi për të gëzuar në mënyrë të plotë dhe të barabartë të drejtat brenda kufijve të përcaktuar me ligj

³⁸ Neni 11, Kodi i Procedurave Administrative. Nuk gjen pasqyrim parimi i mosdiskriminimit, t megjithatë parashikohet “*Parimi i barazisë dhe proporcionalitetit*” i detyrueshëm për t’u përmbushur nga administrata publike në marrëdhëniet me personat privatë, në kuptimin që askush nuk duhet të privilegjohej apo diskriminohet, ndër të tjera, për shkak të gjendjes sociale. Ky parim mbron fëmijën jo vetëm në këndvështrimin e fëmijës si subjekt i drejtpërdrejtë në marrëdhënien administrative, por edhe si subjekt i cili afektohet nga kjo marrëdhënie apo vendimmarrja administrative.

³⁹ “Shkelja e barazisë së shtetasve” e kryer nga ana e punonjësit me funksion shtetëror ose në shërbim publik përbën vepr penale.” Neni 253, Kodi Penal: kur kryerja për shkak të detyrës dhe në ushtrim të saj, nga ana e punonjësit me funksion shtetëror apo në shërbim publik, të dallimeve mbi bazë origjine, seksi, gjendje shëndetësore, bindje fetare, politike, të veprimtarisë sindikale, ose për shkak të përkatësisë në një etni, komb, racë apo fe të caktuar që konsiston në krijimin e privilegjeve të padrejta ose në refuzimin e një të drejte ose përfitimi që buron nga ligji, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.

⁴⁰ VKM Nr. 368, datë 31.5.2005 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Fëmijët 2005-2010”.

⁴¹ Objektivi nr 2, “Strategjia Kombëtare për Fëmijët 2005-2010”.

⁴² Ligji Nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbime shoqërore”, i ndryshuar, neni 3 përcakton parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit si baza mbi të cilën funksionon skema e shërbimeve shoqërore, përkatësisht e detajuar në lidhje me barazinë e mundësive dhe mosdiskriminimin. Pika 1) e Standardeve të Shërbimeve Shoqërore ku sanksionohet trajtimi në mënyrë të barabartë i shtetasve,

dhe dokumentet politike të mbrojtjes sociale, ku një hap të rëndësishëm përbën përkufizimi i kategorive të fëmijëve në rrezik nga përjashtimi social⁴³ si dhe masat që duhet të marrë shteti për aksesimin e të drejtave, veçanërisht atyre të mbrojtjes sociale, për këto kategori fëmijësh. Megjithatë, analiza e plotë e përjashtimit social dhe nivelit të varfërisë në vend nuk është zhvilluar mjaftueshëm⁴⁴ për të shërbyer si bazë për reformimin e skemës mbrojtjes sociale dhe ndihmës ekonomike dhe aktualisht skema ekzistuese nuk siguron aksesin pa diskriminim në të drejtat e kategorive të fëmijëve në rrezik.

Megjithëse legjislacioni shqiptar për sistemin arsimor parauniversitar⁴⁵ dhe Strategjia Kombëtare për Arsimin⁴⁶ parashikojnë si një nga objektivat kryesore sigurimin e aksesit të të gjithë fëmijëve në arsimin e detyrueshëm pa asnjë lloj diskriminimi – “Arsim për të gjithë” – rezulton se mekanizmat ligjore të përcaktuara⁴⁷ nuk janë efikase dhe aktet nënligjore të Ministrisë së Arsimit⁴⁸ për mospërjashtimin *de facto* të grupeve të fëmijëve në rrezik,⁴⁹ apo reduktimit të braktisjes së shkollës nuk kanë dhënë rezultat për shkak edhe të moskoordinimit me sektorë të tjerë, si p.sh, atë të përkrahjes sociale, të shëndetësisë, etj. Aksesit në të drejtën për edukim është më problematik

përfshirë këtu edhe fëmijët, ndaj të cilëve ofrohen shërbimet. Përveç këtij parashikimi deri diku deklarativ, Standardet e Shërbimeve Shoqërore parashikojnë edhe detyrimin e punonjësve të cilët ofrojnë shërbimet shoqërore që të njohin dhe zbatojnë në praktikë këtë parim.

⁴³ VKM Nr. 80, datë 20.01.2008 “Për Miratimin e Strategjisë Sektoriale të Mbrojtjes Sociale dhe të Planit të Veprimit për Zbatimin e Saj parashikon parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit në ofrimin e shërbimeve të mbrojtjes sociale të cilat duhet t’i ofrohen çdo individ në nevojë, pavarësisht nga gjinia, origjina, feja, mosha, aftësitë e kufizuara ose veçanti të tjera.

⁴⁴ Progres Raport i Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit të Shqipërisë me BE, 2008, f. 38.

⁴⁵ Ligji Nr. 7952, datë 21.06.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar” ndryshuar me Ligjin Nr. 8387, datë 30.07.1998 sanksionon parimin e barazisë dhe mos-diskriminimit duke parashikuar gëzimin e të drejtave të barabarta për tu arsimuar pavarësisht gjendjes sociale, kombësisë, gjuhës, racës, bindjeve politike, gjendjes shëndetësore dhe nivelit ekonomik. Dispozitat Normative për Arsimin përcaktojnë si synim të shkollës – mundësimin e krijimit të shanseve të barabarta për të gjithë nxënësit – neni 4 dhe 36/2.

⁴⁶ Strategjia Kombëtare e Arsimit mbështet në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2004 – 2015, miratuar me VKM Nr. 538, datë 12.08.2004.

⁴⁷ Sanksionet për prindërit që nuk dërgojnë në shkollë fëmijët e moshës 6-16 vjeç, ose kur këta mungojnë pa arsye në shkollë ose e braktisin atë, dënohen për kundravajtje administrative me gjobë nga 1000 deri në 10 000 lekë të cilat nuk zbatohen për shkak se drejtoret e shkollave nuk kanë informacion se si duhet të veprojnë për të zbatuar këto masa. Aneks II, Informacion nga strukturat kryesore publike dhe jo publike të përfshira në garantimin e të drejtave të fëmijëve, janar – shkurt 2009 sipas Protokollit Informativ nga Drejtoritë Arsimore në Rrethe.

⁴⁸ Udhëzimi i MASH “Për regjistrimin në shkollë të nxënësve romë që nuk janë të pajisur me certifikatë lindje” si kryerja e studimit për “Mbledhjen e të dhënave të fëmijëve romë, parashkollorë dhe shkollorë, brenda dhe jashtë sistemit”; Urdhri i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr 410, datë 8.11.2006 “Për identifikimin e situatës dhe masat që duhen marrë në luftë kundër analfabetizmit,” Projektit “Shansi i dytë,” nëpërmjet mbështetjes së mësuesve që punojnë me nxënësit që kanë braktisur shkollën, duke ofruar kryerjen e mësimave në kushtet e shtëpisë;

⁴⁹ Aneks II, Informacion nga strukturat kryesore publike dhe jo publike të përfshira në garantimin e të drejtave të fëmijëve, janar – shkurt 2009 sipas Protokollit Informativ nga Drejtoritë Arsimore në Rrethe.

Në shumicën e rrethëve, fëmijët romë dhe egjiptiane nuk pranohen në arsimin e 9-vjeçar për shkak të mos-pasjes së certifikatës së lindjes apo kartelës së vaksinimit por edhe kur pranohen ka diskriminim nga mësuesit apo shokët arsye ndër të tjera që braktisin shkollën. Gjithashtu problem i ndjekjes së arsimit nga fëmijët e ngujuar.

dhe diskriminues ndaj fëmijëve të komunitetit rom, të cilët nuk pranohen në shkolla për shkak të mungesës së certifikatës së lindjes apo kartelës së vaksinimit, e cila është kriter ligjor, fëmijëve me aftësi të kufizuara⁵⁰ për të cilët ende nuk janë përgatitur akte nënligjore nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për të mundësuar infrastrukturën fizike në shkolla dhe mësuesit nuk kanë kohën dhe specializimin e duhur për t'i ndjekur ata.⁵¹ Mungon adresimi ligjor në legjislacionin arsimor mbi fenomenin e diskriminimit, racizmit dhe segregacionit në shkolla kundrejt fëmijëve të komuniteteve me ngjyrë. Shteti shqiptar nuk ka përgatitur ende një plan masash në mbështetje të Deklaratës dhe të Planit të Veprimit të Konferencës Botërore kundër Racizmit, Diskriminimit Racor dhe Ksenofobisë.⁵² Strategjia Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Minoritetit Rom nuk ka përcaktuar masa për parandalimin dhe luftimin e fenomenit të diskriminimit dhe racizmit me të cilën përballen fëmijët romë,⁵³ apo të tjerë me ngjyrë në shkolla. Për rrjedhojë, nevojitet rishikimi i kësaj strategjie.

Legjislacioni mbi shërbimet shëndetësore të kujdesit parësor nuk siguron akses për të gjithë fëmijët, veçanërisht për fëmijët e paregjistruar, fëmijët me aftësi të kufizuara⁵⁴ dhe, çfarë është më shqetësuese, është se këto shërbime kushtëzohen me përfshirjen e nënës në skemën e sigurimeve shoqërore.⁵⁵ Një zhvillim pozitiv lidhur me regjistrimin e fëmijëve të paregjistruar në lindje, është miratimi i ndryshimeve nga Kuvendi i Shqipërisë në Ligjin “Për Statusin Civil, i ndryshuar,”⁵⁶ i cili tejkalon procedurën gjyqësore të mëparshme⁵⁷ dhe parashikon një shpërblim prej 5.000 leke për nënën që regjistron lindjen e fëmijës brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e ligjit. Megjithatë, procesi i zbatimit të këtij ligji rezultoi në jetë të avasthtë dhe nevojiten të organizohen fushata ndërgjegjësimi lidhur me rëndësinë që ka qenia qytetar i ligjshëm i një vendi.⁵⁸

⁵⁰ VKM Nr. 8, datë 7.01.2005 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara” - sanksionon parimin e barazisë dhe mos-diskriminimit duke parashikuar se personat me aftësi të kufizuara janë anëtarë të barabartë të shoqërisë, ata mund të kërkojnë të njëjtat të drejta dhe të përfitojnë të njëjtën ndihmë sociale dhe llojet e asistencës si gjithë qytetarët e tjerë.

⁵¹ Aneks I – Zbatimi i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve analizuar nga këndvështrimi i fëmijëve, dhjetor 2008-janar 2009, f. 5-16.

⁵² Miratuar më 8 Shtator 2001, Durban, Afrika e Jugut.

⁵³ Informacion i marrë nga Shoqata AMARO DROM.

⁵⁴ Zbatimi i dobët i Ligjit të Shëndetit Mendor. Trajtimi i veçantë mjekësor për të cilin ata kanë nevojë, nuk e marrin nga strukturat shëndetësore. Vizitat mjekësore dhe kurat e vazhdueshme kryhen me shpenzimet e familjes. Për personat me probleme fizike, nuk ekzistojnë as ambiente të veçanta ku ata mund të ushtrohen pa paguar para. Për më tepër shiko Aneks I – Zbatimi i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve analizuar nga këndvështrimi i fëmijëve, dhjetor 2008-janar 2009, f. 6.

⁵⁵ Aneks II, Informacion nga strukturat kryesore publike dhe jo publike të përfshira në garantimin e të drejtave të fëmijëve, janar-shkurt 2009 sipas Protokollit Informativ të marrë në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor.

⁵⁶ Ligji nr. 9929, datë 09.06.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8950, datë 10.10.2002 ‘Për Gjendjen Civile’ të ndryshuar”, i propozuar dhe hartuar nga ana e shoqërisë civile.

⁵⁷ Për regjistrimin në gjykatë të fëmijëve të cilët nuk ishin regjistruar brenda 45 ditëve nga dita e lindjes.

⁵⁸ Megjithëse afati për shpërblimin përfundoi në mesin e muajit Shtator 2008 nuk rezultoi në jetë shpërndarë ky shpërblim për nënat që e kanë regjistruar fëmijën sipas afateve – Informacion i marr nga FBSH. Praktikisht ngelen probleme të pazgjidhura nga ligji sidomos për lindjet që ndodhin jashtë materniteteve, asistencën ligjore falas për regjistrimin në gjykatë të fëmijëve të paregjistruar, apo regjistrimin e fëmijëve shqiptarë që lindin jashtë vendit.

Aleanca e Fëmijëve konstaton me shqetësim mungesën e statistikave/studimeve nga ana e shtetit lidhur me diskriminimin e fëmijëve në të gjitha format. Aleanca është e shqetësuar për mungesën e përkufizimit të diskriminimit apo përcaktimin e kategorive më vulnerabel ndaj diskriminimit për mbrojtjen ligjore të çdo fëmije nga diskriminimi në gëzimin e të drejtave në ligjet/kodet kryesore të vendit. Vërehet mungesa e politikave të qarta për të identifikuar, monitoruar dhe vepruar në fushën e parandalimit të diskriminimit në shërbimet publike.⁵⁹ Aleanca mirëpret përpjekjet e Grupit Shqiptar të të Drejtave të Njeriut në përgatitjen e ligjit kuadër kundër diskriminimit dhe miratimin e shpejtë të tij nga Kuvendi i Shqipërisë. Aleanca dëshiron të tërheqë vëmendjen e Komitetit për t'u sugjeruar hartuesve të ligjit kuadër për të drejtat e fëmijëve në Shqipëri përfshirjen e plotë të parimit të mosdiskriminimit, siç është parashikuar në nenin 2 të KDF dhe përfshirjen e tij në të gjitha të drejtat e parashikuara në projekt-ligjin ekzistues. Aksesi në të gjitha të drejtat e KDF është më tepër i rrezikuar për fëmijët e komunitetit rom për shkak të mungesës së mekanizmit të identifikimit të kësaj kategorie – nuk ka statistika zyrtare sa fëmijë janë të regjistruar dhe sa janë të paregjistruar.⁶⁰ Aksesi në të drejtën për edukim, shërbime shëndetësore dhe mbrojtje sociale, por edhe cilësia e ofrimit të këtyre shërbimeve, paraqitet më problematike për fëmijët romë, fëmijët me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore, fëmijët e trafikuar, fëmijët e ngjuar, etj.⁶¹ Paragjykimet dhe diskriminimi racial, sidomos për fëmijët e komunitetit rom, është fenomen shqetësues në shkollë ku mbi 90% e nxënësve romë pohojnë se etiketohen me emrin “gabelli zi” apo mbi 80% e nxënësve romë rrinë të ulur në bankën e fundit të klasës. Organizatat romë mendojnë se shteti nuk i jep prioritet çështjes së diskriminimit me politikat që zbaton. Punonjësit në institucionet shtetërore nuk janë të trajnuar që të mos diskriminojnë qytetarët e etnive të ndryshme nga shumica shqiptare. Jo vetëm mësuesit, punonjësit e policisë, shëndetësisë etj, por edhe komuniteti i gjerë vazhdon të kenë një mentalitet të mbyllur dhe paragjykes dhe diskriminues ndaj komuniteteve romë dhe egjiptiane, të cilët ndikojnë pastaj dhe në mentalitetin e fëmijëve shqiptarë karshi fëmijëve të këtyre dy komuniteteve.⁶² Shteti shqiptar nuk ka zhvilluar fushata ndërgjegjëse kundër paragjykimeve dhe diskriminimit të këtyre komuniteteve.⁶³ Një tjetër problem i identifikuar në praktikë është edhe ai i trajtimit dhe cilësisë së jetës të fëmijëve të infektuar me HIV/AIDS, ku këtyre të fundit u refuzohet e drejta për të frekuentuar shkollën.⁶⁴

Rekomandime:

- Të përgatitet dhe miratohet një ligj anti-diskriminues për mbrojtjen ligjore të çdo fëmijë për të

⁵⁹ VIS Albania.

⁶⁰ Është përgatitur një projekt-udhëzim nga Ministria e Brendshme për të kryer regjistrimin e popullsisë romë.

⁶¹ Aneks II, Informacion nga strukturat kryesore publike dhe jo publike të përfshira në garantimin e të drejtave të fëmijëve, janar–shkurt 2009 sipas Protokollit Informativ nga Drejtoritë Arsimore në Rrethe. Për më tepër shiko Aneks I – Zbatimi i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve analizuar nga këndvështrimi i fëmijëve, dhjetor 2008- janar 2009.

⁶² Informacion nga shoqata romë AMARO DROM.

⁶³ Në vitin 2007 Zyra e informacionit e Këshillit të Evropës në Shqipëri, ndërmori një fushatë kundër diskriminimit të komunitetit Rom. Fushata Dosta ose Mjaft, synoi të sillte qytetarët joromë më pranë atyre romë

⁶⁴ Rasti i dy fëmijëve binjakë në shkollën “Siri Kodra”.

- gëzuar të gjitha të drejtat pa asnjë lloj diskriminimi.
- Të përfshihet në mënyrë të plotë parimi i mosdiskriminimit parashikuar në nenin 2 të KDF në Projekt-ligjin për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe në aksesimin pa diskriminim në të gjitha të drejtat, i cili po hartohet nga Qeveria Shqiptare; përmirësimi i mëtejshëm i legjislacionit dhe praktikës së zbatimit të tij lidhur me parandalimin dhe luftimin e formave të diskriminimit të hapur, ose të fshehtë.
 - Të ndryshohet legjislacioni primar dhe ai sekondar për arsimin me qëllim garantimin e aksesit të të gjithë fëmijëve në arsimin e detyrueshëm pa diskriminim, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve romë dhe atyre me aftësi të kufizuara.
 - Të adresohet ligjërisht fenomeni i racizmit dhe diskriminimit racial në shkolla dhe të ndryshohet Strategjia për Përmirësimin e Jetesës së Komunitetit Rom për përcaktimin e masave kundër diskriminimit dhe racizmit ndaj fëmijëve të këtij komuniteti në shkolla.
 - Të hartohen politika të qarta për të identifikuar, monitoruar dhe vepruar në fushën e parandalimit të diskriminimit në shërbimet publike në përputhje me Deklaratën dhe Planin e Veprimit të Konferencës Botërore kundër Racizmit, Diskriminimit Racial dhe Ksenofobisë.
 - Të trajnohen mësuesit dhe stafi i shkollave për të demonstruar dhe kërkuar sjellje jo-diskriminuese ndaj fëmijëve romë dhe egjiptianë.
 - Të ndërmerren fushata ndërgjegjësuese nga shteti kundër diskriminimit me mbështetjen e mësuesve dhe psikologëve të shkollave, shoqatave të prindërve dhe komunitetit të gjerë.
 - Performancë më e lartë dhe më profesionale nga gjyqësori në lidhje me çështjet në të cilat duhet vënë në qendër interesi më i lartë i fëmijës.

Neni 3 - Interesi më i lartë i fëmijës.

Kodi i Familjes ka vendosur si një nga parimet kryesore të tij interesin më të lartë të fëmijës.⁶⁵ Në Kod përcaktohen edhe parimet/të drejtat⁶⁶ e tjera të fëmijëve të cilat do të përbënin kriteret për të përcaktuar nëse një procedurë vendimmarrje e ka pasur atë konsideratë parësore. Interesi më i lartë i fëmijës, si konsideratë parësore, parashikohet edhe në procedurat e birësimit.⁶⁷

Kodi i Procedurave Administrative nuk parashikon si parim interesin më të lartë të fëmijës dhe nuk i bën asnjë adresim subjektit të mitur. Ashtu si Kushtetuta, edhe ligje të tjera, e kanë parë të miturin të përfshirë në

⁶⁵ Neni 2 i Kodit të familjes përcakton “Prindërit, organet kompetente dhe gjykatat, në vendimet dhe veprimtarinë e tyre duhet të kenë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës.”

⁶⁶ Parimi i mosdiskriminimit; krijimi i kushteve për mbijetesë maksimale; dhe respektimi i mendimit të fëmijës.

⁶⁷ Neni 240 parashikon se “Birësimi lejohet vetëm në interesin më të lartë të të miturit dhe garanton respektimin e të drejtave të tij themelore”.

konceptin e shtetasit, pa e diferencuar atë. Një shprehje e kësaj mungese të konsiderimit si subjekt më vete dhe mospërshtatjes së procedurave me karakteristikat fizike dhe psikologjike të tij, është pikërisht mungesa e parimit të interesit më të lartë të të miturit në vendimarrjen administrative, ku procesi duhet të garantojë edhe parimet e tjera, të cilat shërbejnë si elemente përbërëse të parimit të interesit më të lartë të fëmijës, siç është parimi i respektimit të mendimit të fëmijës.

Edhe në Kodin Penal dhe atë të Procedurës Penale nuk ka gjetur pasqyrim parimi i interesit më të lartë të të miturit si një koncept udhëheqës i trajtimit të subjektit të mitur nga ligji penal dhe si element i rëndësishëm i procedimit penal, i cili do t'i siguronte të miturit, qenien subjekt i mbrojtjes së posaçme, parashikuar si e tillë në Kushtetutë. Legjislacioni nuk merr parasysh interesin më të lartë të të miturit, i cili do të kishte si kriter parësor, jo vetëm deklarativ, ekzistencën e një sistemi të posaçëm të drejtësisë për të mitur.⁶⁸

Në Ligjin për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe të Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë⁶⁹ reflektohet parimi i interesit më të lartë të fëmijës, në rastet kur subjekte të mbrojtjes janë të miturit, por për shkak të mospasjes së zotësisë për të vepruar, subjektit të mitur nuk i është dhënë roli i duhur në këtë vendimarrje, duke përcaktuar se pëlqimin e jep vetëm prindi apo kujdestari.⁷⁰ Në Ligjin “Për Policinë e Shtetit” nuk gjen reflektim në mënyrë të shprehur interesi më i lartë i fëmijës gjatë procedurave të shoqërimit të të miturve.⁷¹

Në Ligjin “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”⁷², nuk ka gjetur shprehje interesi më i lartë i fëmijës, si një nga parimet bazë, në të cilat duhet të mbështetet procesi dhe mënyra e ofrimit të shërbimeve shoqërore. Kështu, parashikohen kriteret kualifikuese për vendosjen e fëmijëve në institucionet rezidenciale⁷³, por nuk gjen rregullim procesi i vendimarrjes, i cili duhej të udhëhiqej nga interesi më i lartë i fëmijës. Mungesa e parimit të interesit më të lartë të fëmijës, vihet re edhe në Vendimet e Qeverisë, që rregullojnë pranimin dhe trajtimin e fëmijëve në institucionet rezidenciale.⁷⁴ Interesi më i lartë i fëmijës nuk është përfshirë as në

⁶⁸ Shqipëria akoma nuk ka ngritur një sistem bashkëkohor të Drejtësisë për të Mitur. Në dhjetor 2008 Kuvendi i Shqipërisë miratoi një paketë të re ligjore për disa ndryshime në Kodin Penal dhe Ligjin për ekzekutimin e vendimeve penale në të cilat parashikohet ngritja e Departamentit të Shërbimit të Provës në Ministrinë e Drejtësisë për mbikëqyrjen e dënimeve alternative nga ato me burgim. Një nga kategoritë e veçanta që përfitojnë nga këto ndryshime janë të miturit. Megjithatë ndryshimet e miratuara nuk reflektojnë tërësisht sugjerimet dhe rekomandimet e shoqërisë civile dhe veçanërisht asaj pjese që punon prej vitesh për ngritjen e një sistemi të integruar të Drejtësisë Penale për të Miturit për të përfshirë në Kodin Penal një nen ku të parashikohet burgimi i fëmijëve si alternativë e fundit në bazë të parimit të interesit më të lartë të fëmijës.

⁶⁹ Ligji Nr. 9205, datë 15.03.2004 “Për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe të Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë”.

⁷⁰ Në nenin 16, “marrëveshja me personin e mbrojtur”, pika 5, parashikohet se: “Në rastin kur personi i mbrojtur është i mitur, duke respektuar në çdo rast parimin e interesit më të lartë të tij dhe ato të zotësisë për të vepruar, të parashikuara në dispozitat përkatëse ligjore, dhënia e pëlqimit dhe nënshkrimi i marrëveshjes së mbrojtjes bëhet nga prindi ose kujdestari i tyre, i caktuar sipas ligjit”.

⁷¹ Neni 101(a), Ligji Nr. 9749, datë 04.05.2007 “Për policinë e shtetit”.

⁷² Ligji Nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”.

⁷³ Kreu I, Ligji Nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”.

⁷⁴ VKM Nr. 510, datë 24.11.1997 “Për kriteret e vendosjes në institucionet rezidenciale të përkujdesjes shoqërore dhe dokumentacioni i nevojshëm për pranim”, në VKM Nr. 209, datë 12.4.2006 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale, publike dhe private të përkujdesit shoqëror” që ka zëvendësuar VKM të

“Standardet e Shërbimeve të përkujdesit shoqëror për fëmijët në institucionet rezidenciale,”⁷⁵ megjithatë, në këto standarde përfshihet ngritja e një sistemi ankimi për fëmijët, i cili do t’i siguronte fëmijës, parimin e respektimit të mendimit të tij dhe do të krijonte premisat për zbatimin e interesit më të lartë të fëmijës.

Familja kujdestare nuk ka filluar ende të zbatohet në praktikë, pavarësisht miratimit të “Dokumentit të politikave për kujdestarinë e fëmijëve në nevojë.”⁷⁶

Vlen të theksohet se Qeveria ka pasur një sensibilizim në lidhje me fillimin e aplikimit gjerësisht të këtij sistemi e për këtë po hartohen aktet ligjore e nënligjore përkatëse. Po kështu, qeveria ka pasur sensibilizimin edhe për deinstitutionalizimin e fëmijëve në nevojë dhe aplikimin e alternativave të reja të shërbimeve sociale (kujdestarisë së fëmijëve) të pasqyruara në Planin Kombëtar të Veprimit për vitet 2005-2010 dhe në Strategjinë Sektoriale të Ministrisë së Punës 2007-2013. Me iniciativë të MPÇSSHB dhe mbështetje të UNICEF, është miratuar strategjia e kujdestarisë për fëmijët në nevojë,⁷⁷ ku, ndër të tjera, parashikohet të pilotohet ky shërbim në Tiranë dhe Shkodër me 80 raste në vitet 2009-2010 për të vazhduar më pas shtrirjen graduale në nivel kombëtar. Një iniciativë për t’u përshëndetur është hartimi nga ana e qeverisë e projekt-ligjit “Për të Drejtat e Fëmijëve” në të cilën pritet të inkorporohet i plotë Parimi i Interesit më të Lartë të Fëmijës, siç parashikohet në nenin 3 të KDE.

Praktika gjyqësore lidhur me zbatimin e interesit më të lartë të fëmijës

Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, gjatë vitit 2008, analizoi nevojat e gjyqtarëve dhe prokurorëve për zbatimin e dispozitave të Kodit të Familjes dhe legjislacionit civil në këndvështrimin e të drejtave të fëmijëve të përcaktuara në KDE.⁷⁸ Për sa i përket zbatimit të Parimit të Interesit më të Lartë të Fëmijës në praktikën gjyqësore familjare, rezulton se ky parim është ende praktikisht i pazbatueshëm dhe jo-efektiv për arsye të mosnjohjes së elementëve të këtij parimi dhe vështirësive në vërtetimin e indikatorëve përcaktues në procedura të veçanta,⁷⁹ por edhe të mungesës së trajnimit mbi Kodin e

mësipërme.

⁷⁵ VKM Nr. 659, datë. 17.10.2006.

⁷⁶ VKM Nr. 1104, datë 30.07.2008, kapitullin 6 “Për një ndryshim në VKM Nr. 80, datë 28.01.2008- për miratimin e Strategjisë Sektoriale të Mbrojtjes Sociale dhe Planin e saj i Veprimit”.

⁷⁷ VKM Nr. 1104, datë 30.07.2008 “Për miratimin e Strategjisë së kujdestarisë për fëmijët në nevojë”.

⁷⁸ Raport Vlerësimi, gusht 2008, “Mbi nevojat e gjyqtarëve dhe prokurorëve në zbatimin e dispozitave të Kodit të Familjes, Kodit Civil dhe Kodit të Procedurës Civile nëpërmjet standardeve të të drejtave të fëmijëve”, përgatitur nga Shkolla e Magjistraturës dhe Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara” Raporti është përgatitur duke iu referuar përgjigjeve të pyetësorëve, diskutimeve në fokus grupet me gjyqtarë dhe prokurorë dhe praktikës gjyqësore të kohëve të fundit (2005-2008) ku janë ekzaminuar më shumë se 200 vendime gjyqësore.

⁷⁹ Në përgjithësi në vendimet gjyqësore të zgjidhjes së martesës në lidhje me lënien e fëmijëve për rritje dhe edukim, por edhe vendimet e kujdestarisë apo birësimet, gjyqtarët nuk shprehin në asnjë paragraf të vendimit mbi arsyet se pse vendimmarrja është në interesin më të lartë të fëmijës apo pse ky interes ka qenë konsiderata parësore: Vendim Nr. 2973, datë 3.4.2008, Gjykata e Rrethit

Familjes apo parimet e përgjithshme të KDF. Gjyqtarët dhe prokurorët renditin dhe një sërë vështirësish të tjera, të cilat i pengojnë në zbatimin efektiv të këtij parimi, të lidhura me mungesën e institucioneve apo shërbimeve për përkujdesjen dhe mbajtjen e fëmijëve, familjeve kujdestare, pamundësi në hetimin gjyqësor të alternativave më të mira për fëmijën, për shkaqe si pamundësi në përcaktimin e burimeve të të ardhurave të secilit prej bashkëshortëve në lidhje me kushtet ekonomike, familjare, vlerat morale, sepse në të shumtën e rasteve, prindërit figurojnë të papunë, emigrantë ose me pasuri të paluajshme të paregjistruara, të sëmurë mendorë, asistencën jo në nivelin e duhur nga punonjësit socialë apo psikologët, etj. Të gjithë gjyqtarët në vendimmarrjet me subjekt të miturit i referohen vetëm aspekteve afat-shkurtra të këtij interesi dhe nuk e analizojnë atë për një periudhë afatgjatë.⁸⁰

Aleanca e Fëmijëve është e shqetësuar për mungesën e plotë,⁸¹ apo të pjesshme,⁸² të reflektimit të Parimit të Interesit më të Lartë të Fëmijës si konsideratë parësore në ligjet kryesore të vendit duke kompromentuar kështu gëzimin dhe realizimin e të drejtave të fëmijëve të përcaktuara sipas fushave përkatëse të legjislacionit shqiptar sipas standardeve të KDF. Aleanca konstaton me shqetësim përfshirjen vetëm si frazeologji të re të parimit të interesit më të lartë të fëmijës, praktikisht të pazbatueshëm, në vendimmarrjet gjyqësore familjare me objekt pasojat e zgjidhjes së martesës për sa i përket caktimit për lënie dhe rritje fëmijës njërit prind, përcaktimin e detyrimit ushqimor, vendosjen e fëmijëve në kujdestari, procedurat e birësimit etj.⁸³ Parimi i interesit më të lartë të fëmijës nuk është i zbërthyer në protokolle apo procedura të standardizuara sipas fushave përkatëse të shërbimeve publike dhe private që u ofrohen fëmijëve, ndër të tjera, në sektorin e arsimit, të shëndetit, shërbimeve sociale, në gjykata dhe punonjësit e këtyre sektorëve nuk kanë marrë trajnim mbi elementet përbërës të këtij parimi. Është shqetësues fakti që përkujdesja shoqërore për fëmijët në nevojë është e rregulluar vetëm nëpërmjet vendosjes në institucion⁸⁴ pavarësisht se vendosja e

Gjyqësor Tiranë, f. 2; Vendim Nr. 220, datë 30. 01. 2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, f. 3. Vendim Nr. 61, datë 15. 01. 2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, f. 2; Vendim Nr. 7205, datë 08.12.2005, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, f. 2; Vendim Nr. 5003, datë 30.5. 2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, f. 2.

⁸⁰ Raport Vlerësimi, Gusht 2008, “Mbi nevojat e gjyqtarëve dhe prokurorëve në zbatimin e dispozitave të Kodit të Familjes, Kodit Civil dhe Kodit të Procedurës Civile nëpërmjet standardeve të të drejtave të fëmijëve”, përgatitur nga Shkolla e Magjistraturës dhe Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara”. Raporti është përgatitur duke iu referuar përgjigjeve të pyetësorëve, diskutimeve në fokus grupet me gjyqtarë dhe prokurorë dhe praktikës gjyqësore të kohëve të fundit (2005-2008)., f. 9-25.

⁸¹ Kodin e Procedurave Administrative, Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale, Kodin Civil, Legjislacionin për mbrojtjen sociale dhe vendimet gjyqësore familjare.

⁸² Ligji për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe të Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë; Ligji Për Policinë e Shtetit; “Standartet e Shërbimeve të përkujdesit shoqëror për fëmijët në institucionet rezidenciale”

⁸³ Raport Vlerësimi, Gusht 2008, “Mbi nevojat e gjyqtarëve dhe prokurorëve në zbatimin e dispozitave të Kodit të Familjes, Kodit Civil dhe Kodit të Procedurës Civile nëpërmjet standardeve të të drejtave të fëmijëve”, përgatitur nga Shkolla e Magjistraturës dhe Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara”. Raporti është përgatitur duke iu referuar përgjigjeve të pyetësorëve, diskutimeve në fokus grupet me gjyqtarë dhe prokurorë dhe praktikës gjyqësore të kohëve të fundit (2005-2008), f. 9-25.

⁸⁴ Vendosja e fëmijëve në institucionet e përkujdesit shoqëror bëhet në bazë të vendimit të marrë nga SHSSH bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmë dhe shërbime shoqërore”, VKM Nr. 209, datë 12.04.2006 dhe Udhëzimi Nr. 2470, datë 6.12.2006 i MÇSSH.

fëmijëve në institucione parashikohet si alternative e fundit në legjislacion⁸⁵.

Rekomandime:

- Të amendohet Kodi i Procedurave Administrative për përfshirjen e parimit të interesit më të lartë të fëmijës në vendimmarrjen administrative në lidhje me subjektet e mitur apo kur interesat e tyre si individë, apo si grup shoqëror, preken nga ajo.
- Të amendohet Kodi i Procedurës Penale për të përfshirë interesin më të lartë të fëmijës si një nga parimet e procedimit penal për të miturit.
- Të amendohet Ligji për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe të Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë për përfshirjen e marrjes së mendimit të të miturit, i cili merret në mbrojtje gjatë hartimit të marrëveshjes, si një element i rëndësishëm i shprehjes së interesit të tij më të lartë.
- Të amendohet Kodi i Familjes për sa i përket vendosjes së sanksioneve ndaj prindërve që nuk zbatojnë vendimet gjyqësore për pagimin e detyrimit ushqimor; përcaktimin e masave urgjente që duhet të marrë gjykata në rastet e pamundësisë së kontaktit prej saj, apo psikologut, me fëmijën që jeton jashtë vendit; në përcaktimin e qartë të detyrave të psikologut dhe punonjësit social gjatë procedurës së marrjes së mendimit të fëmijës në vendimmarrjen gjyqësore familjare.
- Të amendohen Ligji “Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore” dhe aktet nën-ligjore në fushën e përkujdesjes, të cilat duhet të përfshijnë parimin e interesit më të lartë të fëmijës gjatë procedurës së aksesimit dhe të ofrimit të shërbimeve shoqërore.
- Të amendohet Ligji “Për Policinë e Shtetit” për përfshirjen e parimit të interesit më të lartë të fëmijës në veprime që ndërmerren nga policia e shtetit për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike, parandalimin e veprimeve kriminale dhe kundravajtjeve ndaj të miturve dhe në prani të të miturve.
- Të përmirësohet kuadri ligjor dhe infrastruktura e nevojshme në zbatim të institutit të “familjes kujdestare”.
- Të trajnohen punonjësit e policisë, prokurorët, gjyqtarët, punonjësit socialë/psikologët, administratorët socialë, njësitë e mbrojtjes së fëmijëve, mësuesit, mjekët, etj., mbi elementët përbërës të interesit më të lartë të fëmijës dhe aplikimin e këtij parimi si konsideratë parësore në çdo procedurë që afekton jetën e fëmijëve.
- Të unifikohet praktika gjyqësore familjare dhe penale mbi zbatimin e interesit më të lartë të fëmijës si konsideratë parësore.
- Të përcaktohen kriteret e mirërritjes dhe zhvillimit të nevojshëm të fëmijëve.

⁸⁵ Neni 266, Kodi i Familjes.

Neni 6 - E drejta e jetës, mbijetesës dhe zhvillimit.

Legjislacioni shqiptar parashikon mbrojtjen e së drejtës të jetës të personit me ligj.⁸⁶ E drejta e fëmijës për të jetuar, mbijetuar dhe zhvilluar maksimalisht, megjithëse nuk parashikohet si e tillë në mënyrë eksplicite në legjislacionin shqiptar, për shkak edhe të ndërthurjes së disa të drejtave në këtë parim, gjen pasqyrim në ligje të veçanta të sektorit të shëndetësisë.⁸⁷ Legjislacioni shqiptar lidhur me kujdesin shëndetësor të detyrueshëm akoma nuk është rishikuar⁸⁸ dhe, si rrjedhim, jo të gjithë fëmijët kanë akses në shërbimet shëndetësore që duhet të marrin, veçanërisht grupet më të marginalizuara të fëmijëve/fëmijët në rrezik nga përjashtimi social. Imunizimi i fëmijëve dhe akses i mëtijshëm i fëmijëve në shërbimet shëndetësore kushtëzohen me ekzistencën e nënës në skemën e sigurimeve shoqërore/shëndetësore, të cilat kanë efekt të mëtijshëm dhe në mungesën e arsimimit/përjashtimin *de facto* nga shkolla të këtyre fëmijëve.⁸⁹ Niveli i ulët i zbatimit të legjislacionit për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve infektive⁹⁰ në institucionet parashkollore dhe shkollat në zonat rurale dhe të thella të vendit është tregues i ekzistencës së pabarazisë në garantimin e mbrojtjes së të drejtës për shëndet, pa diskriminim të fëmijëve në të gjithë vendin.

Legjislacioni aktual i skemës së mbrojtjes sociale dhe shoqërore nuk përfshin të gjitha kategoritë e fëmijëve të identifikuar në rrezik nga përjashtimi social⁹¹ në Strategjinë Ndersektoriale të Përfshirjes Sociale 2008-2013, e cila i bën një vlerësim fillestar situatës dhe problemeve ekzistuese të kësaj skeme sipas kategorive të këtyre fëmijëve. Megjithatë, reformimi i plotë i skemës së mbrojtjes sociale dhe shoqërore mbetet problem për shkak të mungesës të vlerësimit të situatës së varfërisë në vend dhe analizës jo të plotë të përjashtimit social.⁹² Përkujdesja

⁸⁶ Nenin 21, Kushtetuta e R.SH parashikon se “jeta e personit mbrohet me ligj”. Gjithashtu, neni 15 i Kushtetutës parashikon të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

⁸⁷ Kodi i Familjes, edhe pse nuk garanton mbrojtje të shprehur ndaj jetës së fëmijës, parashikon, në nenin 3, se “Prindërit kanë detyrë dhe të drejtë të kujdesen për mirërritjen, zhvillimin, mirëqenien, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të lindur nga martesë ose jashtë martesë. Shteti dhe shoqëria duhet t’u ofrojnë familjeve mbështetjen e nevojshme për të mbajtur në gjirin e tyre fëmijët, për të parandaluar keqtrajtimin dhe braktisjen e tyre, si dhe për të ruajtur qëndrueshmërinë e familjes”; Në Ligjin Nr. 8876, datë 4.4.2002 “Për shëndetin riprodhues” parashikohet në nenin 22 së veprimtaria e shërbimeve për kujdesin ndaj shëndetit riprodhues parashikuar në këtë nën, përfshin: a) kujdesin para, gjatë dhe pas lindjes; b) kujdesin për rritjen dhe zhvillimin e fëmijës 0-6 vjeç; c) kujdesin për shëndetin e adoleshentëve; Në Ligjin nr. 8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatzënisë”, neni 1 garanton respektimin e çdo qenie njerëzore që në fillim të jetës, dhe përveç rasteve të ndërprerjeve të shtatzënisë për arsye shëndetësore, lejohet dhe ndërprerja vullnetare me kërkesën e nënës. Në Ligjin Nr. 8528, datë 23.09.1999 “Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gji” parashikohet mbrojtja e të drejtës së fëmijës për t’u ushqyer me gji nëpërmjet nxitjes së ushqimit me qumështin e gjirit si një element i pazëvendësueshëm që ndikon drejtpërdrejt në mbijetesën dhe në zhvillimin e plotë dhe të mirë të fëmijës së porsalindur.

⁸⁸ Në proces në Kuvendin e Shqipërisë.

⁸⁹ Progres Raport i Shqipërisë mbi Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit të Shqipërisë me BE, 2008.

⁹⁰ Ligji nr 7761, datë 19.10.1993 “Për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse”.

⁹¹ Fëmijëve jetimë apo me probleme sociale që jetojnë në institucione rezidenciale; fëmijët e tjerë në nevojë që nuk jetojnë në institucione rezidenciale; fëmijët e trafikuar; fëmijët që punojnë; fëmijët AK; fëmijët romë.

⁹² Progres Raport i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit të Shqipërisë me BE, 2008, f. 38.

shoqërore për fëmijët në nevojë paraqitet problematike,⁹³ veçanërisht në rastet kur prindërit për shkak të kushteve ekonomike vendosin të lënë në kujdesje institucionale fëmijët e tyre dhe roli i strukturave të shërbimit social nuk konsiston në mbështetjen e familjeve për mos-braktisjen e fëmijëve të tyre, por limitohet vetëm në vlerësimin e dokumentacionit përkatës.⁹⁴ Përveç kësaj “familja kujdestare” nuk ka filluar ende të zbatohet në praktikë edhe pse është miratuar nga Qeveria Shqiptare “Dokumenti i Politikave për Kujdestarinë e Fëmijëve në Nevojë.”⁹⁵

Megjithëse legjislacioni shqiptar për sistemin arsimor parauniversitar⁹⁶ dhe Strategjia Kombëtare për Arsimit⁹⁷ parashikojnë si një nga objektivat kryesor sigurimin e aksesit të të gjithë fëmijëve në arsimin e detyrueshëm pa asnjë lloj diskriminimi – “Arsim për të gjithë” - rezulton se mekanizmat ligjore të përcaktuara⁹⁸ nuk janë efikase dhe aktet nënligjore të Ministrisë së Arsimit⁹⁹ për mos përjashtimin *de facto* të grupeve të fëmijëve në rrezik¹⁰⁰ apo reduktimin e braktisjes së shkollës nuk kanë dhënë rezultat për shkak edhe të mos-koordinimit me sektorë të tjerë, si p.sh, atë të përkrahjes sociale, të shëndetësisë, etj.

Shteti shqiptar ka miratuar Protokollin Fakultativ “Për përfshirjen e fëmijëve në konfliktet e armatosura”¹⁰¹ dhe Protokollin Fakultativ “Për shitjen e fëmijëve, Prostitucionin dhe Pornografinë me Fëmijë”¹⁰² të Konventës

⁹³ Vendosja e fëmijëve në institucionet e përkujdesit shoqëror bëhet në bazë të vendimit të marrë nga SHSSH bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbime shoqërore”, VKM Nr. 209, datë 12.04.2006 dhe Udhëzimi Nr. 2470, datë 6.12.2006 i MPÇSSHB.

⁹⁴ Pika 2, Udhëzimi Nr. 2470, datë 6.12.2006 i MPÇSSHB.

⁹⁵ VKM Nr. 1104, datë 30.07.2008, kapitullin 6 “Për një ndryshim në VKM Nr. 80, datë 28.01.2008 “Për miratimin e Strategjisë Sektoriale të Mbrojtjes Sociale dhe Planin e saj të Veprimit” - “Për miratimin e Strategjia e kujdestarisë për fëmijë në nevojë”

⁹⁶ Ligji Nr. 7952, datë 21.06.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar” ndryshuar me Ligjin Nr. 8387, datë 30.07.1998.

⁹⁷ Strategjia Kombëtare e Arsimit mbështet në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2004 – 2015, miratuar me VKM Nr. 538, datë 12.08.2004.

⁹⁸ Sanksionet për prindërit që nuk dërgojnë në shkollë fëmijët e moshës 6-16 vjeç, ose kur këta mungojnë pa arsye në shkollë ose e braktisin atë, dënohen për kundravajtje administrative me gjobë nga 1000 deri në 10 000 lekë të cilat nuk zbatohen për shkak së drejtorët e shkollave nuk kanë informacion se si duhet të veprojnë për të zbatuar këto masa. Aneks II, Informacion nga strukturat kryesore publike dhe jo publike të përfshira në garantimin e të drejtave të fëmijëve, janar–shkurt 2009 sipas Protokollit Informativ nga Drejtoritë Arsimore në Rrethe.

⁹⁹ Udhëzim i MASH “Për regjistrimin në shkollë të nxënësve romë që nuk janë të pajisur me certifikatë lindje” si kryerja e studimit për “Mbledhjen e të dhënave të fëmijëve romë, parashkollë dhe shkollë, brenda dhe jashtë sistemit”; Urdhri i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Nr 410, datë 8.11.2006 “Për identifikimin e situatës dhe masat që duhen marrë në lufte kundër analfabetizmit”; Projektit “Shansi i dytë” nëpërmjet mbështetjes së mësuesve që punojnë me nxënësit që kanë braktisur shkollën, duke ofruar kryerjen e mësimave në kushtet e shtëpisë;

¹⁰⁰ Në shumicën e rretheve, fëmijët romë dhe egjiptianë nuk pranohen në arsimin e 9-vjeçar për shkak të mos-pasjes së certifikatës së lindjes apo kartelës së vaksinimit por edhe kur pranohen ka diskriminim nga mësuesit apo shokët arsye ndër të tjera që braktisin shkollën. Gjithashtu problem i ndjekjes së arsimit nga fëmijët e ngujuar. Aneks II, Informacion nga strukturat kryesore publike dhe jo publike të përfshira në garantimin e të drejtave të fëmijëve, janar–shkurt 2009 sipas Protokollit Informativ nga Drejtoritë Arsimore në Rrethe.

¹⁰¹ Ligji Nr 9833, datë 22.11.2007 “Për përfshirjen e fëmijëve në konfliktet e armatosura”.

¹⁰² Ligjin nr 9834, datë 22.11.2007.

së OKB-së, “Për të drejtat e fëmijës”. Kodi Penal ka pësuar ndryshime,¹⁰³ të cilat kanë për qëllim mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi për punë, apo qëllime të tjera të paligjshme duke parashikuar sanksione të rënda kur këto veprime të paligjshme kanë si pasoje humbjen e jetës së fëmijës. Megjithatë, rishikimi i legjislacionit të punës është i nevojshëm në drejtim të përcaktimit të saktë të formave të rënda të punës së fëmijëve që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e tyre, rregullimit ligjor të punës së fëmijëve në familje dhe vetëpunësimit.¹⁰⁴

Kodi Penal parashikon vrasjen e personit si një nga krimet më të rënda, ndaj të cilit është parashikuar dënimi maksimal, ai me burgim deri në 25 vjet.¹⁰⁵ Fenomeni i gjakmarrjes dhe detyrimi i fëmijëve për t’u ngjuar shkelin rëndë të drejtën e fëmijës për të jetuar dhe një sërë të drejtash të tjera të KDF dhe legjislacionit shqiptar. Klasifikimi i gjakmarrjes si vrasje e cilësuar me dënim maksimal, dhe dënimi kundrejt detyrimit për t’u ngjuar penalizohen sipas Kodit Penal, megjithatë këto sanksione janë të pazbatueshme dhe fenomeni mbetet i pranishëm në Shqipëri. Ende nuk janë përgatitur aktet nën-ligjore në zbatim të Ligjit “Për Këshillin Koordinativ për luftën kundër gjakmarrjes,”¹⁰⁶ dhe veçanërisht mungon një Strategji Kombëtare kundër Gjakmarrjes megjithëse kanë kaluar më shumë se tre vjet nga miratimi i këtij ligji.¹⁰⁷

Aleanca e Fëmijëve konstaton me kënaqësi uljen e vdekshmërisë foshnjore për fëmijët 0-1 vjeç dhe grupmoshës 1-19 vjeç¹⁰⁸ dhe raportimin e statistikave sipas shkaqeve të vdekjeve të fëmijëve.¹⁰⁹ Aleanca dëshiron të tërheqë vëmendjen e Komitetit lidhur me mungesën e mbajtjes nga sistemi shëndetësor të statistikave të vdekjeve të dyshimta jo-aksidentale të fëmijëve dhe lëndimeve jo-aksidentale.¹¹⁰ Në këtë linjë, mungojnë protokollet për regjistrimin dhe referimin e rasteve të dhunës të hasura nga ofruesit e shërbimeve shëndetësore, sociale dhe arsimore në vend.¹¹¹ Fenomeni i shfrytëzimit të punës së fëmijëve ngelet

¹⁰³ Është shtuar Nenin 124/b, mbi “Keqtrajtimin e të miturve”, i cili, mes të tjerash, parashikon si vepër penale edhe fenomenin e shfrytëzimit të fëmijës për punë të detyruar, lypje dhe shërbime të tjera të detyruara; shtua një paragraf në Nenin 117 “Pornografia” në lidhje me pornografinë me të mitur, si dhe është ndryshuar Neni 128/b “Trafikimi i të miturve”, i cili parashikon si vepër penale jo vetëm rekrutimin, fshehjen dhe pritjen e të miturve, por edhe shitjen e tyre.

¹⁰⁴ Puna e Fëmijëve dhe Kuadri Ligjor Shqiptar. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, ILO/IPEC, UNICEF, Tiranë, Korrik 2004.

¹⁰⁵ Me anë të parashikimit të veprave penale kundër jetës, në një seksion të veçantë të Kodit Penal, ligjvënësi tenton mbrojtjen e së drejtës themelore të njeriut – të drejtën e jetës.

¹⁰⁶ Ligji Nr. 9389, datë 04.05.2005 “Për Këshillin Koordinativ për luftën kundër gjakmarrjes”.

¹⁰⁷ Në Ligj parashikohet koordinimi i masave dhe luftës se organeve shtetërore dhe institucioneve të tjera publike dhe jo-publike si dhe hartimi e Strategjisë Kombëtare për parandalimin dhe eliminimin e fenomenit të Gjakmarrjes në Shqipëri. Asnjë akt nënligjor nuk është miratuar nga Këshilli i Ministrave në bazë të detyrave të përcaktuara në nenet 4, 5, 6 të këtij ligji të cilat kanë të bëjnë me vlerësimin e situatës së fenomenit në vend, ngritjen dhe funksionimin e strukturave në nivel lokal dhe përgatitjen e strategjisë kombëtare. Për sa i përket hartimit të Strategjisë- Komiteti i Pajtimit Mbarëkombëtar ka paraqitur një draft-Strategji në muajin Mars 2009 në mbledhjen e zhvilluar në të cilën mori pjesë edhe Presidenti i Republikës.

¹⁰⁸ Statistikat e INSTAT.

¹⁰⁹ Statistikat e INSTAT për shkaqet e vdekjeve sipas grup-moshave.

¹¹⁰ Analiza e Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve në Shqipëri, UNICEF, 2007, f. 87.

¹¹¹ Aneks II, Informacion nga strukturat kryesore publike dhe jo publike të përfshira në garantimin e të drejtave të fëmijëve, janar-shkurt 2009 sipas Protokollit Informativ të marrë në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor, drejtoritë arsimore dhe administra-

shqetësues për shoqërinë shqiptare dhe ndryshimet ligjore¹¹² nuk kanë pasur efekt në parandalimin e punës së fëmijëve në ndërtim, puna në rrugë, lypja, me pasoja të rënda në shëndetin e tyre, madje deri në humbjen e jetës së tyre siç ishte rasti i çmontimit të municioneve nga fëmijët në Gërdec në të cilën humbën jetën dhjetëra fëmijë. Për sa i përket mbrojtjes sociale, shqetësues është niveli i ulët i ndihmës ekonomike, e cila nuk kalon shumë prej 7, 000 Leke¹¹³ në muaj për familje. Kjo shumë jo vetëm nuk është e mjaftueshme për të përmbushur nevojat minimale të fëmijëve nga familjet e varfra, por të qenit i varfër nuk garanton marrjen e saj – 69% të familjeve në varfëri të skajshme dhe 75% e të gjitha familjeve të varfra nuk e marrin ndihmën ekonomike.¹¹⁴ Gjithashtu problematik mbetet akses i shërbimet shëndetësore dhe arsim i fëmijëve në rrezik përjashtimi social, veçanërisht i fëmijëve romë, me aftësi të kufizuara, dhe fëmijëve të ngjuar.

Aleanca e Fëmijëve dëshiron të ngrejë si shqetësim të madh fenomenin e vetëgjyqësisë dhe gjakmarrjes dhe dështimin e shtetit shqiptar në garantimin e jetës së personave, veçanërisht fëmijëve, të cilët janë detyruar të ngujohen dhe të privohen nga të gjitha të drejtat bazë. Prej vitit 1991 deri më sot janë ngjuar mbi 6000 familje, duke izoluar gratë dhe fëmijët jashtë çdo rregulli “kanunor”. Një pjesë e madhe e këtyre familjeve kanë emigruar ilegalisht jashtë vendit për t'i shpëtuar humbjes së jetës, megjithatë shifrat tregojnë për një rritje të numrit të familjeve të ngjuara në vite: nga 780 familje të ngjuara e të fshehura në vitin 2005, ky numër ka arritur në 1430 në vitin 2008. Vetëm në Tiranë, kryeqytetin e vendit ndodhen 110 familje të ngjuara dhe 70 të fshehura prej të cilave edhe përfaqësues të policisë së shtetit. Fëmijët e këtyre familjeve nuk dalin dot deri tek pragu i shtëpisë së tyre sepse kanë frikë se mos i vrasin, pa përmendur këtu që kjo kategori fëmijësh nuk kanë akses tek shërbimet shëndetësore dhe kanë vite që nuk frekuentojnë shkollën.¹¹⁵

Intervista me fëmijë të ngjuar dhe mamatë e tyre:116

A. është 6 vjeç. Jeton në fshatin Bardhaj të Shkodrës. Ai gjendet i ngjuar në shtëpinë e tij prej 1 viti e 3 muaj. A. ka probleme serioze të të parit, por nuk është vizituar. Mamaja e tij tregon:

A, ka shumë probleme me sytë, por nuk mundem ta çoj te doktori, kam frikë. Nuk mundem ta çoj as në shkollë, se edhe fëmijët e familjes me të cilën jemi në gjak, janë në të njëjtën shkollë. A, qëndron gjithë ditën në shtëpi, para TV dhe bëhet shumë shpesh nevrik. Ai më pyet: “Pse të mos dal të loz me shokët? Pse të mos shkoj në shkollë?”

torët sociale.

¹¹² Neni 124/b, Kodi Penal shtuar me Ligjin Nr. 9859, datë 21.01.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal”, i ndryshuar.

¹¹³ VKM Nr. 787 mbi Vendosjen e Kriteve, Procedurave dhe Shumës së Ndihmës Financiare, datë 14.12. 2005, nenet 18, 22.

¹¹⁴ Vlerësimi i Tregut Shqiptar të Punës. Banka Botërore, Njësia e sektorit të Zhvillimit Njerëzor f. 5 në Analizën e Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve në Shqipëri, UNICEF, Prill 2007, f. 41.

¹¹⁵ Informacion i marrë në Draft-Strategjinë Kombëtare kundër Gjakmarrjes përgatitur nga Komiteti i Pajtimit Mbarëkombëtar, f. 8.

¹¹⁶ Aneks I – Zbatimi i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve analizuar nga këndvështrimi i fëmijëve, dhjetor 2008-janar 2009, f. 10-11.





J, 9 vjeç dhe B 9 vjeç, janë dy vëllezër binjakë, të cilët jetojnë në të njëjtin fshat me A dhe janë ngujuar në shtëpi prej rreth një viti. Ata nuk shkojnë në shkollë dhe nuk dalin të lozin me shokët. Gjatë kohës së intervistës me mamanë e tyre, J, ishte me temperaturë të lartë, por ai nuk mund të shkonte te doktori. Mamaja e tyre shprehet:

Fëmijët mërzhiten shumë në shtëpi. Ata shpesh herë dalin deri te dera jashtë, por unë i marr menjëherë brenda. Në shkollë nuk mund t'i çoj, kështu që mësuesi vjen këtu në shtëpi për t'u mësuar mësimet.

Fëmijët kanë filluar të bëhen nervozë shumë shpejt. Kohën e kalojnë duke bërë detyrat që u jep mësuesi dhe duke lexuar ndonjë libër.

Në bisedë me mësuesin, i cili shkon në shtëpitë e këtyre fëmijëve, ai pohon se mundohet që t'u mësojë sa të mundet, por ai nuk mund t'u mësojë të gjitha lëndët. Ata marrin edhe një certifikatë, shton ai, por nuk është njëlloj si dëftesa e shkollës.

Rekomandime:

- Të miratohen aktet e nevojshme nën-ligjore në zbatim të Ligjit “Për Këshillin Koordinativ për luftën kundër gjakmarrjes” mbi vlerësimin e situatës së fenomenit në vend, ngritjen dhe funksionimin e strukturave në nivel lokal dhe përgatitjen e Strategjisë Kombëtare kundër Gjakmarrjes.
- Të reformohet legjislacioni i skemës së asistencës sociale dhe ndihmës ekonomike duke përcaktuar mbështetjen e duhur financiare për të gjitha kategoritë e fëmijëve në rrezik përjashtimi social dhe familjeve të tyre mbi bazën e analizës së përjashtimit social dhe monitorimit të varfërisë të përcaktuar në Strategjinë e Integruar të Përfshirjes Sociale, 2008-2013.
- Të bëhet vlerësimi i nevojave/indikatoreve të mirërritjes, sidomos të grupeve të fëmijëve në rrezik përjashtimi social.
- Të merren masa ligjore dhe administrative për identifikimin e fëmijëve në nevojë sipas vlerësimit të nivelit të varfërisë dhe përjashtimit social.
- Të rishikohet legjislacioni penal dhe ai familjar me qëllim parashikimin e mekanizmave efikase/sanksioneve ndaj prindërve/kujdestareve ligjore lidhur me mos-ushtrimin e duhur të përgjegjësisë prindërore dhe veçanërisht me mosdhënien e mjeteve të nevojshme për një standard minimal të jetesës së fëmijëve të tyre.
- Të rishikohet legjislacioni i punës mbi mbrojtjen e fëmijëve në punë, veçanërisht në specifikimin e formave më të rënda të punës së fëmijëve, punës së fëmijës në familje dhe vetëpunësimin në përputhje me Konventën e ILO mbi Format më të Rënda të Punës së Fëmijëve.

Neni 12 - Respektimi i pikëpamjeve të fëmijës

Kodi i Familjes¹¹⁷ është legjislacioni kryesor, i cili ka realizuar zbatimin e të drejtës së fëmijës për të shprehur mendimin e tij, i cili duhet marrë në konsideratë në çdo procedurë që ka lidhje me të, pavarësisht nga mundësia që ka fëmija për të artikuluar mendimin e tij.¹¹⁸ E drejta e fëmijës për t'u dëgjuar është, pothuajse, absolute,¹¹⁹ duke mos e kushtëzuar këtë me asnjë kriter moshor, gjë e cila kërkon patjetër garanci të tilla si prania dhe mbështetja e psikologut. Legjislacioni për birësimin¹²⁰ parashikon të drejtën e fëmijës që ka mbushur moshën 10 vjeç për të dhënë mendimin për birësimin, ndërkohë që marrja e pëlqimit të fëmijës është e detyrueshëm kur ai/ ajo ka mbushur moshën 12 vjeç. Megjithatë, nga shqyrtimi i praktikës gjyqësore familjare¹²¹ të viteve 2005-2008 vërehet një zbatim jo uniform i të drejtës së fëmijës për t'u dëgjuar në të gjitha proceset/komponentët e saj.¹²²

Legjislacioni penal¹²³ parashikon të drejtën e konsiderimit të mendimit të fëmijës kur ky i fundit vjen në

¹¹⁷ Neni 6, Kodi i Familjes parashikon “Në çdo procedurë që i përket të miturit, ai ka të drejtë të dëgjohej, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar, duke ruajtur të drejtën që i japin dispozitat e veçanta që garantojnë ndërhyrjen dhe dhënien e pëlqimit nga ana e tij.

Në rastet kur i mituri kërkon të dëgjohej, kërkesa e tij nuk mund të rrëzohet, veçse për shkaqe të rënda dhe me një vendim tepër të motivuar. I mituri mund të dëgjohej vetë, nëpërmjet një avokati ose një personi të zgjedhur prej tij. Në çdo procedurë që i përket të miturit, prania e psikologut është e detyrueshme për të vlerësuar thëniet e të miturit, në përputhje me zhvillimin mendor dhe situatën e tij sociale”.

¹¹⁸ Kjo e drejtë u garantohet edhe fëmijëve të vegjël që nuk flasin dot apo nuk paraqesin dot mendimet e tyre përpara gjyqtarit apo nëpunësit administrativ nëpërmjet të folurit; fëmijëve me aftësi të kufizuara siç janë shurdh-memecët, të cilët nëpërmjet special-istëve përkatës kanë mundësi të shprehin përpara gjykatës.

¹¹⁹ Përfshirimi nga kjo e drejtë bëhet vetëm për shkaqe të rënda, të cilat organi kompetent duhet t'i motivojë. Mungesa e motivimit në vendim në kushtet kur fëmija është përjashtuar nga vendimi do ta sillte vendimin e gjykatës në kundërshtim me ligjin.

¹²⁰ Neni 15, Ligji Nr. 9695, datë 19.03.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”. Neni 240 parashikon se “Birësimi lejohet vetëm në interesin më të lartë të të miturit dhe garanton respektimin e të drejtave të tij themelore”.

¹²¹ Raport Vlerësimi “Mbi nevojat e gjyqtarëve dhe prokurorëve në zbatimin e dispozitave të Kodit të Familjes, Kodit Civil dhe Kodit të Procedurës Civile nëpërmjet standardeve të të drejtave të fëmijëve”, përgatitur nga Shkolla e Magjistraturës dhe Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara”. Raporti është përgatitur duke iu referuar përgjigjeve të pyetësorëve, diskutimeve në fokus grupet me gjyqtarë dhe prokurorë, si dhe praktikës gjyqësore të kohëve të fundit (2005-2008), f. 26-34.

¹²² Në vendimet gjyqësore mbi lënien për rritje dhe edukim të fëmijëve, për sa i përket pyetjes direkt të fëmijës në gjykatë, ekzistojnë praktika të ndryshme ku shumica e gjyqtarëve marrin mendimin e fëmijës vetëm nëse ka mbushur moshën, ku shumica i referohet asaj 10 vjeç, por edhe 6 apo 12 vjeç, etj. Vështirësitë që hasin gjyqtarët në zbatimin e kësaj të drejte, në këto lloj gjykimesh kanë lidhje me mungesën e kushteve të përshtatshme për pyetjen e fëmijës në gjykatë, mungesën e specializimit të tyre mbi komunikimin me fëmijën, mungesën e fëmijëve për arsye se ndodhen jashtë vendit apo mungesën e përcaktimit të moshës për pyetjen e fëmijës në gjykatë, në proceset me objekt zgjidhjen e martesës. Edhe në rastet e respektimit të kësaj të drejte (qoftë nëpërmjet vlerësimit psikologjik apo pyetjes në gjykatë) në arsyetimin e vendimeve gjyqësore nuk i kushtohet rëndësia e duhur analizimit të mendimit dhe ndjenjave të fëmijës, të cilat duhet të jenë në qendër të gjithë procesit, duke cenuar në këtë mënyrë interesin më të lartë të fëmijës në vendimarrjen përkatëse.

¹²³ Neni 58, Kodi i Procedurës Penale parashikon se: “Personi i dëmtuar nga vepra penale ka të drejtë të kërkojë procedimin e fajtorit. Personi i dëmtuar i cili nuk ka zotësi juridike për të vepruar, i ushtron të drejtat që i janë njohur me ligj nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor”. Neni 59, Kodi i Procedurës Penale, “I dëmtuari akuzues”, parashikohet se ai që është dëmtuar nga një sere veprash

cilësinë e “të dëmtuarit akuzues” në një procedurë penale gjyqësore, por kjo e drejtë mund të ushtrohet vetëm nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor (prindi apo kujdestari) duke ndikuar, kështu, drejtpërdrejt në aksesin e fëmijës në një procedurë të tillë penale për të vënë në vend të drejtat e tij të shkelura dhe të mbrojtura nga ligji penal. Legjislatori nuk ka parashikuar situatën kur prindi apo kujdestari nuk do të kryejnë ankimin në emër të fëmijës (për shkak se janë procedura të nisura në bazë ankimi personal) dhe nuk ka përcaktuar procedura të veçanta ku pjesëmarrja e dëgjimi i fëmijës në proces duhet të bëhet për shkak të interesit më të lartë të tij, edhe pa prezencën e prindit. Në këtë kuadër, edhe kur subjekti i mitur bëhet pjesë e programit të mbrojtjes së dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë, pëlqimin e jep prindi apo kujdestari duke mos përcaktuar marrjen dhe konsiderimin e mendimit të fëmijës, megjithëse kjo procedurë duhet të kryhet në interesin më të lartë të të miturit.¹²⁴ Trajtimi i subjektit të të miturve nuk gjen rregullim të posaçëm¹²⁵ edhe në rregulloret e institucioneve të paraburgimit¹²⁶ dhe vuajtjes së dënimit¹²⁷ për sa i përket dëgjimit në lidhje me një procedurë disiplinore apo ankimi ku nuk parashikohet e drejta për t’u shprehur e subjektit të mitur. Ligji “Për Avokatin e Popullit”¹²⁸ i garanton fëmijës të drejtën e ankimit si pjesë e rëndësishme e të drejtës për t’u shprehur¹²⁹ duke mos e kushtëzuar fillimin e kësaj procedure me përfaqësimin e prindit.¹³⁰

Dispozitat Normative të Arsimit Parauniversitar¹³¹ vijnë në përputhje me të drejtën e fëmijës për t’i marrë

penale, të parashikuara si të bazuara në ankimin personal, ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e demit.

¹²⁴ Ligji Nr. 9205, datë 15.3.2004 “Mbrojtjen e Dëshmitareve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë”. “Në rastin kur personi i mbrojtur është i mitur, duke respektuar në çdo rast parimin e interesit më të lartë të tij dhe ato të zotësisë për të vepruar, të parashikuara në dispozitat përkatëse ligjore, dhënia e pëlqimit dhe nënshkrimi i marrëveshjes së mbrojtjes bëhet nga prindi ose kujdestari i tyre, i caktuar sipas ligjit”.

¹²⁵ Në nenet 53-54 gjatë procedurës së procedimit disiplinor të burgosurve u lejohet të mbrohen me avokat dhe nuk është parashikuar se ky është një detyrim ligjor dhe garanci që shkon bashkë me të drejtën për t’u shprehur të subjekti i mitur. Në nenin 5, parashikohet e drejta e kërkesës dhe ankimit, sipas së cilit të paraburgosurit kanë të drejtë të bëjnë kërkesa dhe ankesa në lidhje me zbatimin e ligjit dhe rregullave të brendshme, gjë e cila detajohet më tej në nenin 45 në të cilin parashikohen edhe afatet e shqyrtimit të tyre.

¹²⁶ Rregullorja e Paraburgimit, Nr. 3705, datë 11.05.2006.

¹²⁷ VKM Nr. 63, datë 9.3.2000 “Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve”, neni 45 dhe 50.

¹²⁸ Ligji Nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”.

¹²⁹ Neni 12, Ligji Nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, parashikohet e drejta për t’u ankuar në të cilin parashikohet se çdo individ, që pretendon se i janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e tyre të ligjshme nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, kanë të drejtë të ankohen ose të njoftojnë Avokatin e Popullit dhe të kërkojnë ndërhyrjen e tij për vënien në vend të së drejtës ose lirisë së shkelur. Në këto raste Avokati i Popullit duhet të ruajë fshehtësinë nëse e sheh të arsyeshme, si dhe nëse kjo kërkohej nga personi që bën ankese, kërkesë apo njoftimin.

¹³⁰ Neni 13, Ligji Nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” sanksionohet se: “Në rastet kur Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes me nismën e vet dhe kur kujdestari ose përfaqësuesi i tij ligjor nuk vepron, nuk kërkohej pëlqimi i të dëmtuarit, kur është i mitur apo i paafte mendërisht apo me aftësi të kufizuara, ose për mbrojtjen e të drejtave të një numri të madh të individëve”.

¹³¹ Kreu VIII, në nenin 36, “Të drejtat”, përcakton se nxënësi ka të drejtë *“të shfaqë lirisht mendimin e tij në të gjitha format: me gojë, me shkrim, publikisht, pa cenuar të drejtat e të tjerëve...”*.

mendimin, megjithëse mënyra e formulimit të tyre është më e gjerë dhe nuk përcakton objektin në lidhje me procedurat administrative edukative, arsimore që prekin vetë subjektin e mitur. Qeveria e Nxënësve¹³² si mekanizëm i rëndësishëm ku e drejta e dëgjimit të fëmijëve vjen si një e drejtë që ushtrohet kolektivisht për t'u siguruar fëmijëve marrjen e mendimit si grup në një proces vendimmarrjeje ende nuk janë konsoliduar për të shërbyer si struktura efikase ku fëmijët të kenë besim të shprehin problemet e tyre.¹³³ Ndërkohë, vlen të theksohet mungesa e aksesit të nevojshëm të fëmijëve gjatë procedurës së shqyrtimit apo marrjes së vendimit pa i garantuar pyetjen apo dhënien e mendimit për çështjen që kërkohet të merret masë disiplinore.¹³⁴

Strategjia Kombëtare e Rinisë 2007-2013,¹³⁵ vendos parime të cilat prekin drejtpërsëdrejti parimin e pjesëmarrjes së fëmijëve dhe detyrimet ligjore në përcaktimin e pjesëmarrjes së të rinjve në bordet e shkollave dhe të këshillave të bashkisë si dhe të qarkut në jo më pak se 20%. Ky rregullim ligjor, megjithëse ende i pazbatueshëm në praktikë, do të garantonte pjesëmarrjen dhe dëgjimin e interesave të të rinjve pranë organeve vendimmarrëse në pushtetin vendor, por e kufizon atë në nivel komune.¹³⁶

Aleanca e Fëmijëve dëshiron të tërheqë vëmendjen e Komitetit lidhur me mungesën e reflektimit të plotë në legjislacionin shqiptar, veçanërisht në legjislacionin penal dhe atë administrativ, të së drejtës së fëmijës për t'u shprehur dhe konsideruar mendimi në vendimmarrjet që e afektojnë atë. Nga anketimi¹³⁷ i bërë me gjyqtarët dhe prokurorët në zbatimin e kësaj të drejte gjatë proceseve gjyqësore familjare, kjo e drejtë nuk respektohet tërësisht në të gjitha proceset e saj sepse gjyqtarët zakonisht i referohen dispozitave konkrete të kujdestarisë apo birësimit dhe jo parimit të përgjithshëm të Kodit të Familjes, i cili i ka dhënë të miturit mundësinë për të marrë pjesë në mënyrë aktive dhe për t'u shprehur/dëgjuar në çdo procedure që i përket atij, duke mos e kushtëzuar këtë me asnjë kriter moshor përcaktuar

¹³² Në nenin 37, parashikohet ngritja e “Qeverisë së nxënësve” si “një strukturë organizative e pavarur e nxënësve në shkollë. Ajo përfaqëson mendimin e masës së nxënësve për çështjet e shkollës, mësimin dhe edukimit të tyre. Nëpërmjet “Qeverisë së nxënësve” sigurohet pjesëmarrja aktive e tyre në proceset e ndryshme demokratike në shkollë dhe në komunitet.” Po në këtë nen, përcaktohen kompetencat e qeverisë së nxënësve, të cilat janë në përputhje me të drejtën e përcaktuar në nenin 12 të KDF.

¹³³ Aneks I, Zbatimi i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve analizuar nga këndvështrimi i fëmijëve, dhjetor 2008- janar 2009, f. 21-28. Strategjia Kombëtare e Fëmijëve dhe Plani i Veprimit 2005-2010 mbështetet në parimin e pjesëmarrjes së fëmijëve dhe fuqizimit të dy formave të organizimit që përfaqësojnë drejtpërsëdrejti interesat e fëmijëve: Qeverisë së Nxënësve dhe Parlamentit Rinor.

¹³⁴ Në pikën 4 të nenit 42 parashikohet së “Në të gjitha rastet, kur ndaj nxënësit merret masë disiplinore informohen me shkrim prindërit, të cilët njoftojnë mësuesin kujdestar se kanë marrë dënimin” dhe se “Nxënësi, ndaj të cilit është marrë masa disiplinore, ka të drejtën e ankesës brenda 7 ditëve pranë drejtorisë së shkollës dhe pranë Drejtorisë Arsimore për pikat.....Vendimet e tyre janë të formës së prerë”

¹³⁵ VKM Nr. 782, datë 16 Nëntor 2006 “Për miratimin e Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2007-2013”.

¹³⁶ Objektivi 2, Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2007-2013.

¹³⁷ Raport Vlerësimi “Mbi nevojat e gjyqtarëve dhe prokurorëve në zbatimin e dispozitave të Kodit të Familjes, Kodit Civil dhe Kodit të Procedurës Civile nëpërmjet standardeve të të drejtave të fëmijëve”, përgatitur nga Shkolla e Magjistraturës dhe Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara”. Raporti është përgatitur duke iu referuar përgjigjeve të pyetësorëve, diskutimeve në fokus grupet me gjyqtarë dhe prokurorë dhe praktikës gjyqësore të kohëve të fundit (2005-2008), f. 26-34.

në nenin 6 të KF. Edhe në rastet e respektimit të kësaj të drejte, (qoftë nëpërmjet vlerësimit psikologjik apo pyetjes në gjykatë) në arsyetimin e vendimeve gjyqësore nuk i kushtohet rëndësia e duhur analizimit të mendimit dhe ndjenjave të fëmijës, të cilat duhet të jenë në qendër të gjithë procesit, duke cenuar në këtë mënyrë interesin më të lartë të fëmijës në vendimarrjen përkatëse.¹³⁸

Aleanca e Fëmijëve konstaton se fëmijët nuk kanë gjetur akoma terrenin e përshtatshëm nga stafi i shkollës, për t'u dëgjuar dhe konsideruar kur shfaqen në mënyrë të organizuar dhe përfaqësohen nga organe të përbëra prej tyre.¹³⁹ Strukturat e ngritura nga fëmijët dhe të përbëra prej tyre, nuk janë shumë funksionale dhe nuk përbëjnë një strukturë efektive ku fëmijët të kenë besim të shprehin problemet e tyre. Bazuar në rezultatet e anketimit: të pyetur nëse nxënësit i shprehin ankesat e tyre në qeverinë e nxënësve, pjesa më e madhe e të anketuarve - 71.59% - janë përgjigjur se nuk i shprehin ankesat e tyre tek kjo strukturë. Në lidhje me faktin se ata të cilët i shprehin ankesat e tyre tek qeveria e nxënësve, kanë informacion se çfarë ka ndodhur me ankesat e tyre, përsëri pjesa më e madhe - 58.83% - është përgjigjur se nuk ka informacion dhe një pjesë jo e vogël e tyre - 41.14% - është përgjigjur se ka informacion. Vërehet se nuk ka rezultuar shumë funksionale edhe "kutia e mendimit", e cila duhet të jetë e vendosur në çdo shkollë, në bazë të një urdhërese të MASH, si një mekanizëm ku nxënësit të mund të shprehin ankesat e tyre. Mbi ekzistencën e kësaj kutie, pjesa më e madhe e nxënësve të anketuar - 52.95% - nuk janë në dijeni dhe pjesa më e vogël, por jo e pakonsiderueshme - 41.46% - janë shprehur se kanë dijeni.¹⁴⁰ Gjithashtu, nga informacioni i marrë pranë Drejtorive Arsimore Rajonale, rezulton se në një pjesë të rrethëve nuk ka informacion në lidhje me mekanizmat që mund të përdoren nga fëmijët për të garantuar të drejtën e tyre për t'u dëgjuar.¹⁴¹

¹³⁸ Në vendimet gjyqësore mbi lënia për rritje dhe edukim të fëmijëve, për sa i përket pyetjes direkt të fëmijës në gjykatë ekzistojnë praktika të ndryshme ku shumica e gjyqtarëve marrin mendimin e fëmijës vetëm nëse ka mbushur moshën, ku shumica i referohet asaj 10 vjeç, por edhe 6 apo 12 vjeç, etj. Vështirësitë që hasin gjyqtarët në zbatimin e kësaj të drejte, në këto lloj gjykimesh kanë lidhje me mungesën e kushteve të përshtatshme për pyetjen e fëmijës në gjykatë, mungesën e specializimit të tyre mbi komunikimin me fëmijën, mungesën e fëmijëve për arsye se ndodhen jashtë vendit apo mungesën e përcaktimit të moshës për pyetjen e fëmijës në gjykatë, në proceset me objekt zgjidhjen e martesës. Lidhur me të drejtën e fëmijës për t'u dëgjuar, në proceset me objekt vendosjen e fëmijëve në kujdestari, 18 gjyqtarë nga 44 të anketuar që i janë përgjigjur kësaj pyetje, përgjigjen se e zbatojnë këtë të drejtë duke iu referuar nenit 267 të KF, i cili përcakton detyrimin për marrjen e mendimit të fëmijës në procesin e kujdestarisë kur ka mbushur moshën 10-vjeç. 3 gjyqtarë shprehin se e zbatojnë rrallë/ose jo këtë të drejtë, 19 të anketuar shprehin se nuk kanë praktikë mbi këtë çështje dhe 4 përgjigje nuk kanë lidhje me pyetjen e shtruar. Vetëm 1 nga 18 gjyqtarët që e zbatojnë këtë të drejtë në rastet e vendosjes në kujdestari të të miturve shprehet se pavarësisht parashikimit në nenin 267/2 të KF mbi marrjen e mendimit të fëmijës kur ka mbushur moshën 10 vjeç, nëse fëmija kërkon të dëgjohet gjykata i jep këtë mundësi edhe kur nuk kanë mbushur moshën e përcaktuar, në respektim të nenit 6 të KF i cili është një parim i përgjithshëm i së drejtës familjare. Nga 41 të anketuar që i janë përgjigjur kësaj pyetje 14 gjyqtarë shprehin se respektojnë të drejtën e fëmijës për t'u dëgjuar në procedurat e birësimit duke iu referuar moshës 10 – vjeç për marrjen e mendimit dhe 12 vjeç në marrjen e pëlqimit. 7 gjyqtarë shprehin se nuk e respektojnë këtë të drejtë në procedurat e birësimit duke u mjaftuar me praktikën e përgatitura nga KSHB apo duke i kushtuar më tepër rëndësi marrjes së miratimit për birësim nga prindërit biologjikë dhe jo nga fëmija.

¹³⁹ Aneksi I- Zbatim i Konventës për të drejtat e fëmijëve analizuar nga këndvështrimi i fëmijëve, dhjetor 2008-janar 2009, f. 26.

¹⁴⁰ Aneksi I- Zbatim i Konventës për të drejtat e fëmijëve analizuar nga këndvështrimi i fëmijëve, dhjetor 2008-janar 2009, f. 21-29.

¹⁴¹ Aneksi II - Pjesa 5, Informacion përmbledhës mbi protokollet për marrjen e informacionit dhe vlerësimin e praktikave pranë Drejtorive Arsimore Rajonale.

Për sa i përket fëmijëve në institucionet rezidenciale, Aleanca e Fëmijëve vëren se ka një mungesë të metodave të përshatshme të komunikimit dhe raporteve të ngushta midis punonjësve dhe fëmijëve, çka i pengon fëmijët të zgjidhin problemet që ata mund të kenë me stafin e punonjësve.¹⁴² Në lidhje me fëmijët e vendosur në institucionet e vuajtjes së dënimit, problematik mbetet fakti se të miturit kryesisht nuk kanë informacion se çfarë është mekanizmi i kërkesë-ankesës. Sipas anketimit të kryer nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, rezulton se fëmijët, kur kanë ankesa ose kërkesa, ia paraqisin edukatorit përkatës. Nga intervistat e bëra, rezulton se ka raste kur të miturit pretendonin se kishin kërkuar avokatin apo punonjës social, por ata kishin shkuar me vonës.¹⁴³

Për sa i përket konsiderimit të fjalës së fëmijëve në shtëpi, duket se prindërit janë më të prirur të dëgjojnë kërkesat e fëmijëve të tyre mbi kurset që duan të kryejnë jashtë programit mësimor - 67.71%- dhe marrjen pjesë në aktivitetet e organizuara nga shkolla - 72.14%. Në lidhje me kohën për të kaluar jashtë shtëpisë, pushimet dimërore apo verore dhe programet që fëmijët kanë dëshirë të shohin në televizor, mund të pohohet se diferenca mes atyre që janë përgjigjur pozitivisht dhe atyre që janë përgjigjur negativisht nuk është e madhe. Një përqindje e konsiderueshme e fëmijëve janë përgjigjur se prindërit nuk i dëgjojnë kërkesat e tyre në lidhje me këto çështje. Çfarë konsiderohet e rëndësishme, për tu nënvizuar nga rezultatet e anketimit është se një përqindje thuhet se pakonsiderueshme e fëmijëve janë përgjigjur se mendimi i tyre konsiderohet gjatë diskutimit të çështjeve të ndryshme familjare - 1.29%.¹⁴⁴

Një përpjekje pozitive së fundmi është bërë nga organizata lokale për ngritjen e Linjës Kombëtare të Fëmijëve, një numër treshifror pa pagesë, i cili pritet të jetë operacional në 1 qershor 2009.¹⁴⁵

Rekomandime:

- Të amendohet Kodi i Procedurës Penale në lidhje me paraqitjen e kallëzimit penal direkt nga fëmija, dhe jo nëpërmjet asistimit nga përfaqësuesi i tij ligjor.
- Të amendohet Ligji për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe të Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë për përfshirjen e marrjes së mendimit të të miturit, i cili merret në mbrojtje gjatë hartimit të marrëveshjes, si një element i rëndësishëm i shprehjes së interesit të tij më të lartë.
- Të amendohet Rregullorja e Paraburgimit dhe Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve me qëllim përcaktimin e rregullave të posaçme për mënyrën e marrjes së masave disiplinore, përfshi përcaktimin në mënyrë eksplicite në marrjen e mendimit të fëmijës në këtë procedure në prani të avokatit të tij.
- Të përcaktohen mekanizma ligjore efektive për marrjen dhe konsiderimin e ankesave të fëmijëve në izolim në një kohe sa MS të shpejtë.

¹⁴² Aneksi I- Zbatim i Konventës për të drejtat e fëmijëve analizuar nga këndvështrimi i fëmijëve, dhjetor 2008-janar 2009, f. 13.

¹⁴³ Aneksi III - Raport monitorues mbi zbatimin e të drejtave të fëmijëve në ambientet e paraburgimit dhe burgut, janar-mars 2009, f. 8.

¹⁴⁴ Aneksi I- Zbatim i Konventës për të drejtat e fëmijëve analizuar nga këndvështrimi i fëmijëve, dhjetor 2008-janar 2009, f. 26.

¹⁴⁵ CRCA me mbështetjen e UNICEF është duke ngritur numrin pa pagesë për fëmijët, në lidhje me ankesat e tyre.

- Të forcohet roli i Qeverisë së Nxënësve dhe Parlamentit Rinor në procesin e politikbërjes dhe monitorimit të strategjive që afektojnë jetën e fëmijëve, duke përfshirë dhe buxhetimin e tyre. Të zbatohen detyrimet ligjore, që rrjedhin nga Strategjia për të Rinjtë në përcaktimin e pjesëmarrjes së të rinjve në bordet e shkollave dhe të këshillave të bashkisë dhe qarkut në jo më pak se 20%.
- Të ndryshohen Dispozitat Normative për Arsimin Parauniversitar lidhur me marrjen e mendimit dhe konsiderimit të tij gjatë marrjes së masave disiplinore.
- Të ndërmerren fushata informuese, me qëllim njohjen e mekanizmave të kërkesë/ankesave nga të miturit në institucionet shkollore, ato të përkujdesjes sociale, të vuajtjes së dënimit dhe linjës 24 orëshe pa pagesë.
- Të trajnohen gjyqtarët, prokurorët, punonjësit e policisë, mësuesit, psikologët e shkollave, punonjësit socialë të institucioneve të përkujdesjes lidhur me rëndësinë e zbatimit të së drejtës së fëmijëve për t'u shprehur dhe konsideruar mendimi në çdo procedurë, sipas metodave të përshtatshme.





V. Të Drejtat dhe Liritë Civile dhe politike (nenet 7, 8, 13, 14, 15, 16, 17, 37(a))

Neni 7 - E drejta për të patur një emër, shtetësi dhe për të njohur prindërit

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë nuk parashikohet shprehimisht ndonjë e drejtë e personit apo e fëmijës për të qenë i regjistruar. E drejta e emrit është garantuar në kontekstin e fitimit të shtetësisë.¹⁴⁶ Megjithatë, lindja si fakt është e ndryshme nga fitimi i shtetësisë, e parë kjo në kontekstin e shtetasve të huaj kur lindin në Shqipëri.

Regjistrimi i lindjeve, rregullohet në mënyrë më të detajuar në nenet 32-42 të Ligjit: “Për gjendjen civile”¹⁴⁷ duke përfshirë të gjitha aspektet e regjistrimit. Në këtë ligj¹⁴⁸ parashikohet se “akti i lindjes vërteton ligjërisht lindjen e shtetasit”. Kur lindja nuk regjistrohet në Zyrat e Gjendjes Civile brenda afateve të përcaktuara nga ligji, ajo kryhet nëpërmjet procedurës gjyqësore.¹⁴⁹ Amendimi i këtij ligji në qershor 2008 ka sjellë, ndryshimin e afatit 15 ditë¹⁵⁰ në 60 ditë kur lindja ndodh brenda vendit dhe në 90 ditë kur lindja kryhet jashtë shtetit. Këto ndryshime u pasuan nga dy fushata sensibilizimi për regjistrimin e fëmijëve, në veçanti të fëmijëve që vijnë nga komuniteti rom. Për regjistrimin e lindjes brenda afatit, nëna përfiton shpërblim në masën 5000 lekë. Të njëjtin shpërblim marrin edhe nënat, të cilat nuk e kishin deklaruar lindjen e fëmijëve të tyre para këtij ndryshimi ligjor dhe e kryejnë atë (regjistrimin) brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Vendosja e këtij përfitimi financiar, u bë me qëllim nxitjen e popullsisë për të regjistruar fëmijët të cilët ishin prej kohësh të paregjistruar. Megjithatë, nuk dihet ende se cilat janë rezultatet konkrete të kësaj amnistie ligjore. Ligji i detyron subjektet shëndetësore, shtetërore dhe private, që çdo ditë të hënë të dërgojnë në zyrat e gjendjes civile ku prindërit kanë vendbanimin, njoftimin për lindjet e ndodhura në institucionet e tyre.¹⁵¹ Procedura e regjistrimit garanton të drejtën e çdo fëmije për të pasur një identitet me qëllim shmangien e trafikimit dhe formave të tjera të shfrytëzimit. Shteti shqiptar ka kryer informatizimin e të dhënave të gjendjes civile, çka ndihmon në mbrojtjen dhe efçencën e të dhënave për fëmijët.

¹⁴⁶ Neni 19, Kushtetuta e R.Sh: “...kushdo që lind duke pasur qoftë edhe njërin prej prindërve shqiptar, e fiton vetiu shtetësinë shqiptare”, neni 6, Ligji Nr. 8389, datë 5.08.1998 “Për shtetësinë Shqiptare”.

¹⁴⁷ Ligjin “Për gjendjen civile”, Nr. 8950, datë 10.10.2002 ndryshuar me Ligjet Nr. 9029, datë 13.03.2003; Nr. 9229, Datë 29.2.2004 dhe Ligjin Nr. 9929, Datë 09.06.2008.

¹⁴⁸ Nenin 35/1, Ligji Nr. 8950, Datë 10.10.2002 “Për gjendjen civile”, i ndryshuar.

¹⁴⁹ Neni 34/5, Ligji Nr. 8950, Datë 10.10.2002 “Për gjendjen civile”, i ndryshuar.

¹⁵⁰ Neni 34 i Ligjit Nr. 8950, Datë 10.10.2002 “Për gjendjen civile” para ndryshimit.

¹⁵¹ Neni 34 /1, Ligji Nr. 8950, Datë 10.10.2002 “Për gjendjen civile”, i ndryshuar.

Legjislacioni shqiptar, parashikon regjistrimin si një e drejtë që garanton gëzimin e të drejtave të tjera të lidhura me qenien shtetas shqiptar. Regjistrimi i fëmijës bëhet kriter për aksesin e fëmijës në të drejtën për edukim.¹⁵² Për të kapërcyer këtë barrierë ligjore për fëmijët romë të paregjistruar, Ministri i Arsimit ka nxjerrë urdhrin, “Për regjistrimin në shkollë të nxënësve romë që nuk janë të paraqitur me certifikatë lindjeje”.¹⁵³ Ndërkohë qeveria shqiptare ka ndërmarrë iniciativën ligjore për miratimin e projekt-propozimit, “Identifikimi dhe Regjistrimi i Popullsisë Rome.” Projekti, do të zbatohet në të gjitha zonat ku të dhënat tregojnë që jeton popullatë rome. Kjo do të identifikohet nëpërmjet informacionit të siguruar nga struktura, partnerë dhe organizata të ndryshme që punojnë me këtë komunitet.¹⁵⁴

Së fundmi, është ndërmarrë një nismë ligjore pozitive në këtë drejtim, duke hartuar një ligj specifik për të drejtat e fëmijëve, i cili është, ende, në fazën e projektligjit dhe pritet të miratohet së shpejti. Ky projekt ligji rikonfirmon dhe një herë të drejtën e fëmijës për t’u regjistruar menjëherë sapo lind dhe për të patur një identitet.¹⁵⁵

Aleanca e Fëmijëve vëren se, pavarësisht ndryshimeve në Ligjin: “Për Gjendjen civile,” ka ende fëmijë të paregjistruar në Shqipëri. Shkaqet e mosregjistrimit lidhen kryesisht me lindjet jashtë maternitetit, pra mungon akti i lindjes; deklarimi i një identiteti fals ose të gabuar të prindërve në aktin e lindjes si dhe mungesa e dokumentacionit të prindërve për fëmijët që kanë lindur jashtë vendit. Prindërit e këtyre fëmijëve, shpesh si pasojë e mungesës së kulturës së duhur, mungesës së informacionit nuk e kanë bërë në kohë regjistrimin e fëmijëve të tyre pranë zyrave të gjendjes civile, ndërkohë që vërtetimi i lindjes së fëmijëve me anë të gjykatës është jashtë mundësive të tyre ekonomike.¹⁵⁶ Në rastin e prindërve emigrantë në Greqi, këta janë të detyruar të ndryshojnë emrat dhe për këtë shkak të deklarojnë atësi/amësi të ndryshme nga ato që figurojnë në regjistrat e gjendjes civile në Shqipëri. Në këtë mënyrë, është e pamundur të transkriptohet lindja e fëmijës dhe përfshirja e tij në trungun familjar. Pavarësisht iniciativave ligjore dhe fushatave, mbetet problematike regjistrimi i komunitetit rom. Ky komunitet si rezultat i mosregjistrimit vuan këto pasoja:

- a. Mohimin i të drejtës për të qenë qytetar i barabartë në shoqërinë demokratike të shtetit shqiptar.*
- b. Mospërfshirje e fëmijëve romë në skemën e përfitimeve të ndryshme të karakterit shëndetësor, social, ekonomik si dhe prindërve të tyre sipas legjislacionit të ndihmës ekonomike.*
- c. Analfabetizmi i fëmijëve romë, mosfrekuentimi i shkollave, mungesa e regjistrimit dhe certifikatave shton rrezikun e trafikimit apo shfrytëzimit.*

Megjithatë, nënvizojmë edhe përfshirjen e shoqatave rome në procesin e regjistrimit të fëmijëve romë të ndërmarrë nga Ministria e Brendshme.

¹⁵² Neni 25/1, i Ligjit Nr. 7952, Datë 21.06.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar” të tij parashikon se për regjistrimin e fëmijës në klasë të parë është e nevojshme ndër të tjera edhe certifikata e lindjes.

¹⁵³ Urdhri Nr. 6, Datë. 29/03/06 “Për regjistrimin në shkollë të nxënësve romë që nuk janë të paraqitur me certifikatë lindjeje” për të lehtësuar aksesin e tyre në sistemin arsimor”

¹⁵⁴ Projekt-propozimi “Identifikimi dhe Regjistrimi i Popullsisë Rome”, Terre des Hommes.

¹⁵⁵ Neni 7/2, Projektligji “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”.

¹⁵⁶ Raporti i veçantë “Për veprimtarinë e Avokatit të Popullit në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve”, Tirane 2008, f. 11.

Në vitin 2007 në Korçë një fëmijë 10 muajsh, i cili ndërroi jetë nga bronkopneumonia mbeti 32 orë pa u varrosur pasi nuk ishte i regjistruar në zyrat e Gjendjes Civile. Martesa në moshë të mitur e së ëmës e fakti se tashmë është vetëm 16 vjeçe ka krijuar problemet e para duke rrezikuar mosvarrimin e foshnjës. Në këto rrethana, familjes nuk mund ti jepej leja për ta varrosur në varrezat publike. Me ndërhyrjen e shoqatave rome në Korçë, Bashkisë së Korçës dhe Avokatit të Popullit u lejua që fëmija të varrosej, ku më parë u kryen procedurat e regjistrimit e mandej të çregjistrimit, nga ku u bë e mundur marrja e certifikatës së vdekjes.¹⁵⁷

Rekomandime:

- Të zbatohet dhënia e shpërblimit për regjistrimin në kohë të lindjeve.
- Të zbatohet Plani i propozuar nga Ministria e Brendshme për regjistrimin e popullsisë rome. Të përsëritet periodikisht nisma.¹⁵⁸
- Të bëhet informimi i komunitetit për regjistrimin e fëmijëve duke treguar rëndësinë e të qenit i ligjshëm brenda vendit dhe jashtë tij.
- Të sigurohet asistencë ligjore falas për fëmijët e komuniteteve vulnerable për çështjet e regjistrimit.¹⁵⁹
- Krijimi i lehtësirave të tjera për personat vulnerabël, të cilët i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian (përfshirimi, ose ulja e taksave vendore).¹⁶⁰
- Autoritetet shtetërore dhe, në veçanti, konsullatat shqiptare jashtë vendit duhet të lehtësojnë procedurat e regjistrimit të fëmijëve.
- Rritja e pjesëmarrjes së organizatave rome në implementimin e projekteve të hartuara nga institucionet shtetërore apo ndërkombëtare që kanë për objektiv minoritetin rom në fushat e lartpërmendura.¹⁶¹

Neni 8 - Ruajtja e identitetit

¹⁵⁷ Rast i raportuar nga shoqata “Amaro Drom” për minoritetin Rom në Korçë, problematika që, verifikohet si pasojë e mos-regjistrimit.

¹⁵⁸ Rekomandim nga Organizata VIS Albania.

¹⁵⁹ Rekomandim i Shoqatës Amaro Drom, (www.amarodrom.hu).

¹⁶⁰ Rekomandim i Shoqatës Amaro Drom, (www.amarodrom.hu).

¹⁶¹ Rekomandim i Shoqatës Amaro Drom, (www.amarodrom.hu).

Përsa i përket kësaj të drejtë Shqipëria ka ratifikuar këta instrumenta ndërkombëtarë:

1. “Konventa për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale nga organet mbikëqyrëse dhe fluksi ndërkufitar i të dhënave” dhe Protokolli Shtesë, me Ligjin Nr. 9287, datë 7.10.2004.

2. Konventa e Hagës “Për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit”, me Ligjin Nr 8624, datë 15.06.2000.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, ratifikuar me Ligjin Nr. 7510, datë 8.8.1991.

3. Konventa për Juridiksionin, Ligjin e Zbatueshëm, Njohjen, Zbatimin dhe Bashkëpunimin në Lidhje me Përgjegjësinë Prindërore dhe Masat për Mbrojtjen e Fëmijëve, me Ligjin Nr. 9443, datë 16.11.2005.

Kushtetuta, garanton fitimin dhe gëzimin e shtetësisë shqiptare vetvetiu në rast se njeri prind është shtetas shqiptar. Shtetësia shqiptare, është baza mbi të cilën gëzohen liritë dhe të drejtat.

Në Kushtetutë¹⁶² përfshihet e drejta e fëmijës për të marrë informacion mbi prindërit e tij, për identitetin apo ndryshimet e identitetit të fëmijës. Kushtetuta njeh të drejtën e fëmijës, për lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë¹⁶³, ndonëse në praktikë nuk merr masa për garantimin e tyre.

Në Kodin Civil, përcaktohet e drejta e personit për të ruajtur emrin dhe mbiemrin si dhe vendbanimin e tij,¹⁶⁴ si dhe e drejta për rivendosjen në vend të së drejtës së mohuar apo cenuar të emrit dhe mbiemrit, me anë të procesit gjyqësor.¹⁶⁵

Në rastin e birësimit, mbiemri i fëmijës së birësuar ndryshon. Fëmija merr për mbiemër atë të birësuesit dhe në rast të birësimit nga bashkëshortet, mbiemrin e përbashkët të tyre¹⁶⁶. Në regjistrin e të dhënave personale të tij ndryshon edhe përkatësia prindërore. Megjithatë, ligji parashikon të drejtën e të birësuarit, sipas moshës dhe nivelit të tij të pjekurisë që të njihet me të dhënat dhe historinë e tij dhe kur është rasti apo është e mundur edhe me të dhëna që i përkasin prindërve të tij biologjikë. Me qëllim, ruajtjen e identitetit të fëmijës, Kodi ndalon, birësimet e fëmijëve nga të paralindurit e tij si dhe vëllai dhe motra. Në rastin e fëmijëve, të lindur jashtë martese, garantohen të njëjta të drejta si për fëmijët e lindur nga martesa.¹⁶⁷

Kodi i Familjes përcakton se amësia dhe atësia e fëmijës së lindur nga martesa provohen nga akti i lindjes i regjistruar në gjendjen civile. Përcaktimi i amësisë dhe atësisë për fëmijët e lindur jashtë martese kryhet me

¹⁶² Neni 23 dhe 35 i Kushtetutës së R.Sh.

¹⁶³ Neni 10, Kushtetuta e R.Sh.

¹⁶⁴ Neni 5 dhe 12, Kodi Civil.

¹⁶⁵ Neni 5, Kodi Civil parashikon “Personit të cilit i mohohet e drejta e përdorimit të tyre ose cenohet nga përdorimi që të tjerët i bëjnë padrejtësisht, mund të kërkojë në gjykatë përdorimin e emrit ose të mbiemrit të vet, pushimin e cenimit si dhe shpërblimin e dëmit përkatës”.

¹⁶⁶ Neni 260, Kodi i Familjes “... N.q.s bashkëshortët birësues kanë mbiemra të ndryshëm, ata vendosin me marrëveshje mbiemrin e fëmijës së birësuar. Në rastin kur marrëveshja mungon fëmija i birësuar merr mbiemrin e atit birësues.

¹⁶⁷ Neni 171, Kodi i Familjes.

anë të njohjes vullnetare dhe/ose përmes një vendimi gjyqësor.¹⁶⁸ Kodi i Familjes, u njeh fëmijëve të drejtën të kundërshtojnë atësinë/amësinë, nëpërmjet provave hematologjike. Personi i paditur nuk mund të dërgohet forcërisht për analizat AND-së, por nëse ai e kundërshton, gjykata merr të mirëqënë atësinë/amësinë e fëmijës. Në një përfundim të tillë arrin edhe Gjykata e Strasburgut në një vendim të saj “Mikulic kundër Kroacisë”¹⁶⁹ ku theksohet se “gjykatat janë të lira të arrijnë në konkluzione duke marrë në konsideratë faktin se një prej palëve ka penguar ndërtimin e disa fakteve” .

Sipas ligjit “Për gjendjen civile”, lindja, seksi, emri e mbiemri, raportet e atësisë, mëmësisë, kombësia dhe shtetësia me përjashtim të seksit, mund të hiqen, të shuhen, të ndryshojnë ose t’u kalojnë të tjerëve në mënyrën e përcaktuar me ligj. Ndryshimet e emrit regjistrohen në procesverbal

Ligji i jep rëndësi momentit të lindjes dhe momentit të regjistrimit pasi ky është momenti ligjor me vërtetimin e të cilit lidhet njohja si subjekt i së drejtës.

Për fëmijët e vendosur në institucione përkujdesjeje, institucioni mban dokumentacionin e duhur për pranimin e fëmijës në shtëpi si dhe historinë e tij personale¹⁷⁰ ku përfshihet edhe informacioni në lidhje me familjen e origjinës.

Së fundmi, është ndërmarrë një nismë ligjore pozitive në këtë drejtim, duke hartuar një ligj specifik për të drejtat e fëmijëve, i cili është ende në fazën e projektligjit dhe pritet të miratohet së shpejti. Ky projekt ligj, rikonfirmon dhe një herë të drejtën e fëmijës për ruajtjen e identitetit.¹⁷¹

Aleanca e Fëmijëve vëren se kuadri ligjor në lidhje me ruajtjen e identitetit është i plotë ndonëse nuk ka referim specifik për fëmijën.

Neni 13 - E drejta e fëmijëve për lirinë e shprehjes

Kushtetuta¹⁷² garanton lirinë e shprehjes, të drejtën e informacionit¹⁷³ dhe të drejtën për tu njohur me të dhënat e mbledhura rreth personit.¹⁷⁴ Këtu përfshihet dhe e drejta e fëmijës të marrë informacion dhe të njihet me të dhënat që disponojnë organet përkatëse për prindërit e tij.

Në Kushtetutë parashikohen dhe mekanizma mbrojtës duke sanksionuar rastet kur kjo e drejtë mund të kufizohet¹⁷⁵.

¹⁶⁸ Neni 165, Kodi i Familjes.

¹⁶⁹ Vendim i Gjykatës së Strasburgut, Datë 07.02.2002, Çështja “Mikulic kundër Kroacisë”.

¹⁷⁰ Vendim Nr. 659, Datë 17.10.2005 “Për Standardet e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale”.

¹⁷¹ Neni 7/1,2 Projektligji “Për Mbrojtjen të Drejtave të Fëmijëve”.

¹⁷² Neni 22, Kushtetuta e R.Sh.

¹⁷³ Neni 23, Kushtetuta e R.Sh.

¹⁷⁴ Neni 35, Kushtetuta e R.Sh.

¹⁷⁵ Neni 17, Kushtetuta e R.Sh.

Garantohet e drejta për t'u informuar për të gjithë pjesëmarrësit në një procedurë administrative¹⁷⁶ si dhe kufijtë e kësaj të drejte, por pa referencë të veçante për fëmijët. Kjo mangësi mund të pengojë fëmijën në ushtrimin personalisht të kësaj të drejte duke e kushtëzuar me pëlqimin e përfaqësuesit ligjor¹⁷⁷.

Në ligjin “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare” nuk ka dispozitë të veçantë ku të flitet për fëmijët, por nuk shprehet as për përjashtime¹⁷⁸.

Ligji për Radio-Televizionin nuk shprehet për nevojat e veçanta të fëmijëve në fushën e mas-medias. Ky ligj parashikon një dispozitë të veçantë për mbrojtjen e të miturve, sipas së cilës nuk lejohet të jepen në radio e televizion reklama që nxisin sjellje, të cilat rrezikojnë shëndetin dhe zhvillimin normal, psikik të fëmijëve¹⁷⁹.

Dispozitat normative të arsimit parauniversitar publik parashikojnë të drejtën e nxënësve për t'u shprehur.¹⁸⁰

Nuk ka ndonjë mekanizëm monitorues të posaçëm në lidhje me të drejtën e fëmijëve për lirinë e shprehjes, megjithatë si i tillë mund të veprojë Avokati i Popullit.¹⁸¹ Fëmija nuk kushtëzohet nga përfaqësimi i prindit për të nisur procedurën e ankimit.¹⁸² Pranë këtij organi është ngritur dhe një nënseksion për fëmijët, por aktualisht nuk funksionon. Për këtë arsye, lind nevoja për ngritjen e një institucioni të pavarur për të Drejtat e Fëmijëve (Ombudsman apo Komisioner për Fëmijët), i cili do të jetë “garantues” i zbatimit të Konventës së të Drejtave të Fëmijës dhe do veprojë për të promovuar të drejtat e fëmijëve¹⁸³.

Së fundmi, është ndërmarre një nismë ligjore pozitive në këtë drejtim, duke hartuar një ligj specifik për të drejtat e fëmijës, i cili është ende në fazën e projektligjit dhe pritet të miratohet së shpejti. Ky projekt ligj rikonfirmon dhe një herë të drejtën e fëmijës për lirinë e shprehjes¹⁸⁴.

Aleanca e Fëmijëve vëren se mungojnë dispozita të veçanta për nevojat e fëmijëve në fushën e mas-medias, pasi

¹⁷⁶ Neni 20, Kodi i Procedurave Administrative.

¹⁷⁷ Neni 7, Kodi Civil, parashikon se “i mituri që ka mbushur 14 vjec, mund të kryejë veprime juridike vetëm me pëlqimin e mëparshëm të përfaqësuesit të tij ligjor”.

¹⁷⁸ Neni 2, Ligji Nr. 8503, Datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”

¹⁷⁹ Neni 56, Ligjia Nr. 8410, Datë 30.09.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në R.Sh”

¹⁸⁰ Neni 36, Dispozitat Normative për shkollat publike 2002-20003, parashikon “... nxënësi ndër të tjera ka të drejtë të shfaqë lirish mendimin e tij në të gjitha format, të njihet me të drejtat e tij, t'i përhapë ato dhe të kërkojë përmbushjen dhe respektimin e tyre prej të tjerëve”.

¹⁸¹ Neni 2/2, Ligji Nr.8454, Datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit” plotësuar me Ligjin Nr.8600, Datë 10.04.2000, ndryshuar me Ligjin Nr.9398, Datë 12.05.2005 thotë se: “Avokati i Popullit i udhëhequr nga parimet e paanësisë, konfidentalitetit, profesionalizmit dhe pavarësisë ushtron veprimtarinë në mbrojtje të të drejtave dhe të lirive të njeriut, të parashikuara në dispozita kushtetuese dhe në ligje”. Në këtë kuadër, e drejta e fëmijëve për lirinë e shprehjes si një e drejtë kushtetuese përfshihet në kompetencat e Avokatit të Popullit, i cili do të marrë masat e nevojshme për rivendosjen e drejtës së shkelur.

¹⁸² Neni 13, Ligji Nr. 8454, Datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”.

¹⁸³ Raporti i veçantë “Për veprimtarinë e Avokatit të Popullit në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve”, Tiranë 2008, f. 13.

¹⁸⁴ Neni 11, Projektligji “Për të Drejtat e Fëmijëve”.

Ligji “Për radion dhe televizionin”¹⁸⁵ shprehet në mënyrë të përgjithshme për respektimin e të drejtave dhe interesave të të miturve. Vërehet gjithashtu se Ligji për Radio-Televizionin dhe Ligji “Për kinematografinë” ka parashikuar ndalimin e shfaqjes së programeve të caktuara për fëmijë, por jo llojin e programeve që duhet të transmetojë për t’i siguruar fëmijës informacionin dhe materialet e nevojshme që synojnë të rrisin mirëqenien e tij shoqërore, shpirtërore e morale, si dhe shëndetin e tij fizik dhe mendor.¹⁸⁶

Rekomandim:

- Të merren të gjitha masat e duhura, duke përfshirë edhe mjetet ligjore, me qëllim zbatimin e plotë të Nenit 13 dhe të paraqiten masa të reja, për të nxitur dhe garantuar të drejtën e fëmijës për liri të shprehjes.
- Të amendohet legjislacioni duke parashikuar në mënyrë më specifike gëzimin e kësaj të drejte nga fëmijët.

Neni 14 - Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë

Në Kushtetutë parashikohet se shteti është asnjans në çështjet e besimit dhe të ndërgjegjes dhe liria e ndërgjegjes dhe e fesë është e garantuar.¹⁸⁷ Pengimi i këtyre të drejtave përbën kundravajtje penale.¹⁸⁸ Kjo e drejtë është e garantuar, por pa referencë specifike për fëmijët.

Arsimi parauniversitar publik ka karakter laik dhe në institucionet arsimore publike ndalohet indoktrinimi ideologjik e fetar.¹⁸⁹

Institucionet arsimore jopublike, ku zhvillohen lëndë fetare, midis të tjerave, duhet të paraqesin edhe një deklaratë, me anë të së cilës marrin përsipër të respektojnë Deklaratën Universale të Drejtave të Njeriut dhe Konventën për të Drejtat e Fëmijës. Nuk është e përcaktuar nëse duhet të merret pëlqimi i fëmijës që regjistrohet në këtë shkollë, ose që do të ç’regjistrohet, ndërsa për pjesëmarrjen fakultative të fëmijëve në veprimtaritë jashtë procesit mësimor, bëhet me miratimin e prindit, kujdestarit.¹⁹⁰ Ligji nuk përcakton se si veprohet kur fëmija dhe prindi kanë mendime të ndryshme, duke lënë mënjanë parimin e interesit më të lartë të fëmijës. Gjithashtu, nuk është parashikuar ndonjë rregull në lidhje me mbajtjen e veshjeve fetare në shkolla.

¹⁸⁵ Ligji Nr. 8410, Datë 30.09.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në R.Sh”.

¹⁸⁶ Ligji Nr. 8096, Datë 29.04.1996 “Për kinematografinë”.

¹⁸⁷ Neni 10, Kushtetuta e R.Sh

¹⁸⁸ Neni 131, Kodi Penal, parashikon: “... kundravajtje penale është krijimi i pengesave ose ndalimi i aktivitetit të personave që duan të marrin pjesë në ceremonitë fetare, ose që duan të shprehin lirisht bindjet fetare”.

¹⁸⁹ Neni 7, Ligji Nr. 7952, Datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 8387, Datë 30.7.1998.

¹⁹⁰ Pika 2/a dhe pika 6 i V.K.M Nr 248, Datë 28.05.1999.

Kodi i Familjes përcakton ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, por nuk ka specifikime për ta drejtuar fëmijën në ushtrimin e të drejtës së besimit fetar.

Nuk ka ndonjë mekanizëm monitorues të posaçëm për shqyrtimin e ankesave të fëmijëve në lidhje me të drejtën e tyre për lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, megjithatë, si i tillë mund të veprojë Avokati i Popullit.¹⁹¹ Pranë këtij organi është ngritur dhe një nënseksion për fëmijët, por aktualisht nuk funksionon.

Së fundmi, është ndërmarrë një nismë ligjore pozitive në këtë drejtim, duke hartuar një ligj specifik për të drejtat e fëmijës, i cili është ende në fazën e projektligjit dhe pritet të miratohet së shpejti. Ky projekt ligj rikonfirmon dhe një herë të drejtën e fëmijës për lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë.¹⁹²

Aleanca e fëmijëve është e shqetësuar se në lidhje me këtë të drejtë ende ka çështje të cilat kërkojnë saktësim të mëtejshëm. Nuk është e parashikuar mosha, në të cilën pëlqimi i prindit për përfshirjen e fëmijës në aktivitete jashtëshkollore me karakter fetar, është i nevojshëm. Kjo do të ishte me interes sidomos në shkolla të këtij karakteri, ku pëlqimi dhe zgjedhja nga vetë fëmija është i domosdoshëm. Aleanca është e shqetësuar për mungesën e një rregullimi të posaçëm dhe të standardizuar në rang vendi nga legjislacioni për arsimin në lidhje me mbajtjen e veshjeve fetare në shkolla. Dispozitat Normative për Arsimin Publik, parashikojnë se uniforma shkollore dhe veshja e nxënësve, në përgjithësi, pa specifikuar veshjet fetare¹⁹³ përcaktohet në rregulloret e brendshme të shkollave dhe këto të fundit, në përgjithësi, nuk kanë parashikime specifike në lidhje me mbajtjen nga ana e nxënësve të veshjeve të caktuara, kryesisht të shamive nga ana e vajzave të besimit mysliman. Duke qenë se në media më shumë se një herë janë raportuar raste konfliktesh të lindura nga interpretimi i rregulloreve të shkollës, ku çështja e mbajtjes së shamive dhe e veshjeve të caktuara janë bërë shkak për moslejimin e nxënësve në ndjekjen e programit mësimor, është e rëndësishme që kjo çështje të rregullohet duke garantuar si të drejtën për besimin fetar dhe aksesin në edukim, duke mos e lënë këtë çështje në diskrecion të drejtuesve të shkollave.

¹⁹¹ Ligji Nr.8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit” plotësuar me ligjin nr.8600 datë 10.04.2000, ndryshuar me ligjin nr.9398, datë 12.05.2005 thotë se Avokati i Popullit i udhëhequr nga parimet e paanësisë, konfidencialitetit, profesionalizmit dhe pavarësisë ushtron veprimtarinë në mbrojtje të të drejtave dhe të lirive të njeriut, të parashikuara në dispozita kushtetuese dhe në ligje. Në këtë kuadër, e drejta e fëmijëve për lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë si një e drejtë kushtetuese përfshihet në kompetencat e Avokatit të Popullit, i cili do të marrë masat e nevojshme për rivendosjen e të drejtës së shkelur.

¹⁹² Neni 12, Projektligji “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”.

¹⁹³ Neni 36, Dispozitat Normative të arsimit publik parashikon :Uniforma shkollore e nxënësit, përdorimi apo mospërdorimi i saj është çështje që vendoset në Rregulloren e Brendshme të Shkollës në bazë të konsensusit të këshillit të mësuesve, këshillit të prindërve dhe qeverisë së nxënësve të shkollës. Neni 40(j) parashikon se një nga detyrat e nxënësve është edhe se veshja e paraqitja e tij të jenë korrekte, pa teprime, e përshtatshme me moshën që ai ka, në përputhje me kërkesat e normat e bashkëjetesës në shoqëri dhe me rregulloren e brendshme të shkollës.

Në median e shkruar¹⁹⁴ është raportuar disa herë mbi ngjarjet e ndodhura në disa shkolla 8-vjeçare dhe të mesme të rrethit të Tiranës, ku nxënësit janë përzënë nga mësimi dhe nuk janë lejuar të ndjekin normalisht atë, për shkak të përdorimit të simboleve fetare, në rastin konkret të ferexheve, në kohën kur ishin në shkollë.

Të ndodhur përpara përgjegjësisë së përjashtimit nga shkolla të minoreneve, ndjekja e arsimit të detyruar të të cilave është një e drejtë e pamohueshme, drejtuesit e shkollave janë shprehur: “Ky veprim është ndërmarrë sepse nuk lejohet prezenca në shkollë me këtë uniformë, duke qenë se shkolla është laike. Po kështu, shkolla ka një rregullore të brendshme, e cila parashikon mbajtjen e një uniforme për të gjithë nxënësit e shkollës”. Prindërit e këtyre fëmijëve janë sorollatur dyerve të shkollave, Drejtorisë Arsimore dhe Ministrisë së Arsimit, por asgjë nuk ka ndryshuar në sjelljen e titullarëve, që nxjerrin përpara ligjin. Ata kanë kthyer mbrapsht prindërit e interesuar për shkollimin e fëmijëve, edhe pse me ferexhe. Sipas tyre, ligji e ndalon fenë në institucionet e arsimit publik, që është laik. Duke iu referuar ligjit për arsimin, në nenin 7 thuhet se “arsimi parauniversitar publik ka karakter laik. Në institucionet arsimore publike ndalohe indoktrinimi ideologjik e fetar”.



Rekomandim:

- Të plotësohet legjislacioni për arsimin duke parashikuar rregullime për veshjen fetare në shkolla.

Neni 15 - E drejta e fëmijëve për lirinë e organizimit dhe tubimit paqësor

Në Kushtetutë, është sanksionuar e drejta e organizimit¹⁹⁵ si dhe liria e tubimeve paqësore.¹⁹⁶ Përdorimi i termit “kushdo” nënkupton përfshirjen e fëmijëve.

Në Kodin Civil, parashikohet e drejta e fëmijëve, që kanë mbushur moshën 14 vjeç, të bëjnë pjesë në

¹⁹⁴ Gazeta “SHQIP”, *Mbanin Ferexhe, drejtoresha përzë dy vajzat nga shkolla*, dt. 05.02.2008 dhe AIM, Tirana, *Katër vajza me ferexhe*, dt. 17.02.2001.

¹⁹⁵ Neni 46, Kushtetuta R.Sh parashikon: “Kushdo ka të drejtë të organizohet kolektivisht për çfarë do qëllimi të ligjshëm”,

¹⁹⁶ Neni 47, Kushtetuta e R.Sh parashikon: “Tubimet paqësore në sheshe dhe në vendet e kalimit publik bëhen sipas procedurave të parashikuara me ligj”.

organizata shoqërore.¹⁹⁷ Ndërsa për krijimin e shoqatave, si për çdo veprim tjetër juridik, kërkohet miratimi i përfaqësuesit ligjor.¹⁹⁸

Ligji “Për të drejtën e tubimeve,” parashikon se të gjithë shtetasit, pa asnjë dallim, kanë të drejtë për tubime publike,¹⁹⁹ duke mos vendosur kufizime moshore, pra, fëmijët nuk pengohen ligjërisht dhe kushtetutshmërisht në realizimin e kësaj të drejte. Lirinë e organizimit si një të drejtë të fëmijëve e gjejmë të parashikuar në dispozitat normative për arsimin parauniversitar.²⁰⁰

Nuk ka ndonjë mekanizëm monitorues të posaçëm për shqyrtimin e ankesave të fëmijëve në lidhje me këtë të drejtë, megjithatë, si i tillë mund të veprojë Avokati i Popullit.²⁰¹ Pranë këtij organi është ngritur dhe një nënseksion për fëmijët, por aktualisht nuk funksionon.

Së fundmi, është ndërmarrë një nismë ligjore pozitive në këtë drejtim, duke hartuar një ligj specifik për të drejtat e fëmijëve, i cili është ende në fazën e projektligjit dhe pritet të miratohet së shpejti. Ky projekt ligj, rikonfirmon dhe një herë të drejtën fëmijëve për lirinë e organizimit dhe e tubimeve paqësore.²⁰²

Aleanca vëren se Kushtetuta dhe ligji nuk e ndalojnë të drejtën e fëmijëve për të zhvilluar tubime paqësore në vende publike, por ekzistenca e disa paqartësive apo mangësive në aspektin normues e mbartin në potencë kufizimin e kësaj të drejte në praktikë.²⁰³ Nga praktika rezulton se nuk janë ngritur struktura për monitorimin dhe garantimin e së drejtës së fëmijëve për lirinë e organizimit dhe tubimit paqësor. Shumë fëmijë marrin pjesë në tubime politike edhe gjatë kohës së mësimi duke qenë thuarje të detyruar nga drejtuesit e institucioneve arsimore publike. Gjithashtu,

¹⁹⁷ Neni 7, Kodi Civil.

¹⁹⁸ Neni 7, Kodi Civil.

¹⁹⁹ Ligjin Nr. 8145, Datë 11.9.1996 “Për të drejtën e tubimeve”, parashikon se në Republikën e Shqipërisë të gjithë shtetasit, pa asnjë dallim për shkak të seksit, racës, ngjyrës, gjuhës, besimit, etnisë, gjendjes ekonomike e financiare, arsimore e sociale, të bindjeve politike, përkatësisë prindërore ose të çdo lloj rrethane tjetër vetjake, kanë të drejtë për tubime publike.

²⁰⁰ Dispozitat normative të arsimit parauniversitar publik, në nenin 36 (g) parashikojnë se nxënësi ka të drejtë të zgjidhet dhe të zgjedhë të tjerët në këshilla, shoqata, organizma të ndryshme, që përcaktohen në ligj apo në Dispozitat normative, si dhe të përfaqësojë interesat e klasës apo të një grupi nxënësish në to; të aderojë në organizata shoqërore në përshtatje me statusin e tyre, apo në shoqata shkencore, klube sportive, grupe kulturore-artistike brenda e jashtë shkolle.

²⁰¹ Ligji Nr. 8454, Datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit” plotësuar me ligjin Nr. 8600 datë 10.04.2000, ndryshuar me ligjin Nr. 9398, datë 12.05.2005 thotë se Avokati i Popullit i udhëhequr nga parimet e paanësisë, konfidencialitetit, profesionalizmit dhe pavarësisë ushtron veprimtarinë në mbrojtje të të drejtave dhe të lirive të njeriut, të parashikuara në dispozita kushtetuese dhe në ligje. Në këtë kuadër, e drejta e fëmijëve për lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë si një e drejtë kushtetuese përfshihet në kompetencat e Avokatit të Popullit, i cili do të marrë masat e nevojshme për rivendosjen e drejtës së shkelur.

²⁰² Neni 13, Projektligji “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës”

²⁰³ Ligji Nr. 8145, Datë 11.9.1996 “Për të drejtën e tubimeve” ka disa rregulla që lidhen me “marrjen e lejes me shkrim nga autoritetet policore”, çështje teknike që kanë të bëjnë me identitetin dhe adresën e organizatorëve, qëllimin e tubimit, datën, vendin dhe kohën e fillimit dhe të mbarimit të tubimit, numrin e përafërt të pjesëmarrësve. Të gjitha këto lidhen me konceptin ligjor “organizatorë të tubimeve paqësore”, nga i cili nuk përjashtohen edhe fëmijët. Ligji nuk shprehet në mënyrë eksplicite nëse garantohet kjo e drejtë për fëmijët, por heshtja apo mangësitë që ai i përmban lënë vend për keqkuptime.

nuk ka masa të veçanta në rastet kur në tubime marrin pjesë edhe fëmijët,²⁰⁴ megjithëse kjo çështje ka qenë edhe në fokusin e punës të Avokatit të Popullit.²⁰⁵

Rekomandime:

- Të plotësohet kuadri ligjor në lidhje me përcaktimin e masave të veçanta për rastet kur në tubime janë pjesëmarrës fëmijët.

Neni 16 - E drejta e fëmijëve për lirinë e jetës private

Kushtetuta ka përcaktuar fshehtësinë e korrespondencës²⁰⁶ dhe paprekshmërinë e banesës²⁰⁷ për cilindo, pa përcaktuar në mënyrë të veçantë kategorinë e fëmijëve, por dhe pa e përjashtuar atë.

Gjithashtu, dhunimi i banesës, ndërhyrja e padrejtë në jetën private, ose shkelja e fshehtësisë së korrespondencës dënohen sipas dispozitave të Kodit Penal.²⁰⁸

Në Kodin e Procedurës Penale, përcaktohen rastet kur mund të bëhet kontrolli i banesës dhe përgjimi i bisedimeve ose komunikimeve.²⁰⁹ Në funksion të mbrojtjes së jetës private të fëmijës në të gjitha fazat e procedimin penal, Kodi i Procedurës Penale, ndalon publikimin e gjeneraliteteve dhe fotografive të të pandehurit të mitur, të akuzuar për veprën penale për të cilën dyshohet.

Në konceptin e jetës private të personit përfshihet edhe e drejta e emrit. Mbrojtja e të drejtës së emrit parashikohet në Kodin Civil.²¹⁰

²⁰⁴ Ligji Nr. 8145, Datë 11.9.1996 “Për të drejtën e tubimeve” ka disa rregulla që lidhen me “marrjen e lejes me shkrim nga autoritetet policore”, çështje teknike që kanë të bëjnë me identitetin dhe adresën e organizatorëve, qëllimin e tubimit, datën, vendin dhe kohën e fillimit dhe të mbarimit të tubimit, numrin e përafërt të pjesëmarrësve. Në nenet në vazhdim nuk asnjë parashikim specifik për fëmijët, nëse duhet të ketë masa të veçanta për zhvillimin e tubimit nga fëmijët ose masa të veçanta mbrojtëse për ta.

²⁰⁵ Deklarate për median nga Avokati i Popullit me synim sensibilizimin e të gjitha forcave politike shqiptare për të mos përfshirë fëmijët në mitingjet elektorale. Raporti i veçantë, “Për veprimtarinë e Avokatit të Popullit në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve”, Tiranë 2008, f. 9.

²⁰⁶ Neni 36, Kushtetuta e R.Sh, “Liria dhe fshehtësia e korrespondencës ose e çdo mjeti tjetër të komunikimit janë të garantuara”.

²⁰⁷ Neni 37, Kushtetuta e R.Sh, “Paprekshmëria e banesës është e garantuar. Kontrolllet e banesës, si dhe të mjediseve që njësohen me të, mund të bëhen vetëm në rastet dhenë mënyrat e parashikuara me ligj”.

²⁰⁸ Neni 112, Kodit Penal “...dhunimi i banesës dënohet me gjobë ose me burgim deri në 3 muaj, ndërhyrja e padrejtë në jetën private përbën kundravajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në 2 vjet, pengimi ose shkelja e fshehtësisë së korrespondencës përbën kundravajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet”.

²⁰⁹ Nenet 202, 221, 222, Kodi i Procedurës Penale.

²¹⁰ Neni 5, Kodi Civil.

Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale parashikon se përpunimi i të dhënave bëhet duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut²¹¹ dhe mbi bazën e kritereve ligjore të vendosura në ligj.²¹² Megjithatë, kriteret ligjore për përpunimin e të dhënave nuk përmbajnë referencë të veçantë për fëmijët, prandaj është e paqartë nëse pëlqimi për përpunimin e të dhënave personale të një fëmije duhet të jepet nga vetë fëmija apo/ose nga përfaqësuesi i tij ligjor. Ligji, gjithashtu, garanton të drejtën për akses²¹³ si dhe të drejtën e subjektit të të dhënave për të kundërshtuar në çdo kohë përpunimin e të dhënave rreth tij, përfshirë të drejtën për t'u ankuar në gjykatë²¹⁴.

Së fundmi, është ndërmarrë një nismë ligjore pozitive në këtë drejtim, duke hartuar një ligj specifik për të drejtat e fëmijëve, i cili është ende në fazën e projektligjit dhe pritet të miratohet së shpejti. Ky projekt ligj rikonfirmon dhe një herë të drejtën e fëmijës për jetë private.²¹⁵

Aleanca për Fëmijët është e shqetësuar për mungesën e strukturave të veçanta për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Megjithatë, si i tillë mund të veprojë Avokati i Popullit. Pranë këtij organi është ngritur dhe një nënseksion për fëmijët, i cili aktualisht nuk funksionon. Gjithashtu, në praktikë vazhdon të ketë raste abuzimi me fëmijët nga punonjësit e administratës apo organet e policisë së shtetit. Gjithashtu, Aleanca është e shqetësuar në lidhje me ushtrimin e së drejtës për të kërkuar procedimin e fajtorit dhe shpërblimin e dëmit nga të miturit, pasi mungesa e zotësisë për të vepruar bën që këto të drejta të ushtrohen nga përfaqësuesit ligjorë. Theksojmë se i mituri nuk mund të kontaktojë një mbrojtës ligjor vetë, por ai përcaktohet nga prindi apo përfaqësuesi ligjor.

Rekomandime:



- Ngritja e strukturave dhe mekanizmave monitoruese dhe garantuese për të drejtën e fëmijës për jetë private.
- Rishikimi i akteve ligjore me qëllim përfshirjen e fëmijëve si subjekte të veçanta të cilat të parashikojnë mënyrat dhe rrugët se si mund të realizohet e drejta për jetë private tek fëmijët.

²¹¹ Neni 2, Ligji Nr. 9887, Datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

²¹² Neni 6, Ligji Nr. 9887, Datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

²¹³ Neni 12, Ligji Nr. 9887, Datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

²¹⁴ Neni 15 dhe 16, Ligji Nr. 9887, Datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

²¹⁵ Neni 14, Projektligji “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës”

Neni 17 - E drejta për të pasur akses në informacionin e nevojshëm

Kushtetuta sanksionon lirinë e shprehjes²¹⁶ dhe të informacionit²¹⁷ për cilindo. Fëmijët përftojnë nga parashikimet e këtyre dispozitave kushtetuese.

Në ligjin “Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë”²¹⁸ i ndryshuar, sanksionohet se veprimtaria radiotelevizive është e lirë.²¹⁹ Megjithatë, në këtë veprimtari respektohen, në mënyrë të veçantë, të drejtat, interesat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve.²²⁰

Ky ligj ndalon edhe dhënien në radiotelevizion të reklamave që nxisin sjellje, të cilat rrezikojnë shëndetin dhe zhvillimin normal psikik të fëmijëve²²¹ si dhe nuk lejohet të paraqiten në reklamë fëmijë me pije alkoolike në duar ose në ndonjë mënyrë tjetër.

Në Kodin Penal parashikohet si vepër penale përdorimi i të miturit për prodhimin e materialeve pornografike, si dhe shpërndarja ose publikimi i tyre në internet apo në forma të tjera.²²²

Ligji “Për Shtypin,”²²³ i ndryshuar, parashikon të drejtën e prokurorit të tërheqë nga qarkullimi një botim edhe pa urdhër konfiskimi në rastet kur nxjerrja apo shpërndarja e atij botimi përbën një vepër të kundërligjshme, e cila vërteton objektin e shpërndarjes së shkrimeve që përbëjnë rrezik moral për rininë.²²⁴

Megjithë rregullimet ligjore, theksojmë se ende ka pak programe për fëmijët,²²⁵ në fushat që lidhen me ta dhe aq më tepër për kategoritë e veçanta të fëmijëve, si ata të minoriteteve, apo me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, nuk ka patur programe konkrete për promovimin e të drejtave të fëmijëve në kuadër të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve.²²⁶

Mungesa e programeve për fëmijë lidhet me mungesën e infrastrukturës/psikologut për realizimin e tyre

²¹⁶ Neni 22, Kushtetuta R.Sh.

²¹⁷ Neni 23, Kushtetuta e R.Sh

²¹⁸ Ligji Nr. 8221, Datë 14.5.1997 “Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

²¹⁹ Neni 4, Ligji Nr. 8221, Datë 14.5.1997 “Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

²²⁰ Neni 35 dhe 42, Ligji Nr. 8221, Datë 14.5.1997 “Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

²²¹ Neni 54, Ligji Nr. 8221, Datë 14.5.1997 “Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

²²² Neni 117, Kodi Penal, ndryshuar me Ligjin Nr. 9859, Datë 21.01.2008.

²²³ Ligji Nr. 7756, Datë 11.10.1993 “Për Shtypin”, i ndryshuar.

²²⁴ Neni 8, Ligji Nr. 7756, Datë 11.10.1993 “Për Shtypin”, i ndryshuar.

²²⁵ Duke pasur parasysh kohën që shpenzojnë fëmijët përpara televizorit, është për t’u theksuar fakti se një pjesë jo e konsiderueshme e fëmijëve të grup-moshës 15-18 vjec kalojnë 5-10 orë në ditë përpara televizor. Shih Aneks I- Zbatimi i konventës për të Drejtat e Fëmijëve realizuar nga këndvështrimi i fëmijëve, dhjetor 2008-janar 2009.

²²⁶ Sipas intervistës së kryer me Departamentin e Programacionit pranë KKRT-se rezultoi se në lidhje me Konventën e fëmijëve nuk ka patur programe konkrete por promovimi i të drejtave të saj është bërë nëpërmjet programeve që promovojnë të drejtat e fëmijëve psh. TVSH ka realizuar programe të tilla. Por gjithashtu TVSH ne krahasim me të gjitha televizione e tjera e ka të drejtyruar me ligj realizimin e programeve për fëmijë dhe kjo e bën më të kompletuar atë në këtë fushë. Në fushën e tv private VIZION plus mund ta vlerësojmë si një televizion privat që i kushton vëmendje të veçantë programeve për fëmijë.

si dhe me pamundësinë financiare.²²⁷ Gjithashtu, problematike paraqiten rastet kur konstatohen shkelje të të drejtave të fëmijëve pasi legjislacioni në këtë pikë është i paplotë.²²⁸ Së fundmi, është ndërmarrë një nismë ligjore pozitive në këtë drejtim, duke hartuar një ligj specifik për të drejtat e fëmijëve, i cili është ende në fazën e projektligjit dhe pritet të miratohet së shpejti. Ky projekt ligj rikonfirmon dhe një herë të drejtën e fëmijës për informacion.²²⁹

Aleanca për Fëmijët është e shqetësuar pasi kuadri ligjor ka karakter deklarativ dhe nuk ka krijuar mekanizma efektivë për implementimin në praktikë. Gjithashtu, Ligji Nr. 8221, datë 14.5.1997 “Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat”²³⁰ shprehet në mënyrë të përgjithshme për respektimin e të drejtave dhe interesave të fëmijëve. Pra, ky ligj nuk parashikon në asnjë rast nevojat e veçanta të fëmijës në fushën e mas-medias. Gjithashtu, duke pasur parasysh kohën që fëmijët shpenzojnë përpara televizorit,²³¹ vlen të theksohet se pavarësisht kufizimeve në lidhje me transmetimet televizive, vihet re mungesa e një programacioni të përshtatshëm për fëmijët dhe adoleshentët në televizionet publike dhe private.

Rekomandime:

- Të rishikohet legjislacioni i brendshëm me qëllim identifikimin e mekanizmave të përshtatshëm për të ndihmuar fëmijët në gëzimin e së drejtës së tyre për akses në informacion.
- Të hartohen udhëzime për të mbrojtur fëmijët nga informacioni i dëmshëm.

Neni 37 - Tortura, trajtimet degraduese dhe privimi i lirisë

Kuadri ligjor shqiptar garanton të gjithë shtetasit, përfshirë edhe fëmijët, nga tortura, trajtimet çnjerëzore dhe poshtëruese.

²²⁷ Sipas intervistës së kryer me Departamentin e Programacionit pranë KKRT-së është shumë e rëndësishme të përmirësohet legjislacioni edhe për sa i përket mbështetjes së TV lokal nga buxheti i Bashkive apo Komunave, p.sh do ishte në ndihmë të TV lokal financimi i programeve të fëmijëve, por kjo do të kërkonte, në mënyrë të veçantë, rregullime ligjore.

²²⁸ Sipas intervistës së kryer me Departamentin e Programacionit pranë KKRT-së rezulton se së shpejti do të miratohet “Rregullorja e sinjalistikës për respektimin e orareve dhe shenjave për programacionet”.

²²⁹ Neni 15, Projektligji “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës”.

²³⁰ Ligji Nr. 8221, Datë 14.5.1997 “Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat”.

²³¹ Shih Aneks I- Zbatimi i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve analizuar nga këndvështrimi i fëmijës, dhjetor 2008-janar 2009, f. 34, “...mbështetur te grafikët dhe tabelat e mësipërme, mund të dallohet se pjesa më e madhe e fëmijëve kalojnë 2-4 orë në ditë duke parë televizor. Është për t’u theksuar fakti se një pjesë jo e pa konsiderueshme e fëmijëve të grup-moshës 15-18 vjeç, në raport me çështjen të cilën po trajtojmë, kalojnë 5-10 orë në ditë përpara televizori ».t

Shteti Shqiptar ka ratifikuar “**Konventën kundër torturës, trajtimit çnjerëzor dhe degradues**” (10 dhjetor 1984). Me ratifikimin e “Konventës Evropiane të të drejtave të njeriut” dhe protokolleve shtesë të saj, kuadri ligjor Shqiptar nuk aplikon dënimin me vdekje.

Në Kushtetutë²³² dhe në Kodin Penal të Shqipërisë, torturat, dënimet poshtëruese dhe çnjerëzore të cilat cenojnë dinjitetin dhe personalitetin e shtetasve dënohen me ligj.

Kodi penal nuk e parashikon si rrethanë cilësuese rastin kur këto vepra penale ndodhin tek fëmijët.

Ligji garanton mosndalimin e personit nën 14 vjeç, duke lënë një boshllëk ligjor për rastet kur personi i ndaluar nuk ka dokument identifikimi dhe dyshohet se është nën këtë moshë. Në këto raste duhet të zbatohet parimi se çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit.²³³ Së fundmi, është ndërmarrë një nismë ligjore pozitive në këtë drejtim, duke hartuar një ligj specifik për të drejtat e fëmijës, i cili është ende në fazën e projektligjit dhe pritet të miratohet së shpejti. Ky projekt ligj rikonfirmon dhe një herë të drejtën e fëmijës për të mos iu nënshtruar torturës, dënimeve ose trajtimeve mizore, çnjerëzore ose poshtëruese.²³⁴

Aleanca për Fëmijë është e shqetësuar për trajtimin gjatë 48 orëve të të miturve në ambientet e paraburgimit të komisarivateve. Gjithashtu, për shkak të mungesave në infrastrukturë, të miturit vendosen në të njëjtat qeli me të paraburgosurit e tjerë duke sjellë raste të abuzimeve apo keqtrajttimeve jo vetëm nga punonjësit në komisariate por edhe nga vetë të ndaluarit.

I mituri E.Sh akuzohet për veprën penale të “Grabitjes me dhunë në bashkëpunim”. Ai akuzohet, se në bashkëpunim me dy persona të tjerë ka tentuar të grabisë një bankë. I mituri referon historinë e tij nga momenti i arrestimit: “Isha në një lokal, në Peshkopi, duke pritur një mikun tim. Ai po vonohej dhe vendosa të dal jashtë lokalit. Kur dola, m’u afruan dy persona të veshur civilë, të cilët më kërkuan t’i ndihmoja me një çakmak për të ndezur cigaren. Kur iu afrova dhe ndeza çakmakun, ata më kapën nga duart dhe më thanë t’i shoqëroja sepse donin të bënin disa verifikime. Nuk më vunë pranga, por me një makinë më dërguan në komisariatin e Peshkopisë, ku qëndrova 6 orë dhe ku më treguan pse isha aty e më bënin pyetje të ndryshme në lidhje me veprën. Aty nuk ushtruan dhunë mbi mua, por më bënin presion psikologjik. Më pas, më hipën në një helikopter dhe më dërguan në Tiranë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë. Aty qëndrova për 8 ditë dhe në ato ditë u bë dhe marrja në pyetje. Gjatë seancës së marrjes në pyetje, në dhomë qëndronin 5 persona të veshur civilë, të cilët më detyronin të tregoja e kur unë u përgjigjesha që nuk dija se çfarë kishte ndodhur dhe se unë nuk kisha informacion, më

²³² Neni 25, Kushtetuta e R.Sh.

²³³ Neni 4, Kodi i Procedurës Penale.

²³⁴ Neni 32, Projektligji “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës”.

godisnin me çorape të mbushur me rërë dhe me grushta, kryesisht në duar, por edhe në pjesët e tjera të trupit. Në kushtet ku isha, pasi isha goditur, firmosa mbi procesverbalin, në të cilin shkruante një nga oficerët e veshur civilë, pavarësisht faktit se unë nuk jepja informacion. Kur kam shkuar në Gjykatë për të më caktuar masën e sigurisë, kam dëgjuar për herë të parë se për çarë akuzohesha dhe kuptova se sa gjëra kisha pranuar, për të cilat nuk kam fare dijeni.²³⁵

Rekomandime:

- Të merren masa për parandalimin e incidenteve dhe keqtrajtimit të fëmijëve.
- Të miratohet një strategji parandaluese kundër dhunës institucionale.
- Të ngrihet një sistem efektiv për paraqitjen e ankesave ndaj akteve të dhunës/keqtrajtimit.
- Të rregullohet kuadri ligjor në lidhje me rastet e ndalimit të të miturve kur janë të papajisur me dokument identifikimi dhe kur ka dyshim për moshën e tyre.
- Të parashikohen në ligj si rrethana cilësuese tortura, trajtimi çnjerëzor, kur këto vepra penale kryhen ndaj të miturve.



²³⁵ Rast i raportuar nga QSHPLI/ Klinika Ligjore për të Mitur.





VI. Ambienti familjar dhe përkujdesja alternative (Nenet 5, 9, 10, 11, 18 para. 1 dhe 2, 19, 20, 21, 25, 27 (4))

Neni 5 - Udhëheqja prindërore dhe të drejtat e fëmijës

Legjislacioni shqiptar përcakton qartë termat dhe kufijtë e përgjegjësisë prindërore, ndonëse nuk jep një përkufizim të institutit të familjes. Megjithatë, familja përcaktohet në konceptin e saj të ngushtë nëpërmjet përcaktimeve të lidhjes at/nënë me fëmijët²³⁶ dhe të dokumenteve të gjendjes civile të cilat lëshohen për të vërtetuar gjendjen familjare.²³⁷ Ndërkohë, Kodi i Familjes megjithëse nuk përfshin brezin e paraardhësve të prindërve në konceptin e familjes, ai garanton ruajtjen e marrëdhënieve vetjake të fëmijës me gjyshërit²³⁸ ndërkohë që nuk sanksionohet kjo e drejtë për vëllezërit dhe motrat kur këta jetojnë të ndarë dhe njëri apo disa prej tyre janë bërë madhorë.

Shqipëria, gjithashtu, ka aderuar në Konventën për Juridiksionin, Ligjin e Zbatueshëm, Njohjen, Zbatimin dhe Bashkëpunimin në lidhje me Përgjegjësinë Prindërore dhe Masat për Mbrojtjen e Fëmijëve.²³⁹ Megjithatë, legjislacioni shqiptar nuk parashikon “*programe këshillimiedukative për afësim prindëror*” për të mbështetur prindërit në rastet kur ata shfaqin probleme dhe deficienca në aftësinë e tyre prindërore.

Legjislacioni shqiptar penalizon braktisjen e fëmijëve nën 16 vjeç si dhe marrjen pa të drejtë të fëmijës.²⁴⁰ Këto dispozita bashkëveprojnë me të drejtën e prindërve për kthimin e fëmijës së mitur, kur ai mbahet pa të drejtë nga persona të tretë.²⁴¹ Megjithatë, garantimi i përgjegjësisë prindërore ndaj personave që ndërhyjnë dhe marrin pa të drejtë fëmijën, nuk garantohet në mënyre efçente pasi Kodi Penal i parashikon këto akte si kundravajtje penale dhe policia e prokuroria nuk mund të bëjnë ndalimin e personit i cili mban pa të drejtë fëmijën. Në praktikë, lënia e fëmijëve paraqitet ende problematike për shkak të mungesës së programeve speciale për familjet në vështirësi ekonomike apo me probleme sociale për të parandaluar këtë fenomen.²⁴²

²³⁶ Neni 165-174, Kodi i Familjes.

²³⁷ Neni 19/1, Ligji “Për Gjendjen Civile” Nr.8950, Datë 10.10.2002.

²³⁸ Neni 219, Kodi i familjes

²³⁹ Ratifikuar me Ligjin Nr. 9443 Datë 16.11.2005.

²⁴⁰ Neni 124, neni 127, Kodi Penal.

²⁴¹ Neni 218, Kodi i Familjes.

²⁴² VKM nr. 80 datë 28.01.2008 “Strategjia sektoriale e mbrojtjes sociale dhe plani i saj i veprimi” në kapitullin e deinstitutionalizimit dhe reformimit të shërbimeve shoqërore ka listuar përparësitë e MPÇSSHB për këto kategori familjesh. Por mungojnë hapa konkrete të pasuara nga rregullime ligjore për parandalimin e këtij fenomeni.

Aleanca për Fëmijët, do të tërheqë vëmendjen e Komitetit se mungesa e këtyre programeve shton mundësinë e braktisjes së fëmijëve nga prindërit, shkeljen e detyrime që shteti ka garantuar në Kushtetutë dhe në Kodin e Familjes për mbështetjen e familjes. Parashikimi i këtyre programeve do të ndikonte në promovimin e një stili të shëndetshëm prindërimi dhe në vazhdimësinë e ekzistencës së përgjegjësisë prindërore. Për më tepër, këto kurse formimi do të ndihmonin për të minimizuar ekspozimin e fëmijëve ndaj rreziqeve dhe mundësive për të qenë subjekt dhune në familje. Në Shqipëri evidentohet një rritje drastike e krimit në familje dhe e raportimit të tij. Bazuar në Analizën Vjetore të Departamentit të Hetimit të Krimit në Ministrinë e Brendshme për vitin 2008 janë evidentuar 822 kallëzime për krime në familje dhe kërkesa për urdhra mbrojtje nga të cilat 22 raste janë me pasojë vdekjen, ndër të cilët 1 fëmijë. Gjithashtu janë evidentuar për vitin 2008, 59 rast vetëvrasjesh për shkak të dhunës në familje nga të cilët 18 raste janë fëmijë. Policia ka ndjekur procedurën për kërkimin e urdhrit të mbrojtjes në gjykatë për 377 raste. Nga të gjitha rastet e mësipërme, 77 prej tyre kanë qenë vetë të miturit të cilët kanë bërë kallëzimin apo kanë kërkuar mbrojtje. Duhet theksuar se pas daljes së Ligjit, “Për mbrojtje nga dhuna në familje” është ngritur ndjeshëm raportimi i rasteve në polici çka tregohet edhe po të krahasojmë faktin se në vitin 2007 ishin raportuar vetëm 270 raste. Megjithatë, vazhdon të mbetet sfida realizimi i garantimit të mekanizmave eficientë për të garantuar mbrojtjen emergjente nëpërmjet strehimit në qendra pritëse.²⁴³

Nga ana tjetër, shteti duhet të marrë masat e duhura për të garantuar mbështetjen e prindërve në ushtrimin e përgjegjësisë prindërore kur ata cenohen nga personat të tjerë, të cilët marrin në mënyrë të padrejtë fëmijët. Sipas legjislacionit aktual prindërit duhet ta rifitojnë këtë të drejtë me një vendim gjyqësor dhe proceset janë të tejzgjuata, ndërkohë që marrëdhënia prind-fëmijë është regresuar.

Aleanca e Fëmijëve është e shqetësuar për numrin e madh të braktisjeve të fëmijëve dhe vendosjes së tyre në institucione pa afat të përcaktuar kur ata kanë ende prindërit gjallë. Ky është një tregues që shteti nuk ka marrë masa për mbështetjen e familjes dhe ka kontribuar, në këtë mënyrë, në institucionalizimin e fëmijëve.

Rekomandim:

- Përfshirja në Kodin e Familjes së masës për ndjekjen e programeve të këshillimit për prindërit/kujdestarët.
- Hartimi i politikave për sigurimin e programeve të këshillimit dhe aftësimit prindëror nga strukturat e pushtetit qendror dhe pajisja me kapacitet e duhura të pushtetit vendor dhe të strukturave shëndetësore për zbatimin e tyre.
- Amendimi i Kodit Penal në lidhje me rregullimin e duhur të marrjes së padrejtë të fëmijës.
- Mbështetja financiare dhe sociale e familjeve për të mos braktisur fëmijët në institucione, për të reduktuar fenomenin e “jetimëve sociale.”

²⁴³ Aneks II, Informacion nga strukturat kryesore publike dhe jo-publike të përfshira në garantimin e të drejtave të fëmijëve (janar-shkurt 2009), sipas protokollit informativ nga Komisariatet e Policisë.

- Amendimi i Kodit të Familjes për njohjen e të drejtës për marrëdhëniet vetjake mes vëllezërve dhe motrave në zbatim të konceptit të “familjes.”

Neni 9 - Ndarja e fëmijëve nga prindërit.

Legjislacioni shqiptar garanton të drejtën e fëmijës për të mos u ndarë nga prindërit kundër dëshirës së tyre, përveçse në ato raste kur është e nevojshme mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës si në rastet e braktisjes, kryerjes së veprës penale apo qenia bashkëpunëtorë në një veprë penale ndaj fëmijës apo shpërdorimit të përgjegjësisë prindërore.²⁴⁴ Kodi i Familjes garanton që fëmija të dëgjohet në çdo procedurë²⁴⁵ që ka lidhje me të përfshirë këtu edhe zgjidhjen e martesës së prindërve, heqjes së përgjegjësisë prindërore duke iu dhënë një vend i rëndësishëm konsiderimit të mendimit të tij në lidhje me cilin prind dhe ku ai dëshiron të banojë. Për fëmijët e moshës mbi 10 vjeç marrja e mendimit është e detyruar. Po kështu, për ndryshimin e vendbanimit garantohej marrja e mendimit të detyrueshëm të fëmijës mbi 14 vjeç²⁴⁶.

Kodi i Familjes²⁴⁷ ka parashikuar mbajtjen e raporteve vetjake midis prindërve dhe fëmijëve edhe pas zgjidhjes së martesës.²⁴⁸ Kjo e drejtë i privohet prindit të cilit i është hequr përgjegjësia prindërore me vendim gjykatë.²⁴⁹ Ligji nuk parashikon mekanizma ligjore dhe sociale si psh. “dhënien e një plani prindërimi” nga gjyqtari dhe përfshirjen e tij në vendimin gjyqësor për zgjidhjen e martesës. Për më tepër, mungojnë në praktikë strukturat e posaçme për të lehtësuar marrëdhëniet konfliktuale post-divorc të prindërve, të cilat ndikojnë negativisht drejtpërsëdrejti te fëmijët. Këtë rol deri më tani e kanë kryer Zyrat e Përmbartimit në rang vendi, të cilat nuk kanë as misionin dhe as kapacitet e nevojshme për ta kryer siç duhet këtë detyrë, në rastet kur prindërit nuk zbatojnë detyrimet e vendimeve gjyqësore në lidhje me fëmijët. Po kështu, zyra e përmbartimit raporton si problem ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në lidhje me të drejtën e vizitës dhe detyrimit për ushqim i cili nuk paguhet në rastet kur prindërit ndodhen jashtë shtetit.

Legjislacioni shqiptar duhet të përmirësohet për të garantuar vazhdimësinë e marrëdhënieve vetjake në rastet e prindërve të akuzuar/dënuar, të cilët kanë fëmijë të mitur dhe e të miturve të akuzuar/dënuar të cilët mbahen të izoluar. Legjislacioni parashikon mbajtjen e fëmijëve deri 3 vjeç pranë çerdhës së burgut kur këta kanë lindur në burg dhe hartimin e programit të posaçëm dhe favorizues për lidhjet me familjen për gratë

²⁴⁴ Neni 228, Kodi i Familjes.

²⁴⁵ Neni 6, Kodi i Familjes.

²⁴⁶ Neni 55, 155, 228 Kodi i Familjes.

²⁴⁷ Neni 215, Kodi i Familjes.

²⁴⁸ Neni 158, Kodit i Familjes.

²⁴⁹ Neni 228, Kodit Familjes.

dhe të dënuarit e mitur.²⁵⁰ Legjislacioni është i mangët pasi e shtrin rregullimin e mësipërm vetëm për të dënuarit, pra, jo për kohën e paraburgimit si dhe bën diferencimin e lidhjes nënë-fëmijë duke diskriminuar marrëdhënien at-fëmijë. Gjithashtu, legjislacioni penal shqiptar duhet të parashikojë më shumë dhe në mënyrë më ekskluzive dënimet alternative, sidomos për nënat me fëmijë të mitur për të siguruar jetesën e përbashkët të fëmijës me prindërit tij, por pa ndëshkuar fëmijën duke e mbajtur edhe në burg.

Së fundmi, është ndërmarrë një nismë ligjore pozitive në këtë drejtim, duke hartuar një ligj specifik për të drejtat e fëmijëve, i cili është ende në fazën e projektligjit dhe pritet të miratohet së shpejti. Ky projekt ligj rikonfirmon dhe një herë të drejtën e fëmijëve për mos u ndarë nga prindërit kundër dëshirës së tyre të parashikuar në nenin 9 të KDE.

Aleanca e Fëmijëve konstaton ende problematike mungesën e “planeve të prindëritmit” si pjesë e vendimeve gjyqësore të dhëna nga Gjykata në rastet e zgjidhjes së martesës, dhe mungesën e strukturave të posaçme për zgjidhjen/ndërmjetësimin e konflikteve të krijuara pas zgjidhjes së martesës, si dhe mungesën e koordinimit të shërbimeve sociale. Mungesa e planeve të tilla ka një ndikim të drejtpërdrejtë negativ tek fëmijët dhe nuk i shërben interesit më të lartë të tij. Nga ana tjetër, Aleanca është e shqetësuar për numrin e madh të rasteve të mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore, përfshirë edhe rastet kur prindi debitor ndodhet jashtë Shqipërisë, nga Zyrat Përmbarimore ku një nga shkaqet që ndikon në këtë aspekt është mungesa e infrastrukturës në dispozicion të këtij institucioni. Në këtë mënyrë, shteti shqiptar duhet ti kushtojë një vëmendje të veçantë parashikimeve buxhetore në këtë aspekt. Gjithashtu, vazhdon të mbetet ende problematike konsolidimi i marrëdhënieve vetjake midis prindërve të akuzuar/dënuar me fëmijët e tyre dhe, nga ana tjetër, të miturve të akuzuar me prindërit e tyre.

Kuadri ligjor krijon situata diskriminuuese në lidhje me rastet e marrëdhënieve atë-fëmijë, në parashikimin e programeve të posaçme gjatë vuajtjes së dënimit, gjithashtu, mosrregullimin e këtyre marrëdhënieve edhe gjatë periudhës së paraburgimit.

Referuar praktikës, Aleanca kërkon të tërheqë vëmendjen për fenomenin negativ të zbatimit të së drejtës zakonore “Kanuni i veriut në pjesën veriore të Shqipërisë” në pjesën veriore të vendit, në bazë të të cilit, nënave nuk u lejohet mbajtja e kontaktit me fëmijët e tyre kur për arsye të vdekjes apo të zgjidhjes së martesës me bashkëshortin ato jetojnë vetëm ose pranë familjes së tyre të origjinës. Ato nuk lihen të mbajnë e as të kenë marrëdhënie me fëmijët e tyre për shkak të zbatimit të parimit kanunor “fëmija ndjek rrugën e gjakut dhe jo atë të tamblit” siç të tregohet në rastin më poshtë.²⁵¹ Në lidhje me këtë fenomen do të rekomandonim që shteti të ndërmarre masa (psh fushata publike edukuese) me qëllim sensibilizimin dhe luftimin e këtyre praktikave të cilat ndajnë në mënyrë të panevojshme fëmijët nga nënat e tyre.

²⁵⁰ Neni 40, Ligji Nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e personave të dënuar me burgim”

²⁵¹ Rast i raportuar nga QSHPLI/ Klinika Ligjore për të Mitur

Çështja e Anila Haklaj

Nusja e ish-kapos së Tropojë, Fatmir Haklaj ka sfiduar për herë të dytë të afërmit e bashkëshortit të saj, të cilët kanë fituar statusin e azilantëve politikë në Suedi. Disa ditë më parë, Anila (Demiri) Haklaj depozitoi një tjetër padi në Gjykatën e Shkallës së Parë të Tiranës.²⁵² Nëpërmjet një kërkesë-padie civile, ajo i kërkoi drejtësisë shqiptare që ta detyrojë babain e bashkëshortit të saj të ndër të rikthejë vajzën e mitur, Fatmirën, që aktualisht ndodhet në Suedi. Anila Haklaj, pasi kishte humbur bashkëshortin, Fatmirin, solli në jetë një vajzë, Fatmirën. Por, nuk do të vononte shumë dhe vajza e vogël do të mbetej dhe pa nënën, Anilën, e cila shkoi të jetonte me familjen e saj. Anila (Demiraj) Haklaj humbi kontaktet me të bijën, pasi familja Haklaj u largua nga Shqipëria në Suedi, gjë për të cilën e ëma, Anila, nuk ishte pyetur fare. E terrorizuar nga humbja e vajzës, Anila paditi në gjykatë prindërit e ish bashkëshortit. Kjo dosje është në gjykim e sipër. Ajo ka tentuar disa herë ta zgjidhë këtë problem me familjen e burrit të ndër, por, me sa duket, nuk ia ka dalë dot, ndaj ka vendosur t'i drejtohet gjykatës. Drejtësia shqiptare u kërkon autoriteteve suedeze informacion mbi statusin që gëzon Fatmira Haklaj, vajza e Fatmir Haklajt, një prej njerëzve më të shumëpërfolur në Tropojë, i cili u ekzekutua gjatë një prite të organizuar dhjetë vjet më parë. Vetëm pasi të ketë në dorë të gjithë informacionin e detajuar mbi statusin e fëmijës, atëherë Gjykata e Tiranës do të dalë me një vendim lidhur me padinë që ka bërë nëna e vajzës, Anila Haklaj

Në një shkrim në gazetën Panorama thuhet se nëse njoftimet nuk arrijnë të firmosen prej tyre, dhe kthehen në Tiranë atëherë procesi do të zhvillohet në mungesë të palës së paditur. Por në këtë rast, edhe nëse gjykata urdhëron që vajza të kthehet për të jetuar me nënën, sërish vendimi mbetet i pa ekzekutuar, pasi fëmija jeton në një vend tjetër dhe ende shteti shqiptar nuk disponon një adresë ku t'i kontaktojë këta.²⁵³



²⁵² Gazeta shqiptare, 31/01/09 nga Trëndafille Visha

²⁵³ Gazeta Panorama 20/0909 nga Fatos Mahmutaj

Rekomandime:

- Përfshirja e “planeve të prindërimit” në legjislacion si detyrim për t’u zbatuar nga gjyqtarët për të mbajtur të qëndrueshme marrëdhëniet prind-fëmijë dhe bashkëpunim institucional për të forcuar rolin e prindërve.
- Ngritja e strukturave përgjegjëse pranë pushtetit vendor për zbatimin dhe monitorimin e “planeve të prindërimit” dhe ndërmjetësimin e konflikteve pas zgjidhjes së martesës.
- Shteti Shqiptar duhet të marrë masa për zbatimin e vendimeve gjyqësore të detyrimit për ushqim dhe mbajtjen e kontakteve prind-fëmijë pas zgjidhjes së martesës.
- Kuadri ligjor, duhet të parashikojë dënime alternative për nënat me fëmijë të mitur për të siguruar jetesën e përbashkët të fëmijës me prindin e tij.
- Kuadri ligjor duhet të përmirësohet në funksion të ruajtjes së marrëdhënieve prind-fëmijë edhe gjatë kohës së paraburgimit.
- Kuadri ligjor duhet të parashikojë marrjen e masave të posaçme për ruajtjen edhe të marrëdhënieve atë-fëmijë gjatë kohës së vuajtjes së dënimit.
- Ndërmarrja e fushatave ndërgjegjësuere për të luftuar stereotipet kanunore të ndarjes së fëmijëve nga nëna e tyre.

Neni 10 - Hyrja ose largimi nga një shtet palë për arsye të ribashkimi familjar

Kuadri ligjor Shqiptar paraqitet i favorshëm për shtetasit e huaj që jetojnë në RSh lidhur me procedurat për bashkimin familjar. Në këtë kuadër, Shteti Shqiptar ka ratifikuar “Konventën për mbrojtjen e të gjithë punëtorëve emigrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre.”²⁵⁴

Ligji “Për integrimin dhe bashkimin familjar të personave që kanë fituar azil në RSH”²⁵⁵ përcakton, ndër të tjera,²⁵⁶ procedurat për bashkimin familjar të personave që kanë përfituar azil në RSh. Sipas këtij ligji, në rastin kur aplikimi për bashkim familjar ka lidhje me një të mitur, te pashoqëruar, vendimi merret jo më vonë se 20 ditë nga data e paraqitjes së aplikimit,²⁵⁷ në raste kompleksiteti të çështjes jo më vonë se 60 ditë nga paraqitja e aplikimit, duke u drejtuar nga interesi më i lartë i fëmijës. Ndërsa në lidhje me procedurat e apelimit, Komisioni Kombëtar për Refugjatët shqyrton kërkesën dhe vendos jo më vonë se 30 ditë nga data e

²⁵⁴ Ratifikuar me Ligjin Nr 9703, Datë 02.04.2007.

²⁵⁵ Ligji Për integrimin dhe bashkimin familjar të personave që kanë përfituar azil, Nr. 9098, Datë 3.07. 2003.

²⁵⁶ Ky ligj garanton edhe një sërë të drejtash të tjera për të miturin azilkërkues si e drejta për arsimimin, punësimin, kujdesin shëndetësor dhe shoqëror, strehimin.

²⁵⁷ Neni 32/2 Ligji Për integrimin dhe bashkimin familjar të personave që kanë përfituar azil, Nr. 9098, Datë 3.07. 2003.

depozitimit të kërkesës.

Në lidhje me shtetasit shqiptarë që janë rezident në një shtet anëtar të BE, prej 1 janarit 2008 ka hyrë në fuqi “Marrëveshja e lehtësimit të vizave” për qytetarët shqiptarë, përfshirë edhe kategorinë e të miturve, ndërkohë që për fëmijët nën 6 vjeç në bazë të kësaj marrëveshjeje aplikohet viza falas.

Legjislacioni vendas parashikon garanci në lidhje me procedurat e birësimit të fëmijëve refugjatë, i cili në çdo rast duhet të kryhet në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës. Birësimi i fëmijës refugjat bëhet pasi kanë kaluar dy vjet nga marrja e azilit dhe janë marrë të gjitha masat për gjetjen e familjes së tij.²⁵⁸

Aleanca e Fëmijëve kërkon të tërheqë vëmendjen për situatën e shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë Shqipërisë në kuadër të ribashkimit familjar dhe në kuadër të ruajtjes së marrëdhënieve midis fëmijëve dhe prindërve, të cilët kanë emigruar në një shtet tjetër, procedura të cilat zgjasin në kohë dhe nuk kanë posaçërisht në vëmendje krijimin e situatave lehtësuese për fëmijët me qëllim mbajtjen e marrëdhënieve prind-fëmijë. Në këtë kuadër, shteti shqiptar duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për zbatimin efektiv të legjislacionit mbi emigracionin, duke miratuar akte nënligjore, të cilat do të lehtësojnë dhe bëjnë efektive procedurat e bashkimit familjar për shtetasit shqiptarë.

Neni 11 - Zhvendosjet e paligjshme dhe mos-rikthimet e fëmijëve në vend të huaj

Shteti Shqiptar ka ratifikuar “Konventën e Hagës për Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve”²⁵⁹. Ndërkohë problematike mbetet harmonizimi i kuadrit ligjor shqiptar me dispozitat e konventës në aspektin e ngritjes një autoriteti kompetent në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga nenet 6 dhe 7 të kësaj konvente. Në kuadër të mbrojtjes së fëmijëve në situata të tilla, Shteti Shqiptar ka ratifikuar “Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të RSh dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë për Mbrojtjen dhe Asistencën e Fëmijëve Viktima të Trafikimit.”²⁶⁰ Ndërkohë që shteti shqiptar duhet të ndërmarrë iniciativa të tjera bashkëpunuese me shtete të tjera anëtare të KDF, e veçanërisht me vendet fqinje, në kuadër të bashkëpunimit për shkëmbimin e informacionit dhe kthimit të shpejtë të fëmijëve.

Problematike paraqitet dispozita e Kodit Penal që klasifikon “marrjen pa të drejtë të fëmijës.”²⁶¹ Kjo dispozitë klasifikon si kundravajtje penale rastet e marrjes pa të drejtë të fëmijës si nga njëri prind ashtu edhe nga persona të tretë. Në këtë kuadër, Kodi penal duhet të amendojë dispozitën në fjalë duke parashikuar si rrethanë rënduese marrjen pa të drejtë të fëmijës nga persona të tretë dhe cilësimin e saj si vepër penale. Gjithashtu, cilësimin e kësaj figure penale kur fëmija është marrë pa të drejtë nga prindi tjetër, apo në rast mosekzekutimi të vendimeve gjyqësore. Në këtë kontekst, Kodi i Familjes duhet të harmonizohet me standardet që vendos

²⁵⁸ Neni 17, Ligji Nr. 9695, Datë 19.03.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetit Shqiptar të Birësimit”.

²⁵⁹ Ligji Nr. 9446, Datë 24.11.2005.

²⁶⁰ Ligji nr. 9544 Datë 29.05.2006.

²⁶¹ Neni 127, Kodit Penal.


Konventa e Hagës (neni 12) për kthimin e menjëhershëm të fëmijës në rastet kur fëmija është larguar apo mbahet padrejtësisht dhe kur në datën e fillimit të procedimit para autoritetit gjyqësor apo administrativ të Shtetit Kontraktues ku është fëmija ka kaluar më pak se një vit nga data e largimit apo mbajtjes së padrejtë të tij. Kuadri ligjor në aspektin e kontrollit të kufijve është përmirësuar kryesisht në hartimin e një ligji të ri, “Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror”²⁶² i cili përcakton si subjekt të veçantë edhe kontrollin e të miturve gjatë kalimit të kufirit të cilët udhëtojnë të shoqëruar apo të pashoqëruar. Pavarësisht garancive që mbart ky ligj, lind si domosdoshmëri plotësimi me akte nënligjore²⁶³ funksionale për rritjen e kontrollit të kufirit të shtetit shqiptar dhe parandalimit të rasteve të zhvendosjes apo rrëmbimit të fëmijëve, duke parashikuar masa të posaçme si konfiskimi i pasaportës. Kuadri ligjor shqiptar nuk parashikon ofrimin e asistencës financiare për fëmijët, apo për prindërit e tyre, për përmbushjen e garancive që parashikon ky nen në funksion të kthimit të shpejtë të fëmijës.

Aleanca e Fëmijëve e konsideron shumë të rëndësishme ngritjen e autoritetit shtetëror me qëllim harmonizimin dhe vënien në zbatim të objektivave të Konventës së Hagës (neni 6 i konventës). Nga ana tjetër, Shteti Shqiptar duhet të ndërmarrë masa për të nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me shtetet palë të KDF me qëllim bashkëpunimin për shkëmbimin e informacionit, lehtësimin e procedurave administrative dhe gjyqësore me qëllim kthimin e shpejtë të fëmijëve. Problematike paraqitet përputhja e kuadrit ligjor shqiptar në lidhje me standardet që parashikohen në “Konventën e Hagës për Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve,” e në mënyrë të veçantë Kodit të Familjes për sa i përket parashikimit të afatit 1 vjeçar për kthimin e menjëhershëm të fëmijës. Ndërkohë që problematikë serioze përbën qenia ende në fuqi e dispozitës së Kodit Penal, “marrja pa të drejtë e fëmijës”, ç’ka do të kërkonte cilësim me rrethana rënduese kur fëmija mbahet pa të drejtë nga persona të tretë dhe cilësimi i kësaj figure kur është kryer nga prindi tjetër. Në lidhje me praktikën gjyqësore vazhdon të mbetet problematike mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore për ushtrimin e përgjegjësisë prindërore²⁶⁴ për shkak të mungesës të mjeteve eficiente ligjore dhe teknike për ekzekutimin e këtyre vendimeve. Aleanca, gjithashtu, e konsideron shumë të rëndësishme nxjerrjen e akteve nënligjore për vënien në zbatim të ligjit, “Për Kontrollin dhe mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror” me qëllim parashikimin e masave të posaçme parandaluese të fenomenit të largimit apo mbajtjes pa të drejtë të fëmijës. Gjithashtu Aleanca, e konsideron shqetësues faktin që legjislacioni shqiptar ende nuk ka parashikuar ofrimin e ndihmës financiare për fëmijët apo prindërit për realizimin e të drejtave që burojnë nga ky nen.

²⁶² Neni 36, Ligji Nr. 9861, Datë 24.1.2008.

²⁶³ Sipas “Planit të integruar të Ministrisë të Brendshme 2008” (faqe 21) janë në proces aktet nënligjore, në zbatim të këtij ligji.

²⁶⁴ Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara “Legjislacioni Shqiptar dhe Konventa e të drejtave të Fëmijëve” 2007, f 187.



Rekomandime:

- Ngritja e autoritetit qendror për zbatimin e objektivave që burojnë nga “Konventa e Hagës për Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve.”
- Harmonizimi i Kodit të Familjes dhe Kodit Penal me Konventën e Hagës për Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve.”
- Të miratohen aktet nënligjore për zbatimin e ligjit “Për Kontrollin dhe mbikqyrjen e Kufirit Shtetëror.”
- Amendimi i Kodit penal në dispozitën që parashikon “Marrjen pa të drejtë e fëmijës.”
- Parashikimi i dispozitave ligjore për ofrimin e ndihmës financiare për fëmijët dhe prindërit të përfshirë në situata të tilla.
- Ngritja e strukturave pritëse për fëmijët e riatdhesuar të cilët nuk kanë mbështetje prindërore apo janë ndarë nga familja në momentin kur janë riatdhesuar.

Neni 18 - Përgjegjësia e përbashkët e prindërve

Kuadri ligjor parashikon ushtrimin e përgjegjësisë prindërore nga të dy prindërit dhe në funksion të interesit më të lartë të fëmijës, si për ata të lindur nga martesë edhe ata jashtë martese.²⁶⁵ Parlamenti Shqiptar ka ratifikuar Konventën, “Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve.”²⁶⁶

Shteti ka krijuar mekanizma për të mbështetur familjet në përmbushjen e detyrimeve të tyre prindërore dhe për të siguruar mbajtjen dhe mirërritjen e fëmijëve pranë familjes duke ndihmuar financiarisht familjet me të ardhura të pamjaftueshme jetese dhe me shumë fëmijë,²⁶⁷ megjithatë kjo mbështetje mbetet ende në kuadër të ndihmës vetëm financiare e pandërthurur kjo me shërbime sociale.²⁶⁸ Ndërkohë, ndihma që ofrohet për familjet nuk bazohet në vlerësimin e nevojave individuale të familjes dhe fëmijëve.

Gjithashtu, Qeveria Shqiptare së fundmi, nëpërmjet dokumenteve strategjike,²⁶⁹ ka parashikuar masa për veprim me qëllim ndihmesën dhe reduktimin e varfërisë për familjet në nevojë dhe grupet e marginalizuara,

²⁶⁵ Neni 2, 4, 215, Kodi i Familjes.

²⁶⁶ Ligji Nr. 9443 Datë 16.11.2005 “Për ratifikimin e Konventës për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve”

²⁶⁷ Ligji Nr. 9355, Datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” dhe VKM Nr. 565, Datë 9.8.2006 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, nga rritja e çmimit të energjisë elektrike”.

²⁶⁸ Kjo e lidhur kryesisht me familjet të cilat kanë migruar pas viteve ’90 nga zonat rurale drejt zonave urbane (qytet të mëdha) VKM Nr. 787, Datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të masës të ndihmës ekonomike”, i ndryshuar.

²⁶⁹ VKM Nr. 80, Datë 28.01.2008 “Strategjia sektoriale e mbrojtjes sociale”.

por ende këto masa nuk janë formalizuar me nxjerrjen e akteve nënligjore për vënien në zbatim të tyre, ku një vëmendje e veçantë duhet ti kushtohet rritjes të nivelit të masës financiare për familjet në nevojë,²⁷⁰ me qëllim reduktimin e fenomenit të lënies së fëmijëve në institucione rezidenciale për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike, pra mospërmbushjes dot nga ana e prindërve të nevojave të fëmijëve. Kështu, vendosja e një fëmije në institucion i kushton shtetit afërsisht 25.000 lek/muaj. Ndërkohë që masa mujore e ndihmës ekonomike fillon nga 2600 lek dhe shkon deri në 7000 lek për familje me më shumë se 7 fëmijë. Shteti për familjet në rrezik të lënies së fëmijëve në institucione mund dhe duhet të parashikojë një shumë më të madhe të hollash dhe programe të cilat mundësojnë punësimin e prindërve. Nga ana tjetër, ende problematike mbetet mosparashikimi i masave për ngritjen e “programeve edukative” apo “këshillime me prindërit” për ushtrimin e përgjegjësisë së prindërve dhe në mënyrë të veçantë ndaj familjeve në nevojë, prindërve me aftësi të kufizuar apo prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuar, të cilat duhet ti paraprijnë rasteve të heqjes së përgjegjësisë prindërore.

Kuadri ligjor, gjithashtu, parashikon mbrojtje të veçantë për gratë gjatë shtatëzanisë dhe të drejtën e tyre për të përfituar leje lindjeje,²⁷¹ ku të njëjtat të drejta në përfitime gëzon edhe nëna e cila birëson fëmijë,²⁷² si dhe garanton mundësinë e nënave për t’u kujdesur për fëmijët e tyre gjatë kohës kur janë në marrëdhënie pune.²⁷³ Ndërkohë që kuadri ligjor ende diskriminon baballarët në lidhje me disa mekanizma mbështetës, të cilat i garantohen vetëm nënës, si psh. në rastet e lindjes së fëmijës, ku ligji parashikon të drejtën e pushimit të paguar deri në 3 ditë duke mos e specifikuar atë si “leje lindjeje”²⁷⁴ dhe nuk parashikon asnjë mundësi për baballarët për të përfituar këtë leje nëse nëna nuk mundet apo nuk dëshiron të kujdeset ajo për fëmijën gjatë kësaj periudhe të fëmijërisë së hershme.

Së fundmi, është ndërmarrë një nismë ligjore pozitive në këtë drejtim, duke hartuar një ligj specifik për të drejtat e fëmijës, i cili është ende në fazën e projektligjit dhe pritet të miratohet së shpejti. Ky projekt ligj rikonfirmon dhe një herë të drejtën e përgjegjësisë së përbashkët të prindërve, të parashikuar në nenin 18 të KDF²⁷⁵.

Aleanca, në kuadër të zbatimit të detyrimeve të këtij neni, përgëzon qeverinë shqiptare për hartimin së fundmi të “Strategjisë sektoriale të mbrojtjes sociale,” por nga ana tjetër kërkon të tërheqë vëmendjen për marrjen sa më shpejt të masave për të vënë në zbatim në mënyrë efektive detyrimet që burojnë nga ky dokument. Një vëmendje të veçantë duhet t’i kushtohet programeve të mbrojtjes sociale dhe mbështetjes financiare në funksion të maksimalizimit e

²⁷⁰ Aktualisht masa mujore e ndihmës ekonomike fillon nga 2600 lek dhe shkon deri në 7000 lek për familje me më shumë se 7 fëmijë.

²⁷¹ Neni 105, Kodi i Punës parashikon si periudhë përfitimi 365 ditë kalendarike dhe 390 për nënat që lindin më shumë se një fëmijë.

²⁷² Neni 27, Ligji Nr. 7703, Datë 11.05.1993 “Për Sigurimet shoqërore”, i ndryshuar.

²⁷³ Neni 96, Kodi i Punës dhe pika 10 VKM Nr. 511, Datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore” “...5 ditëve pushim të paguara dhe deri në 30 ditë pushim të papaguara gjatë një viti”.

²⁷⁴ Pika 9/c VKM Nr. 511, Datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”.

²⁷⁵ Neni 18, Projektligji “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës”.

mundësisë për rritjen e fëmijëve pranë familjeve të tyre, nëpërmjet mbështetjes së përshtatshme të familjes në funksion të reduktimit të fenomenit të “jetimëve sociale”. Për më tepër, mospërfshirja në programet e mbrojtjes sociale duke ndërthurur ndihmën ekonomike me shërbimet sociale të nevojshme për fuqizimin e familjes mbetet ende një nga drejtimitet e pa-adresuara siç duhet nga legjislatori shqiptar. Gjithashtu, Aleanca konstaton si problematike mos marrjen ende të masave për ofrimin e programeve edukative apo këshilluese për ushtrimin e përgjegjësisë prindërore ndaj prindërve, por në mënyrë të veçantë ndaj prindërve të familjeve në nevojë.

Aleanca kërkon gjithashtu, të tërheqë vëmendjen për marrjen e masave administrative dhe ligjore për heqjen e barrierave diskriminuese për baballarët në aspektin e mekanizmave mbështetës që ligji ka krijuar duke iu referuar vetëm nënës.

Rekomandime:

- Marrja e masave administrative dhe ligjore për fuqizimin e përgjegjësisë prindërore, dhe në mënyrë të veçantë për familjet në nevojë.
- Shteti shqiptar duhet të marrë të gjitha masat për rritjen e pagesës së mbështetjes financiare për familjet në nevojë dhe kombinimin e saj me shërbime sociale të përshtatshme për fuqizimin e familjes.
- Shteti Shqiptar duhet të ndërmarrë masa administrative dhe ligjore për përfshirjen e të gjitha familjeve në nevojë në programet e mbrojtjes sociale duke lejuar në rastin e familjeve me fëmijë të mitur vlerësime individuale të nevojave të tyre dhe hartimin e një plani individual për familjen.
- Të merren masa për ngritjen e strukturave me qëllim ofrimin e “programeve edukative” apo “këshillimeve prindërore” për ushtrimin e përgjegjësisë prindërore.
- Duhet të merren masa për fuqizimin dhe rritjen e përgjegjësisë prindërore nga baballarët.

Neni 19 - E drejta për t’u mbrojtur nga çdo lloj dhune.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë,²⁷⁶ megjithëse ka parashikuar mbrojtjen e çdo fëmijë nga dhuna dhe keqtrajtimi, për sa i përket shfrytëzimit, këtë fenomen legjislatori shqiptar e ka lidhur kryesisht me qëllimin për punë. Në kushtetutë nuk përmendet mbrojtja nga abuzimi dhe neglizhimi.

Legjislacioni penal parashikon një sërë veprash penale me subjekt të mitur me qëllim mbrojtjen e tyre

²⁷⁶ Neni 54 në Kreun IV “Liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore”. Kushtetuta e RSh.

nga dhuna, abuzimi, keqtrajtimi dhe neglizhimi, megjithatë, ai shfaq mangësi të theksuara në garantimin e një mbrojtjeje të përshtatshme dhe, shpeshherë, veprat penale janë dukshëm të hartuara duke pasur parasysh subjektin e rritur si viktimë dhe jo fëmijën. Në paragrafin 2 të nenit 90 të KP, parashikohet si njësi matëse për rrezikshmërinë e veprës “dëmtime të tjera me dashje”, aftësia për punë ndërkohë që fëmijët nuk janë subjekte punësimi deri 16 vjeç dhe në çdo rast pasoja dhe graviteti i dhunës te ata duhet të shihet në aspektin e dëmtimit psikologjik, fizik dhe emocional. Formulimi i dispozitës është i orientuar drejt dhunës fizike dhe pavarësisht se brenda termit “.. çdo vepër tjetër dhune”, përfshihet edhe dhuna psikologjike, mungon miratimi i dhunës psikologjike.

Gjithashtu, kryerja e kësaj vepre penale në kushtet e familjes nuk parashikohet si rrethanë më vete dhe nuk është rrethanë cilësuese kur kryhet ndaj të miturit, megjithatë KP e parashikon atë si rrethanë rënduese.²⁷⁷

KP në disa dispozita të tjera²⁷⁸ parashikon si vepra penale, plagosjen e rëndë dhe të lehtë me dashje dhe nga pakujdesia. Qenia e të miturit viktimë e kësaj vepre nuk përbën rrethanë cilësuese dhe nuk klasifikohet më vete në rastet kur ajo ndodh brenda familjes, ç’ka përbën një shkelje më të rënde dhe më të rrezikshme.

Dispozitat garantojnë mbrojtjen e integritet fizik dhe jo atë psikik e emocional. Ato mund të aplikohen me shumë vështirësi për të mbrojtur subjektin e mitur, ndaj të cilit është ushtruar dhunë.

Dënimi për këto vepra penale nuk përfshin dënime plotësuese si ndjekja e programeve për aftësimin prindëror, pagimin e shpenzimeve për kurimin apo trajtimin psikologjik të viktimës.

Parashikimi i përgjithshëm për kompensimin e dëmit me një padi civile, është pothuajse i pamundur për t’u realizuar nga fëmija viktimë. Fëmijës nuk i sigurohet në këtë aspekt ndihma ligjore dhe mbështetja e strukturave ligjore për të realizuar kompensimin.

Kodi Penal parashikon si vepër penale “kryerjen e veprave të turpshme me të mitur që nuk kanë arritur moshën 14 vjeç,”²⁷⁹ megjithatë kjo nuk garanton tërësisht mbrojtjen nga abuzimi seksual, i cili nuk dënohet vetëm se është i turpshëm, moralisht i dënueshëm, por mbi të gjitha sepse ka pasoja për jetën dhe shëndetin e fëmijës.

Marrëdhëniet seksuale me të mitura mbi 14 vjeç penalizohen vetëm nëse ato janë kryer me dhunë.²⁸⁰ Akte të tjera të abuzimit seksual si molestimi i fëmijëve, përdorimi i tyre për kënaqësi seksuale jashtë kontekstit të kryerjes së marrëdhënieve seksuale nuk adresohen në mënyrën e duhur në Kodin Penal. Ekzistenca e “dhunës”²⁸¹ si element shtrëngues, është e domosdoshme për kualifikimin e veprës penale, mungesa e të cilës sjell shuarjen e procedimit penal, kjo për shkak se legjislatori ka lejuar kryerjen e marrëdhënieve seksuale me të mitura mbi 14 vjeç.

²⁷⁷ Neni 50 (a) (e) , Kodi Penal, “kur vepra penale është kryer kundër fëmijëve, grave shtatzëna...”.

²⁷⁸ Në nenet 88, 88a, 88b, 89, 91, 92, Kodi Penal.

²⁷⁹ Neni 108, Kodi Penal.

²⁸⁰ Neni 101, Kodi Penal.

²⁸¹ Neni 101, Kodi Penal.

Mënyra më e përshtatshme, duke pasur parasysh procesin e të provuarit të elementeve të dhunës, i cili është i vështirë, do të ishte mungesa e konsensusit nga ana e fëmijës, pa kërkuar kryerjen e veprimeve të caktuara nga autori i veprës penale.

Kodi Penal parashikon penalizmin e personave, të cilët duke shpërdoruar marrëdhëniet e varësisë apo të detyrës, kryejnë marrëdhënie seksuale dhe homoseksuale.²⁸² Dispozita është shumë e gjerë dhe ka në fokus kryesor mbrojtjen e të punësuarit, apo personave në varësi pune, nga eprorët. Megjithatë me një interpretim të zgjeruar mund të përfshinte edhe mbrojtjen e fëmijëve në institucione, ajo është e nevojshme të riformulohet. Nevojitet të përcaktohet si rrethanë cilësuese kryerja kësaj veprë penale nga personeli apo drejtuesit e qendrave rezidenciale të përkujdesjes apo stafi mësimor i shkollave.

Përgjegjësia e drejtuesve dhe personelit të qendrave duhet të parashikohet jo vetëm në rast kur ata janë personat abuzues por edhe kur ata kanë dijeni dhe lejojnë apo ekspozojnë fëmijët tek fenomeni i abuzimit siç ishte rasti i Qendrës “Fëmijët e Tij” ku një shtetas anglez abuzoi vetë me fëmijët dhe lejoi edhe të rritur të tjerë të abuzonin seksualisht me ta.

Neglizhimi nuk gjen shprehje si i tillë në legjislacionin penal shqiptar, megjithatë, parashikimi si veprë penale i “braktisjes dhe mosdhënies të mjeteve për jetesë fëmijëve”²⁸³ përcakton kufirin minimal për mbrojtjen e fëmijëve nga neglizhimi. Në këtë kuadër, mbrojtja u garantohet vetëm fëmijëve nën 16 vjeç duke e lidhur këtë moshë me mundësinë e të miturve për të fituar të ardhura nga puna e tyre. Duket qarte se dispozita ka këndvështrimin e sigurimit të mjeteve të jetesës dhe koncepti i braktisjes lidhet gjithashtu me këtë. Ndërkohë që aspekte të tjera të neglizhimit, aq më tepër kur si pasojë e tij vjen ekspozimi i fëmijës ndaj rreziqeve për jetën, integritetin e tij fizik dhe moral, nuk gjejnë shprehje në legjislacionin penal.

Dënimi për “Mosdhënien e mjeteve të jetesës” si veprë penale nuk parashikon rastin kur prindi, pa justifikim, nuk ekzekuton vendimin gjyqësor për dhënien e “detyrimit ushqimor”.

Kodi i Procedurës Penale duhet të rishikohet në lidhje me procedurat që duhet të ndjekë i dëmtuari akuzues²⁸⁴ i mitur, i cili për iniciimin e procesit penal dhe atë të shpërblimit të dëmit, duhet të përfaqësohet nga prindi apo kujdestari. Në rast se përfaqësuesi ligjor nuk është dakord me nisjen e këtij procesi dhe nuk i kryen veprimet e duhura procedurale, atëherë fëmija nuk ka mundësi të mbrojë interesat e tij. Në këtë aspekt, ligji penal duhet të plotësohet dhe t’i parashikojë rastet me të dëmtuar akuzues të mitur si vepra penale që ndiqen kryesisht (*ex officio*) nga organi i akuzës. Kjo do të garantonte një mbrojtje më efektive, edhe në rastet e dhunës në familje ku prindi shfaqet si autor i veprave penale, të cilat përcaktohen se ndiqen mbi bazën e kërkesës së të dëmtuarit akuzues.

Kodi i Familjes parashikon humbjen dhe heqjen e përgjegjësisë prindërore në rastet kur prindërit kryejnë vepra penale ndaj fëmijëve të tyre apo kur i marrin ata si bashkëpunëtorë në kryerjen e një veprë penale, rastet

²⁸² Neni 105, Kodit Penal.

²⁸³ Neni 124, 125 Kodi Penal.

²⁸⁴ Neni 58, 59 Kodi i Procedurës Penale.

e heqjes së saj dhe marrjen e masave urgjente në funksion të mbrojtjes dhe interesit më të lartë të fëmijës,²⁸⁵ ç'ka dëshmon një përmbushje të mirë të standardeve që garanton neni 19 i KDF.

Por, në këtë kontekst, ia vlen të theksojmë se do të ishte më e efektshme dhe do të shkurtonte procedurat, heqja e përgjegjësisë prindërore si masë plotësuese gjatë procedimit penal, në rastet kur çështja është bërë objekt i këtij procedimi, duke mos e lënë atë si procedurë më vete.

Ligji “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”²⁸⁶ përcakton fëmijët si kategori me vëmendje të veçantë. Ligji ka përcaktuar termin “dhunë” duke i dhënë një fokus të veçantë pasojave që ka viktimat nga akti i dhunës dhe jo mënyrës se si ushtrohet dhuna apo llojeve të akteve të dhunës. Në ligj parashikohet dhënia nga gjykata e masave me karakter “mbrojtës” dhe “thellësisht mbrojtës”, të cilat sigurojnë vendosjen e viktimës së mitur në strehime të përkohshme, dhënien e të drejtës për të mbajtur fëmijët viktimës, detyrimin për dhënien e detyrimit ushqimor autorit të dhunës, si dhe heqja e përgjegjësisë prindërore.²⁸⁷ Ky ligj parashikon si masë për të paditurin edhe ndjekjen e programeve rehabilituese. Problematika qëndron në zbatimin e këtij ligjim, pasi nuk ekzistojnë akoma struktura pritëse (qendra), të cilët të sigurojnë pritjen e viktimave në kushtet e emergjencës.

Ligji “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”²⁸⁸ nuk përcakton në qëllimin e tij sigurimin e shërbimeve për të trajtuar fëmijët viktimat të dhunës. Megjithatë, ai vendos detyrimin për administratorët shoqërorë në bashki dhe komuna të vlerësojnë nevojat e individëve dhe familjeve që kërkojnë shërbime shoqërore e kushtëzuar kjo nga mundësitë financiare dhe përparësitë kombëtare,²⁸⁹ gjë që duket më shumë si detyrim i përgjithshëm për të cilin lehtësisht mund të ekzistojnë kushtet për të mos u zbatuar. Fëmija viktimë e dhunës, abuzimit e keqtrajtimit nuk gjen referencë direkte në ligj, megjithatë, ai përfshihet nën përkufizimin e individit në nevojë. Administratorët shoqërorë detyrohen të përgatisin dokumentacionin dhe propozimet për miratim në këshillin bashkiak apo të komunës në lidhje me shërbimin e kërkuar. Ligji nuk parashikon sistemin e referimit për fëmijët e dhunuar.

Standardet e Shërbimeve të Përkujdesit shoqëror për fëmijët në institucionet rezidenciale²⁹⁰ parashikojnë mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna dhe abuzimi²⁹¹ kur kjo kryhet nga stafi i qendrës si dhe u garantojnë atyre të drejtën e ankimit.²⁹² Stafi i qendrës duhet të përgatisë një plan veprimesh në rast abuzimesh. Duhet të hartohet dhe zbatohet një program terapie për të trajtuar traumat që ka përjetuar fëmija i abuzuar. Ky program duhet

²⁸⁵ Neni 215, 223, 228, Titulli III, Kodi i Familjes.

²⁸⁶ Ligji Nr. 9669 Datë 18.02.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, I ndryshuar me Ligjin Nr. 9915 Datë 12.5.2008.

²⁸⁷ Neni 10, Ligji Nr. 9669 Datë 18.02.2006 (ndryshuar me Ligjin Nr. 9915 Datë 12.5.2008).

²⁸⁸ Ligji Nr. 9355, Datë 10.03.2005.

²⁸⁹ Neni 31, pika (f), Ligjit Nr. 9355, Datë 10.03.2005. “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”.

²⁹⁰ VKM, Nr. 659, Datë 17.10.2005 “Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale”

²⁹¹ Pika 2, , Pika 3 “ankimi”, pika 4 “hartimi i planit të terapisë për fëmijët e përfshirë në abuzim” VKM Nr. 659, datë 17.10.2005
“Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale”

²⁹² Pika 9, VKM Nr. 659, datë 17.10.2005 “Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale”

të përfshijë udhëzime për stafin, personin përgjegjës për fëmijën si dhe personin abuzues. Sfidë mbetet zbatimi i këtyre standardeve në praktikë.

Dispozitat Normative për Arsimin Parauniversitar dhe Udhëzimi i Ministrit të Arsimit për Eliminimin e Dhunës në Shkollë parashikojnë se individualiteti dhe dinjiteti njerëzor i fëmijës parashkollor dhe i nxënësit respektohet, mbrohet nga dhuna fizike dhe psikologjike, diskriminimi dhe veçimi. Në kopsht dhe në shkollë, janë kategorikisht të ndaluara ndëshkimet fizike apo trajtimet poshtëruese e denigruese të fëmijëve.²⁹³ Megjithatë Ministria e Arsimit dhe e Shkencës e ka përdorur këtë nen të Dispozitave Normative si baza për të detajuar një sërë masash e detyrash duke vendosur theksin tek përdorimi i formave të përshtatshme të disiplinimit dhe menaxhimit të klasës që nuk bazohen në frikë, kërcënim, poshtërim apo përdorim të forcës fizike, përsëri mbetet shumë për të bërë.

Strategjitë e hartuara gjatë kësaj periudhe nga shteti shqiptar si “*Strategjia Kombëtare për Fëmijët*”²⁹⁴ dhe “*Plani i kombëtar i veprimt*”²⁹⁵ kanë adresuar mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna në familje, në shkollë dhe në komunitet; mbrojtjen nga abuzimi dhe neglizhimi (përfshirje sociale e fëmijëve); mbrojtjen nga të gjitha format e shfrytëzimit dhe ka parashikuar një seksion të veçantë për mbrojtjen e fëmijëve vajza, megjithatë, këto parashikime akoma nuk kanë gjetur zbatim.

“Strategjia kombëtare e luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore, 2008-2010”, si dhe dokumenti plotësues “*Strategjia kombëtare për luftën kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve, viktimat të trafikimit*”²⁹⁶ gjithashtu ka prekur fenomenin e trafikimit, shfrytëzimit dhe abuzimit seksual,²⁹⁷ por ende vazhdon të mbetet

²⁹³ Neni 36, “Dispozitat normative për arsimin parauniversitar” 2002-2003.

²⁹⁴ Kapitulli II “Strategjia Kombëtare Për Fëmijët” VKM Nr. 368, Datë 31.05.2005.

²⁹⁵ “Plani kombëtar i veprimt” parashikon në pikën 5 “Të mbrohen fëmijët nga dhuna dhe keqtrajtimi” parashikon masat në vijim “5.1. Të ngrihet një sistem referimi dhe menaxhimi i rasteve kur fëmijët dhunohen dhe keqtrajtohen” sipas masave në vijim; 5.2 Ngritja e Linjës së Ndihmës për Fëmijët në 12 baskitë qendër qarku; 5.3. Të hartohen standardet e shërbimeve për fëmijët: në institucione, në qendrat ditore, të kujdestarisë; 5.1. të përcaktohet statusi i punonjësit social dhe psikologut dhe të promovohet roli i tyre në mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi, dhuna dhe keqtrajtimi; 5.2. kalimi i sistemit të paraburgimit në varësi të Ministrisë së Drejtësisë dhe mundësi të trajtimit të fëmijëve të paraburgosur nga punonjës të specializuar; 5.3. Vendosja e sanksioneve për të garantuar mbrojtjen e fëmijëve nga keqtrajtimi dhe përdorimi i forcës në Komisarate Policie, Dhoma Paraburgimi, Burgje dhe në institucione të tjera, ku fëmijët janë në mbrojtje të shtetit; 5.4. Raportim në Këshillin e Ministrave për situatën dhe masat e marra për mbrojtjen e fëmijëve nga keqtrajtimi në institucione të shtetit; 5.5. Të ndërmerren studime mbi dhunën, keqtrajtimin dhe abuzimin në familje, për të evidentuar shkaqet, qëllimin dhe natyrën e këtyre praktikave, për përcaktimin e politikave dhe ndërhyrjeve kundër dhunës ndaj fëmijëve; 5.6. Ngritja e Qendrave të Rehabilitimit piko-fizik për Fëmijët e dhunuar dhe keqtrajtuar; 5.7. Ngritja e sistemit të drejtësisë për të mitur; 5.8. Ndalimi i publikimit të të dhënave personale për të ndaluarit, kur ata janë fëmijë; 5.9. Të ndalohet dhënia e të dhënave personale të fëmijëve viktimat të krimit, dhunës, abuzimit, vete-vrasjes etj.

²⁹⁶ VKM Nr. 1083, datë 23.7.2008 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore, 2008-2010, si dhe të dokumentit plotësues “Strategjia kombëtare për luftën kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve, viktimat të trafikimit”

²⁹⁷ Përkufizimet ligjore ku mbështetet Strategjia kundër Trafikimit të Fëmijëve: Për qëllimin e kësaj Strategjie: Trafikim i qenieve

i pamjaftueshëm dallimi midis prostitucionit dhe trafikimit të qenieve njerëzore për shfrytëzim seksual.²⁹⁸ Ndërkohë, mbetet i mangët ndërgjegjësimi i të gjitha formave të shfrytëzimit dhe abuzimit seksual duke vënë theksin edhe tek të miturit meshkuj, si dhe bërjen pjesë të kurikulave shkollore.

“Strategjia sektoriale e mbrojtjes sociale dhe planit të veprimit për zbatimin e saj,”²⁹⁹ megjithëse ka parashikuar si subjekt të veçantë fëmijët e trafikuar, fëmijët jetimë, fëmijët që punojnë si dhe fëmijët e tjerë në nevojë që nuk jetojnë në institucionet rezidenciale nuk ka arritur të vërë në zbatim asnjë veprim konkret për këto objektiva.

Aleanca e Fëmijëve është e shqetësuar për situatën e mbrojtjes së fëmijëve nga dhuna, si fizike dhe ajo psikologjike. Shoqëria shqiptare ka trashëguar nga e kaluara një mentalitet tolerant ndaj dhunës, e cila në rastin e fëmijëve perceptohet si mjet i mirë edukues dhe disiplinimi. Nga ana tjetër, fëmijët nuk dinë të identifikojë dhunën dhe, në këtë mënyrë, as ta raportojnë apo të ankohen për të. Një përqindje e konsiderueshme e fëmijëve kanë informacion të pjesshëm, ose të pasaktë, për këtë fenomen. Pjesa më e madhe e fëmijëve të anketuar pohojnë se nuk kanë kërkuar ndihmë në rastet kur janë dhunuar.³⁰⁰ Duke u nisur nga rezultati se pjesa më e madhe e fëmijëve nuk janë ankuar mund të pohohet se ata nuk kanë besim se mund të ketë ndonjë reagim dhe kjo mund të jetë pasojë e eksperiencave të tyre të mëparshme. Po kështu, është e mundshme që këta fëmijë ta perceptojnë dhunën si një fenomen normal, çka tregon se niveli i tyre i ndërgjegjësimit është i ulët. Dhuna rezulton të shfaqet me tepër në shtëpi³⁰¹ kjo pasi në Shqipëri ende ekziston mentaliteti se dhuna që ndodh në familje nuk duhet të raportohet³⁰² dhe duhet të mbetet brenda mureve të shtëpisë. Ndërkohë, profesionistët e fushës së shëndetit publik evidentojnë se janë të patrajnuar dhe nuk e kanë të përcaktuar në mandatin e tyre, të vëzhgojnë dhe të identifikojnë rastet e fëmijëve të dhunuar, abuzuar apo të neglizhuar dhe ta raportojnë këtë.³⁰³ Shteti shqiptar nuk mbledh dhe raporton statistika për prezencën e dhunës tek fëmijët shqiptarë por bazuar në një studim të UNICEF, 2006 mbi dhunën ndaj fëmijëve (438 fëmijë të intervistuar) rezulton se:

njerëzore nënkupton rekrutimin, transportimin, transferimin, strehimin ose pranimin e personave me anë të kanosjes ose përdorimit të forcës ose formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, hilesë, apo të përfitimit nga pushteti ose pozitës së dobët ose të dhënies apo marrjes së pagesave apo avantazheve për të arritur pëlqimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër për qëllime shfrytëzimi. Shfrytëzimi nënkupton, së paku, shfrytëzimin e të tjerëve për prostitucion apo forma të tjera shfrytëzimi seksual, punë apo shërbime të detyruara, skllavëri ose praktika të ngjashme me skllavërinë, robëri ose heqje të organeve.

²⁹⁸ “Strategjia kombëtare për luftën kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve, viktimat e trafikimit”, f. 5

²⁹⁹ Vendim Nr. 80, datë 28.1.2008 “Për miratimin e strategjisë sektoriale të mbrojtjes sociale dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj” seksioni 1.2.1 faqe 9 dhe në vazhdim.

³⁰⁰ Shih Aneksi I – Zbatim i Konventës për të drejtat e fëmijëve analizuar nga këndvështrimi i fëmijëve, dhjetor 2008-janar 2009, f. 41.

³⁰¹ Shih Aneksi I – Zbatim i Konventës për të drejtat e fëmijëve analizuar nga këndvështrimi i fëmijëve, dhjetor 2008-janar 2009, f. 41.

³⁰² Violence against children in Albania, Raport studimor i mbështetur nga UNICEF, Prof. Dr. Adem Tamo, Prof. Dr. Theodhori Karaj, Tiranë 2006.

³⁰³ Aneksi II, Informacion nga strukturat kryesore publike dhe jo publike të përfshira në garantimin e të drejtave të fëmijëve, janar – shkurt 2009, sipas Protokollit Informativ nga Qendrat Shëndetësore.

- *Për sa i përket përdorimit të dhunës në shkolla, djemtë janë më të dhunuar se vajzat me forma si: shtyrje, goditje me objekt, përplasje koke, kapje nga fyti, etj. Edhe në shtëpi djemtë dhunohen më shumë fizikisht, përveçse me kapje nga fyti dhe shtyrje që ndëshkohen vajzat.*³⁰⁴
- *Në lidhje me autorët e dhunës psikologjike në shkolla dhe familje nxënësit (438 të intervistuar) shprehen se ushtrojnë dhunë mësueset femra 54.1, nxënësit e tjerë 22.4% dhe mësuesit meshkuj 18.7%. Në familje: 34.5% thonë se dhunon babai dhe 42.5% thonë se dhunon nëna, më pas vijnë përqindje më të ulta për personat e tjerë në familje si vëllezërit, motrat, gjyshërit*³⁰⁵.
- *Për sa i përket formave të dhunës psikologjike që ushtrohet mund të përmendim forma të tilla si: përdorimi i nofkave: 35.8% në shtëpi dhe 24% në shkollë; Kërcënim me objekte: 17.7% në shtëpi dhe 10.7% në shkollë; Mbyllja në tualet apo në vende të tjera: 18.5% në shtëpi; Kërcënimi i përzënies nga shtëpia: 14.3% në shtëpi; Kërcënim me braktisje: 6.4% në shtëpi; Përzënie nga klasa: 22.6% në shkollë; Vënia e notave negative për sjelljen e keqe: 28.8% në shkollë*³⁰⁶.
- *Në lidhje me pasojat e dhunës fëmijët tregojnë se kanë pasur marrje mendsh, të fikët, gërvishtje, gjakosje, etj.*³⁰⁷

Aleanca është shumë e shqetësuar, gjithashtu, për përdorimin e dhunës ndaj fëmijëve në konflikt me ligjin. Kështu, nga fëmijët e paraburgosur rezultoi se ata bëhen subjekt i dhunës policore kryesisht gjatë fazës 48-orëshe të ndalimit, derisa marrin masën e sigurisë.

³⁰⁴ Violence against children in Albania, Raport studimor i mbështetur nga UNICEF, Prof. Dr. Adem Tamo, Prof. Dr. Theodhori Karaj, f. 66, Tiranë, 2006.

³⁰⁵ Violence against children in Albania, Raport studimor i mbështetur nga UNICEF, Prof. Dr. Adem Tamo, Prof. Dr. Theodhori Karaj, f. 62, 65, Tiranë, 2006.

³⁰⁶ Violence against children in Albania, Raport studimor i mbështetur nga UNICEF, Prof. Dr. Adem Tamo, Prof. Dr. Theodhori Karaj, f. 31, Tiranë, 2006.

³⁰⁷ Violence against children in Albania, Raport studimor i mbështetur nga UNICEF, Prof. Dr. Adem Tamo, Prof. Dr. Theodhori Karaj, f. 56, Tiranë, 2006.

Modeli i ndërhyrjes së CPU-ve

CPU (Child Protection Unit) është një model operacional konkret për mbrojtjen fëmijëve duke hartuar një plan veprimi për të mbrojtur fëmijët në rrezik. Janë pjesë organike thelbësore e administratës së Bashkisë, dhe janë përfshirë në Zyrën e Ndihmës Ekonomike dhe Përkujdesjes Shoqërore. Në këtë njësi, është i punësuar të paktën një person, i cili është i ngarkuar për mbrojtjen e fëmijëve. Implementimi i projektit të CPU-ve është bazuar në Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes së Fëmijëve,³⁰⁸ Planin e saj të Veprimit³⁰⁹ si dhe në Strategjinë Kombërate Kundër Trafikimit të fëmijëve 2008-2010. CPU, është e bazuar në filozofinë e decentralizimit të shërbimeve shoqërore. CPU-të janë përgjegjëse për: a) identifikimin e fëmijëve të abuzuar, neglizhuar, shfrytëzuar, trafikuar dhe të fëmijëve në rrezik; b) mbrojtjen dhe menaxhimin e rasteve për fëmijët e identifikuar dhe të referuar duke ofruar shërbim të drejtpërdrejtë dhe veprime mbrojtëse të koordinuara me struktura publike dhe jo publike në interesin më të lartë të fëmijës; c) analizimin e çështjeve të mbrojtjes së fëmijëve në komunitet me ndihmën e një table të dhënash mbi rastet e menaxhuara; d) promovimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit mbi të drejtat e fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre. Target grupi nën mbrojtjen e CPU-ve janë fëmijët (nën 18 vjeç) dhe familja, fëmijët e trafikuar, të abuzuar, shfrytëzuar dhe të neglizhuar. Këto njësi janë parashikuar për t'iu kaluar gradualisht baskive përkatëse në terma financiare në një hark kohor prej 3 vjetësh. Ky transferim tashmë ka ndodhur në Kukës, bashki e cila mbështet plotësisht njësinë.

Nxjerrja e ligjit për "Mbrojtjen nga dhuna në familje" ka rritur shumë numrin e rasteve të raportimit të dhunës kryesisht nga nënat, ku fëmijët janë dëshmitarë të kësaj dhune dhe si të tilla janë edhe vetë të dhunuar. Megjithatë nga forcat e policisë dhe nga gjyqtarët raportohet vështirësia e tyre për të realizuar një mbrojtje eficiente.

Bazuar në Analizën Vjetore të Departamentit të Hetimit të Krimit në Ministrinë e Brendshme për vitin 2008 janë evidentuar 822 kallëzime për krime në familje dhe kërkesa për urdhra mbrojtje nga të cilët 22 raste janë me pasojë vdekjen, ndër të cilët 1 fëmijë. Gjithashtu, janë evidentuar për vitin 2008, 59 raste vetëvrasjesh për shkak të dhunës në familje, nga të cilët 18 raste janë fëmijë. Policia ka ndjekur procedurën për kërkimin e urdhrit të mbrojtjes në gjykatë për 377 raste. Nga të gjitha rastet e mësipërme 77 prej tyre kanë qenë vetë të miturit, të cilët kanë bërë kallëzimin apo kanë kërkuar mbrojtje. Duhet theksuar se pas daljes së ligjit, "Për mbrojtje nga dhuna në familje" është ngritur ndjeshëm raportimi i rasteve në polici, çka tregohet edhe po të krahasojmë faktin se në vitin 2007 ishin raportuar vetëm 270 raste. Megjithatë, vazhdon të mbetet sfida realizimi i garantimit të mekanizmave eficientë për

³⁰⁸ Miratuar me VKM Nr. 368, Datë 31.05.2005.

³⁰⁹ Miratuar me VKM Nr. 487 Datë 30.06.2005.

të garantuar mbrojtjen emergjente nëpërmjet strehimit në qendra pritëse.³¹⁰

Një përpjekje, së fundi, është bërë nga organizata lokale për ngritjen e Linjës Kombëtare të Fëmijëve, një numër treshifror pa pagesë i cili pritet të jetë operacional në 1 qershor, 2009.³¹¹

Rekomandime:

- Forcimi i sistemit të mbrojtjes së fëmijëve.
- Kryerja e fushatave të ndërgjegjësimit kundër dhunës ndaj fëmijëve në kuadër të një strategjie komunikimi për ndryshimin e sjelljes.
- Amendimi i Kodit Penal në lidhje me parashikimin e veprave penale të dhunës dhe të abuzimit dhe shfrytëzimit ndaj fëmijëve.
- Amendimi i Kodit të Procedurës Penale për ndjekjen penale kryesisht të veprave të abuzimit me fëmijët.
- Zbatimi dhe monitorimi i masave kundër dhunës në institucionet shkollore dhe parashkollore.
- Amendimi i Ligjit për “Ndihmën dhe shërbimet shoqërore,” për përfshirjen dhe parashikimi i fëmijëve, viktimave të dhunës, së abuzimit, neglizhimit si kategori për përfitimin e shërbimeve sociale dhe psiko-sociale. Parashikimi i shërbimeve sociale dhe procedurave përkatëse specifike për këtë target grup fëmijësh.
- Punonjësit e policisë, të shëndetësisë, mësuesit, duhet të pajisen me protokolle të qarta (udhëzues) për identifikimin e çështjeve që kanë të bëjnë me identifikimin dhe raportimin e rasteve të abuzimit, shfrytëzimit dhe dhunimit.
- Ngritja e Gjykatave për të Mitur dhe ofrimi i shërbimeve alternative.
- Zbatimi i Standardeve të Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për Fëmijët në institucionet rezidenciale si dhe rritja e rolit të Shërbimit Social Shtetëror në monitorimin dhe inspektimin e zbatimit të këtyre standardeve dhe, në mënyrë të veçantë, të monitorimit të dhunës, abuzimit nga vetë institucioni dhe nga Inspektoriati i Shërbimit Social.
- Trajnimi i profesionistëve (mjekë, mësues, administratorë socialë, punonjës policie) në lidhje me identifikimin e dhunës dhe parandalimin e saj.

³¹⁰ Aneks II, Informacion nga strukturat kryesore publike dhe jo-publike të përfshira në garantimin e të drejtave të fëmijëve (janar-shkurt 2009), sipas protokollit informativ nga Komisaritet e Policisë.

³¹¹ CRCA me mbështetjen e UNICEF është duke ngritur numrin pa pagesë për fëmijët në lidhje me ankesat e tyre.

Neni 20 - Fëmijët e privuar nga mjedisi familjar

Parlamenti Shqiptar nuk ka ratifikuar Konventën Evropiane (1980) “Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në lidhje me kujdestarinë e fëmijës si dhe për rivendosjen e kujdestarisë.”³¹²

Kuadri ligjor shqiptar parashikon dhënien e ndihmës në para apo në natyrë për familjet pa të ardhura, me të ardhura të pamjaftueshme jetese dhe për ato familje me më shumë se dy fëmijë të lindur njëherësh.³¹³ Po kështu, parashikohen masa për ndihmën dhe reduktimin e varfërisë tek familjet dhe grupet në nevojë.³¹⁴ Megjithatë, situata paraqitet problematike pasi nuk parashikon mbështetjen e veçantë për ato familje apo prindër të cilët për shkak të kushteve të vështira ekonomike kërkojnë dhe vendosin fëmijën në institucione përkujdesjeje. Nga ana tjetër, kur fëmija ndodhet në institucionin e përkujdesjes, kuadri ligjor nuk parashikon përpjekje sistematike apo masa specifike mbështetjeje për ta kthyer fëmijën tek prindërit, apo për ta vendosur nën kujdesin e të afërmeve të tjerë të tij.

Kujdestaria si institut dhe familja kujdestare³¹⁵ parashikohen në ligj dhe vendimmarrja për vendosjen e një fëmije në kujdestari bëhet vetëm me vendim gjykatë, i cili bazohet në interesin më të lartë të fëmijës. Vlen të theksohet se Qeveria ka pasur një sensibilizim lidhur me deinstitutionalizimin e fëmijëve në nevojë dhe aplikimin e alternativave të reja të shërbimeve sociale (kujdestarisë së fëmijëve) të pasqyruara në Planin Kombëtar të Veprimit për vitet 2005-2010 dhe në Strategjinë Sektoriale të Ministrisë së Punës 2007-2013. Me iniciative të MPÇSSHB dhe mbështetje të UNICEF është miratuar Strategjia e Kujdestarisë për fëmijët në nevojë.³¹⁶ Me miratimin e këtij dokumenti është bërë e mundur detajimi i procedurave për identifikimin, listimin dhe monitorimin e familjeve kujdestare. Në këtë dokument parashikohet pilotimi i 80 familjeve kujdestare për herë të parë në Tiranë dhe Shkodër.

Vendosja e fëmijëve në institucione³¹⁷ parashikohet si alternativë e fundit për fëmijët e privuar nga familja e origjinës dhe institucioni i përkujdesjes ushtron tagrat e plota të kujdestarit.³¹⁸ Kështu, në institucionet e përkujdesjes sociale rezultojnë të jenë të akomoduar sot rreth 579 fëmijë, nga të cilët 231 fëmijë janë vendosur në

³¹² Masë e parashikuar nga VKM Nr. 1104, Datë 30.07.2008 “Dokumenti i politikave për kujdestarinë e fëmijëve në nevojë”

³¹³ Neni 5, Ligji Nr. 9355, Datë 10.03.2005 “Për Ndhimën dhe shërbimet shoqërore” (shuma e ndihmës ekonomike varion nga 2600 lek dhe jo më shumë se 7000 lek për familjet me mbi 7 fëmijë, si masë që alokohet çdo muaj), VKM Nr. 565 Datë 9.8.2006 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, nga rritja e çmimit të energjisë elektrike”.

³¹⁴ “Strategjinë sektoriale të mbrojtjes sociale”, VKM Nr. 80, Datë 28.01.2008- për miratimin e Strategjisë sektoriale të mbrojtjes sociale dhe planin e saj i veprimit”.

³¹⁵ Neni 266, Kodi i Familjes.

³¹⁶ VKM Nr. 1104, Datë 30.07.2008 “Për miratimin e Strategjia e kujdestarisë për fëmijë në nevojë”.

³¹⁷ Neni 267, Kodi i Familjes.

³¹⁸ Neni 271, Kodi i Familjes.

institucione publike dhe 348 fëmijë në ato jo-publike.³¹⁹ Problematike paraqitet situata në ligj dhe në praktikë në lidhje me identifikimin dhe aksesin e fëmijëve në nevojë për përkujdesje dhe administrimin e rasteve emergjente.³²⁰ Kështu, për shkak të decentralizimit, aksesin e fëmijëve për sistemin në qendrat e përkujdesjes lidhet me plotësimin e një pakete dokumentacioni, i cili duhet të plotësohet nga kërkuesi (prindi/i afërmi) i fëmijës, ndërkohë që administratori social parashikohet të ketë vetëm mandatin e pranimit të kërkesës dhe vlerësimit të dokumentacionit.³²¹ Administratori social paraqet rastin për vlerësim në Këshillin e Bashkisë/Komunës,³²² i cili merr vendim në lidhje me sistemin e fëmijës në institucionin e përkujdesjes. Në rastet kur në bashkinë apo komunën përkatëse nuk ka institucione rezidenciale, atëherë kërkesa e vlerësuar nga këshilli i bashkisë/komunës i paraqitet Shërbimit Social Shtetëror i cili merr vendim për vendosjen e fëmijës në institucion në nivel nacional që ka kapacitete të lira.³²³ Nëpërmjet këtij kualiteti, shteti shqiptar ka dashur të adresojë përmbushjen e detyrimeve për shkak të decentralizimit të shërbimeve sociale, por njëkohësisht të mbushë vakuumin në rast se në njësitë vendore nuk ka hapësira për përkujdesje institucionale për fëmijët.

Ajo që paraqitet vërtet problematike në këtë qasje lidhet me:
kriteret dhe dokumentacionin për t'u plotësuar, të cilat krijojnë barriera dhe nuk lehtësojnë aksesin në përkujdesje të fëmijëve. Plotësimi i dokumentacionit ka një kosto financiare për t'u përballuar dhe duhet të plotësohet nga kërkuesi (prindi/kujdestari/sektori i shërbimeve sociale/policia);
kohëzgjatja e procesit: bazuar në procedurën e mësipërme, aksesin lidhet me miratimin e rastit nga këshilli i bashkisë /komunës apo i Shërbimit Shtetëror Social;
mosparashikimi i rasteve emergjente: lejimi i aksesit pa kushtin e plotësimit të dokumentacionit për rastet e fëmijëve të abuzuar, dhunuar dhe neglizhuar.

Situata edhe më alarmante lidhet me faktin që përkujdesja shoqërore për fëmijët në nevojë është rregulluar vetëm nëpërmjet vendosjes në institucion, bazuar në procedurën e mësipërme. Ndërkohë që administratori social/sektori i shërbimeve sociale apo njësia e mbrojtjes së fëmijëve në bashki/komuna duhet të kishte rolin e identifikimit, vlerësimit të rastit, të evidentimit të alternativës më të mirë sipas nevojave dhe karakteristikave të fëmijës duke zbatuar prioritetet për vendosjen e fëmijëve në kujdestari pranë të afërmeve, familjes kujdestare dhe, më pas, në institucion. Në rastin e këtij të fundit, kërkuesit, qoftë ky edhe vetë fëmija, duhet të mbështeteshin nga strukturat e shërbimeve sociale në bashki për plotësimin e dokumentacionit. Kur fëmija do të vendoset

³¹⁹ Bazuar në të dhënat e fundit të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale.

³²⁰ Vendosja e fëmijëve në institucionet e përkujdesit shoqëroror bëhet në bazë të vendimit të marrë nga SHSSH bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 9355 Datë 10.03.2005 “Për ndihmë dhe shërbime shoqërore”, VKM Nr. 209 datë 12.04.2006 dhe Udhezimi Nr. 2470, Datë 6.12.2006 i MPÇSSHB.

³²¹ Pika 2, Udhezimi Nr. 2470, Datë 6.12.2006 i MPÇSSHB.

³²² Pika 3, Udhezimi Nr. 2470, Datë 6.12.2006 i MPÇSSHB.

³²³ Pika 6 dhe 7, Udhezimi Nr. 2470, Datë 6.12.2006 i MPÇSSHB.

pranë një institucioni të ndodhur në territorin e bashkisë ku ka vendbanimin, strukturat e mësipërme duhet të merrnin rol për mbështetjen e marrëdhënies prind-fëmijë, me gjithë vendosjen e përkohshme në institucion dhe bashkërendimin e punës me institucionin për të realizuar kthimin e fëmijës pranë familjes, kur kjo është e mundur. Gjithashtu, mungesa e parashikimit të rolit aktiv të strukturave të shërbimit social, të cilat limitohen vetëm në vlerësimin e dokumentacionit dhe jo të vetë rastit bëhet akoma më shqetësuese në rastin e prindërve të cilët, për shkak të kushteve ekonomike, vendosin të lënë në përkujdesje institucionale fëmijët e tyre. Në këto raste, roli i strukturave të mësipërme, duhet të ishte mbështetja e familjeve për të parandaluar braktisjen e fëmijëve nga prindërit biologjikë. Ndërkohë, që vendosja e fëmijëve në institucione i kushton çdo ditë shtetit. E për më tepër, nga ana tjetër shteti ende nuk bën asnjë përpjekje që koston e mbajtjes së fëmijëve në institucion t'ua kalojë familjeve duke garantuar në këtë mënyrë të drejtën e fëmijëve për t'u rritur në një ambient familjar.³²⁴ Legjislacioni ka parashikuar standardet e përkujdesjes në qendrat rezidenciale të fëmijëve³²⁵ duke përfshirë koncepte shumë të rëndësishme si ai i Planit Individual³²⁶ për fëmijën dhe me mbështetjen e UNICEF-it është hartuar një paketë me dokumentacionin që detajon parashikimet e standardeve.³²⁷ Megjithatë, shqetësues në këtë drejtim mbetet numri i pamjaftueshëm i stafit në qendrat rezidenciale për ushtrimin e funksioneve të kujdestarisë, mungesa e kualifikimit profesional dhe trajnimit të vazhdueshëm të tyre. Së fundmi, është ndërmarrë një nismë ligjore pozitive në këtë drejtim, duke hartuar një ligj specifik për të drejtat e fëmijëve, i cili është ende në fazën e projektligjit dhe pritet të miratohet së shpejti. Ky projekt ligj rikonfirmon dhe një herë të drejtën e fëmijës për një përkujdesje alternative të parashikuar në nenin 20 të KDF.³²⁸

Aleanca kërkon të tërheqë vëmendjen për situatën problematike që paraqitet në lidhje me identifikimin dhe mbështetjen e familjeve, të cilat kanë tendencë për vendosjen e fëmijëve në institucione të përkujdesit për shkak të kushteve të vështira ekonomike. Në këtë kuadër, masa të posaçme dhe koordinuese duhet të ndërmerren nga institucionet përgjegjëse vendore për të shmangur fenomenin e braktisjes apo vendosjes së fëmijëve në institucione rezidenciale, si

³²⁴ Neni, 5 dhe 9 i Konventës së OKB-së Për të Drejtat e Fëmijëve

³²⁵ VKM Nr. 659, datë 17.10.2005 “Standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale”; Udhëzimit nr. 830 datë 14.04.2008 “Për zbatimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale publike dhe jo publike.” Më tepër informacion pika IV “Ofrimi dhe përgatitja e akteve” dhe XI “Vend-ndodhja, modeli dhe madhësia e institucionit.”

³²⁶ Udhëzimit Nr. 830 datë 14.04.2008 “Për zbatimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale publike dhe jo publike”.

³²⁷ Përkatesisht “Raport për vlerësimin e nevojave dhe ecurisë (5-10 vjeç)”, “Raport për vlerësimin e nevojave dhe ecurisë (3-6 vjeç)”, “Plani për birësimin e fëmijës/të riut”, “Raport për vlerësimin e nevojave dhe ecurisë të fëmijëve 0-12 muaj”, “Raport për vlerësimin e nevojave dhe ecurisë (1 dhe 2 vjeç)”, “Raport për vlerësimin e nevojave dhe ecurisë (11-15 vjeç)”, “Formulari për informacionin e domosdoshëm”, “Plani i rrugës për të ardhmen”, “Procesverbal i incidentit të mbrojtjes së fëmijës”, “Planifikimi për transferimin e fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara”, “Plani i rrugës për të ardhmen”, “Plani personal për arsimimin në fëmijërinë e hershme”, “Plani i kujdesit për fëmijën ose të riun në një Qendër Zhvillimi”, “Plani i kujdesit për fëmijën ose të riun në një institucion rezidencial të kujdesit për fëmijën”, “Raport i vlerësimit të plotë të nevojave për Qendrat e zhvillimit”.

³²⁸ Neni 19, Projektligji “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”.

dhe mbështetjen brenda programeve të ndihmës sociale të të gjitha kategorive të familjeve në nevojë.³²⁹

Nga ana tjetër, problematike paraqiten edhe procedurat/dokumentacioni që duhet të plotësohen nga familjet në nevojë,³³⁰ si në rastin e mbështetjes me ndihmë ekonomike por edhe në rastin e vendosjes së fëmijëve në qendrat e përkujdesit rezidencial. Ka një numër të konsiderueshëm dokumentacioni që duhet të plotësohet, ka shpenzime financiare dhe në kohë për familjet në nevojë. Për më tepër, mbështetja financiare për familjet apo grupet në nevojë është në nivele shumë të ulëta dhe të pamjaftueshme për përballimin e nevojave jetësore. Pavarësisht tendencës të “Strategjisë Sektoriale të Mbrojtjes Sociale” për rritjen e masës së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë, problematike paraqitet aspekti që shteti shqiptar si indikatorë të varfërisë në Shqipëri përdor vlerësimin e konsumit dhe jo në të ardhurat, sepse informacioni mbi të ardhurat nuk është i saktë në krahasim me informacionin mbi konsumin.

Nga ana tjetër, e drejta për arsim garantohet plotësisht për fëmijët e vendosur në institucione rezidenciale, por Aleanca kërkon të tërheqë vëmendjen për të marrë masa efikase dhe për të luftuar stereotipin dhe ambientin jomikpritës shkollor që ndeshin fëmijët e institucioneve nga fëmijët e tjerë të cilët jetojnë në ambjente familjare.³³¹

Aleanca vlerëson si hap tepër pozitiv hartimin dhe zbatimin e standardeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në qendrat, por në këtë aspekt duhet të fuqizohet roli i strukturave vendore/administratorëve socialë.

Po në aspektin e vendosjes së fëmijëve në institucionet rezidenciale, Aleanca do të theksonte nevojën për ta bërë më eficiente procedurën e “Ankimimit”³³² nga fëmijët në këto qendra, në mënyrë të veçantë, me ngritjen e një institucioni asnjane që do të trajtonte këto ankesa.³³³ Nga intervistat e fëmijëve të vendosur në këto institucione rezulton se

³²⁹ Rasti i familjeve të cilat kanë migruar pas viteve '90 nga zonat rurale drejt zonave urbane (qytet të mëdha) kryesisht në qytete Tiranë, Durrës.

³³⁰ “Strategjinë sektoriale të mbrojtjes sociale” faqe 9 “ Problematike paraqitet procedura/ dokumentacioni që përdoret aktualisht për të identifikuar këto familje i cili plotësohet me vështirësi: (i) nëntë dokumente dhe certifikata shpesh të noterizuar nga shtatë zyra rajonale kërkohen për tu plotësuar; (ii) në këtë proces ka edhe presione për pagesa dhe transaksione të paligjshme; dhe (iii) subjektivizmi dhe gabimet në plotësimin e dokumenteve ballafaqohet edhe me mungesën e kapaciteteve dhe lëvizjet e shpeshta të administratorëve lokalë.

³³¹ Aneksi II, Informacion nga strukturat kryesore publike dhe jo publike të përfshira në garantimin e të drejtave të fëmijëve, janar-shkurt 2009, sipas “, sipas Protokollit informativ nga qendrat rezidenciale, shqetësime të bëra prezente nga këto protokolle: “Në bazë të udhëzimeve të ministrisë fëmijët ndjekim mësimin në një nga shkollat më të afërta të vend-ndodhjes së qendrës, gjithashtu shoqërohen çdo ditë nga kujdestarët e institucionit. Por ajo çka konstatohet, është mospranimi i fëmijëve të institucioneve të përkujdesjes nga fëmijët e tjerë të shkollës publike që vijnë apo rriten në familje normale. Ky është një problem që kërkon zgjidhje.”

³³² Mbështetur në raportin përfundimtar të projektit “Mbështetje për zbatimin e standardeve kombëtare në institucionet rezidenciale të kujdesit për fëmijët në Shqipëri”, iniciuar në kuadrin e bashkëpunimit mes Unicef dhe MPÇSSHB, 2007.

³³³ Aneksi II, informacion nga strukturat kryesore publike dhe jo publike të përfshira në garantimin e të drejtave të fëmijëve, janar-shkurt 2009. Sipas Protokollit i plotësuar në qendrën rezidenciale “Zyber Hallulli” Tiranë “ si pjesë e detyrimeve të standardeve është vendosur kutia e ankesave. Por, gjithsesi, kjo nuk është shumë e eficientë në praktikë pasi fëmija vërtetë që ankohet në zyrën tonë, që ka në përbërje 1 shefe me profesion psikologe dhe në 2 punonjëset sociale. Në rast se ka ankesa për ne apo ndonjë ankesë tjetër mund të shkojë të ankohet edhe tek drejtori i institucionit. Por nëse ka ankesë për drejtorin e institucionit ai nuk ka se ku të

fëmijët mendojnë se punonjësit e përkujdesjes në këto institucione sillen në mënyrë të papërshtatshme me ta, përfshirë si elemente të neglizhimit, ashtu edhe të dhunës psikologjike dhe fizike. Gjithashtu, fëmijët tregojnë se punonjësit e institucioneve bëjnë diferencim në trajtimin e fëmijëve. Ky diferencim duket se vjen për shkak të moshës, gjinisë, por shfaqet edhe mbi baza individuale. Vërehet një mungesë e metodave të përshtatshme të komunikimit dhe raporteve të ngushta midis punonjësve dhe fëmijëve.³³⁴

Historia e Marselit³³⁵

Marseli ka lindur në vitin 1988, në fshatin Gruemirë të Shkodrës. Tani është 20 vjeç dhe jeton që prej 8 vjetësh në institutin e fëmijëve 6-15 vjeç, Shkodër. Në institut ka ardhur së bashku me vëllain e tij më të madh dhe motrën më të vogël. Arsyeja e vendosjes së tij në institut së bashku me vëllezërit e tij, ishte vdekja e atit. Pas vdekjes së të atit, mblihet pleqësia e fshatit (sipas zakonisht që ata kishin) dhe vendosin për fatin e këtyre fëmijëve, pasi nëna e Marselit nuk mund ti mbante e vetme fëmijët për arsye ekonomike. Pleqësia e fshatit, vendosi që fëmijët të kalonin nën kujdesin e xhaxhait. Në institucion, na informojnë që kujdestarinë ligjore vazhdon ta ketë xhaxhai i Marselit me vendim gjykatë. Dy vjet më vonë, pasi Marseli ishte vendosur në institucion, i vdes e motra aksidentalisht. Ai mbetet në institut me të vëllanë. Që nga momenti i mbërritjes, Marseli fillon shkollën fillore dhe tetëvjeçaren, pasi në vend-lindjen e tij nuk kishte patur mundësi që të fillonte shkollën, ndaj për këtë arsye vazhdon të jetë akoma në institucion. Tani është në klasën e nënte, me mësimë është shumë mirë. Është djalë shumë i sjellshëm dhe i rregullt. Përshtatet me shokët edhe pse është shumë më i madh se ata.

Përveç shkollës, mbase dëtove ndjek edhe një kurs profesional për elektroshtepiake, në qendrën e formimit profesional Shkodër. Ndërkohë, nëna e tij është martuar dhe ka krijuar sërish familje.

Gjate gjithë këtyre viteve që Marseli ka qenë në institut, është vizituar nga e ëma. Herë pas here, ajo vjen për ta takuar dhe interesohet për të. Përveç të ëmës, vizitohet herë pas here edhe nga xhaxhai apo familjarë të tjerë nga familja e babait, dhe nga vëllai i tij që tashmë i larguar nga instituti, është martuar dhe ka krijuar familjen e tij. Festat apo fundjavat e veçanta, Marseli i kalon te shtëpia e nënës.

Pas mbarimit të klasës së nëntë, Marseli do të rikthehet me nënën e tij, të jetojë me të dhe familjen e saj.

ankohet. Kjo është diskutuar edhe në trajnimet që kemi bërë, është menduar të ngrihet një institucion asnjans, Ombudsmani i Fëmijëve, ku ata të kishin të drejtë të ankoheshin për stafin e institucionit apo të mund të shprehnin, mbase më lirshëm, shqetësimet e tyre, por kjo formë nuk ka gjetur ende rregullim ligjor.”

³³⁴ Aneksi I – Zbatimi i Konventës së të Drejtave të Fëmijëve nga këndvështrimi i fëmijëve, dhjetor 2008–janar 2009, f. 13.

³³⁵ Rast nga praktika, AiBi.

Rekomandime:

- Marrja e masave legjislative dhe administrative për identifikimin dhe mbështetjen efektive të të gjitha familjeve në nevojë.
- Nxjerrja e akteve nënligjore për vënien në zbatim të institutit të “Familjes Kujdestare”.
- Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe infrastrukturës në lidhje me zbatimin e institutit të “Kujdestarisë institucionale”.
- Duhet të forcohet roli i administratorit social në investigimin e rasteve, marrjen e opinionit të fëmijës, njohjen me nevojat e familjes biologjike dhe bashkëpunimin me të, duke e parë vendosjen e fëmijës në përkujdesje institucionale si alternativën e fundit.
- Kuadri ligjor duhet të parashikojë afate të përcaktuara dhe të shkurtra për kohëzgjatjen e procesit, dokumentacionin dhe rastet emergjente të fëmijëve që vendosen në institucione rezidenciale
- Të merren masa për trajnimin e vazhdueshëm profesional të punonjësve në institucionet rezidenciale, për monitorimin e sjelljes së tyre nga institucionet përgjegjëse dhe ministritë e linjës si dhe për punësimin e personave të kualifikuar në këtë fushë.
- Qëndrimi i fëmijëve në institucione të jetë me afat të caktuar, në rastet kur fëmijët kanë prindër dhe institucionalizohen për shkak të kushteve socialo-ekonomike. Ka patur dhe ka shumë raste kur familjet pasi i institucionalizojnë fëmijët, i ndërpresin marrëdhëniet me ta ose kanë vetëm takime sporadike dhe më pas nuk i pranojnë më në familje.
- Shteti nuk parashikon asnjë formë shërbimi apo ndihme për të rinjtë mbi moshën 15 vjeç, në rastet kur ata janë jetimë biologjikë dhe akoma jetojnë në institucione. Kanë hapësira në ligj për mbështetje dhe lehtësime por në të vërtetë nuk ka asnjë shërbim social që u ofrohet atyre, qoftë edhe nga bashkia me apartamente sociale, apo me kurse profesionale dhe më pas punësim të menjëhershëm, pasi nuk kanë asnjë të ardhur. Kjo kategori të rinjsh ose është pre e keqbërësve dhe e ardhmja e tyre është e tillë, ose në disa raste mbahen për mëshirë në këto institucione me mirëdashjen e titullarëve, por jo në të gjitha rastet. Këta të rinj lihen në mëshirë të fatit, pa u ofruar asnjë alternativë.



Neni 21 - E drejta e interesit më të lartë të fëmijës në procedurat e birësimit

Kodit i Familjes³³⁶ dhe Ligji për Birësimet³³⁷ janë instrumentat ligjorë bazë që rregullojnë Institutin e Birësimit, të cilat përfaqësojnë parimin e birësimit në interesin më të lartë të fëmijës, si në rastin e birësimit

³³⁶ Titulli V, Kodi i Familjes.

³³⁷ Ligji Nr. 9695, datë 19.3.2007, “Për procedurat e birësimit dhe komitetin shqiptar të birësimit”

vendas, edhe në atë ndërvendas.³³⁸

Parlamenti shqiptar ka ratifikuar Konventën e Hagës “Për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit” (29 Maj 1993)³³⁹, Konventën “Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve”³⁴⁰ dhe “Konventën e Hagës për Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve.”³⁴¹

Procedura e birësimit në Shqipëri përfshin procedurën administrative, e cila i paraprin asaj gjyqësore. Procedura administrative e birësimit kryhet nga autoriteti qendror, “Komiteti Shqiptar i Birësimeve,”³⁴² i cili shqyrton dokumentacionin përkatës, vendos për përshtatshmërinë e aplikantit birësues dhe jep pëlqimin për realizimin e çdo birësimi. KSHB dërgon dosjen e birësimit për shqyrtim nga Gjykata në vendbanimin e personit që kërkon të birësojë (në rastin e birësimeve nga shtetas shqiptarë) apo vendbanimin e të të miturit (në rastin e birësimeve nga shtetas të huaj).³⁴³ Në birësimet ndërvendase, KSHB bashkëpunon me autoritetet qendrore të vendeve ku është kryer birësimi, në varësi të shtetësisë dhe vendbanimit të aplikantit.

Kodi i Familjes parashikon në çështjet e birësimit marrjen e mendimit të fëmijës nëse ai ka mbushur moshën 10 vjeç, si dhe pëlqimin (në të kundërt mohimin/veton) e vet fëmijës kur ka mbushur moshën 12 vjeç.³⁴⁴ Kur fëmija është nën moshën 10 vjeç kërkohet pëlqimi i të prindërve dhe kur fëmija nuk ka asnjë nga prindërit është gjykata që vendos për dhënien e pëlqimit. Fëmijëve u është njohur e drejta për këshillim dhe informim mbi pasojat e birësimit dhe të dhënies së mendimit të tyre për birësimin.³⁴⁵ Këshillimi dhe informimi nuk u garantohet prindërve biologjikë,³⁴⁶ megjithatë, ata kanë të drejtë të tërheqin pëlqimin e dhënë brenda 3 muajve. Kuadri ligjor nuk parashikon procedura asistuese për fëmijët me aftësi të kufizuara në marrjen e mendimit dhe pëlqimit të tyre. Kur fëmija është vendosur në institucionin e përkujdesjes, ai mund të shpallet i braktisur dhe si i tillë të jetë i birësueshëm, nëse prindërit e tij në mënyrë të dukshme nuk kanë shfaqur interes përgjatë një viti, ose gjatë tre muajve në rast se fëmija është strehuar nga lindja e tij në institucion.³⁴⁷

³³⁸ Neni 240 i Kodit të Familjes dhe Ligji Nr. 9695, datë 19.3.2007, Neni 2/b “marrjen e masave që birësimet vendase dhe ndërvendase të bëhen në interesin më të lartë të fëmijës, i cili është mbizotërues ndaj çdo interesi tjetër.

³³⁹ Ratifikuar me ligjin Nr 8624, datë 15.06.2000

³⁴⁰ Ratifikuar me ligjin Nr. 9443 datë 16.11.2005

³⁴¹ Ligji Nr. 9446, datë 24.11.2005

³⁴² KSHB është në varësi të Ministrisë të Drejtësisë

³⁴³ 4, Kodi i familjes.

³⁴⁴ Neni 246, Kodi i Familjes, Neni 22/ç Ligji, Nr. 9695, Datë 19.3.2007 “Për procedurat e birësimit dhe komitetin shqiptar të birësimit”

³⁴⁵ Pika 1/a , Neni 15, Ligji Nr. 9695, Datë 19.3.2007 “Për procedurat e birësimit dhe komitetin shqiptar të birësimit”

³⁴⁶ Neni 248 Kodi i Familjes parashikon periudhën e provës deri në 3 muaj për marrëdhëniet midis birësuesit dhe të birësuarit, si dhe parashikon tërheqjen e pëlqimit të dhënë.

³⁴⁷ Neni 250, Kodi i Familjes

Par birësimin surogativ,³⁴⁸ parashikohen të njëjtat kritere dhe procedura si për birësimin normal,³⁴⁹ megjithëse, në praktikë nuk është evidentuar asnjë rast i tillë deri tani. Ligji i jep prioritet birësimit brenda vendit, megjithëse në praktikë janë më të shumta rastet e birësimit ndërvendas. Kështu, nëse gjatë një viti birësohen 28 fëmijë nga këta, 23 birësohen jashtë vendit dhe vetëm 5 fëmijë birësohen brenda vendit.³⁵⁰ Birësimi ndërvendas lejohet vetëm nëse fëmija nuk ka pasur mundësi të birësohet në Shqipëri brenda 6 muajve nga vendosja e tij në listën e birësimit.³⁵¹ Megjithatë, problematike vazhdon të mbetet situata në lidhje me birësimin e fëmijëve duke pasur parasysh se numri i fëmijëve jetimë socialë në institucione është 468 fëmijë.³⁵²

Për birësimet ndërvendase ligji kërkon marrjen e vërtetimeve nga agjencitë ndërmjetësuese se “në vendin e aplikantëve fëmija do të gëzojë të njëjtat të drejta si në Shqipëri” dhe njëkohësisht njohjen e birësimit të plotë.³⁵³ Problematike paraqitet situata ligjore dhe ajo në praktikë në lidhje me procedurat për mënyrën e kalimit të kufirit nga fëmijët kur janë të shoqëruar vetëm nga njëri prind apo nga asnjëri prej tyre pasi, qoftë legjislacioni familjar, qoftë ai për “Për Ruajtjen dhe Kontrollin e Kufirit Shtetëror të Republikës së Shqipërisë”³⁵⁴ nuk rregullojnë këtë procedurë, nuk përcaktojnë masa mbrojtëse ndaj rrëmbimit të fëmijëve si dhe nuk përcaktojnë sanksionet përkatëse. Për periudhën pasbirësuese, Ligji për Birësimet³⁵⁵ parashikon se është KSHB që mbikëqyr periodikisht të gjitha rastet e birësimeve dhe, në rastet e birësimeve ndërvendase, bashkëpunon me autoritetet qendrore të vendeve të tjera ku është kryer birësimi³⁵⁶. Megjithatë, nuk ekzistojnë akte nënligjore të cilat të përcaktojnë saktësisht procedurat që do të ndiqen për monitorimin e periudhës pasbirësuese.

Aleanca për Fëmijët është e shqetësuar par situatën e fëmijëve të vendosur në qendra rezidenciale, të cilët plotësojnë kriteret për t'u birësuar. Megjithëse Komiteti Shqiptar i Birësimeve, si autoritet qendror, bashkëpunon me qendrat e përkujdesjes rezidenciale për të evidentuar shqyrtimin e mundësisë së birësimit të fëmijëve në këto qendra, përsëri evidentohen raste të vonësive të shpalljes së fëmijës si i braktisur duke pasur parasysh edhe se koha e qëndrimit të

³⁴⁸ Neni 43/c, Ligji Nr. 8876, Datë 4.04.2002, “Për Shëndetin riprodhues”.

³⁴⁹ Neni 261, Kodi i Familjes.

³⁵⁰ Bazuar në të dhënat e fundit të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale.

³⁵¹ Neni 28, Ligji Nr. 9695, Datë 19.3.2007 “Për procedurat e birësimit dhe komitetin shqiptar të birësimit” dhe neni 257, Kodi i Familjes

³⁵² Bazuar në të dhënat e fundit të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale.

³⁵³ Kodi i Familjes parashikon në nenin 258, se birësimi është i përvokueshëm.

³⁵⁴ Ligji Nr. 8772, datë 19.4.2001.

³⁵⁵ Pika 3, neni 4 Ligji Nr. 9695, Datë 19.3.2007 “Për procedurat e birësimit dhe komitetin shqiptar të birësimit”.

³⁵⁶ Pas finalizimit të birësimit është detyrë e KSHB të ndjekë përshtatshmërinë e fëmijës në familjen birësuese, e cila shoqërohet me plotësim formularësh të shoqëruar me fotografi nga punonjësit e institucionit apo edhe me vizita të specialiteve të KSHB në shtëpitë e tyre. Kjo është pjesë e takon birësimit vendas. Për birësimin ndërvendas raporti pasbirësues vjen nga agjencia e huaj me të cilën bashkëpunon KSHB në afate të përcaktuara në marrëveshjen dypalëshe . (shih//www.komitetibiresimeve.com).

një fëmijë jetim social në institucionet e përkujdesit, në bazë të legjislacionit është 5 vjet.³⁵⁷ Kjo zgjatje në kohe e procedurave vjen për shkak të neglizhencës së qendrave rezidenciale, moskuptimit të mirë të ligjit nga ato si dhe³⁵⁸ vonesave të procedurave gjyqësore në këtë aspekt. Këto vonesa kushtojnë shumë për jetën, mirëqenien dhe mirërritjen e fëmijëve, sidomos, kur ata janë në fëmijërinë e hershme. Gjithashtu, në praktikë vërehet mungesa e një interpretimi të qartë të konceptit të “mungesës së interesit të dukshëm të prindërve gjatë periudhës një vjeçare apo 3 muajore kur fëmija është vendosur që në lindje në institucion. Punonjësit e qendrave rezidenciale interpretojnë si interes të shfaqur nga prindi edhe vetëm një telefonatë që bën ai apo një i afërmi fëmijës një herë në 6 muaj, apo një herë në vit, duke lënë fëmijën peng të institucionit, duke e privuar atë qoftë nga familja biologjike, qoftë nga familja alternative birësuese. Qendrat rezidenciale e shohin, shpeshherë, jo si detyrë të tyren ekzaminimin e kushteve dhe nisjen e një proces deklarimi braktisjeje në mënyrë që fëmija më pas të futet në listat e birësimit. Ata e konsiderojnë këtë më shumë rol dhe mision të Komitetit Shqiptar të Birësimeve, ndërkohë që me ligj është detyrë e vetë qendrave të përkujdesjes.³⁵⁹ Mungesa e përgjegjësiave dhe procedurave të mirëpërcaktuara ka sjelle që në Shqipëri, të ketë shumë fëmijë të cilët arrijnë moshën madhore si jetimë, të cilët nuk kanë mundur të birësohen.

X është, një fëmijë i lindur jashtë martese në 16.05.94. E ëma e ka braktisur kur ajo ishte 6 muajshe. X është rritur nga daja. Sipas psikologes, fëmija mund të ketë pësuar abuzime (sidoqoftë është një hipotezë që duhet verifikuar). Në këtë periudhë askush nuk interesohet për X. Ndonjëherë, daja i telefonon, por dhe ai ka firmosur një deklaratë ku shprehet për braktisjen e fëmijës.³⁶⁰

Rekomandime:

- Përfshirja në akte nënligjore i interpretimit të konceptit të “interesimit të dukshëm të prindërve”. Parashikimi në to i procedurave të sakta në lidhje me dokumentimin e interesit të shfaqur nga prindi. Ekzaminimi i sjelljes prindërore apo e interesimit të shfaqur nga të afërmi të tjerë në lidhje me interesin më të lartë të fëmijës dhe të drejtës së tij për t’u rritur në një familje
- Amendimi i Ligjit, Nr. 9695, datë 19.3.2007 “Për procedurat e birësimit dhe komitetin shqiptar të birësimit” dhe neni 257 i Kodit të Familjes në lidhje me këshillimin dhe informimin e prindërve biologjike për pasojat e birësimit si dhe asistimi i dhënies së pëlqimit për fëmijët me aftësi të kufizuara.

³⁵⁷ Bazuar në të dhënat e fundit të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale.

³⁵⁸ Informacion nga Bethany Social Services Albania, në grupet e punës ngritur nga “Aleanca për Fëmijët” për hartimin e Raportit Alternativ

³⁵⁹ Aneksin II, Informacion nga strukturat kryesore publike dhe jo publike të përfshira në garantimin e të drejtave të fëmijëve, janar-shkurt 2009, sipas protokollit informativ në qendra rezidenciale për fëmijë.

³⁶⁰ Rast nga praktika, raportuar nga organizata AiBi.

- Plotësimi i akteve nënligjore të cilat të përcaktojnë procedurat për monitorimin e periudhës pasbirësuese.
- Plotësimi i kuadrit ligjor për rritjen e kontrollit kufitar dhe parandalimin e rasteve të rrëmbimit të fëmijëve qoftë nga prindërit, apo persona të tjerë.

Neni 25- E drejta e fëmijës për ekzaminimin periodik të trajtimit.

E drejta për ekzaminim periodik të shërbimeve që u ofrohen fëmijëve (jetimë, të braktisur, me aftësi të kufizuar, viktima të trafikimit) parashikohet në standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale³⁶¹ ku përcaktohet se për çdo fëmijë të vendosur në qendër rezidenciale hartohen plane individuale të kujdesit të cilat duhet të disenjohen nga grupe multidisiplinare duke respektuar edhe mendimin e fëmijëve mbi 14 vjeç. Rishikimi-ekzaminimi periodik i planit të kujdesit (shëndetësor, arsimor, formim profesional, rikthimi në familjen biologjike, jetesë e pavarur) realizohet çdo muaj për fëmijët viktima të trafikimit,³⁶² brenda një periudhe kohore 6 mujore³⁶³ për fëmijët e braktisur dhe jetimë, ndërsa për rastet e fëmijëve me aftësi të kufizuar³⁶⁴ standardet referojnë si periudhë rishikimi çdo vit, megjithatë problematike mbetet mosnxjerrja ende e akteve nënligjore për standardizimin e shërbimeve që do të ofrohen për fëmijët që do të vendosen në “Familje kujdestare.”³⁶⁵ Hartimi i akteve nënligjore, në këtë aspekt, duhet të kenë në vëmendje edhe ekzaminimin periodik të shërbimeve që do t’i ofrohen fëmijëve nga kjo formë alternative përkujdesjeje. Por pavarësisht se standardet garantojnë rishikimin e situatës së fëmijës në lidhje me nevojat e ndryshme që ai paraqet, ende roli i kontrollit dhe ndjekjes të këtyre rasteve nuk është përcaktuar taksativisht nga ligji. Me ngritjen e Inspektoratit të Shërbimeve Sociale,³⁶⁶ programi i kontrollit të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore identifikohet me rolin e një kontrolli të mirëfilltë administrativ duke e kufizuar plotësimin e standardeve

³⁶¹ VKM Nr. 659 Datë 17.10.2005 “Standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale”

³⁶² Vendim Nr. 195, Datë 11.4.2007 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, në qendrat rezidenciale, për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi”

³⁶³ VKM Nr. 659 Datë 17.10.2005 “Standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale” plani i vepërimit pika 2 “Përcaktimi i formave dhe nivelit të pjesëmarrjes së përfrituesve/familjarëve në hartimin, zbatimin dhe rishikimin periodik të programeve individuale” dhe Udhëzim Nr. 830, Datë 14.4.2008 “Për zbatimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale publike dhe jopublike”

Vendim Nr. 195, Datë 11.4.2007 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, në qendrat rezidenciale, për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi”

³⁶⁴ Vendim Nr. 822, Datë 6.12.2006 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuar, në qendrat rezidenciale dhe ditore”

³⁶⁵ VKM Nr. 1104 Datë 30.07.2008 “Dokumenti i politikave për kujdestarinë e fëmijëve në nevojë”

³⁶⁶ VKM Nr. 542, datë 27.7. 2005 “Për miratimin e statutit të shërbimit social shtetëror”; VKM nr. 512 datë 31.05.2006 “Për procedurat e kryerjes së kontrollit të ndihmës ekonomike, pagesës së aftësisë të kufizuar dhe shërbimet shoqërore”

në terma të përgjithshëm, pa u ndalur veçanërisht në kontrollin dhe ekzaminimin e periodik të trajtimit të fëmijës/ve³⁶⁷ për shërbime shtese apo për të ndryshuar totalisht llojin e përkujdesjes apo dhe vetë institucionin. Në lidhje me rishikimin periodik, me qëllim zbatimin e parashikimeve ligjore në lidhje me futjen e fëmijëve në listën për birësim,³⁶⁸ në praktikë rezultojnë se institucionet e përkujdesjes nuk zbatojnë me korrektësi këto afate ligjore. Po kështu, problem është evidentimi i interesit të prindërve apo e të afërmeve, i cili edhe kur është minimal, psh. thjesht një telefonatë, interpretohet nga institucioni si interesim, gjë që rezultojnë në qëndrimin pafund të fëmijëve në institucione. Ligji parashikon, gjithashtu, se institucionet e përkujdesjes dhe sektori i shërbimit social duhet të raportojnë një herë në 6 muaj në Komitetin Shqiptar të Birësimeve (KSHB) në lidhje me afatet dhe arsyet e qëndrimit të fëmijëve në institucionet e tyre.³⁶⁹ Po kështu, KSHB ka të drejtë të ushtrojë kontrolle të vazhdueshme në këto institucione dhe në rast të identifikimit të shkeljeve të kërkojë marrjen e masave disiplinore apo heqjen e licencës në rast se institucioni është privat.³⁷⁰ Problematike shfaqen procedurat e zgjatura gjyqësore në lidhje me deklarimin e braktisjes, e cila varion nga 3-6 muaj. Ligji nuk parashikon afate të posaçme me qëllim që të garantojë kohëqëndrimin sa më të shkurtër të fëmijës në institucion nëse ai përmbush kriteret për të qenë i birësueshëm.

Për fëmijët e vendosur në institucione paraburgimi, rregullorja përkatëse parashikon vlerësimin fillestar të nevojave nga sektori i edukimit mbi bazën e të cilit ndërtohet edhe plani individual, por nuk parashikon rishikimin periodik të tij,³⁷¹ ndërsa për sa i përket shërbimeve bazë, si psh. shërbimi shëndetësor sigurohet në mënyrë të vazhdueshme pa përfshirë programe preventive³⁷², dhe rishikimin periodik mjekësor. Ky shërbim realizohet mbi bazën e kërkesave të paraburgosurve. Megjithatë, Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve, e miratuar së fundmi, ka bërë një hap pozitiv duke parashikuar që shërbimi shëndetësor pranë burgjeve, në mënyrë periodike ushtron kryesisht kontrolle mjekësore për të parë gjendjen e përgjithshme të të burgosurve dhe, veçanërisht, atë psikike.³⁷³

Aleanca përgëzon Qeverinë Shqiptare për hartimin standardeve dhe përpjekjeve për të rregulluar ekzaminimin periodik të shërbimeve për fëmijët e vendosur në qendrat rezidenciale, megjithatë rekomandon që qeveria të fillojë zbatimin e kësaj forme përkujdesjeje alternative duke buxhetuar shërbimet përkatëse. Ndërkohe, institucionet e përkujdesjes duhet të kenë fleksibilitet financiar për të pasur mundësi të referojnë për shërbime fëmijët të cilët

³⁶⁷ Kreu III Procedurat e kontrollit të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore 2. Inspektorati i Ndihmës Ekonomike, *Pagesës për Persona me Afësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore kontrollojnë: a) plotësimin e standardeve të shërbimit, sipas legjislacionit në fuqi;*

³⁶⁸ Neni 250, Kodi i Familjes përcakton se fëmijët në institucione të përkujdesjes sociale deklarohen të braktisur kur prindërit në mënyrë të dukshme nuk kanë treguar interes për ta gjatë një viti, apo 3 muajve kur ata janë strehuar në institucion që nga lindja.

³⁶⁹ Neni 8, pika 1 (i) dhe (ii), Ligji Nr. 9695, Datë 19.3.2007, “Për procedurat e birësimeve dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”

³⁷⁰ Neni 8, pika 2, Ligji Nr. 9695, Datë 19.3.2007, “Për procedurat e birësimeve dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”

³⁷¹ Neni 58, Urdhër Nr. 3705/1, Datë 11.05.2006 “Për miratimin e Rregullores së Paraburgimit”.

³⁷² Neni 22-23, Urdhër Nr. 3705/1, Datë 11.05.2006 “Për miratimin e rregullores së paraburgimit”.

³⁷³ Neni 32, VKM Nr. 303, Datë 25.03.2009, Për miratimin e rregullores së përgjithshme të burgjeve.

kanë nevojë, nëse kjo rezulton nga ekzaminimi periodik si psh. mbulimi i vizitave mjekësore, terapeutike etj. Gjithashtu, shqetësim përbën kohëzgjatja e procedurave gjyqësore, për të cilën është e nevojshme të ketë një vëmendje më të posaçme nga ana e legjislatorit dhe e vetë administratës së gjykatave, e cila duhet t'i trajtojë çështjet e të miturve si çështje me përparësi. Aleanca do të theksojë, gjithashtu, se koncepti i ekzaminimit periodik duhet të zhvillohet si në aspektin ligjor dhe atë të zbatimit në praktikë për sa i përket fëmijëve të mbajtur në institucionet e paraburgimit dhe burgimit. Nga Raporti Monitorues i Komitetit Shqiptar të Helsinkit (më tej KSHH) rezulton se, pavarësisht nga prania e mjekëve në institucion, shprehen se në shumicën e rasteve mjeku nuk ofronte kontrolle periodike, por vetëm kur kishin dhimbje të mëdha. Pjesën më të madhe të problemeve shëndetësore institucioni i zgjidh në spitalin civil të qytetit ku ndodhet institucioni. Më problematike për kontrollin mjekësor të të miturve paraqitej situata në Lezhë ku të miturit ishin kontrolluar nga mjeku vetëm herën e parë kur ata kishin mbërritur në këtë institucion, çka bie në kundërshtim me ligjin,³⁷⁴ “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve” dhe me rregulloret përkatëse të këtyre institucioneve. Gjatë monitorimeve KSHH konstatoi një të mitur M.V. në seksionin e të miturve, IEVP Shënkoll Lezhë, se shfaqte çrregullime mendore, për të cilin nuk ishte marrë asnjë masë.³⁷⁵

Rekomandime:

- Marrja e masave për vënien në zbatim të institutit të “Familjes kujdestare” duke buxhetuar shërbimet përkatëse.
- Kuadri ligjor duhet të parashikojë taksativisht kontrollin dhe ndjekjen e ekzaminimit periodik të trajtimit të fëmijës/ve për shërbime shtesë apo për të ndryshuar totalisht llojin e shërbimit të përkuqjesjes apo dhe vetë institucionin.
- Plotësimi i legjislacionit familjar në lidhje me parashikimin e afateve të shkurtra për çështjet e deklarimit të braktisur të fëmijëve apo të birësimit.
- Plotësimi dhe harmonizimi i Rregulloreve të Paraburgimit me standardet që vendos neni 25 i KDF për rishikim periodik, si dhe me Rregulloren e Përgjithshme të Burjeve të miratuar në mars 2009.



Neni 27 (4) – E drejta e fëmijës për një nivel jetese të mjaftueshëm

³⁷⁴ Ligjit Nr. 8238, Datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve”, të ndryshuar ku thuhet se ...shërbimi mjekësor sigurohet gjatë të gjithë kohës së qëndrimit në institucion, pavarësisht nga kërkesat e të dënuarve...

³⁷⁵ Aneksi III – Raport monitorues mbi zbatimin e të drejtave të fëmijëve në ambientet e paraburgimit dhe burgut, kryer nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, janar–mars 2009, f. 7.

Kuadri ligjor, Shqiptar garanton të drejtën e fëmijëve për pension ushqimor nga prindërit e tyre apo nga persona të tjerë përgjegjës për ta.³⁷⁶ Gjithashtu, dispozitat penale e klasifikojnë si kundravajtje penale mosdhënien e mjeteve të nevojshme për jetesën e fëmijëve në përmbushje të vendimit gjyqësor të formës së prerë.³⁷⁷ Pavarësisht nga garancitë ligjore që mbart legjislacioni shqiptar, problematike mbetet ende përcaktimi i vlerës së pensionit ushqimor nga gjykata dhe ekzekutimi i këtyre vendimeve në praktikë.³⁷⁸ Gjithashtu, kuadri ligjor nuk parashikon rishikim të vendimeve gjyqësore në lidhje me pensionin ushqimor në ato raste kur kushtet/nevojat e fëmijës kanë ndryshuar dhe, po ashtu, dhe ato të prindit/prindërve. Nga ana tjetër, problematike mbetet mosekzekutimi i vendimeve të gjykatave për pension ushqimor në rastet kur prindi debitor ndodhet jashtë Shqipërisë.³⁷⁹ Për më tepër, shteti shqiptar nuk ka aderuar apo përfunduar ndonjë marrëveshje ndërkombëtare me ndonjë shtet tjetër (apo me shtetet ku më së shumti kanë emigruar shqiptarët) për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

Aleanca e Fëmijëve është e shqetësuar, në mënyrë të veçantë, për marrjen e pensionit ushqimor të fëmijës nga prindërit e tyre. Ky shqetësim lidhet si me Gjykatën, e cila ndeshet me vështirësi në caktimin e pensionit ushqimor,

³⁷⁶ Neni 161 dhe Titulli III, neni 192- e në vijim, Kodi i familjes; neni 317 Kodi Procedurës Civile- vënia në ekzekutim të përkohshëm deri në marrjen e vendimit të gjykatës formë e prerë.

³⁷⁷ Neni 125, Kodi Penal.


³⁷⁸ Në “Studimin mbi nevojat e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve” për zbatimin e dispozitave të Kodit të Familjes sipas standardeve të të drejtave të fëmijës (KDF), pothuajse të gjithë gjyqtarët e intervistuar konsiderojnë si problemin më të “zakonshëm” të praktikës së tyre - përcaktimin në vlerë minimale të pensionit ushqimor ndaj fëmijës apo në rastet me ekstreme mosekzekutimin/pagesën e këtij detyrimit ushqimor nga prindi që nuk i është besuar fëmija për rritje dhe edukim. Gjyqtarët eidentojnë **vështirësi në përcaktimin e detyrimit ushqimor** në përputhje me nevojat e fëmijës për shkak të mungesës së të dhënave mbi të ardhurat reale të prindërve/prindit që nuk i është besuar fëmija – punojnë në të zeze, figurojnë të papunë, fshehin të ardhurat në banka jashtë vendit, janë me ndihmë ekonomike, njeri prind është jashtë etj. Kjo lidhet edhe me mungesën e informacionit nga ana e institucioneve shtetërore siç janë Zyra e Punës në Bashki apo Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, etj. Për shkak të këtyre vështirësive, praktika më e ndjekur nga gjyqtarët është ajo e përcaktimit të pensionit ushqimor duke i'u referuar minimumit jetik (përgjysmë) dhe zakonisht vlera e detyrimit ushqimor në shumicën e rasteve varion nga **3000-5000 lekë**, që është absolutisht e pamjaftueshme për mirërritjen/edukimin e një fëmijë sipas standardeve minimale. Mjaft të rralla janë rastet kur gjyqtaret marrin parasysh vetëm nevojat e fëmijës dhe zhvillimit normal të tij dhe vendosin detyrimin ushqimor pavarësisht gjendjes ekonomike të prindit apo i referohen nenit 196 të KF. Tjetër problem që ka dalë nga praktika gjyqësore ka të bëjë me mosndryshimin e masës së detyrimit ushqimor kur kushtet/nevojat e fëmijës kanë ndryshuar dhe, po ashtu, dhe ato të prindit/prindërve.

³⁷⁹ Informacione marrë nga përfaqësues të Zyrës së Përmbarrimit Tiranë, mars 2009. Në shumicën e rasteve vendimi që cakton detyrimin për ushqim mbetet i paekzekutuar vullnetarisht apo me anë të ekzekutimit të detyruar nëpërmjet Zyrës së Përmbarrimit për shkak të mungesës së të ardhurave apo pasurisë së prindit të detyruar. Ka shumë raste ku prindi (zakonisht babai) ndodhen jashtë Shqipërisë dhe Zyra jonë nuk disponon asnjë mjet ligjor dhe infrastrukturor për ekzekutimin e të tilla vendimeve. Në shumicën e rasteve vendimi që cakton detyrimin për ushqim mbetet i paekzekutuar vullnetarisht apo me anë të ekzekutimit të detyruar nëpërmjet Zyrës së Përmbarrimit për shkak të mungesës së të ardhurave apo pasurisë së prindit të detyruar (në raste mjaft të rralla Zyra e Përmbarrimit ndërhyr në tjetërsimin e pasurive të prindit që nuk i është besuar fëmija).

kjo për shkak të informalitetit, mosdeklarimit apo fshehjes të të ardhurave të prindërve dhe moskoordinimi i mirë i informacionit midis institucioneve përgjegjëse. Nga ana tjetër, dispozitat ligjore nuk garantojnë rishikimin e vendimeve të gjykatave për pension ushqimor në rast të ndryshimit të kushteve të jetesës të fëmijës/ve apo prindërit/ve. Nga ana tjetër, ekzekutimi i vendimeve gjyqësore ndeshet me një sërë vështirësish serioze si ligjore dhe në infrastrukturë për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore si brenda vendit dhe jashtë tij. Zyrat e Përmbartimit ndeshin, në mënyrë të veçantë, vështirësi për ekzekutimin e vendimeve kur prindi debitor jeton apo punon jashtë shtetit shqiptar. Ende nuk është ndërmarrë iniciativa për lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërkombëtar mes shteteve për ekzekutimin e këtyre vendimeve.

Rekomandime:

- Shteti Shqiptar, duhet të marrë masa për mirë-koordinimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet institucioneve përgjegjëse për përcaktimin e pensionit ushqimor në përputhje me nevojat dhe interesin më të lartë të fëmijëve.
- Kuadri ligjor duhet të parashikojë rishikimin e vendimeve gjyqësore për pension ushqimor në përputhje me ndryshimin e nevojave të fëmijës/ve apo prindërit/ve.
- Shteti shqiptar duhet të marrë masa efektive për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për pension ushqimor.
- Shteti Shqiptar duhet të ndërmarrë nisma për lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me shtete të tjera për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të pensionit ushqimor.





VII. SHËNDETI BAZË DHE MIRËQENIA

(23, 24, 26, 27 para. 1-3)

Neni 23 - Të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuar

Të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuar garantojnë nga kushtetuta shqiptare nën termin e përgjithshëm fëmijë³⁸⁰ dhe kuadrin të objektivave sociale pa e përcaktuar specifikisht këtë kategori.³⁸¹ Gjithashtu, shteti shqiptar, ende nuk ka ratifikuar “Konventën e OKB për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar” (13 dhjetor 2006).

Mosdiskriminimi për fëmijët me aftësi të kufizuar garantohej nga dispozitat e Kushtetutës brenda konceptit të gjendjes sociale,³⁸² por në këtë aspekt ende mbetet problematike mungesa e miratimit të një ligji anti-diskriminues, si për fëmijët me aftësi të kufizuar, por edhe për kategorinë e personave me aftësi të kufizuar në tërësi.³⁸³ Nga ana tjetër, mungon një mekanizëm i pavarur ankimes për fëmijët me aftësi të kufizuar për shqyrtimin e rasteve të diskriminimit.³⁸⁴

Në kuadrin e garantimit të të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuar, Qeveria Shqiptare, ka miratuar “Strategjinë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuar”,³⁸⁵ (përmbajtja e të cilës nuk është publikuar në Fletoren Zyrtare Nr. 2, datë 18.01.2005) si dhe është ngritur “Këshilli Kombëtar i Personave me Aftësi të Kufizuar.”³⁸⁶ Problematike në lidhje me këtë dokument vazhdon të mbetet moszbatimi në praktikë i objektivave

³⁸⁰ Neni 54 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

³⁸¹ Kushtetuta e RSh Kreu V “objektivat sociale” neni 59 1. Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon:c) standardin më të lartë shëndetësor, fizik e mendor, të mundshëm; ç) arsimimin dhe kualifikimin sipas aftësive të fëmijëve dhe të të rinjve, si dhe të personave të pazënë me punë; e) përkujdesjen dhe ndihmën për të moshuarit, jetimët dhe invalidët; f) riaftësimin shëndetësor, edukimin e specializuar dhe integrimin në shoqëri të të paaftëve, si dhe përmirësimin në vazhdimësi të kushteve të tyre të jetesës;

³⁸² Neni 18/2 Kushtetuta e RSh “2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore”.

³⁸³ Takimet me shoqërinë civile referojnë për ndërmarrjen e një iniciative në këtë fushë nga “Grupi Shqiptar i të drejtave të njeriut” dhe depozitimin e këtij draft ligji në Parlamentin Shqiptar.

³⁸⁴ Nën-Seksioni i Fëmijëve pranë Avokatit të Popullit (ngritur në kuadër të një projekti 3 vjeçar mbështetur nga Save children dhe SIDA) kishte mandatin e identifikimit dhe shqyrtimit të ankesa për fëmijët edhe në këtë fushë.

³⁸⁵ VKM Nr. 8, Datë 7.01.2005 “Për miratimin e Strategjisë kombëtare të personave me aftësi të kufizuar”

³⁸⁶ Ngritur me Urdhrin e Kryeministrit nr. 196 datë 12.12.2005. Ky këshill qeveritar ka funksion monitorimin dhe koordinimin e çështjes së aftësisë të kufizuar dhe është nën drejtimin e Zv. Kryeministrit të Shqipërisë, me pjesëmarrjen e Ministrit të Punës dhe

dhe masave të parashikuara nga kjo strategji.³⁸⁷

Kuadri ligjor shqiptar ofron një pagesë mujore në ndihmë të fëmijëve me aftësi të kufizuara,³⁸⁸ si dhe ofrimin e kujdestarit me pagesë³⁸⁹ vetëm për kategoritë e fëmijëve me diagnoza të rënda (grupi i parë i invaliditetit). Në këtë aspekt, kuadri ligjor shqiptar nuk garanton të njëjtat mundësi për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara duke mos parashikuara ofrimin e kësaj ndihme financiare për kategorinë e fëmijëve me aftësi të kufizuara në dëgjim dhe në të folur.³⁹⁰ Në këtë mënyrë, shteti shqiptar duhet të hartojë një ligj gjithëpërfshirës për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara, për t'i kushtuar ndër të tjera një vëmendje të veçantë fëmijëve në përmbushje të nevojave shëndetësore, arsimore, kulturore, mbështetjes financiare apo asistimit me kujdestar, për të shmangur, në këtë mënyrë, pabarazinë që gjeneron edhe vetë legjislacioni ndërmjet kategorive të ndryshme të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Gjithashtu, problematike paraqiten rastet e familjeve me 2, 3 deri 4 fëmijë me aftësi të kufizuara në përbërjen e tyre. Për këto raste kuadri ligjor parashikon pagesën vetëm për një (1) kujdestar,³⁹¹ (i cili përgjithësisht është nëna e fëmijëve me aftësi të kufizuara) duke shkelur në këtë mënyrë një nga të drejtat themelore të fëmijës me aftësi të kufizuara, të drejtën për të patur kujdestarin/asistentin e tij personal. Gjithashtu, mungojnë masat si ligjore apo administrative, si në nivel qendror apo vendor për të ofruar ndihmë financiare, këshillim praktik apo trajnim prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara, apo vlerësimin e tyre, nëse kanë kapacitetin e nevojshëm për t'u kujdesur ose për të asistuar fëmijët me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, nga intervistat rezultoi se strukturat shtetërore nuk garantojnë trajtim të veçantë mjekësor për të cilin ata kanë nevojë. Nga pohimet e fëmijëve dhe prindërve të tyre, vizitat mjekësore dhe kurat e vazhdueshme kryen me shpenzimet e vetë familjes, të cilat nuk janë të mjaftueshme. Për personat me probleme fizike, nuk ekzistojnë as ambiente të veçanta ku ata mund të ushtrohen pa paguar para.³⁹²

Ndërkohë, kuadri ligjor vazhdon të mbetet problematik në fushën e vlerësimit të fëmijëve me aftësi të

Çështjeve Sociale, Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ministri i Shëndetësisë, Ministri i Drejtësisë, Ministri i Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Ministri i Brendshëm dhe me pjesëmarrjen e 5 OJF-ve Kombëtare të Aftësisë së Kufizuar (Shoqata Kombëtare e Invalidëve të Punës së Shqipërisë; Shoqata Kombëtare e të Verbërve të Shqipërisë; Shoqata Kombëtare e Personave para dhe tetraplegjik të Shqipërisë; Shoqata Kombëtare e Handikapëve Mendor të Shqipërisë dhe Shoqata Kombëtare e personave që nuk dëgjojnë dhe nuk flasin)

³⁸⁷ FSHDPAK- USAID “Monitorimit- Zbatimit të Planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare të personave me aftësi të kufizuara” 2007

³⁸⁸ Neni 7 Ligji 9355 datë 10.03.2005 “Për ndihmë dhe shërbime shoqërore” - pagesa mujore është 8700 lek

³⁸⁹ Neni 8 Ligji 9355 datë 10.03.2005 “Për ndihmë dhe shërbime shoqërore” - pagesa mujore e kujdestarit është 9200 lek

³⁹⁰ Urdhër nr. 362 datë 26.02.2007 “Për miratimin e rregullores për kriteret mjekësore të vlerësimit të aftësisë të kufizuar” - Pagesa mujore për këtë kategori fëmijësh jepet deri në moshën 7 vjeç. Pas kësaj moshe në rast se fëmija nuk paraqet ndonjë diagnozë tjetër i humbet e drejta për të përfituar pagesën mujore

³⁹¹ Neni 8 ligji 9355-Pagesa e kujdestarit në këtë rast është 150% e masës bazë të pagesës së kujdestarisë (9200 lek) pa marrë parasysh faktin se në familje ka 2-3 deri në 4 fëmijë me aftësi të kufizuara.

³⁹² Aneksi – I, Zbatimi i Konventës për të drejtat e fëmijëve analizuar nga këndvështrimi i fëmijëve, dhjetor 2008- janar 2009, f. 7.

kufizuar KMCAP.³⁹³ Komisionet e vlerësimit përbëhen vetëm nga staf mjekësor dhe nga ana tjetër nuk është ngritur një strukturë e specializuar për vlerësimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar (komisionimi i fëmijëve me aftësi të kufizuar realizohet nga i njëjti komision që vlerëson edhe madhorët me aftësi të kufizuar). Gjithashtu, vendimarrja e KMCAP bazohet tërësisht në modelin mjekësor,³⁹⁴ duke përcaktuar vetëm diagnozën dhe nivelin e humbjes së aftësisë për punë, pa marrë parasysh kushtet në të cilat jetojnë fëmijët me aftësi të kufizuar, nevojat e tyre specifike për t'u pajisur me mjete lëvizëse-rehabilituese (karrige me rrota), nevojën për kujdestar-asistent dhe për terapi fizike, të foluri apo okupacionale, nevojën për gjithëpërfshirje në shkollë, formim profesional dhe punësim, apo për aktivitete argëtuese dhe kohën e lirë. Në këtë kuadër, shteti shqiptar duhet të reformojë procesin e vlerësimit dhe komisionimit të fëmijëve me aftësi të kufizuar duke synuar drejt ngritjes së grupeve multidisiplinare të vlerësimit, bazuar në modelin biopsikosocial dhe manualin e ICF me qëllim vlerësimin e nevojave specifike për çdo fëmijë me aftësi të kufizuar.

Kuadri ligjor shqiptar garanton ofrimin e shërbimeve shëndetësore, shërbimeve shoqërore, arsimimin, kohën e lirë, formimin profesional dhe punësimin për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuar në baza të barabarta me fëmijët e tjerë.

Në fushën shëndetësore, kuadri ligjor garanton ofrimin falas të kujdesit dhe shërbimeve shëndetësore publike për kategorinë e fëmijëve deri në 18 vjeç si dhe rimbursimin e disa prej ekzaminimeve mjekësore.³⁹⁵ Por në këtë aspekt, problematike paraqitet cilësia e shërbimit publik që ofrohet nga qendrat shëndetësore, dentare, spitalore, ndërkohë që sistemi i sigurimeve shëndetësore nuk rimbursion shërbimet shëndetësore të ofruara nga operatorët privatë ku edhe shërbimi i ofruar është në nivel më të lartë cilësor.

Në fushën e shërbimeve shoqërore, kuadri ligjor ka decentralizuar dhe standardizuar ofrimin e shërbimeve të ofruara nga qendrat ditore dhe rezidenciale,³⁹⁶ por problematike në këtë aspekt mbetet mungesa e infrastrukturës dhe numrit të pamjaftueshëm të qendrave ditore apo shërbimeve komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuar.

Në fushën e arsimit, kuadri ligjor parashikon ofrimin e një ndihme të veçantë për të nxitur arsimimin e

³⁹³ Vlerësimi i fëmijëve me aftësi të kufizuar realizohet nga "Komisioni mjekësor i caktimit të aftësisë për punë- KMCAP" bazuar në Rregulloren datë 30.05.2005 "Për organizmin, të drejtat, detyrat dhe funksionimin e Komisioni mjekësor i caktimit të aftësisë për punë" organ i cili komisionon personat me aftësi të kufizuar pa bërë ndarje apo specifikime në bazë të moshës.

³⁹⁴ Studimi FSHDPK "Studimi i kuadrit ligjor mbi vlerësimin dhe komisionimin e aftësisë të kufizuar" (dhjetor 2008).

³⁹⁵ Ligji nr. 7870 datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore", Vendim Nr. 383, datë 19.6.2004 "Për miratimin e procedurave, tarifave dhe masën e mbulimit të shërbimeve ekzaminuese unike, terciare, të përfshira në sigurimin shëndetësor"

³⁹⁶ Vendim Nr. 822, datë 6.12.2006 "Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuar, në qendrat rezidenciale dhe ditore"; VKM Nr. 637, datë 30.9.2004 "Për miratimin e dokumentit të politikave të decentralizimit në fushën e ndihmës ekonomike dhe të shërbimeve të përkujdesit shoqëror"; VKM Nr. 563, datë 12.8.2005 "Për respektimin e përgjegjësisë të qarkut në shpërndarjen e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore"

fëmijëve me aftësi të kufizuar.³⁹⁷ Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon arsimin e integruar³⁹⁸ për fëmijët me aftësi të kufizuar, por problematike mbetet moszbatimi në praktikë i kësaj të drejte. Për kategorinë e fëmijëve me probleme fizike, problematike mbeten barrierat arkitektonike në ndërtesat arsimore, çka e bëjnë të pamundur përfshirjen në arsimim të kësaj kategorie fëmijësh, ku pjesa më e madhe e tyre qëndrojnë të mbyllur në shtëpi dhe të paarsimuar për një kohë të gjatë. Ky fenomen, në mënyrë të veçantë, është ndeshur në zonat rurale, por pa lënë mbrapa edhe zonat urbane (periferitë e qyteteve të mëdha).

Gjithashtu, problematike paraqitet arsimimi parauniversitar i fëmijëve me aftësi të kufizuar mendore dhe me aftësi të kufizuar në dëgjim dhe në të folur. Kuadri ligjor garanton ofrimin e arsimimit për këto kategori deri në sistemin 9 vjeçar. Kjo sjell si domosdoshmëri rishikimin, në tërësi, të akteve ligjore që parashikojnë arsimin gjithëpërfshirës dhe në baza të barabarta si për fëmijët me aftësi të kufizuar, dhe për ata pa aftësi të kufizuar, si dhe miratimin e kurrikulës arsimore gjithëpërfshirëse. Në të njëjtën problematikë paraqiten edhe fëmijët me probleme në dëgjim në lidhje me mos standardizimin ende të gjuhës së shenjave nga shteti shqiptar, çka e bën deficituar arsimimin e tyre.

Kuadri ligjor nuk referon specifikisht masa për mbrojtjen e fëmijëve me aftësi të kufizuar në ambientet familjare, apo ato në komunitet, duke e trajtuar këtë kategori nën kuadrin e përgjithshëm të termit fëmijë apo të personave me aftësi të kufizuar.³⁹⁹ Në këtë aspekt, akte nënligjore specifike duhet të miratohen për të garantuar mbrojtjen e fëmijës me aftësi të kufizuar nga dhuna në familje dhe komunitet, si dhe të rrisë ndërgjegjësimin në lidhje me shfaqjen e kësaj forme dhune.

Aleanca e Fëmijëve është e shqetësuar dhe do të tërheqë në mënyrë të veçantë vëmendjen për problematikat në kuadrin ligjor dhe moszbatimin në praktikë të të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuar.

Aleanca është e shqetësuar për stigmën dhe diskriminimin ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuar, mospjesëmarrjen e tyre në baza të barabarta me fëmijët e tjerë në aktivitetet edukative, trajnuese, formim profesional, aktivitetet kreative apo kohën e lirë, për shkak të barrierave arkitektonike dhe kapaciteteve të pamjaftueshme financiare dhe njerëzore në sigurimin e këtyre të drejtave.

Mungesën e shërbimeve shoqërore dhe ofrimin e tyre në përputhje me nevojat që paraqet fëmija me aftësi të kufizuar në çdo etapë dhe aspekt të jetës së tij të përditshme.

Aleanca kërkon, gjithashtu, të theksojë situatën problematike që hasin familjet me më shumë se 1 fëmijë me aftësi

³⁹⁷ Udhëzim nr. 2472 datë 06.12.2006 “për përcaktimin e kriterëve dokumentacionit dhe masës së përfutimit të pagesës të personave me aftësi të kufizuar” - ofrimin e dyfishit të pagesës së aftësisë të kufizuar (aktualisht kjo pagesë është në nivelin e 8700 lek në muaj) kur fëmija ndjek arsimin parauniversitar dhe trefishin e pagesës së aftësisë të kufizuar kur fëmija ndjek arsimimin universitar

³⁹⁸ Dispozitat normative “Arsimimi i nxënësve me nevoja të veçanta” ligji nr. 7952 datë 21.06.1995 “Për sistemin arsimor”

³⁹⁹ Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006; neni 1/2- Qëllimi “ky ligj ka për qëllim 2. garantimin e mbrojtjes me masa ligjore të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimë të dhunës në familje, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuar”.

të kufizuar në familje dhe mungesën e ofrimit të shërbimeve specifike mbështetëse (financiare apo këshilluese/ trajnuese) për prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Aleanca e konstaton shumë problematike ushtrimin e të drejtës për arsimim të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe, në mënyrë të veçantë, për fëmijët në zonat rurale, të cilët janë tërësisht të izoluar. Papërshtatshmëria e ambienteve shkollore, mungesa e infrastrukturës si në aspektin e numrit të pamjaftueshëm të mësuesve dhe mungesës së trajnimeve, si dhe mungesa e kurrikulës⁴⁰⁰ së përshtatshme arsimore e bën garantimin e të drejtës për arsimim për fëmijët me aftësi të kufizuara shumë problematike.

Aleanca konstaton problematike zbatimin dhe nxitjen në praktikë të kohës së lirë, formimit profesional dhe përgatitjes për punësim të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Problematika të tilla kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme me masa ligjore dhe administrative.

Familja x është një familje tiranase autoktone që i ka dy fëmijët me aftësi të kufizuara mendore të rëndë: J 30 vjeç dhe O 28 vjeç. Nëna është me AK fizike, babai ka probleme të aftësisë së kufizuar. Problematika e kësaj familje filloi që kur të dy fëmijët lindën dhe mjekët i diagnostikuan me probleme. Para viteve '90 nëna e këtyre fëmijëve punonte me orar të pjesshëm si kuzhinierë dhe babai si roje. Me ndryshimin e sistemit në Shqipëri ata mbeten pa punë dhe të ardhurat e tyre janë vetëm dy ndihma ekonomike dhe një kujdestari (gjithsej 26100 lek), të ardhura këto që janë fare minimale, sepse njëri nga fëmijët nuk mund të kontrollojë nevojat personale. Me këto të ardhura mujore kjo familje duhet të plotësojë nevojat fiziologjike (të ushqehet, vishet, të kujdeset për një shtëpi të ngrohtë) si dhe të paguajë taksat, ujin dhe energjinë elektrike. Nga diagnoza që kanë fëmijët e kësaj familje nuk mund të përfitojnë as ulje për faturat e energjisë, apo ulje të taksave. I vetmi shërbim që merr kjo familje është shërbimi komunitar që i ofron shoqata.⁴⁰¹



Rekomandime:

- Shteti Shqiptar duhet të ratifikojë “Konventën e OKB për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.”
- Hartimi i një ligji gjithëpërfshirës për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara, me një vëmendje të veçantë të fëmijët me aftësi të kufizuara.

⁴⁰⁰ Sipas Aneks II – Informacion nga strukturat kryesore publike dhe jo publike të përfshira në garantimin e të drejtave të fëmijëve, janar–shkurt 2009, Protokoll Informativ nga Drejtoritë Arsimore Rajonale.

⁴⁰¹ Rast i raportuar nga shoqata: “Ndihmoni jetën”.



- Miratimi i ligjit mosdiskriminues dhe ngritja e një autoriteti ankimues të pavarur për shqyrtimin e rasteve të diskriminimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara.
- Reformimi i sistemit të vlerësimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, duke u bazuar në modelin biopsiko-social dhe ICF-klasifikimi ndërkombëtar i aftësisë të kufizuara.
- Ofrimi i mbështetjes financiare dhe praktike për prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara, dhe duke patur një vëmendje të veçantë për familjet me më shumë se një fëmijë me aftësi të kufizuara.
- Garantimi i të drejtës për arsimim gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara.
- Fuqizimi dhe ngritja e kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve ditore dhe komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara.
- Marrjen e masave specifike për mbrojtjen dhe ndërgjegjësimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara nga dhuna në ambientet familjare dhe në komunitet.

Neni 24 – E drejta e fëmijës ndaj shëndetit dhe shërbimeve të shëndetit

Kushtetuta e RSh⁴⁰² përcakton se *shtetasit* gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtën për kujdes shëndetësor nga shteti, pa asnjë lloj diskriminimi, pa përcaktuar në mënyrë specifike të drejtën e fëmijës ndaj shëndetit dhe shërbimeve shëndetësore.⁴⁰³ Legjislacioni shqiptar mbi kujdesin ndaj shëndetit riprodhues⁴⁰⁴ përcakton masa për mbrojtjen e shëndetit të fëmijëve para, gjatë, pas lindjes/mosha e fëmijërisë së hershme si dhe masa për shëndetin e adoleshentëve. Ndërkohë, megjithëse kanë kaluar më shumë se 6 vjet nga miratimi i këtij ligji akoma nuk janë përgatitur të gjitha aktet e nevojshme nënligjore dhe protokollet e menaxhimit të integruar të sëmundjeve të fëmijërisë së hershme nuk janë zbatuar në të gjithë vendin. Nxjitja e ushqimit me qumështin e gjirit si një element i pazëvendësueshëm ndikon drejtpërdrejt në mbijetesën dhe në zhvillimin e plotë dhe të mirë të fëmijës së porsalindur është e parashikuar në legjislacionin përkatës,⁴⁰⁵ megjithatë mungon baza ligjore lidhur me parandalimin e kequshqyerjes së fëmijëve, apo monitorimin e këtij fenomeni, apo ndërgjegjësimin e komunitetit nga strukturat e shëndetit parësor. Shqipëria rezulton të ketë një nivel të mesëm të pamjaftueshmërisë jodike për shkak të moskonsumimit të kripës së jonizuar, e cila shoqërohet me ndërlikime të rënda në shëndetin e grave shtatzëna dhe fëmijëve. Zbatimi i legjislacionit të miratuar së fundmi pritet të ulë nivelin e këtyre çrregullimeve sodike.⁴⁰⁶

⁴⁰² Neni 55, Kushtetuta e RSH.

⁴⁰³ 114 Neni 54 i Kushtetutës përcakton se çdo fëmijë do të ketë të drejtën e mbrojtjes nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, veçanërisht në moshë të mitur, të cilat dëmtojnë shëndetin dhe moralin, apo rrezikojnë jetën dhe zhvillimin normal të fëmijës.

⁴⁰⁴ Në Ligjin Nr. 8876, datë 4.4.2002 “Për shëndetin riprodhues”, neni 22.

⁴⁰⁵ Ligji nr. 8528 datë 23.09.1999 “Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gj”

⁴⁰⁶ Studimi Kombëtar “Prevalenca e çrregullimeve nga pamjaftueshmëria jodike te fëmijët dhe gratë shtatzëna” nga Ministria e Shën-

E drejta e fëmijës ndaj shërbimeve shëndetësore afektohet nga ligje të veçanta, të cilat ndërveprojnë në mënyre direkte apo indirekte në sigurimin e kësaj të drejte. Megjithatë, ekziston një vakum ligjor për sa i përket unifikimit të përkufizimit ligjor mbi ndihmën e nevojshme shëndetësore që duhet t'u garantohet nga shteti të gjithë fëmijëve pa asnjë lloj diskriminimi. Legjislacioni shqiptar që lidhet me kujdesin shëndetësor të detyrueshëm akoma nuk është rishikuar/miratur,⁴⁰⁷ dhe si rrjedhim, jo të gjithë fëmijët kanë akses në shërbimet shëndetësore që duhet të marrin, veçanërisht grupet më të marginalizuara të fëmijëve në rrezik përjashtimi social. Imunizimi i fëmijëve dhe akses i mëtijshëm i tyre në shërbimet shëndetësore, kushtëzohen me ekzistencën e nënës në skemën e sigurimeve shoqërore/shëndetësore, të cilat kanë efekt të mëtijshëm edhe në mungesën e arsimimit/përjashtimin *de facto* nga shkolla të këtyre fëmijëve.⁴⁰⁸ Niveli i ulët i zbatimit të legjislacionit për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve infektive⁴⁰⁹ në institucionet parashkollore dhe shkollorë në zonat rurale e të thella të vendit është tregues i ekzistencës së pabarazisë në garantimin e mbrojtjes të së drejtës për shëndet pa diskriminim të fëmijëve në të gjithë vendin.

Megjithëse punësimi i të miturve ndalohet, për sa kohë fëmijët ndjekin arsimin e detyruar,⁴¹⁰ garancitë ligjore të parashikuara në legjislacionin e punës - Kodin e Punës⁴¹¹ apo legjislacionin sekondar⁴¹² – nuk janë në përputhje me Konventën e ILO mbi Format më të Rënda të Punës së Fëmijëve dhe Rekomandimin 190 të ILO-s.⁴¹³ Për sa i përket ndalimit të shfrytëzimit të punës së fëmijëve, dispozitat e Kodit Penal⁴¹⁴ nuk rezultojnë të kenë pasur ndonjë efekt në parandalimin e kryerjes së punëve të rënda nga fëmijët, sikurse është puna e fëmijëve në ndërtim, puna në rrugë, lypja, si dhe për më tepër puna e fëmijëve në repartin e çmontimit të armëve në Gërdec, tregon vazhdimin e shfrytëzimit të punës së fëmijëve, me pasoja të rënda në shëndetin e tyre. Rishikimi i legjislacionit të punës është i nevojshëm në drejtim të përcaktimit të saktë të formave të rënda të punës së fëmijëve që dëmtojnë shëndetin e tyre, rregullimit ligjor të punës së fëmijëve në familje dhe vetëpunësimit.⁴¹⁵

Aleanca e Fëmijëve vëren me shqetësim se legjislacioni aktual mbi kujdesin shëndetësor të detyrueshëm nuk është plotësisht në përputhje me standardet e përcaktuara nga KDF dhe nga ky nen. Jo të gjithë fëmijët kanë

detësisë me mbështetjen e UNICEF, 2008. Ministria e Shëndetësisë ka përgatitur një projekt-ligj i cili nuk rezulton të jetë miratur nga Kuvendi i Shqipërisë.

⁴⁰⁷ Në proces në Kuvendin e Shqipërisë.

⁴⁰⁸ Progres Raport i Shqipërisë mbi Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit të Shqipërisë me BE, 2008.

⁴⁰⁹ Ligji nr 7761, datë 19.10.1993 “Për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitesë.

⁴¹⁰ Neni 60 I Ligjit Nr. 7952, datë 21.06.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”.

⁴¹¹ Kodi i Punës parashikon që “punët e lehta” dhe “punët e vështira” do të parashikohen me VKM e cila nuk është hartuar akoma.

⁴¹² VKM 207, datë 9 maj 2002.

⁴¹³ Konventa është ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin Nr. 8774, datë 23 Prill 2001.

⁴¹⁴ Neni 124/b, Kodi Penal shtuar me Ligjin Nr. 9859, datë 21.01.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal”, i ndryshuar”.

⁴¹⁵ Puna e Fëmijëve dhe Kuadri Ligjor Shqiptar. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, ILO/IPEC, UNICEF, Tiranë, Korrik 2004.

akses në shërbimet shëndetësore të kujdesit parësor – veçanërisht fëmijët e paregjistruar, fëmijët me aftësi të kufizuar.⁴¹⁶ Më shqetësuese është se këto shërbime kushtëzohen me përfshirjen e nënës në skemën e sigurimeve shoqërore.⁴¹⁷ Vërehet zbatimi në nivele të ulëta i legjislacionit lidhur me shëndetin riprodhues ku mungojnë Protokollat për Qendrat e Kujdesit të Shëndetit Parësor mbi kujdesin ndaj nënave dhe fëmijëve gjatë dhe pas lindjes.⁴¹⁸ Fenomeni i kequshqyerjes së fëmijëve vazhdon të mbetet një problem shqetësues jo vetëm për shkak të varfërisë, por edhe të kujdesit të pamjaftueshëm ndaj nënës dhe fëmijës, si dhe aksesit të kufizuar në shërbimet shëndetësore. Kequshqyerja e fëmijëve nuk monitorohet në mënyrë sistematike dhe nuk janë përcaktuar masa për t'u ndërmarrë nga institucionet e kujdesit shëndetësor parësor në rastet e identifikimit të kequshqyerjes.⁴¹⁹ Trajnime për stafin shëndetësor dhe përgatitja e materialeve informative mbi komponentët e ushqyerjes me gjë, kohës së futjes së ushqimeve të tjera plotësuese dhe komponentëve dietetike janë veçanërisht të nevojshme në zonat e thella veriore dhe urbane ku vazhdon të ekzistojë mentaliteti i vizitës tek doktori vetëm në raste ekstreme të sëmundjes së fëmijëve.⁴²⁰ Megjithë, i parashikuar në Strategjinë e Shëndetit Publik, 2002-2010, ende mungon mekanizmi i identifikimit dhe referimit në organet përkatëse të rasteve të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit apo pakujdesisë ndaj fëmijëve prej punonjësve të shëndetit dhe trajnime për stafin shëndetësor mbi to.⁴²¹ Sistemi shëndetësor nuk mban të dhëna specifike mbi lëndimet jo-aksidentale apo vdekjet e dyshimta jo-aksidentale të fëmijëve.⁴²² Përveç kësaj, mungojnë statistikat nga strukturat e shëndetit mbi vetëvrasjet e adoleshentëve apo studimet mbi shkaqet e tyre. Pamjaftueshmëria jodike e identifikuar ndërmjet fëmijëve dhe grave shtatzëna në shkallë kombëtare, e cila rezulton të jetë me prevalencë të mesme,⁴²³ dikton nevojën e zbatimit në përputhje me legjislacionin bashkëkohor për konsumimin e kripës së jodizuar në Shqipëri.

⁴¹⁶ Zbatim i dobët i Ligjit të Shëndetit Mendor. Trajtimi i veçantë mjekësor për të cilin ata kanë nevojë, nuk e marrin nga strukturat shetërore. Vizitat mjekësore dhe kurat e vazhdueshme kryen me shpenzimet e familjes. Për personat me probleme fizike, nuk ekzistojnë as ambiente të veçanta ku ata mund të ushtrohen pa paguar para. Për më tepër shiko Aneks I – Zbatimi i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve analizuar nga këndvështrimi i fëmijëve, dhjetor 2008-janar 2009, f. 6.

⁴¹⁷ Aneks II, Informacion nga strukturat kryesore publike dhe jo publike të përfshira në garantimin e të drejtave të fëmijëve, janar–shkurt 2009 sipas Protokollit Informativ të marrë në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor.

⁴¹⁸ Sipas Studimit shumëfaktorësh për nënat dhe fëmijët, megjithëse të dhënat e viteve 2000-2005 tregojnë për uljen e vdekshmërisë foshnjore dhe të fëmijëve nën 5 vjeç, ky tregues është ende i lartë krahasuar me vendet e tjera të rajonit. Vëzhguesi Social 2006, UNICEF-QKS, Firenze.

⁴¹⁹ Aneks II, Informacion nga strukturat kryesore publike dhe jo publike të përfshira në garantimin e të drejtave të fëmijëve, janar–shkurt 2009 sipas Protokollit Informativ të marrë në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor.

⁴²⁰ Praktikant e Rritjes së fëmijëve në zonat e thella veriore dhe në zonat urbane në Shqipëri. Botim i UNICEF, f. 50.

⁴²¹ Analiza e Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve në Shqipëri, UNICEF, 2007, f. 89; Aneks II, Informacion nga strukturat kryesore publike dhe jo publike të përfshira në garantimin e të drejtave të fëmijëve, janar–shkurt 2009 sipas Protokollit Informativ të marrë në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor.

⁴²² Analiza e Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve në Shqipëri, UNICEF, 2007, f. 87; INSTAT mbi shkaqet e vdekjeve.

⁴²³ Studimi Kombëtar “Prevalenca e çrregullimeve nga pamjaftueshmëria jodike tek fëmijët dhe gratë shtatzëna” nga Ministria e Shëndetësisë me mbështetjen e UNICEF, f. 45- 49.

Vërehet mungesë e zbatimit të legjislacionit për parandalimin e sëmundjeve infektive nga strukturat e kujdesit shëndetësor parësor. Situata higjieno-sanitare e kopshteve dhe shkollave në zonat rurale dhe informale të vendit paraqitet alarmante ku ndër të tjera vërehet mungesa e kanalizimeve të ujërave të zeza, mungesa e ujit, mungesa e baxhove, mungesa e ajrosjes për shkak të mbipopullimit apo mësimi me turne dhe si rezultat i të cilave infeksionet e rënda janë tepër të përhapura në këto zona.⁴²⁴ Punonjësit e shëndetit (përfshirë asistencën stomatologjike falas) mungojnë jo vetëm në kopshtet dhe shkollat e këtyre zonave por edhe në rrethe të tjera të vendit. Mungojnë protokollet për raportimin e rregullt të situatës higjieno-sanitare dhe plane konkrete për kryerjen e fushatave sensibilizuese për përmirësimin e situatës higjieno-shëndetësore në mjedise familjare dhe publike.

Shëndeti i fëmijëve të përfshirë në punë të rënda⁴²⁵ dhe sidomos atyre që janë të detyruar të lypin përgjatë gjithë ditës⁴²⁶ është i rrezikuar si shkak i moszbatimit të masave ligjore/sanksioneve të parashikuara për ndalimin e punës së detyruar dhe shfrytëzimit të fëmijëve.

Rekomandime:

- Të përmirësohet legjislacioni i shërbimit shëndetësor me vëmendje të veçantë shërbimin shëndetësor të detyrueshëm për të garantuar aksesin e të gjithë fëmijëve pa asnjë lloj formë diskriminimi në shkallë vendi, veçanërisht për fëmijët e paregjistruar dhe ata me aftësi të kufizuara. Aksesin ndaj shërbimit bazë shëndetësor (paketa bazë e shërbimeve) të mos kushtëzohet nga përfshirja në skemën e sigurimit shëndetësor.
- Të përgatiten të gjitha aktet nën-ligjore të nevojshme për shëndetin riprodhues me vëmendje të veçantë kujdesin për nënat dhe fëmijët gjatë dhe pas lindjes.
- Të vlerësohet shkalla e kequshqyerjes në shkallë kombëtare dhe të trajnohen strukturat e kujdesit shëndetësor parësor mbi identifikimin dhe trajtimin e këtyre rasteve. Ndërgjegjësimi i prindërve, sidomos nënave në zonat rurale dhe të thella malore të vendit, mbi efektet e ushqimit me gji dhe kohës e mënyrës së futjes së ushqimeve të tjera plotësuese.
- Të nxirren aktet e nevojshme nën-ligjore në zbatim të legjislacionit për minimizimin e pamjaftueshmërisë jodike tek gratë shtatzëna dhe fëmijët bazuar në legjislacionin ndërkombëtar mbi kripën e jodizuar dhe konsumimin e saj.



⁴²⁴ Higjiena në zonat rurale. Parandalimi i sëmundjeve infektive. Botim Periodik i Qendrës “Fëmijët Sot”, NR. 2/2008, f. 8-21.

⁴²⁵ Rasti i fëmijëve të përfshirë në çmontimin e municioneve në Gërdec ku humbën jetën dhjetra fëmijë.

⁴²⁶ Organizata jo-qeveritare pjesë të Koalicionit të BKTf si FBSH, Arsis, SHKEJ, dhe World Vision në studimet e kryera dhe shërbimet që ofrojnë për fëmijët e rrugës (që lypin në rrugë) të cilët janë rreth 200 (mosha 1-16 vjeç) vërejnë se këta fëmijë punojnë rreth 12 orë në ditë, në kushte mjaft të vështira dhe janë të paregjistruar/vaksinuar dhe të kequshqyer. Megjithatë nuk ka statistika të sakta lidhur me këtë kategori fëmijësh.

- Të kryhet vlerësimi i situatës higjieno-shëndetësore në kopshite dhe shkolla me qëllim përmirësimin e kësaj situate duke përcaktuar standarde minimale (kanalizime të ujërave të zeza dhe ujë të pijshëm) mbi bazën e të cilave të kryhet monitorimi dhe raportimi sistematik nga strukturat e kujdesit shëndetësor parësor.
- Të përgatitet një plan masash i integruar për të siguruar shërbime shëndetësore të detyrueshme, duke përfshirë këshillimin konfidencial dhe shërbimet mbi shëndetin mendor, seksual, riprodhues për të gjithë adoleshentët pas asnjë lloj diskriminimi.
- Të rishikohet legjislacioni i punës mbi mbrojtjen e fëmijëve në punë, veçanërisht në specifikimin e formave më të rënda të punës së fëmijëve, punës së fëmijës në familje dhe vetëpunësimin në përputhje me Konventën e ILO-s mbi Format më të Rënda të Punës së Fëmijëve.

Neni 26 - E drejta për mbrojtje sociale dhe sigurime shoqërore

Shteti shqiptar ka ratifikuar instrumente ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes sociale, duke përfshirë dhe sigurimet shoqërore.⁴²⁷ Kushtetuta nuk i ka trajtuar në mënyrë të veçantë të drejtat e fëmijëve në fushën e përkrahjes sociale dhe të sigurimeve shoqërore dhe nuk ekziston legjislacion specifik në Shqipëri që mbulon mbrojtjen e fëmijëve. Ligji “Për ndihmën dhe Shërbimet shoqërore”⁴²⁸ parashikon ndihmën sociale dhe shërbimet shoqërore që duhet të përfitojnë nga shteti individët dhe grupet në nevojë.⁴²⁹ Pjesë e mbrojtjes sociale për zbutjen e pasojave të varfërisë, është dhe ndihma ekonomike⁴³⁰ për familjet pa të ardhura, me të ardhura të pamjaftueshme jetese dhe për ato familje me më shumë se dy fëmijë të lindur njëherësh.⁴³¹ Ndihma

⁴²⁷ Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomiko, Shoqërore dhe Kulturore ratifikuar me Ligjin nr. 7511 datë 8.8.1991, neni 9; Karta Sociale Europiane ratifikuar me Ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.

⁴²⁸ Ligji nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”.

⁴²⁹ Neni 1 i Ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, deklaron si synim të tij: “përkufizimi i ndihmës dhe shërbimeve sociale për individët dhe grupet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive dhe të mundësive personale dhe ruajtjen e integritetit për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore...dhe “lehtësimi i varfërisë dhe përjashtimit social për individët dhe familjet ...nëpërmjet sigurimit të ndërhyrjes dhe sistemi shërbimesh që synon përmirësimin e kushteve të tyre të jetesës”.

⁴³⁰ Nenet 10, 19, dhe 20 të Ligjit për Shërbimet Sociale së bashku me VKM Nr. 787 mbi Vendosjen e Kritereve, Procedurave dhe Shumës së Ndihmës Financiare, datë 14 dhjetor 2005.

⁴³¹ Ndihma ekonomike e plotë i jepet individëve apo familjeve pa asnjë të ardhur ndërsa ndihmë ekonomike e pjesshme është e disponueshme në rastet kur një familje kërkuese nuk ka të ardhura të mjaftueshme nga toka, blegtoaria, pemët frutore, pensionet apo burime të tjera – Neni 19 i Ligjit të Shërbimeve Sociale; Gjithashtu ndihmë ekonomike mund të kërkojnë: jetimet e papunë mbi moshën 25 vjeç, jetimet e moshës 18-26 vjeç të cilët nuk janë në institucione rezidenciale dhe prindërit e trinjakëve apo më shumë. Neni 1 e VKM 787 mbi Vendosjen e Kritereve, Procedurave dhe Shumës së Ndihmës Financiare, datë 14 dhjetor 2005.

ekonomike, e cila nuk kalon shumë prej 7,000 lekë⁴³² në muaj për familje, jo vetëm nuk është e mjaftueshme për të mbajtur familjet e varfra, por të qenit i varfër nuk garanton marrjen e saj – 69% të familjeve në varfëri të skajshme dhe 75% e të gjitha familjeve të varfra nuk e marrin ndihmën ekonomike.⁴³³

Legjislacioni aktual i skemës së mbrojtjes sociale dhe shoqërore nuk përfshin të gjitha kategoritë e fëmijëve të identifikuar në rrezik përjashtimi social⁴³⁴ në Strategjinë Ndërsektoriale të Përfshirjes Sociale 2008-2013, e cila i bën një vlerësim fillestar situatës dhe problemeve ekzistuese të kësaj skeme sipas kategorive të këtyre fëmijëve. Megjithatë reformimi i plotë i skemës së mbrojtjes sociale dhe shoqërore mbetet problematik për shkak të mungesës të vlerësimit të situatës së varfërisë në vend dhe analizës jo të plotë të përjashtimit social.⁴³⁵

Përkujdesja shoqërore për fëmijët në nevojë paraqitet problematike,⁴³⁶ veçanërisht në rastet kur prindërit për shkak të kushteve ekonomike vendosin të lënë në kujdesie institucionale fëmijët e tyre dhe roli i strukturave të shërbimit social nuk konsiston në mbështetjen e familjeve për mosbraktisjen e fëmijëve të tyre, por limitohet vetëm në vlerësimin e dokumentacionit përkatës.⁴³⁷ Vlen të theksohet se Qeveria ka pasur sensibilizimin për deinstitutionalizimin e fëmijëve në nevojë dhe aplikimin e alternativave të reja të shërbimeve sociale (kujdestarisë së fëmijëve) të pasqyruara në Planin Kombëtar të Veprimit për vitet 2005-2010 dhe në Strategjinë Sektoriale të Ministrisë së Punës 2007-2013. Me iniciativë të MPÇSSHB dhe mbështetje të UNICEF është miratuar Strategjia e kujdestarisë për fëmijët në nevojë,⁴³⁸ ku ndër të tjera parashikohet të pilotohet ky shërbim në Tiranë dhe Shkodër me 80 raste në vitet 2009-2010 për të vazhduar më pas shtrirjen graduale në nivel kombëtar.

Legjislacioni ka përparuar në drejtim të përgatitjes së standardeve të përkujdesjes në qendrat rezidenciale të fëmijëve⁴³⁹ megjithatë, problematikat⁴⁴⁰ e shfaqura nga monitorim i deritanishëm i zbatimit të këtyre

⁴³² VKM 787 mbi Vendosjen e Kriteve, Procedurave dhe Shumës së Ndhmës Financiare, datë 14 dhjetor 2005, nenet 18, 22.

⁴³³ Vlerësimi i Tregut Shqiptar të Punës. Banka Botërore, Njësia e Sektorit të Zhvillimit Njerëzor, f. 5 në Analizën e Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve në Shqipëri, UNICEF, prill 2007, f. 41.

⁴³⁴ Fëmijëve jetimë apo me probleme sociale që jetojnë në institucione rezidenciale; fëmijët e tjerë në nevojë që nuk jetojnë në institucione rezidenciale; fëmijët e trafikuar; fëmijët që punojnë; fëmijët AK; fëmijët romë.

⁴³⁵ Progres Raport i Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit të Shqipërisë me BE, 2008, f. 38.

⁴³⁶ Vendorsja e fëmijëve në institucionet e përkujdesit shoqëror bëhet në bazë të vendimit të marrë nga SHSSH bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 9355 Datë 10.03.2005 “Për ndihmë dhe shërbime shoqërore”, VKM Nr. 209, datë 12.04.2006 dhe Udhëzimi Nr. 2470, Datë 6.12.2006 i MPÇSSHB.

⁴³⁷ Pika 2, Udhëzimi Nr. 2470, Datë 6.12.2006 i MPÇSSHB.

⁴³⁸ VKM Nr. 1104, Datë 30.07.2008 “Për miratimin e strategjisë së kujdestarisë për fëmijët në nevojë”.

⁴³⁹ VKM Nr. 659, datë 17.10.2005 “Standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale”; Udhëzimit nr. 830 datë 14.04.2008 “Për zbatimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale publike dhe jo publike” Më tepër informacion pika IV “ofrimi dhe përgatitja e akteve” dhe XI “Vendndodhja, modeli dhe madhësia e institucionit.

⁴⁴⁰ Probleme në trajtimin psiko-social të fëmijëve me gjendje post-traumatike; mungesë e hartimit të planit të përkujdesjes për çdo fëmijë; moszbatim i Udhëzimit Nr. 1934, datë 19.10.2007, Për ndjekjen e procedurave ligjore për marrjen e kujdestarisë së fëmijëve, etj.

standardeve, del e nevojshme zbërthimi i këtyre parimeve në plane të detajuara përkujdesje, veçanërisht për trajtimin e fenomenit të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit apo të trajtimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të tyre nga Inspektorati i Shërbimeve Shoqërore si dhe trajnimi i punonjësve⁴⁴¹ që, megjithëse nuk kanë munguar, rezultojnë të pamjaftueshme.

Aleanca e Fëmijëve është e shqetësuar për legjislacionin ekzistues të mbrojtjes sociale, i cili nuk siguron mbështetje sociale sipas grupeve të fëmijëve në rrezik, përjashtimit social dhe objektivave të përcaktuara në Strategjinë Ndërsektoriale të Përfshirjes Sociale.⁴⁴² Analiza e përjashtimit social dhe monitorimi i varfërisë nuk janë zhvilluar mjaftueshëm⁴⁴³ për të shërbyer si bazë për reformimin në mënyrë të plotë të skemës së ndihmës sociale dhe asaj ekonomike nga të cilat përjashtohen kategori të caktuara të fëmijëve⁴⁴⁴ apo familjeve të tyre. Pavarësisht kësaj, skema e sigurimeve shoqërore apo ndihma ekonomike kur ofrohet është më e ulët se minimumi jetik i domosdoshëm, pa marrë në konsideratë minimumin jetik për mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës, e cila nuk është e përcaktuar ende ligjërisht.⁴⁴⁵ Kuadri ligjor lidhur me përfitimin e pensionit familjar nga fëmijët të cilët humbin njërin nga prindërit është problematik për shkak se përfitimi është i mundshëm vetëm nëse prindi i vdekur ka kontribuar në skemën e sigurimeve shoqërore deri në një vit nga vdekja. Mungojnë planet individuale të përkujdesjes sociale, trajtimi psiko-social i fëmijëve me gjendje post-traumatike dhe nuk zbatohen procedurat ligjore për marrjen e kujdestarisë ligjore për fëmijët në institucionet rezidenciale, fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët viktime të trafikimit. Mungesa e monitorimit të cilësisë së këtyre shërbimeve nga Inspektorati i Shërbimit Social është problematike duke dhënë si shembull rastin e Qendrës së Policanit për fëmijët e ngujuar të cilët mbijetonin vetëm nga kontributet e banorëve të vendit. Procesi i decentralizimit dhe transferimit të shërbimeve të përkujdesjes sociale ka krijuar vështirësi në ushtrimin e kompetencave nga organet e qeverisjes lokale, për shkak se është fokusuar tek transferimi i pronësisë dhe kompetencave të administrimit të shërbimeve sociale publike tek bashkitë dhe komunat dhe jo tek qarqet, si dhe skema e financimit vazhdon ende të administrohet nga qeverisja qendrore.⁴⁴⁶

Mungojnë mekanizmat ligjore për t'u mundësuar fëmijëve t'i drejtohen vetë administratorit social në rastet e kushteve të vështira ekonomike, apo kur prindi apo kujdestari ligjor abuzon me ndihmën e dhënë nga shteti për fëmijën.⁴⁴⁷

⁴⁴¹ Në kuadër të Projektit të UNICEF “Mbështetje për zbatimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit në institucionet rezidenciale” po trajtohen punonjësit e këtyre institucioneve.

⁴⁴² Për fëmijët jetimë apo me probleme sociale që jetojnë në institucione rezidenciale; fëmijët e tjerë në nevojë që nuk jetojnë në institucione rezidenciale; fëmijët e trafikuar; fëmijët që punojnë; fëmijët AK; fëmijët romë, etj.

⁴⁴³ Progres Raport i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit të Shqipërisë me BE, 2008, f. 38.

⁴⁴⁴ P.sh: Fëmijët të cilët kanë marrë statusin e refugjatit dhe familjet e tyre nuk marrin ndihmë ekonomike nga shteti. Për më tepër shiko Aneks I – Zbatim i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve analizuar nga këndvështrimi i fëmijëve, dhjetor 2008-janar 2009, f. 8-9.

⁴⁴⁵ Vlera e plotë e ndihmës ekonomike pavarësisht përbërjes familjare nuk shkon më shumë se 7, 000 lekë në muaj.

⁴⁴⁶ “Analiza e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri”, UNICEF, prill 2007, f. 37-38.

⁴⁴⁷ Aneks II, Informacion nga strukturat kryesore publike dhe jo publike të përfshira në garantimin e të drejtave të fëmijëve, janar–

Rekomandime:

- Të reformohet legjislacioni i skemës së asistencës sociale dhe ndihmës ekonomike duke përcaktuar mbështetjen e duhur financiare për të gjitha kategoritë e fëmijëve në rrezik përjashtimi social dhe familjeve të tyre mbi bazën e analizës së përjashtimit social dhe monitorimit të varfërisë të përcaktuar në Strategjinë e Integruar të Përfshirjes Sociale, 2008-2013. Një vëmendje e veçantë duhet ti kushtohet familjeve dhe fëmijëve romë të pargjistruar, me qëllim përfitimin e ndihmës ekonomike pa e kushtëzuar me regjistrimin e fëmijëve.
- Të përcaktohen qartë përgjegjësitë dhe roli i qarkut, komunave dhe bashkive lidhur me organizimin dhe administrimin e shërbimeve të kujdesit social në kuadrin e decenralizimit.
- Të detajohet përshkrimi i punës së administratorit social veçanërisht roli që duhet të kryejë për identifikimin, informimin e familjeve/fëmijëve në rrezik përjashtimi social të cilët mund të mos marrin asistencë financiare apo asistencë për paaftësi si dhe sistemi i fëmijëve në raste emergjente. Bashkëpunimi me Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve. Të kryhet trajnimi i tyre.
- Të përcaktohet standardi minimal jetik për fëmijët si dhe indikatorët e matjes.

Neni 27 – E drejta e fëmijës për një nivel jetese të mjaftueshëm

Trajtimi ligjor i këtij neni është bërë në nenin 26.

Aleanca e Fëmijëve kërkon të tërheqë vëmendjen e Komitetit lidhur me nivelin tepër të ulët dhe të pamjaftueshëm të ndihmës ekonomike të trajtuar në nenin 26 dhe problematikën që paraqet situata në ligj dhe në praktikë në lidhje me identifikimin dhe aksesin e fëmijëve në nevojë për përkujdesje dhe administrimin e rasteve emergjente.⁴⁴⁸ Nuk parashikohet mbështetja e veçantë për ato familje apo prindër të cilët për shkak të kushteve të vështira ekonomike kërkojnë dhe vendosin fëmijën në institucione përkujdesjeje. Përkudësja shoqërore për fëmijët në nevojë është rregulluar vetëm nëpërmjet vendosjes në institucion, ndërkohë që administratori social/ sektori i shërbimeve sociale⁴⁴⁹ apo njësia e mbrojtjes së fëmijëve në Bashki/Komuna nuk kryen identifikimin, vlerësimin e rastit, dhe të evidentimit

shkurt 2009 sipas Protokollit Informativ të marrë nga administratori social.

⁴⁴⁸ Vendorsja e fëmijëve në institucionet e përkujdesit shoqëror bëhet në bazë të vendimit të marrë nga SHSSH bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 9355 Datë 10.03.2005 “Për ndihmë dhe shërbime shoqërore”, VKM Nr. 209 datë 12.04.2006 dhe Udhëzimin Nr. 2470, Datë 6.12.2006 i MPÇSSHB.

⁴⁴⁹ Udhëzimi Nr. 2470, datë 6.12.2006 i MPÇSSHB.

të alternativës më të mirë sipas nevojave dhe karakteristikave të fëmijës duke zbatuar prioritetet për vendosjen e fëmijëve në kujdestari pranë të afërmeve, familjes kujdestare dhe më pas në institucion. Nga ana tjetër, kur fëmija ndodhet në institucionin e përkujdesjes, kuadri ligjor nuk parashikon përpjekje sistematike apo masa specifike mbështetjeje për ta kthyer fëmijën tek prindërit apo për ta vendosur nën kujdesin e të afërmeve të tjerë të tij (koncepti i familjes së zgjeruar). Aksesit i fëmijëve për sistemimin në qendrat e përkujdesjes lidhet me plotësimin e një paketë dokumentacioni i cili duhet të plotësohet nga kërkuesi (prindili afërmi) i fëmijës, ndërkohë që administratori social parashikohet të ketë vetëm mandatin e pranimit të kërkesës dhe vlerësimit të dokumentacionit.⁴⁵⁰ Në rastin e këtij të fundit, kërkuesit, qoftë ky edhe vetë fëmija, duhet të mbështeteshin nga strukturat e shërbimeve sociale në bashki për plotësimin e dokumentacionit.

Nga një studim i kryer mbi nevojat e gjyqtarëve dhe prokurorëve për zbatimin e dispozitave të Kodit të Familjes sipas standardeve të të drejtave të fëmijës (KDF)⁴⁵¹, pothuajse të gjithë gjyqtarët e intervistuar konsiderojnë si problemin më të "zakonshëm" të praktikës së tyre - përcaktimin në vlerë minimale të pensionit ushqimor ndaj fëmijës i cili varion nga 3,000-5,000 leke në muaj apo, në rastet më ekstreme, mos ekzekutimin/pagesën e këtij detyrimit ushqimor nga prindi që nuk i është besuar fëmija për rritje dhe edukim.

Aleanca e Fëmijëve dhe BKTF janë veçanërisht të shqetësuar për gjendjen skandaloze dhe jashtë vëmendjes dhe ndërhyrjes nga ana e strukturave shtetërore të fëmijëve që lypin dhe jetojnë në rrugë. Këta fëmijë përbejnë grupin më të marginalizuar dhe më të rrezikuar prej kategorive të tjera të fëmijëve në rrezik përjashtimi social nga vdekshmëria e lartë si pasojë e kequshqyerjes dhe mungesës së një vendi për të fjetur. Strukturat shtetërore janë apatike për të ndërhyrë dhe gjetur akomodim të përkohshëm për këtë kategori fëmijësh, megjithëse ekzistojnë mekanizmat e duhur ligjore në Kodin e Familjes dhe Kodin Penal për vendosjen e tyre në kujdestari të posaçme dhe ndjekjen e procedurës gjyqësore në bazë të parimit të interesit më të lartë të fëmijës.⁴⁵²

Historia e Arbenit, një djalë 12 vjeçar që lyp në Tiranë⁴⁵³

Arbeni zgjohet çdo mëngjes në orën 7 e 30 dhe shkon së bashku me vëllezërit e tij në një lavazh makinash ku mbush ujë për të pirë për shtëpinë, meqënëse në zonën ku ata jetojnë mungon uji i pijshëm. Në orën 9, ai, mamaja e tij dhe motrat dhe vëllezërit e tij shkojnë në qendër të qytetit. Rrugën e bëjnë në këmbë me qellim që të kursejnë lekë – autobusi kushton 30 lekë për person. Nesë babai i tyre nuk i ka dhënë lekë mamasë së tyre, ata lypin për të fituar pak lekë për

⁴⁵⁰ Pika 2, Udhëzimi Nr. 2470, datë 6.12.2006 i MPÇSSHB.

⁴⁵¹ Raport Vlerësimi "Mbi nevojat e gjyqtarëve dhe prokurorëve në zbatimin e dispozitave të Kodit të Familjes, Kodit Civil dhe Kodit të Procedurës Civile nëpërmjet standardeve të të drejtave të fëmijëve", përgatitur nga Shkolla e Magjistraturës dhe Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara" Raporti është përgatitur duke iu referuar përgjigjeve të pyetësorëve, diskutimeve në fokus grupet me gjyqtarë dhe prokurorë dhe praktikës gjyqësore familjare të kohëve të fundit (2005-2008).

⁴⁵² World Vision Survey "Street children's rights and their life conditions", May-July 2008.

⁴⁵³ Rast nga praktika, Terres des Hommes.

të blerë diçka për të ngrënë mëngjes (byrek ose diçka tjetër të vogël). Arbeni jeton me mamanë, babin dhe vëllezërit e motrat e tij në një barakë të vogël në periferi të Tiranës. Babai i tij është i papunë dhe pjesën më të madhe të ditës e kalon duke pirë. Mamaja e tij e kalon ditën duke lypur së bashku me fëmijët e saj. Vëllai i tij më i madh, tepër i madh për të lypur, grumbullon kanaçe dhe hekura të gjetura në rrugë mbrëmjeve dhe më pas i shet ato për të fituar afërsisht 900 lekë (6.9 Euro në ditë).

Rreth orës 10, ai së bashku me mamanë dhe vëllezërit, fillojnë të lypin në një nga kryqëzimet më të mëdha në qendër të qytetit. Ai shkon pranë të gjitha makinave që janë ndaluar në semafor për të lypur. Ai thotë që në përgjithësi janë gratë ato që i japin më tepër lekë. Gjithashtu, në këtë kryqëzim ka edhe policë trafiku, por ata në përgjithësi nuk i hapin probleme Arbenit. Ndonjëherë ata mundohen ta largojnë Arbenin. Por ai vazhdon të lypë deri rreth orës 4:00 të mbrastit. Në këtë kohë ai me familjen e tij pushon për të ngrënë një hamburger, të cilin mamaja e tij e ka blerë me lekët që ata kanë fituar gjatë ditës. Ata ulen për të ngrënë në parkun pranë kryqëzimit ku lypin.

Pas këtij pushimi, Arbeni së bashku me një ose dy prej vëllezërve të tij, shkojnë në zonën e bllokut për të lypur pranë lokaleve dhe restoranteve. Në rastet kur moti është shumë i ftohtë, ai heq disa nga rrobat e tij me qëllim që të fitojë keqardhjen e njerëzve dhe të fitojë më shumë lekë. Ai vazhdon të lypë deri rreth orës 22:00 ose 22:30 të darkës dhe më pas shkon në park ku takohet me mamanë. Ai ia jep mamasë të tij të gjitha lekët që fiton. Më pas ai, mamaja e tij dhe vëllezërit kthehen në shtëpi me këmbë. Rrugës për në shtëpi mamaja blen pak bukë dhe djathë për familjen. Kur arrijnë në shtëpi, mamaja i jep babait të Arbenit të gjitha lekët që ata kanë fituar gjatë ditës.

Arbeni dhe vëllezërit dhe motrat e tij nuk kanë certifikatë lindje, nuk janë të regjistruar, gjë e cila i pengon ata për të përfituar asistencë ekonomike nga shërbimet sociale të komunës. Asnjë organ shtetëror nuk u ka ardhur në ndihmë dhe nuk u ka dhënë ndonjë lloj mbështetje. Familja ka marrë asistencë nga disa OJF, por kjo nuk ka mundur të ndryshojë situatën e tyre.

Arbeni është i neglizhuar dhe i shfrytëzuar nga prindërit e tij. Shteti nuk ka mundur t'i japë atij asnjë formë asistence. Arbenit i është mohuar një nivel jetese i përshtatshëm dhe ai është në një gjendje pasigurie, e shkaktuar kjo nga varfëria, mungesa e përkujdesjes prindërore, dhe është jashtë vëmendjes së institucioneve shtetërore. Jeta në rrugë u mohon fëmijëve si Arbeni ushqim

të rregullt dhe të shëndetshëm dhe i bën ata të jenë të rrezikuar nga dhuna dhe abuzimi. Për më tepër, e drejta e tyre për arsim dhe zhvillim është e rrezikuar.

Rekomandime:

- Të bëhet vlerësimi i nevojave/indikatoreve të mirërritjes, sidomos të grupeve të fëmijëve në rrezik përjashtimi social dhe të rritet minimumi jetik për familjet e këtyre kategorive bazuar në nivelin e konsumit dhe jo të të ardhurave.
- Të merren masa ligjore dhe administrative për identifikimin e fëmijëve në nevojë sipas vlerësimit të nivelit të varfërisë dhe përjashtimit social.
- Të koordinohet puna e strukturave zbatuese të ligjit, kryesisht të mbrojtjes së fëmijëve dhe mbrojtjes sociale, për sigurimin e akomodimit emergjent dhe, më pas, të zgjidhjeve të qëndrueshme për fëmijët që jetojnë dhe punojnë në rrugë.
- Të rishikohet legjislacioni penal dhe ai familjar me qëllim parashikimin e mekanizmave efikase/sanksioneve ndaj prindërve/kujdestarëve ligjorë lidhur me mosushtrimin e duhur të përgjegjësisë prindërore dhe, veçanërisht, me mosdhënien e mjeteve të nevojshme për një standard minimal të jetesës së fëmijëve të tyre.









VIII. EDUKIMI, ARGËTIMI DHE AKTIVITETET KULTURORE (nenet 28, 29, 31)

Neni 28 – E drejta e fëmijës për arsim.

Shteti shqiptar ka ratifikuar një sërë instrumentesh ndërkombëtare për njohjen e të drejtës për arsim, në përgjithësi, dhe për sigurimin e edukimit të detyrueshëm, në veçanti.⁴⁵⁴ Në Kushtetutën e RSH është sanksionuar parimi se kushdo ka të drejtën për arsimim.⁴⁵⁵ Kushtetuta trajton, përgjithësisht, të gjitha çështjet⁴⁵⁶ që kanë të bëjnë me realizimin e këtij parimi të rëndësishëm konform KDF dhe akteve të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria. Megjithëse legjislacioni shqiptar për sistemin arsimor parauniversitar⁴⁵⁷ dhe Strategjia Kombëtare për Arsim,⁴⁵⁸ parashikojnë si një nga objektivat kryesore sigurimin e aksesit të të gjithë fëmijëve në arsimin e detyrueshëm pa asnjë lloj diskriminimi – “Arsim për të gjithë”, rezulton se mekanizmat ligjorë të përcaktuar⁴⁵⁹ nuk janë efikase dhe aktet nënligjore të Ministrisë së Arsimit⁴⁶⁰ për mospërfshirjen

⁴⁵⁴ Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Sociale dhe Ekonomike; Deklarata Universale mbi të Drejtat e Njeriut; Konventa nr 138 për Moshën Minimale të Punësimit, 1973 dhe Rekomandimi nr 146; Konventa Europiane mbi të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut - Protokoli 1 dhe jurisprudenca;

⁴⁵⁵ Neni 57.

⁴⁵⁶ Arsimi shkollor i detyrueshëm caktohet me ligj; arsimi i mesëm i përgjithshëm publik është i hapur për të gjithë; arsimi i mesëm profesional dhe i lartë mund të kushtëzohet vetëm nga kriteret aftësie; arsimi i detyrueshëm si dhe arsimi i mesëm i përgjithshëm në shkollat publike është falas; nxënësit dhe studentet mund të arsimohen edhe në shkolla jo publike të të gjitha niveleve, të cilat krijohen dhe funksionojnë në bazë të ligjit.

⁴⁵⁷ Ligji Nr. 7952, datë 21.06.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar” ndryshuar me Ligjin Nr. 8387, datë 30.07.1998.

⁴⁵⁸ Strategjia Kombëtare e Arsimit mbështetet në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2004 – 2015, miratuar me VKM nr. 538, datë 12.08.2004.

⁴⁵⁹ Sanksionet për prindërit që nuk dërgojnë në shkollë fëmijët e moshës 6-16 vjeç, ose kur këta mungojnë pa arsye në shkollë ose e braktisin atë, dënohen për kundravajtje administrative me gjobë nga 1000 deri në 10 000 lekë të cilat nuk zbatohen për shkak se drejtorët e shkollave nuk kanë informacion se si duhet të veprojnë për të zbatuar këto masa. Aneks II, Informacion nga strukturat kryesore publike dhe jo publike të përfshira në garantimin e të drejtave të fëmijëve, janar-shkurt 2009, sipas Protokollit Informativ nga Drejtoritë Arsimore në Rrethe.

⁴⁶⁰ Udhëzimi i MASH “Për regjistrimin në shkollë të nxënësve romë që nuk janë të pajisur me certifikatë lindje” si kryerja e studimit për “Mbledhjen e të dhënave të fëmijëve romë, parashkollë dhe shkollë, brenda dhe jashtë sistemit”; Urdhri i Ministrisë

de facto të grupeve të fëmijëve në rrezik⁴⁶¹ apo reduktimit të braktisjes së shkollës nuk kanë dhënë rezultat, për shkak edhe të mos koordinimit me sektorë të tjerë, si psh, atë të përkrahjes sociale, të shëndetësisë, të strukturave lokale etj. Lidhur me arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, ende nuk janë përgatitur akte nënligjore nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës për përgatitjen e programeve të veçanta mësimore sipas aftësive të kufizuara të kësaj kategorie të fëmijëve, apo sigurimin e transportit për fëmijët me aftësi fizike të kufizuara. Shteti shqiptar, pavarësisht përpjekjeve pozitive të bëra për eliminimin e fenomenit të braktisjes së shkollës, ku ndër të tjera mund të përmendet shpërndarja e librave falas, nuk ka përgatitur ende një Plan konkret masash ndër-sektoriale për vlerësimin e situatës,⁴⁶² parandalimin e fenomenit të braktisjes së shkollës

te Arsimit dhe Shkencës Nr 410, datë 8.11.2006 "Për identifikimin e situatës dhe masat që duhen marrë në luftë kundër analfabetizmit"; Projektit "Shansi i dytë" nëpërmjet mbështetjes së mësuesve që punojnë me nxënësit që kanë braktisur shkollën, duke ofruar kryerjen e mësimave në kushtet e shtëpisë;

⁴⁶¹ Në shumicën e rretheve, fëmijët romë dhe egjiptianë nuk pranohen në arsimin e 9-vjeçar për shkak të mos-pasjes së certifikatës së lindjes apo kartelës së vaksinimit por edhe kur pranohen ka diskriminim nga mësuesit apo shokët arsye ndër të tjera që braktisin shkollën. Gjithashtu problem i ndjekjes së arsimit nga fëmijët e ngjuar. Aneks II, Informacion nga strukturat kryesore publike dhe jo publike të përfshira në Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Sociale dhe Ekonomike; Deklarata Universale mbi të Drejtat e Njeriut; Konventa nr 138 për Moshën Minimale të Punësimit, 1973 dhe Rekomandimi nr 146; Konventa Europiane mbi të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut - Protokollin 1 dhe jurisprudenca; Neni 57.

Arsimi shkollor i detyrueshëm caktohet me ligj; arsimi i mesëm i përgjithshëm publik është i hapur për të gjithë; arsimi i mesëm profesional dhe i lartë mund të kushtëzohet vetëm nga kritere aftësie; arsimi i detyrueshëm si dhe arsimi i mesëm i përgjithshëm në shkollat publike është falas; nxënësit dhe studentet mund të arsimohen edhe në shkolla jo publike të të gjitha niveleve, të cilat krijohen dhe funksionojnë në bazë të ligjit.

Ligji Nr. 7952, datë 21.06.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar" ndryshuar me Ligjin Nr. 8387, datë 30.07.1998.

Strategjia Kombëtare e Arsimit mbështet në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2004 – 2015, miratuar me VKM nr. 538, datë 12.08.2004.

Sanksionet për prindërit që nuk dërgojnë në shkollë fëmijët e moshës 6-16 vjeç, ose kur këta mungojnë pa arsye në shkollë ose e braktisin atë, dënohen për kundravajtje administrative me gjobë nga 1000 deri në 10 000 lekë të cilat nuk zbatohen për shkak të drejtoritë e shkollave nuk kanë informacion se si duhet të veprojnë për të zbatuar këto masa. Aneks II, Informacion nga strukturat kryesore publike dhe jo publike të përfshira në garantimin e të drejtave të fëmijëve, janar – shkurt 2009 sipas Protokollit Informativ nga Drejtoritë Arsimore në Rrethe.

Udhëzim i MASH "Për regjistrimin në shkollë të nxënësve romë që nuk janë të pajisur me certifikatë lindje" si kryerja e studimit për "Mbledhjen e të dhënave të fëmijëve romë, parashkollë dhe shkollë, brenda dhe jashtë sistemit"; Urdhri i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr 410, datë 8.11.2006, "Për identifikimin e situatës dhe masat që duhen marrë në luftë kundër analfabetizmit"; Projektit "Shansi i dytë" nëpërmjet mbështetjes së mësuesve që punojnë me nxënësit që kanë braktisur shkollën, duke ofruar kryerjen e mësimave në kushtet e shtëpisë;

Në shumicën e rretheve, fëmijët romë dhe egjiptianë nuk pranohen në arsimin e 9-vjeçar për shkak të mos-pasjes së certifikatës së lindjes apo kartelës së vaksinimit por edhe kur pranohen ka diskriminim nga mësuesit apo shokët arsye ndër të tjera që braktisin shkollën. Gjithashtu problem i ndjekjes së arsimit nga fëmijët e ngjuar. Aneks II, Informacion nga strukturat kryesore publike dhe jo publike të përfshira në garantimin e të drejtave të fëmijëve, janar–shkurt 2009 sipas Protokollit Informativ nga Drejtoritë Arsimore në Rrethe.

⁴⁶² Moszbatimi i akteve administrative të MASH për mbledhjen e raportimeve dy-mujore dhe vjetore nga drejtoritë arsimore mbi

dhe mundësinë për edukimin e fëmijëve që kanë braktisur shkollën.⁴⁶³ Përpjekje pozitive janë ndërmarrë nga Qeveria Shqiptare për arsimin parashkollor të fëmijëve të moshës 5-6 vjeç, nëpërmjet miratimit të Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2004-2015,⁴⁶⁴ megjithatë vërehet një zbatim i ulët i kësaj Strategjie ku ndjekja e arsimit parashkollor nuk kalon shifrën 48%, kjo si pasojë edhe e mungesës së alokimit të buxheteve përkatëse apo politikave fiskale për nxitjen e pjesëmarrjes së fëmijëve të marginalizuar në kopshte.

Kurrikulat e arsimit të mesëm të përgjithshëm dhe, veçanërisht, atij profesional janë rishikuar së fundmi sipas objektivave të legjislationit përkatës⁴⁶⁵ duke përfshirë në to lëndë me zgjedhje dhe trajnime profesionale.⁴⁶⁶ Ky rishikim, pritet të kapërcejë mangësitë e evidentuara dhe të forcojë lidhjen midis arsimit dhe tregut të punës dhe, në këtë mënyrë, rritjen e frekuencimit të arsimit të mesëm.⁴⁶⁷

Ligji për Arsimin Parauniversitar nuk ndalon në mënyrë specifike përdorimin e ndëshkimit trupor në shkollat publike dhe private. Dispozitat Normative të Arsimit Parauniversitar, megjithëse parashikojnë në mënyrë deklarative ndalimin e dhunës, nuk përcaktojnë mekanizmat e nevojshëm ligjorë për parandalimin, mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna e ushtruar brenda mjediseve të shkollës, për të vendosur sanksione për mësuesit që ushtrojnë dhunë apo për të identifikuar dhe raportuar dhunën që vjen nga jashtë.

Aleanca e Fëmijëve dhe BKTF janë të shqetësuara për mungesën e mekanizmave ligjore specifike por edhe mungesën e burimeve njerëzore, apo në infrastrukturë, për të garantuar në praktikë përfshirjen e të gjithë fëmijëve në territorin e R SH në arsimin e detyrueshëm pa asnjë lloj diskriminimi.⁴⁶⁸ Vërehet me shqetësim moszbatimin e politikave shtetërore lidhur me edukimin e fëmijëve romë dhe egjiptianë, të cilëve në një pjesë të madhe të shkollave u krijohen vështirësi për shkak të mungesës së çertifikatës së lindjes apo mungesës së Kartelës së Vaksinit me

fëmijët që kanë braktisur shkollën. Aneks II, Informacion nga strukturat kryesore publike dhe jo publike të përfshira në garantimin e të drejtave të fëmijëve, janar – shkurt 2009 sipas Protokollit Informativ nga drejtoritë arsimore në rrethe.

⁴⁶³ Projekti “Shansi i dytë”.

⁴⁶⁴ Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2004-2015, miratuar nga qeveria shqiptare në qershor 2004.

⁴⁶⁵ Ligji nr 8872, datë 29.03.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

⁴⁶⁶ Kurrikula e re e përgatitur nga Instituti i Kurrikulës dhe Trajnimit.

⁴⁶⁷ Progres Raporti i Shqipërisë mbi Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit me BE, 2008.

⁴⁶⁸ Aneks II, Informacion nga strukturat kryesore publike dhe jo publike të përfshira në garantimin e të drejtave të fëmijëve, janar – shkurt 2009 sipas Protokollit Informativ nga drejtoritë arsimore në rrethe. Për fëmijët e paregjistruar në lindje, me aftësi të kufizuara, fëmijët romë dhe egjiptianë, fëmijët e prekur nga fenomeni i gjakmarrjes, fëmijët nga familjet e varfra, etj. Masat që janë marre janë sporadike dhe vetëm për një pjesë të këtyre kategorive: në një pjesë të rretheve mungon infrastruktura e përshtatshme për fëmijët me aftësi të kufizuara apo shkolla të veçanta për këtë kategori, për përfshirjen e fëmijëve romë, fëmijëve jetimë apo ata që jetojnë në zonat rurale, të cilët mund të mos jenë regjistruar në lindje dhe mospasja e certifikatës e bën të vështirë regjistrimin në shkollë.

justifikimin se mund të jenë rrezik sëmundje për fëmijët e tjerë.⁴⁶⁹ 54% e fëmijëve romë të moshës 6-16 vjeç (arsimi i detyrueshëm) nuk kanë përfunduar një klasë shkollë. Analfabetizmi në 43% i fëmijëve romë të moshës 15-16 vjeç mbetet një problem i spikatur.⁴⁷⁰ Përveç kësaj, shumica e fëmijëve romë nuk dinë gjuhën shqipe për shkak të mos frekuentimit të edukimit parashkollor, ku vetëm 15% e tyre e ndjekin atë, dhe 70% e fëmijëve romë nuk kanë akses në librat shkollorë apo tekstet në gjuhën e tyre (mungon abetarja në gjuhën romë), arsye të cilat sjellin mosfrekuentim të rregullt, probleme në mësim-nxënje, braktisje, etj. Situata paraqitet problematike dhe për fëmijët me aftësi të kufizuara, për të cilët nuk ka ende programe të veçanta mësimore, qoftë si kategori në tërësi apo në bazë të nevojave individuale, staf të specializuar pedagogjik, apo akses fizik/rrugë për të hyrë karroca⁴⁷¹, etj.⁴⁷² Shqetësuese është situata lidhur me mundësinë e aksesit gjeografik në shkollë nga ana e fëmijëve të zonave të thella malore, ku këtyre fëmijëve u duhet të ecin deri në 5 km në këmbë për të shkuar në shkollë.⁴⁷³

Shteti shqiptar ende nuk ka ngritur një program të integruar specifik (jo vetëm në planin arsimor) për të pakësuar apo parandaluar fenomenin e braktisjes së shkollës. Për më tepër, nuk ka një analizë të mirëfilltë nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës lidhur me dukurinë e braktisjes së shkollës dhe ndërhyrjet që duhen bërë në zbatim të Ligjit për Sistemin Arsimor Parauniversitar. Statistikat e mbajtura nga Drejtoritë Arsimore Rajonale në disa rrethelqarqe tregojnë për një tendencë në ulje të rasteve të braktisjes së shkollës. Megjithatë, në pjesën më të madhe të rretheve nuk ka statistika të tilla apo nuk njihen procedurat për mbledhjen dhe raportimin e tyre.⁴⁷⁴ Si pasojë e moszbatimit të akteve administrative të MASH për mbledhjen dhe raportimin dymujor dhe vjetor nga Drejtoritë Arsimore Rajonale nuk ekzistojnë statistika të plota dhe të besueshme për braktisjen e shkollës në nivel kombëtar.⁴⁷⁵ Vetëm në disa rrethe të vendit zbatohen programet/masa (në mënyrë sporadike) në kuadër të Projektit “Shansi i dytë” për të mundësuar vazhdimin e edukimit të fëmijëve që kanë braktisur shkollën apo ngritjen e klasave të veçanta/ripërtëritëse për t’u

⁴⁶⁹ Progres Report i Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit të Shqipërisë me BE, 2008, f. 13-14.

⁴⁷⁰ Save the Children. Education of Roma Children in Albania.

⁴⁷¹ Aneks I – Zbatimi i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve analizuar nga këndvështrimi i fëmijëve, dhjetor 2008- janar 2009, f. 6-7.

⁴⁷² Informacion nga Drejtoritë Arsimore Rajonale.

⁴⁷³ Në shkollat e Topojan, Cernavel, Zapod, Bushtricë, Kalis, Mujaj dhe Letaj, etj. Aneks II, Informacion nga strukturat kryesore publike dhe jo publike të përfshira në garantimin e të drejtave të fëmijëve, janar – shkurt 2009 sipas Protokollit Informativ nga drejtoritë arsimore në rrethe.

⁴⁷⁴ Rrethi i Dibrës raporton për 2.05% fëmijë që kanë braktisur shkollën, ndërsa Durrësi raporton 200 fëmijë. Në Shkodër thuhet se niveli i braktisjes është në rënie, më saktë në 2006-2007-2008 nga 1.4% në 1.1% Në Qarkun e Kukësit (Kukës, Has dhe Tropojë) niveli i nxënësve të braktisur është 523 ose 2.7%. Në Lushnjë, për vitin 2008, në një shkollë me 800 nxënës braktisja ka qenë 7 nxënës. Në rrethin e Tiranës sipas DAR nuk rezultojnë të ketë braktisje. Gjithashtu, rezultojnë se ka një dallim (diferencim gjinor) mes djemve dhe vajzave për sa i përket fenomenit të braktisjes së shkollës. Në zonat malore dhe në fshatrat që iu përkasin rretheve nga është marrë informacioni rezultojnë se nga nxënësit që braktisin shkollën numrin më të madh e përbëjnë vajzat, ndërsa në zonat urbane ky fenomen ishte më i evidentuar te djemtë, sidomos tek ata me probleme ekonomike, të cilët ishin të detyruar të punonin. Informacion i mbledhur nga Drejtoritë Rajonale Arsimore. Pas moshës 11 vjeç braktisja e shkollës nga fëmijët e seksit femër të komunitetit rom është më e lartë se ajo e djemve.

⁴⁷⁵ Studim “Braktisja e Shkollës në Qarkun e Kukësit. Shkaqet dhe Rekomandime“, Tetor 2007, UNICEF, f. 61-62.

afruar nivelit të moshatarëve të tyre.⁴⁷⁶ Sipas Projektit “Shansi i dytë” parashikohej përfshirja e 92 mësuesve nga të cilët vetëm 39 mësues punojnë aktualisht me fëmijët që kanë braktisur shkollën. Vetëm 11% e nxënësve që kanë braktisur shkollën (496 nxënës) frekuentojnë klasat e ngritura në bazë të Projektit.⁴⁷⁷

Roli i shkollës në ndihmën dhe mbrojtjen e fëmijëve brenda mjediseve të saj lidhur me dhunën në shkolla (nga mësuesit, ndërmjet nxënësve apo e ushtruar jashtë saj e identifikuar në shkollë), është inekzistente; kjo për shkak, ndër të tjera, të mungesës së bazës ligjore në legjislacionin parësor apo në Dispozitat Normative të Arsimit Parauniversitar, moskonsolidimit të rolit të psikologut në shkolla apo vartësisë hierarkike të tyre nga Ministria e Arsimit, e cila përbën problem,⁴⁷⁸ për mosndërgjesimin e personelit edukativ mbi forma të tjera alternative të edukimit, ku, megjithë trajnimet e zhvilluara prej Drejtorive Arsimore Rajonale, situata dikton nevojën e vazhdimet të tyre.⁴⁷⁹

Megjithë iniciativat dhe rezultatet pozitive në drejtim të ngritjes dhe rikonstruksionit të shkollave, probleme shqetësuese janë cilësia e dobët e mësimdhënies, mungesa e sigurisë fizike⁴⁸⁰ dhe kushtet mjaft të këqija higjieno-sanitare në shkollat dhe kopshtet e vendi, sidomos atyre që ndodhen në zonat rurale dhe veriore të vendit sipas standardeve të miratuara nga qeveria shqiptare. Mungojnë zyrat e shërbimit shëndetësor në shkolla, mbipopullimi i nxënësve në varësi të sipërfaqes së klasave, mungesa e kanalizimit të ujërave të zezalbanjave, mungesa e furnizimit me ujë të pijshëm, amortizimi i shkollave dhe mungesa e sigurisë së tyre fizike.⁴⁸¹

⁴⁷⁶ Vizita në shtëpi nga stafi pedagogjik, psikologët e shkollave, përfshirja në klasa kolektive, zbatimi në disa rrethe i Projektit të MASH “Shansi i dytë”. Në rrethet e Lushnjes, Gjirokastrës dhe Kukësit nuk ekzistojnë klasa të tilla. Aneks II, Informacion nga strukturat kryesore publike dhe jo publike të përfshira në garantimin e të drejtave të fëmijëve, janar–shkurt 2009 sipas Protokollit informativ nga Drejtoritë Arsimore në Rrethe.

⁴⁷⁷ Informacion nga Ministria e Arsimit dhenë në Konferencën Kombëtare “Shansi i dytë/Braktisja e fshehtë”.

⁴⁷⁸ Sugjerohet që psikologët apo punonjësit sociale të varen nga MPCSSH.

⁴⁷⁹ Aneks I – Zbatimi i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve analizuar nga këndvështrimi i fëmijëve, dhjetor 2008-janar 2009, f. 41.

Një përqindje e konsiderueshme e fëmijëve të grup-moshave 10-14 vjeç dhe 15-18 vjeç janë përgjigjur se kanë qenë viktimë të dhunës. Tek fëmijët e grup-moshës 15-18 vjeç, prindërit janë personat të cilët i dhunojnë më shumë fëmijët, më pas vinë moshatarët dhe më pas mësueset e shkollës. Ndërsa tek fëmijët e grup-moshës 10-14 vjeç duket se ata të cilët ushtrojnë më shumë dhunë ndaj njëri-tjetrit janë bashkë-moshatarët, më pas familjarët dhe më pas mësuesja ku vërehet se këta të fundit nuk kanë informacione të sakta për dhunën.

⁴⁸⁰ Rastet e shembjeve të shkollave janë kthyer në një fenomen shqetësues duke venë në rrezik jetën e nxënësve sidomos në zonat e thella të vendit: Rasti më i rendë i shembjes ka ndodhur 2 vjet më parë kur u shembë ish-Shkolla Teknologjike në Tiranë me 2 të vrarë dhe 6 të plagosur; shembja e çatisë së shkollës në fshatin Kurdar të Rrethit të Matit me 28 Mars 2009 dhe në Poshnje të Beratit 600 nxënës bënë mësim në një stallë bagëtitsh. Informacion i marrë nga gazeta “Tema” e datës 29 Mars 2009, f. 12.

⁴⁸¹ Studim “Higjiena në zonat rurale. Parandalimi i Sëmundjeve Infektive”, Botim Periodik i Qendrës “Fëmijët Sot”, nr. 2/2008, f. 18-20.

Rekomandime:

- Të përcaktohen kritere ligjore për garantimin e përfshirjes së fëmijëve romë dhe egjiptianë në arsimin e detyrueshëm, përfshirë edhe edukimin parashkollor të tyre.
- Të përgatiten programe të përshtatshme mësimore për fëmijët me aftësi të kufizuara, për fëmijët të cilët janë privuar nga liria, si dhe për fëmijët e ngujuar.
- Të merren masa konkrete për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2004-2015, me qëllim krijimin e mundësive për të gjithë fëmijët e moshës 5-6 vjeç në ndjekjen e arsimit parashkollor nëpërmjet alokimit të buxheteve përkatëse, dhe ngritjes së politikave fiskale për nxitjen e pjesëmarrjes së fëmijëve të marginalizuar në kopshte, duke promovuar metoda alternative të arsimit parashkollor.
- Të kryhet nga MASH një vlerësim në shkallë kombëtare për fenomenin e braktisjes së shkollës dhe të hartohet një program i integruar masash me ndërhyrjet e nevojshme në legjislacion.
- Të krijohet baza e nevojshme ligjore dhe ose të ndryshohen Dispozitat Normative të Arsimit për parandalimin e dhunës në shkolla, veçanërisht përsa i përket vendosjes së sanksioneve ndaj mësuesve që ushtrojnë dhunë, si dhe të hartohen protokolle për identifikimin dhe referimin e rasteve të dhunës fizike apo psikologjike.
- Të krijohet infrastruktura e duhur për aksesibilitetin e fëmijëve në shkolla, veçanërisht, në zonat e thella malore apo për fëmijët me aftësi të kufizuara si dhe të garantohet siguria fizike dhe të vendosen kushtet minimale të higjienës, mbipopullimit, ujit të pijshëm, ngrohjes dhe ndriçimit.
- Të hartohet një plan trajnimi dhe kualifikimi për mësuesit, sidomos të zonave rurale dhe të thella të vendit, me qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies.
- Të përkthehen tekstet mësimore në gjuhën e minoriteteve.

Neni 29 – Qëllimet e edukimit

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë parashikohet se shteti synon arsimimin dhe kualifikimin sipas aftësive të fëmijëve dhe të rinjve.⁴⁸² Kushtetuta përcakton mundësinë që kanë nxënësit për tu arsimuar edhe në shkollat jopublike, kur ato janë krijuar dhe funksionojnë në bazë të ligjit.⁴⁸³ Sipas legjislacionit, arsimi i detyruar

⁴⁸² Neni 59, Kushtetuta e RSH.

⁴⁸³ Ligji Nr. 7952, datë 21.06.1995 “Për arsimin parauniversitar” në kreun IV, neni 43-44 parashikon të drejtën për të krijuar institucione arsimore private. Mësimi në këto institucione mund të zhvillohet në gjuhën shqipe ose në gjuhën të huaj, sipas rastit me miratimin e Ministrisë së Arsimit dhe Këshillit të Ministrave. Leja për hapjen e institucione arsimore private jepet kur programet

publik synon të zhvillojë aftësitë intelektuale, krijuese, praktike dhe fizike të nxënësve, të zhvillojë personalitetin e tyre dhe t'i pajisë ata me elementet themelore të kulturës së përgjithshme dhe edukatës qytetare.⁴⁸⁴ Ndërsa arsimi i mesëm publik synon të zhvillojë në mënyrë sa më të plotë e harmonike personalitetin dhe potencialin e nxënësve, për t'i aftësuar ata të kontribuojnë në mënyra sa më aktive në zhvillimet ekonomike, politike, sociale e kulturore të vendit. Vendimi i Këshillit të Ministrave⁴⁸⁵ që përcakton kriteret për hapjen e institucioneve arsimore fetare në gjuhën shqipe apo në gjuhë të huaj, mbështetet në kuadrin ligjor shqiptar dhe në aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria.⁴⁸⁶

Strategjia Kombëtare e Arsimit 2004 – 2015 synon të garantojë një sistem arsimor kombëtar e modern, me qëllim nxitjen e rritjes së qëndrueshme ekonomike dhe konsolidimin e demokracisë, si dhe suksesin në dialogun dhe konkurrencën me vendet e rajonit dhe më gjerë. Ky dokument është përvijuar pas këshillimeve të gjera dhe intensive me përfaqësues të grupeve të ndryshme të interesit, si mësues, menaxherë arsimorë, prindër, nxënës, OJF, sindikatat, intelektualë, etj.⁴⁸⁷

Sipas legjislacionit në fuqi, fëmijët që iu përkasin pakicave kombëtare, duhet t'u krijohej mundësi të mësojnë dhe të mësohen në gjuhën e tyre amtare, të mësojnë historinë dhe kulturën e tyre brenda kuadrit të planeve dhe programeve mësimore.⁴⁸⁸ Megjithatë, Shteti shqiptar ende nuk e ka ratifikuar Kartën Evropiane të Gjuhëve Rajonale dhe Minoriteteve.

Aleanca e Fëmijëve dhe BKTf kërkon të tërheqë vëmendjen e Komitetit lidhur me mungesën e adresimit ligjor të fenomenit të diskriminimit, racizmit dhe segregacionit, veçanërisht atij në shkolla, kundrejt fëmijëve të komuniteteve me ngjyrë. Shteti shqiptar ende nuk ka përgatitur një Plan Masash në mbështetje të Deklaratës dhe të Planit të

mësimore dhe kushtet e realizimit të tyre nuk janë në kundërshtim me legjislacionin, rendin publik normat morale etj. Gjuha dhe letërsia shqipe, historia e kombit shqiptar dhe gjeografia e Shqipërisë zhvillohen detyrimisht në gjuhën shqipe.

⁴⁸⁴ Neni 21, Ligji Nr. 7952, datë 21.06.1995 “Për arsimin parauniversitar”

⁴⁸⁵ Vendim i Këshillit të Ministrave, Nr. 248 datë 28.5.1999 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së lejes për funksionimin e institucioneve arsimore jopublike dhe të institucioneve arsimore plotësuese jopublike, ku zhvillohen lëndë fetare dhe në gjuhë të huaj.

⁴⁸⁶ Në pikën 2 germa (a) të këtij Vendimi përcaktohet se subjekti aplikues deklaron se do të respektojë me rigorozitet parashikimet e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut dhe të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve. Institucione të tilla janë të detyruara të informojnë organet arsimore për veprimtarinë jashtë shkollore. Pjesëmarrja e nxënësve në veprimtari të tilla është fakultative dhe, në çdo rast, kërkohet miratimi paraprak i prindit apo, në mungesë të tij, i kujdestarit ligjor të të miturit.

⁴⁸⁷ Më gjerësisht kjo strategji është trajtuar në komentin e nenit 28 të KDE.

⁴⁸⁸ Neni 10, Ligji Nr. 7952, datë 21.06.1995 “Për arsimin parauniversitar.” Në kuadër të krijimit të mundësive të barabarta dhe të njohjes së gjuhës, kulturës, historisë etj, të vendit të origjinës dhe vendit ku fëmijët jetojnë, Ligji parashikon se fëmijët që jetojnë në Shqipëri dhe që u përkasin pakicave të tjera kombëtare, kanë të njëjtat kushte si fëmijët shqiptarë për t'u shkolluar sipas sa më sipër.

Veprimet të Konferencës Botërore kundër Racizmit, Diskriminimit Racor dhe Ksenofobisë.⁴⁸⁹ Strategjia Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Minoritetit Rom nuk ka përcaktuar masa për parandalimin dhe luftimin e fenomenit të diskriminimit dhe racizmit me të cilën përballen fëmijët romë, apo të tjerë me ngjyrë, në shkollë. 90% e nxënësve e pranojnë se etiketohen në shkollë si “jevgjitë zinj”, 80% e tyre ulen në bankat e fundit të klasave, 50% e tyre ulen në banka vetëm me nxënës të tjerë romë, një në dy nxënës ankohet se mësuesit i përfshijnë apo ndihmojnë më pak se nxënësit jo-romë, 46% e tyre pranojnë se ndëshkohen nga mësuesit më tepër se nxënësit jo-romë, etj.⁴⁹⁰ Gjithashtu, vërehet moszbatimi i Ligjit për Sistemin Arsimor Parauniversitar⁴⁹¹ përsa i përket fëmijëve të pakicave kombëtare (veçanërisht fëmijëve romë), lidhur me mësimin në gjuhën e tyre të historisë, vlerave, traditave dhe mungesën e rishikimit të kurrikulave të mësimin për të përfshirë të gjitha këto elemente.⁴⁹² Mungojnë abetaret dhe tekstet shkollore me qëllim arsimimin e fëmijëve shqiptarë që banojnë jashtë Shqipërisë.

Përsa i përket administrimit të shkollave sipas standardeve të KDF-së, Aleanca e Fëmijëve varen se nuk ka mekanizma konkrete ligjore që garantojnë/verifikojnë zbatimin në praktik të së drejtës së fëmijëve për t'u shprehur në shkollë⁴⁹³, ndër të tjera, për të dhënë mendime, për t'u ankuar për notat, format e disiplinimit, mënyrën e trajtimit nga mësuesit, etj.⁴⁹⁴ Gjithashtu, mungesa e adresimit ligjor të dhunës fizike dhe psikologjike e ushtruar si formë ndëshkimi nga mësuesit, e trajtuar në nenin 28, mbetet çështje shqetësuese ku vërehet zbatimi i ulët i Programit Kombëtar të “Reduktimit të përdorimit të dhunës nga mësuesit si formë disiplinore”.⁴⁹⁵ Masat e marra nga MASH për sigurimin e një sistemi arsimor cilësor janë larg standardeve bashkohore të arsimit dhe tregut të punës ku vërehet mungesë e larmisë së kurrikulave, sidomos atyre që duhet të vendosen nga nxënësit dhe prindërit e tyre. Aleanca e Fëmijëve dëshiron të ngrejë si shqetësim mungesën e njohjes prej fëmijëve të të drejtave të tyre (por edhe nga mësuesit) dhe mënyrën e përdorimit të tyre në shkollë dhe jashtë saj për shkak të mospërfshirjes së saj në kurrikulën e shkollës, pavarësisht pilotimit të edukimit mbi të drejtat e njeriut në disa qytete të vendit.⁴⁹⁶

⁴⁸⁹ Miratuar më 8 shtator 2001, Durban, Afrika e Jugut.

⁴⁹⁰ Save the Children, Educational Situation of Roma Children in Albania. Informacion i marrë nga AMARO DROM.

⁴⁹¹ Neni 10 Ligji Nr.7952, datë 21.06.1995 “Për arsimin parauniversitar.”

⁴⁹² Informacion nga AMARO DROM.

⁴⁹³ Në shkollë fjalë e fëmijëve merret në konsideratë nga mësuesit kur ajo është e shprehur si kërkesë e komunikuar drejtpërdrejtë. Strukturat e ngritura nga fëmijët dhe të përbëra prej tyre, duket se nuk janë shumë funksionale dhe nuk përbëjnë një strukturë efikase ku fëmijët të kenë besim të shprehin problemet e tyre. Kjo tregon se fëmijët nuk kanë gjetur akoma terrenin e përshtatshëm nga stafi i shkollës, për t'u dëgjuar dhe konsideruar kur shfaqen në mënyrë të organizuar dhe përfaqësohen nga organe të përbëra prej tyre. Për më tepër shiko Aneks I, Zbatimi i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve analizuar nga këndvështrimi i fëmijëve, dhjetor 2008-janar 2009, f. 21-28.

⁴⁹⁴ Aneks II, Informacion nga strukturat kryesore publike dhe jo publike të përfshira në garantimin e të drejtave të fëmijëve, janar-shkurt 2009, sipas Protokollit Informativ nga drejtoritë arsimore rajonale.

⁴⁹⁵ Aneks I, Zbatimi i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve analizuar nga këndvështrimi i fëmijëve, dhjetor 2008- janar 2009, f. 36-42.

⁴⁹⁶ Projekt i mbështetur nga UNESCO.

Ilustrime intervistash me fëmijë të komunitetit rom⁴⁹⁷

Unë kam bërë vetëm klasën e parë. Në klasë të dytë e kam lënë shkollën se qante motra shumë. Ajo nuk dinte të lexonte abetaren dhe qante. Nga shkolla na nxori mësuesja se motra qante shumë. Ajo edhe na rrihte. Me shoqet e klasës nuk kam shkuar mirë në shkollë. Ato nuk donin të rrinin me mua dhe më thonin “gabele”. Në shkollë unë nuk e di të kishte ndonjë kurs, i cili u mëson fëmijëve gjuhën rome, as te shtëpia nuk ka. (Vajzë rome, 12 vjeç)

Në fillim kur erdha në shkollë shokët e klasës dhe mësuesit nuk silleshin mirë me mua. Ata më thonin “gabel”. Po tani më respektojnë të gjithë. Kur një mësuese na qëlloi me shpullë mua dhe vëllanë tim, ne u ankuam dhe drejtori i dërgoi letër me vërejtje dhe paralajmërim mësueses. Kurse për mësimin e gjuhës rome nuk ka kurse, as në shkollë dhe as në lagjen time. (Djalë rom, 14 vjeç, në klasë të 7)

Kur erdha në fillim fëmijët e tjerë nuk silleshin mirë me mua, kurse tani nuk kam më probleme me ta. Në klasë jemi vetëm tre romë, por ne nuk flasim kurrë gjuhën rome me njëri-tjetrin në shkollë. Kurse për gjuhën rome nuk ka kurse në shkollë. (Djalë rom 16 vjeç, në klasë të 7)

Në shkollë nuk kam qenë asnjëherë. Nuk më kanë çuar mami dhe babi. Unë kam shumë shokë dhe shoqe që janë në shkollë dhe i kam thënë mamit dhe babit për të shkuar edhe unë, por ata nuk më kanë dërguar. (Djalë rom 8 vjeç)

Rekomandime:

- Të adresohet ligjërisht problemi i stigmatizimit, racizmit dhe diskriminimit të fëmijëve me ngjyrë, veçanërisht atyre romë, në shkolla dhe në komunitet.
- Të përgatitet një plan masash në përputhje me Deklaratën dhe Planin e Veprimit të Konferencës Botërore kundër racizmit, diskriminimit racial dhe ksenofobisë.
- Të rishikohen kurrikulat e mësimin për të garantuar detyrimet ligjore të edukimit të fëmijëve nga minoritetet, veçanërisht atij rom, për sa i përket përfshirjes së vlerave, origjinës dhe traditave të këtij komuniteti.
- Të rishikohet Strategjia Kombëtare për Romët me qëllim krijimin e një strukture koordinuese në nivel qendror dhe pranë strukturave lokale në vendet e populluara nga komuniteti rom për të monitoruar dhe mbështetur në mënyrë të përhershme problemet e ndeshura nga romët në shkolla,

⁴⁹⁷ Aneks I, Zbatimi i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve analizuar nga këndvështrimi i fëmijëve, dhjetor 2008- janar 2009, f. 15-17.

politikat e edukimit dhe projektet pilot.

- Të përgatiten dhe përfshihen më shumë mësues romë në arsimin 9-vjeçar.
- Të rishikohet kurrikula e arsimit parauniversitar me qëllim përfshirjen e lëndëve me zgjedhje të propozuara nga nxënësit dhe prindërit e tyre dhe integrimin e të drejtave të fëmijëve/të drejtave të njeriut si orë mësimore.
- Të ratifikohet Karta Europiane e Gjuhëve Rajonale dhe të Minoriteteve.
- Të përcaktohen mekanizma specifike ligjore për të garantuar efikasitetin e strukturave të Qeverisë së Nxënësve si zëdhënës të problemeve dhe aktorë në vendimmarrje.

Neni 31 - E drejta e fëmijës për t'u argëtuar dhe për të marrë pjesë lirisht në jetën kulturore dhe artistike.

Kodi i Familjes nuk parashikon në mënyrë eksplicite të drejtën e fëmijës për të luajtur, argëtuar dhe pushuar. Pavarësisht se kjo e drejtë mund të burojë nga interpretimi i Parimeve të Përgjithshme⁴⁹⁸ dhe përkufizimit të përgjegjësisë prindërore,⁴⁹⁹ një detajim më konkret në pjesën e përgjegjësisë prindërore të së drejtës të fëmijës për të luajtur, argëtuar e pushuar do të ishte e nevojshme. Legjislatori, në mënyrë deklarative, përcakton si një nga qëllimet e arsimit, emancipimin shpirtëror të individit⁵⁰⁰ duke e lidhur, në këtë mënyrë, të drejtën për edukim me të drejtat e tjera të rëndësishme për fëmijën, si ajo për pushim, argëtim, pjesëmarrje në aktivitete kulturore dhe artistike, etj., të cilat ndikojnë në zhvillimin tërësor të fëmijës. Megjithatë, ky është një parashikim me karakter deklarativ dhe zbatimi në praktikë i këtij parimi kërkon detajime konkrete.

E drejta e fëmijëve për t'u argëtuar dhe luajtur parashikohet në standardet e arsimit parashkollor dhe në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2004-2015, nëpërmjet të mësuarit me anë të lojës. Megjithatë, problematike mbetet mungesa e zbatimit të këtyre standardeve për shkak të mungesës së njohurive dhe trajnimit përkatës të edukatoreve dhe mësuesve. Dispozitat Normative për Arsimin Parauniversitar

⁴⁹⁸ Në nenin 5 të KF përcaktohet se fëmijët kanë të drejtë për një "zhvillim të plotë dhe harmonik të personalitetit të tyre" dhe "rritje në një atmosferë gëzimi dhe mirëkuptimi".

⁴⁹⁹ Në nenin 215 të KF jepet kuptimi i përgjegjësisë prindërore ku parashikohet se prindërit kanë të drejtën dhe detyrimin t'u sigurojnë fëmijëve të tyre mirëqenien emocionale, sociale dhe materiale, duke u kujdesur për ta, duke mbajtur raporte vetjake, duke u siguruar atyre mirërritjen, edukimin, arsimimin. Termat mirëqenie emocionale, sociale dhe sigurimi i mirërritjes përmbajnë, në një interpretim të tyre, edhe elementet e garantimit të së drejtës për të luajtur, argëtuar e pushuar si të domosdoshëm për mirërritjen dhe mirëqenien emocionale.

⁵⁰⁰ Neni 2 i Ligjit Nr. 7952, datë 21.06.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar". I njëjti parashikim përsëritet sërish në nenin 18 të po këtij ligji në lidhje me arsimin parashkollor publik dhe në nenin 21 për arsimin e detyruar publik. Në mënyrë të ngjashme parashikohet në nenin 26 të këtij ligji për arsimin e mesëm publik, ku përcaktohet se sistemi arsimor duhet të zhvillojë në mënyrë sa më të plotë e harmonike personalitetin e nxënësit.

përcaktojnë synimet e shkollës,⁵⁰¹ për emancipimin shpirtëror të nxënësve dhe përmbajnë një kre të veçantë,⁵⁰² i cili i dedikohet vetëm veprimtarive jashtëshkollore ku ngarkohet shkolla që, në përputhje me kushtet, mundësitë dhe objektivat e saj, të zhvillojë veprimtari jashtëshkollore me nxënësit, të cilat duhet të jenë të larmishme, ku renditen veprimtaritë kulturore-artistike, sportive letrare, higjieno-shëndetësore, ekskursione, vizita e piknike.⁵⁰³ Në këtë kuadër, drejtorja e shkollës harton planin vjetor të veprimtarive jashtëshkollore, duke evidentuar edhe veprimtaritë jashtëshkollore, pa mbingarkuar nxënësit, duke afirmuar në këtë mënyrë balancimin e aktiviteteve në të cilat përfshihen fëmijët me të drejtën për pushim.⁵⁰⁴

Një sërë masash mbi përfshirjen dhe krijimin e mundësive për veprimtari rekreative për grupet e marginalizuara të të rinjve,⁵⁰⁵ parashikohen në planin e veprimit të *Strategjisë Kombëtare të Rinisë, 2007-2013*,⁵⁰⁶ të cilat kanë të bëjnë me hapjen e qendrave rinore komunitare për të gjitha grupet e të rinjve, duke përfshirë komunitetin rom dhe egjiptian, në disa rrethe të vendit, ku përqindja e këtyre komuniteteve është më e lartë dhe organizimin e kampeve ose shkollave verore për grupet e marginalizuara dhe të rinj të tjerë, me qëllim integrimin e tyre, etj.

Aleanca e Fëmijëve konstaton me kënaqësi se e drejta e fëmijëve për të marrë pjesë dhe për t'u argëtuar në aktivitetet shkollore gjen zbatim në pjesën më të madhe të fëmijëve të anketuar.⁵⁰⁷ Megjithatë pjesëmarrja e grupeve vulnerabel të fëmijëve, si p.sh., fëmijët romë dhe egjiptianë, me aftësi të kufizuara në aktivitetet jashtëshkollore të organizuara nga shkollat nuk mundësohet, sepse në rrethe të ndryshme të vendit këto kategori fëmijësh nuk janë të përfshirë në sistemin arsimor.⁵⁰⁸ Strategjia Kombëtare e Rinisë dhe Plani i saj i Veprimit nuk janë zbatuar për sa i përket masave për hapjen e qendrave rinore komunitare apo organizimin e shkollave verore për të gjitha grupet e të rinjve, sidomos për grupet e marginalizuara të të rinjve. Me shqetësim vërehet edhe mungesa e bibliotekave komunitare apo mjediseve sportive pranë shkollave të mesme dhe universiteteve. Aleanca konstaton mungesën e vëmendjes nga ana e pushtetit qendror dhe atij vendor për planifikimin urban dhe atë buxhetor në krijimin e hapësirave të nevojshme, ndër të tjera, të parqeve, shesheve të lojrave, për t'u mundësuar fëmijëve të gëzojnë të drejtën për të luajtur, pushuar dhe argëtuar.

⁵⁰¹ Neni 4, Dispozitat normative për sistemin arsimor parauniversitar.

⁵⁰² Kreun VI. Dispozitat normative për sistemin arsimor parauniversitar.

⁵⁰³ Neni 34/1,2, Dispozitat normative për sistemin arsimor parauniversitar

⁵⁰⁴ Neni 35/2, nenin 24 të Dispozitave Normative, parashikohet se në raste e veçanta në edukimin fizik, mund të aplikohet një program i reduktuar, për personat të cilët e kanë të pamundur ti nënshtrohen programit të plotë. Neni 57 i Dispozitave në lidhje me personat me nevojë të veçanta.

⁵⁰⁵ Fëmijët që punojnë, të trafikuar, romë, egjiptianë, të dhunuar me probleme socio-ekonomike, jetimë, etj.


⁵⁰⁶ VKM, Nr. 782, Datë, 17.11.2006.

⁵⁰⁷ Aneks I, Zbatimi i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve analizuar nga këndvështrimi i fëmijëve, dhjetor 2008- janar 2009, f. 26.

⁵⁰⁸ Aneks II, Informacion nga strukturat kryesore publike dhe jo publike të përfshira në garantimin e të drejtave të fëmijëve, janar – shkurt 2009 sipas Protokollit Informativ nga Drejtoritë Arsimore Rajonale.

Rekomandime:

- Të detajohet legjislacioni familjar/Kodi i Familjes në pjesën e përgjegjësisë prindërore për sa i përket të drejtës së fëmijës për të luajtur, argëtuar e pushuar.
- Të detajohet ligji për Sistemin Arsimor Parauniversitar për të specifikuar lidhjen midis të drejtës për edukim dhe zhvillimit e emancipimit shpirtëror dhe kulturor të fëmijëve.
- Të trajnohen edukatorët dhe mësuesit mbi metodat e mësimdhënies interaktive dhe mësimin nëpërmjet lojës.
- Të detajohet lista e punëve të “rënda” të fëmijëve, punës në familje dhe vetëpunësimit sipas Konventave të ILO-s.
- Të ngrihen qendra rinore për të rinjtë në të gjithë vendin, veçanërisht për grupet e marginalizuara.
- Të planifikohen sheshe lojërash për fëmijët parashkollorë dhe ata që ndjekin arsimin e detyrueshëm.
- Të ngrihen mjedise sportive pranë shkollave 9-vjeçare, të mesme dhe universiteteve.





IX. Masat e Posaçme të mbrojtjes (nenet 22, 30, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40)

Neni 22 – Të drejtat e fëmijëve refugjatë.

Të drejtat e fëmijëve refugjatë/azilkërkues garantojnë me ligj, njësoj si për të rriturin.⁵⁰⁹ Në aspektin procedural, ligji u garanton fëmijëve azilkërkues të pashoqëruar të drejtën për t'u asistuar nga një kujdestar për procedurën e azilit,⁵¹⁰ por në praktikën shqiptare rezultojnë të jetë krijuar një problem në lidhje me ligjin e zbatueshëm për këtë kategori personash për të cilët Gjykata e Lartë⁵¹¹ ka interpretuar se marrëdhëniet juridiko-civile të personit të huaj rregullohen nga ligji i vendit të origjinës.⁵¹²

Gjithashtu, legjislacioni nuk parashikon rregulla të veçanta, të harmonizuara me standardet e të drejtave të fëmijëve, për procedurën e intervistimit⁵¹³ të azilkërkuesve të mitur, duke mos sanksionuar, p.sh., praninë e psikologut apo të specialistit të posaçëm (në rastin e fëmijëve me aftësi të kufizuara). Gjithashtu, ligji duhet të amendohet për të garantuar moskthimin e fëmijës së pashoqëruar, të cilit i refuzohet statusi i refugjatit në zbatim të parimit të interesit më të lartë të fëmijës. Megjithatë ligji sanksionon mosndalimin e të miturit të pashoqëruar deri 16 vjeç, ai përsëri përcakton se këta mund të burgosen për arsye ekstreme duke lënë shteg për një interpretim të paqartë të rasteve kur ndalimi dhe burgosja do të lejohen.⁵¹⁴ Po kështu ky ligj, nuk garanton mbrojtje për të miturit mbi 16 vjeç në aspektin e mësipërm.

⁵⁰⁹ Ligji Nr. 8432, Datë 28.12.1998 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 10060, Datë 26.01.2009 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8432, Datë 14.12.1998 ‘Për azilin në R.Sh.’”.

⁵¹⁰ Neni 18, paragrafi 4, Ligji Nr. 8432, Datë 28.12.1998 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.

⁵¹¹ Vendim Nr. 156, Datë 25.01.2005, Gjykata e Lartë ka nxjerrë jashtë juridiksionit kërkesën për kufizimin e zotësisë për të vepruar të shtetasit e huaj me argumentimin se zotësia për të vepruar e shtetasit të huaj nuk rregullohet nga legjislacioni ynë dhe për rrjedhojë mosmarrëveshja nuk hyn në juridiksionin gjyqësor shqiptar. Ky vendim është i gabuar pasi sipas nenit 27, Ligji Nr. 3920, Datë 21.11.1964 “Mbi gëzimin e të drejtave civile nga të huajt dhe zbatimin e ligjit të huaj”, gjykata shqiptare ka kompetencë të shqyrtojë çështjen por duke zbatuar ligjin e vendit të origjinës.

⁵¹² Ligji Nr. 3920, Datë 21.11.1964 “Mbi gëzimin e të drejtave civile nga të huajt dhe zbatimin e ligjit të huaj”.

⁵¹³ Neni 26, Ligji Nr. 8432, Datë 28.12.1998 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.

⁵¹⁴ Neni 16/5, Ligji Nr. 8432, Datë 28.12.1998 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.

Në përputhje me normat ndërkombëtare mbi të drejtat e fëmijëve, të cilat Republika e Shqipërisë i ka ratifikuar, kur është fjala për azilkërkuesit e mitur të pashoqëruar nën moshën 16 vjeç, këta nuk burgosen, përveçse në raste ekstreme. Në çdo rast tjetër, ndaj tyre merren masat e duhura dhe të përshtatshme për fëmijët.

Azilkërkuesit kanë të drejtë të përfitojnë asistencë sociale,⁵¹⁵ pa përcaktuar ndonjë masë për familjet me shumë fëmijë. Azilkërkuesit, në përgjithësi, përfshirë edhe të miturit, duhet të përfitojnë ndihmë nga skema e shërbimeve shëndetësore, çka sjell nevojën për plotësimin e kuadrit ligjor me akte nënligjore.

Aleanca e Fëmijëve është e shqetësuar në lidhje me trajtimin që shteti shqiptar u garanton fëmijëve azilkërkues, pasi ligji nuk bën referim të qartë në parimin e interesit më të lartë të fëmijës dhe të drejtës për t'u dëgjuar gjatë procedurave të përcaktimit të statusit. Gjithashtu, Aleanca është e shqetësuar për mungesën e garancive të ligjit shqiptar në lidhje me moskthimin e fëmijës në rastet kur ai është i pashoqëruar. Ndërkohë që të miturit refugjatë tregojnë se institucionet shtetërore nuk kanë krijuar asnjë lehtësi për fëmijët azilantë për t'u siguruar atyre strehim, ndihmë ekonomike apo shëndetësore.⁵¹⁶ Në këtë drejtim, ata theksojnë bashkëpunimin dhe asistencën e marrë nga UNHCR, e cila ka ndihmuar që azilkërkuesve t'u sigurohen mundësitë minimale të jetesës.⁵¹⁷ Gjithashtu, është për t'u theksuar mungesa e mekanizmave ankimes për fëmijët në rast të heqjes apo kufizimit të lirisë së tyre për shkaqe që lidhen edhe me rastet më ekstreme. Aleanca përgëzon arritjen në legjislacionin shqiptar për trajtimin e njëjtë që u sigurohet personave me statusin e azilkërkuesit dhe atyre me statusin e refugjatit, por, nga ana tjetër, tërheq vëmendjen për faktin që organet e gjyqësorit shqiptar vazhdojnë të zbatojnë ligjin e vendit të origjinës në lidhje me rregullimin e marrëdhënieve juridiko-civile të së drejtës familjare bazuar në legjislacionin e vjetër të para ndryshimeve demokratike.

Rekomandime:

- Të amendohet legjislacioni mbi azilin me dispozita të posaçme për të siguruar që interesi më i lartë dhe mendimi i fëmijës të merren parasysh, në veçanti, gjatë procedurave të përcaktimit të statusit përfundimtar.
- Të amendohet legjislacioni mbi azilin në lidhje me procedurat e shqyrtimit paraprak të kërkesës së të huajve në pikat kufitare dhe të përcaktimit të rasteve më ekstreme kur mund të bëhet ndalimi/burgosja e fëmijëve të pashoqëruar deri 16 vjeç, si dhe të përcaktohet mbrojtja edhe për ata nga 16-18 vjeç.
- Të amendohet Ligji “Mbi gëzimin e të drejtave civile nga të huajt dhe zbatimin e ligjit të huaj.”
- Të merren masa për trajnimin e personave që merren me çështjet e fëmijëve refugjatë.
- Të merren masa për përmbushjen e objektivave afatshkurtra dhe afatgjata që ka ndërmarrë qeveria Shqiptare për periudhën 2007-2013 në kuadër të “Planit Kombëtar të Zbatimit të MSA.”

⁵¹⁵ Neni 15/2, Ligji Nr. 8432, Datë 28.12.1998 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.

⁵¹⁶ Shih Aneks I – Zbatimi i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve analizuar nga këndvështrimi i fëmijëve, dhjetor 2008 – janar 2009, f. 9

⁵¹⁷ Shih Aneks I – Zbatimi i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve analizuar nga këndvështrimi i fëmijëve, dhjetor 2008 – janar 2009.

- Të ngrihen struktura të posaçme për t'u siguruar azilkërkuesve strehim, ndihmë ekonomike dhe mjekësore.

Neni 30 – Fëmijët e minoriteteve dhe grupeve indigjene.

Kushtetuta garanton mosdiskriminim dhe barazi të plotë para ligjit për personat që u përkasin pakicave kombëtare,⁵¹⁸ megjithatë, mungojnë statistika për identifikimin e grupeve vulnerabel të shoqërisë. Legjislacioni nuk parashikon diskriminimin për motive racore, apo për motive të tjera, si rrethanë rënduese në kuadrin e veprës penale të “nxitjes së urrejtjes dhe grindjeve raciale, nacionale dhe fetare.”⁵¹⁹ Megjithëse ligji parashikon, për këto komunitete, përdorimin e gjuhës dhe praninë e përkthyesit në të gjitha fazat e gjykimit,⁵²⁰ në praktikë nuk janë ngritur mekanizmat për t'i realizuar ato.

Personave, që u përkasin pakicave kombëtare, u garantohet e drejta për të mësuar në gjuhën amtare për sa i përket arsimit të detyrueshëm,⁵²¹ por shteti nuk e ka realizuar këtë detyrim. Vlen të theksojmë se shteti ende nuk ka mbështetur shtypjen dhe shpërndarjen falas të abetares në gjuhën rome, apo greke, si standartin minimal të kësaj të drejte. Gjithashtu, keqtrajtimi i fëmijëve të komunitetit rom nga bashkëmoshatarët e tyre, ose nga mësuesit, apo mosnjohja e gjuhës shqipe, janë faktorë ndikues në uljen e numrit të fëmijëve të këtij komuniteti në procesin arsimor.⁵²² Po kështu, mungojnë shfaqja e emisioneve për pakicat kombëtare, apo emisioneve në gjuhën minoritare, megjithëse kjo parashikohet me ligj.⁵²³

Fëmijët minoriteteve, kryesisht ata të komunitetit rom, nuk gëzojnë mbrojtje specifike nëpërmjet rregullimeve të posaçme mbështetëse në lidhje me inkurajimin dhe lehtësimin e regjistrimit të tyre si shtetas.⁵²⁴ Po kështu, nuk ekzistojnë mekanizma monitorues të regjistrimit të komuniteteve me qëllim identifikimin e tyre si kategori në regjistrat e gjendjes civile.

Aleanca për Fëmijët dhe BKTf janë të shqetësuar në lidhje me problemin e mosregjistrimit të fëmijëve të komunitetit rom, si dhe për mungesën e statistikave të sakta për evidentimin e numrit të fëmijëve romë të regjistruar dhe atyre të paregjistruar. Aleanca, gjithashtu, vëren mungesën e një mekanizmi për identifikimin e popullsisë së

⁵¹⁸ Neni 20, Kushtetuta e R.SH.

⁵¹⁹ Neni 265, Kodit Penal.

⁵²⁰ Neni 8, Kodi i Procedurës Penale.

⁵²¹ Neni 10, Ligji Nr. 7952, Datë 21.06.1995 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar”.

⁵²² Studimi: “Vlerësimi i nevojave të grupeve të minoriteteve në rrethet e Korçës dhe Tiranës”, nëntor 2006, CCF Albania, me përkrahjen financiare të Bashkimit Evropian.

⁵²³ Neni 37, Ligji Nr. 8410, datë 30.09.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”.

⁵²⁴ Ligji Nr. 8950, Datë 10.10.2002 “Për gjendjen civile”.

minoriteteve, çka do të përbënte bazën për mbështetjen dhe ndihmën ndaj tyre.

Megjithë miratimin e “Strategjisë për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom”⁵²⁵ shteti nuk ka marrë ende masa për zbatimin e saj. Po kështu, megjithë iniciativën për hartimin e projektligjit “Për identifikimin dhe regjistrimin e popullsisë rome” ende mbetet e papaparashikueshme koha e miratimit të tij. Aleanca dhe BKTf vërejnë se shteti duhet të marrë masa aktive për t’u garantuar fëmijëve të minoriteteve aksesin për arsim në gjuhën e tyre si dhe për të zhvilluar kulturën e tyre, si dhe për rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit dhe interesimit të prindërve që fëmijët e tyre të ndjekin shkollën, duke qenë se interesimi i tyre paraqitet në nivele shumë të ulëta⁵²⁶. Janë për t’u përsëritur nisma të veçuara për organizimin e mësimin në gjuhën rome, si p.sh., në Savër/Lushnjë, apo në rrethin e Fierit, por ato mbeten ende sporadike dhe të pambështetura e të koordinuara nga strukturat shtetërore. Po kështu, problem mbetet çështja e diskriminimit të komunitetit rom dhe egjiptian dhe mos ekzistenca e një ligji kundër diskriminimit, çka tregon mosvëmendjen e shtetit në këtë drejtim.⁵²⁷ Së fundi, aleanca vëren se është i nevojshëm miratimi i një rregulloreje lidhur me të drejtën e përdorimit të gjuhës amtare të minoriteteve në emërtimet tradicionale lokale dhe treguesve të tjerë topografikë në zonat ku ata banojnë.⁵²⁸

Rekomandime:

- Të merren masa për vënien në zbatim të Ligjit “Për gjendjen civile” me qëllim regjistrimin e komunitetit rom duke ngritur struktura bashkëpunimi ndërmjet pushtetit lokal dhe gjendjes civile me qëllim regjistrimin e fëmijëve të komunitetit rom.⁵²⁹
- Të organizohen fushata ndërgjegjësimi për të gjithë komunitetin dhe, në veçanti, për komunitetin rom për regjistrimin në kohë të lindjeve.⁵³⁰
- Të ngrihen mekanizma për identifikimi e individëve të komunitetit rom në momentin e regjistrimit me qëllim njohjen e këtij grupi dhe sigurimin e mbështetjes së posaçme për të.
- Të amendohet Kodi Penal në lidhje me përfshirjen e diskriminimit për motive racore, apo për motive të tjera, si rrethanë rënduese.
- Të miratohet një rregullore mbi të drejtën e përdorimit të gjuhës amtare të minoriteteve në emërtimet tradicionale lokale dhe treguesve të tjerë topografikë në zonat ku ata banojnë.

⁵²⁵ VKM, Nr. 633, Datë 18.09.2003 “Për miratimin Strategjisë për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom”

⁵²⁶ Shih Aneksi I – Zbatimi i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve analizuar nga këndvështrimi i fëmijëve, dhjetor 2008- janar 2009, f. 17.

⁵²⁷ Initiative e Grupit Shqiptar të të Drejtave të Njeriut për hartimin e Ligjit “Antidiskriminim”.

⁵²⁸ Kjo parashikohet si detyrë për shtetin shqiptar në kuadër të “Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare” dhe “Planit Kombëtar të “MSA” por ende nuk është realizuar.

⁵²⁹ Rekomandim nga shoqata “Amaro Drom”, (www.amarodrom.hu).

⁵³⁰ Rekomandim nga shoqata “Amaro Drom”, (www.amarodrom.hu).

Neni 32 - Fëmijët në situata shfrytëzimi.

Kushtetuta garanton të drejtën e fëmijëve dhe të rinjve për të qenë të mbrojtur nga shfrytëzimi dhe përdorimi për punë.⁵³¹

Mbrojtja e fëmijëve nga shfrytëzimi parashikohet në disa strategji kombëtare⁵³². Gjithashtu, detyrimi i të miturit për të punuar, për të siguruar të ardhura, për të lypur apo për të kryer veprime që dëmtojnë zhvillimin e tij, përbën vepër penale,⁵³³ megjithëse nuk parashikohen sanksione ndaj personave që punësojnë fëmijë në mënyrë të kundërligjshme. Punësimi i fëmijëve ndalohet për sa kohë fëmijët ndjekin arsimin e detyruar.⁵³⁴ Megjithë ndalimet ligjore për punësimin e të miturve, në praktikë ka patur raste të punësimit të tyre, kryesisht të fëmijëve të grup-moshës 15-18 vjeç, duke vënë theksin në faktin se punësimi i tyre është shtyrë nga familja.⁵³⁵ Në Shqipëri janë konstatuar raste të punësimit të të miturve edhe nën moshën e lejuar nga ligji, raste në të cilat punëdhënësit kundërshtojnë ekzistencën e marrëdhënieve të punës me të miturit me mungesën e një kontrate të shkruar pune. Megjithatë, ligji parashikon si një nga format për lidhjen e kontratës së punës formën verbale, mjafton që punëdhënësi të pranojë kryerjen e punës për një kohë të caktuar, ose të pacaktuar, dhe kundrejt pagesës.⁵³⁶ Në këtë kuadër, është e nevojshme marrja e masave me qëllim vënien në zbatim të parashikimeve ligjore dhe për mirëfunksionimin e strukturave përgjegjëse për kontrollin e kushteve të punësimit.

Megjithëse legjislacioni shqiptar ka përcaktuar moshën minimale⁵³⁷ të punësimit, ka ndaluar kryerjen e punës së natës⁵³⁸ dhe të punëve të vështira, ose të rrezikshme⁵³⁹ dhe i ka përcaktuar ato⁵⁴⁰, për të garantuar zbatimin eficient të këtyre dispozitave, është e nevojshme të hartohet një listë me punët e lejuara, çka do të ndihmonte në shmangien e interpretimeve subjektive në këtë aspekt.

Kodi i Punës parashikon kryerjen e kontrollit të plotë mjekësor të të miturve nën moshën 18 vjeç me shpenzimet e punëdhënësit.⁵⁴¹ Megjithatë, ky detyrim nuk zbatohet në praktikë, pasi, në përgjithësi, mungojnë

⁵³¹ Neni 54/1, 3, Kushtetuta e R.Sh.

⁵³² “Strategjia Kombëtare për Fëmijët” dhe “Plani kombëtar i veprimit”, si dhe “Strategjia kombëtare kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjes së fëmijëve viktime të trafikimit”.

⁵³³ Neni 124/b, Kodi penal, shtuar me ligj Nr. 9859, datë 21.01.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 7895, Datë 27.01.1995 “Kodi Penal i RSH”, i ndryshuar.

⁵³⁴ Neni 60, Ligji Nr. 7952, Datë 21.06.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”.

⁵³⁵ Shih Aneks I – Zbatimi i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve analizuar nga këndvështrimi i fëmijëve, dhjetor 2008 – janar 2009, f. 46.

⁵³⁶ Neni 21, parag. 1 dhe 2, Kodi i Punës.

⁵³⁷ Neni 98, Kodi i Punës.

⁵³⁸ Neni 101, Kodi i Punës.

⁵³⁹ Neni 100, Kodi i Punës.

⁵⁴⁰ Vendim Nr. 384, Datë 20.05.1996 “Për mbrojtjen e të miturve në punë”, i ndryshuar dhe Vendim Nr. 2007, Datë 09.05.2002 “Për përcaktimin e punëve të vështira, ose të rrezikshme”.

⁵⁴¹ Neni 103 par. 1, 4, Kodi i Punës.

aktet nënligjore për mënyrën e inspektimit në lidhje me punësimin e fëmijëve dhe të kushteve të punës së tyre.

Gjithashtu, mungon parashikimi i procedurave të ankimimit për fëmijët e punësuar dhe statistikën për numrin e tyre dhe llojet e punëve që bëjnë. Po kështu, kuadri ligjor shqiptar nuk përcakton dhënien e ndihmës të miturve viktimë të shfrytëzimit në punë, apo të punëve të dëmshme, pasi ata identifikohen si të tillë.

Të miturit nga mosha 14 vjeç deri në moshën 16 vjeç mund të jenë subjekt i këshillimit dhe i formimit profesional,⁵⁴² megjithatë, kjo është ende e parregulluar me akte nënligjore të veçanta.

Aleanca e Fëmijëve dhe BKTF janë të shqetësuar për punësimin e paligjshëm dhe shfrytëzimin për punë të fëmijëve, i cili është një fenomen i përhapur në Shqipëri. Rezultojnë rreth 6700 fëmijë të rrugës në Shqipëri. Pjesa më e madhe (61%) e fëmijëve të rrugës në rrethin e Tiranës bëjnë punë si mbledhja e sendeve dhe larja e makinave.⁵⁴³ Një nga format më rënda të shfrytëzimit që evidentohet është ai i lypjes dhe detyrimit të tyre për këtë nga vetë prindërit për shkak të varfërisë ekstreme në të cilën jeton familja. Fëmijët, shpesh, lypin deri në 12 orë në ditë në sheshet dhe rrugët kryesore të Tiranës dhe në qytete të tjera të Shqipërisë, si dhe në orët e vona të natës, duke dëmtuar, kështu, shëndetin e tyre. Fëmijët e rrugës, janë të ekspozuar, për më tepër, ndaj të gjitha formave të dhunës gjatë kohës që ata qëndrojnë në rrugë. Të ardhurat që përfitojnë këta fëmijë nga lypja në rrugë janë aq të larta sa për prindërit është më me interes të detyrojnë fëmijët të lypin se sa të punësohen vetë.⁵⁴⁴ Prindërit e tyre janë, ndër të tjera, edhe ushtrues të dhunës fizike dhe psikologjike ndaj tyre. Këta fëmijë nuk frekuentojnë shkollën. Ndër të tjera, vetë këta fëmijë raportojnë se gjatë kohës që qëndrojnë në rrugë, ata janë fyer dhe keqtrajtuar edhe nga policia, edhe kur kjo e fundit ka tentuar t'i çojë në shtëpi.⁵⁴⁵ Nga një vëzhgim në gusht të vitit 2008,⁵⁴⁶ në Tiranë rezultonte se fëmijët e rrugës nuk mund të plotësojnë shumë nga nevojat e tyre bazike. Ata që angazhohen në punë të pakualifikuara, si grumbullimi i sendeve për t'i shitur dhe larja e makinave, janë, veçanërisht, shtresa më vulnerabël. Ata, gjithashtu, janë të diskriminuar në ambientin e tyre shoqëror. Shpeshherë, ata nuk kanë të rritur të tjerë të familjes të cilët janë të punësuar. Bazuar në sa më lart, alarmant paraqitet punësimi i fëmijëve në mënyrë informale në qytete dhe asnjë masë nuk është marrë nga inspektorati i punës për të monitoruar drejt këtë situatë. Po kështu, shteti shqiptar vazhdon të mos njohë fenomenin e shfrytëzimit të fëmijëve në fshat, angazhimin e tyre në punët e familjes, apo në bujqësi, çka, në të shumtën e rasteve, i pengon ata në frekuentimin e rregullt të shkollës. Aleanca dhe BKTF janë të shqetësuar që ky fenomen nuk është konsideruar as në Strategjinë Kombëtare të Fëmijëve. Aktet nënligjore në këtë aspekt duhet të specifikojnë në detaje: cilat do të konsiderohen punë të "vështira" duke marrë në konsideratë edhe aspektin e vështirësive fizike, të cilat prekin personalitetin, rrezikojnë shëndetin dhe sigurinë e fëmijëve. Aleanca përshëndet kryerjen e trajnimeve pranë

⁵⁴² Neni 98/2, Kodi i Punës.

⁵⁴³ Sipas fushatës së BKTF "Evaluation of the Anti Forced Begging Campaign", 2007, janë 6700 fëmijë të punësuar dhe fëmijë të rrugës në Shqipëri.

⁵⁴⁴ "Karakteristikat e fëmijëve të rrugës në Tiranë". Një studim sasi i Tonya R. Thurman, Lisa Johnson, Bridget Lavin, Elizabeth Bunde, Nancy Mock from Tulane University, USA., në bashkëpunim me World Vision Albania. Gusht, 2008.

⁵⁴⁵ Shih Aneks I – Zbatimi i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve analizuar nga këndvështrimi i fëmijëve, dhjetor 2008 – janar 2009.

⁵⁴⁶ Studim për Fëmijët e Rrugës, Tiranë, Shqipëri, Gusht 2008, World Vision.

disa njëjshive bashkiake (për administratorët socialë), në lidhje me identifikimin e situatave të shfrytëzimit,⁵⁴⁷ por thekson nevojën e shtrirjes së këtyre trajnimeve dhe në njësitë bashkiake në zonat më të largëta të Shqipërisë si dhe për trajnime të mëtejshme për njësitë e tjera.

R. H është një djalë 7 vjeç, i paregjistruar në Zyrën e Gjendjes Civile, nga një fshat i Vlorës, i cili nuk ka shkuar kurrë në shkollë. Ai është nga komuniteti rom dhe jeton në një familje të përbërë nga 7 (shtatë) persona. Të gjithë janë të papunë, por mundohen t'i sigurojnë të ardhurat nga mbledhja e kanaçeve, lypja apo mbledhja e sherebelës (një lloj bime me cilësi kurative) në fshatin ku ata jetojnë. Ndonëse është i vogël, djali R shkon në atë pak tokë që ka familja e tij dhe kujdeset për këtë bimë. Kur bimët rriten aq sa duhet, ai i mbledh dhe ia jep nënës së tij për t'i shitur në treg. Gjithashtu, ai e ndihmon të ëmën që t'i ndajë ato në porcione të caktuara e për t'i paketuar që të jenë të gatshme për t'u shitur.⁵⁴⁸

Ndonjëherë, djali shkon edhe në malin pranë fshatit për të mbledhur bimë të tilla. Kjo ndodh kur prodhimi në tokën e tyre të vogël është i varfër.

Në 15 Mars të vitit 2008, në fshatin e Gërdecit, shpërtheu një depo e municioneve të vendosura në një ish zonë ushtarake pranë këtij fshati. Ngjarja ka shkaktuar vdekjen e 26 personave si dhe plagosjen e shumë të tjerëve. Organet e hetimit kanë pohuar se gjithçka ka ndodhur si pasojë e një procesi të parregullt administrativ, i cili i ka mundësuar ndërmarrjes "MEICO" dhe kompanisë SAC-ALBADERMIL" të realizojë procesin e çmilitarizimit dhe të çmontimit në një situatë kaotike. Gjithashtu, është vërtetuar se, në këtë proces, kanë marrë pjesë njerëz, të cilët nuk kanë patur aftësitë e duhura teknike për të punuar në këtë sektor, si dhe fëmijë nën moshën e përfshirjes në punë. Nga dëshmitë e këtyre të miturve rezulton se në fabrikë punonin fëmijë të moshës nga 12-17 vjeç, por edhe fëmijë 7 vjeçarë, të cilët vinin në fabrikë për të ndihmuar prindërit e tyre. Fëmijët punonin rreth 10 orë në ditë dhe gjatë këtyre orëve nuk i linin të pinin as ujë duke qenë se punonin në kontakt me barutin. Fëmijët e intervistuar tregojnë se punësimi në fabrikë bëhej shumë thjesht. Mjaftonte të paraqiteshe në fabrikë dhe të shpreheshe i interesuar për punë dhe siguri i saj nuk ishte i vështirë. Për punën që siguronin, ata nuk bënë kontrata pune, por firmosnin një fletë në të cilën ishte shkruar se, në rast rreziku, çdo punëtor merr përgjegjësitë e veta.⁵⁴⁹

⁵⁴⁷ Sipas Aneksit II – Informacion nga strukturat kryesore publike dhe jo publike të përfshira në garantimin e të drejtave të fëmijëve, janar-shkurt 2009 (Përmbledhje instrumentesh metodologjike), Protokoll informativ nga Drejtoritë Arsimore Rajonale.

⁵⁴⁸ Rast i raportuar nga organizata Terre des Hommes.

⁵⁴⁹ Gazeta Korrieri, "Çmontoja 300 arka fishekë në ditë", Datë 18.03. 2008.

Rekomandime:



- Të parashikohen specifitime më të sakta të shoqëruar me një listë të detajuar kategori punësh që do të konsiderohen “të lehta” për tu kryer nga të miturit.
- Përdorimi i kombinuar i strategjive të ndryshme për të identifikuar fëmijët e rrugës.
- Mënjani i barrierave për kryerjen e shkollës.
- Krijimi i mundësive për përfshirje sociale.
- Ndihmë për vështirësitë ekonomike që mund të ketë antari i familjes.
- Të ndërmerren fushata sensibilizuese me subjekt publikun, përfshirë edhe grupet që punojnë me fëmijët, me qëllim mbrojtjen e tyre nga shfrytëzimi ekonomik.
- Të plotësohet kuadri ligjor penal ndaj individëve, të cilët punësojnë fëmijë kundra dispozitave ligjore apo nënmoshë.
- Të nxitet identifikimi i fëmijëve të shfrytëzuar për punë, fëmijëve të rrugës, nëpërmjet trajtimit të tyre nga shërbimi social i njësive vendore (njësia e mbrojtjes së fëmijëve aty ku ekziston) dhe organizata të tjera.
- Të merren masa të menjëhershme për të larguar fëmijët e shfrytëzuar nga puna në rrugë.
- Të merren masa për heqjen e përgjegjësisë prindërore në rastet kur prindërit, në mënyrë të përsëritur dhe ekstreme, shfrytëzojnë fëmijët dhe i ekspozojnë ata ndaj rreziqeve të jetës në rrugë.
- Të merren masa për ofrimin e shërbimeve të posaçme për vendosjen e fëmijëve në përkujdesje alternative, tek të afërmit, familje kujdestare ose qendra rezidenciale.

Neni 33 - Fëmijët dhe abuzimi me drogat.

Shteti shqiptar ka aderuar në konventën e vetme mbi drogat narkotike,⁵⁵⁰ në “Konventën e kombeve të bashkuara për substancat psikotrope” (1971) dhe “Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi trafikun ilegal të drogave” (1988).

Megjithëse qeveria shqiptare ka miratuar “Strategjinë kombëtare antidrogë 2004-2010”, kjo strategji nuk ka parashikuar masa dhe afate konkrete veprimi për parandalimin e këtij fenomeni.

Prodhimi, kultivimi, shitja, trafikimi i substancave narkotike, lehtësimi i përdorimit të drogave, si dhe rastet e nxitjes dhe injektimit të detyruar të drogave ndaj të miturve⁵⁵¹ përbëjnë vepër penale. Kodi penal nuk parashikon penalizime për përdoruesit e drogave.

Për fëmijët përdorues të substancave narkotike të hospitalizuar në qendrat rezidenciale parashikohet hartimi

⁵⁵⁰ Ndryshuar nga protokollin e vitit 1972 për ndryshimin e Konventës së vetme mbi drogat narkotike, 1961.

⁵⁵¹ Nenet 283, 283/a, b dhe 284, Kodi Penal.

i planeve individuale⁵⁵² ku pjesë e tij është edhe diskutimi rreth rreziqeve që sjell përdorimi i drogës, apo substancave të tjera narkotike dhe psikotrope.

Në kuadër të luftës kundër kriminalitetit policia ka kryer mbikëqyrjen në shkollat e mesme, por kjo nismë nuk është shtrirë në të gjithë Shqipërinë⁵⁵³.

*Aleanca e Fëmijëve është e shqetësuar për rritjen e fenomenit dhe të numrit të fëmijëve përdorues. Vërehet mungesa e standardeve të veçanta për të miturit përdorues të drogave, të vendosur në qendrat rezidenciale, apo të cilët trajtohen në komunitet. Shpeshherë të miturit përdoren nga persona madhorë, ose janë të shfrytëzuar për prodhimin, kultivimin e substancave apo bimëve narkotike, prandaj lypset të amendohet Kodi Penal në këtë drejtim duke e parashikuar specifikisht këtë si veprë penale apo rrethanë rënduese. Aleanca përshëndet nismën e marrë për mbikëqyrjen e ambienteve arsimore, por sensibiliteti për këtë problem duhet të rritet më tepër edhe përmes fushatave informuese në lidhje me substancat narkotike të ndaluara. Në praktikë rezultoi se burimi kryesor nga është siguruar informacioni është shkolla dhe më pas vijnë emisionet televizive që ndiqen nga fëmijët. Vlen të theksohet fakti se vetëm një pjesë e vogël e fëmijëve janë shprehur se informacionin për drogat e kanë marrë në shtëpi.*⁵⁵⁴

Rekomandime:

- Të hartohen standarde të veçanta për të miturit përdorues të drogave, të vendosur në qendrat rezidenciale, shoqëruar kjo me programe specifike sipas veçorisë dhe problematikave që paraqesin të miturit, me programe ekstra shëndetësore dhe rehabilituese, si dhe programe të veçanta për anëtarët e familjes së tij, duke marrë për bazë interesin më të lartë të fëmijës.
- Të amendohet Kodi Penal me qëllim parashikimin si veprë penale, apo rrethanë rënduese, kur të miturit janë shfrytëzuar për prodhimin, kultivimin e substancave apo bimëve narkotike.
- Të parashikohet si rrethanë cilësuese shpërndarja e substancave narkotike në ambientet shkollore.
- Të merren masa nga organet e rendit për luftimin e fenomenit të përdorimit, abuzimit dhe shpërndarjes së drogës në mjediset shkollore duke zgjeruar aksionin e mbikëqyrjes në të gjitha rrethet e Shqipërisë.
- Të plotësohet legjislacioni penal në lidhje me fëmijët e përfshirë në veprimtari kriminale kur ata

⁵⁵² Vendim Nr. 659, Datë 17.05.2005 “Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për fëmijët në institucionet rezidenciale” parashikon se stafi, fëmija, prindërit dhe/ose të afërmit, apo të interesuarit e tjerë për fëmijën, punojnë së bashku për përgatitjen e një programi individual për fëmijën sipas moshës, nevojave dhe mënyrës të re të jetesës së fëmijës në të ardhmen.

⁵⁵³ Ministria e Arsimit dhe Shkencës, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Brendshme në përmbushje të akt - marrëveshjes dy palëshe, “Për luftën kundër fenomenit të përdorimit, abuzimit dhe shpërndarjes së drogës në mjediset shkollore” si dhe është miratuar një Qarkore nga Drejtoria e Policisë për mbikëqyrjen e përdorimit dhe shitjes së drogave në ambientet arsimore.

⁵⁵⁴ Shih Aneksi I – Zbatimi i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve analizuar nga këndvështrimi i fëmijëve, dhjetor 2008-janar 2009, f. 43.

janë nën ndikimin e substancave narkotike ose të pasojave që vinë për shkak të përdorimit të gjatë të tyre.

Neni 34 - E drejta për t'u mbrojtur nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual.

Mbrojtja e fëmijës nga shfrytëzimi për punë garantohet me kushtetutë, ndërsa abuzimi dhe neglizhimi nuk parashikohen në të.⁵⁵⁵

Mosha, nën të cilën ndalohet kryerja e marrëdhënieve seksuale me fëmijët, është 14 vjeç dhe kur kryhet ajo parashikohet si vepër penale.⁵⁵⁶ Legjislacioni penal është fokusuar në mbrojtjen e fëmijëve nga marrëdhëniet seksuale dhe nuk parashikon mbrojtjen e tyre nga abuzimi. Një mbrojtje e pjesshme garantohet nëpërmjet parashikimit të “veprave të turpshme me të mitur që nuk kanë arritur moshën 14 vjeç”, “marrëdhënieve seksuale dhe homoseksuale me persona të pazotë për t'u mbrojtur”. Kodi Penal, më tej, penalizon ushtrimin e prostitucionit dhe shfrytëzimin e tij dhe, kur ky kryhet ndaj të miturve, e konsideron rrethanë rënduese. Po kështu, dënohet mbajtja e lokaleve për prostitucion. Megjithatë, termi prostitucion nuk përfshin, në vetvete, shërbime seksuale përveç kryerjes së marrëdhënieve seksuale, siç janë p.sh., veprimtaritë seksuale kur personi merr kënaqësi pa kryer marrëdhënie seksuale, por për të cilat paguan, përfshirë edhe rastet e “seksit në telefon”.

Kodi Penal parashikon si kundravajtje penale përdorimin e të miturve për prodhimin e materialeve pornografike si dhe shpërndarjen e këtyre materialeve në ambiente me të mitur.⁵⁵⁷ Problematike është qasja e këtij neni pasi fokusohet në penalizmin e veprimtarisë së industrisë së materialeve pornografike dhe kjo vetëm nëse bëhet në ambientet e të miturve. Neni nuk merr parasysh pasojat që shkaktohen te të miturit. Mungon definicioni i pornografisë, si në KDF, çka sjell probleme në zbatimin e ligjit në praktikë.⁵⁵⁸ Më tej, neni nuk parashikon si rrethanë rënduese rastet kur fëmija është ekspozuar dhe identifikuar si i tillë në publik dhe i janë shkaktuar pasoja të tilla në aspektin moral, emocional dhe psikik. Gjithashtu, mungon parashikimi i rrethanës cilësuese të ngritjes së rrjeteve pornografike në internet.

Të miturit viktimë përjashtohen nga përgjegjësia penale. Ndërsa të miturit që ushtrojnë prostitucion nën kërcënim, apo forma të tjera të kundraligjshme,⁵⁵⁹ nuk përjashtohen për shkak të një rregullimi të posaçëm

⁵⁵⁵ Neni 54, 59, Kushtetuta e RSh.

⁵⁵⁶ Neni 100, Kodi Penal.

⁵⁵⁷ Ligji Nr. 9859, Datë 21.1.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, në nenin 117 (pornografia) pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje: “Përdorimi i të miturit për prodhimin e materialeve pornografike, si dhe shpërndarja ose publikimi i tyre në internet apo në forma të tjera, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet dhe me gjobë nga një milion deri në pesë milionë lekë”.

⁵⁵⁸ Protokolli i KDF mbi shitjen, prostitucionin dhe pornografinë e fëmijëve, e përcakton pornografinë si “Pornografia me fëmijët nënkupton çdo paraqitje, me çfarëdolloj mjeti, të një fëmije të angazhuar në një aktivitet të caktuar seksual të vërtetë apo të simuluar, ose paraqitja e një pjesë seksuale të fëmijës me qëllimin parësor, atë seksual”.

⁵⁵⁹ Neni 113, i Kodit Penal: “Ushtrimi i prostitucionit dënohet me gjobë ose me burgim deri në 3 vjet”. Ndërkohë që referuar nenit 12

nga ndjekja penale. Në këtë rast, kërcënimi duhet të gjykohet si vepër më vete, çka është shumë e vështirë të realizohet në praktikë.

I dëmtuari akuzues i mitur (viktima) ka të drejtë të kërkojë nëpërmjet një padie civile⁵⁶⁰ shpërblimin dhe dëmin që i ka ardhur bazuar në nenin 58 të KP nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor. Nuk ekzistojnë rregulla specifike për ankimin/kallëzimin e të dëmtuarit të mitur dhe legjislacioni nuk parashikon asnjë trajtim të posaçëm për viktimën e mitur gjatë procedurave në polici dhe prokurori. Në fazën e gjyimit, dëshmitarit mund t'i garantohet shmangia plotësisht e kontaktit me personat pjesëmarrës në seancën gjyqësore duke e pyetur atë në distancë përmes mjeteve audiovizive, por kjo dispozitë nuk i referohet ekskluzivisht të miturve dhe as nuk i referon ata,⁵⁶¹ ndërkohë që pyetja e dëshmitarit të mitur në seancë bëhet nga kryetari i trupit gjykues dhe jo nga palët.

Legjislacioni shqiptar penal nuk parashikon ndonjë mbrojtje të posaçme nëpërmjet politikës penale për grupet e veçanta, si fëmijët me aftësi të kufizuar apo fëmijët në institucione.

Ligji, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare,”⁵⁶² parashikon mbrojtjen nga abuzimi seksual edhe në kushtet e familjes duke e kategorizuar abuzimin dhe keqtrajtimin seksual si pjesë të dhunës në familje, megjithatë, kjo nuk ndodh kur abuzimi kryhet jashtë marrëdhënieve familjare. Së fundmi, është marrë një iniciativë ligjore për të hartuar projektligjin: “Për mbrojtjen e fëmijës nga dhuna dhe shfrytëzimi.”⁵⁶³

Shqipëria nuk ka ratifikuar Protokollin Opsional të KDF mbi shitjen, prostitucionin dhe pornografinë e fëmijëve.

“Strategjia Kombëtare e Fëmijëve”⁵⁶⁴ dhe “Plani i veprimit për zbatimin e SKF” nuk parashikojnë masa konkrete për evidentimin, shmangien, parandalimin dhe asistimin e të miturve viktimë të shfrytëzimit dhe abuzimit seksual.⁵⁶⁵ Po kështu, “Plani Kombëtar për zbatimin e MSA”⁵⁶⁶ nuk ka parashikuar, specifikisht,

Kodit Penal mosha për përgjegjësi penale: “*Ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së një krimi ka mbushur moshën 14 vjeç*”.

⁵⁶⁰ Nenin 61-68, Kodi Penal: “Padia civile në procesin penal mund të ngrihet edhe për një dëm jopasuror të parashikuar si të tillë në nenin 625 të Kodit Civil sipas të cilit personi që pëson një dëm të ndryshëm nga ai pasuror ka të drejtë të kërkojë të shpërblehet kur është cenuar në nderin dhe në personalitetin e tij”.

⁵⁶¹ Neni 361/ 7, Kodi i Procedurës Penale.

⁵⁶² Neni 1, Ligj Nr. 9669, Datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” (ndryshuar me ligjin Nr. 9914 datë 12.05.2008).

⁵⁶³ Iniciative e CRCA, mbështetur nga UNICEF.

⁵⁶⁴ Masa për veprim faqe 33 “Institucionalizimi i sistemit të monitorimit të punës së fëmijëve për evidentimin, vlerësimin dhe adresimin e problemit kundër praktikave shfrytëzuese të punës dhe trafikimit të fëmijëve”.

⁵⁶⁵ Në programet mësimore të Akademisë të Policisë “Arben Zylyftari” të Ministrisë Rendit Publik dhe në Institutin një vjeçar të Policisë së Shtetit është përfshirë për studim, Konventa e të Drejtave të Fëmijës. Është planëzuar që ky dokument të punohet dhe njihet nga gjithë efektivat e Policisë së Shtetit së bashku me Strategjinë Kombëtare për Fëmijët dhe paketën ligjore përkatëse me qëllim njohjen e të drejtave të fëmijëve dhe trajtimin specifik të fëmijëve, konform standardeve ndërkombëtare e kombëtare të tyre, kur ata bëhen objekt i punës së policisë. (Strategjia Kombëtare e Fëmijëve, faqe 34).

⁵⁶⁶ VKM Nr. 463, Datë 5.7.2006 “Për miratimin e planit kombëtar për zbatimin e marrëveshjes së stabilizim-asociimit”, f. 341.

mbrojtjen e të miturve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual, duke e trajtuar atë brenda objektivit politik të “Krimet të organizuar dhe terrorizmit.”

Megjithëse “Strategjia kombëtare e luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore, 2008-2010,”⁵⁶⁷ ka prekur fenomenin e shfrytëzimit dhe abuzimit seksual,⁵⁶⁸ ende vazhdon të mbetet i pamjaftueshëm dallimi midis prostitucionit dhe trafikimit të qenieve njerëzore për shfrytëzim seksual.⁵⁶⁹ Në strategji referohet si arritje nënshkrimi i “Memorandumit të Mirëkuptimit për Promovimin dhe Zbatimin e Kodit të Sjelljes për Parandalimin e Shfrytëzimit Seksual të Fëmijëve në Turizëm,”⁵⁷⁰ i cili nuk rezulton të jetë publikuar dhe shpërndarë.

Shteti shqiptar nuk ka regjistër të rasteve të shfrytëzimit seksual me qëllim realizimin e një analize të plotë të situatës në këtë drejtim.

Aleanca e Fëmijëve është e shqetësuar për mungesën e mekanizmave ligjore eficiente për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi seksual dhe shfrytëzimi. Gjithashtu, shteti shqiptar nuk ka ndërmarrë fushata edukimi dhe informimi kundër shfrytëzimit seksual të fëmijëve. Fakti që në Shqipëri ndodhin skandale të tilla si rasti i Qendrës “Fëmijët e tij” do të thotë se shteti ka treguar mangësi në parandalimin e abuzimit seksual dhe shfrytëzimit të fëmijëve. Njëkohësisht, vështirësia me të cilën u përball sistemi i drejtësisë për të vërtetuar akuza si ngritja e një rrjeti pornografik dhe shfrytëzimi i fëmijëve nga disa të rritur, që vizitonin qendrën me qëllim përfitimin seksual dhe abuzimin e tyre, tregon për nevojën e përshtatjes sa më të mirë të legjislacionit me parimet dhe standardet e konventës. Më tej, në komunitetet rome dhe egjiptiane nuk respektohet mosha minimale për lejimin e marrëdhënieve seksuale. Fëmijët lejohen që të vegjël të “martohen” dhe të lindin fëmijë. Ky fenomen është i pranishëm më shumë, sidomos, në komuniteti rom. Këto martesë nuk mund të ligjërohen për shkak të moshës dhe shpesh bëhen shkak që dhe fëmijët e lindur nga to të mos regjistrohen.⁵⁷¹ Më shumë fushata ndërgjegjësimi dhe forcimi i zbatimit të ligjit duhet të ndërmerren në këtë drejtim. Në lidhje me trajtimin e fëmijëve viktime të abuzimit,

⁵⁶⁷ VKM Nr. 1083, Datë 23.7.2008 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore, 2008-2010, si dhe të dokumentit plotësues “Strategjia kombëtare për luftën kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve, viktime të trafikimit”.

⁵⁶⁸ Përkufizimet ligjore ku mbështetet Strategjia kundër Trafikimit të Fëmijëve: Për qëllimin e kësaj Strategjie: **Trafikim i qenieve njerëzore** nënkupton rekrutimin, transportimin, transferimin, strehimin ose pranimin e personave me anë të kanosjes ose përdorimit të forcës ose formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, hilesë, apo të përfitimit nga pushteti ose pozitës së dobët ose të dhënies apo marrjes së pagesave apo avantazheve për të arritur pëlqimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër për qëllime shfrytëzimi. **Shfrytëzimi nënkupton**, së paku, shfrytëzimin e të tjerëve për prostitucion apo forma të tjera **shfrytëzimi seksual**, punë apo shërbime të detyruara, skllavëri ose praktika të ngjashme me skllavërinë, robëri ose heqje të organeve.

⁵⁶⁹ “Strategjia kombëtare për luftën kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve, viktime të trafikimit”, f. 5.

⁵⁷⁰ “Memorandumit të Mirëkuptimit për Promovimin dhe Zbatimin e Kodit të Sjelljes për Parandalimin e Shfrytëzimit Seksual të Fëmijëve në Turizëm” ndërmjet Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, f. 76.

⁵⁷¹ Sipas të dhënave të OJF-e Amoro Drom, Shkurt 2009.

mëgjithë faktin se ata intervistohen kryesisht nga oficerë policie femra dhe, në disa raste, në prezencë të psikologut, policia nuk ka protokolle të mirëfillta dhe trajnim të posaçëm për intervistimin dhe trajtimin e duhur të këtyre fëmijëve për mos riviktimizimin e tyre.⁵⁷² Fëmijët, viktimat të abuzimit dhe shfrytëzimit seksual, nuk njihen si kategori në nevojë dhe nuk trajtohen me programe të veçanta multidisiplinare dhe me ndihmë financiare kur është e nevojshme. As administratori social pranë njërive të pushtetit vendor nuk ka një protokoll mbi bazën e të cilit të veprojnë për trajtimin e fëmijëve të abuzuar/shfrytëzuar seksualisht. Trajnimet për ta në këtë drejtim kanë qenë sporadike.⁵⁷³

Rekomandime:

- Të amendohet legjislacioni penal dhe procedural penal në lidhje me parashikimin e plotë dhe të përshtatshëm të veprave me objekt abuzimin dhe shfrytëzimin seksual si dhe të plotësohet dispozita mbi pornografinë duke e parashikuar atë si krim kur kjo kryhet me subjekt të miturin.
- Të parashikohet me ligj mbështetja dhe asistimi ligjor/psikologjik dhe trajtimi i viktimave fëmijë kur janë të dëmtuar nga veprat penale të shfrytëzimit, apo keqtrajtimit seksual, për kërkimin e dëmshpërblimit nga autorët e veprave penale.
- Të miratohet ligji për mbrojtjen; Parashikimi i ri ligjor për largimin nga situata kriminale; Asistenca e viktimave dhe ri-integrimi i tyre në analogji me viktimat e dhunës në familje.
- Të amendohet Kodit i Procedurës Penale në lidhje me procesin e ankimit apo kallëzimit të fëmijës viktimë.
- Të hartohen protokolle standarde dhe të trajnohen punonjësit e policisë, administratorët sociale në lidhje me trajtimin e fëmijëve të abuzuar/shfrytëzuar seksualisht.
- Të ratifikohet nga Shqipëria Protokoll i Opsional i KDF mbi shitjen, prostitucionin dhe pornografinë e fëmijëve

Familja X nga një lagje e Tiranës kishte 6 fëmijë, të cilët nuk mund t'i ushqente dhe për këtë babai i vajzës në bisedë e sipër me disa persona që trafikonin fëmijë, të cilët i përdornin për shfrytëzim seksual, u dha vajzën për qëllime fitimi. Vajza është shitur tek një italian dhe është përdorur për video kaseta porno.⁵⁷⁴

⁵⁷² Sipas Aneksit II – Informacion nga strukturat kryesore publike dhe jo publike të përfshira në garantimin e të drejtave të fëmijëve, janar-shkurt 2009 (Përmbledhje instrumentesh metodologjike), Protokoll informativ nga Komisaritet e Policisë.

⁵⁷³ Sipas Aneksit II – Informacion nga strukturat kryesore publike dhe jo publike të përfshira në garantimin e të drejtave të fëmijëve, janar-shkurt 2009 (Përmbledhje instrumentesh metodologjike), Protokoll informativ nga Administratori Social.

⁵⁷⁴ Rast nga praktika Amaro Drom, Selitë, Tiranë, Shkurt 2009.

Neni 35 - E drejta e mbrojtjes nga rrëmbimi, shitja ose trafikimi për çdo qëllim dhe në çfarëdo forme qoftë.

Kushtetuta,⁵⁷⁵ nuk sanksionon mbrojtjen e fëmijëve nga trafikimi, rrëmbimi⁵⁷⁶ apo shitja. Shqipëria ka ratifikuar Konventën e Hagës, “Për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit” (29 Maj 1993),⁵⁷⁷ “Konventën e Hagës mbi aspektin civil të rrëmbimit të fëmijëve,”⁵⁷⁸ “Konventën shtesë mbi heqjen e skllavërisë, tregtisë së skllavërve dhe institucioneve e praktikave të ngjashme me to”⁵⁷⁹ dhe “Konventën për kontrollin e trafikimit të personave dhe shfrytëzimin e prostitucionit.”⁵⁸⁰ Gjithashtu, është ratifikuar Konventa e OKB “Kundër krimit të organizuar ndërkombëtar” dhe dy protokollat shtesë të saj.⁵⁸¹ Megjithatë, nuk është ratifikuar Protokollin Shtesë i Konventës së të Drejtave të Fëmijëve, “Në lidhje me shitjen e fëmijëve, prostitucionin e fëmijëve dhe pornografinë.”

Shteti shqiptar ka adresuar fenomenin e trafikimit në dokumente strategjike e ligjore.⁵⁸² Megjithëse në këto dokumente përcaktohet vlerësimi sistematik i fenomenit, të dhënat në këtë aspekt vazhdojnë të mbeten sporadike, duke u përqendruar kryesisht në fushën e ndjekjeve penale, dhe nuk përfshijnë shifra nga parandalimi i fenomenit sipas konceptit të “Fëmijëve në rrezik.”⁵⁸³

Duke qenë se fenomeni i trafikimit të fëmijëve shqiptarë në Greqi është raportuar si alarmant duke filluar nga viti 2002 dhe duke qenë se deportimi i fëmijëve ka qenë e vetmja praktikë e kthimit të fëmijëve shqiptarë nga autoritet greke,⁵⁸⁴ për shkak të advokimit të koalicionit të BKTF, “Bashkë kundër trafikimit të fëmijëve,”⁵⁸⁵

⁵⁷⁵ Neni 54/3, Kushtetuta e R.Sh.

⁵⁷⁶ Neni 27, Kushtetuta e R.Sh, “.. askujt nuk mund t’i hiqet liria, përveçse në rastet dhe me procedurat e parashikuara në ligj”.

⁵⁷⁷ Ratifikuar me Ligjin Nr. 8624, Datë 15.06.2000.

⁵⁷⁸ Ratifikuar me Ligjin Nr. 9446, Datë, 24.11.2005.

⁵⁷⁹ Dekretuar nga Presidenti, Nr. 2613, datë 10/03/1958, <http://www.unhchr.ch/html/menu3/b/treaty4.htm> (pranimi 6 Nëntor 1958).

⁵⁸⁰ Dekretuar nga Presidenti, Nr. 2613, datë 10/03/1958, <http://www.unhchr.ch/html/menu3/b/treaty11a.htm> (pranimi 6 Nëntor 1958)

⁵⁸¹ Ligj Nr. 8920, Datë 11.7.2002 “Për ratifikimin e “Konventës së kombeve të bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar” dhe dy protokollave shtesë të saj”.

⁵⁸² “Strategjia kombëtare e luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore, 2008-2010”, si dhe të dokumentit plotësues “Strategjia kombëtare për luftën kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve, viktimat të trafikimit” parashikojnë trajtimin e viktimave bazuar në të drejtat e njeriut dhe vlerësimin sistematik të këtij fenomeni. Në këtë kuadër janë miratuar “Standardet e shërbimeve të përkujdesat shoqëror, në qendrat rezidenciale, për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi”.

⁵⁸³ Terre des hommes dhe Arsis, raportojnë rreth 720 viktimat të dyshuara trafikimi në Shqipëri dhe Greqi dhe rreth 250 fëmijë në rrezik për vitin 2007 ndërsa shifra e identifikuar nga struktura policore anti-trafik është vetëm 32, BKTF, *Raporti i Vlerësimit të Situatës së Trafikimit të Fëmijëve në Shqipëri*, Tiranë, 2007.

⁵⁸⁴ Terre des hommes, Transnational protection of children. The case of Albania and Greece 2000 – 2006, Tirana.

⁵⁸⁵ BKTF, është një koalicion shqiptar i cili përbëhet nga 19 organizata vendase dhe të huaja të cilat punojnë dhe kanë programe konkrete në fushën e parandalimit, mbrojtjes, kthimit vullnetar të asistuar dhe riintegrimi të fëmijëve të trafikuar apo në rrezik trafikimi. (www.bktf-coalition.org).

si me shtetin shqiptar dhe me atë grek, u bë e mundur nënshkrimi i Marrëveshjes mes të dy shteteve për mbrojtjen dhe asistencën e fëmijëve viktimë të trafikut.⁵⁸⁶ Në këtë marrëveshje parashikohet bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve policore, hartimi i standardeve të përbashkëta për mbledhjen e informacionit dhe shkëmbimet statistikore, krijimi i një baze të dhënash për referimet e bëra, miratimi i rregulloreve në lidhje me riatdhësimin në kufi dhe procedurat në këtë rast, monitorimi i asistencës së dhënë fëmijëve-viktima pas riatdhësimit të tyre, përfshirë kushtet e jetesës dhe kushtet e ribashkimit me familjen, miratimi i procedurave efektive për identifikimin e viktimave fëmijë në territoret e tyre, detyrimi i referimit të një fëmije viktimë tek një autoritet kompetent, vendosja e fëmijës në kujdestari pas referimit në strehëz apo qendër.⁵⁸⁷ Megjithatë, deri në momentin që është shkruar ky raport, marrëveshja nuk ka filluar të zbatohet për shkak se nuk është realizuar njoftimi diplomatik i nevojshëm që marrëveshja të vihet në jetë. Krahas bashkëpunimit ndërkombëtar me qëllim uljen e fenomenit të trafikimit të fëmijëve jashtë vendit, autoritetet policore duhet të ngrenë ura bashkëpunimi me organizatat që ofrojnë shërbime komunitare për të parandaluar trafikimin e brendshëm të fëmijëve.⁵⁸⁸ Statistikat tregojnë se vetëm 27% e rasteve të trafikimit të fëmijëve janë trafikuar dhe shfrytëzuar brenda vendit, megjithatë, duhet të merren masa për parandalimin e këtij fenomeni, i cili rezulton të jetë në rritje.⁵⁸⁹

Shteti shqiptar ka synuar të ngrejë një mekanizëm kombëtar referues⁵⁹⁰, pranë Autoritetit Përgjegjës në Ministrinë e Brendshme, duke e lehtësuar nëpërmjet një marrëveshjeje bashkëpunimi mes ministrive të ndryshme, IOM dhe disa OJF-ëve. Sistemi i referimit, megjithatë, nuk ka funksionuar plotësisht. Megjithë aspektin pozitiv të ngritjes së qendrës pritëse për viktimat e trafikimit në Linzë, referimi i fëmijëve tek kjo qendër has në problematika pasi fëmijët mbahen në të njëjtat ambiente me të rriturit. (*Shih informacionin e mëposhtëm*). Gjithashtu, në kuadër të përmirësimit të situatës së fëmijëve të trafikuar, e rëndësishme është ngritja e një baze të dhënash për mbledhjen e të dhënave të personave që hyjnë dhe dalin nga Shqipëria. Ky sistem, i cili është funksional në shumë pika kufitare, ende nuk është instaluar në të gjithë vendin, megjithë përcaktimet se do të përfundonte brenda vitit 2007.⁵⁹¹

⁵⁸⁶ **Ligjin Nr. 9544, Datë 29.5.2006 për ratifikimin e marrëveshjes midis Qeverisë së Republikës Greke dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë** “Për mbrojtjen dhe asistencën e fëmijëve viktimë të trafikimit.

⁵⁸⁷ Neni 8-10, **Ligjin Nr. 9544, Datë 29.5.2006, për ratifikimin Marrëveshja midis Qeverisë së Republikës Greke dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë** “Për mbrojtjen dhe asistencën e fëmijëve viktimë të trafikimit.

⁵⁸⁸ “Situata e përpjekjeve në Shqipëri për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore 2007-2008”, përgatitur nga USAID, tetor 2008. Shembull bashkëpunimi është marrëveshja lokale e bashkëpunimit midis Drejtorisë së Policisë së Qarkut Gjirokastrë dhe Qendrës komunitare në Gjirokastrë, f. 82.

⁵⁸⁹ “Situata e përpjekjeve në Shqipëri për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore 2007-2008”, përgatitur nga USAID, tetor 2008, f. 20.

⁵⁹⁰ Urdhër i përbashkët, Nr. 3394/4, datë 17.5.2006, Ministria e Brendshme, Urdhri Nr. 1192, Datë 19.5.2006, Ministria e Punës dhe e çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Urdhri Nr. 7590, Datë 24.5.2006 për Ngritjen e Mekanizmit Kombëtar Referues, Ministria e Punëve të Jashtme.

⁵⁹¹ “Raport i analizës së situatës së trafikimit të fëmijëve në Shqipëri”, BKTF, f. 27.

Kodi Penal ka parashikuar veprën penale të trafikimit, rrëmbimit dhe pengmarrjes së fëmijëve, shfrytëzimit të fëmijëve për punë⁵⁹² si dhe shitjen e fëmijëve.⁵⁹³ Parashikimi ligjor i trafikimit⁵⁹⁴ është bazuar në definicionin e parashikuar në Protokollin e Palermos ku shfrytëzimi i fëmijëve parashikohet si rrethanë rënduese.⁵⁹⁵ Rrëmbimi dhe pengmarrja e fëmijës⁵⁹⁶ parashikohet si vepër penale më vete duke parashikuar si rrethanë cilësuese rastin kur ajo kryhet ndaj fëmijës nën 14 vjeç, e shoqëruar me tortura fizike ose psikike. Nga parashikimet e mësipërme, vëmë re se elementi i rrëmbimit, i vendosur në kontekstin e përfitimit material, është i ndryshëm nga ai i trafikimit, në të cilin përdoret si terminologji rekrutimi dhe konteksti i ndodhjes së këtij veprimi është shfrytëzimi. I rëndësishëm ka qenë amendimi i Kodit Penal me veprën penale të shfrytëzimit të fëmijëve për punë apo shërbime të detyruara,⁵⁹⁷ e cila e penalizon këtë fenomen jo vetëm në kontekstin e trafikimit. Ajo arrin të garantojë mbrojtje në një fazë paraprake duke qenë një mjet më shumë në parandalimin e krimit të trafikimit. Së fundi, Kodi Penal është plotësuar duke parashikuar si vepër penale detyrimin e të miturve për të punuar për të siguruar të ardhura dhe për të lypur.⁵⁹⁸

Megjithatë, legjislacioni shqiptar nuk parashikon si vepër penale shitjen e fëmijëve, në kuptimin e marrjes së çdo lloj përfitimi nga ana e prindit/kujdestarit në këmbim të dhënies së fëmijës dikujt tjetër, pavarësisht se elemente të shitjes dhe të përfitimit gjenden në nenin 128/b në kontekstin e trafikimit. Pra, në një rast kur do të kishim marrjen e një shume të ardhurash, apo një përfitimi, nga dhënia e fëmijës jo për t'u shfrytëzuar dhe as për t'u trafikuar, një veprim i tillë do të ishte i papenalizueshëm në kuadrin ligjor ekzistues. Kodi Penal paraqet mangësi në rastet e “marrjes pa të drejtë të fëmijës”. Ky akt sipas Kodit Penal klasifikohet si kundravajtje penale. Kjo bën që prokuroria të mos mund të marrë masa të tilla si ndalimi i personave të cilët mbajnë pa tagër fëmijën, pra, ku nuk janë prindërit apo kujdestarët ligjorë të tij. Gjithashtu, Kodi Penal parashikon dënimin edhe të shtetasve të huaj që kryejnë veprën penale të trafikimit të fëmijëve, si brenda territorit të RSh dhe jashtë

⁵⁹² Ligji Nr. 9859, Datë 21.1.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, neni 124/b, “Keqtrajtimi i të miturit”. Keqtrajtimi fizik ose psikologjik i të miturit nga personi që është i detyruar të kujdeset për të, dënohet me burgim nga tre muaj deri në dy vjet. Detyrimi i të miturit për të punuar, për të siguruar të ardhura, për të lypur apo për të kryer veprime, që dëmtojnë zhvillimin e tij dënohet me burgim deri në katër vjet dhe me gjobë nga pesëdhjetë mijë deri në një milion lekë. Kur nga vepra është shkaktuar dëmtimi i rëndë i shëndetit ose vdekja e të miturit, dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet”.

⁵⁹³ Neni 128/b, Ligji Nr. 9859, Datë 21.1.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7895, Datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”.

⁵⁹⁴ Neni 110/a, 128/b, Kodi Penal.

⁵⁹⁵ Neni 114/a, Kodi Penal.

⁵⁹⁶ Neni 109, Kodi Penal.

⁵⁹⁷ Neni 128/b, Ligji Nr. 9686, Datë 26.02.2007 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 27.1.1995 “Kodi Penal i R.Sh”, të ndryshuar. Hartimi i këtij mendimi ligjor është rezultat i advokimit të Koalicionit BKTF dhe bashkëpunimit të Zyrës së Koordinatorit Kombëtar për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore pranë Ministrisë së Brendshme.

⁵⁹⁸ Neni 124/b, Ligji Nr. 9859, Datë 21.01.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 27.1.1995 “Kodi Penal i R.Sh”, të ndryshuar.

saj.⁵⁹⁹ Gjithashtu, penalizohet kërkimi, propozimi, dhënia apo marrja e shpërblimeve apo përfitimeve të tjera që lidhen me procesin e birësimit të të miturit,⁶⁰⁰ por pa specifikuar rastet e birësimeve ndërvendase.

Në Shqipëri janë krijuar gjykatat e krimeve të rënda.⁶⁰¹ Këto gjykata kanë të drejtë të pyesin dëshmitarët⁶⁰² në praninë e të pandehurit dhe mbrojtësit, por pa kontakt vizual me ta, si dhe në raste të veçanta, pa u komunikuar këtyre të fundit identitetin e dëshmitarëve. Megjithatë, ky ligj nuk përmban rregulla të posaçme për dëshmitarët e mitur⁶⁰³ në lidhje me të drejtën e tyre për të dëshmuar, e cila duhet të konsiderohet në zbatim të parimit të interesit më të lartë të fëmijës. Po kështu, Kodi i Procedurës Penale,⁶⁰⁴ ka parashikuar masa për pyetjen në distancë me mjete audiovizive të dëshmitarit, por pa referuar detyrimin për mbrojtje të posaçme të dëshmitarit të mitur.

I mituri parashikohet të përfitojë nga mbrojtja që garanton shteti për “dëshmitarët dhe bashkëpunëtorët e drejtësisë”⁶⁰⁵ nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjes nga ana e prindit/kujdestarit, marrëveshje e cila duhet të bëhet në interesin më të lartë të fëmijës. Megjithë përfshirjen e këtij parimi, fëmijës nuk i është garantuar e drejta për t’u dëgjuar dhe vetë parimi është i pazbërthyer për të bërë të mundur zbatimin e tij.

Standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat e trafikuar, ose në rrezik trafikimi, në qendrat rezidenciale janë të përgjithshme për të gjithë viktimat, pa pasur ndonjë fokus tek specifikat e fëmijës.

Aleanca për Fëmijët dhe BKTF janë të shqetësuar në lidhje me mungesën e mekanizmave mbrojtëse dhe paafësisë për të identifikuar rreziqet dhe shkaqet që çojnë në trafikimin e fëmijëve. Gjithashtu, disa projekte në kuadër të Planit të Veprimit për Fëmijët e Trafikuar, 2005-2007, nuk janë realizuar, ose janë realizuar pjesërisht. Në termat e fushatës kundër trafikimit të fëmijëve, vetëm fushata kundër lypjes së detyruar ka pasur si objektiv të

⁵⁹⁹ Neni 7/d, Kodi Penal.

⁶⁰⁰ Neni 124/a, Kodi Penal.

⁶⁰¹ Ligji Nr. 9110, Datë 24.7.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda”. Neni 5 parashikon se gjykatat e krimeve të rënda gjykojnë në shkallë të parë dhe të dytë veprat penale me një rrezikshmëri të lartë shoqërore si ato të krimit të organizuar, ndër të cilat edhe trafikimin e qenieve njerëzore apo trafikimin e fëmijëve, të parashikuara si të tilla në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale.

⁶⁰² Neni 8, Ligji Nr. 9110, Datë 24.7.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda”.

⁶⁰³ Pavarësisht se mund të interpretohet se rregullat e mësipërme mund të aplikohen krahas atyre të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale për pyetjen e dëshmitareve të mitur.

⁶⁰⁴ Neni 361/5, 361/7, Kodi i Procedurës Penale, “Pyetja e dëshmitarëve të mitur mund të bëhet nga kryetari, mbi kërkesat dhe kundërshtimet e palëve. Kryetari mund të ndihmohet nga një familjar i të miturit ose nga një specialist i fushës së edukimit të fëmijëve. Kur çmohet se pyetja e drejtpërdrejtë e të miturit nuk e dëmton gjendjen psikologjike të tij, kryetari urdhëron që pyetja të vazhdojë sipas dispozitave”.

Referuar planit të MSA do të ndërmerret iniciativa ligjore në - Shtesat në Ligjin nr. 9205, datë 15/03/2004 “Për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë”, iniciativë e cila do të jetë pjesërisht në përputhje me Rezolutën e Këshillit “Për Mbrojtjen e Dëshmitarëve”, Datë 23 nëntor 1995.

⁶⁰⁵ Neni 16, 5, Ligji Nr. 9205, datë 15.3.2004, “Për Mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”.

miturit, në veçanti, ndërkohë që pjesa tjetër e aktiviteteve për informimin e publikut është fokusuar tek fenomeni i trafikimit dhe emigracionit të paligjshëm. Mekanizmi Kombëtar i Referimit (MKR) nuk ka kryer funksionin e tij për të identifikuar dhe adresuar trafikimin e fëmijëve dhe shteti nuk ka mundur të reagojë me shpejtësi për të gjetur dhe mbrojtur fëmijët e trafikuar. Strategjia e re Anti-trafik 2008-2010 i ka kushtuar rëndësi mirëfunksionimit të Autoritetit Përgjegjës (AP) si organi kryesor për mbarëvajtjen e MKR-së duke bërë që gjatë vitit 2008 niveli i identifikimit të rritet.⁶⁰⁶ Përgjegjësia parësore për identifikimin e rasteve duhet të jetë tek shërbimet shoqërore, të cilat akoma janë të paafta të kryejnë këtë funksion. Gjithashtu, Aleanca dhe BKTF vërejnë se Komitetet Rajonale Anti-trafik, të krijuara në 12 qarqe të vendit prej vitit 2006, nuk kanë mundur të kryejnë rolin e tyre. Problematik mbetet, ende, trajnimi i punonjësve të policisë dhe prokurorëve mbi teknikat e intervistimit dhe identifikimit të fëmijëve të trafikuar. Gjithashtu, vlen për t'u theksuar fakti se shteti nuk është i aftë t'u ofrojë trajtimin e duhur fëmijëve të pashoqëruar që identifikohen në kufi. Fëmijët nuk përfitojnë asistencë në raste emergjente të tipit mjekësor, psikologjik apo edhe ligjor. Një nga tiparet e trafikimit të fëmijëve në Shqipëri është fakti që prindërit janë të përfshirë direkt apo tërthorazi në shfrytëzimin e tyre dhe shumë pak sanksione vendosen mbi prindërit që abuzojnë me fëmijët e tyre, si psh., në rastet e shitjes së fëmijës nga prindërit. Privatësia dhe stigmatizimi janë, gjithashtu, çështje me rëndësi në luftën kundër trafikimit. Nëpunës shtetërorë kanë shkelur privatësinë e fëmijëve duke nxjerrë informacione private mbi fëmijët e trafikuar ose në rrezik,⁶⁰⁷ duke sjellë si pasojë stigmatizimin e viktimave, të cilët në Shqipëri vazhdojnë të konsiderohen jo si viktimë, por si persona të lidhur me aktivitetin e paligjshëm.

Informacion mbi Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikimit, Linzë

Është për tu përmendur se ngritja e Qendrës Pritëse të Linzës përbën një hap përpara dhe se kjo qendër është treguar bashkëpunuese me OJF-të për të realizuar sa më mire koordinimin e shërbimeve të nevojshme për viktimat e trafikimit fëmijë dhe femra.⁶⁰⁸

Në vitet 2006-2009, në Qendrën Kombëtare të Pritjes së Viktimave të Trafikimit kanë qëndruar 43 të mitur, nga të cilët 73% e tyre janë vlerësuar të mitur në rrezik trafikimi dhe 27% të mitur viktimë të trafikimit. Të miturit qëndrojnë në Qendër për një periudhë kohe, e cila varion nga 1 deri në disa muaj dhe u sigurohen kushtet e nevojshme të jetesës. Qendra përbëhet nga dy ambiente, në njërin prej tyre ndodhet administrata e institucionit dhe të mitur meshkuj në rrezik trafikimi dhe emigrantë të huaj dhe në tjetrin janë akomoduar vajzat, viktimë të trafikimit apo në rrezik trafikimi. Në qendër janë krijuar ambiente të përbashkëta për zhvillimin e aktiviteteve në grup dhe të miturit kanë të drejtën e një kontakti telefonik dy herë në muaj dhe një herë në

⁶⁰⁶ Sipas të dhënave të AP në data-bazën janë raportuar 108 raste trafikimi ndërmjet të cilëve 17 janë fëmijë.

⁶⁰⁷ BKTF, Situational Analysis on Child Trafficking in Albania, Tiranë, 2007

⁶⁰⁸ Marrëveshja e Bashkëpunimit të Qendrës Pritëse të Linzës me Qendrën e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të integruara për ofrimin e asistencës psikologjike dhe ligjore për viktimat.

muaj kanë të drejtë të takohen me prindërit.⁶⁰⁹

E.F i datëlindjes 11/07/1988 është banor i qytetit të Cërrikut. Vjen nga një familje me probleme të theksuara social-ekonomike. Që në moshën 6 vjeçare, E. F u trafikua në Greqi. Tutorët e tij e shfrytëzuan për 5 vjet për të lypur dhe për të vjedhur. E. F vendos të vetëdorëzohet në polici duke denoncuar dhe tutorët e tij. Organet policore greke e dorëzojnë në kufi. E. F rikthehet pas 6 vjetësh në shtëpi. Por nuk përfundon këtu. E. F i gënjyer nga disa persona largohet përsëri nga shtëpia për në qytetin e Durrësit, ku përfshihet në grupe të rinjsh përdorues të drogës, prostitucionit, etj. Për të siguruar jetesën dhe drogën, lypnin në portin e Durrësit dhe vidhnin banesa private.⁶¹⁰

E.F evidentohet nga OJF-ja “Terre des Hommes,” e cila bën përpjekjet e para për ta larguar nga kjo rrugë. Ata punuan me të, por ishte tepër e vështirë të arriheshin rezultate konkrete. Për ta larguar nga rruga që kishte marrë TdH e referon atë te “Tjetër Vizion” për trajtim të mëtejshëm dhe afatgjatë. I shoqëruar nga punonjës të “Terre des Hommes” viziton ambientet e “Komunitetit strehëz” si dhe i shpjegohet shërbimi. E. F vendos të qëndrojë dhe të bëjë kthesën e jetës së tij. Shumë shpejt ai u përshtat me jetën në komunitet, iu largua veseve të këqija si dhe u rivendosën kontaktet me familjen.

Pas një pune disa mujore E. F kaloi në strukturën e apartamenteve të mbrojtura. Gjatë periudhës së qëndrimit në apartament, E. F përfundoi një kurs profesional 6 mujor.⁶¹¹

Rekomandime:

- Të mendohet Kodi i Procedurës Penale në lidhje me përdorimin në çdo rast të mjeteve audiovizive për marrjen e dëshmisë fëmijëve viktime të trafikimit, shfrytëzimit të prostitucionit, me qëllim shmangien e përballjes së fëmijës me autorin dhe mosrreviktimizimin e tij.
- Të parashikohet ligjërisht ulja e kohëzgjatjes së procedurës për marrjen e dëshmisë së fëmijëve në këto procese gjyqësore.
- Të amendohet Ligji Nr. 9205, datë 15.3.2004, “Për Mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë” duke parashikuar dispozita të formatuara për të miturit si dhe të garantojë marrjen/konsiderimin e mendimit të fëmijës.

⁶⁰⁹ Informacion mbi Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikimit, Linzë, Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara/ Klinika Ligjore për të Mitur.

⁶¹⁰ Rast i raportuar nga qendra “Tjetër Vizion”, Elbasan.

⁶¹¹ Rast i raportuar nga organizata “Terre des Hommes”.

- Të merren masa për zbatimin e Standardeve të Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për personat e trafikuar, ose në rrezik trafikimi, në qendrat rezidenciale: VKM Nr. 195, datë 11.4.2007.
- Të monitorohet dhe të raportohet mbi të dhënat nga zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Luftën Kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjes së Fëmijëve Viktima të Trafikut nga Koordinatori Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore.
- Të akreditohen OJF-të ofruese të shërbimeve për fëmijët e trafikuar dhe në rrezik trafikimi në një sistem gjithëpërfshirës të mbledhjes së të dhënave, të administruara nga Autoriteti përgjegjës, pranë Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore. Të bëhet përcaktimi i rregullave të konfidencialitetit, si masë për garantimin e mbrojtjes së fëmijëve.
- Të respektohet nga ana e gjyqësorit prania e psikologut gjatë procesit të marrjes së dëshmisë në procesin penal nga të dëmtuarit e mitur (viktima).
- Të sigurohet qëndrueshmëria e punonjësve të policisë antitrafik bazuar në terma reference të qarta dhe të pajisen ata me njohuri për mbrojtjen e fëmijëve.
- Të hartohen terma reference për procedurat standarde të operimit për profesionistët e përfshirë në identifikimin, mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijëve të trafikuar.
- Një vëmendje më e madhe duhet t'i kushtohet fenomenit të trafikimit të brendshëm, i cili rezulton në rritje. Masa duhet të merren për gjetjen e fëmijëve të rrëmbyer brenda vendit në një kohë sa më shkurtër.
- Të rritet bashkëpunimi ndërkufitar i të gjitha agjencive shtetërore (policisë, shërbimeve sociale qendrore dhe lokale) sidomos për procesin e identifikimit dhe gjurmimit të trafikimit të fëmijëve.
- **Të merren masa për shtrirjen e bazës së të dhënave për fëmijët e trafikuar që menaxhohet nga Autoriteti përgjegjës në të gjithë pikat kufitare si dhe të fillojë zbatimi i bazës së të dhënave shtesë për viktimat e trafikimit, i cili është ende në procesin e hartimit nga grupet e punës.**⁶¹²

Neni 36 - Mbrojtja nga çdo formë shfrytëzimi.

Kushtetuta parashikon mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi, pa e lidhur këtë të drejtë me formën e shfrytëzimit.⁶¹³ Në legjislacionin aktual shqiptar nuk përmendet në mënyrë specifike mbrojtja e fëmijëve të talentuar nga shfrytëzimi. Kuadri ligjor në fushën e arsimit ka parashikuar të vetmet dispozita për këtë kategori fëmijësh,⁶¹⁴ të cilat kanë më tepër karakter deklarativ dhe gjejnë zbatim në kuadrin e ndjekjes së

⁶¹² BKTF, Analiza e Situatës, 2007 faqe 27, bazuar në Raportin e vlerësimit të **Ministritë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Mars 2008.**

⁶¹³ Neni 54/3, Kushtetuta e RSh.

⁶¹⁴ Ligji për “Sistemin arsimor parauniversitar” parashikon se institucionet parashkollore, arsimit parauniversitar publik në bashkëpunim me prindërit, synon edukimin dhe zhvillimin e personalitetit të fëmijës, të zhvillojë aftësitë intelektuale, krijuese, praktike dhe fizike

arsimit parauniversitar, përfshirë këtu programet kulturore dhe sportive brenda atij mësimor. Legjislacioni nuk rregullon dhe as monitoron punën vullnetare, ose me pagesë, të fëmijëve të talentuar.

Ligji ndalon publikimin e gjeneraliteteve dhe të fotografive të të pandehurve të mitur, të akuzuar, ose të dëmtuar nga vepra penale,⁶¹⁵ (viktima) përfshirë edhe ata që janë të shfrytëzuar për çfarëdolloj qëllimi. Subjektet mediatike nuk parashikohen në mënyrë specifike pasi ligji e lidh publikimin me çdo formë në të cilën ai realizohet. E drejta për t'u mbrojtur nga shfrytëzimi mediatik garantohej në formë pasive dhe nuk ka krijuar mekanizma proaktive. Kur kjo e drejtë shkelet dhe nuk përbën vepër penale, kur personi që e bën publikimin është një nëpunës i shtetit ose i një enti publik, atëherë veprimi konsiderohet si shkelje disiplinore dhe është prokurori, i cili duhet të njoftojë organin përkatës për të dhënë sanksione për këtë shkelje. Në rast se ky veprim kryhet nga mediat private, atëherë rregullimi i mësipërm nuk gjen aplikim dhe e vetmja formë për të vendosur në vend të drejtën e shkelur është ajo e kërimit të shpërblimit të dëmit jopasuror⁶¹⁶ nga ana e të miturit, proces për të cilin atij nuk i garantohej mbrojtja falas.

Mbrojtja e fëmijës të përfshirë në procese penale realizohet nëpërmjet aplikimit të gjykimit me dyer të mbyllura.⁶¹⁷ Ky rregull aplikohet edhe në fushën e procesit civil,⁶¹⁸ kur kjo çmohet e arsyeshme nga gjykata.

Shfrytëzimi mediatik nuk është adresuar as në “Strategjinë Kombëtare për Fëmijët.”⁶¹⁹ Megjithatë, mekanizma mbrojtës të përgjithshëm garantohej, pa iu referuar specifiku të miturve, në kuadër të së drejtës për privatësi.⁶²⁰

E drejta për të mos bërë publike fakte dhe të dhëna shtrihet edhe tek avokati i mbrojtjes, edhe në rastin e klientit të mitur,⁶²¹ pa referencë të posaçme, ndërkohë që rregullat e përfaqësimit, duke përfshirë prindërit apo kujdestarin ligjor, gjejnë zbatim.

të nxënësve, të zhvillojë në mënyrë harmonike personalitetin dhe potencialin e nxënësve për t'i aftësuar ata të kontribuojnë në mënyrë sa më aktive në zhvillimet ekonomike, politike, sociale e kulturore të vendit.

⁶¹⁵ Neni 103/4, Kodi i Procedurës Penale, parashikon “... Gjykata mund të lejojë publikimin vetëm kur e kërkojnë interesat e të miturit ose kur i mituri ka mbushur moshën 16 vjeç”.

⁶¹⁶ Neni 625, Kodi Civil “personi që pëson një dëm të ndryshëm nga ai pasuror ka të drejtë të shpërblehet kur ka pasur një dëmtim të shëndetit ose është cenuar në nderin e personalitetit të tij”.

⁶¹⁷ Neni 340/c, Kodit i Procedurës Penale.

⁶¹⁸ Neni 26/2, Kodit të Procedurës civile parashikon se: Gjykata mund të mos lejojë pjesëmarrjen e media, kur çmon se nuk është në dobi të gjykimit, megjithatë vendimi përfundimtar i gjykatës shpallet publikisht.

⁶¹⁹ Seksioni “Fëmijët dhe Media” ngritur pas miratimit të “Strategjisë Kombëtare për Fëmijët”, miratuar me vendim Nr. 368, Datë 31.05.2005, dhe ku theksohet vetëm bashkëpunimi i medias me fëmijët për të fuqizuar zërin e tyre, por jo tek shfrytëzimi.

⁶²⁰ Neni 2, Ligji Nr. 8517, Datë 22.07.1999 për “Mbrojtjen e të dhënave personale”, parashikon përkufizimin e të dhënave personale, me të cilat do të kuptohet çdo e dhënë për një individ të identifikuar ose të identifikueshëm nga kjo e dhënë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, neni 10 i këtij ligji parashikon se trajtimi i të dhënave personale nga të tjerët lejohet vetëm në rast se subjekti i këtyre të dhënave, ka dhënë shprehimisht pëlqimin për këtë trajtim.

⁶²¹ Ligji Nr. 9109 Datë 17.07.2003 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, parashikon se avokatit i ndalohet të bëjë publike të dhëna që i ka mësuar nëpërmjet personit të mbrojtur ose të përfaqësuar nga ai, ose nga dokumentet që ky i fundit i ka venë në dispozicion, në funksion të mbrojtjes së kërkuar, me përjashtim të rastit kur i mbrojturi ka dhënë miratim me shkrim.

Problematike paraqiten e drejta e gazetarëve për të anashkaluar garancitë e mbrojtjes së jetës private kur këtë e kërkon interesi publik, e cila mund të krijojë kushtet për shfrytëzim mediatik,⁶²² për sa kohë nuk rregullojnë në mënyrë të posaçme mbrojtjen e të miturit dhe lejimin e këtij veprimi vetëm kur është në interesin më të lartë të fëmijës.

Legjislacioni shqiptar nuk e parashikon në mënyrë konkrete, si përkufizim dhe si procedurë, eksperimentin mjekësor, megjithatë, është e ndaluar kryerja e provave klinike me barnat te njerëzit, pa i informuar dhe pa e marrë pëlqimin e tyre me shkrim, por pa specifikuar kategorinë e fëmijëve.⁶²³ Gjithashtu, asnjë parashikim në lidhje me këtë aspekt nuk përfshihet në Strategjinë Kombëtare të Fëmijëve.

Aleanca e Fëmijëve është e shqetësuar për mungesën e mekanizmave eficiente dhe të përshtatshëm për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi mediatik, duke marrë parasysh vulnerabilitetin e fëmijëve dhe pasojat që ka ekspozimi jo i përshtatshëm dhe i kundërligjshëm në media për jetën, zhvillimin, mirërritjen dhe mirëqenien e fëmijëve. Aleanca vëren se mbrojtja e fëmijëve të talentuar, apo shfrytëzimi mediatik, mjekësor dhe mbrojtja e jetës private të fëmijëve, në përgjithësi, nuk ka qenë në vëmendjen e shtetit shqiptar, i cili nuk ka parashikuar asnjë masë në lidhje me to, as në dokumentet politiko-strategjike. Gjithashtu, nuk janë ngritur shërbime rehabilituese për fëmijët që kanë qenë viktimë të çdo forme shfrytëzimi të parashikuar nga ky nen.

Rekomandime:

- Të amendohet Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale, Ligji për Avokatinë, Ligji për Mbrojtjen e të dhënave personale dhe Ligji për barnat.
- Të hartohet një akt rregullator ligjor i posaçëm, i cili rregullon marrëdhëniet e medias me fëmijët, në çfarëdo pozicioni që ata janë kur bashkëpunojnë me median.
- Të ngrihet një organ monitorues dhe sanksiondhënës administrativ në lidhje me ankesat e fëmijëve në këtë drejtim.
- Të trajnohen gazetarët në lidhje me raportimin e rasteve të fëmijëve në media.
- Të parashikohet një ligj i ri për eksperimentimin mjekësor, i cili të përfshijë të gjitha procedurat në lidhje me testimin e metodave të reja mjekësore, përfshirë pacientët e mitur.

⁶²² Neni 4, paragrafi 3, Kodi Etik i Medias Shqiptare, i cili është një dokument jo me fuqi ligjore, “gazetarët mund të botojnë informacione apo pamje të jetës private kur kjo është një domosdoshmëri e interesit publik”.

⁶²³ Ligji Nr. 9323, Datë. 11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”.

Neni 37 - Tortura, trajtimet degraduese dhe privimi i lirisë

Shteti shqiptarë ka ratifikuar “Konventën kundër torturës, trajtimit çnjerëzor dhe degradues.”⁶²⁴ Kuadri ligjor shqiptar, garanton të gjithë shtetasit, përfshirë edhe fëmijët, nga tortura, trajtimet çnjerëzore dhe poshtëruese. Dënimi me vdekje është shfuqizuar.

I mituri mund të privohet nga liria vetëm në rastet e mbikëqyrjes të tij për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij në organin kompetent. Ligji garanton të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të tij.⁶²⁵ Ndërsa heqja e paligjshme e lirisë përbën veprë penale.⁶²⁶

Privimi i lirisë për personat me probleme të shëndetit mendor parashikohet në rastet kur personi paraqet rrezikshmëri për shëndetin dhe/ose jetën e të tjerëve, kryen veprime kundër sigurisë publike, apo me veprimet e tij dëmton ose shkatërron objektet përreth.

Legjislacioni penal Shqiptar, ndalon dhënien e dënimit me burgim të përjetshëm për të miturin që nuk ka mbushur moshën 18 vjeç,⁶²⁷ si dhe në çdo rast dënimi me burgim nuk jepet më shumë se ½ e masës së dënimit që parashikon ligji për veprën penale të kryer,⁶²⁸ apo përjashton të miturin nga dënimi në rastet e rrezikshmërisë së pakët të veprës penale dhe sjelljes së mëparshme të të miturit.⁶²⁹ Dënimi mund të ulet nën kufijtë e parashikuar nga ligji kur i mituri paraqet rrezikshmëri të vogël, duke zbatuar dispozitat për pezullimin e ekzekutimit të vendimit me vënie në provë të miturin, me kusht që gjatë kësaj periudhe të mos kryejë veprë tjetër penale.⁶³⁰ I mituri mund të kryejë dënimin e tij edhe me një dënim alternativ nga ai me burgim, duke punuar në interes publik.⁶³¹ Është për t'u përmendur se falë përpjekjeve të disa OJF-ve⁶³² të mbështetura nga UNICEF, ka filluar që nga shtatori 2007, në qytetin e Tiranës zbatimi i projektit të “Mbikëqyrjes së urdhrave të shërbimit në komunitet” i cili ka synuar të vërë në efikëncë zbatimin e masave alternative për të miturit në konflikt me ligjin. Vetëm në vitin 2008 janë dhënë 52 masa të tilla.⁶³³

⁶²⁴ “Konventa kundër torturës, trajtimit çnjerëzor dhe degradues” (10 dhjetor 1984).

⁶²⁵ Neni 27/5, Kushtetuta e RSH.

⁶²⁶ Neni 110, Kodi Penal.

⁶²⁷ Neni 31, Kodi Penal.

⁶²⁸ Neni 51, Kodi Penal.

⁶²⁹ Neni 52, aKodi Penal.

⁶³⁰ Neni 59, Kodi Penal.

⁶³¹ Neni 63, Kodi Penal.

⁶³² Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara në bashkëpunim me Prokurorinë e Rrethit Tiranë dhe UNICEF, bazuar në një marrëveshje mirëkuptimi kanë realizuar koordinimin dhe zbatimin e urdhrave në shërbim të komunitetit. Qendra “Don Bosko” YAPS, Qendra Maria Magdalen” dhe Ndërmarrja e Gjellbërimit pranë Bashkisë së Tiranës kanë shërbyer si qendra pritjesh për këta fëmijë. Ky projekt po shtrihet edhe në Shkodër dhe Korçë nga janari 2009.

⁶³³ Neni 31/7, Ligji Nr. 10024, Datë 27.11.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr 8331, Datë 21.04.1998 “ Për ekzekutimin e vendimeve penale”.

I mituri nën 14 vjeç⁶³⁴ nuk mund të mbahet apo ndalohet nga organet policore. Të miturit kanë të drejtën e mbrojtjes me një avokat të zgjedhur vetë, apo një avokat falas të caktuar nga shteti.⁶³⁵ Duke qenë se kualiteti i ndihmës ligjore falas ka lënë shumë për të dëshiruar për shkak se ligji nuk parashikonte specifikisht detyrat e avokatit, pavarësisht detyrimeve të përgjithshme, të cilat lindnin për shkak të zbatimit të Ligjit “Për avokatinë në R.Sh”, disa OJF të specializuara në dhënien e ndihmës ligjore, ndërmorën iniciativën ligjore për hartimin e Ligjit “Për ndihmën ligjore falas,”⁶³⁶ i cili reformon gjithë sistemin e ndihmës ligjore dhe hyn në fuqi në 14 prill 2009.

Afatet e paraburgimit llogariten nga çasti i arrestimit ose i ndalimit.⁶³⁷ Për të miturit nuk janë parashikuar afate të posaçme. Megjithatë masat e sigurisë me burgim parashikohen të jepen në rast se çdo masë tjetër rezulton të jetë e papërshtatshme, për subjektin e mitur, ligji nuk bën parashikime të posaçme duke mos respektuar parimin e konsiderimit të tyre si masa përjashtimore.⁶³⁸

Gjatë qëndrimit në institucionet e paraburgimit, shërbimi mjekësor sigurohet gjatë gjithë kohës së qëndrimit në institucion.⁶³⁹ Pavarësisht nga prania e mjekëve në institucion, shpesh, nuk ofrohen kontrole periodike. Vizita mjekësore realizohet vetëm në raste të rënda.⁶⁴⁰

Të miturit e vuajnë dënimin në institucione të posaçme vetëm për ta dhe, në pamundësi, në seksione të veçanta të institucioneve të tjera. Të miturat vajza mbahen nën mbikëqyrjen dhe kujdesin vetëm të një personeli femëror.⁶⁴¹ I njëjti parashikim është edhe për të miturit në dhomat e paraburgimit,⁶⁴² por në praktikë janë konstatuar jo rrallë raste kur ata kanë qëndruar në të njëjtën dhomë me persona të rritur.⁶⁴³

Të dënuarve u garantohej trajtimi social edukativ nëpërmjet veprimtarive individuale dhe formuese në

⁶³⁴ Neni 12, Kodi Penal.

⁶³⁵ Në rastin e të miturit M. M të përfaqësuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit në Gjykatën e Apelit Shkodër gjatë vitit 2007, i mituri ishte hetuar nga Prokuroria e rrethit Lezhë pa pasur një avokat (qoftë dhe kryesisht), në një kohë kur i mituri ishte analfabet dhe i përkiste një familje me probleme sociale.

⁶³⁶ “Studim analize mbi vlerësimin situatës së ndihmës ligjore falas” në Shqipëri, korrik 2006-mars 2007, Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara, mbështetur nga UNICEF dhe hartimi i projekt-ligjit nga Tirana Legal Aid Society në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë mbështetur nga UNICEF.

⁶³⁷ Neni 250/1, Kodi Penal.

⁶³⁸ Shih Aneksi III – Raport monitorues mbi zbatimin e të drejtave të fëmijëve në ambientet e paraburgimi dhe burgut, kryer nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, janar-mars 2009, f. 7.

⁶³⁹ Neni 33, Ligji Nr. 8238, Datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve”, të ndryshuar.

⁶⁴⁰ Shih Aneksi III – Raport monitorues mbi zbatimin e të drejtave të fëmijëve në ambientet e paraburgimi dhe burgut, kryer nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, janar-mars 2009, f. 7.

⁶⁴¹ Neni 17, Ligji Nr. 8328, Datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, neni 20, ‘Rregullorja e përgjithshme e burgeve’.

⁶⁴² Pika 1, “Rregullorja për sigurimin dhe trajtimin e të paraburgosurve”.

⁶⁴³ Shih Aneksi III – Raport monitorues mbi zbatimin e të drejtave të fëmijëve në ambientet e paraburgimi dhe burgut, kryer nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, janar-mars 2009, f. 8.

përputhje me të dhënat e personalitetit të tyre.⁶⁴⁴ Pranë burgjeve funksionon shërbimi edukativ dhe shëndetësor, puna e të cilit konsiston, ndër të tjera, edhe në mbledhjen e të dhënave në lidhje me personalitetin e të dënuarit, të dhëna gjyqësore, psikologjike, fiziologjike, shoqërore etj, të cilat bëjnë të mundur evidentimin e karakteristikave të çdo të dënuari.⁶⁴⁵ Ky informacion përbën bazën për gjykimin e uljes së dënimit dhe/ apo lirimit para kohe me kusht,⁶⁴⁶ megjithatë, personeli i shërbimit edukativ nuk ka të drejta proaktive për të kërkuar uljen e dënimit për të miturit në rastin kur këta kanë treguar sjellje të mirë dhe rezultojnë të rehabilituar. Për të dënuarit e mitur, bëhet një program i posaçëm dhe favorizues për lidhjet me familjen.⁶⁴⁷ Kështu, në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) në Vaqar, të miturve u garantohej takimi me familjaret 1 herë në javë. Problem në këtë drejtim mbeten të miturit, të cilët megjithëse të dënuar, mbahen pranë institucioneve të paraburgimit për shkak të kohës së shkurtër që u mbetet për të kryer dënimin. Në këto raste, strukturat përkatëse nuk i transferojnë ato në IEVP në Vaqar.

Në rastet e shkeljeve disiplinore, ligji nuk parashikon lloje masash të posaçme për të miturit, por sanksionon përgjysmimin e kohës së parashikuar për të rriturit⁶⁴⁸ duke bërë diferencimin vetëm në aspektin sasior. Gjithashtu, nuk parashikohet respektimi i të drejtës së të miturit për t'u asistuar me avokat gjatë procedurës së shqyrtimit të shkeljes dhe të dhënies së masës disiplinore.⁶⁴⁹ Për dhënien e masave disiplinore për shkeljet e rënda dhe shumë të rënda, ngrihet komisioni disiplinor i IEVP me urdhër të drejtorit të institucionit. I dënuari dëgjohet për pretendimet e tij dhe i lejohet mbrojtja me avokat. Për të burgosurit e huaj duhet të sigurohet ndihma e një përkthyesi.⁶⁵⁰ Sipas këtij parashikimi e drejta e mbrojtjes së të dënuarit mbetet fakultative dhe në çmimin e autoriteteve të burgut, ndërkohë që të miturit duhet t'i garantohej mbrojtja në mënyrë të detyrueshme.

Së fundmi, nëpërmjet nismës ligjore për hartimin e një ligji specifik për të drejtat e fëmijëve, rikonfirmohen edhe një herë të drejtat e fëmijës të parashikuara në nenin 37 të KDF-së.⁶⁵¹

Aleanca e Fëmijëve vëren se situata në praktikë ka ende probleme në zbatimin e standardeve ligjore ku thekson dhënien e masës së sigurisë me burgim ende një masë të konsiderueshme për të miturit.⁶⁵² Kohëzgjatja e qëndrimit

⁶⁴⁴ Neni 32, Ligji Nr. 8238, Datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve”, të ndryshuar.

⁶⁴⁵ Neni 78, “Rregullorja e përgjithshme e burgjeve” VKM, Nr. 303, Datë 25.03.2009.

⁶⁴⁶ Neni 63, Ligji Nr. 8238, Datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve”, parashikon se “për uljen e dënimit, vlerësohet qëndrimi i të dënuarit nga ulja e mëparshme ose gjatë 12 muajve të fundit”.

⁶⁴⁷ Neni 40, Ligji Nr. 8238, Datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve”, parashikon “për uljen e dënimit, vlerësohet qëndrimi i të dënuarit nga ulja e mëparshme ose gjatë 12 muajve të fundit”.

⁶⁴⁸ Neni 53, Ligji Nr. 8238, Datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve”, parashikon “për uljen e dënimit, vlerësohet qëndrimi i të dënuarit nga ulja e mëparshme ose gjatë 12 muajve të fundit”.

⁶⁴⁹ Neni 53, Ligji Nr. 8238, Datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve”, të ndryshuar.

⁶⁵⁰ Neni 52/6, “Rregullorja e përgjithshme e burgjeve” VKM, Nr. 303, Datë 25.03.2009.

⁶⁵¹ Neni 33, Projektligji “Për Mbrojtjen e të Drejtave të fëmijës”.

⁶⁵² Shih Aneksi III – Raport monitorues mbi zbatimin e të drejtave të fëmijëve në ambientet e paraburgimi dhe burgut, kryer nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, janar-mars 2009, f. 3.

në vendet e paraburgimit është shumë e gjatë. Bazuar në raportin e monitorimit të Komitetit të Helsinkit, kryer në janar-mars 2009, për respektimin e të drejtave të të miturve që ndodheshin në dhomat e ndalimit dhe të shoqërimit, si dhe në disa paraburgime,⁶⁵³ rezulton se 34 të mitur kishin më pak se 6 muaj të paraburgosur, 11 të mitur kishin 6 muaj deri në një vit dhe vetëm 3 të mitur kishin më shumë se 1 vit që qëndronin të arrestuar në institucionet e paraburgimit.⁶⁵⁴ Nga intervistat e kryera me të mitur, ata pretenduan se në shumë dhoma të ndalimit dhe shoqërimit, të miturit merreshin në pyetje në mjedise të papërshtatshme, nga punonjës policie të pakualifikuar dhe pa respektuar kërkesat e ligjit për dhënien e asistencës ligjore dhe psikologjike.⁶⁵⁵ Për këto arsye ankesat, më të shumta dhe më serioze për shkelje të të drejtave të fëmijëve pranë Avokatit të Popullit, kanë qenë ndaj komisariateve të policisë apo organeve të prokurorisë për shkelje të procedurave të hetimit.⁶⁵⁶ Gjithashtu, një pjesë e mirë e infrastrukturës së komisariateve ishin në rikonstrukcion dhe, për rrjedhojë, kushtet e mbajtjes së të miturve ishin të papërshtatshme. Megjithë rregullin se të miturit mbahen të veçuar nga të rriturit, jo të gjitha komisarariatet kanë dhoma të përcaktuara vetëm për të mitur dhe janë konstatuar raste që të miturit kanë qëndruar në institucionet e paraburgimit në të njëjtën qeli me të rriturit. Edhe në ato raste kur gjendeshin dhoma për të miturit, infrastruktura, kushtet fizike, higjiena dhe pajisjet vetjake linin për të dëshiruar. Megjithëse janë ndërmarrë hapa pozitive për përmirësimi e kushteve fizike dhe hijeno-sanitare, në disa prej institucioneve të paraburgimit ku qëndrojnë të miturit, situata mbetet ende problematike në pjesën tjetër të institucioneve të paraburgimit dhe të ekzekutimit të vendimeve penale. Qelitë janë të papastra, të ftohta dhe në disa prej këtyre institucioneve të miturit gatuanin edhe vetë në dhomë, pavarësisht se institucioni ofronte ushqimin.⁶⁵⁷ Lë për të dëshiruar përgatitja e programeve individuale me të miturit si dhe organizimi i më shumë aktiviteteve kulturore dhe sportive. Problem shqetësues për burgjet shqiptare është mbipopullimi, i cili rrit numrin e të miturve që qëndrojnë në një qeli, në kundërshtim me kapacitetin e lejuar. Gjithashtu, ka pasur raste që të miturit kanë treguar⁶⁵⁸ se ndaj tyre është përdorur dhunë gjatë momentit të ndalimit, qëndrimit në paraburgim si dhe gjatë vuajtjes së dënimit.

⁶⁵³ Gjatë periudhës janar – mars 2009 u kryen nga KSHH 18 misione monitorimi në dhomat e ndalimit dhe shoqërimit: Tiranë, Vlorë, Shkodër, Elbasan, Korçë, Gjirokastrë dhe Durrës si dhe në institucionet e paraburgimit: Vlorë, Durrës, Shënkoll Lezhë, Peqin, Rrogozhinë, Korçë.

⁶⁵⁴ Shih Aneksi III – Raport monitorues mbi zbatimin e të drejtave të fëmijëve në ambientet e paraburgimi dhe burgut, kryer nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, janar-mars 2009, f. 3.

⁶⁵⁵ Studim Krahësues “Legjislacioni shqiptar dhe Konventa e të drejtave të fëmijëve”, f. 492, Qendra e shërbimeve ligjore dhe praktikave të integruara, me përkrahje financiare nga SIDA dhe Save the Children”.

⁶⁵⁶ Raporti i veçantë “Për veprimtarinë e Avokatit të Popullit në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve”, Tiranë 2008, f. 4.

⁶⁵⁷ Shih Aneksi III – Raport monitorues mbi zbatimin e të drejtave të fëmijëve në ambientet e paraburgimi dhe burgut, kryer nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, janar-mars 2009, f. 6.

⁶⁵⁸ Studim Krahësues “Legjislacioni shqiptar dhe Konventa e të drejtave të fëmijëve”, f. 492, Qendra e shërbimeve ligjore dhe praktikave të integruara, me përkrahje financiare nga SIDA dhe Save the Children”, Shih Aneksi III –Raport monitorues mbi zbatimin e të drejtave të fëmijëve në ambientet e paraburgimi dhe burgut, kryer nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, janar-mars 2009, f. 8.

Po rrija në shtëpi dhe aty ra dera. E hapa dhe ishin 10–15 policë. Më thanë: “Ti je XH?” “Po unë jam, pse çfarë ka ndodhur?” “Nuk e di ti se çfarë ka ndodhur” - m’u përgjigjën. Shkova u vështa dhe pastaj dola. Atje para derës sime ishin disa makina jo-policie dhe një furgon policie. Mua më futën në një golf me katër policë. Në makinë kërkuan të më vinin prangat dhe kur unë nuk pranova, polici që kishte prangat më gjuajti në kokë me to dhe më shau me llafe të pista. Pastaj m’i lidhën duart nga prapa me pranga.⁶⁵⁹



Rekomandim:

- Të përmirësohet legjislacioni penal për ta konsideruar, arrestimin, paraburgimin apo dënimin me burgim si masë e cila jepet përjashtimisht dhe vetëm në raste ekstreme.
- Të amendohet Kodi i Procedurës penale për parashikimin e afateve të shkurtuara të gjyqimit për të mitur.
- Të merren masa për të përmirësuar kushtet fizike, hijeno-sanitare dhe ushqimin në institucionet e paraburgimit dhe të ekzekutimit të vendimeve penale.
- Të krijohen mekanizma ku të miturit e mbajtur në burg dhe paraburgim të mund të shfaqin lirshëm dhe në mënyrë të sigurt për ta ankesat e tyre.
- Të ndërmerren fushata informuese me qëllim njohjen e mekanizmit kërkesë-ankesë nga të miturit.
- Të hartohen programe trajnimi të vazhdueshme për punonjësit e policisë, me qëllim specializimin e tyre për kryerjen e intervistave sensitive për fëmijët dhe mënyrat e komunikimit me fëmijët e rritur.

Neni 38 - Mbrojtja e fëmijëve të prekur nga konfliktet e armatosura.

Kuadri ligjor shqiptar përcakton moshën 19-27 vjeç për përfshirje në shërbimin e detyrueshëm ushtarak. Shteti shqiptar ka ratifikuar “Konventën e Gjenevës”,⁶⁶⁰ dhe ka aderuar në Protokollin Shtesë të saj⁶⁶¹ si dhe në Protokollin Opsional të Konventës së OKB-së “Për përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura”. Po kështu, ka ratifikuar Konventën “Për ndalimin e përdorimit, të magazinimit, të prodhimit dhe të transferimit

⁶⁵⁹ Studim Krahësues “Legjislacioni shqiptar dhe Konventa e të drejtave të fëmijëve”, f. 492, Qendra e shërbimeve ligjore dhe praktikave të integruara, me përkrahjen financiare nga SIDA dhe Save the Children”.

⁶⁶⁰ “Konventa e Gjenevës e 12 Gushtit 1949” ratifikuar në datë 27.05.1957.

⁶⁶¹ “Protokollin shtesë i Konventës së Gjenevës të 12 gushtit 1949 në lidhje me mbrojtjen e viktimave të konflikteve të armatosura ndërkombëtare” (Protokolli I), në “Protokollin shtesë të Konventës së Gjenevës të 12 gushtit 1949 në lidhje me mbrojtjen e viktimave të konflikteve të armatosura jondërkombëtare” (Protokolli II) (të miratuara në Gjenevë të Zvicrës në Konferencën Diplomatike më 7.6.1977) dhe në Protokollin “Për miratimin e një simboli plotësues, dallues” (8 dhjetor 2005) (Protokolli III).

të minave kundër personit (mkp) dhe për shkatërrimin e tyre”.

Mbrojtja e fëmijëve nga armët dhe eksplozivi parashikohet si objektiv në “Strategjinë Kombëtare të Fëmijëve,”⁶⁶² por kjo mbrojtje nuk ka gjetur rregullim specifik në kuadrin ligjor shqiptar.

Aleanca është e shqetësuar sepse, pas vitit konfliktit të vitit 1997, popullsia civile ka ardhur në posedim të llojeve të ndryshme të armëve, prandaj është e nevojshme t'i kushtohet një vëmendje e veçantë sensibilizimit të fëmijëve për rrezikun e mbajtjes dhe përdorimit të armëve, duke e përfshirë atë në kurrikulat shkollore. Në këtë kuadër, sensibilizimi duhet të përfshijë, jo vetëm aspektin e sigurisë fizike, por edhe informimin për përgjegjësinë penale, pasi armëmbajtja pa leje përbën veprë penale,⁶⁶³ për më tepër, duhet të përfshihet në kurrikulat shkollore mbrojtja e fëmijëve nga armët dhe eksplozivi.

Rekomandim:

- Të plotësohet kuadri ligjor për mbrojtjen e fëmijëve nga armët dhe eksplozivi.

Neni 39 – E drejta për riaftësimin fizik e psikologjik dhe ri-integrimin në shoqëri

Kushtetuta parashikon, të drejtën për kujdes shëndetësor⁶⁶⁴ për të gjithë shtetasit, por jo të drejtën për ri-integrim dhe rehabilitim social. Megjithatë legjislacioni shqiptar parashikon masa për mbështetjen, rehabilitimin e viktimave, lehtësimin e pasojave dhe parandalimin e dhunës në familje,⁶⁶⁵ ky sistem mbrojtjeje dhe rehabilitimi nuk sigurohet jashtë kontekstit të marrëdhënieve familjare.

Ligji shqiptar ka parashikuar masa për rehabilitimin e të miturve viktime të trafikimit, apo në rrezik trafikimi, ndërkohë që ka një boshllëk në lidhje me masat për të miturit viktime të torturës, të dhunës, abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ekonomik apo seksual.

Në kuadrin e ofrimit të mbështetjes psiko-sociale të fëmijëve, është për t'u vlerësuar përfshirja e psikologut në shkolla, megjithatë, numri i psikologëve nuk është i mjaftueshëm për të garantuar eficiencë në këtë trajtim pasi një psikolog mbulon disa shkolla dhe për shkollat e fshatit kjo nuk garantohet. Gjithashtu, mbetet ende problematike çështja e trajnimit të mësuesve në lidhje me aftësitë për identifikimin e rasteve që kanë nevojë për trajtim në mënyrë që të riaftësohen dhe ri-integrohen. Mësuesit e shohin detyrën e tyre më shumë të lidhur me

⁶⁶² Pika II, nënpika Mbrojtja e Fëmijëve e “Strategjisë Kombëtare të Fëmijëve” miratuar me VKM Nr. 368, Datë 31.05.2005.

⁶⁶³ Neni 278, Kodi Penal.

⁶⁶⁴ Neni 55, Kushtetuta e R.Sh.

⁶⁶⁵ Ligji Nr. 9669, Datë 18.12.2006 “Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare”.

aspektin mësimor dhe jo me atë psiko-social.⁶⁶⁶

Ligji shqiptar parashikon të drejtën për dëmshpërblim të fëmijëve viktimë të shfrytëzimit, ose keqtrajtimit. Përfaqësimi i të miturit në këto procedura gjyqësore bëhet nga prindërit ose nga kujdestarët ligjorë dhe ai ka të drejtë të përfitojë ndihmë ligjore falas.⁶⁶⁷

Angazhimi i të miturve si të dëmtuar akuzues apo dëshmitarë në procese penale, me gjithë parashikimin e disa mjeteve procedurale, si shmangia e kontaktit të viktimës me të akuzuarin dhe përfshirja e avokatit mbrojtës,⁶⁶⁸ apo pyetja e dëshmitarit të mitur nga kryetari i seancës gjyqësore, pra jo nga palët,⁶⁶⁹ është i paplotë pasi këto mjete nuk parashikohen si të detyrueshme në çdo rast për të miturit mbi bazën e llojit të veprës penale,⁶⁷⁰ apo moshës së fëmijës.

Aleanca për Fëmijët është e shqetësuar, në përgjithësi, se shërbimet ri-integruese ofrohen kryesisht nga organizatat lokale dhe ndërkombëtare, ndërkohë që e vetmja qendër pritëse shtetërore është ajo për viktimat e trafikimit⁶⁷¹ dhe ajo nuk mjafton në rang vendi dhe njëkohësisht nuk ka seksion të veçantë për fëmijët. Në këtë kuadër, Aleanca vëren se është e domosdoshme marrja e masave për zbatimin e ligjit për Masat ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare në lidhje me bashkërendimin e strukturave përgjegjëse,⁶⁷² përkatësisht polici, pushtet lokal, qendra pritëse, familje kujdestare, apo vendosja pranë të afërmeve në rastet kjo kur fëmijët rrezikohen nga dhuna në familje dhe jashtë saj. Gjithashtu, shqetësim përbën fakti i moszbatimit të ligjit për “Ndihmën juridike falas” në lidhje me garantimin e të drejtës së të miturve për akses në shërbimin ligjor falas për proceset civile, për marrjen e masave me karakter mbrojtës⁶⁷³ dhe kërkimin e dëmshpërblimit. Ndërkohë, që mekanizmat për mbështetjen, rehabilitimin dhe riaftësimin e fëmijëve nga dhuna jashtë kontekstit familjar nuk janë parashikuar ende në legjislacionin shqiptar. Aleanca përshëndet iniciativat e OJF-ve me mbështetjen e UNICEF për të hartuar një projektligj⁶⁷⁴ në këtë aspekt. Gjithashtu, Aleanca vëren se ligji nuk ka garantuar masa proaktive në lidhje për pranimin dhe integrimin në shkollë të fëmijëve viktimë të shfrytëzimit, abuzimit, dhunës, si masë për riaftësimin e tyre fizik, psikologjik, dhe shoqëror. Së fundi, por jo për nga rëndësia, alarmante paraqitet situata në lidhje me shtimin e numrit të vetëvrasjeve të fëmijëve të raportuara në media. Këto raste janë dëshmi ekstreme, ndër të tjera, për mosfunksionimin e një sistemi, i cili

⁶⁶⁶ Shih Aneks I – Zbatimi i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve analizuar nga këndvështrimi i fëmijëve, dhjetor 2008–janar 2009 dhe Sipas Aneksit II – Informacion nga strukturat kryesore publike dhe jo publike të përfshira në garantimin e të drejtave të fëmijëve, janar-shkurt 2009 (Përmbledhje instrumentesh metodologjike), Protokoll Informativ nga Drejtoritë Arsimore Rajonale.

⁶⁶⁷ Neni 13, Ligji Nr. 10039, Datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”.

⁶⁶⁸ Neni 361/7, Kodi i Procedurës Penale.

⁶⁶⁹ Neni 361/5, Kodi i Procedurës Penale.

⁶⁷⁰ Kryesisht veprat penale sensitive me karakter mbrojtjen nga abuzimi, shfrytëzimi seksual, trafikimi etj.

⁶⁷¹ Vendim Nr. 589, Datë 28.08.2003 “Për ngritjen dhe vënien në funksionim të qendrës pritëse të viktimave të trafikimit”.

⁶⁷² Sipas Aneksit II – Informacion nga strukturat kryesore publike dhe jo publike të përfshira në garantimin e të drejtave të fëmijëve, janar-shkurt 2009 (Përmbledhje instrumentesh metodologjike), Protokoll Informativ nga Komisaritet e Policisë.

⁶⁷³ Ligji Nr. 9669, Datë 18.12.2006 “Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare”.

⁶⁷⁴ Projektligji për “Mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna dhe shfrytëzimi”, iniciativë e CRCA me mbështetjen e UNICEF.

garanton riaftësimin psikologjik dhe social të fëmijëve. Aleanca inkurajon iniciativa promovuese kundër dhunës ndaj fëmijëve të ndërmarra nga organizata të ndryshme.⁶⁷⁵

Në muajin mars, në Durrës, një i mitur u vetëvra me pistoletën e shërbimit të babait, pas një debati me të ëmën për shkollën. Ky është vetëm një rast i raportuar së fundmi në media, ndërkohë që gjatë vitit 2008 janë regjistruar 55 raste, nga të cilat 9 vetëvrasje dhe pjesa tjetër arriti t'i shpëtojë vdekjes.⁶⁷⁶

Rekomandime:

- Të merren masa për zbatimin e ligjit “Për dhunën në marrëdhëniet familjare” duke bashkërenduar përpjekjet ndërmjet policisë, pushtetit lokal, qendrave pritëse, familjeve kujdestare dhe të afërmeve të fëmijës.⁶⁷⁷
- Të miratohet projektligji për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna dhe shfrytëzimi jashtë marrëdhënieve familjare dhe të sigurohen mjetet financiare të duhura për zbatimin e tij.
- Të plotësohet kuadri ligjor për shërbimet sociale në lidhje me zbatimin e programeve të ri-integritimit të fëmijëve bazuar në vlerësim dhe ndjekje të rasteve individuale.
- Të amendohet ligji “Për arsimin” në lidhje me pranimin dhe integrimin në shkolla të fëmijëve viktimë të shfrytëzimit, abuzimit dhe dhunës, duke synuar riaftësimin e tyre fizik, psikologjik, dhe shoqëror.
- Të ngrihen njësitë e mbrojtjes së fëmijës në të gjitha njësitë e pushtetit lokal, përfshirë të gjitha komunat.⁶⁷⁸
- Të krijohen rrjete referuese dhe bashkëpunuese midis organizatave dhe institucioneve brenda komunave, në qytet dhe midis qyteteve.⁶⁷⁹
- Të ngrihen struktura pranë komunave, ose qendrave shëndetësore, që ofrojnë ndihmë për prindërit që ndeshin vështirësi gjatë prindërimit, ose edhe të punojnë me ta përpara se të bëhen prindër.⁶⁸⁰

⁶⁷⁵ Fushata e World Vision 2007 dhe BKTF kundër lypjes dhe dhunimit të fëmijëve 2008.

⁶⁷⁶ Gazeta Shqip, mars 2009.

⁶⁷⁷ Rekomandim nga anëtarët e BKTF (Të gjithë së bashku kundër trafikimit të fëmijëve, www.bktf-coalition.org).

⁶⁷⁸ Rekomandim nga anëtarët e BKTF (Të gjithë së bashku kundër trafikimit të fëmijëve, www.bktf-coalition.org).

⁶⁷⁹ Rekomandim nga anëtarët e BKTF (Të gjithë së bashku kundër trafikimit të fëmijëve, www.bktf-coalition.org).

⁶⁸⁰ Rekomandim nga anëtarët e BKTF (Të gjithë së bashku kundër trafikimit të fëmijëve, www.bktf-coalition.org).

- Të nxitet përfshirja e komunitetit dhe krijimi/ forcimi i mekanizmave joformalë brenda komunitetit për mbrojtjen e fëmijëve.

Neni 40 - Administrimi i drejtësisë për të miturit

I mituri ka të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të tij,⁶⁸¹ të drejtën për ndihmë juridike dhe psikologjike në të gjitha shkallët e procedimit, me praninë e prindit ose personave të tjerë të kërkuar prej tij.⁶⁸² Nga praktika rezulton se në raste të rralla të miturit kanë avokat në momentin e ndalimit dhe jo në të gjitha rastet iu bëhen të njohura të drejtat e tyre, apo u njoftohet akuza.⁶⁸³ Në çastin e ndalimit ose arrestimit, policia gjyqësore duhet të lajmërojë detyrimisht prindërit e të ndaluarit të mitur,⁶⁸⁴ ndonëse, në fakt, njoftimi bëhet më vonë se momenti i ndalimit.⁶⁸⁵ Të miturit e ndaluar, apo arrestuar, duhet të trajtohen në mënyrë të tillë që, ndërhyrja në jetën e tyre private, të bëhet në mënyrën më minimale të mundshme, ndonëse për këtë qëllim nuk ka protokolle që të përcaktojnë në mënyrë specifike rregullat për mbrojtjen e jetës private në dhomat e shoqërimit dhe të ndalimit.⁶⁸⁶

Gjithashtu, kur ka dyshime mbi moshën apo personalitetin e të miturit, organi i procedurës vendos verifikimin⁶⁸⁷ dhe sqarimin e përgjegjshmërisë për të vendosur mbi masën e përshtatshme të dënimit penal.⁶⁸⁸ I mituri mban përgjegjësi penale kur ka mbushur moshën 14 vjeç për kryerjen e një vepër penale dhe 16 vjeç për kundërvajtjet penale.⁶⁸⁹ Ndaj të miturve mund të jepen masa sigurie me arrest në burg vetëm kur ata akuzohen për krime, ndërsa në rastin e akuzimit për kundërvajtje penale,⁶⁹⁰ këto masa nuk mund të jepen.

Në kuadër të një procesi të rregullt gjyqësor, të miturit i garantohet e drejta për t'u ndihmuar nga një

⁶⁸¹ Neni 28, Kushtetuta e R.Sh.

⁶⁸² Neni 35, 48-49, Kodi i Procedurës Penale.

⁶⁸³ Shih Aneksi III – Raport monitorues mbi zbatimin e të drejtave të fëmijëve në ambientet e paraburgimi dhe burgut, kryer nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, janar-mars 2009, f. 9.

⁶⁸⁴ Neni 255/4, Kodi i Procedurës Penale.

⁶⁸⁵ Shih Aneksi III – Raport monitorues mbi zbatimin e të drejtave të fëmijëve në ambientet e paraburgimi dhe burgut, kryer nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, janar-mars 2009, f. 9

⁶⁸⁶ Sipas Aneksit II – Informacion nga strukturat kryesore publike dhe jo publike të përfshira në garantimin e të drejtave të fëmijëve, janar-shkurt 2009 (Përmbledhje instrumentesh metodologjike), Protokoll informativ nga komisaritet e policisë.

⁶⁸⁷ Neni 41, Kodi i Procedurës Penale.

⁶⁸⁸ Neni 42, Kodi i Procedurës Penale.

⁶⁸⁹ Neni 12, Kodi Penal.

⁶⁹⁰ Neni 230, Kodi i Procedurës Penale.

përkthyes.⁶⁹¹ Kjo garanci procedurale i njihet edhe personave me aftësi të kufizuara në të dëgjuar dhe në të folur, por në praktikë mbetet problematik rregullimi i kësaj procedure, pasi shteti nuk ka standardizuar gjuhën e shenjave dhe nuk ka marrë masa për licencimin e përkthyesve të shenjave.⁶⁹² E njëjta problematikë shfaqet edhe për personat me probleme shikimi e që kanë statusin e të dyshuarit/të pandehurit. I mituri nuk mund të akuzohet ose të deklarohet fajtor për një veprë penale, e cila nuk konsiderohej e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj⁶⁹³ dhe ai prezumohet i pafajshëm deri në marrjen e një vendimi gjyqësor të formës së prerë.⁶⁹⁴

Ligji penal parashikon se kur një person, i cili nuk ka marrë ende cilësinë e të pandehurit, bën deklarime të cilat e inkriminojnë, autoriteti procedues është i detyruar të ndërpresë pyetjen, ta paralajmërojë personin se pas këtyre deklarimeve mund të zhvillohen hetime ndaj tij dhe ta ftojë të caktojë një mbrojtës.⁶⁹⁵ Ky parashikim ligjor nuk krijon garancitë e duhura për të miturit për të cilët duhet të ishte parashikuar se organi i policisë gjyqësore në rast se ka dyshime se i mituri mund të japë fakte dhe të dhëna, të cilat mund të çojnë në vetëpërgjegjësi, duhet të garantojë, në çdo rast, pyetjen në prani të mbrojtësit. Për më tej, në rast se një i mitur bën deklarime për vetpërgjegjësi, ato nuk duhet të konsiderohen me vlerën e të dhënave mbi të cilat mund të ngrihet akuza. Në çdo rast, i mituri duhet të rimerret në pyetje në praninë e avokatit. Gjithashtu, ligji parashikon se dëshmitari nuk mund të detyrohet të dëshmojë për fakte, nga të cilat mund të lindë përgjegjësi penale⁶⁹⁶ për të. Edhe ky parashikim ligjor nuk i referohet dëshmitarëve të mitur. Konsensusi i dhënë nga të miturit dëshmitarë duhet të jetë i verifikuar mirë nëpërmjet respektimit të garancive procedurale të formatuara për fëmijët, siç mund të ishte marrja e mendimit të psikologut në lidhje me dëshirën për të dëshmuar.

Ligji penal parashikon për të akuzuarit e mitur të njëjtat afate procedurale për fazën e hetimit dhe atë të gjyqimit, si për të rriturit. Afati i hetimit parashikohet të jetë 3 muaj,⁶⁹⁷ i cili mund të zgjatet me nga 3 muaj të tjerë, por jo më shumë se 2 vjet,⁶⁹⁸ kur kjo diktohet nga kompleksiteti i veprës. Zgjatja e afateve të hetimit është një nga problemet më shqetësuese, sidomos për të miturit, të cilët hetohen në gjendje arresti në burg. Shpeshherë, kur ata janë të akuzuar për vepra penale në bashkëpunim më të rritur, çështja e tyre paraqitet komplekse dhe hetimet zgjasin. Është për t'u theksuar se janë evidentuar në praktikë edhe raste kur të miturit, pavarësisht veprave të lehta, kanë qëndruar në paraburgim mbi 6 muaj për shkak të mosmbylljes së hetimit nga ana e prokurorisë.

Gjithashtu, në gjashtë gjykata të rretheve gjyqësore me qendër apeli, janë ngritur seksione të veçanta penale

⁶⁹¹ Neni 8/2, Kodi i Procedurës Penale.

⁶⁹² Megjithatë ekzistojnë raste sporadike kur kjo e drejtë është realizuar si p.sh. asistimi në një procedurë gjyqësore i përkthyesit të shenjave në rrethin e Elbasanit, raportuar nga FSHDPAK.

⁶⁹³ Neni 29, Kushtetuta e R.Sh; Neni 4, Kodi i Procedurës Penale.

⁶⁹⁴ Neni 30, Kushtetuta e R.Sh.

⁶⁹⁵ Neni 37, Kodi i Procedurës Penale.

⁶⁹⁶ Neni 157, Kodi i Procedurës Penale.

⁶⁹⁷ Neni 323, Kodi i Procedurës Penale.

⁶⁹⁸ Neni 324, Kodi i Procedurës Penale.

për gjykimin e të miturve,⁶⁹⁹ megjithatë, është e nevojshme që këto seksione të ngrihen në çdo rreth gjyqësor. Të miturit dhe avokatit të tij mbrojtës i garantohet e drejta për të sjellë dëshmitarët e tij në proces dhe për të pyetur dëshmitarët e palës tjetër.⁷⁰⁰ Ligji parashikon zgjidhjen e kundërvajtjeve penale pa iu drejtuar procedurës gjyqësore,⁷⁰¹ por pa iu referuar në mënyrë të veçantë të miturve.

Legjislacioni penal parashikon dhënien e masave alternative. Në këtë kuadër vlen të përmendet zbatimi i projektit pilot të UNICEF-it nga Gjykata për dhënien e masave alternative. Të miturit vuajnë dënimin në institucione të posaçme⁷⁰² për ta, ose në seksione të veçanta të institucioneve të tjera, dhe ekzekutimi i vendimeve penale bëhet në vende dhe mënyra favorizuese.⁷⁰³

Legjislacioni parashikon se të miturit nën 14 vjeç që përjashtohen nga dënimi, ose të cilët janë nën moshën 14 vjeç përcaktuar si kufi moshor për përgjegjësinë penale, trajtohen me masa edukuese,⁷⁰⁴ por në realitet, që pas vitit 1990, këto masa nuk janë aplikuar asnjëherë për shkak të mungesës së strukturave dhe të programeve të posaçme. Shumë të mitur nën 14 vjeç, të cilët kryejnë jo vetëm vepra të lehta, lihen nga policia të lirë pa u referuar asgjëkundi për trajtim të mëtejshëm.

Aleanca për Fëmijët dhe KSHH janë të shqetësuara në lidhje me administrimin e drejtësisë penale për të miturit në Shqipëri. Në këtë kuadër duhet që punonjësit e policisë të respektojnë garancitë procedurale që ligji penal u garanton të miturve në konflikt me ligjin, duke i njohur ata me të drejtat e tyre dhe duke u siguruar atyre komunikimin me familjen dhe avokatin në momentin më të parë të ndalimit. Gjithashtu, duhet të theksohet dhe t'i garantohet më shumë akses punonjësit social dhe psikologut në procesin penal, me qëllim që fëmija të marrë mbështetjen e nevojshme. Përveç tyre, rol të rëndësishëm në këtë proces luan shërbimi avokator. Aktualisht një çështje, shpeshherë e diskutuar, është trajnimi dhe specializimi i punonjësve të policisë gjyqësore⁷⁰⁵ dhe avokatëve për të mitur, me qëllim përmirësimin e shërbimit dhe rritjen e profesionalizmit.⁷⁰⁶ Gjithashtu, Aleanca dhe KSHH theksojnë se ligji penal duhet përmirësuar në drejtim të parashikimeve ligjore për trajtimin e grupmoshës 18–21 si një kategori e veçantë.⁷⁰⁷ Aleanca dhe KSHH përshëndesin iniciativën ligjore për ngritjen e strukturës së shërbimit të provës, i cili

⁶⁹⁹ Dekreti i Presidentit të Republikës, Nr. 5351, Datë 11.06. 2007.

⁷⁰⁰ Neni 361, Kodi i Procedurës Penale.

⁷⁰¹ Ligji Nr. 8465, Datë 11.03.1999 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e konflikteve”.

⁷⁰² Neni 17, Ligji 8328, Datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”.

⁷⁰³ Ligji Nr. 8331 Datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” dhe ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”.

⁷⁰⁴ Neni 46, Kodi Penal.

⁷⁰⁵ Manual “Për avokatin mbrojtës të të miturit”, Tiranë 2007, Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara me mbështetjen e UNICEF.

⁷⁰⁶ Shih Aneksi III – Raport monitorues mbi zbatimin e të drejtave të fëmijëve në ambientet e paraburgimi dhe burgut, kryer nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, janar-mars 2009, f. 10.

⁷⁰⁷ Shih Aneksi III – Raport monitorues mbi zbatimin e të drejtave të fëmijëve në ambientet e paraburgimi dhe burgut, kryer nga

do të mbikëqyrë zbatimin e dënimeve alternative duke paraqitur, kështu, informacione dhe raporte para prokurorisë ose gjykatës.⁷⁰⁸ Megjithatë, kërkohet ndërhyrje nga shteti me qëllim miratimin e akteve nënligjore për ngritjen dhe funksionimin e shërbimit të provës. Së fundi, vlen të përmendet mungesa e zbatimit të masave edukuese për të miturit në konflikt me ligjin, për të përmbushur qëllimin e dënimit penal, i cili është rehabilitimi dhe më pas ri-integrimi i personave në shoqëri.

S.S është ndaluar vazhdimisht që prej moshës 11-12 vjeç. Ai është ndaluar në të gjitha rastet për veprën penale të vjedhjes dhe deklaronte në komisariate se “do të vidhte deri ditën që do mbushte 14 vjeç”. Në këtë periudhë ndaj tij nuk u zbatuan masat edukuese me qëllim rehabilitimin dhe në moshën 14 vjeç ai u arrestua për veprën penale të vjedhjes më shumë se një herë dhe qëndroi në ambientet e paraburgimit “Jordan Misja” për rreth 3 muaj, kohë në të cilën i mbaron gjykimi dhe merret vendimi final.⁷⁰⁹

I mituri M.R akuzohet për veprën penale të “vjedhjes në bashkëpunim”, parashikuar nga neni 134/2. Ai së bashku me një shokun e tij në moshë madhore, janë kapur në flagrancë duke vjedhur 50 m tel në ambientet e magazinave të Albtelekom.

Ndonëse vepra penale, për të cilën akuzohet i mituri, nuk paraqet rrezikshmëri të lartë, ai është arrestuar në 08.07.2008 dhe ka qëndruar në ambientet e paraburgimit “Jordan Misja” deri më 10.11.2008, datë në të cilën është dhënë vendimi i lirit të të miturit me kohën e paraburgimit,⁷¹⁰ duke tejkaluar të gjitha afatet e hetimit të parashikuara në ligj.

Rekomandime:

- Të merren masa për vënien në zbatim të të gjitha garancive procedurale që ligji penal garanton për të miturit, si psh., njoftimi i prindërve në momentin e ndalimit të të miturit, ndihmë juridike dhe psikologjike falas, etj.
- Të merren masa për standardizimin e gjuhës së shenjave si dhe licencimin e përkthyesve të shenjave, me qëllim që fëmijëve që nuk dëgjojnë dhe nuk flasin t’u garantohej ndihma, për të cilën kanë nevojë në të gjitha fazat e procesit gjyqësor.
- Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë të hartojë një listë të avokatëve të specializuar

Komiteti Shqiptar i Helsinkit, janar-mars 2009, f. 11.

⁷⁰⁸ Shih Aneksi III – Raport monitorues mbi zbatimin e të drejtave të fëmijëve në ambientet e paraburgimi dhe burgut, kryer nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, janar-mars 2009, f. 12.

⁷⁰⁹ Rast i raportuar nga QSHPLI/ Klinika Ligjore për të Mitur.

⁷¹⁰ Rast i raportuar nga QSHPLI/ Klinika Ligjore për të Mitur.

për të miturit dhe kriteret për caktimin e tyre,⁷¹¹ si dhe të marrë masa me qëllim përmirësimin e shërbimit dhe rritjen e profesionalizmit.

- Të amendohet ligji penal me qëllim përcaktimin e grup moshës 18-21 si një kategori e cila duhet të gëzojë një kujdes të veçantë nga organet e drejtësisë në rastet kur ata janë në konflikt me ligjin.
- Të amendohet ligji penal, me qëllim krijimin e garancive të duhura për të miturit në rast të deklarimeve, të cilat mund të çojnë në vetëpërgjegjësi dhe në rastet kur të miturit thirren të dëshmojnë në një proces gjyqësor.
- Të merren masa për zbatimin në praktikë të masave alternative për të miturit si dhe për ngritjen e strukturave për zbatimin e tyre dhe qendrave të licencuara për ofrimin e shërbimeve ndaj të miturve.
- Të amendohet ligji penal me qëllim ndryshimin e afateve procedurale për fazën e hetimit dhe atë të gjyqimit për të miturit.
- Shteti të marrë masa me qëllim miratimin e akteve nënligjore për ngritjen dhe funksionimin e shërbimit të provës, i cili do të mbikëqyrë zbatimin e dënimeve alternative.
- Shteti të marrë masa për ngritjen dhe funksionimin e qendrave të riedukimit për të miturit me qëllim që ata të vuajnë dënimin në ambiente të veçanta, ku punohet për ri-integrimin e tij në shoqëri.
- Të merren masa me qëllim trajnimin e punonjësve të policisë, prokurorëve, gjykatësve dhe personave të tjerë të përfshirë në proceset e fëmijëve në konflikt me ligjin.
- Të merren masa me qëllim ngritjen e seksioneve të veçanta penale për gjykimin e të miturve në të gjitha rrethet gjyqësore.
- Të merren masa për ngritjen e strukturave dhe programeve të veçanta me qëllim vënien në zbatim të masave edukuese për të miturit nën 14 vjeç.

⁷¹¹ Shih Aneksi III – Raport monitorues mbi zbatimin e të drejtave të fëmijëve në ambientet e paraburgimit dhe burgut, kryer nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, janar-mars 2009, f. 12.

ANEKS I

Zbatimi i Konventes për të Drejtat e Femijeve analizuar nga kendveshtrimi i femijeve Dhjetor 2008 – Shkurt 2009

Në studim do të trajtohen temat në vijim:

A. Fëmijet me karakteristika të vevanta

1. Femijet me aftesi të kufizuara
2. Femijet refugjate
3. Femijet e ngujuar
4. Femijet ne institucion
5. Fëmijët e rrugës
6. Femijet e trafikuar
7. Femijet e minoriteteve

B. Fëmijët pa karakteristika të vecanta

8. Pjesëmarrja dhe argëtimi
9. Konsiderimi i fjales
10. Media
11. Pergjegjesia prinderore
12. Dhuna
13. Abuzimi me drogat
14. Puna



Hyrje

Ky studim me pjesëmarrjen e fëmijëve është kryer në kuadër të hartimit të raportit alternativ mbi zbatimin e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri.

Garantimi I pjesëmarrjes së fëmijëve nepermjet pasqyrimin të mendimit të tyre në raport perben nje burim informacioni I cili ploteson kuadrin mbi zbatueshmerine e te drejtave te femijeve në jetën e përditshme të tyre. Të raportosh mbi situatën e fëmijëve dhe të mos mundësosh ata vetë të thonë fjalën e tyre, jo vetëm që nuk do të kishte kuptim, por do të ishte dhe një shkelle e hapur e të drejtës që kanë fëmijët për t'u dëgjuar dhe konsideruar. Nga ana tjetër, askush me mire se vete femijet nuk mund ta dijë se cfarë i pengon dhe cfarë i bën ata të ndjehen mirë.

Pra përfshirja e fëmijëve në raportim, përvec garantimit të pjesëmarrjes së tyre në proces, rrit dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të grumbulluar në lidhje me çështjet e synuara.

Për këtë arsye të drejtat e fëmijëve vinë në vëmendjen e këtij studimi duke vëzhguar eksperiencat dhe duke dëgjuar dëshmitë e tyre në lidhje me faktin se si ndjehen ata në shtëpi, sa dëgjohet mendimi I tyre nga prindërit, cfarë merrredhënie kanë ata me mësuesit, sa konsiderohen ata në shkollë, sa janë ata të mbrojtur nga rreziqet dhe nga dhuna, sa hapsirë kanë ata për të lozur dhe për t'u argëtuar në shkollë apo në ambjentet ku jetojnë. Për të matur sa zbatohen këto të drejta, metodat e përdorura në këtë studim, (pyetësi dhe intervistat) u fokusuan pikërisht tek këta element specifik të jetës së fëmijëve, duke konkretizuar të drejtat përkatëse në faktorë të cilët përbëjnë eksperiencat, shqetësimet, mendimet dhe dëshirat e fëmijëve në jetën e përditshme. Pra në këtë studim, ashtu sic do të vërehet në vijim, të drejtat e fëmijëve u përkthyen në sjellje, fjalë, kushte fizike, të cilat për nga mënyra se si aplikohen dhe se si perceptohen nga fëmijët, krijojnë apo jo, një mjedis të përshtatshëm për mirrëritjen e tyre. Ky studim është përqendruar tek fëmijët të cilët jetojnë në fshat. Ky përqendrim kryhet për shkak se këta fëmijë nuk kanë qënë objekt i analizës së sbatimit të të drejtave të tyre më parë dhe një arsye tjetër është se stili i jetës së këtyre fëmijëve dallon në mënyrë të dukshme nga jeta e fëmijëve në qytet. Gjithsesi të drejtat e fëmijëve janë të drejta të cilat duhe të gjejnë zbatim tek të gjithë fëmijët, pa asnjë dallim. Për këtë arsye studimi ka përshatur një qasje në të cilën të drejtat e fëmijëve të gjejnë pasqyrim mbi të njëjtat parime si në qytet edhe në fshat, panvarësisht nga diferencat e mundshme në stilin e jetesës së fëmijëve.

Çështjet që do të trajtohen në vijim, ashtu sic është disenuar dhe në metodologjinë e këtij studimi do të do të paraqiten të ndara në dy grupe të mëdha fëmijësh:

A. Fëmijët me karakteristika të vecanta

B. Fëmijët pa karakteristika të vecanta

Kjo ndarje është bërë për faktin se KDE, krahas të drejtave që I garanton në mënyrë universale të gjithë fëmijëve, I garanton gjithashtu të drejta të vecanta disa grupe të fëmijëve, për shkak të karakteristikave të tyre të vecanta apo situatës specifike në të cilën ndodhen.

Për shkak se metodat e përdorura në studim janë ndërtuar duke iu referuar elementëve specifik të cilët

përmenden në nenet përkatëse të KDF-së, tek të dy grupet e sipërpërmendura, në fillim do të paraqitet një pjesë e nenit apo neneve të KDF-së ku jemi referuar në lidhje me çështjen. Nisur nga fakti se në disa raste, të drejta të caktuara prekin të njëjtin argument duke qënë në këtë mënyrë plotësuese të njëra tjetrës, ato çështje janë trajtuar duke u analizuar në optikën e më shumë se një të drejte. Për rrjedhojë i jemi referuar më shumë se një neni.

Pas kësaj pjese, në grupin A, do të vijojë metoda e cila është ndjekur për mbledhjen e informacionit, më pas do të paraqiten rezultatet e studimit me anë të ilustrimeve të intervistave dhe bisedave në grup, konkluzionet dhe rekomandimet.

Në grupin B, për të tre grup-moshat e përfshira në studim, do të paraqiten rezultatet nëpërmjet paraqitjeve grafike (për grup-moshën 15-18 vjec) dhe tabelore (për grup-moshën 11-14 vjec) të të dhënave të pyetësorit dhe në fund do të vijojnë konkluzionet. Në këtë grup, pyetjet dhe përgjigjet e paraqitura me anë të grafikëve dhe tabelave, janë shkëputur nga ato pjesë të pyetësorit ku është synuar të mblidhet informacion në lidhje me të drejtat përkatëse.

- **Qëllimi i studimit**

1. **Të ofrojë një kuadër të qartë mbi faktin se sa zbatohen në jetën e përditshme të drejtat e fëmijës të garantuara nga KDE, në Shqipëri.**

- **Metodologjia**

Ky studim u mbështet në interpretimin e të të dhënave sasimore dhe cilësore.

Për të kryer këtë pjesë të raportit u hartua një metodologji e përbërë nga **pyetësori, intervista dhe grupe diskutimi** me fëmijë. Sic u përmend dhe më sipër, për shkak të specifikimeve që KDE i bën grupeve të caktuara të fëmijëve, ata u ndanë në dy grupe të mëdha si më poshtë.

- A. **Fëmijët me karakteristika të vecanta. Në këtë grup janë trajtuar të drejtat të cilat u garantohen fëmijëve për shkak të karakteristikave të tyre të vecanta apo situatës specifike në të cilën ndodhen:**

1. *Fëmijët të cilët janë pjesë e minoriteteve*
2. *Fëmijët në institucione për kujdesjeje*
3. *Fëmijët e rrugës*
4. *Fëmijët me paafësi*
5. *Fëmijët e ngjuar*

- B. Fëmijët pa karakteristika të vecanta. Në këtë grup janë trajtuar disa nga të drejtat të cilat u garantojnë të gjithë fëmijëve panvarësisht karakteristikave të tyre apo situatës specifike në të cilën ata ndodhen.**

- **Kampionimi**

Studimi u shtri në 10 qytete të Shqipërisë: Tiranë, Durrës, Elbasan, Lushnjë, Korce, Vlorë Shkodër. Gjirokastrë, Dibër dhe Kukës. Ky studim u përqendrua tek shkollat e fshatit të cilët u përkasin këtyre qyteteve. Në secilin qytet u përzgjedhën 1 shkollë të arsimit 9-vjeçar dhe 1 shkollë të arsimit të mesëm. Gjithsej në studim u përfshinë 20 shkolla, 10 shkolla 9-vjeçare dhe 10 shkolla të mesme. Për administrimin e metodave të përzgjedhura, fëmijët u ndanë në grupmoshat 11-14 vjeç dhe 15-18 vjeç.

Në të gjitha qytetet e përcaktuara u shpërndanë gjithsej 1350 pyetësorë. Pyetësorët u hartuan për grupmoshat 11-14 vjeç dhe 15-18 vjeç, dhe u shpërndanë në shkolla 9-vjeçare nga kl V- kl VIII dhe në gjimnaze nga viti I – viti IV. Në secilën shkollë u përzgjedh nga një klasë për cdo vit dhe në secilën klasë u shpërndanë nga 15 pyetësorë. Përzgjedhja e klasave dhe shpërndarja e pyetësorëve u krye me anë të metodës së përzgjedhjes së rastësishme. Pjestarët e ekipit të studimit kanë qëndruar prezent gjatë kohës së plotësimit të tyre, për të shpjeguar të gjitha paqartësitë që mund të kishin nxënësit në lidhje me pyetje të vecanta të pyetësorit, si dhe për t'u siguruar për një mjedis sa më të përshtatshëm dhe pa influencë të jashtme.

Pyetësorët u shpërndarë tek grupi I fëmijëve pa karakteristika të vecanta. Për hartimin e pyetësorëve janë kryer biseda paraprake me ekspertë ligjorë dhe më të gjithë aktorët të cilët operojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, për mbledhjen e informacionit relevant i cili duhej përfshirë në pyetësor. Hedhja e të dhënave, analiza statistikore dhe paraqitja grafike e pyetësorëve u kryen me anë të programit SPSS 12.0.

Për të mbledhur informacion mbi grupet me karakteristika të vecanta u kryen 26 intervista gjysëm të strukturuar me fëmijë. Në mënyrë më specifike, për metodat e secilit nga nënet e këtyre grupeve do të flitet në vijim.

- **Fazat e studimit**

Ky studim u nda në tre faza. **Në fazën e parë** u konsultuan të gjitha materialet dhe raportet mbi të drejtat e fëmijëve në Shqipëri. Këtu duhet të theksohet se nuk u gjetën materiale të mjaftueshme në lidhje me mënyrën se sa zbatohen nene specifike të KDF konkretisht në Shqipëri. Vec kësaj, u kryen konsultime të vazhdueshme me ekspertët ligjor për hartimin e instrumentave të matjes. Pas konsultimeve u ndërtuan pyetësorët, intervistat gjysëm të strukturuar si dhe metoda e organizimit të punës në grup me fëmijët. Pyetësorët u testuan në një

numër prej 50 fëmijësh. Në këtë fazë u krye dhe trajnimi i personave të përzgjedhur nga ACA, për procesin e administrimit të shpërndarjes së pyetësorëve.

Në fazën e dytë u krye administrimi i instrumentave të hartuara, pra u shpërndanë pyetësorët, dhe u kryen besedat në grup dhe intervistat.

Gjatë fazës së tretë u bë u grumbullimi i të dhënave, ndërtimi i grafikëve, analiza statistikore dhe cilësore si dhe u shkruajt raporti i studimit.

• **Përkufizimi i termave të përdorura në studim**

Dhuna fizike përkufizohet si përdorimi i qëllimshëm i forcës fizike apo i fuqisë, i kërcënimit ose përdorimit të saj real, kundër vetes, një personi tjetër, ose kundër një grupi apo komuniteti, forcë e cila con ose ka mundësi të çojë në plagosje, vdekje, dëmtim psikologjik, keqzhvillim ose privim¹.

Dhuna emocionale/psikologjike përkufizohet si mospësigurimi i një mjedisi të përshtatshëm zhvillimor e mbështetës. Ajo përfshin kufizimin e lëvizjeve, talljen, denigrimin, fajësimin, kërcënimin, trembjen, diskriminimin, përqeshjen, ose forma të tjera jofizike të armiqësisë ose trajtimit refuzues².

• **Terminologji**

Inicialet KDF nënkuptojnë; Konventa për të Drejtat e Fëmijës.

Inicialet MASH nënkuptojnë; Ministria e Arsimit dhe Shkencës

• **Sqarim**

Në pyetësor, në lidhje me pyetjen mbi informacionin për dhunën, me termin **përgjigje e plotë** nënkuptohet përgjigjja, e cila në informacionin e dhënë për dhunën, përmban edhe lelementë të dhunës fizike edhe elementë të dhunës psikologjike.

Me termin përgjigje **pjesërisht e plotë**, nënkuptohet përkufizimi apo informacioni i cili përmban element vetëm të një lloji dhune.

Në materialin në vijim me anë të paraqitjes grafikore janë prezantuar rezultatet e pyetësorëve të grup-moshës 15-18 vjeç, ndërsa me anë të tabelave janë prezantuar rezultatet e pyetësorëve të grup-moshës 10-14 vjeç.

¹ Etienne G. Krug, Linda L. Dahleberg, James A. Mercy, Anthony B. Zëi & Lozano R.,(2002), World Health Organization, Publikuar në Gjenevë, f 29,

² Ibid, f 84

I. Fëmijët me karakteristika të vecanta

1. Femijet me aftësi të kufizuara

Neni 23 - Fëmijët me aftësi të kufizuar

Shtetet Palë, pranojnë se fëmija me aftësi të kufizuara mendore ose fizike, duhet të bëjë një jetë normale dhe të përshtatshme, në kushte që garantojnë dinjitetin e tij, që nxisin autonominë dhe lehtësojnë pejsëmarrjen e tij në jetën e bashkësisë.

Mbështetur në frymën që Konventa përcjell, fëmijët me aftësi të kufizuara duhet të përfshihen në jetën e komunitetit, duhet të kenë akses dhe kushte të përshtatshme për arsimim si dhe të gëzojnë lehtësira në lidhje me trajtimin e tyre shëndetësor. Por ajo çfarë është më e rëndësishme është se këta fëmijë, duhet ti gëzojnë këto të drejta, ashtu sikundër të gjitha të drejtat e tjera si të gjithë fëmijët e tjerë pa u ndjerë të diskriminuar. Tek ky grup fëmijësh, studimi është fokusuar pikërisht mbi këto çështje.

1.1 Metoda

Për të marrë informacionin e nevojshëm mbi mënyrën se si jetojnë aktualisht fëmijët me aftësi të kufizuara në Shqipëri, u kryen 5 intervista gjysëm të strukturuar me fëmijë të cilët vuajnë nga probleme të tilla, si dhe u kryen biseda me prindërit dhe pjestarët e komunitetit ku jetojnë këta fëmijë.

1.2 Arsimimi

Mbështetur në pikën dy të këtij neni, fëmijëve me aftësi të kufizuara, duhet t'u krijohen të gjitha kushtet e nevojshme dhe të përshtatshme për ta, në mënyrë që të kenë mundësinë të arsimohen si të gjithë fëmijët e tjerë. Duhet theksuar se arsimimi është një pjesë shumë e rëndësishme e jetës së fëmijëve dhe element bazë i cili përcakton në një mënyrë apo një tjetër të ardhmen e fëmijëve. Le të shohim më poshtë pjesë të intervistimeve të kryera me fëmijët dhe prindërit e tyre.

A është 12 vjec dhe është I paralizuar nga këmbët që në momentet e para kur ka lindur. Kjo paralizë mjekët I kanë shpjeguar se I ka ardhur për shkak të sëmundjes së poleomelitit.

Në shkollë kam 2 javë që kam filluar të shkoj. Jam futur direkt në klasën e V. në shkollë shkoj me taksì, sepse e kam largë nga shpia dhe une nuk mund të hyj në autobus. Herë më shoqeron mami herë babi, por ata janë të sëmurë dhe mundohen të gjejnë punë, kështu që unë iki edhe vetë me taksistin. Kam tentuar të

shkoj edhe me parë në shkollë, por drejtorët me kanë thënë se shkollat kanë qënë të papërshtatshme për mua, për shkak se unë mund të lëviz vetëm me karrocë dhe unë nuk mund t'i ngjisja shkallët e shkollës. Shkolla ku jam tani ka edhe vëndin ku kalon karroca, por vetëm se është largë. Une dua ta vazhdoj shkollën si të gjithë të tjerët.

Mësimet e klasës së parë dhe deri te klasa e pestë I kam mësuar vetë dhe me mamin në shtëpi.

Djalin tim as në kopësht dhe as në shkollë nuk e kanë pranuar më parë. Tani kemi filluar ta cojmë në shkollë, por e kemi shumë të vështirë se duhet ta cojmë me taksi dhe ne nuk kemi mundësi ekonomike. Na ka premtuar një shoqatë se do na I japë ajo lekët e taksisë. Nëse nuk e bën këtë gjë, do të detyrohemi të mos e dërgojmë më në shkollë. (mamaja e A)

Vajzat I kam future në klasën e parë edhe pse janë 9 vjec. Ato vujanë nga një prapambetje e lehtë mendore. E kanë të vështirë të kapin mësimet që bëhen në shkollë. Shpesh ato humbasin edhe vëmëndjen dhe mësuesja nuk I rri dot mbi kokë. (mamaja e dy motrave binjake me prapambetje mendore të moderuar).

1.3 Transporti.

Sic e thashë dhe në fillim, për shkak të transportit dhe lëvizjes unë nuk kam mundur të shkoj në shkollë, sepse nuk ka patur rrugë për të kaluar karroca. Edhe kohën e lirë e kaloj afër lagjës dhe në shpi. Kur bie shi nuk dal nga shtëpia fare. (A. djalë tetraplegjik, 12 vjec)

1.4 Shëndeti

Me shëndetin kam patur shumë probleme. Para kam kryer 3 operacione në këmbë deri tani shton A. Mjekët më kanë thënë se unë mund të bëhem operacion përsëri për të përmirësuar ecjen time, por mund të bëhet vetëm jashtë shtetit dhe familja ime nuk I ka mundësitë për këtë gjë. Ëndrra ime është ky operacon. Te paktën të ngrihem me paterica. (A. djalë tetraplegjik, 12 vjec)

Gjatë gjithë kohës shpenzimet për operacionet I kemi përballuar me mundësitë tona ekonomike. Nuk kemi marrë asnjë përkrahje nga shteti asnjeherë për këto gjëra. (mamaja e A)

Gjatë gjithë kësaj kohe kemi patur shumë problemme me shëndetin e fëmijëve. Pothuaj se tërë këto vite I kemi kaluar nëpër spitale. Madje jemi bërë edhe vetë doktorrë. Të gjitha shpenzimet për vizitat mjekësore dhe ilacet I kemi paguar në të shumtën e rasteve vetë. Madje jemi akoma në borxhe me farmacitë. Por të them të drejtën në disa raste na kanë ndihmuar me ilace shoqata joqeveritare apo edhe miq të mitë. Djalin e kam cuar ta vizitojë edhe në Greqi. Dua të shtoj se edhe transportin me autoambulancë deri në kufi e kam paguar vetë. Atje u bë shumë mirë, por nuk kasha më mundësi të qëndroja atje. Në këtë shtëpi, jetojmë me qira dhe pensioni që bashkëshortja ime merr për fëmijët është shumë I vogël. Aq më tepër që sëmundja e fëmijëve, sidomos e djalit, kërkon që të ushqehen me shumë

fruta që të marrin vitamina. (babai I një djali me hipotemi dhe prapambetje mendore të moderuar dhe I 2 vajzave me prapambetje mendore të moderuar)

1.5 Argëtimi, shoqëria

Fëmijët e mi nuk dalin nga shtëpia për të lozur. Këtu nuk I njohin fëmijët e tjerë, por për shkak të problemeve që këta kanë, fëmijët edhe I kanë tallur. (babai I një djali me hipotemi dhe prapambetje mendore të moderuar dhe I 2 vajzave me prapambetje mendore të moderuar)

Unë kaloj mirë më shokët që kam në lagje dhe në shkollë. Sillen shumë mirë më mua dhe më ndihmojnë të lëviz me karrocën. (A. djalë tetraplegjik, 12 vjec)

Kur shkoj me djalin shpesh nëpër zyra për të kërkuar ndihmë ekonomike apo edhe në spital për t'a vizituar, jo vetëm që nuk më krijojnë ndonjë lehtësi mjekët apo infermierët, por edhe njerëzit që janë aty nuk më lërojnë as rradhën edhe pse e shohin që unë shoqëroj djalin në karrige me rrota. (mamaja e A)

1.6 Konkluzione

- Fëmijët me aftësi të kufizuara duke përfshirë edhe ata me prapambetje mendore edhe ata me probleme fizike, nuk I kanë kushtet e përshtatshme për të ndjekur arsimin e detyrueshëm. Mbështetur në intervistimet e mësipërme, vihet re dukshëm se nuk ekziston infrastruktura fizike në shkolla për këta fëmijë dhe mësuesit nuk kanë kohën dhe specializimin e duhur për t'i ndjekur ata.
- Strukturat shtetërore nuk e garantojnë trajtimin e vecantë mjekësor për të cilin këta fëmijë kanë nevojë. Nga pohimet e mësipërme të fëmijëve dhe prindërve të tyre, vizitat mjekësore dhe kurat e vëzhdueshme kryen me shpenzimet e vetë familjes, të cilat nuk janë të mjaftueshme. Për personat me probleme fizike, nuk ekzistojnë as ambiente të vecanta ku ata mund të ushtrohen pa paguar para.
- Fëmijët me aftësi të kufizuar, në vecanti ata me pamundësi fizike, hasin shumë vështirësi për të lëvizur. Kjo, u limiton atyre edhe aksesin në vënde argëtimi për fëmijët. Transporti duket se është një nga problemet më të mëdha të këtyre fëmijëve, I cili kufizon dukshëm edhe aksesin e tyre në shkolla.
- Fëmijët me aftësi të kufizuar dhe prindërit e tyre duket se ndëshen shpesh edhe me paragjykimet negative të shoqërisë, madje në disa raste edhe nga vetë administrada shtetërore. Gjithsesi duket se komuniteti pranë zonës ku jetojnë këta fëmijë dhe banorët e qytetit në disa raste janë më dashamirës ndaj tyre dhe në disa raste jo. Vlen të theksohet se më shumë pranues duket se janë fëmijët.

2. Femijet Refugjate

Neni 22 - Fëmijët refugjatë

Shtetet Palë, marrin të gjitha masat e duhura për t'u siguruar që një fëmijë, I cili kërkon të marrë statusin e refugjatit ose që konsiderohet si I tillë, sipas procedurave dhe rregullave të së drejtës ndërkombëtare ose të brendshme të zbatueshme, qoftë vetëm apo I shoqëruar nga prindërit e tij, ose nga cdo person tjetër, të përfitojë nga ndihma humanitare e nevojshme.....

Edhe në një vënd me një nivel modest ekonomik si Shqipëria, ku numri I personave të cilët kërkojnë azil duke përfshirë këtu edhe fëmijët, nuk është I lartë, është parë me interes ë vëzhgohet se si jetojnë fëmijët të cilët kanë marrë statusin e refugjatit në Shqipëri.

2.1 Metoda

Për grumbullin e informacionit me këtë grup fëmijësh u kryen intervista gjysëm të strukturuar me 4 fëmijë të cilët jetojnë në Shqipëri me statusin e refugjatit dhe me prindërit e tyre.

Kushtet e jetesës, aspekti ekonomik

Une jetoj në një shtëpi me qera me mamim, motrën dhe vëllain. Qiranë e shtëpisë e paguan UNHCR, sepse ne nuk kemi mundësi. Mamaja është e sëmure dhe e madhe në moshë, ndërsa une me vëllain jemi në shkollë. (vajze 16 vjec nga Kosova).

Po të mos kishte qënë për organizatën UNHCR, ne do kishim ngelur në mes të rrugës. Nuk kemi marrë asnjëherë ndihmë ekonomike nga ndonjë institucion shtetëror. (Mamaja e vajzës 16 vjecare).

Ne jetojmë në shtëpi me qira, të cilën e paguan UNHCR. Që të dy jemi të papunë dhe prandaj nuk kemi kushte të mira ekonomike. Po të mos ishte UNHCR, nuk e dimë se cdo bënim. (prindërit e 3 fëmijëve me status refugjati)

2.2 Shëndeti

Sa herë më sëmuren fëmijët une njoftoj shoqatqn ACE dhe ajo nëpërmjet një shoqate tjetër na ndihmon. Na paguajnë vizitat mjekësore dhe ilacet që na duhet. (mamaja e vajzës 16 vjec)

Sa herë kemi problemme me shëndetin i drejtohem i organizatës që na ka ndihmuar deri tani. Nëse nuk shkojmë me mjekun e caktuar prej saj, ne nuk na e var askush dhe duhet të paguajme për cdo vizitë mjekësore. Shoqata na paguan gjithcka, sa herë sëmuren vajzat apo edhe ne. (prindërit e 3 fëmijëve me status refugjati).

2.3 Shkolla

Në shkollë shkoj shumë mirë. Më pëlajnë mësimet por edhe me shoqërinë kaloj mirë. (vajze 16 vjec nga Kosova).

Me shkollën kaloj mirë në përgjithësi. Sidomos tek kjo ku jam tani, se tek ajo që kam qënë më parë më thërrisin “kosovare” si një mënyrë për të më ofenduar apo për të më mbajtur larg. Edhe tani më ndodh nganjëherë në lagje të dëgjoj, por shumë rrallë. (vajzë 12 vjec nga Kosova)

Unë nuk kam probleme në shkollë. Kaloj shumë mirë me mësueset dhe shoqërinë. (vajzë 17 vjec nga Kosova).

Nga biseda me punonjëse të organizatës UNHCR, mësohet se organizata ka një bashkëpunim të ngushtë me shtetin, sidomos me Ministrinë e Brëndëshme, e cila është e prirur për t’I kryer sa më shpejtë procedurat për marrjen e statusit të refugjatit ndaj personave të cilët kërkojnë azil në Shqipëri. Për sa i përket ndihmës ekonomike për një jetesë sa më normale kjo jepet vetëm nga UNHCR, dhe organizata të tjera jo-qeveritare.

2.4 Konkluzione



- Fëmijët të cilët kanë marrë statusin e refugjatit dhe familjet e tyre nuk marrin ndihmë ekonomike nga shteti dhe atyre nuk u krijohen lehtësira për ndihmën e nevojshme mjekësore nga oranzimat shtetërore.
- Fëmijët duket se gjejnë një vënd të përshtatshëm për t’u integruar dhe nuk ndjehen të diskriminuar për faktin se ata janë refugjatë edhe pse ka episode ku ata etiketohen me emrin e vëndit nga vinë. Gjithsesi kjo nuk duket se vjen për shkak të statusit të tyre të refugjatit.

3. Femijet e ngjuar

Neni 6 - E drejta e jetës. Fëmijët e ngjuar

1. Shtetet Palë, njohin se cdo fëmijë ka të drejtën e pamohueshme për të jetuar.
2. Shtetet Palë, marrin të gjitha masat e mundshme për të siguruar mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës.

E drejta për të jetuar është e drejta më themeltare e një qenie njerëzore. Nisur nga një këndvështrim pak të më të gjërë, duke gjetur mbështetje edhe në frymën dhe përcaktimet e nenit të mësipërm, kjo e drejtë do të lidhej ngushtë me të drejtën për një zhvillim sa më optimal për fëmijën. Si rrjedhojë bashkë me të drejtën për të jetuar, do të shqyrtoheshin në formë të pandashme edhe e drejta për një trajtim të përshtatshëm shëndetësor si dhe e drejta për t'u arsimuar e fëmijës. Panvarësisht se këto element janë përfshirë në shqyrtimin e këtij neni, studimi është përqendruar tek një kategori fëmijësh, problemet e të cilëve janë të mirënjohur nga institucionet përkatëse shtetërore. Këta janë fëmijët e ngjuar. Ky grup fëmijësh është përfshirë si një kategori e vecantë në këtë studim, për shkak se pozita në të cilën ata ndodhen I vendos në një situatë jo normale dhe që I dallon ata ekstremisht nga fëmijët e tjerë. Le të shohim më poshtë pjesë nga informacioni I grumbulluar.

3.1 Metoda

Për të grumbulluar informacion në lidhje me të drejtat e fëmijëve të cilat burojnë nga ky nen u kryen 3 intervista me fëmijë të ngjuar dhe me prindërit e tyre (mamatë). Le të shohim më poshtë informacionin I cili u sigurua nga intervistat.

A . është 6 vjec. Jeton në fshatin Bardhaj të Shkodrës. Ai gjendet I ngjuar në shtëpinë e tij prej 1 viti e 3 muaj. A. ka probleme serioze të të parit, por nuk është vizituar. Mamaja e tij tregon:

A, ka shumë probleme me sytë, por nuk mundem ta coj te doktorri, kam frikë. Nuk mundem ta coj as në shkollë, se edhe fëmijët e familjes me të cilën jemi në gjak, janë në të njëjtën shkollë. A, qëndron gjithë ditën në shpi, para tv dhe bëhet shumë shpesh nevrik. Ai me pyet “ pse të mos dal të loz me shokët? Pse mos të shkoj në shkollë?

J, 9 vjec dhe B 9 vjec, janë dy vëllezër binjakë të cilët jetojnë në të njëjtin fshat me A dhe janë ngjuar në shtëpi prej rreth një viti. Ata nuk shkojnë në shkollë dhe nuk dalin të lozin me shokët. Gjatë kohës së intervistës me mamatë e tyre, J, ishte me temperaturë të lartë, por ai nuk mund të shkonte tek doktorri. Mamaja e tyre shprehet:

Fëmijët mërzhiten shumë në shtëpi. Ata shpesh herë dalin deri tek dera jashtë, por unë I marr menjëherë brënda. Në shkollë nuk mund t'I coj, kështu që mësuesi vjen këtu në shtëpi për t'u mësuar mësimet.

Fëmijët kanë filluar të bëhen nervoz shumë shpejt. Kohën e kalojnë duke bërë detyrat që u jep mësuesi dhe duke lexuar ndonjë libër.

Në bisedë me mësuesin I cili shkon në shtëpitë e këtyre fëmijëve, ai pohon se mundohet që t'u mësojë sa të mundet, por ai nuk mund t'u mësojë të gjitha lëndët. Ata marrin edhe një certifikatë shton ai, por nuk është njëlloj si dëftesa e shkollës.

3.2 Konkluzion:

- Institucionet shtetërore përgjegjëse, nuk mund të garantojnë jetën e fëmijëve (djem) të cilët ngujohen për shkak të fenomenin të gjakmarrjes në disa zona veriore të Shqipërisë. Mbështetur në informacionin e mësipërm, si rrjedhojë e të qenit të ngujuar këta fëmijë mohohen nga kushtet minimale për një zhvillim fizik, psikologjik dhe moral përfshirë këtu edhe të drejtën për t'u shkolluar dhe për shërbimin e nevojshëm shëndetësor.

4. Femijet ne institucion

Neni 20 -Fëmijët në institucion

Një fëmijë të cilit I mohohet në mënyrë të përkohshme ose të përhershme mjedisi familjar , ose kur nuk është në interesin e tij më të lartë të qëndrojnë në këtë mjedis, ka të drejtë për një mbrojtje dhe ndihmë të vecantë nga shteti.

4.1 Metoda

Me fëmijët në institucione u kryen 8 intervista në shtëpitë e fëmijës të qyteteve të Tiranës, Shkodrës dhe Sarandës.

Është e kuptueshme se fëmijët e privuar nga një mjedis I ngrohtë dhe përkujdesës famiiljar, kanë nevojë që të gjejnë mbështetjen e duhur në institucionet e përkujdesjes të ngritur enkas për ta. Krijimi I një ambjenti sa më të përshtatshëm që të krijojë për ta hapsirat e duhura për një zhvillim sa më optimal fizik dhe psiko-emocional është qëllimi kryesor I këtyre institucioneve. Nëpërmjet intervistave është synuar të kuptohet se cili është përjetimi dhe perceptimi I vetë fëmijëve të cilët ndodhen në institucion mbi mënyrën se si ata jetojnë.

Ilustrime intervistash me fëmijët në institucion përkujdesjeje

Trajtimi në institucion

Në mëngjes na zgjojnë kujdestaret rreth orës 6.30 duke bërëtitur nëpër korridor. Thonë “cohuni!!”. Kur kam qënë I vogël me kanë bërëtitur kujdestaret edhe me kanë goditur me shpulla. (Djalë 18 vjec)

Mësueset u bërtasin dhe u gjuajnë fëmijëve të vegjël, sidomos kur ata grinden apo kur bëjnë ndonjë gjë. Mua më mërzhisin kur më kujtojnë të kaluarën time. Nuk dua që ato të ma kujtojnë. Me një kujdestare zihem shumë, por e kam mirë me një tjetër. (Vajzë 15 vjec).

Ka mësuese të mira, por ka edhe të këqija, ato më bërtasin. Edhe kur dalë pa leje nga këtu më bërtasin dhe më kërcënojnë Kur zihen të vegjlit, mësueset u bërtasin dhe I godasin edhe me shpulla. Edhe une kur isha I vogël më kanë rrahur, thuhajse cdo ditë.

Rrobat I lajmë në lavanderi por ndodh që edhe të vidhen. Për t'i marrë fëmijët zihen me njëri tjetrin. Edukatorja nuk përziehet. Fëmijët mbyllen në dhomë dhe zihen deri sa t'i marrin rrobat. Këtë e dinë edhe kujdestaret. (Djalë 14 vjec)

Neve vajzat na trajtojnë më mirë se djemtë zihen. Edhe ne në fakt zihemi me djemtë (vajze 15 vjec)

4.2 Ushqimi

Ushqimi është I mirë, më pëlqen. Ndryshon shumë shpesh. Në hamë në mëngjes para se të shkojmë në shkollë, në drekë nga ora 14 :00, kur vimë nga shkolla dhe në darkë. (djalë 18 vjec)

Ushqimi më pëlqen, është I ndryshëm. (djalë 14 vjec)

Ushqimi nganjëherë nuk më pëlqen. Bëjnë gjëra që nuk I ha. Në guzhinë punojnë edhe vajza, pëveç punëtorëve por ato nuk na pyesin ne se cfarë duam të hamë asnjëherë. (Djalë 15 vjec)

4.3 Shkolla

Në shkollë shkoj vetë. Nuk e kam shumë larg nga këtu. Kur ka takim me prindër vjen kujdestarja ime (djalë 18 vjec).

Në shkollë nganjëherë me thonë se jam konviktor I shtëpisë së fëmijës. Reagojnë keq me mua (Djalë 14 vjec).

Në shkollë shkoj me një djalë tjetër që jemi në një klasë. Atje kalojmë mirë. Kur ka takim me prindër, vjen kujdestarja jonë. (Djalë 15 vjec)

4.4 Studimi

Kur vi nga shkolla, ha bukë, loz dhe pastaj filloj studijoj. Gjithsej jemi gjashtë vetë në grup. Ka mësuese të mira, por ka edhe të këqija që na bërtasin. (djalë 14 vjec)

Studijoj vetëm 2 ditë në javë me mësuesin dhe me një shok. (djalë 18 vjec)

Nga ora 15:00 deri në 16:00, unë bëj detyrat. Mësuese na bërtasin ndonjëherë. Edhe më kanë dënuar një herë duke mos më lënë të dal me shokët. (Djalë 15 vjec)

Argëtimi dhe koha e lirë

Pasi bëj detyrat loz futboll apo shoh tv. Me kanë thënë që do më fusin në futboll apo në boks por deri tani nuk është bërë asgjë. Kur shkolla organizon ndonjë aktivitet sportive une marrë pjesë (djalë 15 vjec)

Unë shoh tv ose loz futboll me cunat se më pëlqen shumë. Shpresoj të na e rregullojnë fushën dhe të na e bëjnë palestrën. Marr pjesë edhe në kurse futbollit që I organizon një organizatë. (vajzë 15 vjec)

Marr pjesë në aktivitete sportive të shkollës, por në të tjera nuk shkoj se kam turp (djalë 18 vjec)

Unë nuk jam në ndonjë kurs jashtë shkolle. Po të kesh qejf thonë që mund të shkosh, por unë nuk kam dëshirë (djalë 14 vjec).

4.5 Konkluzione

- 
- Punojnësit e institucioneve duket se bëjnë diferencim në trajtimin e fëmijëve. Ky diferencim duket se vjen për shkak të moshës, gjinisë, por shfaqet edhe mbi baza individuale.
 - Punonjësit shfaqin shpesh sjellje të papërshtatshme për trajtimin e fëmijëve. Në intervistimet e fëmijëve vihet re se punonjësit shfaqin si elementë të neglizhimit, ashtu edhe të dhunës psikologjike dhe fizike.
 - Fëmijëve shpesh u humbin sendet e tyre personale dhe ata nuk mundet që këto probleme t'i zgjidhin me stafin e punonjësve. Vërehet një mungesë e metodave të përshtatshme të komunikimit dhe raporteve të ngushta midis punonjësve dhe fëmijëve.
 - Ushqimi në institucion shpesh herë është i pëlqyeshëm por shpesh herë nuk është. Të gjitha vaktet hahen me orar.
 - Në institucion vërehen mungesa alternativash për t'u argëtuar si në mungesën e ambjentëve të përshtatshme sportive ashtu edhe në kurse jashtë shkollore të natyrës artistike dhe shkencore.

5. Fëmijët e rrugës

Neni 7 - Fëmijët e rrugës.

1. Fëmija regjistrohet menjëherë sapo lind dhe qysh atëherë ka të drejtën të ketë një emër, të drejtën për të fituar shtetësinë dhe, brenda mundësive të drejtën për të njohur prindërit e tij dhe për të pasur kujdesin e tyre.

Neni 27 - E drejta e fëmijës për një nivel jetese të mjaftueshëm

1. *Shtetet Palë njohin të drejtën e çdo fëmije për një nivel jetese të mjaftueshëm për zhvillimin e tij fizik, mendor, shoqëror, moral.*
2. *Përgjegjësinë për të siguruar kushtet e nevojshme të jetesës për zhvillimin e fëmijës, brenda kufijve të mundësive dhe mjeteve të tyre financiare, e kanë në rradhë të parë prindi ose prindërit ose personat e tjerë përgjegjës për rritjen e fëmijës.*
3. *Shtetet Palë marrin masat e duhura, sipas kushteve kombëtare dhe mundësive të tyre, për të ndihmuar prindërit dhe personat e tjerë përgjegjës për fëmijën, që të vënë në jetë këtë të drejtë dhe në rast nevojë për të lidhur më ushqim, veshëmbathje dhe banim.*

Neni 28 - E drejta për arsim

1. Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për arsimim dhe me qëllim që të arrihet kjo e drejtë, hap pas hapi dhe mbi bazën e mundësive ...

6. Femijet e trafikuar

Neni 35 - Fëmijët e trafikuar

Shtetet Palë marrin të gjitha masat e nevojshme në planin kombëtar, dypalësh dhe shumëpalësh, për të mos lejuar rrëmbimin, shitjen ose trafikun e fëmijëve për çdo qëllim dhe në çfarëdo lloji forme qoftë.

Në këtë grup fëmijësh ashtu sic mund të vërehet janë shqurtuar disa të drejta. Kjo për arsyen se këto të drejta janë shumë të lidhura me njëra tjetrën në rastin e fëmijëve të cilët jetojnë në rrugë. Një vëmëmdje e vecantë, ashtu sic do të vëheret dhe më poshtë, I është kushtuar edhe fenomenit të trafikimit të fëmijëve.

Fënomen ky që është ngushtësisht I lidhur me problemet e fëmijëve të rrugës, për faktin se ata janë fëmijë të pambrojtur dhe si rrjedhojë një target I lehtë për t'u rrëmbyer dhe shfrytëzuar për qëllime përfitimi.

6.1 Metoda

Për të kuptuar më mirë dhe më në thellësi problemet të cilat përjeton një fëmijë I cili jeton në kushtet e rrugës, ky studim përzgjedhi marrjen në detaje të historisë së një fëmije. Kjo paraqitje e një rasti, u gjykua si mënyra më e përshtatshme për të krijuar një tablo më të qartë të jetës së këtyre fëmijëve. Kësisoj, në vijim do të paraqitet informacioni I marrë nga një intervistë me një fëmijë I cili përveç se jeton aktualisht në rrugë, është trafikuar dhe shfrytëzuar në një shtet fqinj për qëllime përfitimi nga persona të tjerë.

A është 16 vjec dhe jeton në një qytet në qytetin e Korcës. Ai aktualisht jeton në rrugë duke lypur dhe duke grumbulluar plera nëpër kazane. Ai nuk ka një certifikatë dhe nuk ka informacion nëse është apo jo I regjistruar. Prindërit e tij janë divorcuar në muajt e para kur A ka lindur. Gjatë bisedës me të ai tregon:

Une kam punuar që I vogël nëpër kazane me babain tim. Edhe tani nëpër kazane punoj edhe une edhe babi. Për të fjetur shpesh herë flej tek një komshi I cili më ka ndihmuar sepse babi me njerken nuk me duan në shtëpi. Nëse shkoj atje ata më rrahin.

Kam bërë 5 klasë shkollë dhe pastaj e kam lënë se me hoqi babi se une duhet të punoja nëpër kazane me të. Më ka nxjerrë edhe në rrugë për të lypur. Në rrugë disa herë më ka kapur policia për të më cuar në shtëpi, por unë u thoja të mos më conin se do më rrihte babi. Kur ata më conin në shtëpi, une largohesha prapë dhe shkoja te komshiu. Edhe policet me kanë goditur nganjëherë me shpulla.

Një herë në rrugë ca të mëdhej me debën dhe më futën që të vidhja ca kazane. Më kapi policia dhe tani une jam me liri me kusht.

Një herë tjetër kur unë po lypja në rrugë, një burrë më goditi me shkelma dhe shpulla. Une nuk kisha ku të shkoja dhe të mbrohesha apo të ankohesha.

Kur kam qënë 6 vjec kam qënë në Greqi. Atje shkova me një shok të babit nga mali. Në fillim unë nuk e dija se ku po shkoja. Ai më nxirrte të lypja dhe kur nuk bëja para më godiste me shpulla. Pastaj më kapi policia dhe më solli me autobus deri këtu. Pasi erdha ne kufi fjeta një natë në Bilisht. Më pas me mori përsëri ai shoku i babit dhe më solli në shtëpi.

Tani jam I sëmure, më duket se jam ftohur. Kur sëmurem nuk kam ku të shkoj.

6.2 Konkluzione

- Mbështetur në informacionin e mësipërm mund të pohohet se fëmijët të cilët jetojnë në rrugë shfaqen të limituar ndaj informacionit janë apo jo të regjistruar në zyrën e gjëndjes civile.
- Gjatë periudhës që ata jetojnë në rrugë nuk ndjekin arsimin e detyruar.
- Kjo kategori fëmijësh kanë marrëdhënie jo të shëndetshme me prindërit e tyre. Vërehen dukesh format e neglizhimit dhe abuzimit fizik dhe psikologjik si dhe shfrytësimi i tyre në punë të papërshtatshme për ta.
- Fëmijët të cilët jetojnë në rrugë janë një preh shumë e lehtë për t'u trafikuar për qëllime shfrytëzimi dhe përfitimi brënda dhe jashtë vëndit. Kjo mund të kryhen edhe nga vetë prindërit e tyre.
- Gjatë kohës të cilën ata jetojnë në rrugë, fëmijët janë të ekspozuar ndaj rreziqeve serioze për jetën e tyre, kanë mungesë totale përkujdesjeje shëndetësore dhe nganjherë përjetojnë episode keqtrajtimi edhe nga punonjës të policisë.
- Fëmijët të cilët janë të trafikuar dhe shfrytëzuar jashtë vëndit, mbështetur në informacionin e mësipërm, duket se nuk i nënshtrohen procedurave për një kthim të sigurt në familjet e tyre nga ana e institucioneve përgjegjëse.

7. Femijet e minoriteteve

Neni 30 - Fëmijët pjesë e minoriteteve.

Në shtetet ku ekzistojnë pakica etnik, fetare apo gjuhësore, ose persona me origjinë autoktone, një fëmije që i përket një minoriteti ose është autokton, nuk mund t'i mohohet e drejta për të pasur kulturën e vet, të ushtrojë dhe praktikojë fenë e vet, ose të përdorë gjuhën e vet së bashku me anëtarët e tjerë të grupit të tij.

Neni 2 Mosdiskriminimi

Shtete Palë, angazhohen të respektojnë të drejtat e përmendura në këtë Konventë dhe t'i garantojnë ato cdo fëmije, që përfshihet në juridiksionin e tyre, pa asnjë lloj dallimi, panvarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinioni politik ose cdo opinion tjetër, nga origjina kombëtare, etnike ose shoqërore....

Për të kuptuar se sa fëmijët romë, diskriminohen dhe se sa shteti u agaranton të drejtat e tyre të përcaktuar nga KDF, ky studim u fokusua tek jeta e tyre në shkollë, vënd ku fëmijët kalojnë një pjesë të mirë të kohës së tyre dhe kanë kontakte të vazhdueshme me një institucion shtetëror. Por sic mund të vërehet dhe në pjesët e ilustruara të intervistave, shkolla nuk ka qënë fokusi i vetëm i bisedave.

7.1 Metoda

Për më mësuar më shumë në lidhje me jetën e fëmijëve të komuniteti rome në Shqipëri, u kryen intervista gjysëm të strukturuar me 5 fëmijë romë.

Ilustrime intervistash me fëmijë të komunitetit romë

7.2 Shkolla

Sic u prek pak edhe më sipër, periudha shkollore është periudha më e rëndësishme për një fëmijë. Shkolla është vendi ku ata ndeshen për herë të parë me rregullin, jetën shoqërore, rregullat, autoritetin si dhe arritjet dhe dështimet personale. Thënë me fjalë të tjera, shkolla krijon mundësitë për një zhvillim sa më normal të fëmijëve. Për këtë arsye, por edhe për të kuptuar më mirë natyrën e ndërveprimit të fëmijëve romë me bashkëmoshatarët e tyre që nuk janë pjesë e këtij komuniteti dhe mësueset, studimi është fokusuar pikërisht në eksperiencat e këtyre fëmijëve në shkollë..

Unë kam bërë vetëm klasën e parë. Në klasë të dytë e kam lënë shkollën, se qante motra shumë. Ajo nuk dinte të lexonte abetaren dhe qante. Nga shkolla na nxorri mësuesja se motra qante shumë. Ajo edhe na rrfite. Me shoqet e klasës nuk kam shkuar mirë në shkollë. Ato nuk donin të rrinin me mua dhe më thonin “gabelle”. Në shkollë unë nuk e di të kishite ndonjë kurs I cili u mëson fëmijëve gjuhën rome, as të shtëpia nuk ka. (vajzë rome 12 vjec)

Në fillim kur erdha në shkollë shokët e klasës dhe mësuesit nuk silleshin mirë me mua. Ata më thonin “gabel”. Po tani më rrepektojnë të gjithë. Kur një mësuese më qëllloi me shpullë mua dhe vëllain tim, ne u ankuam dhe drejtori I dërgoi letër vërejtje dhe paralajmërimi mësueses. Kurse për mësimin e gjuhës rome nuk ka as në shkollë dhe as në lagjen time. (djalë romë 14 vjec, në klasë të 7)

Kur erdha në fillim fëmijët e tjerë nuk silleshin mirë me mua, kurse tani nuk kam më probleme me ta. Nëklasë jemi vetëm tre veta romë, por ne nuk flasim kurrë gjuhën rome me njëri-tjetrin në shkollë. Kurse për gjuhën rome nuk ka në shkollë. (djalë romë 16 vjec, në klasë të 7)

Në shkollë nuk kam qënë asnjëherë. Nuk më kanë cuar mami dhe babi. Unë kam shumë shokë dhe shoqe që janë në shkollë dhe I kam thënë mamit dhe babit për të shkuar edhe unë, por ata nuk më kanë dërguar. (djalë romë 8 vjec)

Mos frekuentimi I shkollës duket se është një faktor I cili ka shtyrë fëmijët të përfshihen në punë.

Unë pasi lashë shkollën shkoja me mamën dhe me babin për të bledhur hekura. Në shkonim në një vënd mbrapa tregut të madh dhe gërmonim në tokë. Pastaj hekurat I shiste babi. Edhe mua më jepte ndonjë lek. (vajzë rome 12 vjec)

7.3 Konkluzione

- Institucionet përgjegjëse shtetërore nuk kanë krijuar kushtet që fëmijët romë të ndjekin kurse për të mësuar gjuhën e tyre. Nga bisedat me këta fëmijë u vu re se ata nuk janë në dijeni dhe nuk kanë frekuentuar asnjëherë kurse të tilla.
- Ambjenti në shkollë ndikon negativisht në frekuentimin dhe ndjekjen e shkollës nga fëmijët. Duket se mësueset edhe nxënësit e tjerë shfaqin sjellje diskriminuese dhe shmangëse ndaj këtyre fëmijëve. Ky është një faktor i cili ka ndikuar negativisht në frekuentimin e tyre në shkollë dhe madje ka çuar në braktisjen e saj prej këtyre të fundit. Gjithsesi duhet theksuar se në rastet kur fëmijët romë qëndrojnë në shkollë për të ndjekur të gjitha vitet shkollore, sjellja e fëmijëve dhe mësuesve në raport me përkatësinë e tyre etnike, shfaqet e moderuar.
- Duket se strukturat e shkollës në disa raste shfaqen më të ndjeshme ndaj problemeve të fëmijëve romë duke dëgjuar dhe reaguar ndaj ankesave të tyre.
- Elementët e dhunës psikologjike dhe fizike shfaqen dukshëm tek fëmijët romë gjatë periudhës që ata janë në shkollë. Sic mund të vërehet nga pohimet e fëmijëve, mësueset shfaqin dhunë psikologjike dhe fizike ndaj këtyre fëmijëve, madje edhe sjellje ekstreme sic mund të jetë propozimi për përjashtim nga shkolla I tyre.
- Pridërit e fëmijëve romë, janë shumë pak të ndërgjegjesuar dhe kanë pak interes që fëmijët e tyre të ndjekin shkollën. Nga bisedat me fëmijët u kuptua qartë se monitorimi I tyre nga ana e prindërve në lidhje me mbarrëvajtjen në shkollë është në nivele shumë të ulta.



II. Fëmijët pa karakteristika të vecanta

8. Pjesëmarrja dhe argëtimi

Neni 31. E drejta e fëmijës për kohë të lirë, argëtim dhe pushim


1. Shtetet Palë I njohin fëmijës të drejtën të pushojë dhe të argëtohet, të praktikojë lojëra dhe veprimtari shplohëse, në përshtatje me moshën, si dhe të marrë pjesë lirisht në jetën kulturore dhe artistike.

Përvec pjesëmarrjes në vendimmarrje, fëmijëve duhet t'u garantohen kushtet e përshtatshme edhe për të marrë pjesë në aktivitete konkurruese apo argëtuese. E drejta e fëmijëve për t'u përfshirë në aktivitete artistike, përfshin të drejtën për të patur akses në aktivitete kulturore të përshtatshme për zhvillimin e tyre, qofshin ato të organizuara nga të rriturit apo edhe të organizuara nga vetë fëmijët. Për të kuptuar se sa shteti shqipëtar I përmbush detyrimet e këtij neni, ky studim u fokusua në aspektin e pjesëmarrjes në aktivitetet që organizon shkolla.

8.1 Pyeja dhe paraqitja grafike dhe tabelore

A të lajmërojnë ty mësueset për aktivitet që organizon shkolla?

B 4. A të lajmërojnë ty mësueset për aktivitete jashtë shkollore që organizon shkolla?




	B.4. A të lajmërojnë ty mësueset për aktivitet jashtë shkollore që organizon shkolla?
	%
bosh	59%
Po	92,46%
Jo	6,95%
Total	100,00%

A merr ti pjesë në këto aktivitete?


	B.5. A merr ti pjesë ne keto aktivitete?
	%
bosh	1,63%
Po	78,85%
Jo	19,53%
Total	100,00%

B.5. A merr ti pjesë në këto aktivitete?



Nëse jo, cila është arsyeja që nuk merr pjesë?

	B.6. Nese jo, cila është arsyeja që nuk merr pjesë?
	%
bosh	68,20%
Nuk te tregon mesuesja/si per aktivitetin	2,37%
Nuk te zgjedh mesuesja/si	6,36%
Nuk te marrin shoket	,44%
Nuk te lene prinderit	2,22%
Nuk ke deshire te shkosh vete	20,41%
Total	100,00%



B.6 Nëse jo, cila është arsyeja që nuk merr pjesë?

8.2 Konkluzione

Mbështetur në informacionin e paraqitur në grafikët dhe tabelat e mësipërme mund të pohohet se pjesa më e madhe e fëmijëve lajmërohen nga mësueset për të marrë pjesë në aktivitete jashtë shkollore të organizuara nga vetë shkolla dhe pjesa më e madhe e tyre marrin pjesë në to. Pjesa më e madhe e fëmijëve të cilët nuk marrin pjesë në këto aktivitete pohon se nuk kanë dëshirë vetë të shkojnë. Këtu vlen për t'u theksuar se një përqindje e

cila mund të merret në konsideratë tek fëmijët e grup-moshës 15-18 vjec, 11.76%, pohojnë se nuk I lajmëron mësuesja dhe 11.18% pohojnë se nuk I përzgjedh mësuesja. Nisur nga përgjigjet e fëmijëve, mund të pohohet se e drejta e tyre për të marrë pjesë dhe për t'u argëtuar në aktivitetet shkollore gjen zbatim në pjesën më të madhe të fëmijëve.

9. Konsiderimi i fjalës

Neni 12 - Konsiderimi i fjalës

1. *Shtetet Palë I garantojnë fëmijës, i cili është I aftë të shfaq pikëpamjet e tij, të drejtën për t'i shprehur lirisht këto pikëpamje, për cdo çështje që ka të bëjë me të, duke I vlerësuar ato në përputhje me moshën dhe shkallën e pjekurisë.*


Për të bërë të mundur mbledhjen e informacionit në lidhje me faktin se sa dëgjohej dhe konsiderohet zëri I fëmijëve, ky studim u fokusua tek konsiderimi I fëmijëve në shkollë në lidhje me kërkesat apo dëshirat e tyre, si në rastet kur shprehen individualisht, ashtu dhe kur ato shprehen nga struktura të vecanta të ngritura nga fëmijët, sic është qeveria e nxënësve. Përvec konsiderimit në shkollë, ky studim trajtoi edhe konsiderimin e fjalës dhe të opinionit të fëmijëve në shtëpi nga ana e prindërve, në lidhje me vendime që u përkasin atyre apo dhe me dëshirat e tyre.

9.1 Pyeja dhe paraqitja grafike dhe tabelore

A i dëgjon mësuesja ankesat e tua gjatë orës së mësimi?

t	C.7. A i degjon mesuesja ankesat tuaja gjate ores se mesimit?
	%
bosh	1,18%
Po	88,17%
Jo	10,65%
Total	100,00%


C 7. A i dëgjon mësuesja/si ankesat tuaja gjatë orës së mësimi



A I dëgjon mësuesja/si kërkesat e tua apo të shokëve të tu të klasës për ndonjë aktivitet jashtë shkollor?

	C.8. A i dëgjon mësuesja/si kërkesat e tua apo të shokëve të tu të klasës për ndonjë aktivitet jashtë shkollor?
	%
bosh	1,78%
Po	86,69%
Jo	11,54%
Total	100,00%


C.8. A i dëgjon mësuesja/si kërkesat e tua apo të shokëve të tu të klasës për ndonjë aktivitet jashtë shkollor?



A I ke thënë ankesat e tua tek qeveria e nxënësve?


	C.9. A e di ti nëse ka qeveri nxënësish në shkollën tënde?
	%
bosh	1,33%
Po	78,70%
Jo	19,97%
Total	100,00%

C.9. A i ke thënë ankesat e tua tek qeveria e nxënësve?



	C.10. A i ke thënë ndonjëherë ankesat e tua tek qeveria e nxënësve?
	%
bosh	1,78%
Po	24,41%
Jo	73,82%
Total	100,00%

C.10. A i ke thënë ndonjëherë ankesat e tua tek qeveria e nxënësve?



A ke ti informacion nëse drejtoria e shkollës I ka dëgjuar kërkesat e qeverisë së nxënësve?

	C.12. A e di ti nëse drejtoria e shkollës i ka dëgjuar kërkesat e qeverisë së nxënësve?
	%
bosh	2,07%
Po	60,50%
Jo	37,43%
Total	100,00%


A ka në shkollën tënde një vend ku mund të dorëzohen me shkrim ankesat e nxënësve?

	C.11. A ka në shkollën tënde një vend ku nxënësit mund të dorëzojnë ankesat e tyre me shkrim?
	%
bosh	3,11%
Po	54,73%
Jo	42,16%
Total	100,00%


A I dëgjojnë prindërit kërkesat e tua për;

1. kurset ku ke dëshirë të shkosh pas mësimit?
2. kohën që do të kalosh me shokët e tu jashtë shtëpisë ?
3. dëshirën se ku do të shkosh me pushime verore apo dimërore?
4. për të ndjekur aktivitete që organizon shkolla ku ke dëshirë të shkosh edhe ti?
5. emisionet apo filmat që do të shohësh në televizor?


C.12A Po në shtëpi a i dëgjojnë prindërit kërkesat e tua për:
 - Kurset që do të shkosh pas mësimit




C.12B Po në shtëpi a i dëgjojnë prindërit kërkesat e tua për:
 - Kohën që do të kalosh me shokët e tu jashtë shtëpisë





C.12C Po në shtëpi a i dëgjojnë prindërit kërkesat e tua për:
 Dëshirën tënde se ku do shkosh për pushime verore apo dimërore



C.12D Po në shtëpi a i dëgjojnë prindërit kërkesat e tua për:
 Aktivitet që organizon shkolla ku ke dëshirë të shkosh dhe ti



C.12E Po në shtëpi a i dëgjojnë prindërit kërkesat e tua për:
 Emisionet apo filmat që do të shohësh në televizor



C.12F Po në shtëpi a i dëgjojnë prindërit kërkesat e tua për:
 Tjetër

	C.13A Po ne shtëpi a i degjojne prinderit kerkesat e tua per - Kurset qe do te shkosh pas mesimit	C.13B Po ne shtëpi a i degjojne prinderit kerkesat e tua per - Kohen qe do te kalosh me shoket e tu jashte shtepise	C.13C Po ne shtëpi a i degjojne prinderit kerkesat e tua per - Deshiren tende se ku do te shkosh per pushime verore apo demerore	C.13D Po ne shtëpi a i degjojne prinderit kerkesat e tua per - Aktivitet qe organizon shkolla ku ke deshire te shkosh dhe ti	C.13E Po ne shtëpi a i degjojne prinderit kerkesat e tua per - Emisjonet apo filmat qe do te shohesh ne televizor
	%	%	%	%	%
Po	70,86%	56,36%	60,65%	71,15%	55,18%
Jo	29,14%	43,64%	39,35%	28,85%	44,82%

Total	100,00%	100,00%	100,00%	100,00%	100,00%
			C.13F Po ne shtëpi a i degjojnë prinderit kërkesat e tua për – Tjetër		
			%		
Nuk ka kërkesë tjetër			88,61%		
Kërkesa për blerjen e librave, veshjeve dhe gjera të tjera			9,02%		
Marrja e mendimit për diskutime të ndryshme në familje			2,37%		
Total			100,00%		

9.2 Konkluzione

Sic mund të vërehet edhe në grafikët dhe tabelat e mësipërme, pjesa më e madhe e nxënësve të moshës 15-18 vjec të pyetur, janë përgjigjur se mësuesja I dëgjon kërkesat e tyre gjatë orës së mësimi (77.86%). Edhe për faktin nëse mësuesja I dëgjon ata kur kanë ndonjë kërkesë për aktivitete jashtë-shkollore pjesa më e madhe e tyre janë përgjigjur pozitivisht (81.18%). Në lidhje me faktin nëse nxënësit I shprehin ankesat e tyre në qeverinë e nxënësve pjesa më e madhe e të anketuarve janë përgjigjur se nuk I shprehin ankesat e tyre tek kjo strukturë (71.59%). Në lidhje me faktin se ata të cilët I shprehin ankesat e tyre tek qeveria e nxënësve, kanë informacion se çfarë ka ndodhur me ankesat e tyre, përsëri pjesa më e madhe është përgjigjur se nuk ka informacion (58.83%), por një pjesë jo e vogël e tyre janë përgjigjur se kanë informacion (41.14%). Nxënësit janë pyetur edhe për mënyrën e të adresuarit me shkrim të kërkesave apo ankesave të tyre, tek një kuti që duhet të jetë e vendosur në cdo shkollë. Mbi ekzistencën e kësaj kutie, pjesa më e madhe e nxënësve të anketuar (52.95%), nuk janë në dijeni dhe pjesa më e vogël, por jo e pakonsiderueshme (41.46%) janë shprehur se janë në dijeni.

Mbi çështjet e mësipërme edhe përgjigjet e dhëna nga grup-mosha 10-14 vjec ndjekin të njëjtin trend.

Mbi konsiderimin e fjalës në shtëpi, duket se prindërit janë më të prirur të dëgjojnë kërkesat e fëmijëve të tyre mbi kurset që duan të kryejnë jashtë programit mësimor (67.71%) dhe marrjen pjesë në aktivitetet e organizuara nga shkolla (72.14%). Në lidhje me kohën për të kaluar jashtë shtëpisë, pushimet dimërore apo verore dhe programet që fëmijët kanë dëshirë të shohin në televizor, mund të pohohet se diferenca mes atyre që janë përgjigjur pozitivisht dhe atyre që janë përgjigjur negativisht nuk është e madhe. Por vlen të theksohet se një përqindje e konsiderueshme e fëmijëve janë përgjigjur se prindërit nuk I dëgjojnë kërkesat e tyre në lidhje

me këto tre çështje. Ajo cfaë vlen të theksohet nga rezultatet e këtij seksioni të pyetësorit është se një përqindje thuhet e pakonsiderueshme e fëmijëve janë përgjigjur se mendimi e tyre konsiderohet gjatë diskutimit të çështjeve të ndryshme familjare (1.29%). Të njëtin trend ndjekin edhe përgjigjet e fëmijëve të grup-moshës 10-14 vjec.

Mbështetur nga gjetjet e mësipërme mund të pohohet se në shkollë fjala e fëmijëve merret në konsideratë nga mësuesit kur ajo është e shprehur si kërkesë e komunikuar në mënyrë të drejt për drejtë mes nxënësit dhe mësuesve. Strukturat e ngritura nga fëmijët dhe të përbëra prej tyre, duket se nuk janë shumë funksionale dhe nuk përbëjnë një strukturë efikase ku fëmijët të kenë besim të shprehin problemet e tyre. Nisur nga ky fakt mund të pohohet se fëmijët nuk kanë gjetur akoma terrenin e përshtatshëm nga stafi I shkollës, për t'u dëgjuar dhe konsideruar kur shfaqen në mënyrë të oranzuar dhe përfaqësohen nga organe të përbëra prej tyre.

Për sa I përket konsiderimit të fjalës në shtëpi, prindërit shfaqen dëgjues vetëm kur fëmijët shfaqin kërkesa që lidhen me interesat e tyre të drejt për drejta dhe jo në rastet kur ata shprehin mendimin në lidhje me problemet familjare.

Në lidhje me këndin ku mund të dorëzohen ankesat me shkrim, që bazuar në urdhëresa e MASH-së duhet të jetë në cdo shkollë, duket se fëmijët e grup-moshës 10-14 vjec të cilët ndjekin arsimin 9 vjecar, janë më të mirë informuar se ata të cilët ndjekin arsimin e mesëm.

10. Media

Neni 17 - Aksesit i fëmijëve tek një informacion i përshtatshëm

Shtetet Palë njohin funksionin e rëndësishëm që përmbushin mjetet e komunikimit masiv dhe garantojnë që fëmija të marrë informacione dhe materiale që vijnë nga burime të ndryshme kombëtare...

e. Nxisin përpunimin e orientimeve të nevojshme për mbrojtjen e fëmijës nga informacioni dhe materialet që dëmtojnë mirëqenien e tij...

Sic kanë treguar pjesa më e madhe e studimeve në lidhje me efektet e medias elektronike tek njerëzit, sidomos tek fëmijët, aksesit i fëmijëve ndaj një informacioni të përshtatshëm merr një rol të rëndësishëm në jetën e fëmijëve dhe një konsideratë të vecantë për t'u shqyrtuar. Në lidhje me këtë argument, studimi është përqendruar tek marrëdhënia e fëmijëve me televizorin si dhe kontrollin e mundshëm që prindërit mund dhe duhet të ushtrojnë tek fëmijët, për të monitoruar informacionin e përshatshëm për këta të fundit. Ajo cfarë sjell në vëmendje kjo qasje, është se të drejtat e fëmijëve mund të mos rrespektohen jo vetëm nisur nga neglizhimi apo veprime aktive të qëllimshme apo edhe jo të qëllimshme të cilat bien në kundërshtim me to, por edhe nga një lloj stili jete I cili edhe pse I ndikuar nga ambjenti përreth apo nga mungesa e informacionit, por nxitur nga qëllime pozitive, ndikon negativisht në mirëritjen e fëmijëve.


10.1 Pyeja dhe paraqitja grafike dhe tabelore

Cilat janë programet dhe filmat që shikon në televizor ?


2. Programe sportive
3. Programe muzikore
4. Programe dokumentarë
5. Filma për fëmijë
6. Filma për të rritur
7. Programe për fëmijë
8. Filma serial
9. Të ndryshme

10.


D. 14A Cilat programe shikon në televizor? - Sport




D. 14B Cilat programe shikon në televizor? - Muzikë




D. 14C Cilat programe shikon në televizor? - Dokumentar




D. 14D Cilat programe shikon në televizor? - Filma për fëmijë




D. 14E Cilat programe shikon në televizor? - Filma për të rritur




D. 14F Cilat programe shikon në televizor? - Programe për fëmijë



D. 14G Cilat programe shikon në televizor? - Seriale



D. 14G Cilat programe shikon në televizor? - Të ndryshme




	D.15A Cilat programe shikon ne televizor? - Sport	D.15B Cilat programe shikon ne televizor? - Muzike	D.15C Cilat programe shikon ne televizor? - Dokumentar	D.15D Cilat programe shikon ne televizor? - Filma per femije	D.15E Cilat programe shikon ne televizor? - Filma per te rritur	D.15F Cilat programe shikon ne televizor? - Programe per femije	D.15G Cilat programe shikon ne televizor? - Seriale	D.15H Cilat programe shikon ne televizor? - Te ndryshme
	%	%	%	%	%	%	%	%
Po	8,28%	16,42%	12,87%	49,26%	21,15%	48,08%	10,80%	15,38%
Jo	91,72%	83,58%	87,13%	50,74%	78,85%	51,92%	89,20%	84,62%
Total	100,00%	100,00%	100,00%	100,00%	100,00%	100,00%	100,00%	100,00%


Me cilin shikon ti televizor?

1. Me mamin
2. Me babin
3. Me të dy bashkë
4. Me gjyshin/shyshen
5. Me motrën/vëllain
6. Vetëm
7. Me shokët/shoqet


D. 16A Me cilin shikon ti televizor - Me mamin




D. 16B Me cilin shikon ti televizor - Me babin




D. 16C Me cilin shikon ti televizor - Me të dy bashkë




D. 16D Me cilin shikon ti televizor - Me gjyshin/gjyshen




D. 16E Me cilin shikon ti televizor - Me motrën/vëllain



D. 16F Me cilin shikon ti televizor - Vetëm




D. 16G Me cilin shikon ti televizor - Me shokët/shoqet



	D.17A Me cilin shikon ti televizor - Me mamin	D.17B Me cilin shikon ti televizor - Me babin	D.17C Me cilin shikon ti televizor - Me te dy bashke	D.17D Me cilin shikon ti televizor - Me gjyshin/ gjyshen	D.17E Me cilin shikon ti televizor - Me motren/ vellain	D.17F Me cilin shikon ti televizor - Vetem	D.17G Me cilin shikon ti televizor - Me shoket/ shoqet
	%	%	%	%	%	%	%
Po	24,41%	15,98%	41,12%	12,43%	60,36%	30,03%	12,72%
Jo	75,59%	84,02%	58,88%	87,57%	39,64%	69,97%	87,28%
Total	100,00%	100,00%	100,00%	100,00%	100,00%	100,00%	100,00%

Sa kohë qëndron ti përpara televizorit?



D.13. Sa kohë qëndron ti përpara televizorit?

	D.14. Sa kohe qendron ti përpara televizorit?
	%
0 ore ne dite	3,99%
1 ore ne dite	19,82%
2 ore ne dite	34,76%
3 ore ne dite	20,12%
4 ore ne dite	9,62%
5-10 ore ne dite	8,73%
gjysem ore ne dite	2,96%
Total	100,00%

Programet dhe filmat I shikon..

	D.16 Programet apo filmat i shikon
	%
bosh	1,78%
Paradite (nga ora 8:00 - 12:00)	2,22%
Pasditë (nga ora 12:00 - 18:00)	27,96%
Ne darke (nga ora 18:00 - 24:00)	43,93%
Pasditë edhe ne darke	19,23%
Paradite, pasditë dhe ne darke	1,33%
Paradite edhe ne darke	2,81%
Paradite edhe pasditë	,74%
Total	100,00%

10.2 Konkluzione

Kohëzgjatja dhe qëndrimi para televizorit. Në lidhje me faktin se sa kohë shpenzojnë fëmijët që jetojnë në fshat përpara televizorit, duke u mbështetur te grafikët dhe tabelat e mësipërme, mund të dallohet se pjesa më e madhe e fëmijëve kalojnë 2-4 orë në ditë duke parë televizor. Është për t'u theksuar fakti se një pjesë jo e pa konsiderueshme e fëmijëve të grup-moshës 15-18 vjec, ne raport me çështjen të cilën po trajtojmë, kalojnë 5-10 orë në ditë përpara televizorit.

Filmat dhe programet fëmijët I ndjekin gjatë orëve të mbrëmjes. Nga rezultatet e mësipërme mund të

pohohet se oraret e preferuara të fëmijëve për të parë televizorë janë gjatë periudhës së mbrëmjes., por një pjesë e considerueshme e fëmijëve pohojnë se preferojnë të shohin televizor edhe gjatë orarit të pasdites.

Lloji I programeve të cilat ndiqen nga fëmijët. Përgjigjet e fëmijëve të të dy grup-moshave në lidhje me këtë argument, tregojnë se ka një shpërndarje të llojit të programeve dhe filmave që cilat ata ndjekin.

Personat me të cilët fëmijët I shohin programet dhe filmat. Në lidhje me faktin se me kë preferojnë fëmijët të shohin programet dhe filmat televiziv, mbështetur në rezultatet e studimit, mund të pohohet se fëmijët preferojnë të qëndrojnë përballë ekranin më shumë me motrën apo vëllain, me të dy prindërit dhe vetëm. Vërehet se fëmijët e grup-moshës 15-18 vjec kanë më shumë dëshirë që të qëndrojnë vetëm përpara televizorit, në krahasim me fëmijët e grup-moshës 10-14 vjec. Tek kjo grup-moshë, prindërit duket se kanë më pak vëmendje dhe ushtrojnë më pak kontroll mbi programet që shohin dhe kohën që fëmijët shpenzojnë përpara televizorit.

11. Përgjegjësia prinderore


Neni 18 - Përgjegjësia e përbashkët prindërore e mbështetur nga shteti

Shtete Palë përpigjen me të gjitha mundësitë, për të siguruar njohjen e parimit, sipas të cilit të dy prindërit kanë përgjegjësi të përbashkët për edukimin dhe zhvillimin e fëmijës.

Ky nen shqyrton balancën e përgjegjësi midist prindërve dhe Shtetit dhe në vecanti adreson mbështetjen ndaj prindërve për ushtrimin e përgjegjësi të tyre. Ky nen duhet të lexohet në vijim të nenit 5 të KDF (të drejtat dhe detyrimet e prindërve dhe familjes, zhvillimi i kapacitetit të fëmijës) dhe neneve 32 (2) dhe 27 (përgjegjësia e Shtetit në ndihmën ndaj prindërve për të siguruar se fëmijët kanë mbrojtjen dhe përkujdesjen edukur dhe standartet e përshtatshme për të jetuar.

11.1 Pyejta dhe paraqitja grafkore dhe tabelore

Kush kujdeset më shumë për ty?



E. 17. Kush kujdeset me shumë për ty?

	E.18. Kush kujdeset me shume per ty?	
	%	
bosh		1,92%
Mami		8,73%
Babi		2,07%
Te dy njelloj		87,28%
Total		100,00%

11.2 Konkluzione

Në lidhje me perceptimin e fëmijve se cili prind kujdeset më shumë për ta, mbështetur në rezultatet e mësipërme mund të pohohet se të dy prindërit kujdesen njëllë për fëmijët e tyre. Gjithësi mamaja duket se është personi i cili kujdeset më shumë në krahasim me babain.

12. Dhuna

Neni 19 - E drejta e fëmijës për t'u mbrojtur nga të gjitha llojet e dhunës

Shtetet Palë marrin të gjitha masat legislative, administrative, shoqërore dhe edukative për mbrojtjen e fëmijës nga cdo formë e dhunës fizike ose mendore, fyerja apo keqtrajtimi, braktisja apo mospërfillja....


Dhuna ndaj fëmijëve është një fenomen i lidhur dhe me shumë elementë të tjerë. Përgjegjësia e prindërve për t'u siguruar drejtimin e duhur fëmijëve të tyre (neni 5 i KDF) si dhe disiplinimi në shkollë, i cili duhet të bëhet në përputhje me dinjitetin e fëmijes dhe me KDF-në (neni 28 i KDF), duhet të dyja të kenë në qëndër të vëmendjes, mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës fizike apo mendore³. Për këtë arsye, ky studim do të fokusohet tek dhuna ndaj fëmijëve duke iu referuar përcaktimeve të sipërpërmendura të nenit 19 dhe duke e parë dhunën ndaj fëmijëve në këndvështrimin e aplikimit të KDF në shkollat dhe shtëpitë shqipëtare. Nisur nga fakti se në nenin e sipër përmendur të gjitha format e shfaqjes së dhunës janë konsideruar të ndaluara për t'u shfaqur si dhe duke marrë parasysh se të gjitha llojet e dhunës kanë efekte serioze negative për fëmijën kur bëhet viktimë e tyre, ky studim si format e dhunës psikologjike edhe ato të dhunës fizike i ka konsideruar si elementë të cilët duhet të analizohen brenda një kuadri. Kjo, sigurisht, edhe për faktin se qëllimi i studimit nuk është të evidentojë se si shfaqet dhuna dhe format e saj, por të kuptojë se sa prezente është ajo në jetën e përditshme të fëmijëve. Le të shohim në vijim përgjigjet e fëmijëve mbi përjetimet e tyre në lidhje me dhunën dhe informacionin që ata kanë për të.

³ Hodgink R & Nećell P., (1998) *Implementation Handbook for the Convention of the Rights of the Child*. Publikuar: në Neć York, UNICEF, f 493

12.1 Pyeja dhe paraqitja grafkore dhe tabelore


A të kanë goditur apo sharë ndonjëherë?

F.18 A të kanë goditur ose sharë ndonjëherë?



	F.20. A te kane goditur apo share ndonjehere?
	%
bosh	2,51%
Po	50,74%
Jo	46,75%
Total	100,00%

Nëse po, kush?




F.19. Nëse po, kush?


	F.21. Nese po, kush?
	%
Pa pergjigje	43,20%
Mesuesja/si	11,83%
Prinderit	15,38%
Moshataret	22,78%
Mesuesja dhe prinderit	6,80%
Total	100,00%

A ke kërkuar ndihmë në raste të tilla?

F.20 A ke kërkuar ndihmë në raste të tilla?




Nëse po, ku ke kërkuar ndihmë?



F.21 Nëse po, ku ke kërkuar ndihmë?

	F.22. Ku ke kërkuar ndihmë në raste të tilla?
	%
Asgjekundi	57,99%
Mësuesja	9,17%
Familja	20,12%
Shoqëria	4,59%
Qeveria e nxënësve	,30%
Familja dhe mësuesja	7,69%
Policia, ambulance, institucion shtetëror	15%
Total	100,00%


A mund të shkruash se çfarë kupton ti me fjalën dhunë?



F.21 A mund të shkruash se çfarë kupton ti me fjalën dhunë?

	F.19. A mund të shkruash se çfarë kupton ti me fjalën dhunë?
	%
bosh	7,69%
Informacion i plotë	27,51%
Informacion pjesërisht i plotë	43,49%
Informacion i pasaktë	21,30%
Total	100,00%

Nga e ke marrë informacionin për dhunën?



F.23 Nga e ke marrë informacionin për dhunën?

12.2 Konkluzione

Dhuna duket se është një fenomen i cili ndjejet prezent në jetën e përditshme të fëmijëve. Një përqindje e konsiderueshme e fëmijëve të të dyja grup-moshave janë përgjigjur se kanë qënë viktimë të dhunës. Tek fëmijët e grup-moshës 15-18 vjec, prindërit janë personat të cilët i dhunojnë më shumë fëmijët, më pas vinë moshatarët dhe më pas mësueset e shkollës. Ndërsa tek fëmijët e grup-moshës 10-14 vjec duket se ata të cilët ushtrojnë më shumë dhunë ndaj njëri-tjetrit më pas vinë bashkë-moshatarët e më pas familjarët dhe më pas mësueset.

Pjesa më e madhe e fëmijëve të anketuar janë përgjigjur se nuk kanë kërkuar ndihmë në rastet kur janë dhunuar (50.53%). Një faktor interesant i cili vëheret në rezultatet e mësipërme është se fëmijët të cilët kanë kërkuar ndihmë edhe pse ndjehen të dhunuar në një masë të madhe nga familjarët e tyre, përsëri janë këtyre të fundit të cilëve pjesa më e madhe e fëmijëve u kërkojnë ndihmë dhe pas tyre vinë mësueset.

Në lidhje me informacionin për dhunën, mund të pohohet se fëmijët e grup-moshës 15-18 vjec kanë informacion më të saktë se sa fëmijët e grup-moshës 10-14 vjec. Por duhet theksuar se një përqindje e konsiderueshme, 29.89% e fëmijëve kanë informacion të pjesshëm mbi këtë fenomen. Fëmijët e grup-moshës 10-14 janë jo të mirë informuar mbi dhunën dhe llojet dhe format e saj. Një përqindje jo e lartë 27.51% kanë informacion të plotë ndërsa 43.49% kanë informacion të pjesshëm për dhunën. Ajo çfarë vlen të theksohet nisur nga rëndësia dhe përhapja e fenomenit, është se një përqindje e konsiderueshme e kësaj grup-moshe, 21.30% kanë informacion të pasaktë për dhunën.

Për sa i përket mënyrës se nga është siguruar informacioni, mësuesja duket se është burimi kryesor, e më pas vinë prindërit.



13. Abuzimi me drogat

Neni 33 - Fëmijët dhe abuzimi me drogat

Shtete Palë marrin të gjitha masat e duhura, duke përfshirë ato legislative, administrative, shoqërore dhe edukative, për të mbrojtur fëmijët nga përdorimi i paligjshëm i drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope...

Një nga mënyrat më të mira për t'u mbrojtur nga drogat, sidomos tek fëmijët adoleshentë, është informimi i tyre mbi pasojat negative të substancave narkotike të ndaluara. Për këtë arsye, mbështetur në frymën e nenit të sipër cituar, ky studim u përqendrua tek fakti se sa informacion kanë fëmijët për drogat dhe nga e kanë marrë informacionin për to.

G.24. A ke ti informacion për drogat?



G.25 Nëse po, nga e ke marrë këtë informacion?

13.1 Konkluzione

Në lidhje me substancat narkotike të ndaluara, pjesa më e madhe e fëmijëve janë përgjigjur se kanë informacion për to. Burimi kryesor nga është siguruar informacioni është shkolla dhe më pas vinë emisionet televizive që ndiqen nga fëmijët. Vlen të theksohe fakti se vetëm një pjesë e vogël e fëmijëve janë shprehur se informacionin për drogat e kanë marrë në shtëpi.

14. Puna

Neni 32 - Puna e fëmijëve

Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për t'u mbrojtur nga shfrytëzimi ekonomik dhe nga kryejra e cdo pune që paraqet rreziqe ose që cënon edukimin e tij ose dëmton shëndetin apo zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral apo shoqëror.


Përfshirja e fëmijëve në punë është një fenomen i cili mund të dëmtojë seriozisht mirëqënien dhe të ardhmen e fëmijës. Në lidhje me këtë nen, studimi është fokusuar tek përqindja e fëmijëve të cilët punojnë, lloji i punëve që ata kryejn dhe gjithashtu tek fakti se nga janë shtyrë këta fëmijë që të përfshihen në punë.

14.1 Pyetja dhe paraqitja grafike dhe tabelore e tyre

A ke punuar ndonjëherë?


	G.23. A ke punuar ndonjëherë?
	%
bosh	3,85%
Per te fituar para	9,47%
Per te ndihmuar familjen	86,69%
Total	100,00%

H.26. A ke punuar ndonjëherë?




Nëse po, çfarë pune ke bërë ?

	G.24. Nese ke punuar, cfare pune ke bere?
	%
bosh	89,50%
Ndërtim ose pune krahu e rende	1,04%
Sherbime	6,36%
Shites	2,96%
5	,15%
Total	100,00%



H.27. Nëse po, çfarë pune ke bërë?

Kush të ka nxitur për të punuar?



H.28. Kush të ka nxitur për të punuar ?

	G.25. Kush të ka nxitur për të punuar në të ardhmen?
	%
Pa përgjigje	88,17%
Mami	,74%
Babi	,89%
Shoket	,44%
Vete	8,28%
Pjesetare te familjes / Vete	1,18%
Pjesetare te familjes / Shoket	,15%
Mesuesja	,15%
Total	100,00%

14.2 Konkluzione


Mbështetur në rezultatet e anketimit, pjesa më e madhe e fëmijëve të anketuar nuk kanë punuar, por duhet shprehur se një pjesë jo e pakonsiderueshme e fëmijëve janë përfshirë në punë. Pjesa më e madhe e fëmijëve të grup-moshës 15-18 vjeç ka kryer punë si kamarier, banakier apo ndihmës në punë bujqësie. Ndërsa pjesa më e madhe e fëmijëve të grup-moshës 10-14 vjeç kanë punuar për të ndihmuar familjen në punët e shtëpisë. Të dy grupet e fëmijëve në pjesën më të madhe të tyre, duket se janë përfshirë në punë të shtyrë nga dëshira e tyre. Por një fakt interesant është se një pjesë jo e pakonsiderueshme e fëmijëve, janë përfshirë në punë të shtyrë nga mamaja e tyre.

Shtojcë 1

Në këtë pjesë të studimit janë paraqitur rezultatet, të cilat burojnë nga kombinime të caktuara të gjetjeve të pyetësorit dhe të cilat përbëjnë interes për analizën dhe konkluzionet e raportit.


Përqindja e fëmijëve të cilët janë sharë dhe goditur dhe janë ankuar tek qeveria e nxënësve

	Perqindja e nxenesve qe jane goditur apo share dhe qe jane ankuar tek qeveria e nxenesve.
	%
Po	25,36%
Jo	74,64%
Total	100,00%




Përqindja e fëmijëve që janë goditur apo sharë, që janë ankuar tek qeveria e nxënësve dhe që kanë informacion se drejtorja e shkollës i ka marra parasysh kërkesat e tyre.

	Perqindja e nxenesve qe jane goditur apo share dhe qe jane ankuar, qe kane informacion se drejtorja e shkolles i ka marre parasysh kerkesat e tyre.
	%
Po	77,94%
Jo	22,06%
Total	100,00%




Përqindja e fëmijëve për të cilët kujdeset mamaja dhe janë përfshirë në punë



	Perqindja e femijeve per te cilet kujdeset me shume mamaja dhe qe kane punuar per te fituar para	
	%	
Po		6,78%
Jo		93,22%
Total		100,00%


Përqindja e fëmijëve për të cilët kujdeset babai dhe janë përfshirë në punë



	Perqindja e femijeve per te cilet kujdeset me shume babai dhe qe kane punuar per te fituar para	
	%	
Po		21,43%
Jo		78,57%
Total		100,00%


Përqindja e fëmijëve që janë sharë apo goditur në raport me gjininë

	Perqindja e femijeve sipas gjinise që janë sharë apo goditur në shtëpi ose shkollë
	%
Mashkull	50,36%
Femer	49,64%
Total	100,00%



Përqindja e fëmijëve të cilët nuk marrin pjesë në aktivitetet që organizon shkolla në raport me gjininë

	Perqindja e femijeve sipas gjinise që nuk marrin pjesë në aktivitete të organizuara nga shkolla
	%
Mashkull	47,71%
Femer	52,29%
Total	100,00%



ANEKSI II

Informacion nga strukturat kryesore publike dhe jo publike te perfshira ne garantimin e te drejtave te femijeve, Janar – Shkurt 2009. (Permbledhje instrumentash metodologjike)

Pjesa 1

Informacion permbledhes mbi Protokollet e Vleresimin te OJF-ve qe ofrojne sherbime me baze komunitare.

Pjesa 2

Informacion permbledhes mbi Protokollet e Vleresim praktik te situates ne Komisariatet e Policise.

Pjesa 3

Informacion permbledhes mbi Protokollet e Vleresimin praktik te vizites ne insitucione rezidenciale.

Pjesa 4

Informacion permbledhes mbi Protokollet e Vleresimit praktik te vizites ne qendren e kujdesit te shendetit paresor.

Pjesa 5

Informacion permbledhes mbi Protokollet per marrjen e informacionit dhe vleresimin e praktikave prane Drejtorive Arsimore Rajonale.

Pjesa 6

Informacion permbledhes mbi Protokollet e Vleresimit te praktikës se Administratorit Social

PJESA 1

Informacion permblledhes mbi Protokollet e Vleresimin te OJF-ve qe ofrojne sherbime me baze komunitare.

Realizuar: Tirane: “Sos Village”, Korce: “MEDPAK”; Kukes: “Qendra e Keshillimit te Grave dhe Sherbimet Sociale”, Lushnje: Qendra “Femijet Sot”; Shkoder: Shoqata “Refleksione; Mat: “Lulet e Molles”

	PO ose JO	PERSHKRIMI
Politika dhe legjislacioni		
Kane hartuar OJF politika, udhezime apo norma qe rregullojne veprimtarine e saj? (kerkoni t’l shihni dhe merrni nje kopje nese eshte e mundur)	PO	OJF-te mbeshteten ne parime dhe norma qe rregullojne veprimtarine e tyre dhe koordinimin dhe bashkepunim me OJF te tjera qe punojne per femijet. Dokumenti baze per keto OJF eshte Rregullorja e Brendshme e Qendres, megjithate ne disa OJF zbatohen rregulla te tjera. Psh. OJF-ja ne Tirane zbaton Kodin e etikes profesionale, Kodin e Sjelljes të CRCA/DCI, strategjine e CRCA/DCI Shqipri dokumenta të ruajtjes në konfidencialitetit, standarte dhe normat e CRCA/DCI Shqiperi, etj.
A mbulojne keto politika, udhezime apo norma per:		
- vleresimin per nevojat e femijes? Nese po, cfare parashikojne?	PO	Vleresimi i nevojave te femijes eshte pjese e punes te ketyre OJF-ve ne praktike, me qellim mbrojtjen e te drejtave te femijes si dhe zbatimimi i parimit te interesit me te larte te tyre. Gjithashtu pjese e punes eshte edhe ofrimi i sherbimeve rehabilituese per femijet si psh ne Elbasan ku behet rehabilitimi i femijeve me aftesi te kufizuar ose ne Lushnje ku qellim eshte rehabilitimin i femijeve rreth me femijet normal

- kriteret per ofrimin e sherbimit? Nese po, cfare parashikojne?	PO	Ne te gjitha OJF-te ka kriteret per ofrimin e sherbimeve. Korrektesia, cilesia e sherbimeve te ofruara si dhe plotesimi i standarteve te larta te sherbimit, respektimi i diversiteteve jane kriteret te pergjithshme ne ofrimin e sherbimeve nga keto OJF. Ne OJF-ne ne ELbasan kriteret jane te mbeshtetura ne Standartet e qendrave ditore te vendosura nga MPCSSHB. Shembull: Ne OJF-ne ne Shkoder punohet me femijet egjiptian te cileve u ofrohet kopesht per femije 3-6 vjec, shkolle 9 vjecare, nje trajtim me ushqim, aktivitete jashte shkollore, pajisje e femijeve me te gjitha materialet shkollore, si dhe nje ambjent shkollor me te gjitha mjetet e nevojshme.
- standardet per cilesine e ofrimit te sherbimit? Nese po, cfare thone?	PO	Ndone ne te gjitha OJF-te pranohet se ka standarte ne lidhje me cilesine e sherbimeve te ofruara, ato jo gjithmone citohen. Megjithate ne Tirane keto standarte jane ne dy nivele : te brendshme, te percaktuara nga Kushtetuta e Shqiperise dhe nderkombetare, te percaktuara nga KDF-ja. Ne Korce cilesia e sherbimit te ofruar kerkon monitorim te vazhdueshem te ketyre sherbimeve si dhe zgjedhje te stafit te specializuar
- protokollet per asistencen ndaj: - Femijeve viktimat te dhunes ne shtepi? - Femijeve viktimat te abuzimit seksual? - Femijeve viktimat te trafikimit? - Femijeve viktimat te braktisjes kronike? - Femijeve te rruges?	PO	Praktika mungon ne kete drejtim dhe ne asnje rast nuk pranohet se ka protokolle per asistencen ndaj femijeve te dhunuar, te abuzuar seksualisht etj pervec OjF-se ne Tirane ku, keto protokolle jane pjesë e dokumentacionit të programeve të CRCA/DCI Shqipëri dhe përfshihen: fëmijët viktimat të dhunës, viktimat të abuzimit seksual, viktimat të braktisjes kronike viktimat të braktisjes kronike, femijeve të rruges dhe çdo shqetësim tjetër të fëmijëve.

- rishikimin e nevojës së vazhdueshme për ofrimin e shërbimit? Nëse po, çfarë parashikojnë ato?	PO	Ne të gjitha OJF-te është praktike pune rishikimi i shërbimeve të ofruara, çka nënkupton: ndjekjen në vazhdimësi të fëmijëve, vlerësimin e tyre pas hershem, diagnostikimit, hartimit të Planeve Edukative Individuale dhe rishikimin e tyre. Në Shkoder dhe Kukës matës për këto qëllim shërbejnë intervistat e strukturuar dhe gjysem të strukturave të fëmijëve të trajtuar.
- Konsultimin me fëmijën apo familjen në lidhje me shërbimet? Nëse po, çfarë parashikojnë?	PO	Ne të gjitha OJF-te organizohen konsultime me fëmijën apo familjen e tij në lidhje me shërbimet të ofruara. Kështu psh në Korce prinderit janë të pranishëm gjatë hartimit të PEI (Plani Edukativ Individual), konsultave me specialistë të zhvillimit etj. E veçantë është praktika në OJF-ne të Tiranës ku pjesë e strukturës së CRCA/DCI Shqipëri është edhe Bordi i Fëmijëve dhe në fund të shërbimit bëhet vlerësimi i shërbimit nga fëmijët dhe familjet e tyre.
- Bashkëpunimin me ofrues të tjerë shërbimesh? Nëse po, çfarë parashikohet në këto aspekt?	PO	Pjesë e veprimtarisë së këtyre OJF-ve është edhe bashkëpunimi me ofrues të tjerë shërbimesh. Shembull mund të sjellim MEDPAK në Korce e cila ka bashkëpunuar me OJF të tjera si dhe me pushtetin lokal dhe DAR. Në Lushnjë rehabilitimi i fëmijëve në nevojë ka sjellë bashkëpunim me Zyren Arsimore të këtij rrethi.
- Procedurat për shqyrtimin e incidenteve të dhunës apo abuzimit të kryer nga stafi i OJF? Nëse po, çfarë parashikohet?	PO	Me përjashtim të OJF-se në Lushnjë dhe Kukës, në të gjitha OJF-te të tjera ka një procedurë për shqyrtimin e incidenteve të dhunës apo abuzimit të kryer nga stafi, e cila parashikohet në Kodin e Etikës. Në këto kod përcaktohen masat që duhet të merren në këto raste, të cilat variojnë nga masa disiplinore deri në largim nga detyra. Shembull në OJF-ne në Mat: Kur konstatojmë dhunë të ushtruar ndaj fëmijes jashtë mjediseve të qendres, marrim takim me familjen. Sipas rregullores së funksionimit të qendres, kur konstatohet dhunë në mjediset e qendres (deri me sot nuk ka ndodhur) me problemin merret koordinatori i qendres. Punonjësit e qendres janë trajnuar për trajtimin e fëmijëve.

A ekziston nje procedure: - ankimimi per perfituesit e sherbimeve? Nese po, per cfare jane ankuar me shumefemijet perfitues apo perfaqesuesit e tyre ligjore?	PO	OJF-te u njohin perfituesve te sherbimeve te drejten e ankimit edhe pse nuk ka patur raste te tilla ne praktike. Praktika qe ndiqet ne keto raste eshte e ndryshme psh: Ne Korce rezultatet e projektit apo sugjerimet per gjerat qe duhen permiresuar maten ne menyre te vazhdueshme permes pyetsoreve. Ne Mat jane vendosur 2 kuti te mbyllura ku femijet shprehen rreth problemeve qe kane te bejne me realizimin e programit apo trajtimin e tyre. Ne Kukës eshte vendosur nje kuti vlersim – ankimim ne qender dhe ne te shumten e rasteve femijet jane ankuar qe te dine me shume per te drejtat e tyre Ne Lushnje dhe ne Shkoder nuk ekziston nje procedure amkimimi per perfituesit e sherbimeve
- nje procedure disiplinore per stafin? Nese po, cfare permban kjo procedure?	PO	Ne te gjitha OJF-te ekziston nje procedure disiplinore per stafin, me perjashtim te OJF-se ne Mat. Megjithese kjo procedure nuk pershkruhet ne te gjitha rastet ajo permban masa disiplinore sipas rasteve te shkeljes se disiplines dhe parashikon deri largimin nga puna per punonjesin
- procedurat per shqyrtimin e situatave emergjente ku femija eshte ne rrezik imediat dhune, abuzimi apo trafikimi?	PO	Edhe pse te gjitha OJF-te pranojne se ka procedura per shqyrtimin e situatave emergjente ku femija eshte ne rrezik imediat dhune, abuzimi apo trafikimi, nuk pershkruhet se si realizohet ajo. Perjashtim ben Tirana ku keto procedura jane pjese e sherbimeve qe ofrohen nga programi i Linjes Kombetare te Telefonit te Femijeve ne Shqiperi. Ne Mat dhe Elbasan kjo procedure mungon

A po zbulon stafi incidente dhune, abuzimi apo trafikimi brenda një familjeje apo dicka tjetër, që duhet të raportohen tek: - Drejtori i OJF - Një autoritet tjetër kompetent?	PO	Ne Korce, Elbasan dhe në Mat pohohet se nuk ka patur dhe nuk janë zbuluar incidente dhune, abuzimi apo trafikimi, ndërsa në Tiranë, Lushnjë, Kukës dhe Shkodër, në rast se zbulohet një rast i tillë, procedura është që punonjësi të denoncojë këtë rast njëherë brenda organizatës dhe me pas në organizma të tjera kompetente.
Praktika		
Si i marrin OJF klientet për pranimin e shërbimit?		
A bazohen ndonjëherë OJF tek:		
- aktivitetet e veta të ndryshme/ përjasja proaktive (psh vizita në familje (jepni detaje në rast se po)	PO	OJF-të zhvillojnë aktivitete të ndryshme si psh vizitat në familje. Këto vizita përbejnë fokus të punës së tyre për të bërë familjarët e fëmijëve bashkëpunetorë në arritjen e objektivave si dhe për të vlerësuar më mirë nevojat dhe kushtet e zhvillimit të fëmijëve.
- Policia? (Jepni detaje në rast se ju referohen raste)	PO	Deri tani nuk ka patur raste. Përjashtim në Tiranë ku në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet CRCA/DCI Shqipëri dhe policisë së Shtetit janë referuar raste prej tyre.
- Shkollat? (Jepni detaje në rast se ju referohen raste)	PO	Të gjitha OJF-të dëshmojnë për një praktikë bashkëpunimi me shkollat me qëllim referimin e rasteve të abuzimit me fëmijet. Shembull është Tiranë e cila ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet CRCA/DCI Shqipëri dhe Drejtorisë Arsimore. Mbi bazën e kësaj marrëveshjeje janë referuar raste të abuzimeve në shkollë Në Kukës rezulton se nuk ka patur një praktikë të tillë
- Administratori social/punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve në bashki/komune? (Jepni detaje në rast se po)	PO	Po, pranohet se ka bashkëpunim të OJF-ve me administratorin social/ punonjësin e mbrojtjes së fëmijëve në bashki/komuna me qëllim raportimin e rasteve të abuzimit me fëmijet, pa treguar konkretisht se si realizohet ai. Shembull i mirë është Tiranë e cila ka një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet CRCA/DCI Shqipëri dhe bashkisë për referimin e rasteve të abuzimit të identifikuar nga ata Në Kukës rezulton se nuk ka patur një praktikë të tillë

- OJF te tjera? Jepni detaje ne rast se po)	PO	Po, ka bashkepunim ndermjet OJF-te te ndryshme. Shembuj ne kete drejtim jane: Tirana e cila ka nenshkruar marreveshje bashkepunimi ndermjet CRCA/DCI Shqiperi dhe OJF-te te tjera. Ne baze te kesaj marreveshjeje jane referuar raste ta abuzimeve me femijet. Ne Elbasan, bashkepunetore kane qene edhe OJF-te te tjera te cilet kane ne fokus femijet apo personat me AK dhe kane bere referim te ketyre rasteve.
- ndonje mekanizem tjeter koordnimi sic jane njesite per mbrojtjen e femijeve (CPU), komiteti I monitorimit te punes se femijeve apo komiteti rajonal I anittrafikimit?	JO	Nuk ka praktike ne kete drejtim. Perjashtim ben Korca qe citon bashkepunimet qe ajo ka me Drejtorite Arsimore Rajonale , bordet e prinderve te femijeve me aftesi te kufizuar, etj.
- nje tjeter linje? (Jepni detaje ne rast se po)	Jo	Pergjigja eshte negative
Cfare sherbimesh siguron OJF?		Sherbimet qe ofrojne OJF-te jane te ndryshme ne varesi te objektit qe ato kane. Keshtu psh: a) Ne OJF-ne e Tiranes sherbimet qe ofrohen jane: - keshillim psikosocial i femijeve ne burgun e Vaqarrit; - trajtim te rasteve femijeve ne burgun e Vaqarrit; - edukim formal dhe joformal femijeve ne burgun e Vaqarrit; - argetim femijeve ne burgun e Vaqarrit; - keshillim me telefon per femijet dhe familjaret e fmeijeve; - trajnim te institucioneve qeveritare dhe jo-qeveritare dhe femijeve per te drejtat e femijeve dhe cheshtje si; abuzimi i femijeve; b) Ne OJF-ne e Matit keto sherbime jane: - ushqim, edukim falas nepermjet veprimtarive qe realizohen, - Organizon aktivitetet me gra te shtresave te ndryshme , kryesisht per perkujdesjen ndaj femijeve.

Cilat jane qellimet e sherbimit te dhene?	Sherbimet e ofruara nga OJF-te ne baze komunitare synojne permiresimin e situates se te drejtave te femijeve ne Shqipëri nepermjet sherbimeve direkte me fëmijët dhe aktoreve qe punojne per te drejtat e femijeve. Megjithate ne varesi te objektit te tyre apo kategorise me te cilen ata merren, qellim mund te jete permiresimi i jeteses se femijeve/personave me aftesi te kufizuar permes trajnimeve dhe sensibilizimit te opinionit publik (rasti i Korces) apo integrimi i komunitetit rom me pjesen tjeter te shoqerise (rasti i Shkodres)	
Aty ku sherbimet perfshijne keshillim psikologjik apo sherbim psikol-social, cfare mekanizmesh te vecante ekzitojne per cilesine e kontrollit?	Ne lidhje me mekanizmat dhe format e monitorimit te sherbimeve te ofruara pergjigjet jane te ndryshme. Ne Korce, Mat, Kukes dhe Elbasan rezulton se keto mekanizma nuk ekzistojne. Ne Tirane dhe ne Shkoder jane marre masa ne kete drejtim. Shembull i mire eshte Shkodra pasi monitorimi eshte pjese e punes se koordinatorit te projektit, i cili kontakton direkt me femijet per te identifikuar dhe hetuar cilesine e sherbimit te ofruar nga i gjithe stafi i projektit, behen takime me prinderit dhe kujdestaret, takime te rregullta me mesuesit, drejtorine e shkolles, inspektoret e drejtorise arsimore etj	
A jane vleresuar nevojat e kujdesit per femijet ne fillim te sherbimeve?	PO	Nga informacioni i dhene rezulton se cdo OJF perpara se te filloje zbatimin e projekteve ben nje vleresim te situates dhe nevojave te target grupit per te orientuar nderhyrjen dhe punen ne vazhdim Perjashtim ben vetem OJF ne Lushnje e cila nuk ben nje vleresim paraprak te nevojave te femijes ne fillim te sherbimeve. Shembull mund te sjellim OJF ne Shkoder, e cila perpara fillimit te projektit ne vitin 2001 ka bere nje studim ne terren nga eshte konstatuar qe per 10 vjet ne lagjen "Liria" (1991 – 2001) nuk kishte shkolle, mqs banoret e pa strehe kishin zene ambientet e shkolles ekzistuese. Ky ishte nje problem i madhe pasi ne kete periudhe ishte krijuar nje kontigjent i madhe i femijeve analfabet.
A eshte perdorur vleresimi per te krijuar nje plan individual kujdesi per cdo femije ne praktike?	Po	Nga informacioni i marre rezulton se, ne cdo rast, eshte perdorur vleresimi per te krijuar nje plan individual kujdesi per cdo femije. Perjashtim ben Elbasani ku nuk permendet nje praktike e tille.

A jane te kuptueshem dhe te perditesuara regjistrimet e ruajtura ne lidhje me te gjitha sherbimet kujdesit duke perfshire dosje te detajuara per cdo femije?	Po	Nga praktika ne OJF rezulton se cdo femije ka dosjen e vet me vleresimet, planet edukative individuale dhe raportet perkatese mbi vezhgitet dhe sherbimet e tjera te ofruara.
A jane keto regjistrime te kompletuara, te perditesuara dhe te sigurta? <i>(Ju lutem kerkoni te shihni regjistrimet)</i>	PO	Regjistrimet jane te perditesuara dhe te kompletuara duke siguruar privatesine e femijeve. Ne disa raste si psh ne Elbasan dhe ne Kukes eshte krijuar edhe nje sistem arkive per kete qellim. I vetmi rast ku eshte marre asnje mase ne kete drejtim eshte Lushnja
A perfshijne regjistrimet e cdo femije: - daten e fillimit te marrjes se sherbimit dhe perfundimit te tij? - formen, permbajtjen dhe detajet e vendosjes se kujdesit dhe sherbimet e marra? - dokumentin perkates te identitetit dhe informacione te tjera personale? - planin individual te kujdesit per cdo femije? <i>(ju lutem kerkoni te ekzaminoni regjistrimet dhe nese eshte e mundur te merrni kopje. Nese jo, ju lutem plotesoni fushen e informacionit sebashku me nje vleresim per cilesine dhe qartesine e regjistrimit)</i>	Po	Rregjistrimet e cdo femije ne OJF permbajne informacion mbi daten e marrjes se sherbimit dhe llojet e sherbimeve te ofruara si dhe mbi planin individual te kujdesit. Shembull mund te sjellim Matin ku per cdo femije eshte krijuar nje fletoren regjistrimi. Qendra, per evidentim, mban nje liste ditore te paraqitjes se femijeve ne qender. Here pas here pershkruhet gjendjen sociale e psikomotore si dhe ndryshimet qe paraqesin femijet gjate frekuentimit. Ne Lushnje nuk ndiqet nje praktike e tille.
A operon OJF me nje "sistem manaxhimi te rastit"?	Po	Ne Korce, Tirane, Lushnje, Kukes dhe Shkoder operohet me nje sistem menaxhimi te rastit. Kjo nuk eshte praktike per Matin dhe Elbasanin.

A rishikohen periodikisht sherbimet e marra per nje femije?	Po	Sherbimet rishikohen ne menyre periodike per te vleresuar cfare eshte arritur dhe cfare jo Perjashtim ben Lushnja
Nese po, sa shpesh?	PO	Rishikimet behen periodikisht cdo 6 muaj ose nje vit. Ne raste te vecanta si psh ne Korce ato jane me te shpeshta, nje here ne 2 muaj apo ne Shkoder cdo jave, ne varesi te rastit
A konsultohen ne praktike regjistrimet kur kerkohet te behen vendimet e kujdesit apo vendosen rishikimet?	Po	Me perjashtim te Lushnjes, ne cdo OJF behen konsultime ne praktike te regjistrimeve kur kerkohet te behen vendimet e kujdesit apo vendosen rishikimet
A marrin pjese ne vendimet e kujdesit prinderit apo kujdestaret ligjore te femijeve? Nese po, ne c'menyre?	Po	Prinderit e femijeve ose kujdestaret ligjore te tyre jane pjese perberese e procesit vendimmarres ne lidhje me vendimet e kujdesit. Kjo realizohet ne te shumten e rasteve permes takimeve te here pas hereshme me prinderit, pyetjeve direkte dhe anketimeve. Ne OJF-ne ne Lushnje nje bashkepunim i tille paraqet veshtiresi.
A referon OJF ndonjehere femije per t'u pranuar ne kujdesin rezidencial?	Po	Ne OJF-ne ne Tirane dhe ne Lushnje pranohet se ka raste te referimit te femijeve per t'u pranuar ne kujdesin rezidencial, ndersa ne Shkoder, Mat dhe Elbasan nuk njihet si praktike. Shembull I mire ne kete drejtimeshte Kukesi ku femijet dergohen ne qendren kombetare ne Luize dhe ne qendren "Vatra"Vlore
Nese po, kujt duhet t'i referojne ata?	- sherbimet social; shtepise se fmeijse ose te foshnjes si dhe OJF-ve qe oforjne sherbime rezidenciale si Fshatrat e Femijeve SOS apo shellterin	Psh. ne Tirane ku ka njihet si praktike: sherbimit social, shtepise se femijes ose te foshnjes si dhe OJF-ve qe ofrojne sherbime rezidenciale si Fshatrat e Femijeve SOS apo shellterin.

Sipas cilave rrethanave mund ta bejne ata nje referim te tille?	Sipas nevoja immediate te femijes	Referime te tilla mund te behen vetem ne raste kur kushtet nuk e lejojne mbajtjen e tyre ne qendra komunitare
A i dergon OJF ndonjehere raste tek:		
- policia? (Jepni detaje nese po)	PO	Nuk ka patur raste te tilla ne praktike Perjashtim ben Kukesi
- qendrat rezidenciale? (Jepni detaje nese po)	Po	Teorikisht pranohet si mundesi por nuk ka asnje rast ne praktike
- administratori social? (Jepni detaje nese po)		Mat, Elbasan- Jo Tirane, Korce, Shkoder, Kukesi - Po, por nuk jepen detaje
- ndonje organizem koordinimi sic eshte CPU? (Jepni detaje nese po)		Pergjigja eshte negative ne te gjitha rastet Perjashtim ben Kukesi ku jane nenshkruar marreveshje dhe plane pune te perbashketa, ku rolet jane percaktuar mes aktoreve
- ndonje tjeter? (Jepni detaje nese po)	JO	Pergjigja eshte negative ne te gjitha rastet
Cfare veprimesh duhet te marre OJF ne rast se perballet me nje situatë emergjence (psh femija eshte ne rrezik imediat dhune apo abuzimi)?	-vlereson nevojat emergjente te fmeijes, referon rastin ne polici si hde ofron sherbimin e nevojshem sipas vleresimit	Praktike e perbashket ne rastet e emergjences eshte vleresimi i nevojave emergjente te femijes, referimi ne polici i rastit si dhe ofrimi i sherbimeve te nevojshme.

Cfare kualifikimesh duhet te kete stafi?	- arsim te larte sipas profileve te kerkuara ne pozicion; - nivel master, doktrature - trajnime ne fushe dhe kualifikime te tjera ne fushe	Stafi prane OJF-ve qe ofrojne sherbime ne baze komunitare duhet te kete aresim te larte sipas profileve te kerkuara ne pozicion, trajnimi ne fushe si dhe kualifikime te tjera.
Cfare kontrollesh behen ne background-in e stafit para se te rekrutohen/merren ne pune?	- kalimi ne disa faza perzgjedhese si dhe verifikime te dokumentacionit te dhene;	Individi aplikant duhet te kete arsimin perkates sipas pozicionit, te kete trajnimet dhe kualifikimet e duhura dhe aftesi humane per te punuar me femijet. Ai l nenshtrohet nje faze perzgjedhese, intervistimi dhe verifikimi te dokumentacionit
A ka OJF nje strategji per qendrueshmerine e sherbimeve ne terma afatgjate?	Po	Pergjigja eshte pozitive me perjashtim te Lushnjes. Shembuj jane Shkodra dhe Tirana qe veprojne mbi bazen e ketyre strategjive, e para mbeshtetet ne nje strategji te hartuar per vitet 2007 – 2012, ndersa e dyta ne Strategjine e CRCA/DCI Shqiperi 2005- 2010
Qendrimet		
A eshte trajnuar stafi ne:		
- vleresimin dhe aftesite e planifikimit te kujdesit?	- PO	Ne Tirane, Elbasan, Shkoder, Kukes dhe ne Mat jane bere trajnime te stafit ne lidhje me vleresimin dhe aftesine e planifikimit te kujdesit, ne ndryshim nga Lushnja dhe Korca
- mbajtjen e regjistrimeve?	- PO	PO, ka patur trajnime te stafit ne lidhje me mbajtjen e regjistrimeve dhe ne disa raste si psh ne Elbasan trajnimet jane ofruar nga CISP. Vetem ne Lushnje jo
- identifikimin dhe punen me femijet e dhunuar, abuzuar, trafikuar?	-PO	Stafi l OJF-ve eshte trajnuar ne lidhje me identifikim dhe punen me femijet e dhunuar, abuzuar apo te trafikuar. Kjo rezulton nga pergjigjet e dhena ne Tirane, Elbasan (keto trajnime jane ofruar nga CIPS), dhe Shkoder. Keto trajnime kane qene te pjesshme ne Mat ose mungojne si psh ne rastin e Korces.
- kuptimin e te drejtave te femijeve dhe standardeve minimale per sherbimet sociale?	-Po	Stafi l OJF-ve ne Tirane, Elbasan, Korca, Mat, Kukes dhe Lushnje jane trajnuar ne lidhje me kuptimin e te drejtave te femijeve dhe standardeve minimale per sherbimet sociale.

- si te veprojne me ankimet?		Stafi I OJF-ve ne Tirane, Elbasan, Korce, Mat, Kukes dhe Lushnje jane trajnuar ne lidhje procedurat e ankimit.
Ka njohuri stafi i OJF:		
- mbi ekzistencen dhe permbajtjen e rregullave, politikave, standardeve, apo protokolleve qe rregullojne dhenien e sherbimeve nga nje OJF?	-PO	Nga informacioni i marre rezulton se stafi i OJF-se ka njohuri mbi ekzistencen dhe permbajtjen e rregullave, politikave, standardeve, apo protokolleve qe rregullojne dhenien e sherbimeve nga nje OJF. Psh ne ne Elbasan anetaret e stafit jane ne dijeni te standarteve te vendosura nga MPCSSHB
- mbi parashikimet e K.F per kujdestarine, biresimin dhe braktisjen?	-PO	Ne Tirane, Kukes dhe Shkoder stafi eshte i njohur me parashikimet e K.F per kujdestarine, biresimin dhe braktisjen, ne ndryshim nga Korca, Lushnja dhe Elbasani ku pergjigja eshte negative.
- mbi parashikimet e K.P per dhunen, abuzimin, trafikimin?	-PO	Ne disa OJF si psh ne Tirane, Shkoder, Kukes dhe Korce stafi ka njohuri ne lidhje me parashikimet e K.P per dhunen, abuzimin, trafikimin. Ne Mat njohurite e stafit jane te pjesshme, ndersa ne Lushnje dhe Elbasan stafi nuk eshte i njohur fare me to
Monitorimi dhe raportimi		
Cfare rregullimesh ne ligjin kombetar merr ne konsiderate OJF si te detyrueshme per te?		Disa OJF si psh Elbasani dhe Mati nuk shprehen ne lidhje me ligjet e detyrueshme per to. Megjithate ne varesi te objektit te tyre apo te target grupit qe trajtojne ne disa OJF si psh ne Korce merr rendesi njohja e kuadrit ligjor te personave me aftesise se kufizuara. Ne te gjitha rastet baze eshte Ligji per funksionimin e OJF-ve,
Kur eshte regjistruar OJF ne Sh.S.Sh dhe eshte kontrolluar OJF nga inspektoret e Sh.S.Sh para se te regjistrohet?	-PO	Nga informacioni i marre rezulton se eshte praktike e zakonshme per OJF-te kontrolli paraprak nga inspektoret e SH.S.SH-se dhe me pas regjistrimi i tyre. Disa shembuj: OJF ne Korce eshte rilicensuar me Nr e licenses 2161 date 21.11.2007 OJF ne Lushnje eshte regjistruar ne gjykatën e lushnjes ne vitin 2001 OJF ne Elbasan eshte regjistruar ne gjykatën e elbasanit ne vitin 2001 etj

Kur e kanë bërë inspektorët e Sh.S.Sh vizitën e fundit? Ishte e parashikuar apo jo?	JO	SHEMBUJ Tiranë- E parashikuar Korçë- Ishte lajmëruar nga Sherbimi Social Rajonal Shkoder- Para 6 muajsh Elbasan- Nëntor 2008, e parashikuar
Ka aktualisht OJF ndonjë kërkesë për raportim në drejtorinë e inspektoratit të Sh.S.Sh? Nëse po, cilat janë?	-JO	Me përjashtim të OJF-se në Mat në asnjë rreth tjetër nuk ka aktualisht ndonjë kërkesë për raportim në drejtorinë e inspektoratit të Sh.S.Sh
Cilat janë burimet kryesore të fondeve të OJF dhe cilat janë kërkesat për raportim tek donatorët?	- UNICEF Zyra Shqiptare - DCI International - Ambasada e Hollandezëve - Olof Plame International	SHEMBUJ Tiranë: UNICEF Zyra Shqiptare , DCI International, Ambasada e Hollandezëve, Olof Plame International. Raportimi bëhet në varësi të formave të donatorëve Lushnjë: Soros dhe Bashkia Shkoder: ICCO, UNIFEM. Raportimet bëhen çdo 6 muaj dhe bazohen në formate që ato kërkojnë në momentin kur firmoset kontrata. Mat:SGF Zvicër.Raportim periodik, çdo 3 muaj si dhe raportim 1 vjeçar Elbasan: MPCSSHB, donatorët, bashkia

A i raporton OJF rastet e regjistrimit tek: - Ndonje drejtor/shef zyre? - Ndonje strukture qeverisëse sic është Bashkia apo Sh.S.Sh? - Ndonje audit i jashtëm apo donator?	Bordi Drejtues	Nga informacioni i marre rezulton se pergjithesisht ka nje praktike raportimi te OJF-ve ne struktura te tjera si psh bashkia apo donatoret. Ne praktike do te permendim sa me poshte: Ne Tirane raportimi behet tek Bordi Drejtues i OJF-se Ne Korce raportimi behet tek zyra e sherbimit social ne bashki Ne Mat raportimi behet tek donatori,SGF Sviscer Ne Elbasan raportimi behet tek Drejtori I Sektorit te Programimit Social , Bashkia Elbsan nga e cila eshte edhe varesi Ne Lushnje dhe Shkoder nuk ka asnje sqarim ne lidhje me kete pike.
A është stafi i OJF subjekt i rishikimit dhe vleresimit periodik ne rolin te tij?	-PO	Po,stafi i OJF eshte subjekt i rishikimit dhe vleresimit periodik ne rolin te tij
Merret parasysh aftesia e stafit ne nje proces monitorimi/rishikimi?	-PO	Stafi i OJF-ve eshte subjekt i nje procesi monitorimi/ rishikimi te vazhdueshem persa kohe qe OJF-te punojne ne baze projektesh. Kjo ben qe edhe stafi i saj te zgjidhet bazuar ne objektivat e projektit dhe te rishikohet sa here qe ndryshojne objektivat e tij

PJESA 2

Informacion permbledhes mbi Protokollet e Vleresim praktik te situates ne Komisaritet e Policise

Realizuar në Tiranë, Durrës, Korçë, Kukës, Shkodër, Lushnjë, Dibër, Elbasan.

	PO ose JO	PERSHKRIMI
Politika dhe legjislacioni		
I. Femijet viktim/deshmitare		
A ka policia politika, standarde, apo protokolle per te ndihmuar femijet viktim dhe deshmitare me te cilet ajo ka kontakt?	PO	Nga informacioni i marre rezulton se Policia e Shtetit ne aktivitetin e saj me femijet viktim dhe deshmitare bazohet kryesisht ne Strategjine kombetare per femijet viktim te abuzimit apo ne parimet e pergjithshme te KDF. Ne shume raste gjen zbatim legjislacioni procedural ne te cilin perfshihen femijet nen 18 vjec. Referim i behet edhe Ligjit te dhunes ne familje, Ligjit per mbrojtjen e te drejtave te te miturve apo Kodit i familjes etj.
Nese po, a permbajne keto protokolle rregulla specifike per:		
- femijet viktim te abuzimit seksual?		Nga informacioni i mbledhur ne komisaritet e policise rezulton se nuk ka protokolle dhe per rrjedhim as rregulla specifike per trajtimin e femijeve viktim te abuzimit seksual. Praktika ne komisaritetin e policise eshte e diversifikuar ne kete drejtim pasi, psh ne komisaritetin e Shkodres zbatohet Strategjia kombetare per viktim te abuzimit, ndersa ne rrethet tjera veprimtaria e tyre bazohet kryesisht ne legjislacion. Ne cdo rast femijet viktim te abuzimit seksual marrin trajtim te menjehershme mjeksor e psikologjik.
- femijet viktim te trafikimit?		Veprimtaria e komisariteve te policise ne lidhje me kete kategori bazohet vetem ne legjislacion pa bere referime te vecanta.
- femijet viktim te dhunes?		Nuk ka informacion.

A perfshijne keto protokolle:		
- rregulla per intervistat me karakter sensitiv per femijet?	PO	Ndonese pergjigja eshte pozitive nuk behet asnje referim specifik. Ne keto raste aplikohen rregulla te pergjithshme si psh vendosja e femijes në një ambient të përshtatshëm per intervistim, apo prania gjate intervistes e nje psikologu ose nje personi qe deshiron femija.
- nderhyrjen ne jeten private ne menyren minimale te mundshme?	Po	Nderhyrja ne jeten private ne menyren minimale te mundshme eshte nje rregull qe respektohet ne te gjitha komisaritet e policise, me qellim qe te miturit te mos ndihen te e dhunuar ne privatesine tyre.
- nje kerkese per rregullimin e pershtatshem te rastit?	Po	Nga informacioni i marre rezulton se trajtimi i femijeve viktime te dhunes apo abuzimit parashikon rregullimin dhe sistemimin e pershtatshem te tyre duke pasur parasysh karakteristikat e vecanta te rastit. Komisariati i policise ne Durres ka bashkepunuar me qendrat rezidenciale te Linzes dhe Vlores per nje sistemim sa me te mire te femijes duke i ofruar atij sherbimet per te cilat ka nevoje.
- nje kerkese per referim tek sherbimet sociale apo te suportit aty ku eshte e nevojshme?	Po	Ne te gjitha komisaritet e policise eshte praktike percjellja zyrtarisht e kerkeses tek sherbimet sociale per te marre suportin e nevojshem ne trajtimin e femijes viktime e dhunes. Ne disa raste kerkesa dergohet pasi eshte marre paraprakisht pelqimi I vet femijes.
- rregullat per mbrojtjen e jetes private te femijes?	Po	Ndonese nuk ka protokolle qe te percaktojne ne menyre specifike rregullat per mbrojtjen e jetes private te femijes, praktika e komisariateve te policise e unifikuar ne lidhje me kete ceshtje. Ne cdo rast merren masa per mbrojtjen e jetes private te femijes, bazuar ne strategjite kombetare per femijet apo ne konveten per te drejtat e femijeve etj.
- rregullat per mbrojtjen e viktimave/deshmitareve aty ku femija ka me shume mundesi te lendohet, perfshire edhe rastin kur kthimi i femijes ne shtepi nuk eshte i sigurte?	Po	Veprimtaria e policise se komisariateve per mbrojtjen e viktimave/deshmitareve aty ku femija ka me shume mundesi te lendohet, perfshire edhe rastin kur kthimi i femijes ne shtepi nuk eshte i sigurte, bazohet ne rregulla qe kerkojne dergimin dhe strehimin e femijeve, ne rast nevoje ne qendra te percaktuara. Psh ne Durres eshte praktike shoqerimi I femijeve prane qendrave rezidencale ne Tirane, per t’l ofruar atyre kujdesin dhe ndihmen per te cilen kane nevoje. Ne raste te tjera si psh ne Lushnje nje praktike e tille nuk eshte gjithmone e lehte per shkak te kushteve dhe infrastructures jo te mire.

II. Femijet ne konflikt me ligjin		
A ka policia standarde, apo protokolle te cilat garantojne ne praktike respektimin e te drejtave proceduriale te femijeve te akuzuar per nje vepr penale? Nese po cilat jane keto?	Po	Respektimi i te drejtave proceduriale te femijeve te akuzuar per nje veper penale njihet si detyrim ligjor nga te gjitha komisaritet e policise ne rrethe. Ndonese jo te gjitha citojne se cilat jane burimet per kete detyrim ligjor, Kodi i Procedures Penale, Kodi Civil shebejne si baze per percaktimin e standarteve qe duhen respektuar me qellim garantimin e te drejtat te femijeve. Krahas sa me siper, ne baze te ligjit “Per mbrojtjen e femijeve apo viktimave te dhunes ne familje”, percaktohet se femija duhet te jete ne shoqerine e nje te rrituri per zhvelimin e ketyre procedurave ose te nje personi te besuar.
A mund te pershkruani rregulloren ne lidhje me dokumentimin e veprimeve te kryera nga policia me nje te mitur te dyshuar apo te akuzuar?		Veprimtaria e policise ne kete drejtim eshte e unifikuar ne te gjitha rrethet, rregullat proceduriale qe zbatohen jane te njejta. Keshtu nese nje i mitur ka kryer veper penale bëhet shoqërimi i tij në prani të prindit, psikologut a kujdestarit ligjor, ndërsa nëse kapet në flagrancë duke kryer një vepër penale fëmija shoqërohet në polici nga patrulla dhe paralelisht njoftohet familja për rastin. I mituri i shoqëruar vendoset në një zyrë të veçantë dhe pritët ardhja e psikologut që të merret në pyetje
Si rregullohet veprimtaria e organit te prokurorise ne lidhje me bashkepunimin me organet e policise ? Mund te na e ilustroni me nje rast konkret?		Ne te gjitha rastet bashkepunimi i organit te prokurorise me organet e policise eshte ne formen e komunikimit verbal. Ne momentin e pare, kur policia merr dijeni per rastin e dyshuar per krim, lajmeron prokurorin e gatshem, i cili sjell psikologun qe do te asistojë gjate procesit te marrjes ne pyetje te femijes. Shembull ne komisariatin e Lushnjes: Para tre ditesh kemi arrestuar dy te mitur per vjedhje dhe arme mbajtje pa leje. Ky ishte nje rast i perseritur. Keto vepra penale fillohen nga ne por eshte nje sektor i te miturve ne rrethin vlore. Ne si polici kryejme veprimet e para proceduriale, ku mund te perfshihet dhe ndalimi ose arrestimi ne flagrante. Pastaj per hetime te metejshme i kalon per hetim prokurorise. Kur eshte me mase sigurimi, materialet vene ne prokurori dhe pastaj ne gjykate. Pas shpalljes se gjykates, ato ia dergon seksonit per te mitur ne prokurorine e Vlores.

Cilat jane verpimet konkrete qe eshte e detyruar te kryeje policia ne baze te ligjit ne rast se ndalon nje te mitur te dyshuar apo te akuzuar?		Nga informacioni i mbledhur ne komisariatet e policise mbi veprimet qe kryen policia ne rast se ndalon nje te mitur te dyshuar apo te akuzuar jane: - venia ne dijeni e prokurorit te gatshem - marrja ne pyetje e femijes ne prani te prinderve dhe te psikologut Prokurori vendos nese femija do te ndalohej dhe me pas behet shoqerimi i te miturit ne ambientet e paraburgimit,vecant nga te paraburgosurit e tjere. I mituri nuk mund te ndalohej nese nuk ka mbushur moshen per pergjegjesi ligjore (14 vjec).
Praktike		
I. Femijet Viktima/Deshmitare		
A merren ne praktike masa per:		
- garantimin qe femija viktime/deshmitar te trajtohet ne nje menyre te kujdesshme dhe te dhembshur, duke pasur parasysh situaten e tij personale?	PO	Ne te gjitha rrethet pohohet se merren masa per garantimin qe femija viktime/deshmitar te trajtohet ne nje menyre te kujdesshme dhe te dhembshur, duke pasur parasysh situaten e tij personale, por nuk percaktohen konkretisht se cilat jane ato. Vetem ne komisariatin e Lushnjes nuk merre masa konkrete per kete qellim
- llogaritjen e nevojave te vecanta per femijeve viktime te abuzimit seksual apo trafikimit (psh intervistojne oficeret femra vajzat viktime?)	Po, pjesërisht	Te gjitha rrethet pohojne marrjen e masave praktike ne llogaritjen e nevojave te vecanta te femijeve viktime te abuzimit seksual apo trafikimit. Ne fakt, jane kryesisht oficeret dhe agjente femra qe merren me intervistimin e te miturve dhe ne vecanti te femrave te trafikuar. Kur shihet e nevojshme, intervistimi behet ne prani edhe te psikologut
- garantimin se nderhyrja ne jeten private te femijes do te jete minimalja e mundshme (psh sa here ne dite mund te merret ne pyetje nje femije)?	Po	Po, merren masa per te garantuar nje nderhyrje minimale ne jeten private te femijes. Per kete arsye femija intervistohet vetem nje here ne dite, ne prani te prindit ose te psikologut. Ne cdo rast duhet te krijohet nje ambient i pershtatshem per te realizuar intervistimin. Femija mund te ripyetet me vendim te prokurorit, vetem kur lind nevoja gjate hetimit.

- vleresimin e nevojave të femijes viktime/deshmitar për:		
- Mbrojtje të menjehershme nga dëmtimi i metejshëm;	Po	Nga informacioni i marre rezulton se në të gjitha komisaritet e policisë merren masa për mbrojtjen e fëmijëve viktime apo deshmitar. Në këto kuader, merren masa për të njoftuar Seksionin e Mbrojtjes së Dëshmitarëve në Policinë e Shtetit ose, duke u bazuar në rrethanat konkrete, i kërkohej gjykatës leshimi i urdherit të menjehershëm të mbrojtjes me qëllim marrjen e personit në mbrojtje nga policia.
- Shërbime shëndetësore, psikologjike, sociale apo të llojeve të tjera;	Po	Përgjigja, në lidhje me marrjen e masave, është pozitive e megjithatë nuk përcaktohet se çfarë bëhet konkretisht në këto raste. Në komisaritin e policisë në Durrës psh merren masa për dërgimin e fëmijes për kontroll mjekësor apo për ndihmë në Qendrën e Grave dhe Vajzave në Durrës. Me pas bëhet njoftimi në bashki me qëllim që kjo e fundit të nderhyjë me punonjësit social.
- garantimin e jetës private të fëmijëve (psh. mund të regjistrohet dhe perdoret në gjykatë dëshmia e fëmijes) ?	Po	Po, merren masat për të garantuar jetën private të fëmijes. Psh, mund të regjistrohet dhe perdoret në gjykatë dëshmia e fëmijes pa qenë e nevojshme prania e tij në sallën e gjyqit.
Çfarë ndihme merr femija viktime/deshmitar në praktike:		
- ligjore?	Po	Në rastet kur femija është në pamundësi ekonomike, i caktohet një avokat nga shteti për t'i garantuar asistencën e nevojshme ligjore.
- psikologjike?	Po	Fëmijes i ofrohet ndihmë psikologjike nepermjet asistencës së punonjësit social apo psikologut
- shëndetësore?	Po	Në të gjitha komisaritet merren masa për dënimin e ndihmes shëndetësore nga mjeku i komisaritetit apo dërgimit të fëmijes në spitalin rajonal
- financiare?	Jo	Fëmijëve viktime/deshmitarë nuk u garantohej ndihmë financiare pasi ka mungesë fondesh dhe këto nuk janë të përfshira në aktet normative. Përfundimisht vetëm komisariti i Kukësit që parashikon dënimin e ndihmes financiare pa cituar burimin e tyre.

A ka mundesi femija ne kontakt me policine te ankohet per trajtimin qe i behet nga policia? Nese po, cila eshte procedura?	Po	Femija gezon te drejten e ankimit ne lidhje me trajtimin qe i behet nga policia. Per kete aresye ne momentin qe merret ne pyetje i behen me dije te drejtat qe atij i takojne, perfshire edhe te drejten per ankim. Ankesa behet nepermjet avokatit, prindit ose psikologut dhe mund t'i drejtohet titullarit te policise, prokurorit ose Avokatit te Popullit.
A merren masa ne praktike per te vleresuar nevojat e femijeve te arrestuar nen moshen e pergjegjesise penale apo te femijeve te rruges?	Po	Ndonese pranohet marrja e masave per vleresimin e nevojave te femijeve te arrestuar nen moshen e pergjegjesise penale apo te femijeve te rruges, nuk percaktohet konkretisht se cilat jane ato. Informacioni nuk eshte i qarte.
A dergohen keta femije ne sherbimet sociale perkatese (psh ne qendra kujdesi rezidencial apo kerkohen familjet e femijeve te rruges)?		Pavaresisht se ne te gjitha komisaritet e rretheve, pervec komisaritetit te Kukesis, parashikohet mundesia qe femijet te dergohen ne qendra kujdesi rezidenciale, ne praktike kjo eshte e veshtire. Femija nuk mund te vendoset ne nje qendre kujdesi nese ai nuk eshte deklaruar i braktisur dhe per kete aresye ne shume raste lind nevoja te kerkohen familjarët.?????

Cilat janë masat që ka ndermarre policia pas miratimit të ligjit “Per masa ndaj dhunes ne marredheniet familjare”		Ne komisariatin e policise ne Durres: Është hapur një rregjistër i veçantë për telefonatat denoncuese pranë sallës operative, ndërkaq ekziston dhe rregjistri tjetër pranë oficerit të policisë. E dhunuara intervistohet, plotësohet kërkesë padia e saj për leshimin e “Urdherit të Menjehershëm të Mbrojtjes” bazuar në ligjin Nr.9669, dt.18.12.06 dhe materialet i kalojnë drejtëpërdrejtë Gjykatës ku bëhet séance në prani të dy palëve. Zbatimin e vendimit të ben përmbartuesi dhe në rast se vendimi shkelet, bazuar në nenin 320 të KP nis proçedimi penal ndaj dhunuesit. Ne komisariatin e policise ne Korce: Eshte krijuar nje seksion i vecante per dhunen ne familje i drejtuar nga Oficeri i Policise Gjyqesore Ne komisariatin e policise ne Kukes : Ne baze te ligjit “Per masa ndaj dhunes ne marredheniet familjare” policia ben zbatimin e Urdherit te mbrojtjes ose Urdherit te menjehershem te mbrojtjes, te leshuar nga gjykata Ne komisariatin e policise ne Lushnje: Ne kuader te njohjes se ligjit “Per masa ndaj dhunes ne marredheniet familjare” eshte organizuar nje trajnim tre ditor me te gjithë efektivat e policise te Komisaritet Lushnje. Ne komisariatin e policise ne Shkoder: Eshte krijuar nje seksion i vecante per dhunen ne familje. Nje hap konkret ka te beje me plotesimit nje kerkese padie per urdher te menjehershem te mbrojtjes qe i referohet gjykates se rrethit Shkoder Ne komisariatin e policise ne Diber: Ne kuader te njohjes se ligjit “Per masa ndaj dhunes ne marredheniet familjare” jane organizuar trajnime me te gjithë efektivat e policise te Komisaritet Diber.
Cilat janë veprimet që ndermerr policia për të realizuar mbrojtjen e viktimave të dhunes (nenes, femijes)?		Veprimet që ndermerr policia për të realizuar mbrojtjen e viktimave të dhunes kanë të bëjnë me shoqërimin e dhunuesit dhe monitorimin e vazhdueshëm të gjendjes. Në raste ekstreme punonjësit e policisë plotësojnë formularët përkatës dhe ia dergojnë gjykatës, e cila leshon urdherin e mbrojtjes ose të menjehershëm të mbrojtjes.

Sa raste të dhunës në familje me subject direct ose indirect femijet janë raportuar deri tani në Komisarlatin tuaj?	Statistika është për të gjithë qarkun e Durrësit	Ne qarkun e Durrësit janë raportuar: 1-rast me të mitur direkt subject dhune dhe 99-raste denoncimesh të dhunës në familje gjatë 2008-s + dy raste vrasjesh të grave nga bashkëshortët (një në Durrës dhe një në Krujë) Ne rrethin e Korçes denoncohen rreth 4-5 raste në ditë dhe mbi 300 raste në vit Ne komisarlatin e Kukësit janë denoncuar gjithsej 2-raste Ne komisarlatin e Shkodrës, për një periudhë tre muajore është denoncuar vetëm 1-rast në lidhje me një deshmi nga tre femije të një qendre rezidenciale Ne komisarlatin e Dibres dhe Gjirokastrës nuk është denoncuar asnjë rast dhune.
A ka vend për permiresim të praktikës në lidhje me zbatimin e rregullimeve ligjore për mbrojtjen nga dhuna në familje? Cfare do të donit jut e sygjeroni në lidhje me këto?	Po	Me qëllim permiresimin e praktikës për zbatimin e rregullimeve ligjore për mbrojtjen nga dhuna në familje sugjerohet: 1. përfshirja në Kodin Penal të këtij fenomeni me qëllim minimizimin e tij. 2. ngritja e seksioneve të vecanta në gjykate për këto vepra penale. 3. krijimi i një kartoteke për identifikimin e personave dhunues dhe ato të dhunuar. 4. krijimi i urave të bashkëpunimit mes pushtetit qendror dhe atij vendor me qëllim identifikimin e institucioneve përgjegjëse për zbatimin e rregullimeve ligjore për mbrojtjen nga dhuna në familje. 5. koordinim i punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse dhe ndihmese me detyra të specifikuar për dhenien e ndihmës së nevojshme viktimave të dhunës.

II. Fëmijet ne konflikt me ligjin		
A mund te pershkruani rrugen duke treguar me detaje se si vepron policia ne rastin kur ndalon nje te mitur sit e dyshuar per kryerjen e nje vepre penale?		Procedura qe ndjek policia ne te gjitha rrethet, ne rastet kur ndalon nje te mitur eshte e njejte si me poshte: Bëhet shoqërimi i fëmijës në prani të prindit, psikologut a kujdestarit ligjor, ndërsa nëse kapet në flagrancë duke kryer një vepër penale fëmija shoqërohet në polici nga patrulla dhe paralelisht njoftohet familja për rastin. I mituri i shoqëruar vendoset në një zyrë të veçantë dhe pritët ardhja e psikologut që të merret në pyetje.
A lejohet te hyje ne ambientet e policise avokati mbrojtës? Mund te me tregoni proceduren ne kete rast?	Po	Ne baze te ligjit nr. 9669, dt 18. 12. 2006 "Mbi mbrojtjen e te miturve"percaktohet se intervistimi i femijes behet ne pranine e psikologut, kujdestarit apo avokatit te tij. Ky eshte nje detyrim ligjor qe respektohet nga te gjitha komisaritet e policise kur ndalon nje te mitur si te dyshuar per kryerjen e nje vepre penale.
Si e realizoni njoftimin e prinderve te te miturit dhe sa kohe zgjat nga momenti i ndalimit te te miturit deri sa njoftohen prinderit/familjaret?		Nga informacioni i mbledhur rezulton se praktika e ndjekur eshte e njejte ne te gjitha komisaritet e rretheve. Menjehere pas ndalimit te te miturve njoftohet familja me telefon ose ne banese nepermjet inspektorit te rrethit. Njoftimi duhet te behet brenda nje kohe sa me te shkurter.
- A ka ne strukturen tuaj psikolog? - Nese po eshte personi i punesuar ne kete pozicion si psikolog?	Po	Nga informacioni i marre rezulton se ne organiken e te gjitha komisariateve eshte percaktuar edhe pozicioni i psikologut.
- A ka mundesi i mituri te beje ankim per sjelljen e punonjesve te policise? - Cila eshte procedura? - Cilat jane masat qe merren ne keto raste?	Po	Ne te gjitha komisaritet e rretheve procedura eshte e njejte: I mituri mund te beje ankim per sjelljen e policisë në strukturat përkatëse si SHKB, prokurori, Av. i Popullit apo tek drejtori i policisë së qarkut si dhe tek shefi i komisaritatit. Rasti shqyrtohet nga komisioni dhe paraprakisht merret masa e pezullimit dhe nese shihet e aresyeshme çështja kalon në prokurori për hetime të mëtejshme ose nxirret në lirim personi abuzues

Qendrimë		
A është trajnuar policia për:		
- intervista sensitive për fëmijet dhe menyrat e komunikimit me fëmijet e rritur?	Po	Ne të gjitha komisaritet e policive në rrethë janë bërë trajnime për intervista sensitive me fëmijet dhe menyrat e komunikimit me fëmijet e rritur. Psh, në komisaritin e Durrësit këto trajnime janë organizuar nga Ministria e Brendshme, PNUD dhe aktorët e shoqërisë civile.
- nevojat e vecanta të fëmijes viktime të abuzimit seksual dhe trafikimit?	Po	Ne pjesën më të madhe të komisaritet e policive në rrethë janë bërë trajnime për nevojat e vecanta të fëmijes viktime të abuzimit seksual dhe trafikimit. Psh, në komisaritin e policisë në Shkoder këto trajnime janë organizuar nga CAAHT- USAID, PAMECA. Megjithatë, nga informacioni rezultoi se nuk ka patur trajnime në këtë drejtim në komisaritin e policisë në Kukës.
- shenja dhe simptoma që tregojnë krimet kundër fëmijëve?	Po	Përgjigja është pozitive në të gjitha komisaritet e policisë në rrethë. Psh, në komisaritin e policisë në Shkoder trajnimi është organizuar nga IOM.
- njohjen dhe parandalimin e kanosjes, kërcënimeve, apo dëmtimeve ndaj fëmijëve viktime/dëshmitare?	Po	Janë organizuar trajnime për njohjen dhe parandalimin e kanosjes, kërcënimeve, apo dëmtimeve ndaj fëmijëve viktime/dëshmitare në të gjitha komisaritet e policive në rrethë. Psh, PAMECA ka organizuar trajnimin e efektivave të policisë në komisaritin e Shkodrës.
- njohuri se cili shërbim social duhet t'i drejtohen për fëmijet viktime/dëshmitare?	JO	Ka pasur trajnime në këtë drejtim por nuk janë cituar në asnjë rast.
A kanë njohuri oficerët e policisë për :		
- ekzistencën dhe përmbajtjen e rregullimeve ligjore, për ndihmën ndaj fëmijëve viktime dhe dëshmitare (referuar si më lart)?	Pjesërisht	Ne të gjitha komisaritet e policisë në rrethë rezultoi se janë bërë trajnime në këtë drejtim. Vetëm në komisaritin e policisë në Durrës trajnime kanë qenë të pjesëshme.
- përmbajtjen e ligjeve relevante që ndeshkojnë aktet e dhunës, abuzimit, braktisjes dhe shfrytëzimit në shtëpi dhe në insitucione si shkollat dhe qendra kujdesi rezidencial?	Po	Ne të gjitha komisaritet e policisë në rrethë rezultoi se oficerët e policisë kanë njohuri mbi përmbajtjen e ligjeve relevante që ndeshkojnë aktet e dhunës, abuzimit, braktisjes dhe shfrytëzimit në shtëpi dhe në insitucione si shkollat dhe qendra kujdesi rezidencial. Si baze shërbejnë KP dhe KKP, ligji "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare". Nderkohe që të gjithë oficerët kanë qenë dhe janë në proces trajnimi.

- nevojat e keshillimit dhe suportit per femijen viktime/deshmitar dhe sidomos per femijet viktimat te dhunes seksuale dhe trafikimit?	Pjesërisht	Njohuritë në lidhje me nevojat e keshillimit dhe suportit për femijen viktime/deshmitar dhe sidomos për femijet viktimat të dhunës, janë të pjesshme pasi vetëm specialistët që trajtojnë rastet e vecanta kanë njohuritë përkatëse. Në Komisaratin e policisë në Korce dhe në Kukës rezultojnë se nuk ka informacion në këtë drejtim.
Monitorimi dhe raportimi		
A regjistrohen të dhëna të fëmijes viktime/deshmitar? Nëse po çfarë regjistrohet saktësisht? <i>(ju lutem kerkoni te shihni regjistrimet dhe merrni kopje nese eshte e mundur ose plotesoni fushat e informacionit qe jane regjistruar)</i>	Po	Në të gjitha komisaritet e policive në rrethë ekziston një regjister ku regjistrohen gjeneralitetet e plota të fëmijës, rasti konkret, vepra penale, cilësia e personit.
A i jepen këto regjistrime drejtorise rajonale te policise apo ndonje autoriteti tjetër?	Po	Nga informacioni i marrë rezultojnë se regjistrimet e bëra nga komisaritet e policive në rrethë i kalojnë Drejtorive Rajonale të Policisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, Prokurorisë dhe Gjykatës.
A ka mundësi t'ju mituri te beje ankim per sjelljen e punonjesve te policise? Cila eshte procedura? Cilat jane masat qe merren ne keto raste?	Po	Në të gjitha komisaritet e policisë në rrethë përgjigja është pozitive.
A vleresohet dhe rishikohet periodikisht roli i oficerëve te policise qe punojne me femijet?		Në të gjitha komisaritet e policisë në rrethë bëhet rishikimi periodik i rolit të oficerëve të policisë që punojnë me fëmijet. P.sh. në komisaratin e policisë në Shkodër vlerësimi i punës së oficerëve të policisë bëhet çdo vit.

A ka kërkesa të vecanta raportimi për rastet e femijeve viktime të trafikimit?		Nga informacioni i marre rezulton se raportimi për rastet e femijeve viktime të trafikimit ka kërkesa të vecanta. Kështu psh: -Ne komisaratin e policise ne Durres raportimet për rastet e femijeve viktime të trafikimit bëhen tek eprori dhe janë të hollësishme, ndërsa për publikun vetëm nëpërmjet specialistit përkatës dhe brenda asaj që përcaktohet në udhëzimin e Ministrisë. -Ne komisaratin e policise ne Korce keto raporte behen cdo tre muaj. -Ne komisaratin e policise ne Lushnje raportimi i behet zv ministres, institucioneve perkatese, ne drejtorine e pergjithshme te policise se shtetit, sektorit kunder trafikimit te qenieve njerezore.
---	--	---

Shenim: Seksioni është i ri dhe përgjegjesja e tij është i vetmi person që punon në këtë seksion policor dhe mbulon të gjithë qarkun e Durresit. Ajo nuk ka një zyrë të veten, po punon në një zyrë me 5-6 oficerë të tjerë policie; nuk ka automjet që të ndjeke ngjarjet dhe shpesh detyrohet të marrë taksë për të shkuar në vendngjarje dhe vlefë të transportit të shpenzuar nuk i likuqdohet.

Është kërkuar, sipas drejtorit të policisë së qarkut Durres Ilia Nasi që të ketë nga një inspektor në tre komisaritet e policisë: Durres, Shijak, Krujë.

PJESA 3

Informacion permbledhes mbi Protokollet e Vleresimin praktik te vizites ne Insitucione Rezidenciale

Realizuar ne Tirane, Durres, Elbasan, Shkoder, Korce.

	PO ose JO	PERSHKRIMI
Politika dhe legjislacioni		
A ka ndonje kod per etiken profesionale apo guide per stafin? Nese po, cfare permban? <i>(kerkoni nese mund ta shihni ose te merrni nje kopje)</i>	Po	Pergjithesisht praktika (Durres, Tirane, Elbasan) eshte e unifikuar ne kete drejtim pasi egziston Kodi i Sjelljes (i Etikes) dhe “Standartet për fëmijët në qendrat rezidenciale” qe percakton qarte dhe rregullon marredheniet midis stafit dhe femijeve, midis pjestareve te stafit, ato me prinderit e femijeve etj. Krahas kodit te siperpermendur, ne cdo institucion gjendet “Rregullorja te Brendshme” e vete institucionit. Ne kete rregullore percaktohen qarte rregullat per stafin.
A ka nje politike te shkruar apo rregullime qe drejtojne veprimtarine e insitucionit? Nese po, cfare permbajne? <i>(kerkoni nese mund ta shihni ose te merrni nje kopje)</i>	Po	Veprimtaria e institucionit rregullohet nga Rregullorja e Brendshme e Ministrise se Punes, Ceshtjeve Sociale dhe Shanceve te Barabarta qe permban detyrat dhe pergjegjesite qe ka gjithsecili punonjes i stafit. Ne Elbasan krahas rregullores gjen zbatim edhe Deklaraten e Qellimit te Institucionit dhe Udhezuesin per femije, ndersa ne Durres eshte dhe nje rregullore tjeter e miratuar nga Keshilli Bashkiak i Durresit. Ne Korce qendra funksionon ne baze te ligjit “ Per ndihmen dhe sherbimet sociale”, Nr 9355 dt.23.05.2005 Ne Tirane- Standartet për fëmijët në qendrat rezidenciale” ku janë të përcaktuar 11 standarte të cilat përcaktojnë qëllimin dhe llojet e shërbimeve që qendra duhet të ofrojë dhe në përputhje me standartet e vendosura. Këto standarte jemi duke i përmbushur, në vazhden edhe të njësjerë tranimesh që kemi bërë nga UNICEF.

A ka ndalime ne politiken e shkruar apo rregullimet ligjore per rekrutimin dhe kerkesen e femijeve persa i perket vendosjes ne kujdesin rezidencial?	Jo	Ne Durres rezulton se asnje femije nuk pranohet ne institucion pa nje urdher pranimi nga SH.S.SH dhe pa dosjen e plote te tij. Edhe bashkia e Durresit ka te drejten qe te sjelle ne institucion femije, pasi ka bere vleresimin real te rastit, po gjithcka dhe ne kete rast kalon nepermjet SH S SH. Ne Elbasan , per shkak te natyres se sherbimeve rezidenciale qe ofrohen dhe kapaciteteve te stafit nuk mund te pranohen femije me te vegjel se 5 vjec ose me te medhenj se 15 vjec, Nuk mund te pranohen femije me aftesi te kufizuara apo me prapambetje mendore Tirane- Të drejtën e vendosjes së fëmijëve në institucionin tonë e ka SHSSH. Institucioni ynë ofron vetëm shërbime. Ndërkohë që kemi kërkuar që të paktën në komisionin e pranimit të këtë edhe përfaqësues nga institucioni ynë, pasi në të shumtën e rasteve fëmijët që na vinë për tu sistemuar nga komisioni i SHSSH paraqiten me mungesë dokumentacioni. E kemi kërkuar këtë gjë po ende nuk është rregulluar ligjërisht.
E ndalon politika e shkruar apo normat ligjore ndeshkimin trupor dhe te gjitha masat e tjera disiplinore te quajtura mizore, cnjerezore apo trajtimin degradues (perfshire izolimin , perdorimin e forces apo shtrengimet fizike)?	Po	Krahas KDF dhe Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, te gjitha masat disiplinore te quajtura mizore, cnjerezore apo trajtimin degradues ndalohen nga Rregullorja e Brendshme e Institucionit , e cila percakton ne menyre te qarte respektimin e dinjitetit dhe vleren e lindur te femijes apo te riut. Rastet e abuzimeve apo te keqtrajtimeve (perfshire izolimin, perdorimin e forces apo shtrengimet fizike), ndalohen dhe merren masat e nevojshme ne perputhje me rregulloren e Institucionit

A mbulon politika e shkruar apo normat ligjore : - Vleresimin e nevojave të fëmijëve dhe hartimin e nje plani kujdesi individual? - Rishikim periodik të vendosjes se fëmijes? - Planin per perfundimin e vendosjes dhe riintegrimin dhe kujdesin e mevonshem?	Po	Ne praktiken e Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit rezulton se vlerësimi i nevojave të fëmijës dhe hartimi i nje plani individual kujdesi behet mbi bazen e formulareve të gatshëm të hartuar nga Ministria e Punës në bashkëpunim me UNICEF Egziston praktika e rishikimit periodik të vendosjes së fëmijës dhe kjo behet cdo 6 muaj dhe qofte për bërësim a kthim pranë familjes biologjike shihen dhe vlerësohen kushtet ekonomiko-sociale të familjes dhe me pas vendimi merret vetëm nga gjykata për transferimin e kujdestarisë Nga praktika e Elbasanit rezulton se brenda institucionit është ngritur nje grup multidisiplinar, qëllimi i të cilit është vlerësimi i nevojave dhe ecurisë së fëmijëve. Prej kohësh pjesë e rëndësishme e dokumentacionit për cdo fëmijë është edhe vlerësimi i nevojave të tyre, ku një vend të rëndësishëm zë “Plani i përkujdesjes” apo që në ndryshe e quajmë RVNE- Raporti i vlerësimit të nevojave dhe ecurisë. Gjithashtu pjesë e detyrimeve të standarteve është edhe rishikimi periodik i vendosjes së fëmijës në institucion, ky rishikim bëhet cdo 6 muaj, pjesë e të cilit është edhe “Plani i Arsimit” ose ndryshe në cilësojmë PPA. Në këtë kontekst është duke u përgatitur plani për një vajzë që këtë vit përfundon klasën e 9-të. Edhe “Plani i largimit” është pjesë e punës sonë, këtë vit nuk kemi fëmijë në këtë moshë por vjet kemi trajtuar një rast të tillë.
---	-----------	---

A permban politika e shkruar apo normat ligjore nje mekanizem efektiv ku femijet mund te shenojne ankesat e tyre apo shqetesimet ne lidhje me trajtimin apo kushtet e vendosjes tek: - Drejtori i insitucionit? - Ndonje autoritet tjeter kompetent?	PO	Nga praktika ne keto te gjitha rrethet ku eshte bere anketimi rezulton se kutia e ankesave eshte konceptuar si mekanizem efektiv ku femijet mund te shenojne ankesat apo shqetesimet ne lidhje me trajtimin tyre ne institucion, qe me pas mund te hapet vetem ne prani te nje inspektori, kryesisht punonjesi social, nga titullari ose nga komisioni. Autoritet tjeter competent per shqyrtimin dhe vleresimin e ankesave te femijeve eshte edhe Sherbimi Social Shteteror. Po pjesa e ankimit është e detyrueshme edhe si pjesë e detyrimeve të standarteve, ne kemi kutinë e ankesave. Por gjithësesi kjo nuk është shumë efciente në praktikë pasi fëmija është e vertëtë që ankohet tek zyra jonë, që ka në përbërje 1 shefe me profesion psikologe dhe ne 2 punonjëset sociale. Dhe në rast se ka ankesa për ne apo ndonjë ankesë tjetër mund të shkojë të ankohet edhe tek drejtori i insitucionit. Por nëse ka ankesë për drejtorin e institucionit ai nuk ka ku të ankohet. Kjo është diskutuar edhe në trajnimet që kemi bërë, është menduar të ngrihet një institucion asjëanës, Ombusmani i fëmijëve, ku ata të kishin të drejtë të ankoheshin për stafin e institucionit apo të mund të shprehinin mbase më lirshëm shqetësimet e tyre, por kjo formë nuk ka gjetur ende rregullim ligjor.
A ka ndonje procedure disiplinare per stafin? Nese po, cfare permban ajo?	Po	Procedura disiplinare per stafin percaktohet ne Rregulloren e Brendshme te Institucionit dhe kur konstatohet shkelje e te drejtave te femijes, abuzim a dhunim merren masa administrative deri ne pushim nga puna. Ne keto raste gjejne zbatim edhe dispozitat e Kodit te Punes qe rregullojne ne menyre me te pergjithshme marredheniet e punes.
A ka ndonje protokoll apo udhezim per incidentet e dhunes apo abuzimit brenda institucionit? Nese po, cfare permban?	Po	Praktika eshte e unifikuar ne kete drejtim pasi si baze sherben Rregullorja e Brendshme e Institucionit
A ka zbuluar stafi incidente dhune apo abuzimi brenda institucioneve qe duhet te raportohen tek: - Drejtori i Insitucionit? - Ndonje autoritet tjeter kompetent?	Po	Nga studimi rezulton se nuk ka asnje rast te evidentuar apo te dokumentuar i cili mund te deshmoje per incidente te dhunes apo te abuzimit me femijet brenda Institucionit. Vetem Tirana raporton raste sporadike te abuzimit te femijeve me te rritur kundrejt atyre me te vegjel. Edhe ne qendren rezidenciale ne Korce, duke qene se eshte nje qender per persona me AK , si dhe ngarkesa e qendres eshte madhe ka pasur incidente dhune midis <i>rezidenteve</i> me njeri tjetrin.

(PER KUJDESHIN REZIDENCIAL NE OJF) A ka kritere te shkruara per pranimin ne institucion? (kerkoni te shihni nje kopje)		Nga studimi rezulton se ne Tirane, Durres, Korce, Shkoder nuk ka dijeni per egzistencen e kriterëve të shkruara për pranimin e fëmijëve në institucion. Në këtë pikë distancohet vetëm praktika e Elbasanit pasi, në institucionin e këtij rrethi ka kritere të shkruara për pranimin e fëmijëve në institucionet rezidenciale. Konsiderohet si detyrë e SHSSH
A i përfshijnë kritere të tilla:		
- vlerësimin rigoroz të nevojave të fëmijës nga një skuadër e përshtatshme, multidisiplinare dhe e kualifikuar?		Vetëm në Elbasan, në rastet e pranimit të fëmijës në Institucion, grupi multidisiplinar evidenton nevojat e fëmijës për zhvillim, duke plotësuar Raportin e vlerësimit të nevojave dhe të ecurisë. Mungon një praktikë e tillë në Tirane, Durres, Korce dhe Elbasan
- Keshillimin me fëmijën dhe prinderit e tij/saj.		Vetëm në Elbasan parashikohet si kriter keshillimi me fëmijën dhe prindin e tij dhe kjo është kompetencë e P/Social apo Psikologut të qendres. Mungon një praktikë e tillë në Tirane, Durres, Korce dhe Elbasan
- vlerësimin e sigurisë së menjëhershme të fëmijës sikundër edhe nevojat/ zhvillimin/ e tij afatgjatë për kujdes?		Vetëm në Elbasan, kuadër të raportit të vlerësimit të nevojave dhe të ecurisë së fëmijës, grupi multidisiplinar harton planin e perkujdesit i cili përfshin nevojat e tij për zhvillim në kujdes rezidencial për një periudhë kohe afatgjatë. . Mungon një praktikë e tillë në Tirane, Durres, Korce dhe Elbasan
- Parimi që fëmijet duhet të pranohen në qendrat e kujdesit rezidencial vetëm në rast se nuk ka alternative tjeter dhe për minimumin e nevojshëm të afatit kohor?		Tirana, Durresi, Korca dhe Shkodra nuk shprehen ndërsa në Elbasan parashikohet si kriter pranimi në institucion mungesa e një alternative tjeter të mundshme për sistemin e fëmijës. Si alternative e fundit mbetet Institucioni i perkujdesit shoqëror.
Praktika		
(PER INSTITUCIONET SHTETERORE) A ka institucioni kontroll mbi pranimet apo e gjithë kjo kontrollon teresisht nga komisioni qendror për pranimet Sh.S.Sh?	JO	Procesi i pranimit të fëmijëve në institucionet e perkujdesit shoqëror kontrollon teresisht nga komisioni qendror për pranimet Sh.S.Sh . Ky konstatim vjen nga institucionet e perkujdesit shoqëror në Tirane, Durres, Elbasan, Korce dhe Shkoder

(PER INSTITUCIONET SHTETERORE)	Po	Pranimi i femijeve ne institucionet e perkujdesit shoqeror kerkon paraprakisht vendimin e Sh.S.Sh-se, megjithate nga praktika rezulton se ne raste emergjente eshte pranuar mbajtja e femijeve te cilet vijne me nje urdher pranimi emergjent nga Drejtori i SH S Sh. Femija merret dhe dorezohet me procesverbal te autoriteti sugjerues brenda nje kohe te shkurter, zakonisht jo me shume se 48 ore, por ne cdo rast informohet SH.S.Sh dhe merret miratimi qofte ky dhe verbal nga autoriteti. Ndersa ne Korce rezulton se nuk ka patur praktika te tilla.
A vleresohen nevojat per kujdes te cdo femije sipas hyrjes se insitucionit ne praktike?	PO	Nga praktika ne institucionet e perkujdesit shoqeror ne Tirane, Durres, Elbasan, Korce dhe Shkoder rezulton se pergjithesisht ka nje plan perkujdesjeje per te gjitha femijet qe pranohen ne institucion. Per kete arsye, menjehere pas sistemimit te femijes ne institucion behet vleresimi i nevojave me te domosdoshme e me pas vazhdohet me vleresimin e nevojave afatgjata.
A perdoret vleresimi per te hartuar nje plan kujdesi individual per cdo femije ne praktike?	PO	Nga praktika rezulton se per hartimin e nje plan kujdesi individual per cdo femije ne praktike behet vleresimi i nevojave dhe ecurise se femijes (Raporti I Vleresimit dhe Ecurise). Plani i perkujdesit rishikohet nje here ne 6 muaj. (Ne Elbasan ky vleresim dhe rishikim behet nga grupi multidisiplinar dhe Punonjesi I pavarur per rishikim)
A ruhen te qarta dhe te perditesuara regjistrimet ne lidhje me te gjitha sherbimet e kujdesit perfshire dosje te detajuara per cdo femije?	PO	Ne baze te VKM nr. 209 cdo femije ka dosjen personale ku pasqyrohen te gjitha sherbimet e kryera ne qender si dhe vleresimet e planeve te perkujdesit individual. Keto dosjet ruhen pergjithmone edhe pas largimit te femijes nga institucioni
A jane regjistrime te tilla mbi femijet te kompletuara, te sigurta dhe perditesuara? (ju lutem kerkoni te ekzaminoni regjistrimet)	Po	Ne lidhje me sigurine dhe perditesimin e regjistrimit te femijeve praktika eshte e ndryshme. Ne Elbasan nuk ka asnje informacion ne lidhje me kete problem , ne Durres dhe ne Tirane nuk behet perditesimi i tyre.

A përfshin regjistrimi i cdo fëmije: -datat e pranimit dhe të nisjes? -formen, përmbajtjen dhe detajet e vendosjes së kujdesit dhe shërbimit të marra? -dokumentet përkatëse të identitetit dhe cdo informacion tjetër personal? -detaje për gjithë periudhën e qëndrimit të fëmijes në kujdes alternativ? -plani individual i kujdesit të fëmijes?	Po	Regjistrimi i fëmijëve në institucionet e kujdesit shoqëror bëhet duke respektuar detyrimet që burojnë nga VKM nr. 209, datë 12.04.2006. Regjistrimi i fëmijës përfshin të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm, që nga shërbimet e ofruara dhe përshkrimet e detajuara për fëmijen nën kujdes alternativ. Përfshihet akt-marreveshja prind-institucion; certifikata e lindjes dhe deklarata e nënës si akt noterial për braktisjen ose lenien e foshnjes në institucion. Plani individual i kujdesit gjithashtu.
A rishikohet periodikisht vendosja e cdo fëmije?	Po	Nga praktika në institucionet e kujdesit shoqëror në Tiranë, Durrës, Elbasan, Korçë dhe Shkoder rezulton se cdo 6 muaj bëhet rivekurimi i rastit dhe vlerësimi i situatës social-ekonomike të familjes, për të parë ecurinë e saj me qëllim kthimin e fëmijës në familje, në rast se situata është përmirësuar.
Nesë po, sa shpesh?		Nga studimi rezulton se vendosja e fëmijëve në institucionet e kujdesit rishikohet periodikisht, cdo 6 muaj. Kjo praktikë ndiqet në Durrës dhe Elbasan ku, në mbledhjet e rishikimit, bëhet vlerësimi periodik i cdo fëmije si dhe mundësia për rivedosjen e tij në familjen biologjike apo sistemin tjetër. Në Durrës është stafi multidisiplinar dhe kryesisht punonjësi social, i cili bën këtë vlerësim 2 herë në vit dhe vit pas viti.

A konsultohen regjistrimet ne praktike kur kerkohen te behen vendimet e kujdesit apo rishikimet?	Jo	Ne praktike rezultojn se ne institucionet e perkujdesit shoqeror ne Tirane nuk behet konsultimi i regjistrimeve ne rastet e rishikimit te vendosjes se femijes ne institucion. Ndryshe ndodh ne Durresi, Elbasani, Korce dhe Shkoder te cilat e vleresojne si shume e rendesishme ne kete proces
A ekzaminohen mundesite e biresimit ne rastet kur perkujdesja nga prindit eshte ose e pamundur ne menyre perfundimtare ose nuk eshte treguar ne kohen e caktuar sipas ligjit?	Jo	Praktika e Tiranës, SHkoder ne lidhje me kete ceshtje eshte e ndryshme nga praktika qe ndiqet ne Durres, Elbasan apo ne Korce pasi theksohet se nuk eshte kompetence e institucionit vleresimi i mundesise se biresimit te femijes ne rastet kur perkujdesja nga prindi eshte ose e pamundur ne menyre perfundimtare ose nuk eshte treguar ne kohen e duhur. Biresimi ndodh vetem pasi femija eshte shpallur i braktisur me vendim gjykate dhe eshte kompetence e Komitetit Shqiptare te Biresimeve Ne institucionet e perkujdesit shoqeror ne Durres dhe Elbasan ekzaminimi i mundesise se biresimit ne rastet kur mugon perkujdesja prinderore shihet nga nje tjetër kendeveshtrim, ai i interesit me te larte e femijes. Keshtu psh vitin e kaluar ne institucionin e perkujdesjes ne Durres u shqyrtua rasti kur nena e vajzes vinte kontaktonte me te 1 here ne vit duke e bere te pamundur deklarimin e femijes te braktisur. Pasi u vleresua se ne takimet e tyre vjetore lidhja nene-bije ishte e vaket, pa afeksion e ngrohtesi, u vleresua si e nevojshme te nderhyhej. Nena ishte ne kushte te veshtira. Pa pune, pa nje shtepi te qendrueshme. Nena dha nje deklarate per braktisjen e femijes dhe aktualisht vajza rome eshte ne proces biresimi ne France.
Cilat jane veprimet qe ndermerr institucioni ne lidhje me garantimin e futjes se femijeve pa prespektive per tu rivendosur ne gjirin e familjes biologjike, ne listat e biresimit?		Ne institucionin e perkujdesjes shoqerore ne Tirane nuk ndermerret asnje veprim ne lidhje me garantimin e futjes se femijeve pa prespektive per tu rivendosur ne gjirin e familjes biologjike, ne listat e biresimit. Kjo shihet si kompetence e Komitetit Shqiptar te Biresimeve Ne Durres dhe Elbasan, kur shihet qe kushtet emocionale dhe ato ekonomiko-sociale nuk plotesohen, nderhyhet qe femija te futet ne listen e biresimeve. Nese interesimi eshte i dukshem nga prindi ateherë i lihet me shume kohe vleresimit
A planifikon ne menyre aktive institucioni riintegrimin e cdo femije ne familjen e tij/saj apo nje zhvillim tjetër te pershtatshem familjar?	Po	Institucionet e perkujdesjes shoqerore konsiderojne riintegrimin e cdo femije ne familjen e tij si qellim baze i punes se institucionit edhe ne baze te rregulloreve te brendshme. Madje ka strategji per kete qellim dhe qe ndiqen me perparësi. Psh: ne institucionin e perkujdesjes shoqerore ne Durres, vitin e kaluar ne 4 raste femijet jane kthyer prane familjeve biologjike ose te afermeve te tyre dhe jane ndjekur edhe pas kthimit ne familje per te pare pershtatjen, ecurine e tyre

Kur fillon plani i riintegritit dhe kujdesit të mevonshëm në rastin e një femije të vetëm?		Nga praktika në qendrat rezidenciale të Tiranës, Durrësit dhe Elbasan plani i riintegritit të femijes fillon kur femija përfundon sistemimin në institucion perkujdesi, dhe 6 muaj ose 1 vit para largimit të tij, praktikohet Plan i rruges për të ardhmen (rikthim në familjen biologjike, vendosje në konvikt, jetesë e pavarur, vendosje në institucion tjetër të perkujdesit) Në qendrën rezidenciale në Shkoder plani i riintegritit fillon pas kërkesës së familjes ose në momentin e transferimit të femijes në një qendër tjetër
Si merr parasysh plani për riintegritin rrethanat e vecanta të femijes?	Po	“Plani i rruges për të ardhmen” merr parasysh të gjitha rrethanat e vecanta të femijes (edhe të femijëve me AK) e nevojat e tij për zhvillim (mëdhimin e femijes, familjarëve të tij, vlerësimin e aktoreve të tjera etj)
Cilat janë qëllimet e riintegritit të një femije?	Po	Nga praktika rezulton se duke vlerësuar interesin më të lartë të femijes, riintegriti ka si qëllim përsosur sigurimin e një jetese sipas standarteve më të mira dhe rikthimin në familjen biologjike Ky objektivi është përsosur nëse rrethanat e lejojnë, në të kundërt është deklarimi i braktisjes së femijes dhe gjetja e një familjeje të re nga Komiteti Kombëtar i Biresimeve. Në qendrën rezidenciale në Korce qëllimi i riintegritit është të bëjë PAK të familjarizohet me komunitetin dhe të mos ndihet i huaj.
Përfundimisht sa është përqindja e femijëve që lene institucionin për: - Riintegritin me familjes ekzistuese? - Riintegritin në rrethin e të afërmeve? - Biresimin? - Kujdes tjetër rezidencial?		Nga praktika rezulton se, përgjithësisht, informacioni grumbullohet dhe përpunohet në Sektorin e Statistikave në SH. S.SH. Megjithatë, psh në qendrën rezidenciale të Durrësit rezulton se gjatë vitit 2008 ka patur: - 3 raste të riintegritit të femijëve me familjen e origjinës - 1 femije është biresuar nga tezja e vet - 5 të biresuar

Cilave OJF qe ofrojne sherbime me baze komunitare u referohet institucioni pas perfundimit te vendosjes?	JO	Nga informacioni i mbledhur rezulton se ne qendrat rezidenciale ne Tirane dhe ne Elbasan nuk ka nje praktike bashkepunimi me OJF-te. Ndersa ne Durres dhe Shkoder, institucioni bashkepunon me shoqata te tjera homologe te cilat ofrojne sherbime komunitare per sistemimin e fëmijëve dhe qe kane si qellim formimin profesional te te riut.
A jane facilitetet te vogla dhe te organizuara rreth te drejtave dhe nevojave te fëmijës ne vendosjen sa me prane te jete e mundur ne situaten e nje familje apo grupi te vogel?	PO	Nga informacioni rezulton se krijimi i nje ambienti sa me te ngjashem me ambjentin familjar perben misionin apo qellimin e qendrave rezidenciale. Ato jane te konceptuara si nje familje alternative, pasi vete institucionet dhe sherbimet qe ato ofrojme jane ne kuadrin e shtepive-familje. Ne qendren rezidenciale ne Korce dhe Shkoder ekzistenca e nje numeri te madh personash veshtireson krijimin e nje suate te ngjashme me ate familjare dhe ofrimin e sherbimeve cilesore.
A inkurajohet kontakti me familjen e origjines se fëmijës dhe a lehtesohet ne mbrojtjen e fëmijës dhe interesit me te larte te tij/ saj? Nese po, si?	PO	Po, femija nxitet te mbaje kontaktet me prinderit gjithnje kur shihet interesim real nga ana e prindit apo e familjareve te tjere. Kujdestaret e fëmijës organizojne takime te shpeshta te fëmijës me familjen biologjike me qellim forcimin e marredhenieve mes dy paleve.
A marrin pjese prinderit apo kujdestaret ligjore te fëmijëve ne vendimet e perkujdesit? Nese po, si?	PO	Nga informacioni i marre rezulton se kujdestaret ligjore apo prinderit e fëmijës jane te pranishem ne cdo vendim qe merret per fëmijen. Ato kane informacion per nevojat e fëmijës dhe planet e perkujdesit duke dhene mendimin e tyre lidhur me keto vendime.
A e ndjekin fëmijet ne insitucion shkollen ne komunitetin lokal?	PO	Fëmijet e vendosur ne institucione apo qendra rezidenciale ndjekin shkollat dhe kopshtet publike, ndersa ne Korce kjo praktike mungon.
A kane ne praktike fëmijet mundesine te ankohen ne lidhje me trajtimin e tyre tek: - Drejtori I institucionit? - Ndonje autoritet tjeter kompetent?	Po	Fëmijet kane te drejte ne cdo kohe te ankohen ne lidhje me trajtimin e tyre dhe te vendosin ankesat e tyre ne kutine e ankesave. Nje praktike e tille mungon ne Korce.

A informohen femijet mbi rezultatin e ankimit të tyre dhe a u sqarohet dhe argumentohet vendimi në praktike?	PO	Nga informacioni i grumbulluar rezulton se fëmijëve u komunikohet rezultati i ankimit Një praktikë e tillë mungon në Korce.
Cfare veprimi duhet të ndërmerret stafit për të zbuluar incidente të dhunës/abuzimit brenda institucionit?	Po	Me qëllim zbulimin e incidenteve të dhunës/abuzimit me fëmijët brenda institucionit bëhet monitorimi në çdo kohë i tyre apo marrja e kontakteve konfidenciale me fëmijët
Qendrim / Si mendoni?		
A është trajnuar stafi në:		
- vlerësimin dhe karakteristikat e planit të kujdesit?	PO	Me qëllim trajnimin e stafit të qendrave rezidenciale në lidhje me vlerësimin dhe karakteristikat e planit të kujdesit janë organizuar seminare nga SH.S.Sh dhe Unicef (Tiranë, Durrës, Korce dhe Shkoder). Trajnimi mungon në rrethet tjera si p.sh Elbasan
- ruajtjes së regjistrimeve?	E ka K.SH.B	Praktika është e ndryshme në lidhje me trajnimin e stafit për ruajtjen e regjistrimeve pasi në qendrën rezidenciale në Tiranë kjo shihet si detyrë e K.SH.B, ndërsa në Durrës ruajtja e regjistrimeve bëhet nga titullari dhe punonjësit social. Praktika mungon për rrethet e Elbasanit. Korça dhe Shkodra dëshmojnë për organizimin e trajnimeve nga SH.S.SH
- identifikimin dhe punën me fëmijët e abuzuar?	PO	Trajnime për identifikimin dhe punën me fëmijët e abuzuar është bërë me trajnime të ndryshme të organizuara nga OJF të ndryshme, si p.sh në Durrës trajnime të stafit është bërë nga shoqata angleze "Hope&Homes"
- të qenurit të informuar mbi të drejtat e fëmijëve dhe standardeve minimale të kujdesit rezidencial?	PO	Trajnime të stafit është bërë nga Drejtoria e Sh.S.Sh dhe unicef Unicef si dhe dhe FSHDP AK në Korce
- si të veprojnë me ankimet?	PO	Në Tiranë dhe Durrës po nga SH.S.SH ndërsa në Elbasan ky trajnim nuk bëhet -jo
- të dërguarin e karakteristikave jetësore të fëmijëve?	Jo	Nuk ka trajnime në këtë drejtim
A duhet të dije stafi rezidencial:		

- mbi ekzistencën dhe përmbajtjen e rregullimeve, politikave, standardeve apo protokolleve për garantimin e kujdesit në institucione?	PO	Trajnime të ndryshme nga UNICEF, SH.S.SH dhe organizata të ndryshme
- mbi nevojat për konsultimin dhe suportin e fëmijëve viktimë të abuzimit?	PO	Nga praktika në qendrat rezidenciale të Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit rezulton se stafi ka informacion të mjaftueshëm për evidentimin e rasteve të fëmijëve të abuzuar dhe mbështetjen emocionale dhe psikologjike të fëmijëve
- mbi veprimin e ndonjë mekanizmi ankimes të aksesueshëm për fëmijën?	PO	Në praktiken e qendrave rezidenciale ka informacion të mjaftueshëm në lidhje me mekanizmat ankimes të aksesueshëm për fëmijën por nuk tregohet se si është marrë ai.
- mbi rregullimet e Kodit të Familjes për kujdestarinë, biresimin dhe braktisjen?	PO	Stafi dhe në mënyrë të veçantë sektori social, ka njohuri të mjaftueshme për rregullimet e kodit të familjes, kujdestarinë dhe procesin e biresimit.

- mbi standardet e reja te qeverise per kujdesin rezidencial perfshire ate ne lidhje me: - ushqimin; - shendetin; - edukimin; - mundesine per te luajtur; - fene; - jeten private; - marredheniet; - kushtet e jeteses. <i>(Ju lutem perdoreni kete seksion per te percaktuar nivelin e pergjithshem te njohurive te stafit te kujdesit. Gjithsesi kini parasysh se kjo nuk duhet te jete ne fokusin e vleresimit te praktikes)</i>	Po	Stafet ne qendrat rezidenciale kane njohuri per funksionimin e standarteve te reja ne praktike lidhur me ushqimin, shendetin, planin e perkujdesit, edukimin, kushtet e akomodimit, argetimin, ankimimin, jeten private dhe marredheniet me familjaret.
Monitorimi dhe raportimi		
Cilat regjistrime garantoohen nga autoritetet pergjegjese per zhvillimin dhe monitorimin e kujdesit rezidencial?	Nuk e di	Mungon informacioni ne lidhje me kete pike ne qendrat rezidenciale te Tiranës dhe Elbasanit. Ndersa ne qendren rezidenciale te Duresit , Sh.S.Sh njihet si autoriteti qe ndjek kujdesin rezidencial dhe monitoron te gjitha dokumentimet e bera per secilin femije

A ka inspektime te rregullta qe perfshijne edhe vizitat e parashikuara dhe ato te panjoftuara, duke perfshire diskutimin dhe vezhgimin e stafit dhe femijeve?	PO	Po, ne qendrat rezidenciale kryhen inspektime te rregullta nga inspektoret e Sh.S.Sh-se si dhe nga Zyrat e Sherbimit Social Rajonal per qendrat rezidenciale ne rrethe.
Cfare ka ndryshuar institucioni ne 12 muajt e kaluar si rezultat i rekomandimeve te inspektoreve?	PO	Ne qendrat rezidenciale rekomandimet e inspektoreve kane ndikuar kryesisht ne rritjen e cilesise se sherbimeve
A eshte e detyrueshme raportimi ne Sh.S.Sh i ankimeve te marra nga drejtori i institucionit ?	Jo	Ne qendren rezidenciale ne Tirane, Korce dhe Shkoder nuk konsiderohet i detyrueshem raportimi ne ShSSH i ankimeve te marra. Ndryshe ne Durres dhe Elbasan
A eshte e detyrueshme raportimi tek Sh.S.Sh i incidenteve te dhunes/ abuzimit brenda institucionit?	Po	Megjithese nuk ka pasur raste te evidentuara te abuzimit te femijeve brenda institucionit, eshte e rendesishme raportimi tek SH.S.SH apo Sherbimi Social Rajonal, me qellim mbrojtjen e femijes. Nje praktike e tille mungon ne Shkoder.
A eshte roli i stafit rezidencial subjekt i rishikimit dhe i vleresimit?	JO	Ne Tirane- jo Ne Korce dhe Shkoder- po
A merret parasysh kapaciteti i stafit ne nje proces monitorimi/ rishikimi?		Ne baze te informacionit te mbledhur nga qendrat rezidenciale ne rrethet Tirane, Durres, Elbasan, Korce dhe Shkoder, ne procesin e vleresimit apo ne mbledhjet e rishikimit te planit te perkujdeses, eshte e rendesishme qe stafi rezidencial te kete kapacitetin dhe profesionalizmin e duhur

PJESA 4

Informacion permbledhes mbi Protokollet e Vleresimit praktik te vizites ne qendren e kujdesit te shendetit paresor.

Realizuar ne Tirane, Durres, Korce, Lushnje, Kukes, Shkoder, Diber, Elbasan. Gjirokaster.

	PO ose JO	PERSHKRIMI
Politika dhe legjislacioni		
I. E drejta per shendet dhe sherbime shendetesore		
A ekziston nje rregullim ligjor I kenaqshem I cili te mundesoje realizimin e mbrojtjes se shendetit te femijeve?	Po	Ne te gjitha rrethet pranohet qe ka nje rregullim ligjor, por nje pjese e rretheve ose njohin fare pak legjislacionin ne kete fushe, ose nuk e njohin fare.
A mund te permendni disa prej ligjeve, vendimeve dhe rregulloreve?	Jo	
Mund te permendni disa nga masat specifike qe parashikohen per femijet ne lidhje me mbrojtjen e shendetit te femijeve?	Po	Vaksinimi i detyrueshem, ndjekja per zhvillimin psikomotor deri ne njehet e mteje, kujdesi pediatrik. Kryesisht keto masa permenden edhe ne rrethet e tjera, me perjashtim te Dibres, ku nuk njihen keto masa. Ne Shkoder permendeshin si masa pergatitja e materiale promocionale per dhunen ndaj grave dhe femijëve nga Departamenti i Promocionit Shëndetësor, në ISHP dhe zhvillimi i takimeve me komunitetin, shkollat, punonjës të kujdesit shëndetësor në qytet dhe zonat rurale.

Cilat jane masat qe garanton legjislacioni ne lidhje me mbrojtjen e shendetit te nenes shtatzane dhe per uljen e vdekshmerise foshnjore?	Po	Ne Tirane permendet leja një vjetore e lindjes për nënën, kujdesi prenatal për nënën në konsultoren e gruas, vaksinimi i rregullt. Shtesa terapisë me acid folik dhe fluor. Ne rrethin e Durrësit permenden ne vija te pergjithshme duke referuar te udhezime te Ministrise se shendetesise dhe ligjit per shendetin riprodhues, por pa permendur konkretisht se cfare masash parashikon ky legjislacion, ne Elbasan gjithashtu, ne Diber nuk njihen keto masa, ne Korce dhe Lushnje permendet vaksinimi gjate shtatzanise, kontrole te shpeshtaetj, gjithashtu dhe ne Gjirokastr pervec ketyre permendej dhe depistimi i shtazanise per HIV/AIDS ne gratë shtatzëzana ne Shkoder nuk ka pergjigje. Pra mund te themi qe masat qe parashikon legjislacioni ne lidhje me kete ceshtje, ne pergjithesi njihen pak.
A garanton legjislacioni aksesin e te githe femijeve ne sherbimin shendetesor?	Po	Eshte e njejta pergjigje(po), por te pjesa e pershkrimt ka shume pak te dhena, cka tregon nje njohje te percipet te legjislacionit ne lidhje me kete pike.Ne rrethin e dibres nuk ka pergjigje.
A parashikohen procedura/ dokumenta, mospasja e te cilave e bent e veshtire per disa kategori femijesh te marrin sherbime shendetesore?	Po	Ngrihet kryesisht si problem mospasja e certifikates se lindjes, librezja shendetesore c'ka veshtireson marrjen e sherbimit shendetesor per disa femije. Dibra, Kukesi dhe Korca pa pergjigje. Ne Lushnje pergjigjja ishte jo, dmth nuk parashikohen procedura/dokumenta, mospasja e te cilave e ben te veshtire per disa kategori femijesh te marrin sherbime shendetesore.
II. Mbrojtja nga dhuna dhe trajtimi I pershtatshem shendetesor I saj		
A ekzistojne rregullime apo udhezime mbi regjistrimin dhe dergimin e rasteve te ndeshura te dhunes, abuzimit, shfrytezimit apo braktisjes sidomos ne pikepamjen strikte mjekesore,?	Po	Ne pjesen me te madhe te rretheve pranohet qe ka rregullime ne lidhje me kete ceshtje. Ne Durrës dhe Diber permendet nje formular specifik i cili thuhet t'i jete shperndare te gjitha qendrave shendetesore. Ne Kukes nuk kishte udhezime ne lidhje me kete ceshtje, por thuhej qe stafi mjeksor ishte trajnuar. Ne Gjirokastr nuk kishte rregullime
Nese po, a permbajne protokolle te tilla parashikime te vecanta per:		
- identifikimin e dhunes fizike?	Po	

- identifikimin e dhunes psikologjike?	Po	Ne Shkoder Është përgatitur protokolli i unifikuar për trajtimin e dhunës në familje, i cili ofron udhëzime për mënyrat e depistimit, kujdesin e integruar fizik e psikologjik për pacientët që pranojnë abuzimin, vlerësimin dhe planin e sigurisë për viktimën e dhunuar, dhënien e informacionit mbi të drejtat e pacientit dhe ligjin për dhunën në familje, referimine viktimës tek burimet ekzistuese për shërbime të tjera sociale e ligjore. Per qytetet e tjera pergjigjja eshte positive, por nuk ka asnje koment.
- identifikimin e abuzimit seksual?	Po	
- identifikimin e braktisjes kronike?	Jo	Ne Korce dhe Shkoder pergjigjja ishte jo.
- nje kerkese per regjistrimin periodik te rasteve te dhunes, abuzimit, shfrytezimit apo braktisjes, nga pikepamja e mbrojtjes se femijeve ne regjistrimet mjekesore ose te tjera?	Po	Eshte e njejta pergjigje,(po). Ne Diber permendet nje regjister i posacem i cili mbahet nga drejtoria e shendetit publik. Ne Shkoder mbahej nje procesverbal. Ne Korce nuk ishte si praktike regjistrimi I rasteve te tilla., ndersa ne Kukes thuhej qe nuk paraqiten rastet per shkak te mentalitetit.
- nje procedure raportimi te brendshme per te siguruar nje pergjigje te pershtatshme ndaj situatave te tilla?	Po	Ne Elbasan nuk ka pergjigje per kete pyetje.Ne Korce dhe Kukes nuk kishte nje procedure te tille.Ne Shkoder mbaheshin raporte te brendshme periodike qe perfshin lloje te ndryshme informacioni. Ne rrethet e tjera ka te njejten pergjigje,(po), por procedura e raportimit kryesisht nuk njihet tamam.
- kriteret per dergimin e rasteve:		Kryesisht pranohet qe ka kriteret , por ato nuk jane te percaktuara qarte. Ne Diber, Kukes dhe Korce punonjesit nuk njihen me keto kriteret, dmth nuk ka kriteret te tilla.
- ne polici?	Po	
- tek administratori social?	Po	
- tek OJF qe ofrojne sherbime me baze komunitare?	Po	
A ekzistojne rregullime apo udhezime mbi proceduren ne rastin e braktisjes se femijes ne qendren shendetesore?	Jo	Nuk njheshin te tilla procedura. Ne Lushnje thuhej qe kishte udhezime mbi proceduren ne rastin e braktisjes se femijes ne qendren shendetesore, por nuk kishte asnje pershkrim te kesaj procedure, ndersa ne Gjirokastrës keto raste ndiqeshin nga spitali,dmth nuk kishte nje procedure te mirefillte.

A ekzistojne rregullime apo udhezime mbi proceduren ne rastin e ekzaminimit mjekesor te nje femije viktime te trafikimit apo abuzimit seksual? Nese po, cfare parashikimesh permbajne?	Jo	Ne pjesen me te madhe te rretheve nuk kishte, ose nje procedure e tille njihej percipitas nga punonjesit; ne Durres permendeshin disa takime me OJF ne lidhje me kete ceshtje.
Praktika		
I. E drejta per shendet dhe sherbime shendetesore		
- A realizohet vaksinimi I femijeve sipas nje kalendari periodic te percaktuar?	Po	Vaksinimi I femijve kryhej rregullisht ne te gjitha rrethet e anketuara.
- A ka mjaftueshem vakcina?	Po	Ne te gjitha rrethet kisht mjaftueshem vakcina
- A vaksinohen te gjithe femijet?	Po	Ne te gjitha rrethet vaksinoheshin te gjithe femijet
- Pershkruani mjetet (format e ndergjegjesimit) qe perdoren per te realizuar vaksinimin e te gjithe femijeve?	Po ~97%	Patronazh I rregullt për identifikimin e femijeve të porsalindur. Ishte e njejta procedure si kjo per te gjitha rrethet, permendej dhe shperndarja e njoftimeve, flete palosjeve, fushata sensibilizuese etj. Ne Gjirokaster per kete pike nuk kishte pergjigje.
- Si realizohet garantimi I te drejtes per te mos qene o kequshqyer?		Në konsultoren e fëmijëve. Edukimi prindëror
- Si monitorohet kjo?		Ne pjesen me te madhe te rretheve nuk realizohej sic duhej ose nuk realizohej fare garantimi I te drejtes per te mos qene I kequshqyer, nuk monitorohej dhe nuk direshin masat qe merren ne rastet e kequshqyerjes se femijve. Ne Lushnje permendej si mase trajtimi neper qendra femijesh si Kryqi i Kuq, ose ato qe ofrojne te tilla sherbime, ndersa ne Shkoder raste te tilla Rekomandohen tek seksioni i ndihmes ekonomike ne Bashki dhe tek OJF qe ofrojne sherbime sociale
A promovohet ushqyerja me gji e femijeve?	Po	Ne te gjitha rrethet promovohej ushqyerja me gji. Kjo realizohej nepermjet keshillimit te nenave, me postera te ndryshem.
Nese po , si realizohet kjo konkretisht?		

A garantohet higjena neper kopshte dhe shkolla? Cilat jane mekanizmat per monitorimin e situates higjenike	Po Po	E njejta pergjigje per te gjitha rrethet(po). Ne Durres ngrihej si problem numri i madh i femijve ne kopshte dhe shkolla. Ne pjesen me te madhe te rretheve ishte e njejta menyre kontrolli Kontrolli nga inspektorët e DSHP. Ne Elbasan dhe Korce nuk kishte pergjigje ne kete pike. Ne Lushnje situat monitorohej nepermjet Kontroleve nga mjeku i kopshteve dhe i shkollave dhe nga mjeku i higjienesi Qendres Sanitare. Ne Kukes nuk shpjegoheshin mekanizmat per monitorimin e situates.
A ka buxhet te mjaftueshem per te perballuar nevoja shendetesore te femijeve ne rrethin tuaj? A perdorni ju burime alternative per te perballuar nevojat? Nese po, cilat jane procedurat ?	Jo Jo	Ne te gjitha rrethet nuk ka buxhet te mjaftueshem, me perjashtim te Koces. E njejta pergjigje per te gjitha rrethet(jo). Ne Lushnje permendeshin si burime alternative ndihmat qe kerkoheshin nga bizneset private, nga OJF, Bashkia etj. Gjithashtu dhe ne Shkoder organizoheshin takime dhe krijime bashkepunimesh me OJF qe operojne ne nivel local, per te perdorur burime alternative.
I. II. Mbrojtja nga dhuna dhe trajtimi I pershtatshem shendetesor I saj		
Cfare kriteresh perdoren ne praktike per te identifikuar rastet e :	Plotësohen formularë	Ne Elbasan dhe ne Tirane perdoreshin formulare dhe protokolle.
- dhunes fizike?	Ne rrethet ku nuk perdoreshin formulare shikoheshin shenjat klinike te dhunes, ne Kukes nuk kishte pergjigje per te katra pikat e kesaj pyetje por thjesht thuhej qe I drejtojmë prane organeve perkatese, ndersa ne Shkoder thuhej qe raste te tilla nuk paraqiteshin fare per shkak te stigmatizimit qe mund t'ju behej ketyre personave, ne Gjirokaster pritej sa te denonconte vete personi. Ne pergjithesi mund te themi qe nuk ka kriteret e percaktuara qarte, te pakten per ato rrethe qe nuk perdorin formulare.	

- dhunes psikologjike ?	Identifikim I rasteve te tilla ishte I veshtire sepse mungonte prania e nje psikologu dhe nuk ishin zhvilluar trajnime te personelit mjeksor per te identifikuar te tilla raste. Ne Korce perdoreshin intervista sipas moshes se femijes. Ne Lushnje thuhej vetem qe keto raste I identifikon psikologu.	
- abuzimit seksual ?	S'ka pergjigje per keto pika ne te gjitha rrethet. Ne Lushnje thuhej vetem qe identifikohen nga mjeku I familjes.	
- braktisjes kronike?	Ne pjesen me te madhe te qyteteve nuk ka pergjigje per kete pike.	
A merren ne praktike masa:		
- per te regjistruar peroidikisht dhunen, abuzimin, braktisjen, shfrytezimin SIDOMOS NE TERMA STRIKTE MJEKESORE? <i>(ju lutem kerkoni te shihni regjistrimet dhe merrni kopje nese eshte e mundur)</i>	Po	Ne pjesen me te madhe te rretheve pranohet qe merren masa per te regjistruar periodikisht keto raste por, por nuk tregohen konkretisht formularet e regjistrimeve. Ne Lushnje I intervistuari nuk kishte dijeni nese ishin marre masa apo jo, ne Kukes nuk ishin paraqitur raste te tilla, ndersa ne Shkoder mundesa e denoncimit nga frika bente qe most e merreshim masa per te rregjistruar te tilla raste.
- mbi perdorjen e nje mekanizmi koordinimi te brendshem per te garantuar nje pergjigje te pershtatshme per raste te tilla?		Ne pjesen me te madhe te rretheve, kjo pike ose eshte pa pergjigje , ose thuhet qe nuk ka pasur raste, ose nuk tregohet konkretisht si funksionon nje mekanizem I tille. Ne Gjirokaster thuhej se në do shkolle sipas funksionon psikologu shkollor i cili kryen koordinimin midis institucioneve dhe përgjigjet profesionalisht
- per te percaktuar nese eshte e sigurte (nga pikepamja e mbrojtjes se femijes) per nje femije per t'i kthyer kujdesin e tij/saj te meparshem? Aty ku percaktohet se kjo nuk eshte e sigurte, cfare veprimi duhet ndermarre?	Po	Per kete pike ne pjesen ne te gjitha rrethet nuk ka nje pergjigje te sakte, dmth nje pergjigje qe te jete e lidhur me pyetjen , c'ka tregon qe nuk ka kriteret te percaktuara qarte per kete ceshtje dhe nuk njihen sakte masat qe duhen marre nese persaktohet se nuk eshte e sigurte per nje femije t'l rikthet kujdesit te meparshem. Sugjerohej bashkepunimi me OJF.
- per te vleresuar shendetin, sherbimet psikologjike, sociale apo nevoja te tjera te femijeve qe dyshohet se kane vuajtur dhunen, abuzimin, shfrytezimin apo braktisjen;	Po	Ne pergjithesi rezulton se nuk jane marre masa te tilla per te ofruar kete lloj sherbimi, ose jane marre shume pak.

- per te derguar raste te dhunes, abuzimit, shfrytezimit, apo braktisjes :	Po	Ne pergjithesi pranohet te jene marre masa te tilla, por nuk ka nje pershkrim sesi veprohet konkretisht ne praktike. Durresi raporton qe nuk ka patur raste te tilla (te femijve te abuzuar ne vitin 2008), ndersa ne Kukes nuk jane marre masa ne praktike per te derguar raste te tilla ne organet e meposhtme.
- Ne polici?	Po	Sipas rastit, kur ata janë me pasoja të rënda
- Tek administratori social?	Po	Kur kanë nevojë për këshillim Pervec Tiranës dhe Korcës në rrethet e tjera nuk janë marre masa për derguar raste te tilla te administratori social.
- Tek OJF qe ofrojne sherbime me baze komunitare?	Po	Në rastet që kanë nevojë për mbrojtje (strehim) apo nevoja ekonomike (ndihmë)
Qendrimet		
A eshte trajnuar stafi per:	Jo	
- parashikimet e politikave relevante dhe rregullimet ligjore (te referuara me lart), aty ku keto ekzistojne?		Rezultoni qe vetem nje pjese e rretheve te jete trajnuar per kete pike.
- identifikimin e situatave te: - kequshqyerjes, kushteve higjienike, dhunes, abuzimit, braktisjes apo shfrytezimit duke perfshire shenjat dhe simptomat?	Po Po	Ne pjesen me te madhe te rretheve trajnimi eshte bere. Ne nje pjese te tyre nuk eshte bere per te gjitha rastet e perfshira ne kete pike. Kryesisht per identifikimin e braktisjes apo rastet e shfrytezimit nuk ka trajnime. Ne Shkoder nuk jane bere trajnime per te gjitha pikat e kesaj pyetje.
- proceduren ku nje femije eshte braktisur?	Jo	Per kete pike per te gjitha rrethet nuk ka trajnime. Ne Gjirokaster ishin bere trajnime nga OJF.
- sherbimet me baze komunitare te vlefshme per referim rastesh?	OJQ	Pergjigjja eshte ose jo ose behet referim ne OJF.

A ka stafi njohuri:		
- mbi ekzistencën dhe përmbajtjen e ndonjë politike apo rregullimi (referuar me lart) aty ku keto ekzistojnë?	Jo	Ne pjesën më të madhe të qyteteve rezultoi që nuk ka njohuri në lidhje me këto pike.
- mbi detyrën statutoresë për dërgimin në polici të rasteve dhunes, sipas nenit 282 të K.Pr.P?	Jo	Ne një pjesë të qyteteve ka njohuri, në pjesën më të madhe nuk ka njohuri.
- mbi shërbimet me bazë komunitare siç janë keshillimi apo shërbimet e suportit të familjes?	Po	Ne pjesën më të madhe të rrethëve ka njohuri për këto pike.
- cili është roli i administratorit social?	Po	Vetëm një pjesë e qyteteve ka njohuri ose njohuri të pjesshme për administratorin social. Në Lushnjë dhe Kukës nuk ka përgjigje fare për këto pike. Në Tiranë përgjigja është që ka rol koordinues
Monitorimi dhe raportimi		
A janë regjistrimet mjekësore dhe të tjera që sqarojnë me hollësi rastet e kequshqyerjes, neglizhimit higjienik, dhunes apo abuzimit të raportuara në drejtorinë e shëndetit rajonal?	Po	Por respektohen shumë pak. Kryesisht në këto pike përgjigjja është jo ose ka regjistrime vetëm për identifikimin e rasteve të dhunes, ose nuk janë të hollësishme.
A i kalohen regjistrime të tilla drejtorisë së policisë rajonale apo ndonjë autoriteti tjetër?	Po	Sipas rasteve kur ato nuk zgjidhen nga drejtoria e shëndetit Në pjesën më të madhe të rrethëve këto regjistrime i kalonin një autoriteti tjetër. Në Dibrë nuk ka fare regjistrime të tilla, ndërsa në Korce dhe Kukës regjistrime të tilla nuk i kalonin një autoriteti tjetër, ndërsa në Shkodër i kalonin vetëm administratorit social për ndihmë ekonomike. Në Gjirokastrë nuk kishte dijeni për këto pike.
Si monitorohet dhe supervizohet stafi që ndjek rastet e dhunes dhe abuzimit ndaj fëmijëve?		Më shumë monitorimi ndodh përmes shoqatave. Për këto pike pranohet nga pothuajse të gjithë qytetet që nuk ka një proces monitorimi dhe supervizimi të vecantë. Në Lushnjë thuhet se monitorimi bëhet nëpërmjet Koordinatorit të Drejtorisë shëndetësore rajonale, ndërsa në Shkodër monitorimi bëhet Vetëm nëpërmjet raporteve kur ka raste të tilla të paraqitura. Në Gjirokastrë bëhet nëpërmjet vlerësimeve periodike, nga Buletinet shtetërore dhe OJF-të

PJESA 5

Informacion permbledhes mbi Protokollet per marrjen e informacionit dhe vleresimin e praktikave prane Drejtorive Arsimore Rajonale.

Realizuar ne Tirane, Durres, Elbasan Korce, Lushnje, Shkoder, Diber, Kukes, Gjirokaster.

	Po ose Jo	Pershkrim
Legjislacioni, praktika dhe politikat		
Aksesi ne te drejten per Edukim		
Cili eshte kuadri ligjor qe zbaton Drejtoria Arsimore ne lidhje me garantimin e procesit mesimor te detyruar dhe te mesem?	Po	➤ Pothuajse ne te gjitha rrethet permenden keto dispozita: Dispozitat normative , Udhezimi I vitit te Shkollor Ligji per sistemin arsimor parauniversitar, Udhezimi te MASH dhe te DAR, marrveshjet e bashkepunimit me OJF-te si ajo e UNICEF me Min Jashtme italiane dhe MASH per te drejtat e femijeve, Marrveshjet me Save the children, me Terre des hommes, strategjia kombetare femijeve e Ministrise se arsimit Strategjia kombetare e komunitetetit Rom (Ministria e arsimit dhe OSBE)

A garantohet ne praktike perfshirja e te gjithë femijeve ne sistemin aresimor? Si realizohet ajo? - Femijet e paregjistruar ne lindje; - femijet me aftesi te kufizuara; - femijet rome; - femijet te prekur nga fenomeni I gjakmarrjes	Po	➤ Ne Tirane pergjigjja eshte po pasi ka disa programe ndihmese qe favorizojne keto grupe. Si programi “ Braktisja e fshehte”, per femijet rome ne zonat periferike dhe vizitat ne shtepi per femijet qe braktisin shkollen. Ne lidhje me femijet me aftesi te kufizuarm sherbimi psikologjik ne shkolla punon shume per gjithetheperfshirjen e tyre dhe mbeshtetjen ndaj mesuesve. Ne pjesen me te madhe te rretheve jane marre masat per te garantuar ne praktike perfshirjen e ketyre kategorive te femijve ne sistemin arsimor. Jane ngritur shkolla te vecanta per femijet me AK, ne rrethin e Dibres jane caktuar mesus qe punojne vetem me femijet e ngujuar, Ne shkollat e Durresit mundesohet regjistrimi i femijeve pa cerficate lindjeje. Ne elbasan per femijet rome ekziston nje projekt i OJF-ve ne bashkepunim me MASH qe zbatohet ne shkollen “ Xhaferr Kongoli” ne te cilen femiejt rome pergatiten edhe per profesione te ndryshme. Ketu jane te angazhuar edhe mesuesit.Ne Durres ekzistojne te dhena te rregjistrimit te femijeve rom ne shkolla. Sipas frekuentimit jane shkollat Isuf Puka , Hasan Koci Kulla . Garantohet ndjekja e shkolles normale dhe projekti shansi i dyte i cili eshte nje mundesi e dyte.Ne rrethin e Korces nuk tregohej se kush ishin masat konkrete per te garantuar ne praktike kete te drejte. Ne Lushnje ngruhej si problem rastet e femijve rome, femijet jetime apo ata qe jetojne ne zonat rurale, te cilet mund te mos jene regjistruar ne lindje dhe mospasja e certifikates e ben te veshtire regjistrimin ne shkolle. Ne Shkoder parashikohet dhe mesimi ne kushte shtepie per femijet e ngujuar, ndersa ne Kukes mungonte infrastruktura per femijet me aftesi te kufizuara. Megjithate mund te thuhet qe masat qe jane marre jane vetem per nje pjese te ketyre kategorive dhe jo per te gjitha, psh ne Kukes ishin marre masa per fenijet e ngujuar por nuk ishin marre per ata me aftesi te kufizuara.
---	-----------	---

A parashikon legjislacioni shqiptar rregullime te vecanta ne lidhje me garantimin e te drejtave per femijet me aftesi te kufizuara dhe si zbatohen ato ne rrethin tuaj? Mund te permendni disa nga keto rregullime dhe legjislacionin perkates (ligj & akte nenligjore)		Tirana e ka lene pa pergjigje kete pike.Ne pjesen me te madhe te rretheve nuk permenden dispozita konkrete, cka tregon qe intervistesit nuk njihen me legjislacionin perkates ne lidhje me ket ceshtje. Ne Gjirokastr permenden Dispozitat Normative, K R E U XIII, ARSIMIMI I NXËNËSVE ME NEVOJA TËVEÇANTA, Neni 57,59,62 Marrëveshjen e Mirëkuptimit nr.602.datë,30.01.2006 midis MASH-it dhe Save the Children,për zbatim të projektit “Përmirësimi i cilësisë në Arsimin e Detyruar” për fëmijët me aftësi të kufizuara. Persa i perket menyres se zbatimit, kryesisht thuhet se zbatohet ne institucione te vecante sic eshte shkolla e (P.L.M), dhe integrimi nderlendor qe ka nevojte per permiresime te nevojshme ku kurikulat te pershtaten me keto femije nga personeli mesimor e ndihmes . Ne nje pjese te rretheve nuk ka kushte per zhvillimin normal te mesimit ose ne nje pjese tjeter, stafi i mesuesve nuk eshte i trajnuar sic duhet.Ne Korce permendj strategjia e qarkut te Korce per arsimin per tegjithe, e cila parashikon rregullime dhe veprimtari specifike per kete grup permiresimin e shkollave speciale dhe kthimin e tyre ne qendra burimore shtrirja graduale ne arsimin gjithepershires.

Cili është niveli i braktisjes së shkolles për arsimin e detyruar në rrethin tuaj? A keni ju statistika për këtë? Cili është sistemi për prodhimin e statistikave?	Jo	➤ Në të gjitha rrethet statistikën mbahen nga DAR perkatese. Rrethi i Dibrës raporton për 2.05% fëmijë që kanë braktisur shkollën, ndërsa Durresi raporton 200 fëmijë. Në Korce nuk kishte përgjigje për këtë pikë. Në Shkodër thuhet se niveli i braktisjes është në rënie, me saktë në 2006-2007 -2008 nga 1.4% në 1.1% Në Qarkun e Kukës (Kukës, Has dhe Tropojë). Niveli i nxënësve të braktisur është 523 ose 2.7%. Në Elbasan thuhet vetëm që ka statistika por nuk jepet ndonjë e dhënë. Në Gjirokastrë thuhet që nuk është shqetësues niveli i braktisjes, ishin konstatuar vetëm 5 nxënës. Në Tiranë thuhet Nga statistikën e rregullta që vijnë nga shkollat nuk rezultojnë të këtë braktisje. Statistikën vijnë të sakta nga secila shkollë dhe përpunohen pranë DART nga inspektorja e statistikave ➤ Në dhe Durres nuk ka përgjigje në lidhje me sistemin për prodhimin e statistikave , ndërsa Dibra dhe Elbasani, Shkodra, Kukësi dhe Korça shpjegojnë këtë procedurë: Cdo drejtori shkollë i kërkojnë informacion, dergohet modeli i statistikës që do plotësohet, përpunohet në zyrën e statistikës në DAR dhe kjo shkon në MASH. Në Lushnjë statistikën Statistikat janë nxjerre nga studimi i kryer nga ZA në nëntor të 2008. Psh. Në një shkollë me 800 nxënës braktisja ka qënë 7 nxënës. Në Gjirokastrë statistikën mbaheshin nga “Sektorit të Burimeve Njerëzore”(Personi përgjegjës për statistikën)
---	-----------	--

A ka ndonje dallim (diferencim gjinor) mes djemve dhe vajzave persa l perket fenomenit te braktisjes se shkolles?		➤ Tirana nuk ka pergjigje per kete pike. Ne Korce thuhet qe nuk ka dallim. Ne Diber pjesa me e madhe jane femra rreth 60%, ndersa ne Durres, Shkoder dhe Elbasan nga nxenesit qe braktisin shkollen djemte perbejne nurin me te madh, por kjo nuk dihet nga stistikat por eshte mendimi i te intervistuarit. Po ne Elbasan, raportohet qe ka shume femije qe kane braktisur shkollen dhe nuk raportohen si te tille pasi drejtoret e shkollave i justifikojne duke thene aresye te ndryshme si largimi jashte shtetit etj. Realisht nr. l femijeve qe kane braktisur shkollen eshte me i madh sesa raportohet. Ne Lushnje Ne fshatra eshte e theksuar braktisja e shkolles nga vajzat. Ne qytet eshte me e evidentuar te djemte sidomos te ata me probleme ekonomike qe jane te detyruar te punojne. Ne Kukes me shume jane vajzat ato qe braktisin shkollen e sidomos ne zonat e thella malore., ndersa ne gjirokaster diferencia vihej re ne nxenesit rome te te cilet braktisja e shkolles ishte me e madhe nga vajzat.
Cfare ndodh me femijet e identifikuar te cilet ka braktisur shkollen? Cilat jane veprimet konkrete te cilat ndiqen nga Drejtoria aresimore ne keto raste?		➤ Pak a shume eshte e njejta pergjigje per te gjitha rrethet (Ne keto raste ata vizitohen ne shtepi nga stafi i shkolles dhe sherbimi psikologjik dhe perfshihen ne klasa kolektive per femije te moshave te ndryshme). Permendet dhe bashkepunimim me OJF te ndryshme, pune bindese me prinderit etj. Gjoha per penalizimin e rasteve te tilla nuk ka qene nje mase e efektshme. Pervet kesaj keto raste raportoheshin ne MASH, ngriheshin ekiye qe ndiqnin kete fenomen.
A ka ne rrethin tuaj klasa per per femijet qe kane braktisur shkollen per te marre edukim ne menyre te tille qe kapin sa me shpejt vitin shkollor ku duhet te ishin?	Po	➤ Ne disa shkolla te disa rretheve,aplikohej projekti l MASH“ Shansi l Dyte”, por ne disa prej tyre per kete vit shkollor nuk kishte filluar ende zbatimi l tyre,ose nuk funksiononin. Ne Lushnje, Gjirokater dhe Kukes nuk kishte klasa te tilla.

A është I mundur ne rrethin marrja e aresimit profesional? Cilat jane llojet e aresimit profesional te ofruara? Sa te lidhura jane ato me oferten e tregut te punes?	Po	➤ Net gjitha rrethet ofrohet arsim profesional. Kryesisht ne rrethet me te medha ka me teper profile sesa ne rrethet me te vogla te tilla si Dibra ku permendet vetem profile ekonomik, I cili ne vitin 2008 ka nxjerr maturen e pare. Ne Kukës nuk kishte shkolla profesionale. Ne pjesen me te madhe te rretheve pranohet qe ka nje lidhje midis profilit dhe ofertes te tregut te punes, ne pjese tjeter thuhet qe jot e gjitha I afroreshin tregut te punes.
A jane mesuesit te punesuar nga drejtoria juaj te formuar per lenden qe japin mesim? Mund te na jepni nje statiske ne lidhje me mbulimin e e nevojave me profilin e duhur te mesuesit?	Po	➤ Ne pjesen me te madhe te qyteteve eshte dhene e njejtja pergjigje (Po, ne te gjitha shkollat mesuesit japin lenden per te cilen jane diplomuar). Ne Diber nje pjese e mesuesve nuk jane te diplomuar per lenden per te cilen japin mesim. Ghithashtu ky problem vihet re dhe ne fshatrat e rrethit te Elbasanit. Ne Kukës ka mungesa te mesuesit e lendeve Matematike, Kimi, informatik dhe anglisht. ➤ Vetem dibra, Korca, Gjirokastra dhe Lushnja japin statistika ne lidhje me kete pyetje Ne Diber Mesuesit e fillores (kl. I-V) jane 26% me arsim te laret> Te tjeret jane me arsim te mesem pedagogjik. Mesuesit e ciklit te larte (kl. 6-9) te shkolles 9-vjeçare jane 29% e tyre me arsim te larte. Ne Korce rreth 80%. Ne Lushnje 100%. Ne GJIROKASTER 80%
Aksesibiliteti gjeografik dhe aksesibiliteti per femijet me AK.		

A jane shkollat ne rrethin afer qendrave banuese? Ne qytet? Ne fshat? Si mund ta pershkruali situaten ne lidhje me aksesibilitetin e nga ana e femijeve ne fshat? Sa kohe I duhet nje femije per te shkuar ne shkolle? (shembull) Cilat jane masat qe ju si drejtori planifikoni te merrni ne kete aspect?	Po	DART mbulon vetem qytetin. Sipas hartes sociale te zhvilluar ne cdo shkolle, mesatarja e largesise se shkolles nga shtepia eshte 2 - 3 km, dhe me pak se 10 % e nxenesve e kane shtepine me larg se kaq. ➤ Ne lidhje me kete pyetje ne rrethin e Tiranës dhe Korces nuk ka pergjigje. Kjo pike ne pjesen me te madhe te rretheve mbetet problematike. Ne rrethin e Dibres aty ku ka infrastructure, jane marre masat per te vendosur sherbimin e transportit. Ne rrethin e elbasanit kjo pike nuk perbente problem, situatë ishte normale. Gjithashtu dhe ne Lushnje dhe ne Shkoder . dhe ne Gjirokaster situatë ne qytet ishte normale, por ne disa fshatra kishte mangesi ne transport. Per femijet ne fshat ne gjirokaster ishte vendosur transport rrugor. ➤ Ne rrethet ku ekzistonte ky problem nje femije ne fshat. I duhej rreth 30 minuta ose me shume per te shkuar ne shkolle, ndersa ne Korc rreh 10 min, ne Lushnje 20 min, ne Kukes Ne zona e thella ka femije qe levize deri ne 5 km per te shkuar ne shkolle. Psh. Ne shkollat e Topojan, Cernalev, Zapod, Bushtric, Kalis, Mujaj dhe Letaj. Ne gjirokaster ,ne disa fshatra nje femije I duhej rreth 35 minuta. ➤ Nuk eshte dhene pergjigje ne lidhje me kete pyetje ne pjesen me te madhe te rretheve. Ne diber po ndertohej e nje konvikti , i cili do te mundesonte femijet e fshatrave te larget per te ndjekur shkollen. Ne Lushnje parashikohej perdorimi i mjeteveve trasportit ne funksion te zonave rurale me ne nevoje. Enjejta gje dhe ne Kukes. Ne gjirokaster ishte marre nje mase e tille , kishin grumbulluar fëmijt në qëndër shkolla dhe kemi siguruar transportin ku infrastruktura rrugore është e rregullt
--	-----------	---

A garantohet aksesibiliteti i fëmijëve me AK ne institucionet aresimore ne rrethin tuaj? A jeni ju ne dijeni te ndonje rregullimi ligjor perkates i cili parashikon rregulla te vecanta per aksesin e fëmijëve me AK dhe sa zbatohet ai? Sa garantohet aresimi gjithepershires per femijet me AK?	PO	➤ Kjo pike mbetet ende problematike, ne Durres Per fshatin kjo nuk eshte e mundur por 10 femije AK ndjekin arsimin edetyruar ne shkollat normale . Ne elbasan ka probleme , per aresye se godinat shkollore jane ndertesa te vjetra dhe pas rikonsruksioneve nuk jane bere infrastruktura e pershtatshme per kete kategori. Pra problem eshte infrastruktura net e gjitha qytetet. Ne Diber nuk permendet ndonje mase konkrete per menyren e zbatimit te legjislacionit ne kete fushe. Ne Lushnje ngrihej si problem mungesa e shkollave te vecanta per femijet me aftesi te kufizuara. Ne Kukës nuk kishin kushte te pershtatshme femijet me AK ne fshatra. Ne gjirokaster ngihej si problem mungesa e shkollave te vecanta per femijet me AK dhe kjo pengonte ne ofrimin e nje arsimi cilesor per keta femije. Ne Tirane pranohej qe Edhe pse femijet me AK lejohen te arsomohen ne shkolla publike, ka pune per te bere pasi ende nuk kaprograme te vecanta dhe staf te vecante mbeshtetes dhe edukues per ta. Thjesht punohet individualisht dhe ne klasa me numer te madh nxenesish. ➤ Ne pjesen me te madhe te qyteteve nuk permendej ndonje rregullim ligjor. ➤ Kryesisht permendej Strategjia e Femijeveme AK e MASH .ne kuader te kesaj strategjie shkollat trajtojne me prioritet keto femije duke ofruar integrim social brenda klases dhe brenda procesit mesimor . Paga e mesuesve qe punojne me keta femije eshte e diferencuar.Ne Diber kishte klasa te vecanta per keta femije. Tirana nuk kishte pergjigje per kete pike. Ne Lushnje pranihej qe Nuk merren masa te vecanta per keta femije, ata arsimohen ne shkolla publike pa i ndjekur njeri per nevojat e vacanta qe atat kane. Mund te themi qe nuk garantohet plotesisht arsimi gjithepershires per femijet me AK.
--	-----------	--

Cili do të ishte sygjërimi juaj në lidhje me përmirësimin e situatës në aspektin e aksesibilitetit?		➤ Kryesisht këto ishin sugjerimet që kanë dhënë pjesa më e madhe e rrethëve: Të ekzistojnë kushtet fizike të përshtatshme, trajtim të diferencuar për mësuesit që punojnë me këta fëmijë. Për fëmijët me AK që nuk mund të vijnë në shkollë (janë të paralizuar) të ofrohet shërbimi arsimor në shtëpi, hapja e shkollave të posaçme për këta fëmijë dhe kushte të vecanta sipas kategorive. Në Durrës dhe Korce nuk kishte sugjerime. Në Tiranë jepej si sugjerim: Program i përshtatur sipas nevojave dhe aftësive të fëmijës, dhe personel i specializuar me edukatore zhvillimi, psikologe dhe infermiere.
<u>E drejta për të mos qene I shfrytëzuar dhunuar apo I abuzuar</u>		
A jeni në dijeni të garancive dhe të masave që parashikon legjislati shqiptar në lidhje me mbrojtjen e PAK nga shfrytëzimi, dhuna dhe abuzimi në institucionet arsimore dhe në familje? Mendoni se ato janë të mjaftueshme?	Jo	➤ Bie në sy që në Tiranë nuk ka njohuri për masat ligjore në këtë fushë. Në rrethet e tjera kishte pak njohuri ose aspak, përmendej neni 54 i kushtetutës, urdheresa për shkollat ku mësuesit e kanë të ndaluar të ushtrojnë dhunë ndaj fëmijëve, të shfrytëzojnë apo abuzojnë ata. ➤ Për këtë pikë, në përgjithësi nuk kishte përgjigje ose thuhej në mënyrë të përmblodhur që kishte nevojë për përmirësimeose detajime. Në Shkodër thuhej se ato janë të mjaftueshme por duhej forcuar zbatimi.

A kane gjetur pasqyrim dhe a kane marre nje focus te vecante ne programet mesimor informacioni per dhunen dhe abuzimin? A jane trajnuar mesuesit per identifikimin e dhunes tek femijet dhe per mosperdorimin e formave te dhunshme te disiplinimit?	Po	➤ Ky informim ka ardhur kryesisht nga stafi psikologjik permes takimeve dhe seminareve ndergjegjesuese, permes pyetesoreve dhe takimeve individuale. Kryesisht kjo pergjigje eshte dhene net e gjitha rrethet. Pra, thuhet qe informacioni eshte dhene ne ne lende te ndryshme ka trajtim te problemeve te dhunes dhe abuzimit, ne menyre te vecante ne oret ekstrakurrikulare dhe oret educative. Ne Korce informacionet per dhunen dhe abuzimin nuk ka gjetur pasqyrim ne programet mesimore. Ne Lushnje , cdo muaj ka nga nje teme diskutimi per dhunen si dhe jane ndertuar kende informacioni ne cdo shkolle. ➤ Rezulton qe ne pjesen me te madhe te rretheve mesuesit te jene trajnuar. Keto trajnime jane bere ose nga OJF te ndryshme ose nga Sektori i Trajnim-Kualifikimit. Ne ndryshim nga pjesa me e madhe e rretheve, Tirana nuk jep informacion per kete pike.
Ne c’nivel eshte implementimi i legjislacionit aktual ne kete drejtim? Cilat jane disa nga masat konkrete qe ka marre DAR ne kete drejtim?		➤ Ne pjesen me te madhe te rretheve nuk ka nje pergjigje per kete pyetje ose pergjigjja nuk eshte e lidhur me pyetjen qe behet. Ne rrethet qe jane pergjigjur thuhet se eshte ne nivel fillestar, ose mjaftueshem. Ne Shkoder thuhet se zbatimi eshte ne nivel te larte nepermjet bashkerendimit te punes dhe programeve edhe me OJF Ne Gjirokaster Është një proces ,jo vetëm në fazën e sensibilizimit,por edhe në fazën e zbatimit të tij në kurrikul dhe ekstakurrikul. ➤ Ne nje pjese te rretheve nuk jane marre masa, nderkohe qe ne Elbasan eshte hartuar nje qarkore nga DAR dhe eshte shperndare ne shkolla, ne Lushnje permenden udhezime,qarkore, trajnime te DAR ndersa ne Diber permenden si masa te tilla veprimtari ne sensibilizim e mbrojtje te te drejtave te femijeve, si dhe thuhet qe prane çdo shkolle funksionon “Grupi i Krizave” i cili menaxhon situata te veçanta ne shkolle etj.

A ka protokolle, praktika, udhëzime të shkruara për trajtimin e problematikave të dhunës dhe abuzimit në institucionet arsimore publike dhe private në rrethin tuaj? A ekzistojnë mundësi ankimimi për fëmijet në institucionet shkollore? - Si realizohet monitorimi i tyre? - A ekzistojnë masa të vecanta për mbrojtjen e fëmijëve PAK? - A ekzistojnë mekanizma për të monitoruar dhe mbrojtur fëmijet nga dhuna e raportuar që ndodh në familje?		➤ Në pjesën më të madhe të qyteteve kishte protokolle ose praktika të tilla të tilla, në Durrës në shkollat e qyteti ekzistojnë protokolle të realizuara nga shërbimi psikologjik ndërsa në zonat e fshatit kjo realizohet nëpërmjet nëndrejtorëve që mbulojnë punën edukative. Në Elbasan nuk kishte, nderkohe që problematike ishin dhe zonat rurale. Në Tiranë përgjigja ishte e tillë: brenda hierarkisë shkollore ka mundësi të plotë për ankimim dhe kërkesë për ndihmë të cilat gjithnjë merren në konsideratë. Madje realizohen shpesh edhe pyetësore dhe intervista të fshehta për evidentimin e fenomenit ➤ Në Tiranë nuk jepet përgjigje për këtë pikë, ndërsa në rrethet e tjera jepeshin mundësi të tilla si qeveria e xhenesë, drejtoria e shkolles, në DAR tek psikologjia shkollore dhe në Diber përmendeshin Nepermjet kutisë së mendimit (gjendet në çdo shkollë). Në Korce nuk përshkruhej mënyra konkrete për ankimimin. ➤ Në Diber, Korce dhe në Tiranë nuk kishte përgjigje në këtë pikë, ndërsa në Durrës një procedurë e tillë realizohet nëpërmjet sektorit të inspektoriatit koordinativ të shërbimit psikologjik e supervisorit të atashuar pranë koordinatorit në periudhë të vecantë kohore, ndërsa në Elbasan bëhet ballafaqimi i problemeve të ardhura nga inspektorët e DAR ➤ Tirana, Kukesi nuk jepnin përgjigje për masat për mbrojtjen e fëmijëve PAK, në Lushnjë nuk përmendeshin ndonjë masë të vecantë, por thjesht Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, Në Shkodër dhe Diber thuhej që ka masa por nuk përmendeshin konkretisht çfarë mase, në Elbasan, dhe Korce nuk kishte masa të tilla. ➤ Në pjesën më të madhe të rrethëve nuk ekzistonin të tilla mekanizma, nderkohe që në Durrës ekzistonte një mekanizëm i tillë: psikologu raportonte tek koordinatori i shërbimit për rastet të specifikuara deri në zyrën e mbrojtjes së fëmijëve në Bashki (CPU)
--	--	--

A keni pasur raste të raportuara për mesues që zhvillojnë mesim privatisht për nxenesit e tyre? Nese po, sa raste? Cilat janë masat që janë marre në këte drejtim?	JO	➤ Në një pjesë të rrethëve thuhej që nuk ka raste të tilla, ndërkohe që në Elbasan pranohej vetëm se ka ankesa nga nxenes kryesisht të shkollave të mesme për mesues që ushtrojnë presion me ane të notes për kurset private, ndërsa në Diber rezultoi se ka ankesa nga nxenes kryesisht të shkollave të mesme për mesues që ushtrojnë presion me ane të notes për kurset private, ndërsa në Korce thuhet që ka shumë pak raste, në Lushnjë thuhej që ky ishte një fenomen shumë i përhapur, dhe në Kukës gjithashtu ekzistonte ky problem, por thuhej që nxenesit nuk i denonconin mesuesit e tyre. ➤ Në pjesën më të madhe të qyteteve nuk kishte përgjigje për këte pikë, çka mund të tregojë që nuk janë marre masa ndërsa në Diber ndaj këtyre mesuesve DAR, ka marre masa administrative, psh në lëvizje të mesuesit nga një shkollë në tjetrën, në Lushnjë ishin vendosur si masa paralajmërimet.
A keni ju në plan të tuajë iniciativë në lidhje me përmirësimin e situatës në këte kuadër të drejtash?		➤ Tirana dhe Korça nuk ka përgjigje, në Durrës Në cdo shkollë ka një planin edukativ për veprimtarinë jashtë korikulare, orët e lira në kuadër të cilave përshihen module mësimore apo projekte që mbështeten financiarisht, ndërsa në Elbasan përmendej një urdher i DAR që ndalonte mesimin e kurseve private, në Diber, Lushnjë nuk përmendeshin konkretisht çfarë masash kishte. Në Kukës Nga DAR janë zhvilluar pyetësore lidhur me këto probleme, janë zhvilluar takime me organe drejtuese të shkollave
Cilat do të ishin sygjerimet tuaja në lidhje me përmirësimin e zbatimit të legjislativës aktual?		➤ Në pjesën më të madhe të rrethëve nuk ka sugjerime, në Shkodër dhe Kukës përmendej thjesht përforcimi i zbatimit të ligjit, Në Gjirokastrë përmendej bashkëpunimi me i madh midis organeve që punojnë në këte fushë.
E drejta për t'u degjuar		

A ekzistojnë rregullime ligjore apo rregulloret që garantojnë të drejtën e fëmijës për të shprehur në institucionet arsimore? - të kene të drejtë të japin mendimin e tyre për një çështje të përbashkët apo individuale? - Të kene të drejtë të ankohen për notën? - Të kene të drejtë të ankohen për mënyrën se si trajtohen nga mësuesit? Cilat janë mekanizmat konkretë që e garantojnë këtë?	➤ Një nga këto rregullime ligjore është Qeveria e nxënësve, të cilët kanë rolin e zedhenesit të të gjithë nxënësve, të shqetësimeve dhe kërkesave të tyre. ➤ Gjithashtu stafi psikologjik siguron mundësi për mbështetje dhe për të mbrojtur të drejtat dhe shkeljet që ju bëhen nxënësve. ➤ Drejtoritë e shkollave dhe DART gjithashtu janë të hapura për çdo ankese apo sugjerim. ➤ Për pikën e parë dhe nën-pikën e saj, ishte pak a shumë e njëjta përgjigje si kjo më lart, për të gjitha rrethet. ➤ Një pjesë e rrethëve nuk kishte informacion për këto mekanizma (Durrësi, Tiranë, Shkodër), ndërkohë që në të tjerët përmendej qeveria e nxënësve, kutia e mendimit, ankesa me shkrim ose me gojë në Drejtori ose në DAR si mekanizma konkrete që mund të garantojnë të drejtën për të degjuar. Në Lushnjë përmendeshin dhe udhëzimet e MASH. Të cilat zbatohen nga drejtoritë e shkollave, në Gjirokastrë përmendeshin pyetësor . psikologët, inspektimet, vëzhgimet etj.
A sigurohet trajtimi i barabartë i nxënësve të mirë me nxënës të përparim me të ulët në mesime? Si realizohet ky në praktike? A janë trajnuar mësuesit me metoda të përshtatshme komunikimi me nxënës?	➤ Në rrethin e Tiranës nuk ka përgjigje për të treja këto pyetje, ndërkohë që në rrethet e tjera përgjigja ishte pozitive. Në Kukës pranohej që në pak raste ndodhte që nxënës të përparim me të ulët në mesime të lihehin pas dorë nga mësuesit, e njëjta gjë dhe në Gjirokastrë. ➤ Në pjesën më të madhe të rrethëve kjo realizohej nëpërmjet përdorimit të metodave të teknikave gjithëpërfshirëse. Përmes mënyrës së komunikimit, vendosjes së nxënësve në banka pa i paragjykuar ata nga përparimi në mesime, pjesëmarrja në aktivitete pa dallime, trajnimeve të mësuesve mbi metodat e mesimdhënisë dhe komunikimit me nxënës. ➤ Në pjesën më të madhe të rrethëve mësuesit janë trajnuar ose nga DAR, IKT (Institute I Kërkimeve dhe Trainimeve) MASH, nga OJF-ve e pedagogë të psikologjisë, por pranohej që trajnime të mëtejshme ishin të nevojshme.

Cilat jane format e disiplinimit qe perdoren ne shkolla? Cili eshte mekanizmi verifikues per vendosjen e tyre?	➤ Format kryesore ishin qortim, keshillim, verejtje , pune educativene klase, Mungesat, notat negative, qortimet dhe masat disiplinore perjashtim nga shkolla per shkollat e mesme.Keto masa mund te shenoheshin dhe ne regjister ose ne deftesen e nxenesit. Ne rrethe te ndryshme permendeshin procedura te ndryshme : Verifikimi behej nga drejtoria e shkolles, grupi multidisiplinar ne shkolle ose verifikimi behej nga Drejtoria Arsimore e sektori inspektimit ne DAR, dhe ne Diber funksiononte dhe nje procedure e tille pas njefare kohe (3-6 muaj) nga dhenia e nje mase discipline , veprimi i nxenesit analizohet ne klase , ne keshillin e mesuesve e ate te disciplines i cili mund dhe te marre vendim per heqje te mases. Ne Korce nuk kishte pergjigje.Ne kukes ishin vendosur kartela per nxenesit me sjellje jo normale(????). Ne Gjirokaster thuhej vetem qe nxenesit kane mundesi ti apelojne keto masa, ose ne drejtorine e shkolles ose ne DAR. Ne Tirane Per verifikimin e tyre ne shkolla funksionon keshilli disiplinor qe cakton denimet pas shqyrtimit te hollësishem te fakteve dhe deshmive konkrete.
Programet kulturore, argetuese.	
A ekzistojne detyrime ligjore per DAR dhe institucionet aresimore ne lidhje me organizimin e aktiviteteve kulturore, sportive per femijet?	➤ Ne pjesen me te madhe te rretheve aktivizoheshin aktivitete sportive kulturore,. Përveç planeve qe harton e realizon çdo shkolle me vete, edhe DAR harton nje plan te aktiviteteve vjetore dhe u a dergon ate te gjitha shkollave. Planet hartohen mbështetur ne udhëzimin e MASH pe rate vit shkollor Vec aktiviteteve qe zhvillohen ne shkolla , zhvillohen edhe aktivitete te perbashketa bazuar ne planin e hartuar si p.sh ne dite te vecanta si dita e ujit, dita e Kongresit te Manastirit. Ne Tirane programi parashikon ore te lira qe duhen shfrytezuar me aktivitete zbavitese dhe aut – door per ne funksin te lendeve te caktuara dhe profilit qe kane.
A jane ato gjithepershireshe pra per te gjithë femijet (rome, me aftesi te kufizuara,vajza, djem)?	➤ E njejta pergjigje per te gjithë rrethet.(po). Ne Gjirokater femijet rome nuk ishin te perfshire ne keto aktivitete, sepse ata nuk ishin te perfshire as ne sistemin arsimor.
Cilat jane disa nga aktivitet qe keni bere dhe qe planifikoni te beni?	Kryesisht aktivitetet ishin ne kuader te fesaive te ndryshme, dhe kryesisht keto aktivitete (Ekskursione dhe vizita ne vende historike, kampionate sportive, dita e luleve, muaji i letersise, festimet me rastin e festave kombetare, dita e kinemase, koncerte festive) permendeshin dhe ne rrethet e tjera, gjithashtu permendeshin dhe ekspozitat ose kalendare te ndryshme., olimpiada shkencore, konkurse per te drejtat e femijve etj.

PJESA 6

Informacion permbledhes mbi Protokollet e Vleresimit te praktikes se Administratorit Social

Realizuar ne Tirane, Durres, Elbasan, Korce, Lushnje, Shkoder, Gjirokaster, Diber.

	PO ose JO	PERSHKRIMI
Politika dhe legjislacioni		
A ka ndonje pershkrim te detajuar te pozicionit te punes per postin e administratorit social? Nese po, cfare perfshin?	Po	Administratori social eshte pergjegjes per zgjidhjen e problemeve sociale te komunitetit i cili perfshihet ne harten e Njesise Bashkiake 10. Pervec kesaj ai ndjek dhe kontrollon perfshirjen e personave ne skemen e ndihmes ekonomike dhe sociale E njejta pergjigje ishte dhene te gjitha rrethet, ne Kukes pergjigja eshte po, por nuk jepet asnje pershkrim, ne Gjirokaster pershkrimim per pozicionin e punes se adminstratoriteshte: merr ne mbrojtje femijet e shtresave dhe kategorive te ndryshme. Ne Diber nuk kishte pershkrim por behej referim te ligji nr.9355 .
Ka kriteret per te vleresuar pranueshmerine per te marre:		
- mbeshetjet financiare? Cilat jane keto?	Po	Mbeshetjet financiare per kategorite e ndryshme si : kryefamiljari me shume femije, te semuret invalide, te papune etj Durresi dhe Kukes i ne kete pike ben perseri reference ne Ligjin Per ndihmen ekonomike. Ne Elbasan permendej si kriter te ardhurat e cdo familje; ndihme ekonomike te plote perfitojne familjet qe nuk kane asnje lloj te ardhure, te pjesshme ato qe kane pak te ardhura, ne Diber i intervistuari thoshte qe perfitonin te papunet, femijet pa te ardhura ose me te ardhura te pamjaftueshme, ne Korce nuk permendeshin kriteret konkretisht por thuhej vetem qe ato percaktoheshin nga Ministria e puneve dhe ceshtjeve sociale. Ne Lushnje, gjirokaster gjithashtu nuk permendej ndonje kriter.

- perfitim per paaftesi? Cilat jane keto?	Po	Perfitimin per paaftesi e cakton komisioni mjeko-social sipas kategorive te semundjeve ku i paafti mund te marre nje shume mujore te hollash i cili quhet pension invaliditeti Kjo pergjigje ishte dhene ne pjesen me te madhe te rretheve, ose behej referim te ligji per personat me aftesi te kufizuara.
Ka kriteret per administratorin social per tju referuar femijeve dhe familjeve per:		
- kujdesin rezidencial? Cilat jane keto?		Tirana nuk ka pergjigje per kete pike Durresi referonte perseri te ligji per ndihmen ekonomike, pa shpjeguar konkretisht se cilat ishin kriteret, ndersa ne elbasan permendej si kriter relacion per gjendjen social-ekon. te familjes ku banon femija. N e Korce pranohej qe kishte kriteret por ato nuk permendeshin konkretisht. Pothuajse ne te gjitha rrethet nuk permendej ndonje kriter konkret. Ne Diber nuk ka ende qendra rezidenciale.
- sherbimet e komunitetit?		I njeiti konkluzion si me lart. Ne Gjirokastr nuk ofroheshin sherbime te tilla. Ne Diber pergjigjja ishte po , por pa pershkrim.
Ka udhezime apo protokolle per te regjistruar detaje te rasteve te femijeve qe paraqiten per ndohme tek administratori social? Cilat jane keto?	Po	Ne Tirane Udhezime te tillavijne Nga MPCSSH dhe Sherbimi Social Shteteror. Pervet Tiranes , qytetet e tjera nuk kishin udhezime ose ne Durres thuhet qe kishte udhezime te brendshme. Ne Diber nuk ka dokumentacion regjistrimi.
Ka udhezime apo protokolle per veprimet emergjente qe duhet te ndermarre administratori social per te mbrojtur femijet nga dhuna, abuzimi, shfrytezimi dhe braktisja (sic jane vendosja emergjente ne kujdesin rezidencial)?	Po	Ka udhezime te cilat kane si detyre orientimin e kesaj lloj kategorie drejt qendrave rezidenciale ose OJF-ve te ndryshme Ne Durres dhe ne Tirane ka udhezime te tilla,ne Durres ekzistoni dhe marreveshje te brendshme mes bashkise dhe OJF-ve qe punojne me femijet, nuk kishte udhezime dhe ne Korce nuk permendeshin konkretisht se ku konsistonin keto udhezime. Nga pergjigjet e dhena ne rrethet e tjera rezulton se nuk ka udhezime per keto raste. Ne Diber thuhej qe nuk ka raste zbatimi, sepse nuk ka qendra rezidenciale.
Ka administratori social udhezime apo protokolle per identifikimin si me poshte:		Pevet Tiranes ku pergjigjja eshte pozitive per te gjitha pikat e kesaj pyetje, ne te gjitha rrethet e tjera pergjigjja eshte "jo" per te gjitha pikat. Ne Diber pavarisist pergjigjes pozitive, i intervistuari nuk dinte te permendte konkretisht asnje nga keto protokolle, por referohej te ligji 9355.

- identifikimin e dhunes fizike		
- identifikimin e dhunes psikologjike?		
- identifikimin e abuzimit seksual?		
- identifikimin e braktisjes kronike?		
Praktika		
A bazohet administratori social ne te dhenat e marra nga:		
- policia?	Jo	Pervec Tiranes, ne te gjitha rrethet e tjera e tjera pergjigjja eshte po. Ne Gjirokastr Në prefekturë ekziston një Zyrë Teknike kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore,ku në rrjet institucional,raportohen rastet e cdo institucionisi për rastet e dhunimit si për trafikimin. Ne Diber pergjigjja eshte po per te gjith pikat e kesaj pyetje, por thuhet qe nuk ka patur raste.
- shkollat?		E njehta pergjigje per te gjitha rrethet (po), Ne Durres Drejtoria Arsimore Rajonale jep informacion per braktisjen e shkolles, raste qe kane nevoje per ndihme; ka lidhje te ngushte me psikologet e shkollave per raste konkrete, gjithashtu dhe ne Korce. Ne Lushnje Per femijet qe kane braktisur shkollen apo ata qe lypin, nje here ne tre muaj behej nje evidence, tani per momentin nuk zbatohet nje praktike e tille
- qendrat shendetesore?		E njehta pergjigje per te gjitha rrethet (po), megjithate ne Durres thuhej qe bashkepunimi midis me qendrat shendetesore nuk kishte funksionuar.
- OJF?		Vetem ne Korce nuk ka pergjigje per kete pike, net e gjitha rrethet e tjera pergjigjja eshte po.
-ne lidhje me femijet e rruges? (Nese po, cfare ben ai/ajo?)		Pervec Tiranes dhe Gjirokastrës qe nuk ka pergjigje per kete pike, ne rrethet e tjera thuhej qe ishin evidentuar rastet e femijve te rruges. Ne keto raste ne Korce administratori social ben pune edukuese me prinderit e ketyre femijeve, ne rrethet e tjera nuk tregohet konkretisht se cfare bente adminstratori social ne keto raste. N e Lushnje nuk trajtoheshin problemet e femijve te rreuges. Ne Diber administratori social bisedon me supervizorin dhe me tej problemi trajtohet nga institucionet shteterore dhe nga Ojf.

Ben administratori social ndonjehere vizita ne shtepi me qellim per te vleresuar:		Ne te gjitha rrethet pergjigjja ishte po,per te gjitha pikat e kesaj pyetjeje,por ne disa rrethe vizitat beheshin me kerkese te familjarit, ne Durres ngrihej si problem mungesa e automjetit c'ka veshtiresonte levizjen e administratorit social ne per banesa. Ne Gjirokaster para se te beheshin vizita, merreshin te dhena nga zyra e punes. Ne Diber pergjigjja ishte pozitive por pa asnje koment tjeter.
- kushtet e perfitimit te asistences sociale finaciare?	Papunesi dhe kushte te keqija per sa i perket banimit ku personi nuk siguron minimumin jetik	
- kushtet e paaftesise?	Sipas raporteve mjeko_ligjore si dhe verifikim direct me personin e paafte	
- nje situatë te dyshuar emergjence?	Verifikim i sakte i situates dhe i rrethanave ne te cilen zhvillohet gjithmone duke u bazuar ne ligj	
Nese JO, si arrin administratori social te kete informacionin e mjaftueshem per secilen nga keto situata?	Ne rastet kur nuk ishte e mundur per te vleresuar rrethanat e mesiprme nepermjet vizitave ne shtepi, ateher vleresimi behej. Nepermjet kontrollet ne familje 2 here ne vit,nepermjet intervistimeve,nepermjet kontrollit te Listave te ardhura nga institucionet brenda dhe jashte bashkise, nepermjet takimeve me drejtorit e shkollave.	
Ne berjen e nje vleresimi (per mbeshtetje financiare, konfirmim te pageses per paaftesi apo sherbime) administratori social:	Po	Merr pjese ne komisionin vleresues
- keshillohet me agjenci te tjera si shkolla, qendra shendetesore, zyra pune apo OJF?		Pervec Elbasanit dhe Lushnjes, ne pjesen me te madhe te rretheve pergjigjja ishte po. Administratori merr te dhena nga keto institucione te permendura dhe merren vertetime nga zyra te tjera shteterore ne baze te kriterëve te percaktuara per perfitimin e pageses
- keshillohet me femijen?	Po	E interviston ate rreth problemit konkret Pervec Elbasanit dhe Lushnjes, ne te gjitha rrethet e tjera pergjigjja ishte po. Kukesi , pa pergjigje.
- garanton qe vleresimi eshte perfunduar brenda afatit kohor te vendosur?	Po	E njehta pergjigje per te gjitha rrethet. Ne Elbasan nuk kishte pergjigje per kete pike.
Ka derguar ndonjehere ne praktike administratori social rastin e nje femije:	Po	

- per pranim ne kujdesin rezidencial shteteror, shtepine e femijes qe ndodhet ne rrethin e tij?	Po	Ne Tirane per pranimin ne kujdesin rezidencial shoqeror pranohej qe kishte administratori kishte derguar raste. Ne te gjitha rrethet pergjigjja ishte po, pervec Elbasanit dhe Dibres, rreth ne te cilin adminstratori sapo ka filluar pune dhe sishin paraqitur raste per te gjitha pikat e meposhtme. Ne Durres ndiqej nje procedure e tille per keto raste: Behet vleresimi i situates, kalohet ne Keshill Bashkiak dhe me pas i dergohet Sh.S.SH dhe ky vendos ta dergoje femijen aty ku ka vend. Ne Gjirokaster raste të tilla i ishin referuar qëndrës rrezidenciale për mbrojtjen e fëmijëve në Elbasan dhe në Fier.
-ne sherbimet me baze komunitare?	Po	E njejta pergjigje per te gjitha rrethet(po), pervec E lbasanit. Ne Durres permendej rasti i 2 femijeve te rruges te cilet jane derguar ne nje qender ditore.Ne Gjirokaster kishin patur raste të tilla ,si në rastet e kthimit të fëmijëve nga emigracioni dhe në rastet e trafikimit ,të cilat ishin cuar në qendren komunitare"Jetë dhe shpresë" në kete rreth.
- ne polici?	Jo	Pervec Korces dhe Gjirokastres, net e gjitha qytetet pergjigjja eshte jo.
- ne spital apo tek ndonje mjek?		Ne kete rast pergjigjet jane te ndryshme nje pjese e qyteteve femijet nuk ishin derguar ne ndonje spital ose mjek, ndersa ne disa te tjera po. Ne Durres prandaj femija cohet per kontroll te mjeku dhe analiza te plota, ne rastet kur femija duhet te vendoset ne qender rezidenciale sepse i duhen kryer te gjitha analizat mjekesore .
- ne nje strukture e nivelit bashkiak si njesia e mbrojtjes se femijeve "CPU" apo nje structure tjeter?		Pervec Elbasanit dhe Gjirokastres, ne te gjitha rrethet e tjera pergjigjja ishte po.
- ne nje strukture te nivelit rajonal sic eshte komiteti rajonal I anti-trafikimit?		Ne pjesen me te madhe te qyteteve pergjigjja ishte jo, ne Durres thuhej qe ky komitet nuk funksionon. Vetem ne Korce dhe Gjirokaster pergjigjja ishte positive.
Ka administratori social regjistrime ne praktike te rasteve te cilat trajtohen me: (mbeshtetje financiare, pagese per paaftesi apo referime sherbimesh)? Nese po, cfare informacioni regjistrohet?		E njejta pergjigje po per te gjitha rrethet, pak a shume te njejta te dhena,(Rregjistrohen te gjitha faktoret , rrethanat,kushtet per te cilat keto persona e perfitojne kete paaftesi) mbaheshin ne cdo rreth.

Mban administratori social dosje per femijet/familjet per te cilet ai ka dijeni se mund te jene ne rrezik apo ne nevoje, por te cilet nuk marrin asistence financiare apo asistence per paaftesi?		Ne pjesen me te madhe te rretheve pergjigjja eshte po, ne Elbasan keto te dhena mbaheshin ne regjistrin klasik te pritjes se qytetareve. Ne Lushnje dhe Shkoder nuk kishte nje praktike te tille. Ne Tirane ka nje database te vecante
Mund te apeloje nje individ vendimin e nje administratori social? Nese po, cila eshte procedura?	Po	Ne Elbasan nuj kishte pergjigje per kete pike. Ne Durres dhe Gjirokaster intervistuesi nuk kishte dijeni ne lidhje me kete ceshtje, ne Korce , tirane pergjigjja ishte po, por nuk pershkruhej mire procedura qe ndiqej per ankim. N e Korce thuhej vetem se mund te behej nje ankese me shkrim drejtuar,drejtore, Bashkise,gjykatesit, Kryeministrit etje. Ne LUSHNJE mund te apelohej te kryetari i bashkise, ne Shkoder thuhej qe ankimi shqyrtohej nga Keshilli Bashkiak. Ne Diber mund te apelohej te pergjegjesi i zyres, me pas ne instanca me te larta brenda bashkise ose ne instanca me te larta shtetore. Ne Tirane Prane strukturave perkatese si SHSSH, etj
A ndjek administratori social rastet? Nese po, sa shpesh rishikohet cdo rast?	Po	Elbasani nuk ka pergjigje per kete pike, ne Korce rastet rishikoheshin cdo muaj, ndesa ne Durres thuhej vetem qe rishikoheshin shume shpesh por nuk percaktohej se sa/Gjithashtu dhe ne Lushnje ,Shkoder, Diber dhe Gjirokaster nuk thuhej se saa shpesh rishikoheshin keto raste. Ne Tirane Raste ndiqen ne vazhdushmeri sipas specifikave.
Ka administratori social nje liste te OJF-ve te disponueshme vendore te cilat ofrojne sherbimet ne komunitet?		E njejta pergjigje per te gjithë rrethet.(po)
Qendrimë		
Eshte trajnuar administratori social per:		
- identifikimin e situatave te dhunes, abuzimit, braktisjes apo shfrytezimit duke perfshire shenjat dhe simptomat?	Po	Ne Tirane, Lushnje, Shkoder, Gjirokaster dhe Korce ishin kryer trajnime, ndersa ne rrethe te tjera nuk kisht trajnime ne lidheje me kete pike. Megjithate ne asnje rreth nuk ka pershkrime per trajnimet qe ishin kryer.

- vendimet e zbatueshme te komisionit te Sherbimit Social Shtetror qe rregullojne pranimin ne kujdesin rezidencial shtetesor?	Po	Pervec Elbasanit, Shkodres dhe Gjirokastrës, ne rrethet e tjera pergjigjja eshte po.
- parashikimet ne Kodin e Familjes per kujdestarine, biresimin dhe braktisjen?	Po	Ne pjesen me te madhe te rretheve pergjigjja ishte po, por nuk thuhej nese trajnimet ishin ber per te treja temat dmth kujdestarine, biresimin dhe braktisjen apo vetem per nje pjese te tyre. Ne Elbasan trajnimet ishin bere vetem per biresimin dhe kujdestarine. Ne Shkoder dhe Gjirokaster nuk ishin bere trajnime.
- parashikimet me te fundit te Kodit Penal per shfrytezimin e e femijeve per pune, per dhunen dhe abuzimin te parashikuar ne ligjin mbi dhunen ne marredheniet familjare?	Po	Ne Durres trajnimi ishte bere pjeserisht jo per te gjithë administratoret sociale, por vetem drejtuesit e departamenteve te sherbimit social ne bashki. Ne Tirane, Lushnje Shkoder, Diber, Gjirokaster dhe Korce pergjigjja ishte po, ndersa ne Elbasan nuk ka pergjigje per kete pike.
- sherbimet me baze komunitare te vlefshme te referuar rastet ?	Po	Ne Durres dhe Elbasan nuk ka pergjigje per kete pike. Ne Skoder nuk ishin kryer trajnime. Ne rrethet e tjera trajnimet jane kryer .
Si e kupton administratori social termin “mbrojtja e femijes”, cfare elementesh duhet te perfshihen ne te ?	Po	Nje pergjigje e ngjashme me Tiranen(Mbrojtja e femijes nenkupton zbatimin e rregullave te cilat jane te parashikuara ne Konventen e te Drejtave te Femijeve) eshte dhene ne Korce, Diber dhe Gjirokaster, ndersa ne Durres pergjigjja ishte: Respektim i nevojave baze per ushqim, strehim e veshmbathje; mundesine per shkollim e argetim; mosshfrytezimin e tij per lypje, pune e prostitucion; nje pergjigje e ngjashme ishte dhene dhe ne Lushnje, dhe ne Elbasan pergjigjja ishte : Femijet e mitur vendosen ne kujdestari dhe gezojne mbrojtje te vecante nga shteti kur prinderit e tyre jane ne pamundesi perte ushtruar pargjegjsine prinderore, kane vdekur, jane shpallur te pagjetur dhe u eshte hequr pergjegjesia prinderore ose u eshte hequr zotesia per te vepruar. Ne Shkoder i intervistuari nuk kishte njohuri per kete pyetje.
Monitorimi dhe raportimi		

Raportohen ndokund regjistrimet e administratorit social, si ne Sh.S.Sh rajonale?	Po	Pergjigjja ishte po ne te gjitha rrethet. Ne Durres raportohej Vetem per rastet per strehim rezidencial, te tjerat jo se konsideroheshin pjese e sherbimeve lokale qe ofrohen. Ne Elbasan Administratori raporton tek administratori I rajonit dhe ne drejtorine e kujdesit social ne bashki. Ne Lushnje Raportohen ne drejtorine rajonale, e cila i kalon ne Drejtorine e Pergjithshme e me pas ne Ministri, ne Shkoder thuhej vetem qe raportohen ne sektorin perkates,ndersa ne gjirokaster thuhej qe Raportohet në pushtetin vendor dhe në fondacionin që na financon në raporte zyrtare. Ne Diber raportohej ne Drejtorine e perkujdesit te femijve.
A raporton administratori social te dhena te familjeve qe jane ne nevojte por qe nuk marrin asistence financiare apo pagesa per shkak te paafetise?	Po	E njejta pergjigje per te gjitha, me perjashtim te Shkodres dhe Dibres qe nuk beheshin raportime.
A monitorohen dhe rishikohen vendimet e administratorit social nga nje supervizor?	Po	E njejta pergjigje per te gjitha Ne Lushnje monitoroheshin nga Ministria e Punes dhe nga Ministria e Financave, ne Gjirokaster monitoroheshin nga nje punonjes ne Bashki. Ne Diber nga pergjegjesi i ndihmes ekonomike .

ANEKSI III

Raport monitores mbi zbatimin e të drejtave të femijeve në ambientet e paraburgimit dhe burgut, Janar – Mars 2009

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) është organizata e parë e të drejtave të njeriut në Shqipëri.

Misioni i KShH është të kontribuojë për një respektim më të mirë të të drejtave të njeriut dhe forcimin e shtetit të së drejtës në përputhje me të drejtat e njeriut sipas Aktit Final të Helsinkit dhe dokumenteve të tij pasuese, me detyrimet ligjore ndërkombëtare të ndërmarra nga Këshilli i Europës dhe Kombet e Bashkuara, si dhe me normat e të drejtave të njeriut promovuar nga Bashkimi European.

Mandati i KShH është të monitorojë, llojë, mbështesë, së bashku me aktorë të tjerë të shoqërisë civile dhe organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare, përmbushjen e standardeve për të drejtat dhe liritë themelore; të sensibilizojë qytetarët shqiptarë dhe të gjithë aktorët përkatës mbi këto të drejta; të ndikojë në rritjen e transparencës së administratës publike për zbatimin e duhur të ligjeve nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të saj si dhe të ofrojë oponencë ligjore për përmirësimin e legjislacionit dhe zbatimit të tij në praktikë.

Respektimi i të drejtave të shtetasve të privuar nga liria ka qënë dhe mbetet në vëmendje të KSHH-së. Gjatë vitit 2008, KSHH ka kryer monitorime të herëpashershme në institucionet e mbyllura si: dhomat e ndalimit dhe shoqërimit, vendet e paraburgimit dhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

Në kuadër të përgatitjes së këtij raporti , KSHH kreu disa monitorime të respektimit të të drejtave të të miturve që ndodheshin në dhomat e ndalimi dhe të shoqërimit si dhe në disa paraburgime. Gjatë periudhës janar – mars 2009 u kryen 18 misione monitorimi në dhomat e ndalimit dhe shoqërimit: Tiranë, Vlorë, Shkodër, Elbasan, Korçë, Gjirokastër dhe Durrës si dhe në institucionet e paraburgimit: Vlorë, Durrës, Shënkoll Lezhë, Peqin, Rrogozhinë, Korçë.

Përzgjedhja e tyre u bë duke mbajtur parasysh vendodhjen e seksioneve të të miturve në gjykatat e vendeve ku ndodhen edhe vendet e monitoruara dhe vendet e monitoruara më parë

Qëllimi i misioneve të monitorimit është monitorimi i zbatimit dhe respektimit të të drejtave të fëmijëve sipas Konventës për të drejtat e fëmijës.

Metodologjia e përdorur për mbledhjen e të dhënave është vëzhgimi i kushteve të institucioneve të mbyllura, intervistimi i të miturve lidhur me kushtet dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me trajtimin e tyre dhe intervistim i punonjësve të institucionit.

Vëzhguesit e KSHH-së intervistuan **54 të mitur dhe të rritur të rinj (18 – 21 vjeç)** që ndodheshin në dhomat e ndalimit, shoqërimit dhe paraburgimit, gjatë periudhës së kryerjes së monitorimeve.

Të dhëna demografike, sociale dhe kulturore të të miturve të privuar nga liria dhe të intervistuar.

Të miturit e intervistuar në dhomat e paraburgimit (po në dhomat e ndalimit dhe shoqërimit) ishin të grupmoshës 14 - 16 vjeç (14 të mitur), 29 të intervistuar i përkasin grupmoshës 17 – 18 vjeç dhe 7 të intervistuar i përkasin moshës 19 –21 vjeç .

Të gjithë të miturit e intervistuar janë meshkuj. Vendbanimi i tyre ishte i ndryshëm. Pjesa më e madhe e tyre banojnë në zona urbane.

Gjendja ekonomike dhe sociale paraqitetej pothuajse e njëjtë për të gjithë të miturit e intervistuar. Shumë prej tyre jetonin në familje me një gjendje ekonomike të paqëndrueshme ose të varfër, me prindër të divorcuar ose të paafte për punë, me vëllezër dhe motra më të vegjël ose të paafte për punë. vetëm disa prej të miturve të intervistuar pohuan se familja e tyre ishte në gjendje të mirë ekonomike dhe kishin të dy prindërit.

Kryesisht të miturit e intervistuar kishin përfunduar arsimin e detyrueshëm (8 ose 9-vjeçar); kishte prej tyre që kishin përfunduar vetëm arsimin fillor dhe një pjesë e vogël ishin me arsim të mesëm ose të paarsimuar..

Neni 37 i Konventës “Për të drejtat e fëmijës”

Tortura, trajtimet ç’njerëzore ose poshtëruese

Në legjislacionin tonë të brendshëm parashikohet koncepti i torturës dhe trajtimit mizor, çnjerëzor dhe poshtërues. Neni 25 i Kushtetutës së RSH-së sanksion se „*Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues,*”

Tortura parashikohet si vepër e veçantë penale në nenin 86 të Kodit Penal, “...Tortura, si dhe çdo akt tjetër njerëzor apo poshtërues dënohen me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet. Po kjo vepër, kur ka sjellë gjymtimin, shëmtimin ose çdo dëmtim të përbërshëm të shëndetit të personit dënohet me një marxh me të lartë burgimi...”

Në Kodin penal të RSH-së parashikohen dy dispozita lidhur me torturën, në kuadër të rekomandimeve të CPT në vitin 2007 ata janë riformuluar duke përcaktuar veprimet të cilat përbëjnë torturë (neni 86, me ndryshimet sipas Ligjit Nr. 9686, datë 26.2.2007 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal të RSH-së). **Gjithashtu me ndryshimet e bëra Kodit Penal me ligjin Nr. 9859, datë 21.01.2008, shtohet neni 124/b në të cilën përcaktohet se ...**Keqtrajtimi fizik ose psikologjik i të miturit nga personi që është i detyruar të kujdeset për të, dënohet me burgim nga tre muaj deri në dy vjet. Detyrimi i të miturit për të punuar, për të siguruar të ardhura, për të lypur apo për të kryer veprime që dëmtojnë zhvillimin e tij dënohet me burgim deri në katër vjet dhe me gjobë nga pesëdhjetë mijë deri në një milion lekë. Kur nga vepra është shkaktuar dëmtimi i rëndë i shëndetit ose vdekja e të miturit, dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.”...

Ndalimi i torturës është sanksionuar edhe si një nga parimet kryesore gjatë procedimit penal “*Liria e personit mund të kufizohet me masa sigurimi vetëm në rastet dhe mënyrat e përcaktuara me ligj. Askush nuk mund të nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit poshtërues*” (Neni 5/1 dhe 2 i Kodit të Procedurës Penale së RSH-së).

Sipas nenit 31 të Kodit Penal të RSH-së, dënimi me burgim të përjetshëm nuk zbatohet ndaj të miturve. Dënimi me vdekje është hequr nga legjislacioni shqiptar sin ë kohë paqeje dhe lufte.

Nga intervistat me të miturit, ata pretendonin se ka patur raste të ushtrimit të dhunës në komisarate por jo në vendet ku ndodheshin aktualisht në institucionet e paraburgimit.

Dënimi me burgim - si masë e fundit

Bazuar në nenin 37 paragrafi b të Konventës “Për të drejtat e fëmijës” burgimi i fëmijës duhet të jetë në përputhje me ligjin dhe të përdoret vetëm si një masë e fundit dhe për një kohë sa më të shkurtër”.

Nga intervistat e kryera me të mitur, rezultoi se të gjithë të miturit ishin arrestuar sipas procedurave të përcaktuara ligjore dhe gjykata kishte dhënë masa e vlerësimit “arrest me burg”. Duke u nisur nga llojet e veprave penale për të cilën të miturit e intervistuar akuzoheshin, shumica e tyre akuzoheshin se kishin kryer

vepra penale kundër pronës, kryesisht vjedhje për të cilat pavarësisht rrezikshmërisë së vogël ishte dhënë masa e arrestit me burg.

Në shumicën e rasteve, veprat penale e kryera nga të miturit ishin vjedhje të sendeve të tilla si: celularë, hekurishte, vjedhje në xhep, Një pjesë e të miturve të intervistuar (13) akuzoheshin për vrasje ose armëmbajtje pa leje. Kishte të mitur që ishin akuzuar për veprat penale të trafikimit të lëndëve narkotikeve, marrëdhënie seksuale me dhunë, dhënie ndihme për kalim të paligjshëm, kundërshtim me dhunë i punonjësit të policisë të rendit (9 të mitur).

Kohëzgjatja e qëndrimit në vendet e paraburgimit (prej momentit të vlerësimit të masës së arrestit deri në momentin e intervistimit) ishte i gjatë. 34 të mitur kishin më pak se 6 muaj të paraburgosur, 11 të mitur kishin 6 muaj deri në një vit dhe vetëm 3 të mitur kishin më shumë se 1 vit të arrestuar dhe vazhdonin të qëndronin në institucionet e paraburgimit.

Institucionet e paraburgimit dhe të ekzekutimit të dënimit me burgim janë pjesë e rëndësishme e sistemit të drejtësisë penale. Në vitin 1998¹, ato ishin të klasifikuara në katër kategori: burg i sigurisë së lartë, burg i zakonshëm, burg i sigurisë së ulët dhe institute të veçanta. Në institucionet e veçanta përfshihen edhe ato për të mitur. Çdo institucion ka një regjim të veçantë, të përcaktuar në ligj dhe në rregulloren e brendshme të tij. Me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 9888, datë 20.03.2008 klasifikimi i institucioneve ndryshoi duke u shtuar dhe kështu pas Institute të veçanta dhe Institucionet e paraburgimit.

Organi i parë me të cilin përballen të miturit në konflikt me ligjin është policia e shtetit.. Të miturit shoqërohen në polici dhe në rastet e shoqërimit nuk mund të mbahen më shumë se 10 orë. Sipas nenit 107 të ligjit Nr.9749, datë 04.06.2007 përcaktohet se të miturit shoqërohet në mjedise të veçanta nga të rriturit. Në momentin e ndalimit të miturit që ndalohen në qarkun e Tiranës nga punonjës të policisë së shtetit dërgohen në Drejtorinë e policisë së Tiranës, ku qëndrojnë deri në marrjen e masës së vlerësimit. Ndërsa të miturit që ndalohen nga policia e shtetit në qarqet e tjera qëndrojnë në komisariate deri në momentin e marrjes së masës së vlerësimit nga gjykata.

Masa e vlerësimit merret me vendim të formës së prerë nga gjykatat e rretheve gjyqësore në të cilat janë ngritur seksionet për të mitur me Dekretin Nr. 5351 datë 11.06.2007. Nëpërmjet këtij dekreti janë ngritur 6 seksione të veçanta penale për gjykimin e të miturve pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë, Korçë dhe Gjirokastrë.

¹ Klasifikimi është bërë në bazë të ligjit nr.8328, datë 16.IV.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” me ndryshimet përkatëse nenet 13-17.

Gjatë fazës së procedimit paraprak ata mbahen në vëndet e paraburgimit të cilat prej janarit të vitit 2007 kanë kaluar në varësi të Ministrisë së Drejtësisë. Kur vendimi penal i dhënë nga gjykata merr formë të prerë, të miturit dërgohen në institucionet e vuajtjes së dënimit, në të cilat sipas përcaktimit të ligjit duhet të qëndrojnë në qeli të veçanta nga të rriturit².

Nga misionet e monitorimit të kryera ka rezultuar se të miturit që pasi kanë marrë masën e vlerësimit janë dërguar brenda 24 orëve në Institucionet e paraburgimit. Ndërsa të miturit që kanë marrë vendim të formës së prerë nga gjykata dërgohen në seksionet e të miturve pranë Institucionet e Ekzekutimit të vendimeve penale. Aktualisht në Shqipëri ekziston vetëm IEVP i Vaqarrit si institucion ku mund të qëndrojnë të miturit me vendim të formës së prerë. Në proces ndërtimi është një institucion i ri për të miturit në Kavajë.

Trajtimi i të miturve me dinjitet

Një sërë nenesh të Kodit Penal, të Kodit të Procedurës penale si dhe ligje të tjerë penale si Ligji Nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për trajtimin dhe të drejtat e personave të dënuarve dhe të paraburgosur” me ndryshimet përkatëse sipas ligjit Nr. 9888 datë 10.03.2008, parashikojnë trajtimin e veçantë e të miturit që kanë shkelur ligjin.

Neni 33 i Kodit penal përcakton se ekzekutimi i dënimit të të miturve behet në mjedise të veçanta nga të rriturit. Sipas nenit 75 të ligjit Nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për trajtimin dhe të drejtat e personave të dënuarve dhe të paraburgosur” me ndryshimet përkatëse sipas ligjit Nr. 9888 datë 10.03.2008, thuhet se në institucionet e paraburgimit ndalohet mbajtja e të miturve në një dhomë me të rriturit, ose vendosja e të miturve vajza me të mitur djem në një dhomë. Të miturit vendosen në dhoma e seksione të veçuara, duke u krijuar mundësinë e një trajtimi të veçantë. Të miturat vajza mbahen nën mbikëqyrjen dhe kujdesin vetëm të një personeli femëror.

Gratë e paraburgosura vendosen në dhoma apo seksione të veçanta nga burrat dhe mbahen nën mbikëqyrjen e kujdesin vetëm të një personeli femëror.

Nga intervistat e kryera me të mitur, ata pretenduan se në shumë dhoma të ndalimit dhe shoqërimit, të miturit merreshin në pyetje në mjedise të papërshtatshme, nga punonjës policie të pakualifikuar dhe pa respektuar kërkesat e ligjit për dhënie të asistencës ligjore dhe psikologjike. Gjithashtu gjatë monitorimeve të kryera u vu re se një pjesë e mirë e infrastrukturës së Komisariateve ishin në konstruksion dhe për rrjedhojë kushtet e mbajtjes së të miturve ishin të papërshtatshme.

² Ibid., ligji sa më sipër

Si rregull, të miturit mbahen të veçuar nga të rriturit, por jo të gjitha komisaritet kanë dhoma të përcaktuara vetëm për të mitur. Edhe në ato raste kur gjendeshin dhoma për të miturit, infrastruktura, kushtet fizike, higjena dhe pajisjet vetjake linin për të dëshiruar.

Në institucionet e paraburgimit, të miturit mbaheshin veçmas nga të rriturit. Nga intervistat me të miturin A.Z³ rezultoi se kishte qëndruar në Institucionin e paraburgimit Rrogozhinë për 6 muaj në qeli me të rritur. Rast i përsitur ky, i identifikuar gjatë monitorimeve të ndryshme që KSHH ka realizuar në periudha të mëparshme duke përbërë kështu shkelje të rëndë të legjislacionit në fuqi.

Nga një komunikim me Drejtorin e Përgjithshëm të Burgjeve për të miturin A.Z rezultoi se me urdhër të Ministrit të Drejtësisë Nr. 329 në datën 15.01.2009 janë ngritur seksione paraburgimi për të miturit në IEVP Rrogozhinë dhe IEVP Peqin.

Dënimi me burgim për të miturit nuk mund të jetë më shumë se ½ e dënimit të parashikuar nga vepra penale (neni 51 KP).

Kodi penal përcakton rastet kur jepen masat edukuese për të miturit të cilët nuk kanë mbushur moshën për përgjegjësi penale ose janë përjashtuar nga dënimi. I mituri mund të përjashtohet nga dënimi në rastet kur vepra që ka kryer ka rrezikshmëri të pakët, nga rrethanat konkrete të saj si dhe nga sjellja e mëparshme e të miturit.

Kodi penal parashikon uljen e dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji kur i mituri paraqet rrezikshmëri të vogël. Në nenin 59 parashikohet pezullimi i ekzekutimit të vendimit me vënie në provë të miturin, me kusht që gjatë kësaj periudhe mos të kryejë vepër tjetër penale. I mituri mund të kryejë dënimin e tij dhe me një dënim alternativ nga ai me burgim, duke punuar në interes publik. (ka masa të tjera alternative).

Gjithashtu të miturit i janë dhënë një sërë garancish dhe nga ligji procedural penal duke i përcaktuar të drejtën e mbrojtjes me një avokat të zgjedhur vetë dhe në rastet e pamundësisë financiare i sigurohet një avokat falas. Në rastin e të miturit M.M të përfaqësuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit në Gjykatën e Apelit Shkodër gjatë vitit 2007, i mituri ishte hetuar nga Prokuroria e rrethit Lezhë pa patur një avokat (qoftë dhe kryesisht), në një kohë kur i mituri ishte analfabet dhe i përkiste një familje me probleme sociale.

Sipas Kodit Penal, neni 250/1 përcaktohet se afatet e paraburgimit llogariten nga çasti i arrestimit ose i ndalimit..Nga një studim që Komiteti Shqiptar i Helsinkit, “Respektimi i të drejtave të të miturve në procesin

³ I mituri qëndronte aktualisht në Institucionin e paraburgimit në Vlorë, seksioni i të miturve

penal”⁴ rezultonte se, nga pikëpamja ligjore, afatet e paraburgimit respektoheshin, por përsëri ato janë për periudha shumë të gjata duke mos respektuar parimin e burgut si një masë të fundit dhe në afate sa më të shkurtëra të mundshme.

Në institucionet e paraburgimit: Korçë, Rrogozhinë, Peqin janë ngritur seksione të posaçme për të miturit, ndërsa seksionet për të mitur kanë ekzistuar në institucionet: Shënkoll Lezhë, Vlorë, Durrës, Institucioni 313 Tiranë, etj.,

Trajtimi i të miturve në institucionet e paraburgimit

Bazuar në legjislacionin ndërkombëtar në fushë dhe në nenin 33 të Kodit Penal (neni 33 i k.p) është miratuar ligji 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e personave të dënuar me burgim dhe të paraburgosurve” i cili ndryshoi në mars 2008. Ligji parashikon parimet themelore që duhet të respektohen në trajtimin e të paraburgosurve dhe të dënuarve në përgjithësi dhe të miturve në veçanti, përcakton llojet e institucioneve të riedukimit, organet drejtuese të institucioneve të paraburgimit dhe burgjeve, kushtet e jetesës në institucion, pranimin dhe trajtimin e të miturve të arrestuar dhe të dënuar, regjimin në institucion, lejet dhe shpërblymjet, transferimet, lirimet, etj.

Ligji përmban dispozita që kanë të bëjnë me trajtimin e të miturve që ndodhen në Institucionet e paraburgimit dhe ata që vuajnë dënim me burgim, kryesisht me arsimimin dhe formimin e tyre profesional, mbajtjen e lidhjeve me familjarët, etj. Megjithatë ndryshimet e bëra se fundmi në këtë ligj, ende ligji nuk përcakton qartë të gjitha standartet ndërkombëtare që duhet të respektohen në trajtimin e personave të mitur që vuajnë dënimin me burgim ose që janë të paraburgosur.

Nga vëzhgimi i kryer në këto institucione paraburgimi ka rezultuar se një pjesë e institucioneve të paraburgimeve ku qëndrojnë të miturit janë ristrukturuar duke përmirësuar kushtet fizike të mbajtjes së të miturve të paraburgosur (seksioni i të miturve në paraburgimin e Vlorës, Korçës dhe Durrës). Dhomat e të miturve janë të veçanta nga ata të të rriturve, kanë kubaturë të përcaktuara nga ligjet në fuqi. Kushtet higjieno sanitare në disa institucione janë të mira por në disa të tjera lënë për të dëshiruar, si: seksioni i të miturve Shënkoll Lezhë. Gjendja në këtë seksion nuk paraqitej e mirë, qelitë ishin të papastrat dhe se të miturit gatuanin edhe në dhomë vet, pavarësisht se institucioni ofronte ushqimin. Probleme të kushteve higjienike kishte edhe në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale në Korçë, seksioni i paraburgimit të të miturve, një institucionin i inagruar gjatë muajit janar 2009. Problem në shumicën e institucioneve mbetet ngrohja, sidomos në stinën e dimrit si dhe duset të cilat për shkak të mungesës së ujit 24 orë kufizonte larjen e të miturve.

⁴ Botim i Komitetit Shqiptar të Helsinkit, Prill 2007 (studim i vendimeve penale të formës së prerë të të miturve 2005 – 2006)

Bazuar në normën e re të ushqimit, të miturit marrin ushqim më specifik se të rriturit. Një pjesë e të miturve konsumon ushqim të ofruar edhe nga familja, pjesa tjetër me vështirësi ekonomike konsumonte ushqim nga institucioni i cili shpërndahej 3 herë në ditë sipas vakteve.

Në një pjesë të seksioneve të të miturve kishte biblioteka ose vënde të cilat shërbenin si biblioteka (jo të mirëfillta) por fondi i tyre ishte i varfër dhe me mungesa të theksuara të librave.

Lidhur me arsimimin e të miturve në seksionet e paraburgimit, në datën 5.12.2008, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Drejtësisë nëpërmjet një marrëveshjeje do ti japi një shans të dytë të paraburgosurve dhe të dënuarve përtë ndjekur arsimin e detyruar. Procesi mësimor do të realizohet me kohë të plotë ose të pjesshme në një ambient të veçantë të përshtatur për dhënie mësimi pranë I.E.V.P. Arsimit me kohë të plotë do të realizohet vetëm për nxënësit në moshën e arsimit të detyruar në IEVP Vaqarr, Tiranë. Arsimit me kohë të pjesshme do të realizohet në të gjitha IEVP, bazuar në legjislacionin përkatës për arsimimin me kohë të pjesshme. Të miturit e paraburgosur të intervistuar gjatë këtyre misionëve të monitorimit ende nuk kanë filluar të ndjekin arsimin e plotë. Gjatë kësaj periudhe ata ndjekin kurse të ndryshme të gjuhës angleze, kurse profesionale si: hidraulik, informatike, pikturë, kopshtari, etj. Në institucionin e paraburgimit të Vlorës mundësitë për veprimtari të tilla ishin më të mëdha.

Në të gjitha institucionet e monitoruara kishte programe sociale dhe edukuese për të miturit, por kryesisht programe në grup. Lë për të dëshiruar përgatitja e programeve individuale me të miturit si dhe organizimi i më shumë aktiviteteve kulturore dhe sportive. Aktivitetet sportive zhvillohen në ambientet e ajrimit të cilat janë të hapura duke u kushtëzuar kështu nga kushtet klimaterike dhe duke përbërë një shkelje të të drejtave të të miturve për aktivitete sportive të vazhdueshme. Dhomat e të miturve kryesisht janë të pajisur me televizor, radio të cilët ndihmon të miturit për të marrë informacion.

Në shumicën e institucioneve të paraburgimit të monitoruara me të miturit punonte një psikolog ose punonjës social, në raste të tjera dy punonjës social ose në ndonjë institucion tjetër si ai në Korçë nuk kishte punonjës social të përcaktuar vetëm për të miturit.

Në një pjesë të vogël të institucioneve të monitoruara gjendej i punësuar stomatolog me kohë të plotë, por shërbimi stomatologjik ishte i paefektshëm pasi mungonin pajisjet për të ofruar shërbimin. Të miturit ishin pothuajse të gjithë të kartelizuar. Pavarësisht nga prania e mjekëve në institucion, të miturit e intervistuar u shprehën se në shumicën e rasteve mjeku nuk ofronte kontrollë periodike, por vetëm kur kishin dhimbje të mëdha. Pjesën më të madhe të problemeve shëndetësore nga vetë institucioni gjejnë zgjidhje në spitalin civil të

qytetit se ku ndodhet institucioni. Më problematikë për kontrollin mjekësor të të miturve paraqitej në Lezhë ku të miturit ishin kontrolluar nga mjeku vetëm herën e parë kur ata kishin mbërritur në këtë institucion, ç'ka bie në kundërshtim me nenin 33 të ligjit nr. 8238, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve”, të ndryshuar ku thuhet se ...*shërbimi mjekësor sigurohet gjatë të gjithë kohës së qëndrimit në institucion, pavarësisht nga kërkesat e të dënuarve...*

Gjatë monitorimeve KSHH konstatoi një të mitur M.V në seksionin e të miturve, IEVP Shënkoll Lezhë, se shfaqte çrregullime mendore, për të cilin nuk ishte marrë asnjë masë. Për këtë arsye KSHH nëpërmjet një shkrese drejtuar Prokurorisë pranë rrethit gjyqësor Tiranë adresoi problemin, ku kjo e fundit nëpërmjet një shkrese na informoi se do të kryejë veprimet hetimore duke përfshirë verifikimin e ekspertimit psikiatriko ligjor.

Të miturit kryesisht nuk kishin informacion se çfarë ishte mekanizmi i kërkesë ankesës. Por sipas intervistave dhe shpjegimeve rezultonte se ata kur kishin ankesa ose kërkesa ja paraqisnin edukatorit përkatës. Nga intervistat e bëra kishte raste kur të miturit pretendonin se kishin kërkuar juristin ose punonjës social por ata kishin shkuar me vonesë.

Trajtimi gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit

Lidhur me ekzekutimin e dënimeve penale, ligji bazë që rregullon këtë fazë të procedimit penal, është ligji “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, nr 8331, datë 31.04.1998, i ndryshuar. Ligji trajton probleme që kanë të bëjnë me ekzekutimin e dënimeve penale si edhe disa rregulla të veçanta për trajtimin e të miturve në fazë.

Të miturit i garantohet komunikimi me organet kompetente, ankimi në gjykatë dhe mbrojtja me avokatë sipas nenit 7 të këtij ligji. Organet e ekzekutimit të vendimeve penale duhet të njoftojnë paraprakisht prindin ose kujdestarin për ekzekutimin e këtij vendimi (neni 14 i këtij ligji).

Ekzekutimi i vendimeve penale për të miturit bëhet në vende dhe mënyra të veçanta e favorizuese, të përcaktuara në këtë ligj ose me dispozita të tjera (Neni 5 i Ligjit për ekzekutimin e vendimeve penale si dhe në nenin 33, paragrafi 3 i Kodit Penal).

Nga monitorimi i zbatimit të ligjit të praktikë, rezulton se në shumicën e rasteve ekzekutimi i vendimit penal të formës së prerë me burgim është e njëjtë si për të rriturit edhe për të miturit.

Të miturit e kryejnë dënimit me burgim në vende të veçanta nga të rriturit, por trajtimi i tyre është larg standartave të përcaktuara në ligjet shqiptare. Në Shqipëri ka vetëm një institucion të vuajtjes së dënimit për të dënuarit e mitur: burgu i Vaqarit. Para viteve '90, në Shqipëri kanë ekzistuar institute riedukimi për të miturit dhe fëmijët. Me gjithë kërkesat e hershme dhe të vazhdueshme për rihapjen e një shkolle riedukimi për të mitur që kryejnë krime, kjo shkollë nuk është hapur ende. Aktualisht është në fazat përfundimtare Institucioni i Kavajës në të cilën do të qëndrojnë të miturit të cilët kanë marrë dënimin me burg.

Në vendet e vuajtjes së dënimit të miturit në përgjithësi qëndrojnë në qeli të veçanta nga të rriturit por ka patur raste që ata kanë qëndruar në të njëjtën dhomë me persona të rritur (shih më sipër shëmbullim A.Z i cili kishte qëndruar me të rritur në Institucionin e Rrogozhinës). Problem shqetësues për burgjet shqiptare është mbipopullimi i cili rrit numrin e të miturve që qëndrojnë në një qeli në kundërshtim me kapacitetin e lejuar. Kjo çon në shkelje të të drejtave të tyre. Gjithashtu ka patur raste që të miturit kanë pretenduar ⁵ për përdorim dhune gjatë momentit të ndalimit, qëndrimit në paraburgim si dhe gjatë vuajtjes së dënimit, raste të cilat mbeten në të shumtën e rasteve të pavërtetuara pasi janë ngritur me shumë vonesë si problematikë. Të miturit kanë pretenduar më shumë për përdorim dhune në dhomat e ndalimi dhe shoqërimit dhe denoncimi duke e bërë të pavërtetueshme për shkak të kohës së gjatë të kaluar.

2. Neni 40 i Konventës për të drejtat e fëmijës

Sistemi i administrimit të drejtësisë penale për të mitur

Respektimi i të drejtave të fëmijëve gjatë procedimit penal

Në Shqipëri nuk ka një legjislacion të veçantë për të miturit. Ligje të ndryshme përmbajnë rregullime që synojnë të mbrojnë interesat e miturve. Nga pikëpamja ligjore, në krahasim me të rriturin, i mituri gëzon disa të drejta të veçanta. Kjo mbrojtje është sanksionuar në dokumentat të ndryshëm ndërkombëtare, në Kushtetutën e RSH-së, Kodin penal, Kodin i procedurës penale dhe në ligje të tjera penale⁶.

Kushtetuta përcakton rastet e kufizimit të lirisë së të miturve: së pari, në rastet e mbikqyrjes së tij për qëllime edukimi ose shoqërimi i tij në një organ kompetent dhe kur personi (i mitur ose madhor) është

⁵ Shqetësime të tilla kanë ardhur në KSHH nëpërmjet ankesave, vëzhgimeve sporadike dhe të planifikuara të kryera në ambjentet ku qëndrojnë të miturit.

⁶ Shih publikimin “Sistemi i drejtësisë penale për të miturit në Shqipëri”, botim i Komitetit Shqiptar të Helsinkit, viti 2005

endacak, alkolist, toksiman, etj, theksohet në mënyrë të veçantë mbrojtja e fëmijëve nga dhuna ose format e tjera të shfrytëzimit (neni 53 paragrafi 3).

Detyrimi për njoftimin e prindërve

Në çastin e ndalimit ose arrestimit, policia gjyqësore duhet të lajmërojë detyrimisht prindërit e të ndaluarit të mitur (neni 255/4 të Kodit të Procedurës Penale) Që në momentin e ndalimit ose të arrestimit, policia gjyqësore duhet të lajmërojë detyrimisht prindërit e të ndaluarit të mitur. Nga intervistimi i të miturve shumica i janë njoftuar më vonë prindërit se momenti i ndalimit duke përbërë shkelje të dispozitës.

E drejta e mbrojtjes dhe ndihma psikologjike

Sipas nenit 35 të K.Pr.P-së, të miturit të pandehur i jepet ndihmë juridike dhe psikologjike, ndihma juridike e cila në rastin e të miturit është e detyrueshme. Nga vëzhgime të ndryshme të realizuara nga KSHH rezulton se në raste të rralla të miturit kanë avokat në momentin e ndalimit. Gjithashtu, jo në të gjitha rastet ju bëhen të njohura të drejtat e tyre si dhe njohja me akuzën kjo e pohuar nga të miturit gjatë intervistimit. 7 prej të gjithë të miturve të pyetur nuk janë njoftuar për të drejtën e mbrojtjes në momentin e arrestimit.

Një pjesë e mirë e të miturve të intervistuar në këtë interval kohor prej 3 muajsh kishin avokatë të caktuar nga familja, por kishte dhe nga ata të mitur të cilët kishin avokatë të caktuar kryesisht. Gjatë intervistimit të miturit pohonin se avokati vinte rrallë për t'i takuar dhe më shumë e theksuar kjo gjë ishte me avokatët e caktuar nga shteti.

Masat e vlerësimit

Për sa i përket zbatimit të masave shtrënguese ndaj të miturve, kodi i procedurës penale përcakton rregulla të veçanta lidhur me zbatimin e masave shtrënguese, por nuk përcakton masa specifike për të miturit. I vetmi lehtësim që përcakton kodi është se nuk mund të caktohet masa e arrestit me burg për të miturit që akuzohen për një kundravajtje penale (neni 230 i K.Pr.P). Përsa i përket masës së arrestit dhe afatet e tij, ato janë të njëjta si për personat e rritur, duke mos bërë ndonjë dallim nga zbatimi i afatave të paraburgimit me personat e rritur.

Ndaj të miturve, gjykatat më shpesh kanë zbatuar masa detyruese dhe jo ndaluese, veçanërisht arrest me burg, arrest në shtëpi, detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore, ndalim dhe detyrim për paraqitje etj. Nga

292 të mitur të gjykuar për vitin 2005 dhe 2006, vendimet e të cilave janë monitoruar nga KSHH, vetëm në 25 raste i mituri është gjykuar në gjendje të lire⁷.

Në administrimin e drejtësisë penale për të miturit, është e rëndësishme që të gjitha organet që e përbëjnë atë të jenë efektive dhe të respektojnë interesat e të miturve në proces. Rol në sistemin e administrimit të drejtësisë penale për të mitur luajnë policia e shtetit, policia gjyqësore, prokuroria, gjykatat, avokatët, punonjësit socialë dhe psikologët dhe institucionet e vuajtjes së dënimit.

Bazuar në kompetencat që i jep ligjit “Për Policinë e shtetit”, *policia* është në kontakt me të miturin autor të një krimi, si dhe me të miturin viktimë të një krimi në familje ose jashtë saj sidomos kur janë viktimat të trafikut dhe në rolin e dëshmitarit. Aktualisht janë krijuar struktura të posaçme, përgjegjësia e të cilave është mbrojtja e fëmijëve nga shfrytëzimi kriminal dhe përfshirja e tyre në krim, abuzimi për shkaqe të ndryshme dhe garantimi i të drejtave të tyre ligjore. Në strategjinë e re të policisë së shtetit 2007 – 2013 është lënë si detyrë zbatimi i detyrimeve të strategjisë kombëtare “Për mbrojtjen e fëmijëve” duke e shtrirë këtë dhe në nivel lokal si dhe duke bashkëpunuar ngushtësisht me organizatat kombëtare dhe ato ndërkombëtare⁸. Janë ngritur seksione të veçanta për kryerjen e veprimeve me të mitur.

Roli i *prokurorisë* në respektimin e të drejtave të fëmijëve në kontakt me drejtësinë është i rëndësishëm për shkak të veprimeve procedurale që kryen kur i mituri është në konflikt me drejtësinë. Në këtë aspekt është theksuar shumë trajnimi dhe specializimi i prokurorëve për të kryer veprimet procedurale me të miturit. Trajtime vazhduese janë kryer më së shumti nga Shkolla e Magjistraturës në bashkëpunim me organizata ndërkombëtare dhe vendase. Gjithashtu në gjashtë prokuroritë pranë rretheve gjyqësore kanë ngritur seksionet e të miturve të cilët hetojnë çështjet e të miturve.

Sistemi gjyqësor është pjesë e sistemit të drejtësisë penale. Drejtësia penale jepet nga gjykatat penale të shkallës së parë, gjykatat e apelit dhe Gjykata e Lartë. Pjesë e sistemit gjyqësor është së fundmi edhe gjykata e krimeve të rënda. për një kategori të caktuar veprash penale. Aktualisht në Shqipëri nuk ka një gjykatë për të miturit, por me dekret të Presidentit të RSH-së Nr.5351, datë 11.6.2007 u ngritën seksionet e veçanta penale për gjykimin e të miturve pranë gjykatave të rretheve gjyqësore duke mundësuar kështu një gjykim më efikas të të miturve. Dekreti i Presidentit të RSH-së ka hyrë në fuqi në 1 shtator 2007.

⁷ Të dhëna të marra nga studimi i bërë në vitin 2006 në disa gjykata të rretheve Tiranë, Shkodër, Fier, Korçë, Vlorë, Gjirokastrë dhe Elbasan. Për më shumë shih studimin “Respektimi I të drejtave të të miturve në procesin penal”, botim i Komitetit Shqiptar të Helsinkit, prill 2007

⁸ Shih “Sistemi i drejtësisë penale për të miturit në Shqipëri”, botim i Komitetit Shqiptar të Helsinkit, viti 2005

Roli i punonjësit social dhe psikologut është shumë i rëndësishëm në procesin penal kur në konflikt me ligjin është i mituri. Kjo është e parashikuar në Kodin e Familjes dhe Kodin e Procedurës Penale (nenet 35, 361, etj). Por jo në të gjitha rastet punonjësi social ose psikologu ka qënë prezent.

Përveç tyre, rol të rëndësishëm në funksionimin e këtij sistemi luan *shërbimi avokator*. Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të avokatisë duhet të vërë në dispozicion të autoriteteve proceduese listat e avokatëve dhe të vendosë kriteret për caktimin e tyre. Për të gjitha veprimet procedurale gjykata, prokuroria dhe policia gjyqësore duhet të njoftojnë avokatin e të miturit, kërkesë kjo përgjithësisht e respektuar. Aktualisht një çështje shpeshherë e diskutuar është trajnimi dhe specializimi i avokatëve për të mitur me qëllim përmirësimin e shërbimit dhe rritjen e profesionalizmit.

Deri tani ende nuk është hartuar një listë vetëm me avokatë të specializuar për të miturit por është lënë si një hap për t'u ndërmarrë në të ardhmen nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë. Pavarësisht hartimit të një sërë ligjesh si Ligji nr 10039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”.

Mosha minimale e përgjegjësisë penale

Legjislacioni shqiptar (neni 12 i kodit penal) përcakton moshën 14 vjeç si moshë minimale për përgjegjësi penale për kryerjen e një krimi dhe 16 vjeç për kundravajtjen penale. Në legjislacionin shqiptar ndryshe nga një sërë kodesh nuk parashikohet një trajtim i veçantë për personat e grupmoshës 18– 21 vjeç .

Në radhët e studiuesve, hartuesve të ligjit, të punonjësve të praktikës që merren me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve është vënë në diskutim nëse mosha për përgjegjësi penale është efektive dhe për këtë arsye është parë mundësia e rritjes së moshës së fillimit të përgjegjësisë penale⁹.

Neni 17 i Kodit Penal parashikon edhe papërgjegjshmërinë për shkak të paaftësisë për shkak të gjendjes mendore në kohën e kryerjes së veprës penale.

Masat alternative të dënimit me burgim

Kodin penal i RSH-së parashikon disa dënime alternative të cilat mund të aplikohen për të miturit, por të cilat për shkak të mungesës së infrastrukturës, janë pak të zbatueshme. Me ndryshimet e bëra në Kodin Penal

⁹ Për më shumë “Oponenca ligjore e paketës ligjore për të miturit”, studim i KSHH-së, i pabotuar, janar 2005 si dhe publikimi “Sistemi i Drejtësisë Penale për të miturit në Shqipëri”, botim i Komitetit Shqiptar të Helsinkit, viti 2005, fq 28-30.

të Republikës së Shqipërisë me ligjin Nr. 10023, datë 27.11.2008 dhe ndryshimet e ligjit Nr. 10024 datë 27.11.2008 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” janë shtuar dënimet alternative dhe u miratua baza ligjore e shërbimit të provës. Ndryshimet e bra do të mundësojnë zbatimin më të gjerë të dënimeve alternative.

Dënimet alternative që mund të zbatohen për të miturit- autor të veprave penale janë gjysëmliria, pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë, qëndrimi në shtëpi nëpërmjet të cilës jo vetëm të miturit nën 18 vjeç por edhe për personat e grupmoshës 18 – 21 vjeç, kur kanë kryer vepra penale të cilët dënohen deri në dy vjet burg ose kur kjo është pjesë e mbetur e dënimit, gjykata mund të vendosë vuajtjen e dënimit me qëndrimin në shtëpi të të dënuarit, në një shtëpi tjetër private ose në një qëndër të kujdesit dhe të shëndetit.

Nga studimet e kryera nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit¹⁰ rezulton se në përgjithësi, masat alternative për të miturit nuk kanë qënë të përdorshme aq sa duhej. Kjo situatë është rrjedhojë e mungesës të strukturave mbikqyrëse për zbatimin e masave alternative dhe mungesës së qendrave të licensuara nga për ofrimin e shërbimeve ndaj të miturve në kontakt me drejtësinë penale. Pezullimi i dënimit me burgim, parashikuar nga neni 59 i kodit penal është dënimi më i zbatuar¹¹. Kjo alternativë është zbatuar për 103 të mitur nga të cilët 76 vendime janë dhënë nga gjykata e Tiranës. I vetmi dënim alternativ për periudhën 2005 – 2006 në gjykatat në të cilat është shtrirë studimi rezulton vendimi i dhënë nga gjykata e rrethit gjyqësor Vlorë për punë në interes publik ndaj një të mituri.

Me hyrje në fuqi të ligjit po merret masat e ngritjes së strukturës së shërbimit të provës I cili do të mbikqyrë zbatimin e dënimeve alternative duke paraqitur kështu informacione dhe raporte para prokurorisë ose gjykatës. Shërbimi I provës organizohet në nivel qëndror dhe vendor. Drejtoria e Përgjithshme e shërbimit të Provës në Ministrinë e Drejtësisë përbën nivelin qëndror, ndërsa zyrat vendore të shërbimit të provës veprojnë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore. I mbetet Këshillit të Ministrave të miratojë aktet nënligjore përkatëse për zbatimin e shërbimit të provës.

Përfundime

- Të miturit e intervistuar kryesisht I përkasin familjeve më gjëndje ekonomike të paqëndrueshme ose të varfër si dhe me prindër të divorcuar ose të paafët për punë
- Nga të miturit e intervistuar pretendohet se ka patur raste dhune por ato janë më të shumta në komisariate

¹⁰ Për më shumë “Respektimi i të drejtave të të miturve në procesin penal”, prill 2007, fq 24

¹¹ Ibid., fq 24

- Nga intervistimi rezultoi se shumica e të miturve akuzoheshin për vepra penale kundër pasurisë
- Një pjesë e mirë e të miturve kanë më pak se 6 muaj të paraburgosur
- Të miturit janë gjykuar nga seksionet penale të të miturve pranë rretheve gjyqësore
- Në dhomat e ndalimit dhe shoqërimit të miturit merreshin në pyetje në mjedise të papërshtatshme
- Kushtet në komisariate lënë shumë për të dëshiruar pasi një pjesë e mirë ature janë në konstruksion
- Jo të gjitha komisarariat kanë dhoma të veçanta për të miturit
- Të miturit mbahen në dhoma të veçanta nga të rriturit në seksionet e paraburgimit por jo gjithmonë në seksione të veçanta
- Masa arrest me burg nuk shihet si një masë e fundit dhe me afate sa më të shkurtra për të miturit
- Shumë nga institucionet në të cilat qëndrojnë të miturit janë të rikonstruktura duke përmirësuar kështu kushtet fizike por përsëri në disa institucione kushtet higjeno sanitare, kushtet fizike lënë për të dëshiruar
- Ka mungesë të ujit 24 orë si dhe mungesë të ngrohjes sidomos më e theksuar në ato institucione të cilat ndodhen në zona të ftohta
- Aktualisht të miturit ndiqnin kurse të ndryshme profesionale por janë minimale dhe vihen re vetëm në disa institucione.
- Programe sociale për të miturit ka por kërkohet një organizim më i mirë i tyre duke shtuar veprimtaritë sportive.
- Shërbimi shëndetësor lë për të dëshiruar pasi nuk ishte periodik por sipas kërkesave të vetë të miturve.
- Të miturit e kryejnë dënimin më burgim në Institucione të veçanta.
- Nga të miturit e intervistuar rezultoi se prindërit ose kujdestarët nuk lajmërohen në momentin e ndalimit.
- Cilësia e avokatëve dhe specializimi i tyre mbetet ende problematik.
- Shumica e të miturve gjykohen në gjëndje arrest me burg.
- Ka hyrë në fuqi shërbimi i provës por ende nuk është vënë në zbatim në dhënien e masave alternative për të miturit të parashikuar nga ligji.



ANEKS IV

Lista e organizatave të angazhuara në mënyrë aktive për hartimin e Raportit Alternativ:

A. Trafikimi i fëmijëve dhe fëmijet e rruges:

1. Organizata “Aleanca për Fëmijë”
2. Organizata “Shkej”
3. Organizata “Partnere për Fëmijet ”
4. Organizata “Të gjithë së bashku kundër trafikimit/ BKTF”
5. Organizata “Terre des Hommes”
6. Organizata “World Vision”
7. Organizata “Tjeter Vizion”
8. QSHPLI/ Klinika Ligjore për të Mitur

B. Ambjenti familjar dhe perkujdesja alternative:

1. Organizata “Aleances për Fëmijë”
2. Organizata “Bethany Christian Service”
3. Organizata “Children Today”
4. Organizata “Every Child”
5. Fshati “SOS”
6. Organizata “AiBi”
7. QSHPLI/ Klinika Ligjore për të Mitur

C. Minoritetet:

1. Organizata “Aleances për Fëmijë”
2. Organizata “ARSIS Tirana”
3. Organizata “CARITAS Albania”
4. Organizata “Terre des Hommes”,
5. Organizata “ShKEJ”
6. Organizata “VIS Albania”

7. Organizata “Rromani BAXTALBANIA”
8. Organizata “Amaro-Dromi”
9. QSHPLI/ Klinika Ligjore për të Mitur

D. Te drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara:

1. Organizata “Aleances për Fëmijë”
2. Organizata “Për gratë dhe fëmijet”
3. Organizata “FSHDPAK”
4. Organizata “Ndihmoni jetën”
5. Organizata “MEDPAK”
6. Organizata “SH.K.SH.NJ.NO”
7. QSHPLI/ Klinika Ligjore për të Mitur